

NAMAZI

ADHURIMI NË DIMENSIONET E MIRAXHIT

NAMAZI

ADHURIMI NË DIMENSIONET E MIRAXHIT

M. Fethullah Gylen

© Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.

Ndalohet shumëfishimi, botimi, fotokopjimi dhe depozitimi elektronik, mekanik apo me anë të ndonjë sistemi tjetër regjistrimi i teksteve dhe figurave të krejt librit apo të një pjese të tij, pa leje me shkrim nga shtëpia botuese.

M. FETHULLAH GYLEN
NAMAZI, Adhurimi në dimensionet e Miraxhit
Kolana e librave – PRIZMI

Titulli i origjinalit në turqisht:
NAMAZ, MIRAÇ ENGINLIKLI İBADET

Përktheu: Alfons Pupli

Grafika: Indrit Isufi

ISBN: 9789928476517

Shtëpia Botuese “ZAMBAKU”
Adresa: Rruga Demneri, Z.K. 2679, 41/2/37
Kashar | Tiranë

www.zambaku.al

PËRMBAJTJA

Në vend të parathënies.....	11
Namazi.....	15
Hyrje.....	25

PJESA E PARË E VËRTETA E ISLAMIT

1. Përkufizimi i Islamit.....	31
2. Shehadeti dhe Islami	33
3. E vërteta e “Lá iláhe il’lalláh”	35
Kur në zemër hyn besimi!	37
4. Islami si mësim i të gjithë profetëve	40
5. Rëndësia e bindjes ndaj profetëve	43
6. Muhamedi (paqja qoftë mbi Të) si i fundit i profetëve	46
7. Besimi (imani), të vepruarit dhe nocioni ‘të qenit rob i Zotit’	49
a. Marrëdhënia besim-vepër	49
b. Nocioni i ‘të qenit rob i Zotit’	53

PJESA E DYTË NAMAZI NË ISLAM

1. Vendi që zë namazi në fe dhe rëndësia e tij	61
a. Adhurimi i parë për të cilin do të jepet llogari	65
b. Vëllai binjak i imanit	68
c. Indeksi i të gjithë adhurimeve	69
d. Përgatitja për namaz	74
e. Shpërblimi i namazit	77
2. Namazi si adhurim.....	82
a. Kryerja e adhurimeve vetëm se jemi urdhëruar për t’i kryer ato.....	82
b. Mospritshmëria në adhurime	86
c. Shirku dhe shtirja (rija) në adhurime	87
Shirku i vogël: Shtirja.....	90
Të shfaqësh diçka ndryshe në namaz	93
d. Vetëdija e të qenit rob i Zotit në adhurime	94
3. Falja e namazit në mënyrë të vetëdijshme	96

a. E vërteta e namazit	100
b. Thellimi në namaz.....	103
c. Namazet plot respekt dhe frikë	108
d. Tre elementë të rëndësishëm në namaz.....	114
e. Përqendrimi në namaz	115
f. Namazi i lamtumirës	118
g. Tre nivelet e namazit.....	119
h. Dashuruesit e namazit	120
i. Qindra rekate namaz çdo ditë	123
4. Farat e namazit.....	126
Dimensioni i meditimit në namaz.....	129
5. Dimensioni i dhikrit dhe ai i pendimit në namaz.....	133
6. Delikatesa e zemrës dhe namazi.....	137
7. Namazi i Profetit tonë të dashur (s.a.s.)	142
8. Sëmundjet që prekin namazin.....	146
a. Hedhja e vesveseve nga ana e shejtanit	146
b. Vjedhjet e shejtanit nga namazi	149
c. Dembelizmi ndaj namazit.....	149
d. Lohja nga adhurimet	154
Namazi që merr për pjesë vetëm lodhjen.....	156
Një kujtim dhe kujdesi në namaz	158
9. Ekuilibri mes namazit dhe lartësimit të emrit të Allahut	158
Ndikimi varet nga marrëdhënia me Allahun.....	162
Tre kushte për t'u bërë 'Hero i Namazit'	163
10. Funkzioni i mesxhideve dhe xhamive.....	166

PJESA E TRETË PËRGATITJA PËR NAMAZ

1. Abdesi	173
Paralajmërimi i parë në rrugën drejt namazit.....	174
Thellësia në mendime.....	175
Të qëndruarit larg preokupimeve.....	179
a. Pastrimi i dhëmbëve para abdesit.....	181
b. Kuptimet që shprehin duatë e abdesit	183
Marrja e abdesit në mënyrën e duhur pavarësisht vështirësive.....	185
Teprimi (ifrat) në adhurime dhe lënia e tyre mangët (tefrit)	189
c. Mirësitë që plotësohen me abdesin	191
d. Shkallët e pastërtisë në namaz	194
2. Ezani	197
3. Namazet sunet.....	200
4. Ikameti.....	202

PJESA E KATËRT
PJESËT PËRBËRËSE TË NAMAZIT DHE URTËSITË E TYRE

1. Kushtet e namazit	208
a. Taharet nga hadethi – Pastrimi konvencional (Marrja e guslit dhe abdesit)	208
b. Pastrimi material (Pastrimi nga ndyrësitë materiale)	209
c. Mbulimi i pjesëve intime të trupit	209
d. Orientimi kah kibla	210
e. Koha	212
f. Nijeti	212
<i>Nijeti është shpirti i asaj që vepronhet</i>	214
<i>Një përpyetje deri në vdekje</i>	216
2. Shtyllat e namazit	218
a. Tekbiri iftitah (fillestar)	218
b. Kijami (Qëndrimi në këmbë)	219
c. Kiraeti (Leximi i ajeteve të Kuranit)	220
d. Rukuja	224
e. Sexhdeja	225
f. Teshehudi/Ulja pas çdo dy rekateve	229
3. Elementë plotësues të namazit	231
a. Ta’dfili erkán	231
Qëllimi i namazit	234
b. Falja e namazit me xhemat	237

PJESA E PESTË
KOHËT E NAMAZIT

1. Caktimi i namazit pesë herë në ditë	243
a. Pesë kohët e namazit në Kuranin Famëlartë	243
b. Pesë kohët e namazit në hadithe	247
2. Urtësitë e caktimit të namazit në pesë kohë të ditës	250
a. Kuptimi i kohës së namazit të sabahut	253
b. Kuptimi i kohës së namazit të drekës	255
c. Kuptimi i kohës së namazit të ikindisë	256
d. Kuptimi i kohës së namazit të akshamit	258
e. Kuptimi i kohës së namazit të jacisë	259
f. Errësira e natës dhe tehexhudi	261

PJESA E GJASHTË
FRYTET E NAMAZIT

1. Frytet e namazit në aspektin individual	267
a. Të qetëson zemrën dhe të mundëson një paqe shpirtërore	267
Për të siguruar paqen e zemrës	271

b. Bën që ndjenjat e njeriut të marrin drejtimin e duhur	275
c. Është një përgjigje ndaj ftesës hyjnore	277
d. Është bashkëbisedim me Zotin.....	278
e. E mban njeriun larg imoraliteteve	280
f. Të kujton kushtet e besimit.....	282
g. Është shlyerje për mëkatet.....	285
h. Të afron tek Allahu.....	286
2. Frytet e namazit në aspektin shoqëror.....	289
a. Mundëson barazinë mes njerëzve	290
b. Disiplinon njeriun dhe shoqërinë.....	291
c. E bën njeriun bujar.....	293

PJESA E SHTATË NAMAZI I XHUMASË

1. Rëndësia e namazit të xhumasë.....	297
2. Namazi i xhumasë është një adhurim gjithëpërfshirës	304
3. Disa pika që duhen pasur kujdes në namazin e xhumasë	305
4. Namazi i parë i xhumasë	309
5. Kërkimi i kohës së lutjeve të pranuar në ditën e xhuma.....	312

PJESA E TETË NAMAZET NAFILE

1. Të mirat e namazeve nafile	317
a. Plotësojnë farzet	317
b. Na afrojnë akoma më shumë me Allahun	318
c. Të lartësojnë në gradë.....	319
2. Disa namaze nafile.....	324
a. Namazi i tehexhudit.....	324
Jeta e natës e trashëgimtarëve të kauzës së profetësisë.....	331
b. Namazi/dua i/e nevojtarisë (hâxhet)	333
Si falet namazi i nevojtarisë?	336

PJESA E NËNTË DUATË QË MUND TË THUHEN NË NAMAZ

1. Duatë që mund të thuhet në ruku	343
2. Duatë që mund të thuhet kur ngrihemi nga rukuja.....	344
3. Duatë që mund të thuhet në sexhde	345
4. Duatë që mund të thuhet mes dy sexhdeve	346
5. Duatë që mund të thuhet në teshehud.....	346
6. Ajetet që mund të thuhet si dua në çdo pjesë të namazit	347
7. Nga duatë e tjera të Profetit tonë (s.a.s.)	348

Kjo vepër është përpiluar në bazë të ligjëratave në lidhje me temën e namazit, të cilat autori ynë i nderuar i ka zhvilluar nëpër foltoret e xhamive para vitit 1980, atëherë kur vazhdonte të ushtronte detyrën e predikuesit të fesë.

Në vend të parathënies

“Namazi është miraxhi i besimtarit; namazi është drita, buraku i tij në rrugën drejt miraxhit; namazi është anija, sateliti, aeroplani i shpirtrave besimtarë në udhëtim; ai është vendqëndrimi më i afërt me të përtejmen, vendstrehimi i fundit i udhëtarit që synon afrimin me Zotin dhe takimin me Të; namazi është një nga mjetet më të mëdha në shërbim të përmbushjes së qëllimit e që ndan me të të njëjtin cak.”

Po, kështu e përshkruan namazin Fet’hullah Gyleni... Namazi është miraxhi i besimtarit, mjete që na mundëson arritjen te Zoti përmes rrugës më të shkurtër të mundshme, një nga pesë kushtet e Islamit, shtylla më e rëndësishme pas deklarimit të shehadetit. Aq i rëndësishëm është namazi, saqë mund të konsiderohet edhe si vëllai binjak i imanit. Vetëm se imani ka lindur pak para tij. Qëllimi është fitimi i kënaqësisë së Allahut, namazi është shkaku që bën të mundur arritjen e këtij qëllimi. Megjithatë, ekziston një vijë e hollë mes shkakut dhe qëllimit. *“Në Kuran, namazi përmendet menjëherë pas çështjeve që i përkasin besimit. Edhe pse ne nuk mendojmë kështu për të tjerët, sahabët dyshonin në imanin e atij që nuk falte namaz.”* Në këtë mënyrë e shpjegon autori vëllazërinë iman-namaz. Prandaj, sado shumë përpjekje të tregohet për namazin, sado të shumta të jenë vështirësitë përballë të cilave nxjerrim gjoksin, gjithmonë ia vlen.

Kushdo mund të flasë për namazin, por, ta dëgjosh atë nga njerëzit që janë bërë njësh me të, është krejtësisht tjetër gjë. Sa njerëz janë në gjendje t’i shprehin përvojat e përjetuara në namaz, ato çfarë ndiejnë

teksa qëndrojnë me përrulje dhe gjithë respekt në praninë e Allahut? Sa njerëz mund të tregojnë se çfarë afërsie me Zotin kanë arritur të kapin nëpërmjet sexhdes? Sidomos në ditët e sotme, sa njerëz që janë në gjendje ta falin namazin ashtu siç duhet, duke i dhënë hakun atij, mund të hasim? Sa prej tyre arrijnë të bëhen shembull për të tjerët? Nëse namazi shpjegohet ashtu siç përjetohet, në përputhje me të vërtetën e tij, dhe jo nëpërmjet ca informacioneve të thata, kushedi sa e sa persona, deri më tani të huaj ndaj namazit, do të fillojnë të falin namaz. Madje do të ketë edhe nga ata që pandehin se i kanë falur namazet, por që do të thonë sërish *'bismil'lah'* e do t'ia nisin edhe një herë nga e para. Ashtu siç gjen të barasvlershmin e tij në këto fjali:

“Gjatë namazit, besimtari është i këndellur në maksimum dhe gjendet i rrethuar nga paqja, qetësia e të qenit i drejtuar me gjithë zemër për nga Zoti i vet. Fundja, kjo është sjellja dhe qëndrimi që i shkojnë atij për shtat. Pakujdesia dhe hutesa, në asnjë mënyrë nuk mund të futen në ambientin e tij.”

“Gjatë kohës që është në kijam (qëndrimi në këmbë gjatë faljes së namazit), besimtarit do t'i vijnë në mendje gjithë këto mirësi të grumbulluara në shportën e tij dhe, gati për të dhënë llogari para Zotit në Ditën e Gjykimit, do ta imagjinojë veten përballë urdhrin 'Jep llogari për frymët që ke marrë e ke dhënë gjatë gjithë jetës tënde!'”

“Besimtari, që, për të fituar atë që Zoti i ka premtuar, përmbush urdhrin dhe propozimin që po Zoti i tij i ka bërë, do të ndiejë një kënaqësi të ëmbël dhe të pakufi në të gjitha pjesët përbërëse të namazit. Sepse pas këtij premtimi fshihet fitimi i kënaqësisë së Allahut dhe soditja e bukurisë hyjnore.”

Ja pra, fryt i të tilla ndjenjave është libri që po mbani në duar. Më shumë se një libër ilmihali që përbëhet vetëm nga informacione dhe dije teorike, është një udhëzues që do të pasqyrojë frymën, shpirtin e namazit. Ndonëse nuk i përmban disa tituj që mund t'i hasim në një libër të zakonshëm ilmihali, është e mundur që, për ata që dëshirojnë ta falin namazin ashtu siç duhet, të gjenden një sërë njohurish të përgjithësuar.

Pjesa kryesore e librit përbëhet nga seria e ligjëratave të Fet'hullah Gylenit në lidhje me temën e namazit, të cilën e ka predikuar mes datave 11 gusht – 13 tetor të vitit 1978 në xhaminë e qendrës së Bornovës, në Izmir. Pas një shqyrtimi të detajuar, këto ligjëratat u kthyen nga gjuha e folur në atë të shkruar. Më vonë, teksti i përftuar nga ligjëratat u pasurua me shtesa nga fjalime dhe shkrime ndër vite të Fet'hullah Gylenit në lidhje me namazin. Pjesët e grumbulluara, pas një klasifikimi të fundit, iu nënshtruan edhe korigjimeve dhe rregullimeve përfundimtare. Në fund, pas një kontrolli edhe nga vetë Fet'hullah Gyleni dhe pas miratimit të tij, libri arriti në duart tuaja.

Me ndihmën e Zotit, duke filluar nga libri i namazit, kolanës së veprave të Fet'hullah Gylenit do t'i shtohet edhe '*Seria e adhurimeve*', ndërsa ne, do të kemi mundësinë të përsiatim nga horizonti i të nderuarit Fet'hullah Gylen adhurimet, të cilat përbëjnë shtyllat e Islamit. Dëshirojmë që librat e tjerë të serisë, konkretisht *Agjërimi*¹, *Zekati* dhe *Haxhi*, t'i përgatisim sa më shpejt të jetë e mundur dhe t'ua paraqesim vlerësimeve tuaja.

Përpyekja nga ne, suksesi nga Allahu...

¹ Libri i agjëritimit është botuar edhe në shqip (Agjërimi - Adhurimi i Veshur me Falje).

Namazi

Namazi është miraxhi i besimtarit; namazi është drita, buraku i tij në rrugën drejt miraxhit; namazi është anija, sateliti, aeroplani i shpirtrave besimtarë në udhëtim; ai është vendqëndrimi më i afërt me të përtejmen, vendstrehimi i fundit i udhëtarit që synon afrimin me Zotin dhe takimin me Të; namazi është një nga mjetet më të mëdha në shërbim të përmbushjes së qëllimit e që ndan me të të njëjtin cak.

Rruga e të qenit faqebardhë e me sy shkëlqimtarë në Ditën e Kiametit, me duar e fytyra krejtësisht të pastra, me një ndërgjegje të delirë sa botët e brendshme të atyre në qiell, rruga e të qenit edhe para të parëve, me shenjat e sexhdes dhe të abdesit nëpër trup, kalon nga namazi dhe nga veprimet që bëhen para namazit. Në të njëjtën kohë, këtij adhurimi, i cili konsiderohet edhe një gradë e veçantë e afrimitetit me Allahun dhe që përfshin thellësi shumë të ndryshme, nëse marrim parasysh kuptimin e kalimit të jetës para Zotit duke u përqendruar në idenë e të qenit rob i Tij, mund të quhet edhe “*ribat*” (lidhje).

Abdesi – ruaj mendimin e shqyrtimit të temës së abdesit veçmas në vazhdim – është paralajmërimi i parë dhe përgatitja më e parë në rrugën drejt namazit; kurse ezani – edhe kjo çështje duhet shpjeguar më vete – është paralajmërimi i dytë dhe një mënyrë e rëndësishme “tendosjeje metafizike”. Njeriu, trupi i të cilit pastrohet nga gjërat e papastra dhe negativitetet e dukshme e të padukshme në sajë të abdesit, nëpërmjet ezanit dëgjon ndërgjegjen dhe përfytyrimet e mundësuarat prej tij, kurse me namazin e parë që fal, përpiket të gjejë zërin, frymën thellë brenda vetes dhe, mandej, vihet në pritje të startit të lëvizjes së madhe, e cila mund të realizohet vetëm nëpërmjet faljes me xhemat.

Ky adhurim i bekuar në dimensionet e miraxhit, që e bën njeriun të endet në qiejt e pafundësisë dhe të arrijë gjer në botën e engjëjve, është si një lumë brenda të cilit hidhemi e lahemi pesë herë në ditë dhe që, në çdo zhytje, na pastron edhe një herë tjetër nga gabimet tona; na merr dhe na çon në oqeane, na shëtit vazhdimisht mes fillimit e fundit, dhe kjo, në vetvete, bart kuptimin e ushtrimeve të përjetshmërisë dhe përshpirtshmërisë jashtë dimensioneve tona.

Nëpërmjet namazit, dita dhe nata e njeriut i nënshtrohen një ndarjeje plot të fshehta. Jeta organizohet sipas një kuptimi të kohës me në qendër adhurimin dhe, në këtë mënyrë, bëhet e mundur vazhdimësia e sjelljeve tona të bukura nën kontrollin dhe mbikëqyrjen e Zotit. Ndërkohë, veprimet tona jashtë adhurimeve shndërrohen gjithashtu në adhurime, marrin ngjyrën e tyre dhe jeta jonë e përkohshme në këtë botë fillon të valëvitet me ngjyrën e atyre në qiell.

Kur çasti i vërshimit të ezanit mes zhurmëve të kësaj bote apo edhe nga mesi i një heshtjeje të përgjithshme të bëhet i qartë nëpërmjet akrepave të orës, lëvizjes së diellit, shtimit të zërave dhe frymëmarrjeve rreth e rrotull xhamisë, përjetimit të emocionit të pafundësisë në çdo anë, kontrollit të fytyrës nga ana e muezinëve dhe tingujve të parë fishkëllyes e të zhurmshëm të altoparlantëve, do të fillojnë të dëgjohen bisdat e heshtura nëpër zemra, përçartjet e njerëzve brenda turbullirës të të qenit të sapozgjuar nga gjumi dhe fjalët që i kapërcejnë dimensionet tona sikur të ishte duke u përjetuar një botë e ndërmjetme mes dynjasë dhe botës së përtejme. Për më tepër, me manovrat e mendimeve në kërkim të një shtegu të ri dhe me marrjen në konsideratë të rrugës së namazit edhe pse ende nuk është bërë hyrja brenda tij, dalin në pah një sërë ndjenjash të tjera, mëmëritet një botë e tërë gjërash dhe, në emër të adhurimit që planifikohet të realizohet pak më pas, kërkohet përqendrimi dhe tendosja metafizike e nevojshme në përpjekjen për të arritur qëndrueshmërinë me të gjitha aftësitë shpirtërore.

Ecja drejt mesxhidit, mendimet gjatë rrugës, tendosja e parë dhe akordimi, që realizohen përmes abdesit, mund të konsiderohen si përpjekje për të arritur qëndrueshmërinë e duhur. Ezani është si një ftesë për në dhomën e haremit, një tingull hyjnor që na përgatit për

përqendrimin deri në thellësitë e shpirtit tonë, një penzë që ulet e ngrihet mbi ndjenjat tona. Edhe pse veshët tanë janë mësuar me të për shkak se përsëritet çdo ditë, edhe pse logjika jonë e thjeshtë e merr si të mirëqenë atë, ezani shfaqet papritmas pas kodrave, që janë gjithmonë të pranishme mes nesh dhe së përtejmes, si një hënë. Ezani gjëmon si rrufetë dhe, brenda një çasti, bën që shikimet tona tokësore t'i kthehen qiellit. Ndërkohë, fillon një kapitull krejt i ri hyjnor, që vërshon si uji i burimeve, që shpërthen madhërisht si një ujëvarë dhe që zbraz në shpirtrat tanë melodinë më të këndshme në botë, atë më mahnitësen, më gjallëruesen. Por nuk mbetet me kaq, na tërheq drejt atmosferës së atllastë të konotacioneve dhe i pëshpërit zemrave tona magjitë e epokave të ndritshme, na entuziazmon duke na i gjetur dhe kthyer sërish ëndrrat tona të hapura drejt përjetësisë dhe gjërat që kemi humbur nëpër kthesat e ndryshme të historisë, na dhuron një tufë zërash të freskët, një tufë poezish dhe harmoni. Sikur të jemi duke marrë një dush muzikor, ne ezanin e ndiejmë gjithmonë me gjithë qenien tonë dhe, në çdonjërin nga këto ndjesi, zgjohemi ndaj një magjie të papërshkrueshme, një shijeje, hijeshie dhe kënaqësie tjetër. Kjo ndjenjë dhe intuitë, shumë herë na ngre drejt qiellit nëpërmjet një spiraleje të magjishme ose na jep ndjesinë e fluturimit me balonë në lartësi shumë të mëdha. Aq më shumë kur ezani këndohet në përshtatshmëri të plotë me thelbin e tij, si zëri e fryma e ndërgjegjes. Sa të shndritshme dhe përtëritëse janë minutat e ezanit; kur qiejt mbushen me dritë, shpirti Muhamedan hap flatrat dhe gjuha Ahmedane i bën qiejt dhe tokën të kumbojnë! Në ato minuta, nëse njeriu do të zbriste në thellësitë e shpirtit, nëse do t'i vinte veshin ndërgjegjes së tij, kushedi ç'kuptime të pazbuluara më parë do të ndiente, kushedi ç'asociacione ndjesish do t'i ngjallehin në thellësitë e tij!

Ndërgjegjet e gjalla, të cilat, duke rinovuar vazhdimisht veten, janë në gjendje të ruajnë freskinë e tyre përse i përket zemrës dhe shpirtit, në çdo kohë ezani ndiejnë ëmbëlsinë dhe gjallërinë e çasteve kur ai zbriti për herë të parë nga qielli, kurse brenda zërit që lartësohet nga minaret dëgjojnë thirrjet e pejgamberëve. Mandej arrijnë korin e tekbireve, tehlileve (të thënit "*Lá iláhe il'lallah*") dhe shehadetit të engjëjve në

zemrat e tyre, dhe, në fund, bëhen sikur po dëgjojnë frymën ringjallëse të Xhibrilit, frymëmarrjet jetëdhënëse të Israfililit.

Pasi arrihet tendosja dhe ngopja jashtë namazit nëpërmjet ezanit, akoma pa filluar hapja drejt thellësive të afrimitetit të vërtetë përmes namazit farz, me namazin e parë nafile dhe ikametin, të cilët konsiderohen pjesë të fazës së rrethimit të shpirtrave nga flladet e mëshirës hyjnore, kontrollohet edhe një herë tjetër përqendrimi i thelluar hap pas hapi deri në atë minutë. Mbasi rishikohen edhe një herë vëmendja dhe kujdesi, që i përkasin qetësisë dhe paqes përfundimtare, fillon ecja drejt namazit sikur të ishte një ecje për në miraxh. Zërat, tingujt, fjalët dhe veprimet që përplasen me zemrën tonë deri në atë moment, që bëhen shkak për kalimin e anëve tona njerëzore në një gjendje alarmante dhe që na bëjnë të drejtohemi për nga mihrabi ynë i përjetshëm, janë si një proces akordimi për gjetjen e melodisë së vërtetë të zemrës sonë në telat e ndërgjegjes. Zëri i vërtetë në adhurim, para atij mihrabi unik, fillon me veprimet e përbashkëta të pjesëtarëve të xhematit, ndjenjat dhe mendimet e të cilëve janë bërë një, që, të përulur e me duart të lidhura para vetes, qëndrojnë pas një imami, që përkulen për të shprehur respektin dhe nderimin e tyre, që ngrihen e i bëjnë temena të Vërtetit (*xhel'le xheláluhu*), që ulen në tokë dhe, duke bashkuar kokë e këmbë në të njëjtën pikë, ecin drejt Allahut. Në atë masë që e ndiejmë në ndërgjegjet tona vetëdijen e xhematit, po në atë masë bëhemi sikur po ndiejmë dhe dëgjojmë të gjitha bukuritë, gëzimet, harënë e epokave të ndritura, dikur të përjetuara nga profetët.

Po, për ata që janë bërë njësh me harmoninë e namazit në qiej, çdo lëvizje dhe çdo fjalë pas imamit lëshon tingujt e mallit të qenies njerëzore për parajsën e humbur dhe valëvitet me një ndjenjë shprese, atë të shpresës për t'u ribashkuar me të. Pothuajse për të gjithë ata që e lëshojnë veten në atmosferën e namazit, këtij adhurimi në dimensionet e miraxhit, ai ngjason me agimet e ditëve lozonjare e plot ëndrra të periudhave tona parajsore të dikurshme dhe të xheneteve përtej kësaj bote. Ne, në masën e botës sonë emocionale, sa herë qëndrojmë në namaz, gjerbim dëlirësinë dhe qetësinë e një brezi të tërë drite, që

shtrihet nga bukuritë e xhenetit deri në epokat tona të arta dhe shtriqemi gjithë haré. Në këtë mënyrë, mendjet tona, të shthurura e të pështjelluara nga një mijë e një rropama të botës, vijnë në vete; shpirtrat tanë çlirohen nga atmosfera e zyrtë dhe shtrënguese e trupores dhe bota jonë e zemrës fillon të fluskojë edhe një herë me dëshirën e zjarrtë të ribashkimit. Njerëzit e shpirtit dhe zemrës, edhe nëse jo në çdo kohë namazi dhe në çdo kryerje të farzeve, të paktën disa herë në ditë bëjnë vajtje-ardhje mes parapërjetësisë dhe përjetësisë; shumë herë mendojnë njëkohësisht për të kaluarën dhe të ardhmen; pjesët e arta të kohës, të cilat duken sikur kanë kaluar, i soditin bashkë me majat e smeralda të së ardhmes që valëvitet gjithë shpresë; ndiejnë e jetojnë në të njëjtën kohë jetën e tyre bashkë me jetën që kanë jetuar të tjerët dhe, sikur të jenë duke pirë nga uji i keutherit, gjejnë brenda vetes kujtime të një mijë e një kënaqësive dhe lumturive. Ashtu si në ëndrra, kapërcejnë distancat, enden nëpër botë të pakufizuara nga koha, ndiejnë të gjitha kënaqësitë e gjërave të jashtëzakonshme, kalojnë nga njëra ndjenjë në tjetrën e nga ideja në ide dhe çdo moment e përjetojnë brenda një tufani të veçantë njohjeje, dashurie dhe kënaqësie. (Këto konsiderata janë për ata që kanë arritur në këtë pikë të horizonteve të mendimit dhe dijes.)

Sidomos kur shpirti dhe zemra bëhen njësh me namazin, kjo cilësi ndriçuese i transformon veprimet tona të zakonshme duke i zëvendësuar ato me poezinë e saj dhe duke i mbështjellë me harmoninë dhe natyrën e saj qiellore.

Lëvizjet misterioze dhe magjike të namazit, të cilat ushqejnë mendimet, imagjinatën dhe ëndrrat tona disa herë në ditë, gjithmonë e gjejnë një mënyrë dhe një shteg që do të mundësojnë kalimin në botët e përtejme e që do t'i bëjnë zemrat tona të thonë:

*“Vendi im në hapësirë u zëvendësua,
I tërë trupi në shpirt m'u shndërrua,
Vështrimi i Zotit qartaz u dallua,
Veten e pashë të dehur në bashkim!”*

(Nesímí)

Dhe, në këtë mënyrë, me thellësitë e tij edhe përtej dimensioneve, adhurimi vë në dukje edhe një herë atë bukuri të pafillim, të fshehur nëpër zemra si një thesar, dhe burimin e të gjitha përfitimeve. Për këtë arsye, më shumë se sa çështjet e njohura dhe që duken qartë, në namaz përjetohen një tufan ndjenjash dhe një vorbull emocionesh madhështore, që i kapërcejnë rrethanat dhe çështjet si sasia apo cilësia. Në namaz, horizontin tonë të të shprehurit e mbështjellin gjëra që nuk mund të thuhet gjithmonë. Ndjenjat e pamundura për t'u shprehur i pëshpërisin shpirtit tonë një melodi të çuditshme. Ndjesi e mendime të thella, që vështirë të përfshihen nga gjuha jonë e përditshme, pushtojnë qenien tonë. Dhe hapen dyert e një zgjuarsie në ngjyra të padukshme, të një mendimi thuajse në vijën e atij të profetëve, të cilat i kalojnë kufijtë e mendjes materiale dhe të logjikës abstrakte. Nga ky këndvështrim, mund të themi se, për robin, nuk ka një adhurim më të madh se namazi dhe nuk ka një gjendje më të shëndetshme dhe më të thellë se ato të shoqëruara nga përfytyrimet dhe mendimet që flluskojnë në namaz.

Horizonti i namazit, që arrihet nga shpirti i njeriut duke kapërcyer me ndjenjat dhe perceptimet e tij ekzistencën dhe çdo gjë tjetër që mund të shihet me sy dhe duke mbërritur në pikën e të padukshmes dhe të panjohurës, shpreh përmallimin, pikëllimin dhe mallin për vendlindjen e të gjithë shpirttrave që janë në gjendje ta dëgjojnë atë. Në të njëjtën kohë, shpreh edhe qetësinë e zembrës, këndshmërinë e ndjenjave njerëzore, soditjen e sipërfaqes së tokës nga ana e yjeve, sekretet e qiejve, rrezatimet e botës së përtejme, shpatet e xhenetit, pemët që lëkundën nëpër ato shpate, lumenjtë që rrjedhin nën ato pemë... I shpreh të gjitha këto me çdo pjesë të tyren, me Kuranin brenda tij, me lutjet... I shpreh të gjitha këto dhe, me një mënyrë krejtësisht të re, i përsërit sikur të ishte duke u shërbyer ujë keutheri shpirttrave tanë...

Pas kijamit, këta robër besnikë e të mbërthyer tek adhurimet dhe robëria ndaj Zotit, emocionet e shpirttrave të tyre të dëlirë dhe ngazëllimin e mendimeve të tyre të drejta dëshirojnë t'i ulërasin edhe një herë nga podiumi i rukusë. Me një ndjenjë që buron nga përzierja

e madhësisë me mëshirën e hirësinë dhe me një sjellje dinjitoze, përkulen si një shkop; përkulen dhe, me një vetëdije të thellë të të qenit robër të Zotit, mërmërisin në çdo çast madhështinë hyjnore, përpiqen të hapin dyert e “Bahçes së Shenjtë” nëpërmjet rukusë, kësaj mënyre të një pjese të banorëve të qiellit për t’iu drejtuar Allahut, dhe arrijnë thellësitë e botëve të tyre shpirtërore në masën e hapjes së atyre dyerve. Ashtu si në haxh apo edhe në udhëtime të tjera, ku ngjitja drejt majave dhe arritja në rrafshnalta pas kapërcimit të majave shoqërohet me këndim të tekbireve dhe tehlileve, edhe gjatë miraxhit, këtij udhëtimit shpirtëror nën titullin ‘namaz’, kalimi nga një pjesë e tij në tjetrën shoqërohet me të njëjtat ndjenja e mendime të dëlira dhe shprehet gjithmonë nëpërmjet të njëjtave fjalë të bekuara. Me tekbiret, tahmidet dhe mendimet që rrjedhin nga këto fjalë, të cilat, për të shprehur në mënyrën më të mirë të mundshme respektin ndaj Allahut, thuhet pothuajse në çdo pjesë të namazit, preken tokmakët e portës së Divanit të Lartë dhe, mandej, me vëmendjen, vigjilencën dhe kujdesin për ta vlerësuar në mënyrën më të përsosur një çast të volitshëm, kalohet në pritje të asaj ore të nderuar; kalohet në pritje dhe, me ndjeshmërinë e një maceje që pret gjahun e saj, me durimin e një merimange, bëhen përpjekje për të kapur përfitimet dhe pasqyrimet hyjnore.

Rukuja lëshon mbi ne fladet e saj në një hap më tej kijamit dhe u pëshpërit shpirtrave tanë rreth një ëndrre më të bukur se jeta, më joshëse se kënaqësitë trupore dhe të pamundur për t’u bërë realitet në këtë botë të kufizuar. Na pëshpërit sa e sa gjëra rreth kësaj ëndrre, të cilën ne nuk jemi në gjendje as që ta bëjmë pjesë të imagjinatës sonë. Zemrave tona i premtan ditë, orë dhe minuta të smeralda, përtej objekteve që dëshirojmë dhe presim. Në fund të fundit, a nuk jemi të gjithë nga pak fëmijë të shpresave, idealeve, ëndrrave dhe pritshmërive tona? Pothuajse të gjithë ne, kur zgjohemi ndaj realitetit pasi jemi rrahur nga mbrapshtitë e ditëve të sotme, e kapërcejmë kohën brenda së cilës ndodhemi dhe, me shpresën e jetës dhe lumturisë që do të arrijmë më tej, themi “e ardhmja” dhe kundrojmë livadhet e xhenetit me buzën në gaz.

Rukuja, me dimensionet në kuptimin e saj të përkuljes para Zotit, merr zërat e të gjithë të përkulurve dhe, herë duke thënë “Zoti im, mua më ka prekur e keqja” e herë “Vetëm Ty t’i shpreh hallet e mia dhe rrëmujën brenda kokës sime”, na bën të ndiejmë një gurgullimë nga lumi i jetës dhe një aromë këmishe nga krahina e Jusufit (a.s). Në këtë mënyrë, nëpërmjet sihariqit të mrekullive që do të vijnë nga përtej të vërtetave, na bën të shpërthejmë në haré. Madje na emocionon në një mënyrë të atillë, saqë drejtojmë belin në shoqërinë e një tufani falënderimesh dhe i servirim Atij edhe një moment tjetër mirënjohjeje. Ky qëndrim i shkurtër në këmbë është një liman i veçantë nisjeje drejt të Vërtetit dhe ndryshe nga ai i pari. Në këtë liman të shndritshëm, kijamin, leximin e ajeteve të Kuranit dhe tesbihet e rukusë i kalojmë edhe një herë nëpër thellësitë e zemrës sonë, përpiqemi të ndiejmë pafundësinë e ndjenjave, imagjinatës dhe ëndrrave tona duke i ngjeshur ato brenda kësaj ndalese fare të shkurtër, mobilizojmë të gjitha forcat tona ndjenjësore për të përfituar sa më shumë dhe, me pamjet e “thesareve të fshehtë” që kemi kapur, lëshohemi në një rrjedhë të re ndjesish, më të gjerë, më të thellë dhe në ngjyrat e një afërsie më të madhe me Zotin. Është e vështirë të kuptosh se ç’lloj gëzimi dhe kënaqësie arrijnë ata që e ndiejnë namazin në ruku dhe e dëgjojnë në kijam, se me ç’tmerr dhe respekt përpëliten, me çfarë shpresash tendosen dhe se me ç’lloj frike dridhen. Kjo mënyrë të ndieri, ky dëgjim, është i pari i hapave më seriozë të ndërrmarë drejt arritjes tek i Dashuri, ndërsa hapi i dytë është sexhdeja.

Sexhdeja është terreni i falënderimeve dhe mirënjohjes për dhuratat e shpërblimet e mundësuar brenda namazit; ajo është ena refraktare e frikës dhe respektit, brenda së cilës derdhen plotësisht zemrat e shkrira, për të marrë trajtën e të qenit robër të Zotit. Sexhdeja ndodhet mes lutjeve dhe pranimit të tyre nga ana e të Vërtetit. Ajo është vija e drejtë mes dy pikave. Sexhdeja është vendi ku mbizotërojnë mendimet dhe ndjenjat e zjarra të mallit ndaj të Dashurit që duhet njohur dhe dashur, është vendi i takimit me Të. Ne, duke e provuar sexhden në vendndodhjen e saj të vërtetë, ndiejmë një esencë të filtruar nga imani, Islami dhe ihsani të rrjedhë në majat e smeraldta të zemrave tona, duke kaluar nëpër kijamin,

rukunë dhe qëndrimin në këmbë pas rukusë të namazeve tona.

Në sexhde, duke bashkuar në të njëjtën pikë kokën dhe këmbët, marrim një formë të rrumbullakët; tendosemi si një hark; bëhemi një zë, një frymë, dhe rënkojmë. Bashkojmë me imanin tonë pafundësinë e shpresave tona të mjaftueshme për çdo vepër dhe paradhënien e mëshirës që shfaqet te çdo gjë. Përpiqemi të ndryshojmë fatin tonë duke kaluar nën këtë brez shumëngjyrësh, që i ngjan një ylberi me njërin skaj në këtë botë dhe skajin tjetër në botën e përtejme.

Në këtë pikë, në këtë majë të fatit të tij, tek e cila e kanë ngritur ndjesitë e përjetuara në sexhde dhe nga ku shikon e mediton të vërtetën, duke përdorur gjuhën e zemrës, duke derdhur të gjitha fjalët e ndjenjave të tij, duke e kthyer pak dynjanë drejt anëve të botës së përtejme dhe duke lejuar që bota e përtejme të reflektohet pakëz në botën e tij shpirtërore, njeriu mund të ndiejë dhe përjetojë një privilegj të atillë, thua se është duke lexuar eposin e adhurimeve dhe robërisë së tij ndaj Zotit.

Po, kur duatë, që shpërthejnë me vetëdijen e të qenit rob i Zotit, ndeshen me ujëvarat e mëshirës dhe begative të Tij dhe vërshojnë brenda njëra-tjetrës, kur lutja dhe përgjigjja e saj takohen me shoqi-shoqin, ndjenjat tona fillojnë të rrjedhin po aq bukur sa jeta parajsore, po aq gjerësisht sa malli i ritakimit. Për ata që kuptojnë, shija e këtyre bukurive është aq e mprehtë, theksi i tyre është aq magjepsës, saqë, pasi i kanë ndier dhe përjetuar ato një herë, nuk dinë si të falënderojnë e të jenë mirënjohës ndaj Pronarit të mirësive për gjithë këto mirësi.

Një rob i Zotit, që, i përlurur dhe me një spirale drite, ngjitet në majat më të paarritshme dhe i jep nëpërmjet këtij udhëtimi qiellor një tjetër thellësi afrimitetit me të Vërtetin, me ndjenjën, vetëdijen dhe dehjen e arritjes së “Bahçes së Xhenetit” dhe duke paraqitur respektin e lavdërimet ndaj Allahut për ta larmuar edhe me një dimension tjetër takimin me të Dashurin, ngre kokën gjithë respekt dhe, duke thënë “*ettehijātu...*” me edukatën dhe moralin e të gjendurit para Tij, kalon në ekstazë, në një gjendje të magjishme, të mbinatyrshme, sikur të mos jetë më një genie tokësore.

Aq sa heroi i namazit, i entuziazmuar nga këto kënaqësi të pafund dhe me një ndjenjë që nuk di të ngopet, përtej kufijve të sasisë dhe cilësisë, kthehet drejt shlyerjes së borxhit të mirënjohjes ndaj të Vërtetit në emër të pasurisë, jetës dhe të gjitha dhuntive hyjnore, të cilat i bën më të thella e të pafundme nëpërmjet njetit dhe i përjetëson duke i lidhur me të Vërtetin përmes besimit e sinqeritetit të tij... Kujton Allahun me gjithë ndjeshmërinë e zemrës së tij dhe rënkon... Sjell në mendje Profetin (s.a.s.), qetësohet përbrenda... Mendon për njerëzit që ndajnë me të të njëjtën lumturi, gjëmon me lutje të hairit... Dhe këtë udhëtim të miraxhit, që e nisi me tekbire, e përfundon me shehadetin, i cili konsiderohet themeli i fesë...

Njerëzit e mësuar me namazin dhe që ushqehen nëpërmjet tij, nuk ngopen kurrë me të. “A nuk ka më?” – janë fjalët e tyre në fund të çdo namazi dhe vrapojnë nga njëri namaz nafile në tjetrin. Nëpërmjet namazit të duhasë ngrihen lart si dielli, shkojnë e prekin tokmakun e derës së afrimitetit përmes namazit *eu’uábin*, me namazin e natës (*tehexhahud*) i dërgojnë rreze drite errësirave të jetës së varrit dhe, në këtë mënyrë, përpiqen të thurin jetën e tyre si një dantellë mbi shallet e adhurimit, duke mos dashur të ndahen aspak nga drita brenda së cilës po jetojnë e nga kuptimet që u kanë mbështjellur shpirtrat. Nuk e dëshirojnë aspak një ndarje të këtillë, përkundrazi, vrapojnë pareshtur drejt bukurive që premtan adhurimi.

M. F. Gylen, *Sızıntı* (Revista Burimi), Korrik, 1994

Hyrje

Namazi është një nga pesë shtyllat bazë të Islamit. Ai është direku i fesë, baza dhe thelbi i lutjeve. Namazi është shkaku që i mundëson njeriut afrimin tek Allahu, por edhe vetë afrimi. Për këtë arsye, namazi mbart një rëndësi të madhe për besimtarin. Ai nuk duhet parë si një punë e rëndomtë mes angazhimeve të tjera të kësaj bote dhe që duhet kryer sa për të kaluar radhën. Kur e kërkon nevoja, çdo gjë duhet sakrifikuar për të, e jo më të neglizhohet apo të kryhet me nxitim për shkak të ndonjë pune tjetër. Po, namazi është më i bukuri mes gjërave që do të bëjë njeriu në jetën e tij dhe më i bukuri duhet të jetë. Kujtimet më të ëmbla të jetës duhet të jenë të lidhura me namazin. Sepse në miraxh nëpërmjet namazit dilet; nëpërmjet namazit arrihet tek Allahu dhe po nëpërmjet tij është e mundur dalja para profetëve dhe qëndrimi pranë tyre. Krahas këtyre, të gjendurit në adhurim para Allahut pesë herë në ditë – në varësi të thellësisë së ndërgjegjes – e lartëson individin shumë e më shumë.

Përmbajtja e namazit është aq e gjerë sa për t'u bërë shkas që njerëzit të mendojnë thellësisht. Njeriu, gjatë faljes së namazit, herë e gjen veten para Allahut, i mbërthyer nga një ndjenjë e thellë dashurie për Të, herë e ndien veten si një individ të xhematit të lidhur në namaz prapa Profetit tonë (*sal'lallahu alejhi ue sel'lem*), herë e sheh veten drejtpërdrejt në mesin e rreshtave të engjëjve, kurse ndonjë herë tjetër, i bëhet sikur, me një lëvizje të vetme, vë ballin në mbulesën e Arshit. Që njeriu të ketë sukses në këtë, kushti i parë që duhet të plotësojë është ky: ta dijë namazin si një miraxh ose si një hije të miraxhit.

Për besimtarin, çdo namaz është një rast për arritjen e miraxhit. Prandaj, detyra e besimtarit në këtë pikë është që në çdo namaz të plotësojë miraxhin e tij, qoftë edhe në dimensione të ndryshme. Në namaz, çdo tel i zemrës duhet të jetë njëlloj i rëndësishëm dhe si i atillë duhet t'i lëshojë tingujt e tij. Namazi duhet falur në mënyrë të atillë, që namazi i çdokujt të bëhet shembull për atë të një tjetri, që sexhdeja të shndërrohet në një burim të pashtershëm kënaqësie, që lutjet të shndërrohen në një ushqim që nuk i shkakton mërzi njeriut, që rukuja të kthehet në një veprim të veçantë dhe që këndimi i ajeteve të Kuranit në namaz të shndërrohet në një harmoni fjalësh plot gjallëri. Me të vërtetë, edhe ajeti **“Dhe mbështetu në të Plotfuqishmin, Mëshirëplotin, i Cili e sheh qëndrimin tënd në këmbë (gjatë namazit) dhe lëvizjet e tua midis atyre që përulen në sexhde.”**², përveçse na përshkruan namazin e Pejgamberit sonë (*sal'lallahu alejhi ue sel'lem*), na tregon gjithashtu edhe se si duhet ta falim namazin.

Ne duhet të falemi në të njëjtën mënyrë që është falur Profeti ynë (paqja qoftë mbi Të). Sigurisht, është e pamundur të kapim trajtën dhe kuptimin e namazit të falur nga një profet, e kemi të pamundur të ndiejmë ato çfarë ka ndier Ai (s.a.s.), por kjo nuk na pengon të jemi në atë rrugë. I Dërguari i Allahut (s.a.s.), në një prej haditheve të bekuara të Tij, kur shpjegon konceptin *“ihsan”*, përdor përkufizimin *“të kryesh adhurimet sikur je duke e parë Allahun”* dhe, në vazhdim, thotë: *“Edhe nëse ti nuk e sheh Atë, Ai të sheh ty!”*³. Ja, pra, nëse falet me një vetëdije kaq të thellë, besoj se namazi do t'i japë frytet e pritura.

Në një hadith tjetër, Pejgamberi ynë (s.a.s.) ka urdhëruar: *“Fale namazin si të ishte namazi i lamtumirës.”*⁴ Namazi i lamtumirës është namazi i fundit në jetën e një njeriu. Pra, do të thotë që ta falësh namazin duke e menduar atë si namazin e fundit të jetës. Ashtu siç i përkushtohet namazit dhe e fal atë me kujdes e në mënyrën më të përsosur të mundshme një njeri të cilit i është thënë se i ka mbetur aq

² Surja Shuara, ajetet 217-219.

³ Buhári, ímán 37; Muslim, ímán 5, 7.

⁴ Ibn Máxhe, zuhd 15; Ahmed ibn Hanbel, el Musned 5/412.

jetë sa për të falur një namaz të vetëm, po me të njëjtin përkushtim duhen falur të gjithë namazet. Falja e namazit në mënyrë të përsosur nuk duhet të kufizohet në vlerësimet “*përsosmërisht dhe pa asnjë mangësi*” të librave të fikhut. Kuptimi i saj duhet menduar shumë më përgjithësisht dhe duhet të përfshijë të gjitha aspektet e namazit, qofshin ato materiale apo shpirtërore. Po, nëse namazi falet në mënyrë të përsosur, – ashtu siç përmendet edhe në një sërë hadithesh – bëhet e mundur fshirja e gjynaheve, pastrimi nga to. Sepse, në namaz, pendimi shndërrohet e bëhet si një pjesë e pandarë e ndërgegjes. Aq shumë është kredhur pendimi në pjesët përbërëse të namazit, saqë është thuajse e pamundur ta mendosh atë të ndarë nga namazi. Sigurisht, nuk do të thotë se çdo namaz bart kuptimin e pendimit. Por shkrirja e njeriut me namazin dhe dalja e tij para Zotit i bërë njësh me të, bëhet shkas për lindjen e një ndërgegjesimi tek ai në çështjen e pendesës. Mjaft që namazi të kryhet brenda kushteve të kërkuara.

Për më tepër, Zoti i Madhëruar, në lidhje me namazin, thotë kështu: “***Vërtet që namazi të ruan nga shthurja dhe nga çdo vepër e shëmtuar.***”⁵ Që namazi të ketë një ndikim të tillë mbi robin, fillimisht nevojitet që ai të kryhet në gradën e dëshiruar. Robi duhet ta ndiejë në zemër vuajtjen e mëkatit të tij, madje gjatë njëzet e katër orëve të ditës, që, mandej, kjo të shndërrohet në një ftesë për faljen e atij mëkati. Thënë më qartë, së pari, namazi duhet falur ashtu siç duhet, duke i dhënë hakun çdo pjese të tij (*ta’dili erkân*), pastaj, duhet lexuar sa më shumë Kuran, duhet qëndruar sa më gjatë në kijam, rukú e sexhde dhe duhet treguar përpjekje për të kapur dimensione të ndryshme e të veçanta në çdo pjesë të namazit.

Nga ana tjetër, çdo devijim i bërë në pjesët përbërëse të namazit – sipas fjalëve të Pejgamberit tonë (s.a.s.) – e çon njeriun drejt kafshërisë (përsa i përket pamjes së tij të brendshme). Ai (s.a.s.), për atë që kalon në veprimin pasardhës të namazit para imamit, ka thënë: “*Ndonjëri prej jush, kur ngre kokën para imamit në ruku dhe sexhde, a nuk ka frikë se mos Zoti i Madhëruar do t’ia shndërrojë (do ta ringjallë duke ia*

⁵ Surja Ankebut, ajeti 45.

shndërruar) kokën në kokë gomari ose pamjen në pamje gomari?”⁶. Për sexhden që bëhet me nxitim, ka thënë kështu: “*Mos e ulni dhe ngrini kokën si sorra që çukit ushqimin!*”⁷. Kurse për uljet e gabuara në teshehud (ulja gjatë namazit), ka thënë: “*Kur uleni, mos e lëshoni veten si qentë!*”⁸ Pra, do të thotë se namazi kërkon që robi të bëhet një qenie njerëzore e përsosur. Kjo është arsyeja pse njeriu duhet t’i vlerësojë edhe një herë namazet që ka falur; duhet të përpiqet t’i ndiejë thellësisht dhe me çdo pjesë të tijën kijamin, rukúnë dhe sexhden.

Krahas faljes së namazit brenda ndjenjave të *hushú*-së (ndjenja e frikës dhe respektit ndaj Allahut) dhe *hudúsë* (ndjenja e përlulësisë para Allahut), është shumë e rëndësishme që ai të kryhet në përputhje me të gjitha kushtet e tij dhe askush nuk mund të thotë se kjo është diçka e thjeshtë. Sepse mes trajtës së jashtme të namazit dhe përbërësve të brendshëm të tij ka një marrëdhënie dhe një lidhje të ngushtë. Dhe nuk është aspak e drejtë që kjo detyrë, kjo përgjegjësi, të reduktohet thjesht në trajtën e saj të jashtme. Krahas trajtës së tij të jashtme, namazi absolutisht duhet falur në përshtatshmëri të plotë edhe me kuptimin, thelbin dhe përmbajtjen e tij.

Me pak fjalë, namazi përbën një bazë shumë të rëndësishme në emër të adhurimit. Madje, duke marrë në konsideratë kuptimet që ai bart, mund të quhet edhe “*thelbi i të gjitha adhurimeve*”. Për këtë arsye, sahabët i shihnin si hipokritë ata që nuk falnin namazin, kurse dijetarët, shumë herë jepnin si shembull lënien e namazit kur vinte puna tek shpjegimi i temës së “hipokrizisë me vepra” (*amelí nifák*).

Pra, namazi nuk është një çështje që mund të merret me të lehtë. Për ata që e marrin me të lehtë, kam frikë se, një ditë, do të veprojnë në të njëjtën mënyrë edhe me fenë. Nëse një njeri nuk fal namaz, do të thotë se ai po përjeton humbjen më të madhe të jetës së tij. Kështu që, ajo që duhet të themi është: “Patjetër namazin, patjetër namazin!”

⁶ Buhári, edhán 53; Muslim, salát 114,115.

⁷ Ebú Dáúd, salát 147; Nesái, tatbik 55.

⁸ Ahmed ibn Hanbel, el Musned, 2/311; Tajálisí, el Musned fq. 338.

PJESA E PARË



E VËRTETA E ISLAMIT

1. Përkufizimi i Islamit

Fjala ‘Islam’, e cila rrjedh nga rrënjët “*silm*” (paqe) dhe “*selamet*” (shpëtim), si fjalë bart kuptimet: dorëzim, nënshtrim, shpëtim, të qenit paqësor dhe i panjollë. I Dërguari i Allahut (s.a.s.), në përkufizimet që i ka bërë në kohë të ndryshme, më shumë ka qëndruar mbi kuptimin përmbledhës të Islamit dhe ka nxjerrë në pah kuptimin e tij në terminologji. Ja disa nga përshkrimet që Profeti ynë (s.a.s.) i ka bërë Islamit:

Në hadithin e Xhibrilit, i cili transmetohet thaujse në të gjitha burimet themelore të hadithit, i Dërguari i Allahut (s.a.s.) i bën një përshkrim përmbledhës Islamit. Kështu na e përcejell këtë hadith Omeri (*radijalláhu anh*):

“Isha ulur pranë të Dërguarit të Allahut kur, papritur, u shfaq një burrë me rroba jashtëzakonisht të bardha e me flokë jashtëzakonisht të zinj. Tek ai nuk kishte asnjë shenjë që do të vërtetonte ardhjen e tij nga ndonjë udhëtim i largët. Për më tepër, askush nga mesi ynë nuk e njihnte atë. Erdhi, u ul para të Dërguarit të Allahut dhe mbështeti gjunjët e veta tek gjunjët e Tij. Vendosi duart gjithë respekt mbi gjunjë dhe filloi të pyeste: ‘O Muhamed! Çështë Islami?’ Pejgamberi ynë i nderuar (s.a.s.) e shpjegoi kështu Islamit: ‘Të dëshmosh se nuk ka zot tjetër përveç Allahut dhe se Muhamedi është rob dhe i dërguari i Tij, të falësh namazin, të japësh zekatin, të agjërosh gjatë muajit të Ramazanit dhe, nëse ke mundësi, të vizitosh Shtëpinë e Allahut (të kryesh haxhin).’ I huaji miratoi duke thënë: ‘Të vërtetën the!’ (Duke qenë se kjo pikë i bën shumë përshtypje, Omeri i nderuar thotë:) Ne u habitëm kur pamë se ai edhe bënte pyetje, edhe miratonte fjalët që thuheshin. Pastaj pyeti sërish: ‘Çfarë është imani?’ I Dërguari i Allahut (s.a.s.) iu përgjigj në këtë mënyrë: ‘Të besosh Allahun,

engjëjt e Tij, librat e Tij, profetët e Tij, ditën e fundit dhe kaderin, pra, që e mira dhe e keqja caktohen prej Tij.’ I huaji miratoi përsëri: ‘Të vërtetën the!’ Mandej, pyeti prapë: ‘Çfarë është ihsani?’ I Dërguari i Allahut tha: ‘Ihsani është kryerja e adhurimeve sikur po e sheh Allahun. Por, edhe nëse nuk je në gjendje ta shohësh Atë, dije se Ai po të sheh ty.’ I huaji vazhdoi të pyeste: ‘Kur është çasti i kiametit?’ I Dërguari i Allahut (s.a.s.) iu përgjigj: ‘Në lidhje me kiametin, i pyeturi nuk di ndonjë gjë më shumë se ai që po pyet.’ I huaji: ‘Cilat janë shenjat e kiametit?’ Profeti ynë i nderuar: ‘Të shohësh gratë robëresha të lindin të zotët e tyre dhe barinj të këmbëzbathur e gjysmë të zhveshur të deveve teksa garojnë me njëritjetrin në ngritjen e ndërtesave të larta.’ Pas këtyre fjalëve, i huaji doli e iku. Unë qëndrova ca më gjatë. I Dërguari i Allahut (s.a.s.) m’u drejtua mua: ‘O, Omer! A e di se kush ishte ai person?’ Unë iu përgjigja: ‘Allahu dhe i Dërguari i Tij e dinë më mirë.’ Pas këtyre fjalëve të mia, i Dërguari i Allahut (s.a.s.) tha kështu: ‘Ai ishte Xhibrili (alehjis’selam). Erdhi për t’ju mësuar juve fenë.’⁹

Siç vihet re, në këtë hadith qëndrohet mbi tri çështje të rëndësishme, të cilat janë: gjashtë kushtet e besimit, pesë shtyllat e Islamit dhe vetëdija e ihsanit, e cila nënkupton kryerjen e dy çështjeve të para në kthjelltësinë e vetëdijes dhe të ndriçimit të brendshëm. E në fakt, çdo besimtar i përgjegjshëm duhet të qëndrojë mbi këto çështje dhe, me aq sa mundet, duhet t’i kryejë ato.

Sipas një transmetimi tjetër, i cili na përcillet nga Talha (r.a.), i Dërguari i Allahut (s.a.s.) e përshkruan Islamit përmbledhtazi:

‘Një ditë prej ditësh, në mesxhid erdhi një burrë nga banorët e Nexhidit. Flokët i kishte të shprishura. Na vinte tek veshët zëri i tij, por nuk arrinim të kuptonim asgjë nga sa thoshte. Pasi iu afruam mirë, kuptuam se po bënte pyetje në lidhje me Islamit. Pejgamberi ynë (alehjis’salātu ues’selám) sapo kishte mbaruar së thëni ‘Pesë kohët e namazit, natën dhe ditën’ kur burri pyeti prapë: ‘A kam detyrim tjetër përveç këtyre pesë kohëve?’ ‘Jo, vetëm nëse dëshiron të falësh namaz nafile (vullnetar),’ tha i

⁹ Muslim, ímán 5, 7; Buhári, ímán 37, tefsíru súra (31) 2.

Dërguari i Zotit dhe shtoi: 'Është edhe agjërimi në muajin e Ramazanit.' 'A ka agjërim tjetër përveç tij?' 'Jo, por, nëse dëshiron, mund të mbash agjërim nafile.' Profeti ynë i nderuar dhe bujar i kujtoi atij zekatin. Burri pyeti: 'A kam detyrim tjetër përpos zekatit?' 'Jo, por, në qoftë se jep në mënyrë vullnetare, është tjetër gjë.' Burri u ngrit të ikte dhe, teksa po largohej, tha: 'Ashtu siç nuk do t'iu bëj ndonjë gjë shtesë këtyre, po ashtu nuk do të lë mangët asnjërin prej tyre.' Kurse Profeti ynë (s.a.s.) tha: 'Nëse e mban fjalën, ka shpëtuar (ose 'nëse e mban fjalën, do të jetë nga banorët e Xhenetit).'¹⁰

Siç shihet, në këtë hadith dhe në hadithe të tjera të ngjashëm me këtë, i Dërguari i Allahut (s.a.s.) ka bërë një përkthim të përgjithshëm të Islamit duke përmendur çështjet themelore si shehadeti, namazi, zekati, agjërimi dhe haxhi. Kam përshtypjen se, nëse ajetet e Kuranit do të vlerësoheshin e do të shiheshin në tërësi së bashku me këto hadithe të lartpërmendura, do të vërehej një përkthim i Islamit me të gjitha aspektet e tij, duke filluar me besimin dhe duke mbaruar me moralin. Edhe dijetarët i kanë trajtuar këto çështje veç e veç që shumë kohë më parë dhe temat e lidhura me Islamit i kanë organizuar nën titujt “*itikad*” (besimi), “*ibadet*” (adhurimi), “*muamelat*” (dispozitat e marrëdhënieve shoqërore) dhe “*ukubat*” (dispozitat e së drejtës penale). Për këtë arsye, kur themi Islam, shohim tërësinë që përfaton çdo pjesë të jetës nga besimi te morali, nga edukata te qeverisja e politika dhe nuk mendojmë asnjë rrugë tjetër përveç bindjes ndaj Muhamedit (s.a.s.), që na i ka bërë të ditura të gjitha këto.

2. Shehadeti dhe Islami

Siç vërehet edhe në hadithin e Xhibrilit, shehadeti është i pari në mesin e pesë shtyllave themelore të Islamit. Thënë ndryshe, kushti i parë i Islamit është shehadeti, që shprehet nëpërmjet dëshmisë “*Eshhedu el'la iláhe il'lalláh ue eshhedu enne Muhammeden abduhú ue rasúluhu*”, ose

¹⁰ Buhári, ímán 34; shehadat 26; Muslim, ímán 8.

shprehja e njësimi të Zotit (*kelime i teuhíd*) me fjalët “*Lá iláhe il’lalláh Muhammedun Rasúlulláh*”. Sepse këto dy koncepte përfshijnë dy kuptimet që ruajnë në vetvete thelbin dhe shpirtin e Islamit. Njëra prej tyre, duke u bërë përkthyes i dorëzimit dhe bindjes së zemrës e duke mbajtur si dëshmitarë të gjitha grimcat e universit, është të dëshmuarit nëpërmjet fjalëve “*Eshhedu el’lá iláhe il’lalláh*” se vetëm Zoti i Madhëruar është i Adhuruari Absolut dhe i Dëshiruari i Denjë; kurse e dyta është të besuarit tek të gjithë profetët në personin e Profetit të Lavdishëm, Pejgamberit tonë (s.a.s.), duke thënë “*Muhammedun Rasúlulláh*” ose “*Eshhedu enne Muhammeden abduhú ue rasúluhu*”. Sepse Profeti ynë (s.a.s.) është rima e poemës së profetësisë, përfaqësuesi dhe miratuesi i vërtetësisë së parimeve të pacenuara, si dhe korrigjuesi i vlerave të prishura si rezultat i devijimeve. Të gjitha fjalët kanë ardhur dhe janë mbledhur tek Ai (s.a.s.), Ai i ka vënë vulën gjithçkaje dhe vetëm nëpërmjet Tij është plotësuar zhvillimi dhe përparimi i njerëzimit. Ai i ka ardhur njerëzimit si një profet i përsosur dhe me një fe të përsosur, Ai ka dëshmuar për profetësinë e të gjithë profetëve të nderuar, nga Ademi (a.s.) deri te Mesihu (a.s.). Ja, pra, këtë shprehin fjalët “*Eshhedu enne Muhammeden abduhú ue resúluhu*”.

Aq të shenjta janë këto dy fjalë, saqë është e pamundur të gjesh ndonjë fjalë tjetër më të rëndë, më me vlerë se ato tek Allahu. I Dërguari i Allahut (s.a.s.) e shpreh këtë me fjalët: “*Lutja më e mirë është ajo që bëhet në Arafat; fjala më e mirë, që e kam thënë unë dhe profetët e tjerë para meje, është ‘Lá iláhe il’lalláh’*”¹¹

Një hadith tjetër, i transmetuar nga Ebu Dherri (r.a.), është si vijon:

“*Një herë pata shkuar tek i Dërguari i Allahut (s.a.s.). Ai po flinte në atë çast. Kur u zgjua, u ula pranë Tij dhe filluam të bisedonim. Në një moment më tha: ‘Çdo rob që vdes pasi ka thënë fjalët Lá iláhe il’lalláh hyn në Xhenet.’ Unë, i habitur, e pyeta: ‘Edhe nëse bën zina (marrëdhënie seksuale jashtëmartesore), edhe nëse bën hajdutëri?’ Pejgamberi m’u përgjigj: ‘Po, edhe sikur të bëjë zina e hajdutëri!’ Unë nuk durova dot*

¹¹ Muatta, Kurani 32, haxh 246; Abdurrezzak, el Musannef 4/378. Me shprehje të përafërta: Tirmidhí, de’auát 123.

dhe e pyeta sërish: ‘Hyn në Xhenet edhe nëse bën zina, edhe nëse bën hajdutëri?’ I Dërguari i Allahut më dha përsëri të njëjtën përgjigje: ‘(Po), edhe sikur të bëjë zina, edhe sikur të bëjë hajdutëri!’ Tri herë i pati përsëritur këto fjalë. Ndërsa herën e katërt tha kështu: ‘Do të futet në Xhenet, edhe sikur të mos e dëshirojë Ebu Dherri një gjë të tillë.’¹²

3. E vërteta e “Lá iláhe il’lalláh”

Është e mundur që në kuptimin e e shprehjes së njësimi të Zotit (*kelimej teuhíd*) të shihet gjithçka që lidhet me sistemin e të qenit rob i Zotit në Islam. Besimtari, kur thotë “Lá iláhe il’lalláh”, nënkupton se vetëm Allahun njeh si Zot dhe se nuk kënaqet me askënd tjetër përpos Tij. Kurani e vërteton këtë me fjalët: “**Vërtet, zemrat qetësohen me përmendjen e Allahut!**”¹³ Kuptimi që bart ky ajet është: “Vetëm Allahun adhuroni dhe vetëm Atij bëjuni rob, mos kërkonit strehim dhe mbështetje tek askush tjetër përveç Tij. Sepse, përveç Zotit, nuk ekziston asnjë fuqi tjetër ku mund të mbështetesh e që mund t’i besosh. Vetëm në këtë mënyrë do të arrini qetësinë shpirtërore.” E, në fakt, fjala “Allah” (*Lafzatu’lláh*) i përfshin të gjitha këto kuptime.

Nuk më duket e përshtatshme që fjala e lartë “Allah” të pranohet si një fjalë e përcjellë nga një fjalor tjetër dhe të thuhet se, sipas shkencës së etimologjisë, rrjedh nga kjo apo ajo fjalë. Nuk ma bën zemra të pranoj një përpjekje të tillë për t’i gjetur një origjinë asaj. Mirëpo, duke e lidhur atë edhe me disa fjalë të tjera, disa janë orvatur t’i gjejnë një fjalë bazë. Por, nëse do t’më pyesnin mua, do të thosha kështu: Krijuesi i Plotfuqishëm i gjithësisë është i pafillimtë, dhe si i tillë, emri i Tij është “Allah” që në paraekzistencë. Nuk është aspak e përshtatshme të kërkosh për ndonjë fjalë rrënjë për emrin “Allah”.

Çdo gjë është e lidhur me Allahun dhe çdo gjë falë Allahut ekziston. Fjala “Allah” është nuri dhe drita e fytyrës së gjithësisë. Aty ku fjala

¹² Buhári, libás 24; Muslim, ímán 154

¹³ Surja Rað, ajeti 28.

“Allah” nuk është e pranishme, të gjitha dijet dhe njohuritë mbeten thjesht si diçka imagjinare, iluzione mashtruese, mirazhe, mbeten si grumbuj idesh të pakuptueshme, tejet të koklavitura e që nuk u gjendet filli.

Poeti A'şhá, nga poetët arabë të periudhës së injorancës, pati shkuar pranë të Dërguarit të Allahut (s.a.s.) sapo kishte dëgjuar për profetësinë e tij dhe, pasi dëgjoji kuptimet dhe të vërtetat që shprehen në Kuran, thaujse pati kaluar në ekstazë. Por kjo situatë nuk pati qenë e mjaftueshme për të. Sepse ai donte t'i besonte më thellësisht kuptimit të shprehjes “*Lá iláhe il'lalláh*”. Për këtë arsye, i kërkoi kohë Pejgamberit tonë (s.a.s.) dhe u kthye në vendlindjen e tij. Me këtë gjendje të tijën, ai sikur donte t'i thoshte kështu Profetit tonë (s.a.s.): “Ti kërkon nga unë të them një fjali; por kuptimi që shpreh kjo fjali është jashtëzakonisht i gjerë. Mua më duhet t'i përvetësoj këto kuptime të gjera, t'i ndiej në ndërgjegjen time, të bëj të mundur që të gjitha grimcat e trupit tim t'i ndiejnë ato.” Pra, shprehja “*Lá iláhe il'lalláh*” nuk është një shprehje që mund të thuhet në mënyrë të rëndomtë. Përkundrazi, kur ajo shqiptohet, do të thotë se po pranohet një rend jete, një sistem që e rrethon jetën me çdo gjë të sajën, dhe se i duhet qëndruar besnik asaj deri në fund të jetës.

Shkurtimisht, i Vërteti i Madhëruar ka krijuar universin për të bërë të njohur veten, dhe, për të bërë të mundur leximin e attributeve të tij, brenda atij universi ka vendosur një rend. Për rrjedhojë, rendi për Të flet, harmonia Atë përmend, gjithësia Atë rri e shpjegon. Të gjitha qeniet e universit, të vetëdijshme dhe të pavetëdijshme, janë si gjuhë që thërrasin emrin “Allah” dhe që e përmendin pa pushim Atë. Kurse njeriu, si një krijesë tek e cila Zoti ka mundësuar edhe çeljen e lules së të shprehurit, me ndërgjegjen, aftësinë e tij për të perceptuar dhe vullnetin e tij, bëhet përkthyes i këtyre përmendjeve kudo nëpër gjithësi dhe, më pas, i shpreh këto të vërteta edhe nëpërmjet gjuhës së vet.

Kur të vijë koha, gjithçka do t'u bashkohet këtyre gjuhëve që ulërasin ekzistencën e Allahut, të gjithë do të shkrihen ashtu siç shkrihen akujt me ardhjen e pranverës e, në këtë mënyrë, do të bëhen përkthyes të së drejtës dhe së vërtetës. Akujt në behar shkrihen, në behar zgjidhen

gjuhët, edhe bilbilat në behar fillojnë të këndojnë. Farat e mbjella mbijnë e fillojnë të hedhin shtat po ashtu në behar. Mund të themi se ne e kemi arritur beharin ku të gjitha këto përjetohen hap pas hapi. Sot, në çdo anë po lartësohen thirrjet “*Lá iláhe il'lalláh*”, sikur po përjetohet një “Periudhë Lumturie” e re. Sepse ajo periudhë lindi në gjirin e atyre që i vunë gjoksin problemeve dhe vuajtjeve, që u zhytën trimërisht, pa më të voglën frikë, mes qindra situatave të vështira e që u treguan të vendosur në çështjen e të jetuarit të Islamit. Lartësimi i thirrjeve “*Lá iláhe il'lalláh*” në luginat e Mekës, atje ku dikur jetohej një jetë e mbuluar nga shtresat e errësirave të besimeve pagane njëra mbi tjetrën, lartësimi i tyre, përhapja dhe bërja bujë në të gjithë botën u arritën si përfundim i përbalimit të këtyre vështirësive e vuajtjeve.

Kur në zemër hyn besimi!

Sa për të dhënë një shembull në lidhje me sa thamë: Pas një jete trembëdhjetëvjeçare plot vështirësi, Allahu i Madhëruar u hapi myslimanëve dyert e Medines. Besimtarët, duke u forcuar këtu çdo ditë e më shumë, si një çinar që qëndron mbi trungun e tij, kishin filluar të drejtoheshin tashmë dhe të rrinin mbi këmbët e veta. Frytet e para të kësaj i patën marrë në luftën e Bedrit, ku korrën një fitore të madhe. Kjo fitore bëri të mundur që politeistët të mos ndiheshin më të pathyeshëm, kurse nga ana tjetër, vërtetoi se, tashmë, Islami po qëndronte mbi këmbët e veta dhe se po vepronte brenda një harmonie të plotë. Mushrikët nuk e gëlltitën dot dhimbjen e humbjes përballë një grupi prej treqind vetash dhe, në çdo rast që u jepej, shfaqnin inatin, dëshirën e madhe për t’u hakmarrë. Prej tyre ishin edhe Safuan bin Umeje dhe Umejir bin Uehb, dy djem xhaxhallarësh të mbushur me urrejtje dhe zemërim ndaj Profetit tonë (s.a.s.) në çdo frymëmarrje të tyren. Kishin këtë plagë të përbashkët sepse njërit i ishte zënë rob i biri, ndërsa tjetrit i ishte vrarë në luftë i ati. Pas luftës së Bedrit, këta të dy ishin ulur bashkë një ditë, po i qanin hallet njëri-tjetrit dhe po planifikonin të këqijat që do mund t’i bënin Pejgamberit tonë (s.a.s.).

Ranë dakord më në fund dhe vendosën; Umejri bin Uehbi, me pretekstin për të parë të birin, do të shkonte në Medine dhe, duke gjetur edhe për këtë një pretekst, do t'i afrohej edhe të Dërguarit të Allahut (s.a.s.). Pastaj, me shpatën e tij të helmatisur, do të bëhej shkak që Ai (s.a.s.) të binte shehid. Në këtë mënyrë, do të hakmerrej si për veten, po ashtu edhe për të gjithë fisin e Kurejshëve. Umejri, me kokën të mbushur nga këto mendime, vete në Medine. Por, akoma pa e gjunjëzuar devenë e tij para mesxhidit, Omeri (r.a.), i cili e përshkruan atë me fjalët “Ky qen është Umejri bin Uehbi, armiku i Allahut”¹⁴, e vëren dhe, më pas, u drejtohet personave përreth: “Kini kujdes! Po dalloj praninë e një shpate nën rrobën e tij, të mos i bëjë diçka të keqe të Dërguarit të Allahut!” Mandej, shkon pranë Profetit (s.a.s.) dhe i thotë: “O i Dërguari i Allahut! Po vjen Umejri, mos t’ju bëjë keq juve!” I Dërguari i Allahut (s.a.s.), duke buzëqeshur, urdhëron: “O, Omer! *Lëre të vijë!*” Kur Umejri i afrohet të Dërguarit të Allahut pasi është futur në mesxhid, Pejgamberi ynë (s.a.s.) e pyet: “*Pse ke ardhur, o Umejri?*” Umejri i thotë se ka ardhur të paguajë për lirim të të birit. Kurse i Dërguari i Allahut (s.a.s.) ia kthen në këtë mënyrë: “*Nëse do, a të ta them unë se për çfarë ke ardhur?*” Pastaj i tregon një për një të gjitha detajet e planit që kishte thurur bashkë me Safuanin. Ky njeri, i quajtur “Shejtani i Kurejshëve”, kur dëgjon fjalët e të Dërguarit të Allahut, kërcen nga vendi dhe thotë “*Lá iláhe il’lalláh Muhammedun Rasúlulláh*”. Kur fati është duke kompozuar të tjera gjëra, edhe njeriu më i djallëzuar bëhet brenda një çasti nga ndjekësit e të Dërguarit të Allahut (s.a.s.).

Gjatë qëndrimit të tij pranë të Dërguarit të Allahut (s.a.s.), Umejri tejmbushet me dashuri për Islamin dhe entuziazëm, aq sa nuk e zë më vendi. Tani, ai dëshiron t’i japë hakun shpatës që e kishte sjellë për të vrarë Profetin tonë (s.a.s.). Për këtë arsye, i kërkon leje të Dërguarit të Allahut (s.a.s.) që të kthehet sërish në Mekë. I Dërguari i Allahut (s.a.s.) është i bindur, mekasit nuk janë në gjendje t’i bëjnë asgjë këtij njeriu po aq trim dhe heroik sa Omeri (r.a.). Kështu që, e lejon të shkojë përsëri në Mekë. Nga ana tjetër, Safuani është duke fërkuar duart çdo ditë. Ai

¹⁴ Ibn Hisham, es Síretun’nebeuijje 3/213.

është në pritje të ngjarjes së madhe që mendon se do të ndodhë në Medine, vete e pyet për lajmet më të reja secilin karvan që vjen nga ato anë. Sepse lajmi që do të vijë nga atje do t'i bëjë të gëzohen pa masë atë dhe të gjithë banorët e tjerë të Mekës. Mirëpo, një ditë, atij i vjen lajmi i pranimit të Islamit nga ana e Umejrit, një lajm që e bën të luajë mendsh.

Umejri, ashtu siç kishte bërë edhe Omeri kur po largohej nga Meka, hyn në Mekë duke i sfiduar të gjithë. Këtu, në të shumtën e rasteve, i kalon ditët duke u shpjeguar njerëzve të drejtën dhe të vërtetën. Brenda kësaj periudhe kohore, Umejri i jep vërtet hakun të qenit mysliman. Sepse kur do të kthehet në Medine dy-tre vjet më vonë, prapa tij do të vërehet një bashkësi e madhe njerëzish që do të kenë zgjedhur të jenë myslimanë. Pavarësisht këmbënguljes së Umejrit, djali i xhaxhait të tij, Safuani, ishte treguar kokëfortë dhe nuk i ishte bashkuar ende karvanit të fatlumëve; me çlirimin e Mekës, kishte marrë mbi shpinë barrën e vet dhe ishte arratisur drejt vendeve përtej detit. Umejri, i mërziur tej mase nga kjo gjendje e Safuanit, vjen tek Pejgamberi ynë (s.a.s.) dhe, pasi i tregon për situatën e Safuanit, i kërkon që ta falë dhe ta marrë nën mbrojtje atë. Për të vërtetuar marrjen e tij në mbrojtje, i kërkon çallmën që Profeti ynë (s.a.s.) kishte mbështjellë në kokën e Tij të bekuar gjatë hyrjes në Mekë dhe që ia kishin parë të gjithë. Sepse ai parashikonte se Safuani do të ishte një njeri i dobishëm për Islamin në të ardhmen.

Më në fund, Umejri arrin ta gjejë Safuanin dhe e sjell atë tek i Dërguari i Allahut (s.a.s.). Kur del para të Dërguarit të Allahut, Safuani është i trishtuar, nuk është në gjendje as për ta parë në fytyrë Pejgamberin tonë. Mes tyre zhvillohet kjo bisedë:

“O i Dërguari i Allahut! Umejri më tha se më keni dhënë mbrojtje. A është e vërtetë kjo?” Njeriu i tolerancës dhe mirëkuptimit, me një sjellje që vetëm Atij i shkon për shtat, i përgjigjet: “Po, e vërtetë është.” “O i Dërguari i Allahut! Unë e pranoj vërtetësinë e gjërave që ke sjellur ti. Por dua që t’më japësh dy muaj kohë për t’u menduar.” thotë Safuani. I Dërguari i Allahut (s.a.s.), duke buzëqeshur sikur të ishte duke i parë

në ato çaste trimëritë që ky bir fisnik i fisit Kurejsh do të shfaqte në Jermuk përballë Bizantit, i thotë se i ka dhënë jo dy, po katër muaj kohë. Nuk kalojnë as disa javë dhe Safuani vjen para Profetit tonë (s.a.s.) dhe, duke thënë “*Eshhedu el’lá iláhe il’lalláh ue eshhedu enne Muhammeden abduhú ue Rasúluhu*”, bëhet shkak që edhe Umejri të mbytet në lot gëzimi.

4. Islami si mësim i të gjithë profetëve

“Islam” është emri i sistemit që rregullon çdo gjë në mendimet, imagjinatën, jetën praktike dhe botën e brendshme të njerëzve që nga koha e Ademit (a.s.) e gjer në ditët e sotme, që u ka vënë atyre nga një masë dhe që i peshon ato nëpërmjet peshores që ka vendosur ai vetë. Ky sistem, duke qenë se është vendosur nga ana e një Individualiteti që e ka krijuar njeriun në trajtën e një mekanizmi dhe që e vëzhgon, e ndjek atë me çdo gjë të tijën, është mjaft gjithëpërfshirës. Islami i ka mbledhur në strukturën e tij çështjet që kanë të bëjnë me këtë botë e me botën tjetër si një tërësi dhe ka mundur të ndërtojë një lidhje me Allahun, madhështia dhe fuqia e të Cilit është e pafund, dhe, në këtë mënyrë, ka mundur të rregullojë edhe marrëdhëniet me universin. Për rrjedhojë, në varësi të thellimit të tij në Islam do të jetë edhe paraqitja e thelbit të tij thuajse të pafund. Këto thellësi që i përkasin Islamit, në fakt, janë brenda përkufizimit të tij dhe janë shprehur nëpërmjet gjuhës së profetëve.

Këtë përshkrim e ka bërë për herë të parë Ademi (a.s.). Profetët që kanë ardhur pas tij i kanë thirrur njerëzit në Islam nën të njëjtin përshkrim dhe i kanë ftuar të shohin thellësitë brenda tij. Pas Ademit (a.s.), Nuhu (a.s.) ka thënë: “***Mua më është urdhëruar të jem prej atyre që (i) nënshtrohen (Atij).***”¹⁵ Kur vendosnin gurët njëri mbi tjetrin për

¹⁵ Surja Junus, ajeti 72.

të ndërtuar Shtëpinë e Allahut, e cila, deri në Ditën e Kiametit, do të jetë kibla e njerëzimit mbi sipërfaqen e tokës dhe shtylla e shndritshme gjer në *Sidretul Muntehá* (një pemë e madhe në të majtë të Fronit Hyjnor, mbi qiellin e shtatë) rreth së cilës bëjnë tavaf engjëjt, Ibrahim i dhe Ismaili (a.s.) janë lutur kështu: ***“Zoti ynë! Na bëj të përlulur ndaj Teje! Bëj që edhe pasardhësit tanë të jenë të përlulur ndaj Teje!”***¹⁶

Jusufi (a.s.), pasi u bë drejtues i ekonomisë shtetërore të Egjiptit, pasi u bashkua me prindërit e tij dhe pasi shpëtoi vëllezërit nga problemet e urisë dhe mjerimit, me pak fjalë, pasi arriti çdo gjë materiale dhe shpirtërore, iu lut Zotit në këtë mënyrë: ***“Zoti im! Bëj që të vdes si mysliman dhe më shoqëro me punëmirët (në botën tjetër)”***¹⁷ E në fakt, nuk është e mundur të tregohet një njeri i dytë që të ketë arritur këto privilegje që zotëronte ai. Kur shpjegon gjendjen e Jusufit (a.s.), Pejgamberi ynë (s.a.s.) thotë kështu: *“Fisnik, bir fisniku, i të birit të fisnikut, i të birit të fisnikut është Jusufi, i biri i Jakubit, i të birit të Is’hakut, i të birit të Ibrahimit.”*¹⁸ Të gjithë gjyshërit e Tij ishin profetë. Ai njeri fisnik e bujar, pasi mblodhi tek vetja të gjitha këto privilegje të jashtëzakonshme, këto tha si fjalë të fundit. E në fakt, ky duhet të jetë mendimi ideal i një zemre që ia ka përkushtuar veten Allahut dhe që digjet nga malli e dëshira për të arritur tek Ai.

Kur një njeri shprehet me fjalët “U bëra mysliman”, kjo mbart kuptimin “Ja dorëzova vullnetin tim Allahut”, që do të thotë të përsëritësh fjalët e Ademit (a.s.), të Nuhut (a.s.), të Halilurrahmanit (mik i të Gjithmëshirshmit) (a.s.), babait të profetëve, të Jusufit (a.s.) dhe, në fund, të Sulltanit të Sulltanëve, Zotërisë dhe Krenarisë së Gjithësisë (s.a.s.). Këto fjalë të thëna përmes gojës së profetëve në emër të gjithë njerëzimit përbëjnë besëlidhjen me Zotin, premtimin e dhënë ndaj Tij.

Ashtu siç dihet, dorëzimi dhe nënshtrimi nënkuptojnë bindjen e njeriut ndaj Allahut në mendim, konceptim dhe vepra. Për këtë arsye,

¹⁶ Surja Bekare, ajeti 128.

¹⁷ Surja Júsuif, ajeti 101.

¹⁸ Buhári, enbijá 18-19; menákib 13; Tirmidhí, tefsír (12) 1.

Zoti i Madhëruar i është drejtuar Profetit tonë (s.a.s.) me fjalët: ***“Thuaj: ‘Në të vërtetë, namazi im, kurhani im, jeta ime dhe vdekja ime i përkasin vetëm Allahut, Zotit të botëve. Ai nuk ka asnjë ortak. Kështu jam urdhëruar dhe unë jam i pari që i nënshtrohem Atij.”***¹⁹

Nëse do të shpreheshim në një kontekst më të gjerë, kuptimi i këtyre fjalëve të Zotit është ky: “O i Dashuri im! Sovraniteti dhe sundimi mbi gjithçka i përket vetëm Allahut. Kështu që, dorëzohu tek Allahu, i Cili ka në dorë sundimin e kësaj bote dhe të botës së përtejme, që drejton e kontrollon gjithçka nga sistemet planetare deri tek grimcat më të vogla. Ai është i pashoq. Madhështia dhe sundimi vetëm Atij i takojnë. Thuaj: ‘Unë i kam pranuar i pari gjërat e thëna prej Tij dhe për këtë jam urdhëruar.’”

Në letrën që i Dërguari i Allahut (s.a.s.) i pati dërguar Herakliut gjendej edhe kjo shprehje: *“Hyr në Islam, gjej shpëtim.”*²⁰ Kjo do të thoshte: “Lërja Allahut dhe të Dërguarit të Tij, Muhamedit (s.a.s.) drejtimin e anijes që do të të shpëtojë ty nga këto dallgë të frikshme duke të nxjerrë në bregun e sigurt. Në të kundërt, do të ekspozohesh ndaj problemeve e vuajtjeve që sjellin këto dallgë gjigante dhe nuk do të jesh në gjendje të gjesh paqe e qetësi.” Në pjesët në vazhdim të letrës shkruhej edhe fjalia *“Allahu do të të shpërblejë dyfish”*, e cila ka të bëjë me ata që janë në postin e drejtuesit. Kjo është një fjali që i referohet të gjithë drejtuesve, që nga një kryetar familjeje e deri te drejtuesi i një rajoni, nga ky i fundit e gjer te kryetari i shtetit. Sepse, nëse bëhet mysliman drejtuesi që ndodhet në krye të grupit të njerëzve për të cilët është përgjegjës, edhe këta të fundit do të veprojnë në të njëjtën mënyrë dhe, kështu, përveç shpërblimit të pranimit të Islamit nga ai vetë, do të marrë edhe shpërblimin e njerëzve të tij. Nga ana tjetër, në rast se ai kthen fytyrën në anën tjetër dhe mbyll veshët ndaj të Vërtetit, ngaqë është drejtues dhe ngaqë do të bëhet sebeb edhe për përpëlitjet e të tjerëve brenda mosbesimit dhe devijimit, bashkë me gjynahet e veta do të marrë mbi shpinë edhe gjynahet e tyre.

¹⁹ Surja En’ám, ajetet 162-163.

²⁰ Buhárí, bed’ul uahj 6; Muslim, xhihad 74.

5. Rëndësia e bindjes ndaj profetëve

Njeriu, nëpërmjet kërkimeve dhe studimeve në lidhje me universin, mund të fitojë disa njohuri, falë të cilave mund të arrijë të thotë se ekziston një krijues. Por kjo deklaratë mbetet me kaq, vështirë të shkojë përtej mendimeve të Uaraka bin Neufelit apo Zejdit, djalit të xhaxhait të Omerit (r.a.), të cilët patën vazhduar jetët e tyre si “*hanifë*”²¹, para se të vinte Pejgamberi ynë (s.a.s.). Mendoni sikur ndodhëni të ulur brenda një dhome dhe, në një moment, dëgjoni trokitjen e derës. Gjëja e parë që ju vjen në mendje është mendimi se prapa derës gjendet dikush. Ja, pra, kjo, në një farë mënyre, këtij shembulli i ngjason. Nga mënyra e trokitjes, njeriu mund të arrijë në disa konkluzione; nëse goditja shkakton një tingull ritmik, mund të thotë se prapa derës ndodhet një krijesë me vetëdije. Zaten, pa qenë në gjendje të përdorë shqisën e të shikuarit, vetëm kaq mund të jetë përfundimi që mund të nxjerrë mendja. Në fund të fundit, çdo gjë e thënë në lidhje me atë gjë që gjendet pas derës nuk shkon përtej hamendësimeve.

Shembulli i dhënë nga Platoni në lidhje me njerëzit në shpellë përbën një shpjegim ndryshe të kësaj të vërtete. Ai pretendon se njohuritë e njeriut rreth qenieve mund të jenë aq sa hijet e tyre ose aq sa pasqyrohen ato brenda shpellës nga jashtë. Ndërsa informacioni i vërtetë rreth qenieve jashtë shpellës mund të merret vetëm nëse vjen dikush nga jashtë dhe jep informacion të qartë në lidhje me to. Në qoftë se do të bënim një lidhje mes atij personi dhe institucionit të profetësisë, mund të themi kështu: Njerëzit mund të besojnë në ekzistencën e Krijuesit dhe të fitojnë njohuri të qarta e të prera për Të vetëm me ndihmën e udhëzimeve dhe mësimëve të profetëve. Për shembull, emrat dhe

²¹ Kështu quhen ata që, gjatë periudhës së injorancës, ruajtën besimin e drejtë mono-teist, pa devijuar në shirk apo idhujtari. Ata janë përshkruar gjithashtu edhe si njerëz që vepruan në përputhje me atë që u pati ardhur nga feja e Ibrahimit (paqja qoftë mbi të) dhe që vazhduan jetën e tyre si robër të Allahut. Në periudhën e injorancës, arabët e quanin “*hanif*” këdo që ndiqte fenë e Ibrahimit (a.s.). (Ibn Mandhur, Lisánul Arab 9/58)

atributet e Tij, gjërat që kërkon nga robërit e Tij në emër të adhurimit, mënyra se si duhet të kryen ato adhurime dhe shumë çështje të tjera si këto mund të njihen e të mësohen vetëm nëpërmjet të informuarit nga ana e një profeti.

Gjithësia është krijuar si një libër dhe është vënë para syve të të gjithë njerëzve. Qeniet misterioze, të cilat gjenden kudo nëpër univers, dhe ngjarjet rrinë e ndjekin njëra-tjetrën brenda një harmonie të plotë. Ekzistenca e një force dhe fuqie vepruese dhe kontrolluese prapa gjithë këtyre ndodhive është e sigurt. Nëse nuk i vihet veshi fjalës së profetit, atëherë, mendimi që do të arrihet në lidhje me këtë forcë e fuqi do të jetë në trajtën e ekzistencës së një vendburimi shpirtrash që kontrollon gjithçka apo të një grupi mendjesh që sundon mbi çdo gjë, ose të ekzistencës së një force dhe fuqie brenda çdo lënde. Mendime të këtij lloji jo vetëm që i ngatërrojnë e ua bëjnë lëmsh kokat njerëzve, por nuk shprehin as ndonjë kuptim për të qenë dhe të pranueshëm nga logjika. Kurse Allahu (*xhel'le xheláluhu*), i Cili na bën ta ndiejmë praninë e Tij nëpërmjet mijëra ngjarjeve nëpër univers, është larg sasisë dhe cilësisë. Brenda kritereve të sufizmit, pavarësisht asaj që mund të mendohet rreth Tij, Krijuesi i Plotfuqishëm është përtej të përtejshmes së çdo gjëje që mund t'i vijë në mendje njeriut.²² Ai nuk mund të perceptohet nëpërmjet Individualitetit të Tij; Ai mund të njihet vetëm përmes emrave dhe attributeve të Tij. Ndërsa kjo, realizohet vetëm me vënien në punë të mendjes, zemrës dhe shpirtit nën udhëheqjen dhe drejtimin e profetëve. Për të arritur pagabueshmërinë në këtë pikë, e vetmja zgjidhje është dëgjimi i fjalëve të profetëve, të cilët janë përfaqësuesit e rrugës së drejtë. Lidhja me karvanin e profetëve, të cilët thonë se janë të lidhur me Zotin dhe se nuk kanë asnjë kapital apo pasuri tjetër përveç asaj që u vjen prej Tij, është garancia e ecjes sonë në rrugën e drejtë.

Të gjitha problemet do të zgjidhen duke iu drejtuar botës së profetëve dhe të gjitha të panjohurat do të bëhen të njohura në atmosferën e tyre

²² Alijulkarí, er Raddu alev káilín bi uahdetil vuxhúd 1/16.

të ndritshme. Sepse ata janë dërguar si shembuj dhe udhërrëfyes për njerëzimin. Zoti i Madhëruar, duke e ditur se njerëzimi ka nevojë për ta, nuk ka lënë pa profet asnjë nga popujt mbi sipërfaqen e tokës. Le të shkohet në cilindo vend të botës dhe në cilëndo periudhë kohore të saj, patjetër që do të dëgjohej fryma e një profeti që thotë: “O populli im! Adhurojeni Allahun dhe mos i shoqëroni Atij zota të tjerë.” Kurani e shpreh kështu këtë të vërtetë: **“Çdo populli Ne i çuam një të dërguar (që u thoshte): ‘Adhuroni Allahun dhe shmangni idhujt!’”**²³ Në mënyrë që ata të mos përkulen para njeriut, të mos shkojnë pas totemeve dhe të mos lidhen pas njerëzve të hyjnizuar. Në vënd të këtyre, të adhurojnë vetëm dhe vetëm Allahun e të kërkojnë ndihmë prej Tij. Një besimtar i vërtetë, në lutjen e Kunutit, të cilën e lexon çdo ditë, duke thënë “Zoti im! Prej Teje kërkojmë ndihmë e falje dhe po prej Teje kërkojmë udhëzim. Ty të besojmë, Ty të pendo kemi dhe tek Ti mbështetemi. Të përmendim Ty e të lavdërojmë me gjithë të mirat e Tua, të falënderojmë Ty duke i përmendur mirësitë e Tua. Ne nuk të mohojmë Ty. Largohemi nga ata që të kundërshtojnë Ty dhe presim lidhjet me ta.”, shpreh besnikërinë e tij ndaj këtij premtimi që i ka bërë Zotit të Madhërisëm.

Përsëri, Allahu i Madhëruar, që njerëzit ta kenë më të lehtë, profetët i ka dërguar nga popujt e tyre dhe në gjuhët e tyre. Ajeti **“Ne nuk kemi çuar asnjë të dërguar, përveçse në gjuhën e popullit të tij, për t’u shpjeguar atyre (shpalljet e Zotit).”**²⁴ e shpreh më së miri këtë të vërtetë. Në një ajet tjetër, drejtuar Profetit tonë (s.a.s.), duke thënë **“Ne e kemi bërë atë (Kuranin) të lehtë, në gjuhën tënde, vetëm që, nëpërmjet tij, ti t’u japësh lajmin e mirë besimtarëve të devotshëm dhe të paralajmërosh njerëzit kokëfortë (në mosbesimin e tyre).”**²⁵, theksohet po ashtu i njëjti kuptim. Po, Profetit të Lavdishëm (s.a.s.), që ishte shfaqur si një arab në mesin e shoqërisë arabe, i nevojitej të fliste

²³ Surja Nahl, ajeti 36.

²⁴ Surja Ibrahim, ajeti 4.

²⁵ Surja Merjem, ajeti 97.

arabisht. Nëse do të kishte dalë në mesin e ndonjë populli tjetër, gjuhën e atij populli do të kishte folur. Çdo profet ka folur gjuhën e popullit në mesin e të cilit është shfaqur. Në mënyrë që çdo çështje t'i shpjegohet qartë dhe haptazi të gjithëve.

6. Muhamedi (paqja qoftë mbi Të) si i fundit i profetëve

Poema profetike, e cila ka filluar me Ademin (a.s.), ka arritur përsosmërinë nëpërmjet Muhamedit (s.a.s.), Profetit tonë të lavdishëm e të nderuar. Ndërkohë që të vërtetat ekzistonin tek Ademi (a.s.) në trajtën e një fare, tek Nuhu (a.s.) patën nxjerrë kokën mbi dhe, tek Ibrahim (a.s.) kishin hedhur shtat e kishin filluar të lulëzonin, kurse tek Profeti ynë (s.a.s.) filluan të jepnin frytet e tyre, duke mundësuar gjelbërimin e plotë të lëndinave dhe shndërrimin e botës në një trëndafilishtë. Sepse ai është një profet universal. Universaliteti i Tij shprehet përmes ajetit: ***“Dhe Ne nuk të kemi dërguar ty (o Muhamed), veçse si mëshirë për botët.”***²⁶ Të gjithë kanë përfituar nga kjo mëshirë e gjerë e të Dërguarit të Allahut (s.a.s.). Aq sa një ditë, Xhibrili (a.s.), një nga engjëjt më të mëdhenj dhe ai që i solli Pejgamberit tonë (s.a.s.) shpalljet e Kuranit përgjatë gjithë profetësisë së Tij, kur pyetet me *fjalët* ***“O Xhibril, a ke përfituar edhe ti nga mëshira e përgjithshme?”***, përgjigjet në këtë mënyrë: ***“Po, kam përfituar. Sepse as unë nuk isha i sigurt në lidhje me fundin tim. Kur Kurani më quajti mua ‘të besueshëm’, atëherë edhe unë u sigurova në lidhje me përfundimin tim.”***²⁷ Kurani thotë kështu për Të: ***“Atë e zbriti Shpirti i besueshëm (Xhibrili).”***²⁸ Gjerësia e kësaj mëshire, prej së cilës ka përfituar edhe vetë Xhibrili (a.s.), është një shembull i mjaftueshëm për të treguar gjerësinë e rrethit të forcës së shenjtë tërheqëse të Tij. Atëherë, ne besimtarët nuk duhet ta lëmë jashtë zemrës sonë, madje për asnjë çast, vetëdijen e të qenit një umet i gjendur brenda një rrethi mëshire që përfshin edhe engjëjt.

²⁶ Surja Enbija, ajeti 107.

²⁷ Kadi Ijad, esh Shifá 1/17.

²⁸ Surja Shuará, ajeti 193.

Po, Islami ka arritur përsosmërinë nëpërmjet Pejgamberit tonë (s.a.s.), njerëzimi në periudhën e Tij është zhvilluar, në periudhën e Tij ndodhën revolucionet materialo-shpirtërore në mendjen dhe mendimet e njeriut, në strukturën shoqërore nuk mbeti asgjë në emër të jetesës prej beduini, gjithçka lulëzoi dhe çdo anë u mbulua nga begatitë. I Dërguari i Allahut (s.a.s.), drejt fundit të detyrës së Tij si pejgamber, por edhe të jetës së Tij, teksa po kryente haxhin e Lamtumirës, i tha njerëzimit fjalët e Tij të fundit. Mes këtyre fjalëve recitoi edhe ajetin **“Sot jua përsosa fenë tuaj, e plotësova dhuntinë Time ndaj jush dhe zgjodha që Islami të jetë feja juaj”**²⁹ e, në këtë mënyrë, dha lajmin e plotësimit të fesë.

Zbritja e këtij ajeti është një mirësi dhe një bekim i atillë në emër të umetit të Muhamedit (s.a.s.), aq sa një ditë, një hebrë i drejtohet Omerit (r.a.) në këtë mënyrë: “O Udhëheqësi i Besimtarëve! Në Kuran gjendet një ajet i atillë, që, nëse do të na ishte zbritur neve, ditën e zbritjes së atij ajeti do ta kishim shpallur ditë feste.” Kur Omeri (r.a.) e pyeti atë se për cilin ajet bëhej fjalë, ai i pati përmendur ajetin e mësipërm. Pasi dëgjon përgjigjen e tij, Omeri (r.a.) buzëqesh dhe ia kthen në këtë mënyrë: “Myslmanët e dinë shumë mirë se ku dhe në çfarë atmosfere është shpallur ai ajet dhe se Profeti ynë (s.a.s.) ia ka përcjellur atë umetit të Tij. Atë ditë ishte edhe ditë e xhuma, edhe dita e Arafatit.”³⁰ Kështu, ia bëri të qartë atij se që të dyja ditët janë festë për ne.

Po, dita kur zbriti ai ajet që një festë për umetin, por kishte edhe një trishtim të madh brenda kësaj feste. Sepse i njëjti ajet njoftonte edhe për vdekjen e Pejgamberit tonë. Ai (s.a.s.) solli një fe, një sistem, të cilin, me urdhrin e Allahut, e përfaqësoi më së miri dhe e përcolli tek njerëzit, dhe, pasi e kreu detyrën e Tij, sërish nëpërmjet një urdhri, u thirr të shkonte tek Allahu.

Kur themi se çdo gjë u plotësua dhe u arrit falë Muhamedit (s.a.s.), mund të na lindë pyetja: “Tek të tjerët kishte mangësi?” Në të kaluarën, ishte e domosdoshme që çdo populli, çdo fisi t’i dërgohej një profet

²⁹ Surja Máide, ajeti 3.

³⁰ Buhári, ímán 33, megází 77, tefsiru súr (5) 2, itisám 1; Muslim, tefsir 3, 4, 5.

(pa dyshim që kjo domosdoshmëri ishte për njeriun, nuk mund të bëhet fjalë për një nevojë të tillë të Zotit të Madhëruar); një peygamber i lindur në Kinë nuk mund ta bënte të njëjtën detyrë edhe në Indi. Në të njëjtën mënyrë, një profet që dilte në ndonjë vend të Evropës, nuk mund të hynte nën peshën e detyrës së profetësisë në kontinentin e Azisë. Sepse kushtet e atyre periudhave ishin shumë të rënda, atëherë nuk kishte mjete udhëtimi si këto të ditëve të sotme. Në fakt, edhe në kohën kur u shfaq Profeti ynë (s.a.s.), njerëzimi në të njëjtën situatë ndodhej; komunikimi bëhej i mundur mbi shpinën e kuajve, nëpërmjet lajmëtarëve që dërgoheshin në të katër anët e botës. Por, me shtimin e mjeteve të komunikimit për umetin e Tij, bota tashmë thajse është shndërruar në një qytet, dhe kjo është një mrekulli e Pejgamberit tonë (s.a.s.). Për rrjedhojë, dërgimi i Profetit Muhamed (s.a.s.) në një periudhë kur njerëzimi do të përparonte shumë në fushat e qytetërimit, dijes, teknikës dhe teknologjisë, ka qenë e veçanta e Tij. Për këtë arsye, ndërsa profetët e mëparshëm qenë dërguar vetëm tek popujt apo fiset e tyre, Pejgamberi ynë (s.a.s.) u dërgua si profet për mbarë njerëzimin. Profeti ynë e ka shprehur këtë me këto fjalë: *“Çdo profet është dërguar vetëm për popullin e vet. Kurse unë jam dërguar për të gjithë njerëzit.”*³¹

Po, me zhvillimin e mundësive të komunikimit dhe transportit, sot bota sikur është shndërruar në një fshat global. Një ngjarje e ndodhur diku nëpër botë mund të ndiqet njëkohësisht nga të gjithë. Tashmë njerëzimi po endet nëpër hapësirë dhe po mëson e po merr informacion për planetet dhe yjet.

Në një hadith tjetër, i Dërguari i Allahut (s.a.s.) bën një krahasim të bukur për të treguar se Ai është hallka e fundit e zinxhirit të profetëve: *“Shembulli im dhe ai i profetëve të tjerë para meje i ngjason kësaj: Një burrë kishte ndërtuar një shtëpi shumë të bukur, por në një qoshe të saj kishte mbetur një hapësirë boshe sa për një qerpiç. Njerëzit filluan të shëtisnin shtëpinë duke e admiruar atë, por, kur panë boshllëkun në njëren qoshe të shtëpisë, thanë: ‘A nuk do të vihet edhe qerpiçi që mungon*

³¹ Buhári, tejmum 1, salát 56; Muslim, mesáxhid 3, 5.

këtu?’ Ja, pra, ai jam unë, unë jam i fundit i profetëve.”³²

Po, Ai ishte plotësuesi i poezisë që pati filluar me Ademin (a.s.). Nëse nuk do të kishte ardhur Ai (s.a.s.), nuk do të ishte e mundur që ne të dëgjonim emrin e Ademit (a.s.), të mësonim për Musain (a.s.) dhe të njihnim ashtu siç duhet Isain (a.s.). Njerëzimi vetëm falë Tij (s.a.s.) ka arritur të marrë informacionet dhe njohuritë e sakta në lidhje me popujt dhe ngjarjet e të kaluarës. Ashtu siç është Ai një profet universal, po ashtu edhe profetësia e tij duhet pranuar nga e gjithë bota. Sepse çelësi i miratimit të gjithçkaje është në dorën e Tij. Besimi në Zot, besimi tek profetët, librat dhe bota e përtejme janë të mundur vetëm brenda kornizës së parimeve që solli Ai (s.a.s.).

7. Besimi (imani), të vepruarit dhe nocioni ‘të qenit rob i Zotit’

a. Marrëdhënia besim-vepër

Feja, ashtu siç ka dimensionin e saj ideor dhe besimor, i cili duhet besuar, ka edhe aspektin që duhet vënë në jetën praktike, pra, atë të veprave. Imani përbën aspektin teorik të Islamit, ndërsa adhurimet dhe veprat përbëjnë aspektin praktik të tij. Ama veprat vijnë pas besimit. Në këtë aspekt, parimet që do të hidhen në praktikë janë në pozitën e plotësuesve të gjërave që, si fillim, duhen besuar teorikisht. Mbijetesa, qëndrimi në këmbë i një jete teorike pa atë praktike është i pamundur. Edhe nëse ia del të qëndrojë në këmbë, vështirë të jetë jetëgjatë. Ashtu siç ka dhënë edhe Bediuzaman (Mrekullia e kohës) Said Nursi, “*Siç nuk mund të bëhet shkak për shpëtimin Islami pa iman, po ashtu, nuk mund të jetë mjet shpëtimi as imani pa Islam.*”³³ Asnjëri nga këta të dy nuk është në gjendje të hedhë dritë i vetëm as në jetën e kësaj bote dhe as në atë të botës tjetër. Për këtë arsye, njeriu duhet të jetojë ashtu siç beson dhe është i detyruar ta mbështesë besimin me veprat e tij.

³² Buháí, menákib 18; Muslim, fedáil 23.

³³ Bediuzamani, Letrat, fq. 55 (Letra e Nëntë).

Askush nuk ka parë që besimi i një personi që nuk vepron të zgjasë për një kohë të gjatë. Imani përforcohet vetëm me mënyra e metoda të tilla si: frekuentimi i mesxhideve, edukimi i nefsit nëpërmjet agjërimit, pastrimi i zemrës nga çdolloj koprracie etj. Përsëri, besimi forcohet edhe duke urdhëruar të mirën e duke ndaluar të keqen.

Shkurtimisht, të gjitha gjërat në emër të shtyllave të Islamit janë nga një mbështetëse, përforcuese në të djathtë e në të majtë të imanit, para dhe pas tij. Në këtë aspekt, adhurimet shprehin përruljen para Allahut të njerëzve që thonë se i besojnë Atij. Sepse një njeri që beson duhet të dallojë nga ata që nuk besojnë. Besimtari shfaq lidhjen e tij me Allahun vetëm nëpërmjet adhurimeve dhe, kështu, vërteton se i ka besuar Atij me të vërtetë.

Adhurimet janë litarët e pakëputshëm të marrëdhënies ndërmjet robit dhe Allahut. Sa më shumë që t'i forcojë njeriu këta litarë, aq më i zhvilluar do të jetë shpirtërisht, aq më i zhvilluar do të jetë aspekti i tij engjëllor. E, në fakt, ky është kuptimi i vërtetë i adhurimeve dhe i të qenit rob i Allahut. Kjo lidhje duhet ruajtur përgjatë gjithë jetës. Për këtë arsye, edhe Profeti ynë (s.a.s.) është shprehur kështu: *“Më e virtytshmja e veprave është ajo që, edhe pse e paktë, është e vazhdueshme.”*³⁴ Namazi që falet çdo ditë, i ndarë në pesë kohë, konsiderohet si më e pakta që mund të bëhet në çështjen e adhurimit. Sipas kësaj, do të thotë se një njeri që lë pas dore pesë kohët e namazit privohet nga kjo vepër e virtytshme dhe se, rrjedhimisht, nuk ka hyrë në rrugën që do t'i mundësonte lidhjen me Zotin e tij dhe pastrimin e zemrës nga bloza e ndryshku. Duke iu drejtuar Pejgamberit tonë (s.a.s.), Zoti i Madhëruar thotë: **“Dhe adhuroje Zotin tënd derisa të të vijë vdekja.”**³⁵ Kuptimi i këtij ajeti është ky: “Duke kryer adhurimet deri në çastin kur do të të vijë vdekja, ti vër në pah natyrën tënde; trego se nuk je nga ato gjallesa që lëvizin mbi katër këmbë apo që zvarriten në tokë.”

Po, marrëdhënia e zemrës dhe shpirtit me botën hyjnore mund të zhvillohet e të përparojë vetëm nëpërmjet adhurimeve. Zhvillimi i

³⁴ Buhárí, libás 43; Muslim, salátul musáfírín 218.

³⁵ Surja Hixhr, ajeti 99.

lidhjes me Zotin varet nga vënia në punë në këtë drejtim e këtyre dy organeve. Ashtu si lëvizjet e përsëritura me duar dhe këmbë, të cilat, me kalimin e kohës, bëjnë të mundur që duart dhe këmbët të mësohen me ca gjëra në atë drejtim, po ashtu zemra dhe shpirti fitojnë prirje ndaj ca çështjeve përmes adhurimeve, nuk ndiejnë frikë ndaj tyre dhe në trup nuk ndodh asnjë shkurajim. As rëndimi i gjumit, as lezeti i ushqimeve dhe as kënaqësitë e tjera të jetës nuk përbëjnë pengesë për adhurimet. Me këtë rast, mund të themi se ashtu siç shkohet drejt mosbesimit nëpërmjet disa veprimeve të bëra zakon, po ashtu edhe robëria ndaj Zotit arrihet përmes fitimit të ca zakoneve. Njeriu, në të shumtën e rasteve, nuk e gjen mundësinë për ta adhuruar me një ndërgjegje vigjilente Zotin. Por shprehitë e fituara në zemër dhe shpirt bëjnë të mundur kapërcimin me lehtësi të boshllëqeve që mund të dalin në marrëdhënien me Zotin. Për shembull, nefsiti i vjen rëndë të çohet që herët në mëngjes e të marrë abdes me ujë të ftohtë. Në vend të kësaj, ai preferon të pushojë brenda një shtrati të rehatshëm. Por, me shprehitë që ka fituar, njeriu i kapërcen të gjitha këto vështirësi dhe ngrihet për të falur namazin. E, në këtë mënyrë, nuk lejon që të krijohen boshllëqe në lidhjen e tij me Zotin. Herë të tjera, me zemrën dhe shpirtin të gjendur brenda ndijimit të adhurimeve dhe ngopjes me to si pasojë e puhizave të ardhura nga Zoti i Madhëruar, njeriu i kryen ato në shoqërinë e mijëra buzëqeshjeve të fshehura në buzët e tij.

Në natyrën e tij, njeriu bart kuptime edhe nga natyra kafshërore, por edhe nga ajo engjëllore. Zhvillimi dhe përparimi i anës së tij engjëllore bëhet i mundur vetëm duke i dhënë më shumë peshë adhurimeve dhe duke injoruar anën kafshërore. Aspekti engjëllor i njeriut shfaqet dhe përparon në atë masë që përsëriten e që ndihen përbrenda adhurimet. Kështu, njeriu fillon të lartësohet shpirtërisht me gradat që fiton. Nga ana tjetër, adhurimet e kryera duke qëndruar larg Allahut dhe të lidhur me dynjanë mbeten të mangëta, me një pjesë të formulave të tyre të pazbatuara. Si rezultat i kësaj, ato nuk e përmbushin detyrën e një pikëkalimi të hapur nga ndërgjegjet për në botën hyjnore. Si përfundim, lidhja me Allahun nuk mund të zhvillohet, ndërsa kjo anë e njeriut mbetet e gjymtë.

Zhvillimi është i padiskutueshëm për këdo që përpiqet në lidhje me botën e tij të brendshme. Ky mund të jetë një hindu, një brahman, një mistik i krishterë apo dikush tjetër, nuk ka rëndësi se kush. Ai mund të rrijë për ditë të tëra pa ngrënë e pa pirë, mund t'i mbajë ndjenjat epushore larg mendjes së tij për muaj me radhë dhe mund të kalojë gjithë jetën në shoqërinë e flladeve të botës hyjnore. Por mes të vepruarit të një myslimani në këtë mënyrë dhe të vepruarit të tjerëve – nga pikëpamja e asaj që kërkohet – ka goxha ndryshim. Ndërkohë që myslimani është në rrugën e përparimit me çdo vepër që bën, të tjerët janë në vend-numëro ose janë duke u hedhur dhe duke rënë në të njëjtin vend. Ata, duke u bazuar tek disa vëzhgime të brendshme që iu mundësohen, me atë të tyren, pandehin se po bëjnë përparim. Por ajo çfarë ata bëjnë nuk përbën asgjë më shumë se të kërcyerit në mënyrë të vazhdueshme në fundin e një pusi. Për rrjedhojë, distanca e përshkuar është vetëm sa gjatësia e një pusi. Ndërsa qëllimet e të vepruarit në këtë mënyrë janë arritja e qetësisë, arritja e paqes shpirtërore edhe në mospasje, shpëtimi, qoftë edhe përkohësisht, nga vuajtja e mosekzistencës së përjetshme dhe kërkimi i zgjidhjeve për rëndesën e llogaridhënies pas vdekjes.

Sot, shumë njerëz të privuar nga kuptimi i saktë i hyjnore rrinin e vërtiten brenda kornizës së ngushtë të besimeve të tyre të ngushta dhe nuk po munden të hedhin hapat e të përparojnë drejt botës hyjnore. Qëllimi i veprave të tyre është vetëm përftimi i një vëzhgimi të brendshëm. Përkarshi kësaj, situata e myslimanit, përse i përket adhurimeve që bën, është si ajo e një lokomotive të mirëvendosur në shinat e saj. Ai, në çdo fazë të jetës së tij, mbërrin në një stacion të ndryshëm, ku arrin të depërtojë në brendësinë e ngjarjeve dhe objekteve, të shijojë emrat dhe atributet hyjnore dhe, i gjendur përballë madhësisë së Esencës Hyjnore, mahnitet e kalon në ngazëllim. Ky është një udhëtim që, në mënyrë të drejtpërdrejtë, flet me të folurën e Esencës Hyjnore, sheh me shikimin e Tij, dëgjon me të dëgjuarin e Tij dhe kap me kapjen e Tij. Dhe përballë një udhëtimi të këtillë mendja dhe perceptimi mbeten të pamjaftueshëm!

Në këtë udhëtim, pas “*sejr ilalláh*” (udhëtimi drejt Allahut) dhe “*sejr fil’láh*” (udhëtim në emrat dhe atributet e Allahut), fillon “*sejr minalláh*”, i cili është kthimi nga i Vërteti tek njerëzit përsëri. Pra, është hyrja sërish në mesin e njerëzve, kapja e tyre nga duart për t’i çuar drejt pjekurisë dhe për t’i bërë edhe ata të shijojnë të gjitha kënaqësitë e mundësuarat si rezultat i distancave të përshkuara, gjithmonë duke ndjekur rrugën e të Dërguarit të Allahut (s.a.s.). Kjo rrugë e besimtarit që, tamam si një lokomotivë, ka vënë pas vetes me mijëra njerëz, duke qenë se shkon drejt botës hyjnore, zgjatet deri në pafundësi. Sepse udhëtimi që bëhet drejt Allahut nuk ka fund. Çdo njeri, që, duke përparuar në rrugën e këtij udhëtimi shpirtëror, arrin në observime të brendshme, i shijon dhe i ndien ato mes gëzimit dhe kënaqësisë që të mundësojnë adhurimet, dhe, ndërkohë që nyjet e ndjesive hyjnore zgjidhen një nga një, mbetet ballë për ballë me buzëqeshjet e botës hyjnore.

b. Nocioni i ‘të qenit rob i Zotit’

Shpirtrat zhvillohen dhe arrijnë fuqinë e tyre të vërtetë nëpërmjet adhurimit të Allahut. Sepse marrëdhënia me Allahun është një cilësi që i përket vetëm qenieve njerëzore; nuk mund të bëhet fjalë për një marrëdhënie të tillë të kafshëve me Të. Zoti i Madhëruar i krijon ato dhe i shtyn drejt gjërave të caktuara, të cilat ua ka vendosur në natyrën e tyre. Në anën tjetër, nga njeriu kërkon që, për të mos u ekspozuar ndaj një prishjeje dhe kalbjeje shpirtërore, të ndërtojë një marrëdhënie me Të, t’i bindet Atij dhe ta adhurojë Atë. Sepse adhurimi është marrëdhënie e njeriut me Allahun, pra, lidhja e tij me Atë që e ka krijuar dhe që e mban në këmbë. Kjo mbajtje në këmbë ka të bëjë edhe me aspektin trupor, edhe me aspektin mendor, edhe me atë të botës së brendshme. Të gjitha këto ndjesi vdesin kur lidhja me Të ndërpritet. Sepse epshi, urrejtja, inati dhe ndjenja të tjera si këto janë arsye të mjaftueshme për vrasjen e këtyre ndjesive hyjnore. Robi duhet të qëndrojë në namaz, të shohë nëpërmjet tij Arshin e Madh dhe të arrijë kënaqësinë e adhurimit të vërtetë, në mënyrë që, edhe kur instinktet kafshërore si urrejtja dhe inati të ushtrojnë ndonjëherë veprimtarinë e tyre, ana e tij engjëlllore

t'i fshijë si një sfungjer këto shkrime të ndyra të tyret dhe të nxjerrë në pah identitetin e tij të vërtetë.

Po, marrëdhënia, lidhja e njeriut me Zotin e Madhëruar vazhdon për aq kohë sa ai kryen adhurimet dhe çon në vend detyrën e të qenit rob i Tij. Çdo pengesë që futet mes robit dhe Zotit të tij mbart natyrën ndërprerëse të kësaj marrëdhënieje. Allahu (*xhel'le xheláluhu*), duke iu drejtuar Profetit tonë (s.a.s.) me fjalët **“Prandaj, përmende emrin e Zotit tënd dhe përkushtoj krejtësisht Atij!”**³⁶, sikur po i thotë Atij kështu: “O i Dashuri im! Shkëputu nga sevdaja për fëmijët dhe bashkëshorten; edhe sikur të jesh i martuar, veçohu pak, përkushtoj Zotit tënd dhe pastroje zemrën nga gjërat që kanë të bëjnë me dynjanë. Sepse ti je një profet. Dhe cilësia e mbërritjes së një profeti tek Allahu, adhurimet e tij, në këto pika e tregojnë veten.” Kjo gjendje – sipas mistikëve – është prerja e lidhjes me çdo gjë tjetër përveç Allahut; ndërsa sipas dijetarëve gjithmonë kërkues të së vërtetës, do të thotë t'i konsiderosh si të kësaj bote dhe t'i hedhësh pas shpine të gjitha gjërat që të largojnë nga Allahu.

Këtu është e nevojshme të qëndrohet pak tek fjala “tebettel”, e cila përmendet në ajetin e mësipërm. Kjo folje, e cila, sipas shkencave të morfologjisë dhe etimologjisë, na shfaqet në mënyrën urdhërore, do të thotë: “Shtrëngoje veten në këtë pikë, edhe sikur zemra jote të mos e dëshirojë këtë gjë.” Pra, ka një vështirësi, një stërmundim në këtë mesele. Kur njeriu të shtrëngojë veten për kapërcimin e kësaj vështirësie, observimet në lidhje me botën e tij të brendshme do të vazhdojnë të vijnë duke u shtuar. Ama sforcimi në krye të kësaj çështjeje është i paevitueshëm. Në një sure tjetër thuhet kështu: **“O ti, i mbështjellë (o Muhamed)! Çohu dhe paralajmëro! Zotin tënd madhëroje, petkat e tua pastroj dhe largohu nga ndyrësia (adhurimi i idhujve)!”**³⁷

Kurse në një ajet tjetër, i Dërguari i Allahut (s.a.s) urdhërohet në këtë mënyrë: **“Dhe qëndro me ata që i luten Zotit të vet në mëngjes dhe mbrëmje, duke dëshiruar Fytyrën (kënaqësinë) e Tij dhe mos i**

³⁶ Surja Muzzemmil, ajeti 8.

³⁷ Surja Mud'deth'thir, ajetet 1-5.

shmang sytë nga ata (tek të tjerët), duke dëshiruar stolitë e shkëlqimin e kësaj jete. Mos dëgjo atë, zemrën e të cilit ia kemi lënë mospërfillëse ndaj përmendjes Sonë, që shkon pas dëshirave të veta duke shkelur çdo kufi në veprimet e tij.”³⁸ Kjo mund të përmblihet kështu: “Ti bëj atë që të shkon ty për shtat, mos ua ngul sytë pasurive materiale dhe atyre që i zotërojnë ato!”

Allahu (*xhel’le xheláluhu*), nëpërmjet gjithë këtyre ajeteve, e ka edukuar të Dashurin e Tij të Moralshëm në një mënyrë të atillë, saqë, falë këtij edukimi, Ai (s.a.s.) ka zënë vend në fronin e zemrës së gjithë njerëzimit tash e katërmbëdhjetë shekuj më parë. Ne, nga të gjitha këto, mund të nxjerrim këtë kuptim: Kur e kërkon nevoja, njeriu duhet të jetë në gjendje t’i fshijë e t’i flakë tutje të gjitha pengesat që bëhen shkas për shkëputjen e lidhjes së tij me Zotin.

Bekimet, të mirat dhe pasqyrimet shpirtërore, që i vijnë shpirtit të njeriut përmes adhurimeve, shtohen në varësi të lidhjes me Zotin. Sa më e fortë të jetë kjo lidhje, aq më të shumta do të jenë edhe përfitimet. Në këtë rast, ndërgjegjet arrijnë në një atmosferë të hareshme e flladitëse. Ashtu siç thuhet në ajetet “*Vallë, a nuk e sheh se si Allahu e përqsas fjalën e mirë me pemën e mirë, e cila rrënjën e ka të fortë në tokë, kurse degët nga qielli?*”³⁹ dhe “*Tek Ai ngjiten fjalët e bukura, ndërsa veprën e mirë Ai e ngre Vetë (Punët e mira dhe të pëlqyera ua shtojnë vlerën fjalëve të bukura).*”⁴⁰, fjalët që dalin nga zemra, të dëlira, të paturbullta dhe të papërziera, fjalët dhe veprat që synojnë vetëm fitimin e kënaqësisë së Zotit ngjiten tek Allahu. Kurse fjalët dhe veprimet pas të cilave fshihen mendime të tjera mbeten të privuara nga këto begati dhe bereqete.

I Dërguari i Allahut (s.a.s.), në një hadith të tijin, thotë kështu: “*Tre njerëz do të jenë ndër të parët që do të thirren në ditën e Kiametit: I pari mes tyre do të jetë hafizi i Kuranit të Shenjtë; dikush i vrarë në rrugë të Allahut do të jetë i dyti, kurse i treti do të jetë një person që ka bërë një*

³⁸ Surja Kehf, ajeti 28.

³⁹ Surja Ibrahim, ajeti 24.

⁴⁰ Surja Fátir, ajeti 10.

jetë të pasur në këtë botë. Allahu (xhel'le xheláluhu) do ta pyesë atë që lexon Kuran: 'A nuk ta kam mësuar edhe ty atë që i zbrita të Dërguarit tim?' Burri do t'i përgjigjet: 'Po, o Zot!' Allahu do ta pyesë sërish: 'Çfarë veprash bëre me ato që dije?' Përgjigjja e burrit do të jetë kështu: 'Unë e lexoja atë ditë e natë.' Allahu i Madhëruar do ta përgënjeshtrojë: 'Ti po gënjen!' Edhe engjëjt do t'i kundërvihen atij: 'Ti po gënjen!' Pastaj, Allahu (xhel'le xheláluhu) do t'i thotë: 'Përkundrazi, ti lexove që të tjerët të thonë se filani po lexon Kuran, dhe ashtu thanë.' Mandej do t'i vijë radha personit të pasur. Allahu (xhel'le xheláluhu) do t'i drejtohet atij: 'A nuk të pata dhënë ty shumë pasuri, madje, aq sa për të mos qenë nevojtar ndaj askujt?' Burri i pasur do të përgjigjet: 'Po, o Zot.' Dhe kur Zoti ta pyesë 'Si veprova me atë që të dhashë?', ai do të thotë: 'E përdora për t'u bërë mirë të tjerëve dhe për të ruajtur marrëdhëniet e mira me të afërmit.' Allahu do t'ia kthejë: 'Përkundrazi, ti i bëre këto që të tjerët të thonë se filani është xhymert, dhe kështu thanë.' Pastaj, para Allahut do të vijë personi që u vra në rrugën e Allahut. Allahu (xhel'le xheláluhu) do ta pyesë: 'Për çfarë u vrave ti?'. Ai do të përgjigjet: 'U urdhërova të bëja xhihad në rrugën Tënde. Kështu që, luftova derisa më gjeti vdekja.' 'Po gënjen!' do t'i thotë atij i Vërteti i Madhëruar. Pas këtyre fjalëve të Zotit do të flasim edhe engjëjt: 'Ti po gënjen!' Allahu i Lartësuar do t'i thotë edhe këtij: 'Ti luftove që të tjerët të thonë se filani është trim, dhe kështu u tha.' (Më pas, Profeti ynë (s.a.s.), duke i rënë Ebu Hurajras (r.a.) tek gjuri, thotë:) 'O Ebu Hurajra! Këta tre njerëz janë tre krijesat e para të Allahut, ndaj të cilëve Xhehenemi do të shfrejë në Ditën e Gjykimit!'⁴¹

Prandaj robi, në gjërat që bën në emër të adhurimeve, duhet ta kontrollojë njetin e tij herë pas here dhe ta mbajë atë të pandryshueshëm. Sepse të gjitha adhurimet fitojnë peshë dhe thellësi për sa kohë kryhen me qëllimin për të fituar kënaqësinë e Zotit.

Po, adhurimet, bindja dhe nënshtrimi janë shprehje të marrëdhënies me Zotin. Emocionet e gënjeshtërtë dhe entuziazmimet e shtirura janë monedha të pavlefshme në këtë rrugë. Gjërat që mundësojnë bonuse përgjatë kësaj rruge janë ahet e lëna mbi cullufet e zeza të natës, sexhadet

⁴¹ Tirmidhí, zuhd 48; Ibn Hibbán, es Sahíh 2/136.

e lagura me lot, zemrat që ndizen kur dëgjojnë urdhrin “O njerëz! Bëhuni robër të Zotit tuaj!”. Të gjitha këto janë nga ato vepra që bëhen shkak për pastrimin e njeriut nga shëmtitë dhe shndërrimin e tij në një krijesë të denjë për Xhenetin. Ashtu siç ndahen dhe pastrohen nga mbetjet ari dhe argjendi, për të ardhur në trajtën e tyre përfundimtare, po ashtu edhe njeriu, që të pastrohet, të hyjë në Xhenet dhe të meritojë kundrimin e bukurisë së Allahut (*Xhemalullah*), është ngarkuar me detyrën e adhurimit të Allahut dhe të qenit rob i Tij. Nëpërmjet kësaj robërie do të pastrohet dhe do të arrijë kthjelltësinë njeriu. Dhe, ashtu siç ka thënë edhe i Dërguari i Allahut (s.a.s.), kur të tjerët ta shohin atë, do të sjellin në mendje Allahun.⁴² Po, adhurimet dhe robëria ndaj Allahut janë ato që e pastrojnë njeriun, e kthjellojnë dhe i mundësojnë ndjenja të kulluara. Për këtë arsye, Allahu (*xhel'le xheláluhu*) urdhëron kështu: “O njerëz! Adhuroni Zotin Tuaj, i Cili ju ka krijuar ju dhe ata që ishin para jush, që të mund të ruheni (nga të këqijat).”⁴³

Adhurimi, me të gjitha format e tij, bën të mundur organizimin dhe formësimin e jetës, gjithashtu të jep mundësinë për ta ndarë kohën në pjesë të caktuara. Ne e kuptojmë dhe njihemi me sekretin e kohës kur adhurimet, duke hyrë brenda saj në trajtën e vijave të ndritshme, e ndajnë atë në pjesë. Agjërimi bën të mundur ndarjen e vitit. Falë tij, muajt e vitit vihen në radhë; muajt Rexhep, Shaban, Sheual, Dhilkade, Dhilhixhe formojnë një hallkë rreth Ramazanit; xhumaja u jep ngjyrë ditëve të javës. Java i nënshtrohet një ndarjeje nëpërmjet xhumasë; dita ndahet në pesë pjesë me namazet, falë namazeve ndriçohet çdo orë e saj. Kështu, e gjithë koha përreth jetës sonë mbushet me harënë e të qenit rob i Allahut.

⁴² Ibn Máxhe, zuhd 4.

⁴³ Surja Bekare, ajeti 21.

PJESA E DYTË



NAMAZI NË ISLAM

1. Vendi që zë namazi në fe dhe rëndësia e tij

Vendi që zë namazi në fenë Islame është shumë i madh. Në Kuran, namazi përmendet menjëherë pas çështjeve që i përkasin besimit. Edhe pse ne nuk mendojmë kështu për të tjerët, sahabët dyshonin në imanin e atij që nuk falte namaz. Në këtë pikë, hadithi “*Mes robit dhe mosbesimit qëndron vetëm lënia e namazit*”⁴⁴ është një argument i rëndësishëm që e mbështet këtë qasje të sahabëve. Kurse falja e namazit brenda ndjenjës së *hushú*-së (frikë, bindje, përrulje, nënshttrim), për të cilën do të flasim më gjerësisht në vijim, është e një rëndësie të veçantë për sa i përket përfitimeve që vijnë bashkë me të.

Namazi është më gjithëpërfshirësi i adhurimeve. Nga ky këndvështrim, mund të thuhet se ai është adhurimi më i përsosur i njeriut të përsosur. Po, namazi është adhurimi më i përshtatshëm ndaj këtij njeriu të përkryer, i krijuar me aftësinë për të arritur tek Allahu, për të interpretuar ekzistencën dhe për të zhbhiruar gjithësinë përmes dijeve dhe shkencave të ndryshme. Njeriu mund ta shprehë përsosmërinë në thelbin e tij vetëm nëpërmjet një adhurimi si namazi dhe vetëm nëpërmjet tij mund shfaqë veçorinë e të qenit njeri, gjë kjo që edhe Allahu e kërkon prej tij.

Po, përsosmëria materialo-shpirtërore e njeriut është një e vërtetë e padiskutueshme. Për shembull, pamja e jashtme e trupit të njeriut dhe përshtatshmëria, harmonia e kohezioni mes organeve të tij janë aq të bukura sa për të ngjallur ndjenjën e admirimit tek të gjithë. Gjenitë e artit romak e patën kuptuar shumë mirë bukurinë e tij, por, për shkak se nuk iu drejtuan Unitetit Hyjnor, u përpoqën t’i shprehin këto ndjenja përmes pikturave dhe skulpturave konkrete dhe, në këtë mënyrë, e kufizuan këtë mesele brenda ca kornizave fare të ngushta.

⁴⁴ Muslim, ímán 134; Tirmidhí, ímán 9; Ebú Dáúd, sunnet 15.

Unë, duke thënë shprehimisht “Nëse Allahu do të lejonte që t’i bëhej sexhde edhe dikujt tjetër përpos Tij, ky do të ishte njeriu”, e kam shfaqur këtë admirim timin për njeriun në kohë dhe vende të ndryshme. Në një aspekt, kuptimin e kësaj fjalie duket sikur e mbështet edhe urdhri që morën engjëjt për t’i bërë sexhde Ademit (a.s.). Sigurisht, dimensionit tjetër i kësaj çështjeje, ai i bindjes ndaj urdhrave të Allahut pa kërkuar për urtësitë dhe përfitimet që fshihen pas tyre, peshon më rëndë.

Parë në aspektin e përfitimeve shpirtërore që përmendëm më sipër, kryerja e këtij adhurimi, që lidhet ngushtë me njeriun, në një mënyrë të përkryer është shumë e rëndësishme. Zoti i Madhëruar, në suren *Mu’minún*, thotë kështu: **“Me të vërtetë, janë të shpëtuar besimtarët, të cilët janë të përlulur në namazin e tyre.”**⁴⁵ Pavarësisht faktit që nuk është e drejtë të nxirret kuptimi i kundërt i diçkaje në çdo rast, nëse do të merrnim parasysh kuptimin e kundërt të këtij ajeti, mund të arrihej në këtë përfundim: “Nuk mund të shpëtojnë ata që nuk janë të përlulur në namazin e tyre.” Edhe pse nuk kemi tendencën për të anuar nga ky interpretim, e vlerësojmë si një veprim të kujdesshëm marrjen në konsideratë edhe të kësaj mundësie. Nga ky këndvështrim, ne besojmë se, ashtu siç e ndien me të gjitha qelizat e tij një njeri i uritur ushqimin që ha, ashtu siç e shijon pirjen e ujit një njeri i tharë nga etja apo ashtu siç e ndien oksigjenin në mushkëritë e tij një person që po merr frymë lirshëm në një atmosferë me ajër të pastër pasi ka mbetur për ca kohë në një vend me ajër të rënduar, edhe namazi duhet falur duke u ndier në këtë mënyrë.

Po, namazi nuk është diçka që mund të anashkalohet apo që, nëse do të shpreheshim me gjuhën e popullit, mund të kryhet sa për sy e faqe dhe sa për të kaluar radhën. Ai është një adhurim që kërkon kohën e vet të veçantë, dhe të përqendruarit para fillimit të këtij adhurimi është diçka që duhet bërë patjetër. Në fakt, namazi dhe përgatitjet para namazit janë në gjendje ta bëjnë të mundur këtë përqendrim dhe, nga renditja e tyre, mund të shihen edhe si instrumente të procesit të namazit.

Për shembull, nëpërmjet kryerjes së nevojës, gjërat e tepërta në trup nxirren jashtë dhe, kështu, njeriu ndien një lehtësim. Më pas, përmes

⁴⁵ Surja *Mu’minún*, ajetet 1-2.

abdesit, bëhet i mundur balancimi i energjisë kinetike në trupin tonë dhe, me këtë, realizohet edhe një relaksim tjetër. Menjëherë pas kësaj, ezani Muhamedan, i cili hap flatrat nga minaret e xhamive, na tërheq drejt një thellësie e drejtimi të veçantë. Mandej, ecet drejt xhamisë me përulje, thua se po arrihet tek Allahu. Njëpërmjet melodive të ëmbla të muezinit mundësohet hyrja në një botë tjetër, falen sunetet dhe, më në fund, vjen ikameti i muezinit. Po, të gjitha këto janë nga një thirrje drejt thellësisë së brendshme, ndjesive ndaj Zotit dhe të menduarit vazhdimisht për Të, të gjitha këto janë elementë të rëndësishëm për sigurimin e përqendrimit të nevojshëm në përmbushjen e detyrës së faljes së namazit farz.

Falja e namazit, duke e ndier kaq thellësisht, është një qëllim, kurse përgatitjet që bëhen para namazit mund të vlerësohen si strategji që do të bëjnë të mundur arritjen e atij qëllimi. Thënë në një kuptim më të gjerë, ashtu si qasjet e ndjekura për realizimin e qëllimeve të caktuara, edhe këto mund të shihen si motive të përdorura për të arritur atë namaz të përkryer. Ezani, ikameti, abdesi, namazet nafile dhe asnjë nga veprimet e tjera para namazit nuk janë qëllimi kryesor. Të gjitha këto janë veprime të realizuara që edhe adhurimi i njeriut, qenies më të përkryer e të krijuar në trajtën më të bukur, të jetë i denjë për të.

Namazi, i cili do ta afrojë me Allahun këtë krijesë të përsosur për sa i përket strukturës së saj të brendshme e të jashtme dhe që konsiderohet një shprehje e të qenit me të vërtetë njeri, duhet të kryhet patjetër brenda një thellësie të brendshme serioze. Ankthi në lidhje me paaftësinë për ta arritur faljen e namazit në këtë mënyrë ose vuajtja e përjetuar në këtë pikë është një nivel i rëndësishëm për robin. Këtu duhet të themi edhe se një namaz i tillë, i cili në vetvete përbën qëllimin e epërm të çdo besimtari, “shumë pak” njerëzve i mundësohet. Togfjalëshi “shumë pak”, i përdorur në fjalinë pararendëse është relativ. Për shembull, dikush ka vënë kokën në sexhde dhe nuk mendon ta ngrejë atë që aty; një tjetër, kur qëndron në namaz, ndihet sikur e ka lëshuar veten brenda një kopshti trëndafilash; dikush tjetër mendon sikur është duke shëtitur nëpër shpatet e parajsës gjatë faljes së namazit; të tjerë mund ta shohin veten para krijesave të tjera shpirtërore. Ky është një horizont

që mund të kapet nga gjithsecili në varësi të aftësive që ka. Sidoqoftë, për sa kohë që ne të jemi në ndjekje të përsosmërisë me nijetet tona, edhe nëse nuk ia dalim ta arrijmë qëllimin e dëshiruar, është gjithmonë e mundur që, përmes nijeteve tona, ta kapim atë çfarë synojmë. Nuk duhet harruar se *“Nijeti i besimtarit është më i dobishëm se vepra e tij”*⁴⁶.

Ndonjëherë ndodh që, edhe pse njerëzit kanë bërë çdo gjë ashtu siç duhet në emër të namazit, për arsye të ndryshme, të mos jenë në gjendje ta falin namazin duke e shijuar atë në maksimum. Për shembull, në momentin që je duke falur namazin vijnë fëmijët dhe të hipin në shpinë, që, çështë e vërteta, kjo gjë i ndodhte shumë herë edhe të Dërguarit të Allahut (s.a.s.). Ose mund të ndodhë që gjatë faljes së namazit të dëgjohet një zhurmë e madhe dhe e gjithë vëmendja rrëshqet drejt asaj pike. Për rrjedhojë, arritja e kulmit në namaz bëhet e pamundur.

Gjatë namazit, ekziston mundësia që të përballemi me disa situata të paparashikueshme dhe që nuk janë në dorën tonë, por ka edhe ca situata të tjera, të cilat burojnë nga ana jonë njerëzore. Për shembull, gjatë faljes së namazit, njeriut mund t'i vijnë në mendje ëndrrat që ka thurur në botën e tij të brendshme, duke kaluar kështu para namazit në ato çaste dhe duke iu bërë atij perde. Në një situatë të këtillë, njeriu e ndien veten vazhdimisht brenda një mjegulle apo tymi. Edhe një njeri si Omeri (r.a.), i lidhur vazhdimisht me qiejt, hutohet gjatë namazit për shkak se mendjen e ka të zënë me lajmin që i sollën, një problem që kishte të bënte me Irakun.⁴⁷

Një aspekt tjetër i kësaj teme është në lidhje me atmosferën në të cilën falet namazi. Është më se e qartë se mes një namazi të falur në një atmosferë larg problemeve dhe vështirësive dhe një namazi tjetër të falur nën shtrëngimin e një mijë e një vuajtjeve, shqetësimeve dhe mendimeve të gjithfarëllojshme do të ketë dallime të mëdha. Namazet e llojit të dytë janë si një dimension i veçantë i thellësisë së namazit. Në fakt, edhe pse qetësia jonë në namaz shpohet një mijë e një herë nga

⁴⁶ Taberání, el Mu'xhemul kebír 6/185-186; Bejhakí, es Sunenus-sugrá fq. 20.

⁴⁷ Ibn Sa'd, et Tabakatul kubrá 7/441.

gjëra të ndryshme që na vijnë nga të gjitha anët, në një këndvështrim tjetër, të ndierit e namazit si një frymëmarrje mes këtij stresi dhe problemeve bën që ai të fitojë një tjetër ngjyrë, mbase të pakuptueshme për ne. Dhe, për mendimin tim, kjo është ajo që ka rëndësi.

Kjo është arsyeja pse namazet e falura në kohë lufte kanë shumë më shumë sevape se namazet e falura në kohë normale. Kur shohim mënyrën se si kryhet falja e “salátul hauf” (namazi i frikës), përballemi me tablo që mund të na duken të çuditshme. Në suren *Nisá*, ky namaz shpjegohet kështu:

“Kur të jesh ti (o Muhamed) në mes të besimtarëve dhe të prish faljen e namazit (në luftë), atëherë njëri grup prej tyre le të falet me ty dhe le t’i mbajnë pranë edhe armët e veta! Pastaj, këta le të rrinë pas jush dhe le të vijë grupi tjetër, i cili nuk është falur, dhe le të falet me ty! Le të jenë syçelë dhe t’i mbajnë armët e veta! Jobsimtarët dëshirojnë që të jeni të pakujdesshëm ndaj armëve dhe pajimeve tuaja, që t’ju sulmojnë me tërë fuqinë...”⁴⁸

Ja pra, një namaz i falur në këtë mënyrë, duke menduar se kur do të bëhemi shënjestër e plumbave apo se kur do të përballemi me ndonjë bombardim, edhe pse mund të na vijë çuditshëm, është shumë më i vlefshëm dhe i një cilësie më të lartë në krahasim me namazet e tjera.

Si përfundim, mund të themi se edhe në namazin që fal duke kërkuar hapësirat boshe nëpër kohë, duke u ndier sikur një barrë e rëndë po të rëndon mbi shpinë dhe duke thënë “Pavarësisht gjithçkaje, unë duhet ta kryej atë patjetër”, ka një thellësi të atillë, për të cilën jam i mendimit se vështirë të kapet nga ata që falin namazet nëpër teqé e kënde adhurimi, madje edhe në Qabe.

a. Adhurimi i parë për të cilin do të jepet llogari

Namazi është adhurimi i parë për të cilin besimtari do të japë llogari para Allahut. As zinaja, as konsumi i pijeve alkoolike e as ndonjë gjë tjetër! Nga kjo, nuk duhet nxjerrë përfundimi se adhurimet e tjera janë

⁴⁸ Surja *Nisá*, ajeti 102.

të parëndësishme, përkundrazi, duhet kuptuar rëndësia e namazit. Nëse një njeri nuk fal namaz, do të thotë se po përjeton humbjen më të madhe të jetës së tij.

Krahasuar me faljen e namazit, kryerja e adhurimeve si agjërimi, zekati, haxhi është më e lehtë. Namazi ka vështirësinë e tij specifike. Në fakt, sahabët nuk shihnin si “munafik” (hipokrit) atë që nuk agjëronte apo që nuk kryente adhurimin e haxhit, por atë që nuk falte namaz. Madje edhe dijetarët, kur bëhej fjalë për temën e hipokrizisë me vepra, shumë herë jepnin si shembull braktisjen e namazit. Paraqitja e adhurimeve të tij para Allahut pesë herë në ditë – në varësi të thellësisë së ndërgjegjes së tij – ia lartëson gradën njeriut aq sa s’mund ta imagjinojë. Po, namazi nuk duhet shpërfillur; kam frikë se ai që shpërfill namazin do të shpërfillë edhe fenë një ditë. E vërteta e miraxhit është e pranishme në kuptimin e namazit, por gjithsecili e ndien atë sipas vetes së tij. Ndjesia e ngjitjes për në atë miraxh është në varësi të aftësive të çdonjërit nga ne. Miraxhi më i përkryer është ai i Pejgamberit tonë (s.a.s.).

Sapo të hedhë hapin e parë në botën tjetër, robi do të përballet së pari me llogaridhënien për namazin. I Dërguari i Allahut (s.a.s.) e ka shprehur këtë të vërtetë duke thënë kështu: *“Vepra e parë për të cilën do të japë llogari njeriu në ditën e Kiametit është namazi. Nëse llogaridhënia e kësaj vepre kalon mirë, do të thotë se ka shpëtuar. Nëse kjo llogaridhënie del keq, do të thotë se ka rënë në humbje.”*⁴⁹ Prandaj, rëndësia që do t’i japë robi namazit në këtë botë do të jetë ajo që do të përcaktojë se për ku do të dërgohet ai brenda një çasti të vetëm, në një nga gropat e Xhehenemit apo në një nga vilat e Xhenetit.

Kështu që, besimtari duhet t’i falë pesë namazet ditore pa i lënë mangët ato dhe, në çdo rast, duhet të kërkojë mënyrat dhe rrugët për përforcimin e lidhjes së tij me Zotin. Sepse çdo namaz që kryen këtu, në botën e përtejme, në atë ditë kur mund të turpërohet e të bëhet rezil, do t’i dalë para e do t’i vijë në ndihmë. Profeti ynë (s.a.s.), kur shpjegon

⁴⁹ Ebú Dáúd, salát 144-145; Tirmidhí, meuákít 193; Nesái, salát 9; Ibn Máxhe, ikáme 202.

në lidhje me tmerrin e asaj dite, thotë kështu: “Nëse dikujt do t’i bëhet imtësisht llogaridhënia në botën tjetër, do të thotë se ai do t’i nënshtrohet ndëshkimit!” Kur Aishja (r.a.) pyet me fjalët “Si është e mundur? A nuk ka thënë Allahu i Madhëruar ‘Ai, të cilin do t’i jepet libri i tij në dorën e djathtë, do ta ketë të lehtë llogarinë dhe do të kthehet i gëzuar te të afërmit e tij.’⁵⁰”, i Dërguari i Allahut (s.a.s.) përgjigjet në këtë mënyrë: “Jo! Kjo është llogaridhënie. Në ditën e Kiametit, të gjithë ata që do të merren në llogari imtësisht janë, pa dyshim, të shkatërruar!”⁵¹ Zoti i Madhëruar na ndihmoftë me mirësinë dhe bujarinë e Tij në atë ditë kur do të kemi nevojë për ndihmesën e Tij; punët tona të mira, por të vogla, na i bëftë të mëdha dhe mos na mbajttë përgjegjës për të metat tona!

Kështu e përshkruan Kurani turmën që, me braktisjen e namazit, përfundojnë të zhgënjyer:

“Çdo njeri është peng i veprave të veta, përveç njerëzve të krahut të djathtë; të cilët në kopshtet e Xhenetit pyesin njëri-tjetrin për keqbërësit: ‘Çfarë ju ka sjellë në Sekar?’ Ata do të përgjigjen: ‘Nuk ishim nga ata që falnin namaz dhe as prej atyre që i ushqenin të varfërit. Ne lëshoheshim në biseda të kota me llafazanët dhe mohonim Ditën e Llogarisë, derisa na erdhi vdekja.’”⁵²

Një çështje që na tërheq vëmendjen këtu është përmendja së bashku e braktisjes së namazit dhe asaj të bamirësisë. E kundërta e kësaj është falja e namazit dhe bamirësia ndaj të varfërve dhe nevojtarëve. Në shumë ajete të Kuranit Famëlartë, këto dy çështje përmenden së bashku. Njëra rregullon jetën personale të individit dhe mundëson miraxhin personal, ndërsa tjetra, brenda një integriteti dhe uniteti shpirtëror, bën të mundur ndërtimin e një shoqërie të fortë e të shëndetshme dhe, si përfundim, mundëson një zhvillim dhe përparim të përbashkët. Për rrjedhojë, këto janë dy adhurime të rëndësishme e të pandashme nga njëri-tjetri.

⁵⁰ Surja Inshikak, ajetet 7-9.

⁵¹ Buhárí, ilm 35; Muslim, xhennet 79.

⁵² Surja Muddeththir, ajetet 38-47.

Adhurimi i parë, që u është bërë obligim (farz) besimtarëve, është namazi. Rrjedhimisht, ai do të jetë gjëja e fundit që do të braktiset në mesin e umetit të Muhamedit (s.a.s.). Shumë urdhëresa të fesë Islame ndoshta do të braktisen me kalimin e kohës; për shembull, në çarshi e pazar nuk do të mbesin më sjellje në përputhje me urdhrin e Allahut, zjarri i fitnes (përçarje) do të mbulojë çdo anë dhe numri i atyre që do të hidhen brenda tij do të jetë i pallogaritshëm. Megjithatë, namazi do të jetë e vetmja gjë që, në emër të adhurimeve dhe robërisë ndaj Allahut, do të vazhdojë pavarësisht një mjedisi dhe atmosfere të këtillë. Zoti i Madhëruar mos na e tregoftë atë periudhë kur namazi do të braktiset krejtësisht! Ne shpresojmë dhe besojmë se ndodhemi në prag të një pranvere dhe të një ringjalljeje të re. Kemi shpresë tek mëshira e Zotit, i Cili na e bën të njohur veten me fjalët “Unë jam ashtu siç më mendon robi im”⁵³, që këto pranvera e ringjallje t’i shtojë, t’i bëjë të gjithë njerëzit të vrapojnë drejt Tij dhe t’u mundësojë atyre, sikur edhe vetëm në çastet e fundit të jetës, nderin e kryerjes së miraxhit përmes namazit. Allahu i Madhëruar na mundësoftë të gjithëve që, në botën tjetër, të kundrojmë bukurinë e Tij të përkryer.

b. Vëllai binjak i imanit

Imani dhe namazi kanë lindur nga i njëjti bark; namazi është vëllai binjak i imanit. Imani përbën aspektin teorik të fesë. Përforcimi i kësaj ane teorike dhe shndërrimi i saj në një thellësi të natyrës së njeriut janë të mundur vetëm nëpërmjet adhurimeve, me në krye namazin. Në këtë këndvështrim, mund të thuhet se namazi është imani praktik, kurse imani është një namaz teorik. Ata që e shohin fenë thjesht si një pranim me vetëdije dhe që nuk e përfshijnë në jetën e tyre adhurimin, pa e kuptuar aspak këtë, nuk kanë mundur të shpëtojnë nga rënia në kontradiktë me veten. Po, direku i fesë është namazi. Namazi është një hauz pastrimi, një lumë pendimi që rrjedh e shkon drejt pafundësisë, brenda të cilit besimtari futet e pastrohet të paktën pesë herë në ditë.

⁵³ Buhárí, teuhíd 15, 35; Muslim, dhikr 2, 19, teube 1.

Ai është një obligim shumë i rëndësishëm, i cili duhet kryer ashtu siç duhet edhe në çastet më të rrezikshme, më të nxehta të shesheve të betejave e të luftrave. Namazi është një vendstrehim i sigurt, një shtysë e rëndësishme në arritjen e afrimitetit me Zotin dhe rruga më e shkurtër e ribashkimit me Të. Për shkak të këtyre veçorive, që nga Shekulli i Lumturisë e gjer më sot, miqtë e Allahut e kanë vënë atë në qendër të jetës së tyre dhe, duke mos u mjaftuar vetëm me kryerjen e namazeve farz, e kanë bërë zakon faljen e qindra rekateve namaz nafile në ditë.

c. Indeksi i të gjithë adhurimeve

Namazi, duke qenë se bart në shpirtin e tij kuptimin e të gjithë adhurimeve të tjera dhe përmban gjurmë të secilit adhurim, është si një indeks i tyre. Në lidhje me adhurimet e tjera, njeriu e përmbush detyrën e tij të të qenit rob i Allahut duke i kryer ato në periudha të caktuara kohore. Por nuk është kështu për namazin. Ai, në një mënyrë të vazhdueshme, siguron lidhjen e njeriut me Allahun, bën të mundur vazhdimin e lidhjes me mëshirën e Tij. Parë nga ky aspekt, nuk është e mundur të imagjinohet një adhurim i dytë, që të jetë në gjendje të matet me të. Namazi, për sa kohë kryhet me një zemër të mbushur me frikë dhe respekt ndaj Zotit të Mëshirshëm dhe Bujar, bëhet shkak i një lumturie si në këtë botë, ashtu edhe në botën tjetër. Për këtë arsye, ai që i ka dhënë rëndësinë më të madhe namazit është Muhamedi (s.a.s.), më i përgjegjshmi i njerëzve, që erdhi duke marrë mbi supë peshën e një kauze të madhe. Ai nuk mjaftohej vetëm me pesë namaze në ditë; kuptimin që shpreh namazi, “Të takohesh me Zotin e Madhëruar dhe t’i lutesh e përgjërohesh Atij”, e përjetonte edhe gjatë netëve. Madje – ashtu siç është shprehur Aishja (r.a.) – Ai (s.a.s.) nuk e braktisi kurrë namazin e natës, atë namaz që e konsideronte si një përgjegjësi të tijën; edhe në ato raste kur nuk ndihej mirë, përpiquej ta kryente atë qoftë edhe duke qëndruar i ulur.⁵⁴ Kështu, Ai (s.a.s.) nuk lejoi që në jetën

⁵⁴ Muslim, salátul musáfirín 141; Tirmidhí, salát 348; Ebú Dáúd, tatavvu 26; Nesáí, kible 13, kijámul lejl 2, 64.

që e kishte ndarë për të adhurar Zotin të ekzistonte qoftë edhe një grimë errësirë. Asnjë çast të jetës së tij nuk e kaloi në shkujdesje, pa përmendur emrin e Allahut.

Namazi përfshin edhe disa veçori, të cilat nuk gjenden tek adhurimet e tjera. Ai është një përgjigje ndaj ftesës së Zotit, një pranim i saj, dhe forma e këtij pranimi, formuluar në një mënyrë unike. Në këtë aspekt, namazi është një adhurim i veçantë dhe me veçori specifike të tijat. Të gjitha adhurimet janë të lidhura me kohë të caktuara; rrjedhimisht, kryhen dhe mbarojnë në periudha kohore të paracaktuara; kurse namazi vazhdon pa ndërprerje. Për shembull, bashkë me fillimin e agjërimit të Ramazanit, ne jemi të vetëdijshëm se ardhja e fundit të atij muaji të bekuar nuk është larg. Çështë e vërteta, agjërimi në vetvete është një adhurim i nderuar dhe që bëhet në fshehtësi të plotë. Sepse sekretin e atij që qëndron pa pirë e pa ngrënë për hir të Zotit, vetëm Allahu i Madhëruar (*xhel'le xheláluhu*) e di. Dhe vetëm Ai mund ta shpërblejë dhe ta vlerësojë këtë veprim të robit të Tij. Megjithatë, duhet pritur një vit i tërë për t'u ribashkuar me adhurimin e agjërimit të muajit të Ramazanit.

Edhe zekati, i cili jepet një herë në vit, duke qenë se kërkon plotësimin e disa kushteve, është nga ato adhurime që jo gjithkush mund t'i bëjë. Në çastin kur vjen koha e kryerjes së këtij adhurimi, ju dorëzoni në vendin ku duhet dorëzuar atë çfarë keni lënë mënjanë nga pasuria tuaj për zekatin dhe, në këtë mënyrë, bëni të mundur shlyerjen e borxhit tuaj. Nga ky këndvështrim, ai mund të shihet edhe si një adhurim momental, i çastit. Në fakt, zekati, përgjatë vitit, i jep bollëk dhe bereqet pasurisë nga ku ka dalë si i tillë. Mbase mund t'ju vijë sikur një pjesë e shpirtit tuaj po ikën kur shkulni një copë nga pasuria tuaj, por, ngaqë jeni duke vepruar në përputhje me urdhrin e Zotit tuaj, zemra tuaj gjen paqe. Dhe, kështu, ju do të ndiheni të gëzuar dhe brenda një qetësie shpirtërore tek po e jepni atë.

Kështu është edhe haxhi; besimtari, duke veshur rrobën e ihramit në atë vend që po shkon me rastin e haxhit, ia jep zemrën Zotit dhe, me dashuri e gjithë entuziazëm, thotë: "*Urdhëro, Zoti im! Nuk ka zot*

tjetër veç Teje, Ti je Një, je i Pashoq, të gjitha falënderimet Ty të takojnë, të mirat prej Teje na vijnë, pasuria është e Jotja, Ti nuk ke ortak.” Dhe, në këtë mënyrë, ai shpreh gatishmërinë e tij ndaj urdhrave të Allahut. Të gjitha këto janë pjesë të daljes para Allahut, të të folurit me Të dhe të mbushjes së brendësisë sonë me përfitime që vijnë nga ajo botë. Secili nga këto adhurime ka karakteristikat e veta të veçanta, por janë të përkohshme që të gjitha; vjen dita dhe besimtarit, edhe sikur të mos dojë të dalë nga ato vende të shenjta, i thuhet: “Tashmë duhet të largohesh.” Kështu, do të detyrohet të kthehet andej nga ka ardhur, i trishtuar dhe zemërthyer.

Në agjërim, njeriu i drejtohet Zotit të Madhëruar duke ia ndaluar vetes ngrënien dhe pirjen. Edhe gjatë faljes së namazit – edhe pse përkohësisht – në njëfarë kuptimi, kemi ndalim të vetes ndaj gjërave të kota të kësaj dynjaje dhe kthim të mirëfilltë për nga Allahu.

Qetësinë, që vështirë se mund të arrihet edhe në Arafat, falja e namazit pesë herë në ditë e sjell me fundin e rrobës së mbushur me xhevahire dhe e derdh para besimtarit. Ai (*xhel’le xheláluhu*) vjen me këtë ftesë pesë herë në ditë, duke bërë të mundur që besimtari ta ndiejë para syve të vet praninë e Tij. Nga ana tjetër, edhe besimtari vendos kokën në sexhde pesë herë në ditë dhe, ashtu siç shprehet edhe poeti ynë i njohur, thotë: “Më uth në ballë, më uth ti, sexhadja ime!”

I Dërguari i Allahut (s.a.s.) urdhëron kështu: “*Robi është më afër Zotit të tij kur ndodhet në sexhde. Kështu që, lutuni sa më shumë (kur jeni në sexhde)!⁵⁵* Ne, duke vënë kokën në sexhde, arrijmë kulmin e kësaj afërsie. Mandej, të përfshirë në mendime e përfytyrime të këtilla, themi: “*I përsosur është Zoti im i Lartësuar.*”

Namazi bart gjithashtu në shpirtin e tij edhe kuptimin e përsëritjes në çdo moment. Në këtë aspekt, ai sikur shkon krah për krah me “*Lá iláhe il’lalláh Muhammedun Rasúlulláh*”. Ashtu si disa prej nesh që, duke iu bindur fermanit të Lajmdhënësit Fjalëdrejtë (*Muhbiri Sádik*), themi nga njëqind herë “*Lá iláhe il’lalláh Muhammedun Rasúlulláh*”

⁵⁵ Muslim, salát 215; Ebú Dáúd, salát 148; Nesái, meuákít 35; tatbík 78.

në mëngjes e në mbrëmje ose nga tridhjetë e tri herë në çdo tesbihat të namazit dhe, në këtë mënyrë, përpiqemi ta sjellim në mendje shprehjen e njësisë së Allahut sa më shumë të jetë e mundur, po ashtu edhe namazi bëhet pjesë e pandashme e jona, madje, duke dalë para nesh me ftesën **“Ata ngrihen nga shtrati, i luten Zotit të tyre me frikë e shpresë dhe japin nga ajo që iu kemi dhënë Ne.”**⁵⁶, futet edhe brenda gjumit tonë të ëmbël të natës. Në një hadith tjetër, i Dërguarit të Allahut (s.a.s.) thotë kështu: *“Kur i vdekuri vendoset brenda varrit, akoma pa u larguar zhurma e hapave të atyre që po e përcjellin, vijnë engjëjt dhe i bëjnë pyetje. Pikërisht në këtë moment, shfaqet diçka e shndritshme, që vjen dhe i ulet të vdekurit te koka. Kjo gjë është namazi i tij. Një gjë tjetër e shndritshme shkon e ulet te këmbët e tij. Kjo është tërësia e punëve të tjera të mira të tij. Një gjë tjetër e shndritshme ulet në anën e tij të djathtë. Ky është agjërimi i tij. Edhe në të majtën e tij vete e ulet diçka e shndritshme. Kjo gjë është zekati i tij. Këto e mbrojnë të vdekurin nga shtrëngimi i varrit.”*⁵⁷ Duke u bazuar në këto fjalë të Pejgamberit tonë (s.a.s.), kuptojmë se as namazi nuk do t’i braktisë ata që nuk e braktisën atë gjatë jetës së kësaj bote dhe se do t’u gjendet pranë atyre edhe në varr, atëherë kur të gjithë miqtë e të afërmit do të ngulin aty dy gurë dhe, pastaj, do t’u kthejnë shpinën. Sepse namazi, me çdo aspekt të tijin, është bërë pjesë e brendësisë së besimtarit.

Adhurimet ndahen në dy kategori, adhurimet që kanë të bëjnë me trupin dhe ato që kanë të bëjnë me pasurinë. Ndonëse namazi vlerësohet si një adhurim i kategorisë së parë – ashtu siç pohojnë disa juristë të jurisprudencës islame – nuk mund të themi se ai nuk bart asnjë nga aspektet që e bëjnë të përfshihet edhe në adhurimet e kategorisë së dytë. Sepse në kohët e vjetra, njerëzit nuk ishin në dijeni të çështjes së quajtur “vlera e kohës”. Me shfaqjen e kapitalizmit dhe komunizmit, njerëzit filluan të kuptonin vlerën e kohës. Në Islam ama, koha e kishte një vlerë dhe vlera e saj dihej. Njeriu ndan një pjesë të kohës së vet si për namazin, po ashtu edhe për abdesin. Në një këndvështrim tjetër,

⁵⁶ Surja Sexhde, ajeti 16.

⁵⁷ Ahmed Ibn Hanbel, el Musned 6/352, 4/287, 295; Aburrezzak, el Musannef 3/582, 583.

mund të themi edhe se, gjatë faljes së namazit, personit i vjetërsohen rrobat që ka mbi trup. Pastaj, është i detyruar që, për të falur namazin, të mbyllë dyqanin e tij. Dhe, kur të gjitha këto bëhen bashkë, e kemi të lehtë të shohim se edhe namazi e ka një aspekt që mund ta kategorizojë atë edhe në mesin e adhurimeve që kanë të bëjnë me pasurinë apo anën financiare të personit.

Namazi ka gjithashtu edhe aspektin e ‘pastrimit të zemrës’ dhe atë të ‘edukimit të nefsit’, mbi të cilat më së shumti qëndrojnë sufitetë. Në namaz, njeriu i drejtohet Allahut me zemrën e tij dhe e thyen më dysh nefsën. Krenarinë e nefsit e përdredh nëpërmjet çengelit të sexhdes. Rrjedhimisht, arrijmë në përfundimin se namazi, mes të tjerave, përfshin edhe kuptimin e përparimit të shpirtit.

Një tjetër veçori e namazit është qëndrimi i njeriut krah për krah me engjëjt, në të njëjtin saf. Lidhur me këtë çështje, të cilën e pranojnë edhe fakihët, këshillohet që në fund të namazit, kur jepet selam djathtas dhe majtas, të bëhet nijet dhënia e selamit jo vetëm pjesëtarëve të tjerë të xhematit, por edhe shpirtave dhe engjëjve. Nga kjo kuptojmë se edhe ata i bashkohen namazit të njeriut. Dhe Allahu mundëson zbritjen e sekines (qetësi shpirtërore) në ato vende ku ata janë të pranishëm. Kështu, namazi përmban edhe një shije të adhurimit të engjëjve. Disa nga engjëjt qëndrojnë vazhdimisht në ruku, kurse disa të tjerë në sexhde dhe, në këtë mënyrë, shprehin respektin e nderimet e tyre ndaj Zotit të Madhëruar. Edhe njeriu, në njëfarë mënyre, përfaqëson këto adhurime të engjëjve. Ndërkohë që çdo kategori engjëjsh përfaqëson dhe kryen vetëm një nga këto lloje të adhurimeve, njeriu i kryen të gjitha së bashku në namaz.

Nga ana tjetër, kur shohim krijesat e tjera kudo nëpër rruzullin tokësor, vërejmë se disa prej tyre qëndrojnë mbi dy këmbë, disa mbi katër e disa të tjera mbi bark dhe se në këtë formë, me gjuhën e tyre të gjendjes, shprehin adhurimet ndaj Allahut. Namazi i njeriut është i një cilësie të atillë, saqë mund ta shprehë fare mirë edhe adhurimin e gjithë qenieve të tjera. Për më tepër, namazi e udhëzon njeriun në kuptimin e atyre veçorive që Zoti ia ka mundësuar atij dhe jo krijesave

të tjera. Në kijam, njeriu thotë “Zoti im, falënderimet të takojnë Ty, që nuk më krijove të palëvizshëm si pemët. Falë nyjave që më ke dhënë, mund të ulem e të ngrihem, mund t’i bëj të gjitha llojet e lëvizjeve pa më të voglin mundim.”; në ruku, thotë “Falënderimet të takojnë Ty, që nuk më ke krijuar të përkulur e të palosur më dysh, si ca krijesa të tjera.”; në sexhde, thotë “Falënderimet të takojnë Ty, Zoti im, që nuk më ke krijuar si një krijesë që tërhiqet zvarrë e fërkon fytyrën nëpër tokë.” Dhe, duke thënë kështu, njeriu arrin të kuptojë edhe këto gjendje të qenieve të tjera. Në Kuranin Famëlartë, në lidhje me këtë situatë, Allahu i Madhëruar thotë kështu: ***“Allahu ka krijuar çdo lloj kafshe prej ujit; disa nga ato zvarriten barkas, një pjesë ecin me dy këmbë e disa prej tyre me katër këmbë. Allahu krijon çfarë të dojë. Me të vërtetë, Allahu është i Fuqishëm për çdo gjë.”***⁵⁸

Për sa i përket aspekteve që numëruam më sipër, namazi është për njeriun thuasjse një indeks, një indeks që i kujton atij të gjitha adhurimet.

d. Përgatitja për namaz

Për shkak të shenjtërisë dhe natyrës së jashtëzakonshme të namazit, edhe veprat dhe punët që bëhen në rrugën drejt namazit, tek Zoti i Lartë vlerësohen po aq sa namazi. Sepse të vrapuarit pas një pune që shpreh seriozitet dhe ndjeshmëri, siç thuhet edhe në hadithin *“Nijeti i besimtarit është më i mirë se vepra e tij”*⁵⁹, kërkon të veprosh sikur të ishe duke e bërë atë punë. Në lidhje me këtë çështje, ne, me një besim të pafund, mbështetemi në mëshirën e pafund të Zotit të Plotfuqishëm dhe themi: Nga istibraja e gjer te hapat që hedhim rrugës për në xhami, të gjitha punët që bëjmë si parapërgatitje të namazit do të vlerësohen si vetë namazi dhe do të na mundësojnë të fitojmë sevape si ato të namazit. I Dërguari i Allahut (s.a.s.) thotë: ***“Për sa kohë jeni duke pritur namazin, konsideroheni në namaz.”***⁶⁰

⁵⁸ Surja Núr, ajeti 45.

⁵⁹ Taberání, el Mu’xhemul kebír 6/185-186; Bejhákí, es Sunenus’sugrá, fq. 20.

⁶⁰ Buhári, edhán 30. Për hadithe me kuptim të ngjashëm me këtë: Buhári, mesáxhid 36, bujú 49; bed’ul halk 7; Muslim, mesáxhid 275.

Një transmetim tjetër është si vijon: “Selmani, një nga sahabët e Profetit, ishte ulur poshtë një peme bashkë me shokët e tij. Pastaj merr në dorë një degë dhe, duke e shkundur atë, bën që gjethet e saj të bien përtokë. ‘A nuk do t’më pyesni se pse e bëra këtë?’ u thotë atyre që kishte pranë. Kur shokët e tij e pyesin, ai u përgjigjet kështu: ‘Kështu pati vepruar një herë edhe i Dërguari i Allahut dhe na pati pyetur ashtu siç ju pyeta unë tani. ‘Përse, o i Dërguari i Allahut?’ e pyetëm ne. Ai na u përgjigj në këtë mënyrë: *‘Nëse një mysliman merr abdes ashtu siç duhet dhe pastaj ngrihet për të shkuar në namaz, gjynahet e tij bien siç po bien këto gjethe.’*”⁶¹

Po, besimtari, që nga çasti kur niset për të shkuar në mesxhid – edhe pse nuk është futur akoma në namaz në kuptimin e tij të mirëfilltë – konsiderohet se ka hyrë shpirtërisht në namaz. Në një hadith tjetër, Profeti ynë (s.a.s.) e shpreh këtë situatë në një mënyrë më të qartë: “*Këtë natë, Zoti im m’u shfaq në trajtën më të bukur dhe më tha: ‘O Muhamed!’ ‘Urdhëro, Zoti im, nën urdhrat e Tua jam!’ thashë unë. ‘A e di se me çfarë garojnë Engjëjt më të Lartë (Melei A’lá)?’ më tha. ‘Jo!’ i thashë. Pas kësaj, vuri dorën midis shpatullave të mia. (Freskinë e saj e ndjeva edhe në gjoks.) Kur po ndodhte kjo, mësova se ç’po ndodhte në qiej e në tokë. Pastaj më pyeti sërish: ‘O Muhamed! A e di se në çfarë garojnë Engjëjt më të Lartë?’ ‘Po! Në kryerjen e veprave që të lartësojnë e që bëhen kefaret (shlyerje) për gjynahet. Ndërsa kefaretet janë: të shkosh për në namaz më këmbë, të marrësh abdes ashtu siç duhet në të ftohtin e acartë dhe, pasi ke falur një namaz, të presësh namazin tjetër. Kushdo që i vazhdon këto, jeton një jetë të hairit, i mundësohet një vdekje e hairit dhe, në aspektin e gjynaheve, do të jetë ashtu siç ka qenë në ditën që e ka lindur nëna,’ thashë unë.*”⁶²

Do të thotë se pritja e namazit të radhës pas faljes së një namazi përbën një çështje të rëndësishme për Engjëjt më të Lartë. Për shembull, keni falur namazin e drekës dhe nuk keni ndonjë namaz tjetër farz për të falur në ato çaste. Pritja për namazin farz të radhës, duke thënë “Ah,

⁶¹ Ahmed ibn Hanbel, el Musned 5/437; Dárimí, taháret 45.

⁶² Bezzár, el Musned 11/42.

sikur të vijë koha e ikindisë, të kem mundësinë të qëndroj para Zotit tim e të kryej edhe farzin e asaj kohe!”, bëhet shkak për shtyrjet mes engjëjve. Po, do të thotë se robi hyn në adhurim që në çastin kur i vë qëllim vetes për ta kryer atë.

Hedhja e hapave në rrugën drejt mesxhidit ka një rëndësi të veçantë. Sepse mesxhidet janë vende të shenjta, ku përgjërimit dhe nijetet ngrihen për tek Allahu. Disa njerëz, duke i falur namazet në shtëpitë e tyre dhe jo në mesxhide, mbeten të privuar edhe nga namazi i përkryer, edhe nga një sevap njëzet e shtatë herë më i madh.

Fisi Beni Selime, në kohën e të Dërguarit të Allahut (s.a.s.), jetonte në një nga mëhallat jashtë Medines. Ashtu siç e kishin të vështirë të vinin në Xhaminë e Profetit në kohën e faljes së namazeve, po aq të vështirë e kishin edhe pjesëmarrjen në të gjitha ligjëratat e Pejgamberit tonë (s.a.s.). Për këtë arsye, morën vendimin për t’u zhvendosur diku në afërsi të Mesxhidit. I Dërguari i Allahut (s.a.s.), i cili ishte vënë në dijeni të kësaj meseleje, u drejtohet atyre me këto fjalë: *“Beni Selime, qëndroni në mëhallën tuaj! A nuk e merrni në konsideratë sevapin e hapave (që hidhni kur jeni duke ardhur për në mesxhid)?”* Pas këtyre fjalëve të Profetit, ata hoqën dorë nga vendimi i tyre për t’u zhvendosur afër xhamisë.⁶³

Po, do të shkojmë në mesxhid e do ta kryejmë më së miri namazin tonë. Sepse mesxhidet janë shenja treguese të drejtuara për nga Qabeja, mesxhidi i Allahut në sipërfaqen e tokës, dhe që u tregojnë njerëzve rrugën drejt Allahut. Andaj, namazet e falura me xhemat vlerësohen mes namazeve të falura në Qabe. Sepse, nëse Qabeja është një mesxhid i caktuar nga Allahu, të tjerat janë xhami të lidhura me të dhe të ndërtuara nga njerëzit që e rrethojnë atë nga të gjitha anët. Minberët dhe mihrabët e këtyre mesxhideve janë të drejtuar për nga mihrabi dhe minberi i mesxhidit të Allahut. Meqenëse asnjëri nga ne nuk është në gjendje t’i falë të gjitha namazet në Qabe, që të mund të fitojmë sevape sikur jemi falur atje, duhet të mos heqim dorë nga frekuentimi i këtyre mesxhideve, që mund të konsiderohen si projeksione të Qabesë.

⁶³ Buhári, edhán 33; fedáílul Medine 11; Muslim, mesáxhid 280-281.

e. Shpërblimi i namazit

Namaz do të thotë që njeriu të piqet pesë herë në ditë e të marrë ngjyrën e pritur prej tij. Me fjalë të tjera, njeriu, duke u bërë transparent nëpërmjet namazit, duhet të jetë në gjendje të pasqyrojë emrat dhe atributet e Allahut si dhe ngjyrën e gjendjes së përftuar tek ai nën ndikimin e urdhrave të Zotit të Madhëruar. Për shembull; çfarë kërkon Zoti im nga unë, të qëndroj me përlujë para Tij, i bindur dhe i nënshtruar? E bëj këtë nëpërmjet kijamit tim. Të thyej egon dhe krenarinë time? Këtë e bëj nëpërmjet rukusë sime. Të tregoj respekt ndaj Tij dhe ta lartësoj Atë? Këtë e shpreh dhe e realizoj nëpërmjet sexhdes sime. Duke menduar në këtë mënyrë, njeriu tregon se është gjithmonë i gatshëm për të çuar në vend urdhrat e Zotit dhe, nëse lejohet të bëhet një krahasim i tillë, merr edhe ai ngjyrë nga ngjyra e Zotit. Pra, kjo bart kuptimin e arritjes së qetësisë së zemrës në botën e brendshme përmes besimit në Zot, daljes faqebardhë e me ballin lart, manifestimin e së vërtetës ***“Në fytyrat e tyre shihen shenjat e sexhdes”***⁶⁴ nëpër fytyra dhe, duke marrë formën që Profeti ynë (s.a.s.) përshkruan me fjalët ***“Për shkak të abdesit, gjymtyrët dhe balli i besimtarit (në botën tjetër) do të shkëlqejnë si shenjat e bardha në ballin dhe këmbët e kuajve”***⁶⁵, pasqyrimin e të gjitha ngjyrave të botës hyjnore. E ku mund të gjendet një ngjyrim më i bukur se ky!

Për ata që kanë arritur ta ndiejnë kënaqësinë e tij, namazi është një vepër shumë e këndshme, ndërsa për ata që nuk kanë mundur t’ia kuptojnë vlerën, është thjesht një peshë, një barrë e rëndë mbi supe. Disa njerëz i kërkojnë llogari vetes sikur kanë kryer një mëkat të pafalshëm me mosfaljen e namazit për këtë apo atë arsye; ndërsa ca të tjerë e konsiderojnë namazin si një barrë, të cilën Allahu ua ka ngarkuar njerëzve e që vështirë të mbahet mbi supe, dhe si një detyrë që duhet kryer duke e menduar si një bela për t’u hequr qafe. E në fakt, kjo e dyta është një shembull i mungesës së kërkimit të llogarisë ndaj vetes. Në njeri me mend në kokë, duke menduar se nuk do të jetojë

⁶⁴ Surja Fet’h, ajeti 29.

⁶⁵ Muslim, tahâret 39; Nesâî, tahâret 110; Ibn Máxhe, zuhd 36.

përjetësisht në këtë botë, se vdekja do t'i vijë patjetër një ditë dhe se shenjat e pleqërisë janë në të vërtetë dëshmi në lidhje me afrimin e vdekjes, përpiqet t'i vlerësojë si duhet mirësitë dhe bekimet që Zoti i Madhëruar i ka mundësuar dhe, kështu, një pjesë të madhe të njëzet e katër orëve që i jepen çdo ditë e përdor për t'u përgatitur për botën e përtejme. Ai nuk e shikon të mjaftueshme ndarjen e vetëm një ore në ditë për namazin, i cili i mundëson atij frymëmarrjen e shpirtit, kalimin në një gjendje të denjë për botën e përtejme, duke u pastruar fizikisht dhe shpirtërisht në praninë e Allahut, dhe soditjen e bukurisë së Zotit; thënë ndryshe, një njeri i arsyeshëm nuk mund ta kufizojë me kaq kohën që do t'ia kushtojë namazit, këtij adhurimi që do t'i mundësojë kundrimin dhe dëgjimin e gjërave të papara e të padëgjua ndonjëherë. Ai përpiqet të rrisë frytshmërinë e namazeve të tij duke ndërthurur me pesë kohët e namazeve farz edhe disa namaze nafile (vullnetare).

I Dërguari i Allahut (s.a.s.), në një hadith të transmetuar nga Ebu Hurajra (r.a.), thotë kështu: *“Namazet më të vështira për hipokritin (munafikun) janë namazi i jacisë dhe ai i sabahut. Po ta dinin hairin e këtyre dy namazeve, do të vinin në faljet e tyre edhe sikur të duhej të vinin duke u zvarritur.”*⁶⁶ Hipokrizia konsiston në mashtrimin e palës përballë dhe përfaqëson kryerjen e punëve pa dëshirë e pa i ndier nga brenda. Munafiku e ka të pamundur të tregohet i sinqertë dhe të përballojë zahmetin namazeve të sabahut dhe jacisë. Sepse këto dy kohë janë kohë përgjumjeje dhe rehatie. Ndërsa besimtari, duke u bazuar në thënien “Ka rahmet (mëshirë) aty ku ka zahmet”, merr pjesë në namazet e sabahut dhe jacisë – mes fakihëve diskutohet nëse falja e tyre me xhemat është farz apo vaxhip – edhe sikur të jetë i detyruar të shkojë duke u zvarritur, qëndron i përlur pas imamit dhe, në këtë mënyrë, i paraqet Allahut robërinë dhe adhurimin e vet.

Po, namazi është më i vlefshmi mes gjërave që njeriu do të çmojë. Por disa njerëz, të cilët punojnë deri në vdekje për jetën fare të shkurtër të kësaj bote e që ndonjëherë as që e marrin shpërblimin e atij mundi të

⁶⁶ Buhári, edhán 34; meuákít 20; Muslim, mesáxhid 252.

harxhuar, nuk ndajnë as vetëm një orë të ditës për namazin, adhurimin që do të japë si fryt Xhenetin dhe të parit e Bukurisë së Allahut (Xhemalullah). Në ditët e sotme, ngaqë nuk po marrin hakun e djersës së derdhur në punët përkatëse, të gjithë po ankohen për mungesën e parave, për gjendjen e tyre ekonomike të dobët, nga punëtorët tek nëpunësit civilë, nga këta të fundit deri tek pensionistët. Në fakt, këto burojnë nga pandjeshmëria e punëdhënësve në çështjet e mbajtjes së fjalës dhe të vepruarit në përputhje me dhënien e hakut. Premtojnë, por nuk i mbajnë premtimet; japin fjalën për diçka, por nuk e çojnë atë në vend. Pretendojnë se do të sjellin paqe e lumturi dhe jo vetëm që nuk ia dalin një gjëje të tillë, po edhe i kërcënojnë njerëzit.

Por, nëse individualiteti që premtonte diçka është Allahu (*xhel'le xheláluhu*), Ai e përmbush patjetër premtimin e dhënë. Për shembull, nëse Ai (*xhel'le xheláluhu*) u ka thënë robërve të Tij “Në qoftë se e falni namazin, do t’ju kaloj mbi urën e Siratit vetëtimthi, do t’ju nderoj me soditjen e Bukurisë Sime, lotët që derdhni çdo ditë në sexhaden tuaj do t’i vendos në njërën anë të peshores e do t’u vë atyre një çmim të pashoq!”, e mban fjalën dhe i bën të gjitha këto. Allahu, i Cili na bën të themi “Ai është i Fuqishëm të bëjë çdo gjë” disa herë në ditë, është i Plotfuqishëm për gjithçka. Të njëjtën gjë mund ta mendojmë edhe për çështjet në lidhje me të cilat kërcënon; Atij i mjafton forca dhe fuqia për t’i zbatuar dënimet që ka paracaktuar për gjërat që na e ka ndaluar t’i bëjmë, por derën e faljes e lë gjithmonë të hapur.

Po, Allahu (*xhel'le xheláluhu*), i Cili nuk e thyen kurrë premtimin e Tij, u premtonte robërve të Tij Xhenetin në këmbim të faljes së namazit. Besimtari, nëpërmjet shkallëve të namazit, lartësohet dhe ngjitet në botën ku do të kundrojë Zotin. Është sikur i shton çdo ditë jetës së vet nga një palë shkallë me pesë shkallare. Një besimtar i tillë, i cili i vazhdon namazet e tij me përpikmëri, kur të vdesë e të dalë ballë për ballë me mëshirën e Zotit, nuk do dijë çfarë të bëjë nga gëzimi. Pamja me të cilën do të përballet do ta mahnisë. Kështu na e shpjegon Kurani i Mrekullueshëm gjendjen e besimtarit në mahsher (vendi i tubimit të njerëzve pas ringjalljes): **“Ai, të cilit do t’i jepet libri i veprave të**

tij nga ana e djathtë, do t'u thotë (njerëzve të tij): 'Ja, lexojeni librin tim! Vërtet, unë kam qenë i bindur se do të jepja llogari.'"⁶⁷ Allahu i Madhëruar na bëftë edhe ne pjesë të këtij grupi njerëzish të virtytshëm!

Ne, të stërvitur e të edukuar sikur të ishim tamam ushtarë, gjendemi të dërguar në këtë botë me detyrën për të fituar meritën për pozitat e larta të botës së përtejme. Gjithçka këtu konsiston në një trajnim dhe edukim, në plotësimin e mangësive, eliminimin e gjërave defekteze dhe të pasheshuara, përparimin dhe ngritjen e njeriut në pikën e përsosmërisë dhe, në këtë mënyrë, në arritjen e një gjendjeje të denjë për të fituar Xhenetin dhe kundruar Zotin. Adhurimi që do të mundësojë realizimin e këtyre qëllimeve në mënyrën më të përkryer është namazi. Sepse namazi është aq i madh, saqë nuk mund të krahasohet me adhurimet e tjera. Ai është direku i fesë, ai e bën të mundur lëvizjen, lundrimin e anijes së fesë. Allahu (*xhel'le xheláluhu*) e sheh namazin si një miraxh, kurse ne dëshiron të na shohë si persona që ngjiten nëpër shkallët e miraxhit. Namazi do të jetë mjeti më i rëndësishëm i përparimit tonë shpirtëror, nëse do të vazhdojmë me faljen e namazeve tona deri në çastin kur do të japim shpirt e do të arrijmë tek mëshira e Zotit të Madhëruar. Në momentin që do të lartësohemi në atë gradë dhe pozitë, ai do të thotë: "Allahu im! Këta nuk më braktisën mua në botë. As Ti mos i braktis ata!" Nga ana tjetër, nëse nuk marrim abdes ashtu siç duhet, nëse nuk i falim me kujdes namazet, nëse nuk i bëjmë veprat e tjera të mira, atëherë namazet do të na drejtohen me fjalët "Ashtu siç na braktise në atë botë, ashtu të braktistë Zoti këtu!"

Nëse në një shoqëri, veçanërisht në shtresën e të arsimuarve dhe njerëzve të ndritur të saj, nuk ka një prirje drejt namazit, do të thotë se jeta fetare e asaj shoqërie ka filluar të venitet. Po të merret parasysh gjendja e mjerë e popujve myslimanë sot, do të vërehet se kokat që nuk ulen poshtë para madhështisë së Allahut dhe nuk denjojnë të shkojnë në sexhde, puthin pragun e derës së shumë të vegjëlve si vetja e tyre dhe arsyeja e kësaj do të kuptohet më mirë. Ngaqë nuk besojnë në llogaridhënien e asaj çfarë bëjnë, vendin e ndjenjës së përgjegjësise

⁶⁷ Surja Hakka, ajetet 19-20.

dhe të frikës ndaj Zotit ua kanë zënë huqë të tilla si vjedhja, abuzimi, keqpërdorimi dhe shpërdorimi. E, në fakt, një shoqëri e formuar nga besimtarë të vërtetë nuk është kështu; ata bartin në ndërgjegjet e tyre shqetësimin e dhënies së llogarisë edhe për gjënë më të vogël e, për rrjedhojë, sipas kësaj i hedhin hapat. Një besimtar, i cili, duke ardhur në mesxhid pesë herë në ditë, e ripërtërin besëlidhjen e tij me Zotin, sikur thotë: “Zoti im, nuk e kam harruar faktin që jam robi Yt! Erdha sërish para Teje për ta pohuar këtë edhe një herë. Edhe kur të dal jashtë, në përputhje me këtë të vërtetë do ta organizoj jetën time, praninë Tënde nuk do ta nxjerr nga mendja as për një çast. Do t’i hedh hapat duke qenë i vetëdijshëm se po më vëzhgon në çdo moment; jo të drejtat e njerëzve, po as një milingonë nuk do të shkel!” Ai është i detyruar të mendojë kështu. Përndryshe, bie në kundërshtim me gjërat që thotë dhe i bie se ka gënjyer. Sepse ai, brenda një dite, del përpara Allahut pesë herë, përkulet e shkon në ruku dyzet herë, tetëdhjetë herë vendos kokën në sexhde dhe shpall e pohon madhësitinë e Zotit. Rrjedhimisht, në jetën e një besimtari të tillë nuk mund të ketë vend për devijime.

Po, ngritja jonë nga ana e Allahut (*xhel’le xheláluhu*) në shkallën më të lartë të njerëzimit varet nga modestia, përlulesia që tregojmë para Tij në emër të të qenit rob i Tij. Në të kundërt, për sa kohë jetojmë si robër të përfitimeve dhe interesave tona, duke u fokusuar vetëm në punët tona të përditshme, mbase nga jashtë do të duket sikur po fitojmë diçka, por, në të vërtetë, do të humbasim shumëçka. Zoti i Madhëruar na mundësoftë kujtimin e botës tjetër në çdo situatë, në çdo çast. Na mundësoftë të bëjmë punë të atilla, që të jemi në gjendje ta kujtojmë Atë në çdo moment; të kujtojmë llogaridhënien, mizanin (peshoren), çastin kur nga të gjitha anët do të fluturojnë fletoret; t’i kujtojmë të gjitha këto dhe sipas tyre të rregullojmë gjendjen tonë. Zaten, besimtar është ai që, kur e shikon, të sjell në mendje Zotin dhe botën tjetër, i mundëson zemrës tënde të fitojë sërish drejtimin e duhur.

Ç’lumturi për ata që vrapojnë drejt mesxhidit pesë herë në ditë, që zhyten në detin e namazit, pastrohen nga të gjitha papastërtitë,

materiale dhe shpirtërore, dhe, mandej, duke qëndruar të pastër e të përlur para Zotit, fillojnë të luten e të shprehin dëshirat e tyre në lidhje me rindërtimin e botës tjetër.

2. Namazi si adhurim

a. Kryerja e adhurimeve vetëm se jemi urdhëruar për t'i kryer ato

Ka një sekret në kthimin nga Allahu i Madhëruar, në adhurime dhe lutje. Kjo do të thotë se robi mund të mos i dijë kuptimet që u atribuohen atyre; ai i kryen ato vetëm se është urdhëruar që t'i kryejë dhe, në këtë mënyrë, tregon se është një rob i gatshëm për t'i bërë ato çfarë i kërkohen. Nëpërmjet adhurimeve mund të arrihen përfitime si të ushqyerit e zemrës, shpirtit, ndjenjës dhe sekretit (sir), si dhe kthimi i këtyre për nga Allahu (*xhel'le xheláluhu*). Kur mendohet pak njeriu, mund të vërejë se ka edhe urtësi e dobi të tjera përveç të lartpërmendurave.

Për shembull, mund të kuptohet fare thjesht nëpërmjet mendjes se zekati është një urë e Islamit dhe një masë që bashkon të varfërit me të pasurit, i ngroh ata me njëri-tjetrin dhe që parandalon përçarjet, mosmarrëveshjet dhe konfliktet. Haxhi mund të mendohet si një udhëtim, një shëtitje që e çlodh njeriun, që i jep atij mundësinë për të ardhur edhe një herë në vete dhe si një kongres për mbarë botën islame. Mund të konkludohet se, nëpërmjet agjërimit, nefsi (ego) i njeriut mëson bindjen dhe se njeriu bën një lloj pehrizi e gjen shërim.

Por besimtari nuk i lidh kurrë adhurimet e tij me këto të mira e përfitime. Sepse ai e di se, çfarëdo qofshin urtësitë dhe të mirat e adhurimeve, pavarësisht faktit nëse i kupton apo jo ato, është thelbësore të mendojë që duhet vepruar në përputhje me atë që i është bërë e ditur dhe urdhëruar dhe që, në atë urdhër, mund të ketë edhe urtësi të tjera, të pakapshme nga mendja e tij. Si në rastet e zekatit, agjërimit dhe haxhit, mund të paraqiten disa urtësi edhe për ndarjen e namazeve në kohë të caktuara, për ndryshimet në numrin e rekateve, edhe për

veprime specifike gjatë namazit siç janë rukuja, sexhdeja, kijami. Por një besimtar i sinqertë nuk i lidh namazet e tij me këto urtësi. Përkundrazi, ai merr për bazë urdhrin hyjnor. Në metodologjinë e fikhut, kjo veçori e adhurimeve është quajtur *'ta'abbudî'* (kryerja e adhurimeve pa kërkuar për urtësitë apo të mirat që na vijnë prej tyre, kryerja e tyre me idenë për të zbatuar urdhrat e Allahut në lidhje me to).

Një aspekt i rëndësishëm i gjërave që bartin këtë veçori është ky: Ju nuk mund të vëreni një lidhje mes asaj që bëni dhe asaj që ju mundëson Zoti i Plotfuqishëm sipas parimit të shkakësisë (marrëdhënies shkak-pasojë). Për shembull, ju falni namazin dhe pastaj shikoni se dëshira të atilla në lidhje me këtë botë e me botën tjetër, të zemrës e të shpirtit, të mendjes e të ndjenjave u janë realizuar, saqë, duke thënë se si janë të mundura të gjitha këto, habiteni përballë tyre. Këtu ekziston një pikë shumë delikate. Kryerja e adhurimeve duke menduar vetëm faktin se kështu ka urdhëruar Allahu, e zhvillon tek ju akoma më shumë këtë ndjenjë.

Po të mendoni mrekullitë e të Dërguarit të Allahut (s.a.s.), si mund të ndahet në dy pjesë hëna me ngritjen e një gishti të dorës së Tij ndërkohë që ndodhet me këmbët në tokë; si mund të shkojë pema pranë Tij vetëm nëpërmjet një shenje me gisht; si mund t'i shtohet bereqeti një ushqimi për dhjetë veta vetëm duke shëtitur dorën e tij të bekuar mbi të, aq sa të ngopë pastaj shtatëqind veta! Duke qenë se në të gjitha këto nuk ka asnjë anë të arsyeshme sipas parimit të shkakësisë, atëherë kuptohet se Allahu (*xhel'le xheláluhu*) po mundëson një favor të veçantë. Po kështu ndodh edhe me njeriun. Kur shikon adhurimet e veta dhe rezultatet që merr prej tyre, kur shikon bekimet dhe mirësitë për sa i përket sjelljeve të veta, qëndrimeve, jetës shpirtërore dhe asaj të zemrës, ndjenja e kryerjes së adhurimeve thjesht për të çuar në vend urdhrat e Allahut do t'i shtohet.

Për më tepër, kjo veçori e adhurimeve ka një rëndësi shumë të madhe sepse bën të mundur lindjen e ndjenjës për të mos kërkuar asgjë prapa detyrës së robërisë ndaj Zotit (*xhel'le xheláluhu*), për t'i lidhur veprat e

kryera vetëm me urdhrin e Tij dhe për t'iu drejtuar Atij me sinqeritet. Ushqen ndjenjën e kërkimit të pëlqimit dhe kënaqësisë së Tij. Madje, jo vetëm në adhurimet farz, kjo veçori gjendet edhe në parimet e vendosura në lidhje me jetën personale, familjare dhe shoqërore të njeriut. Njeriu, edhe në kryerjen e punëve dhe veprimeve të tjera të jetës së tij të përditshme, mund të ruajë nijetin e kryerjes së tyre vetëm se është urdhëruar për t'i bërë ato në atë mënyrë. Edhe pse në punët e zakonshme e të përditshme vërehet më shumë çështja e kuptimeve të ndërhuara mbi arsyen, logjikën dhe urtësinë, mundet që edhe tek ato të merret për bazë aspekti i “të qenit të urdhëruara”. Nëse robi i kryen adhurimet apo edhe gjërat e tjera të jetës së tij të përditshme në varësi të idesë se po bën atë për çfarë është urdhëruar, mësohet me shpirtin e adhurimit të sinqertë. Këtë mund ta lidhni edhe me fjalët e Ustadit (Said Nursi): Nëse njeriu i bën një pjesë të punëve të tij të përditshme për fitimin e kënaqësisë së Allahut dhe i lidh ato me një nijet sakllam, për shembull, nëse, me nijetin për të ndjekur sunetin e Pejgamberit tonë (s.a.s.), ha si Ai, ulet e ngrihet si Ai dhe përpiqet që në çdo veprim të tijin t'i ngajë Atij, atëherë adetet (punët e zakonshme) i shndërrohen në ibadete (adhurime).⁶⁸

Kuptimi themelor i kryerjes së adhurimeve vetëm se janë urdhëruar nga Zoti është ky: Allahu i Madhëruar është Pronari dhe Zotëruesi i vërtetë. Kurse njerëzit janë robërit e Tij e, për rrjedhojë, prona e Tij. I zoti i pronës vepron si të dojë me pronën e vet. Kështu që, Ai është Sovrani Absolut në përcaktimin e sjelljeve dhe veprimeve tona. Megjithëkëtë, Allahu (*xhel'le xheláluhu*), mes gjithë krijesave, njerëzve u ka dhënë në njëfarë kuptimi detyrën e kalifit në punët e përditshme që kryhen rëndom, u ka njohur atyre të drejtën për të ndërhyrë tek gjërat e tjera. E, në fakt, ky konsiderohet një zotërim relativ. Njerëzit, duke kryer adhurimet dhe me idenë për të çuar në vend urdhrat e Allahut, duhet t'i binden dhe t'i dorëzohen në mënyrë absolute Sunduesit dhe Zotëruesit Absolut; duhet të përdorin gjithashtu edhe të drejtën relative që iu është njohur në çështjen e ndërhyrjes te sendet në punët

⁶⁸ Bediuzamani, Shkreptimat, fq. 109 (Shkreptima e Njëmbëdhjetë, Pika e Parë).

e zakonshme të jetës së përditshme. Por duhet të dinë se, edhe gjatë ushtrimit të kësaj të drejte, Pronari i Vërtetë i çdo gjëje dhe Shkaku i Vërtetë është Allahu.

Allahu i Lartësuar ka krijuar në këtë univers disa ligje si forca e shtytjes dhe ajo e tërheqjes, forca e fërkimit, forca e rëndesës, të cilat mund t'i quajmë edhe si zakone sublime të të Përkryerit. Për shembull, bimët dhe pemët rriten, zhvillohen dhe bëhen të frytshme për sa kohë gjejnë në tokë forcën e mbirjes, vazhdojnë kontaktin me diellin dhe takohen me ujin. Zhvillimi, rritja dhe frytshmëria e bimëve në varësi të ujit është një ligj i Allahut. Në fakt, Allahu (*xhel'le xheláluhu*) është Ai që e krijon përfundimin që do të merret nga ujitja e bimës, por, në të njëjtën kohë, edhe ujitjen e ka krijuar si një shkak për atë përfundim. Ne, duke qenë të vetëdijshëm për këtë, zhvillojmë metoda të ndryshme ujitjeje sipas kushteve, shkencës, teknologjisë dhe botëkuptimit të periudhës në të cilën jetojmë dhe i aplikojmë ato. Kur hedhim farën, për të marrë në gradën më të lartë e më të mirë të mundshme përfundimin e pritur nga ajo farë, kërkojmë, gjejmë dhe aplikojmë atë lloj metode mbjelljeje që nevojitet.

Por, edhe gjatë hedhjes së farës, themi: “Gjërat që po bëj unë janë vetëm shkaqe. Ai që do të më japë prodhimin e kësaj fare është Allahu. Nëse është dikush që do të bëjë të mundur rritjen e saj, ai është Allahu. Vetëm Ai mund të më japë dy nga një. Por shkaqet i bën thjesht perde për lavdinë dhe madhështinë e Tij.” I qëndrojmë besnik shprehjes së Mesazheve të Dritës: *“Lavdia dhe madhështia kërkojnë që shkaqet të jenë perde për Dorën e Fuqisë Hyjnore përpara shikimit të mendjes, ndërsa Uniteti Hyjnor dhe Gjithëlavdia kërkojnë që shkaqet t'i tërheqin duart e tyre nga ndikimi i vërtetë.”*⁶⁹ Ja, pra, ne e adhurojmë Allahun dhe shprehim robërinë tonë ndaj Tij duke e lidhur edhe një çështje të këtillë me kryerjen e çdo gjëje vetëm se jemi urdhëruar në atë mënyrë. Edhe pse në një mënyrë relative, Ai na ka dhënë të drejtën dhe mundësinë për të ndërhyrë tek sendet, dhe, nëse i përmbushim kushtet duke mos

⁶⁹ Bediuzamani, Fjalët, fq. 744 (Fjala e Njëzet e Nëntë, Qëllimi i Parë), fq. 773 (Fjala e Njëzet e Nëntë, Qëllimi i Dytë).

harruar se na e ka urdhëruar edhe këtë, do të arrijmë vetëdijen e vërtetë të adhurimit dhe të të qenit rob i Tij.

b. Mospritshmëria në adhurime

Një besimtar, që e ka kapur sekretin e adhurimit, të gjithë veprat e veta i lidh vetëm me kënaqësinë e Allahut. Orvatet të hapë vetëm derën që shkon drejt fitimit të kënaqësisë së Allahut të Lartësuar, përpiqet të përdorë vetëm atë korridor. Nëse Zoti i Madhëruar e bën atë të fitojë fuqinë e shpirtit të vet dhe i mundëson atij ngritjen në gradën e jetës së zemrës, ai i shikon këto si bekime të veçanta të të Gjithëmëshirshmit Mëshirëplotë. Pavarësisht arritjes apo jo të një rezultati të këtillë, ai vazhdon adhurimet duke ia kushtuar të gjithë vëmendjen Krijuesit Sublim. Madje, kur përballet ndonjëherë me situata të jashtëzakonshme, thuajse të mrekullueshme, me një qëndrim të singertë, i shikon ato ashtu siç i shohin njerëzit e Zotit dhe, duke u shprehur me fjalët “*Me meritë nuk i kam këto unë i varfëri; ky hir e kjo mirësi vallë pse më erdhi?* Unë pata kërkuar më të madhen e gjërave që duhen kërkuar. Unë të pata kërkuar Ty. Ti bëhu i imi, pastaj, bëhet edhe sikur të mos kem asgjë tjetër. Sepse, vetëm duke të gjetur Ty, gjej gjithçka e shpëtoj nga fukarallëku.” jeton me një vetëdije të plotë adhurimi.

Vetëm ata që nuk kanë pritshmëri mund të përparojnë pa ngecur në këtë rrugë të vështirë, të tjerët mund të mashtrohen në çdo çast. Zemra e njeriut pa pritshmëri rreh gjithmonë me këto mendime: “O Zot, Ti më ke dhënë një pafundësi të mirash dhe, për më tepër, kundrejt asnjë pagese apo shpërblimi tjetër! Zaten, unë i paskam marrë paradhënie të gjitha. Më ke dhënë mirësinë e quajtur ‘jetë’, më ke nderuar duke më bërë njeri, më ke ndriçuar zemrën me nurin e Islamit, më ke bekuar me mundësinë për të ecur në korridorin e dijes dhe dashurisë. Më ke dhënë mundësinë për t’i shërbyer fesë, vatanit dhe popullit tim. Çfarë kisha për të marrë, i paskam marrë të gjitha dhe, karshi gjithë këtyre bekimeve, më paske ngarkuar me një shërbim të këndshëm, të rehatshëm e të lehtë, pra, kryerjen e adhurimeve. Tani, ajo që më takon

mua është fitimi i kënaqësisë Tënde duke i përdorur dhe vlerësuar më së miri të mirat që më ke dhënë. Të jem robi Yt deri kur të më shterojnë fuqitë dhe, mandej, të kërkoj strehim tek mëshira dhe bujaria Jote.”

Si rrjedhojë e mendimeve të këtilla, miqtë e të Vërtetit shpeshherë përgjërohen kështu në lutjet e tyre: “O Zot! Kur ne nuk kishim nevojë as që të ekzistonim, kur nuk kishim nevojë as për këtë apo atë gjë, Ti na i dhe si mirësi e bekime edhe ato gjëra, të cilave nuk ua ndienim nevojën. Kurse tani, tani kemi nevojë që të të adhurojmë Ty në një mënyrë të singertë. Jemi nevojtarë ndaj mëshirës dhe bujarisë Tënde. Ne nuk ekzistonim, as që mund ta mendonim ekzistencën, nuk e kishim marrë aspak në konsideratë idenë e të qenit njeri, nuk mund ta merrnim. Këto nuk ishin nevoja tonat. Por Ti, me bujarinë Tënde, na i mundësove të gjitha këto. Tash e tutje, që të mund të qëndrojmë në këmbë, kemi shumë nevojë për Ty; kemi shumë nevojë për Ty, që të mos rrëshqasim, të mos rrëzohemi... Kemi shumë nevojë për Ty, që të mund të qëndrojmë në rrugën drejt Xhenetit; kemi shumë nevojë për Ty, që të mos ngecim tek dobësitë tona, që të përparojmë drejt fitimit të kënaqësisë Tënde! O Allahu ynë, që na mundëson edhe ato gjëra për të cilat nuk kemi nevojë! Prej Teje i lypim edhe ato çfarë na nevojiten!”

Po, është shumë e rëndësishme ta njohim Zotin e Madhëruar në atë masë që duhet njohur. Është shumë e rëndësishme ta shohim Atë ashtu siç na shikon Ai ne, t'i drejtohem Atij siç na drejtohet Ai neve. Sërish, duke thënë “O Zot! Na e bëj të njohur Vetën Tënde, mbushi zemrat tona me dashurinë për Ty, me dashurinë Tënde ushqej shpirtat tanë! Zemrat tona të mos devijojnë kurrë! Na jep forcë e vullnet për të mundur shejtanin dhe unin orientues drejt së keqes (nefsi emmâre)!”, në derën e Tij e kërkojmë edhe këtë.

c. Shirku dhe shtirja (rija) në adhurime

Sëmundjet si shtirja dhe të rendurit pas famës (*sum'a*), të cilat burojnë nga boshllëqet dhe dobësitë njerëzore e që ia paralizojnë njeriut jetën shpirtërore dhe atë të zemrës, shfaqen në mënyra të ndryshme.

Ndonjëherë, ka veprime që bëhen drejtpërdrejt vetëm që të shihen e të dëgjohen nga të tjerët. Herë të tjera mund të bëhet fjalë për situata, në të cilat ka orvajtje për ta treguar sa më të thellë cilësinë e veprave të kryera dhe, kështu, për të tërhequr vëmendjen tek ndjenjat vlerësuese e lavdëruese të njerëzve në lidhje me ato vepra.

Tabloja e mëposhtme, në lidhje me hipokritët që shkojnë drejt namazit thuajse duke i tërhequr zvarrë këmbët e tyre dhe që përshkruhet në Kuranin e Shenjtë, mund të jepet si shembull për situatën e parë:

“Në të vërtetë, hipokritët përpiqen të mashtrojnë Allahun, por edhe Allahu u përgjigjet mashtrimeve dhe dredhive të tyre. Kur ata ngrihen për namaz, ngrihen me përtesë, vetëm sa për t’u dukur para botës, dhe Allahun e përmendin fare pak.”⁷⁰

Në kohën e profetit Muhamed (s.a.s.), kur drejtimi i vendit ishte në duart e myslimanëve, hipokritët përpiqeshin të dukeshin sikur falnin namaz, ose për të përfituar nga plaçka e luftës, ose për interesa të tjera që ata i shihnin si të rëndësishme. Për këtë arsye, shkonin në mesxhid pa pikë dëshire, falnin pa qejf namazin dhe shikonin për ndonjë mënyrë se si të largoheshin një çast e më parë nga mesxhidi. Në thelbin e këtij qëndrimi dhe të këtyre sjelljeve të hipokritëve nuk ndodhet ndonjë shqetësim si falja e namazit; bëhet fjalë vetëm për një përpjekje për t’u dukur ashtu, për ta treguar veten të atillë. Këtë çështje, që përmendet në lidhje me namazin, mund ta mendojmë edhe për adhurimet e tjera. Për shembull, një person, i cili nuk ka ndonjë brengë të tillë si kryerja e dhikreve apo përmendja e Zotit të Madhëruar dhe që ulet diku e merret me llafe për orë të tëra, nëse në një vend ku janë të pranishëm shumë njerëz merr në dorë trespiket dhe, me qëllimin që ta shohin e ta dëgjojnë të pranishmit, befas fillon të bëjë dhikër, edhe kjo gjendje e tij bën pjesë brenda kornizës së përshkruar më sipër.

Ndonjëherë, megjithëse veprimi i shfaqur nuk është kryer në varësi të qëllimit për t’u dukur e për t’ua bërë të ditur të tjerëve, ekziston mundësia që, gjatë kryerjes së veprimit, personi të bjerë në një devijim

⁷⁰ Surja Nisá, ajeti 142.

të tillë si përpjekja për ta treguar sa më të thellë cilësinë e atij veprimi. Fjala vjen, një person, teksa fal namazin në një vend ku nuk ndodhet askush tjetër, e kryen atë shkel e shko, pa i kushtuar rëndësinë e nevojitur kryerjes së rregullt të çdo pjese të tij. Ulja në ruku dhe ngritja prej saj thuhetse ndodhin përnjëherësh, aq sa të mos jesh në gjendje të kuptosh nëse ka thënë të paktën një herë “*Subhâne Rabbijel Adhím*” në momentin e kryerjes së saj; pasi ngrihet nga rukuja, vete menjëherë në sexhde, akoma pa u drejtuar mirë. Situata e tij në sexhde nuk është e ndryshme nga ajo e rukusë. E pra, një njeri që i kalon në këtë mënyrë rukunë dhe sexhden e tij kur është duke u falur vetëm, nëse në praninë e të tjerëve përpiqet të duket sikur po e fal namazin gjithë përkushtim, - ashtu siç thotë edhe hadithi – do të thotë se sjelljes së atij personi po i vjen era “shirk i fshehtë”.⁷¹

Po, sjellje të këtij lloji preken nga shirku. Sepse gjatë atyre sjelljeve nuk janë marrë në konsideratë Allahu dhe kënaqësia hyjnore, po vetëm kënaqësia e të tjerëve. E, në fakt, thellësia që reflektohet jashtë fiton vlerë nëse është e pranishme edhe në zemër. Në të kundërt, të treguarit i thellë me tendencën për ta bërë veten të pëlqyeshëm tek të tjerët është një situatë shumë e rrezikshme dhe, – Zoti na ruajt – edhe sikur të jetë besimtar personi, në fletoren e tij kjo regjistrohet si një akt shirku.

Në të vërtetë, thelbi i Islamit është titulli i rendit të përbërë nga një përmbledhje ligjesh hyjnore, që ka ardhur për t'i shpëtuar njerëzit nga shirku. Le të theksojmë edhe një herë këtu se Allahu (*xhel'le xheláluhu*) është i adhuruari, i dashuruari, i dëshiruari dhe i kërkuari ngaqë është Allah. Atë nuk e bëjnë Allah adhurimet tona. Prandaj, është e drejtë e Tij dhe detyrë e jona që, duke i lidhur të gjitha mendimet me Individualitetin e Tij, të adhurohet e të mos i vihet asgjë si ortak. Të përfshish mendime e përfytyrime të tjera gjatë kryerjes së kësaj detyre do të thotë ta ndotësh atë.

Të gjithë ne, si besimtarë që jemi, në adhurimet dhe shërbimet që bëjmë e që përpiqemi të bëjmë, duhet të marrim në konsideratë vetëm

⁷¹ Ibn Máxhe, zuhd 21; Ahmed ibn Hanbel, el Musned 3/30.

pëlqimin dhe kënaqësinë e Allahut të Madhëruar, duhet të tregojmë në çdo çast përpjekjen për të përmbushur plotësisht detyrimin e të qenit robër të Zotit dhe, me mendimin se mos vallë po i turbullojmë ujërat e adhurimeve tona me ca mendime në kundërshtim me sinqeritetin, duhet të dridhemi madje. Ky duhet të jetë horizonti që besimtarët duhet të arrijnë. Përveç kesaj, ekziston edhe një gjendje tjetër shpirtërore, ajo e lënies së kënaqësisë së Allahut mënjanë dhe e orvatjes për t'u dukur i lezetshëm tek të tjerët, e të qenit vazhdimisht në pritje të duartrokitjeve dhe lavdërimeve të shoqëruara me fjalët *“máshálláh, bárekalláh”*. Kjo është një gjendje e shëmtuar që të kujton shirkun dhe që, pa dyshim, nuk i shkon aspak një besimtari.

Çdo gjë që bëhet për hir të Allahut – nëse do ta shprehnim me fjalën e Kuranit të Urtë – duhet të jetë e mirë, e bukur, e këndshme (tajjib). Dhe është e nevojshme që të mos përzihet as edhe një grimcë e së ndytës (habís) me atë që është e mirë, e bukur, e këndshme. Sepse ajo grimcë ndyrësi do të bëhet shkas për ndotjen edhe të asaj që është e pastër, madje, ndoshta edhe për kalbjen e saj. Kjo nuk do të shërbente për asgjë tjetër veç lumturimit të nefsit dhe shejtanit. Në të vërtetë, detyra e besimtarit është të kënaqë Allahun dhe jo nefsën e shejtanin.

Shirku i vogël: Shtirja

Mund të ndodhë që njeriu të shfaqë ndonjëherë shenja “krekosjeje” gjatë faljes së namazit. I Dërguari i Allahut (s.a.s.) thotë kështu në një nga hadithet e Tij: *“Ajo çfarë më frikëson më së shumti në lidhje me ju është shirku i vogël.”* Kur sahabët e pyesin se çfarë është shirku i vogël, Profeti ynë (s.a.s.) përgjigjet në këtë mënyrë: *“Shtirja (rija).”*⁷² Shirku i madh është pranimi i të adhuruarve të tjerë përpos Allahut, të adhurosh gjëra të tjera veç Tij, ti bësh Atij ortakë në madhësitinë e Tij. Çfarë është shirku i vogël atëherë? Ai është të jetuarit i lidhur me veten dhe dëshirën për t'u dukur. Përveç faljes së namazit, rëndësi kanë edhe mënyra se si falet njeriu dhe emocionet e ndjenjat që përjeton

⁷² Ahmed ibn Hanbel, el Musned 5/428, 429; Taberání, el Mu'xhemul kebir 4/253.

gjatë faljes. Para së gjithash, namazi duhet falur për hir të Allahut dhe si një falënderim e mirënjohje për të mirat që Zoti i Madhëruar na ka dhënë deri në atë çast. Allahu i ka mundësuar mirësi të pafund njeriut në çdo periudhë të jetës së tij. Po, Allahu na ka dhënë një mjedis të pastër e në përputhje me anën tonë shpirtërore, na ka dhuruar aftësinë për të adhuruar, na ka çelur zemrat, na e ka bërë të mundur të piqemi mendërisht dhe na ka udhëzuar në rrugën e drejtë; më tej akoma, na ka dhënë edhe aftësinë për të qenë të suksesshëm në kryerjen me lehtësi të detyrës sonë si robër të Zotit. Pra, kur duam të falim namazet, ne mund të falemi lehtësisht.

Ndonjëherë, pavarësisht faktit se njeriu ka bërë njet të falë namazin, ngaqë është i paralizuar dhe, për rrjedhojë, është i detyruar të jetojë i lidhur për shtrati, nuk mund ta falë namazin të plotë dhe ashtu siç dëshiron. Ose, për shkak se ndodhet në birucë/burg, qëndron larg xhematit të namazeve të xhumasë dhe Bajramit pavarësisht dëshirës së madhe për të qenë pjesë e tyre. Kështu që, sa i kemi akoma në dorë mundësitë, me zemrat të mbushura me falënderim e mirënjohje të pafund ndaj Zotit tonë, duhet ta adhurojmë Atë në çdo këmbëz të shkallëve të jetës.

Çështje e vërteta, kur qëndron në namaz para Allahut, besimtari shpreh në radhë të parë faktin e të qenit borxhli karshi Tij. Sepse i është borxhli Zotit për çdo gjë të tijën nga koka deri te këmbët. Nëse Ai do të na i merrte gjërat që i përkasin Atij, pas do të mbetej vetëm një zero, asgjë më shumë. Do të thotë se ne mund të qëndrojmë përballë Tij vetëm në sajë të gjërave me të cilat Ai na ka pajisur.

Siç kuptohet, namazi është i tëri një bekim, një mirësi e Allahut ndaj nesh. Ndërsa po qëndron para Allahut falë gjërave me të cilat Ai vetë të ka bekuar, ndërsa po kryen detyrën e falënderimit dhe mirënjohjes ndaj Tij, të harrosh Hakun (të Vërtetin) dhe të orvatesh për t'u dukur e për të bërë shfaqje para hallkut (njerëzit, bota) është një sjellje vërtet e pahijshme. Ja, pra, kjo është shtirja e vërtetë. Dhe, ngaqë e tillë është shtirja, ndonjëherë mund të ndodhë që edhe shmangia e shtirjes së vullnetshme të bartë një kuptim të shtirjes. Njeriu, që shqetësohet kaq

shumë nga shtirja, që i trembet asaj në këtë masë, vallë pse shqetësohet? Po ta dijë njeriu se prona dhe pasuria i përkasin tjetër kujt, po ta dijë se po qëndron mbi këmbët që dikush tjetër ia ka dhënë hua, po ta dijë se është në gjendje të shfaqë adhurimet e tij ndaj të Vërtetit falë fuqisë që i përket dikujt tjetër, po ta dijë se zemra e tij rreh për vetë faktin se është dikush tjetër që ia mundëson rrahjet e zemrës, atëherë nuk është nevoja t'i shmanget shtirjes. Për këtë arsye, njerëzit e së vërtetës, nga frika se mos bien në shtirje, edhe braktisjen e një sërë çështjesh e kanë konsideruar si një shtirje më vete. Kurse veprimet e bëra për t'u dukur në sytë e hallkut janë shirk për ta. Këtu ndahen njerëzit e lartë nga njerëzit e thjeshtë; meseleja është thjeshtë një mesele perceptimi.

Le ta përsërisim edhe një herë se shtirja tek njeriu është nxjerrja në pah e diçkaje që, në të vërtetë, nuk është pronë e tij, nuk i përket atij. Transmetuesi i haditheve Ebu Lejth Semerkandíu, në temën e sinqeritetit në librin e tij *Tenbíhul gáfílin* (Vërejtje ndaj të shkujdesurve), e sqaron këtë mesele nëpërmjet një shembulli mjaft të bukur: Gjendja e njeriut që me veprimet e tij shtiret dhe është në kërkim të famës i ngjan kësaj: Një burrë, kur po bëhet gati të dalë në çarshi, mbush torbën e tij me guraçokë. “Sa të mbushur e paska torbën!” thonë ata që e shohin. Ama, në të vërtetë, përveç fjalëve të njerëzve, gurët e torbës nuk i sjellin asnjë dobi tjetër atij. Në qoftë se do të donte të blinte diçka me to, nuk do të mundte. E njëjta gjë vlen edhe për atë që vepron duke u shtirur dhe vetëm për t'u dukur. Njerëzit mund të thonë fjalë të bukura në lidhje me të, por nuk do të ketë asnjë sevap për të në botën tjetër.⁷³

Njeriu, kur vepron duke u shtirur, do të thotë se po shet një gjë që, në fakt, nuk është pronë e tij. Ngaqë gjatësia e trupit të tij është e pamjaftueshme në arritjen e dritares së hapur për të, e mbush hapësirën e saj, e mbyll ose mundohet ta arrijë duke u ngritur në majë të gishtave. Bediuzamani shprehet kështu në lidhje me këtë çështje:

“Në godinën shoqërore të bashkësisë njerëzore, gjithësecili ka një dritare, që quhet një rang, nga ku mund të shikojë e mund të shihet nga të tjerët.

⁷³ Semerkandí, *Tenbíhul gáfílin*, fq. 23.

Në qoftë se dritarja është më e lartë se vlera e njeriut, ai do të zgjatet me mendjemadhësi.

Por në qoftë se dritarja është më e vogël se sa shtati i aspiratës së tij, ai do të përkulet e do të ulë kokën gjithë modesti.

Masa e madhështisë tek të përkryerit është modestia. Ndërsa për të gabuarit e të mangët, masa e vogëlsisë është mendjemadhësia...⁷⁴

Atij që shtiret, Allahu do t'ia tregojë në botën tjetër se për kë i ka kryer ato adhurime. Do t'i shpallë në botën e engjëjve edhe ata që kanë rendur pas famës.

Po, besimtari duhet t'i reflektojë jashtë edhe me qëndrimin dhe sjelljet e tij ato në çfarë beson, mënyrën si beson, bukuritë pas të cilave ka lidhur zemrën dhe mënyrën se si mendon. Për shembull, një individ, i cili ka një lidhje të fortë me Zotin e Madhëruar dhe një marrëdhënie të patëmetë me Pejgamberin tonë (s.a.s.), të Dërguarin e nderuar të Zotit, dhe që i ka bërë këto pjesë të natyrës së tij, parimet e atij besimi që ka përvetësuar me zemër do t'i shfaqë edhe me pjesët e tjera të trupit dhe do t'i përmbushë/duhet t'i përmbushë në çdo çast të jetës së vet kushtet e të gjitha gjërat e tjera që i bën të nevojshme ai besim. Në këtë drejtim, ai do t'i kryejë më së miri dhe pa asnjë mangësi adhurimet, do të falë ashtu siç duhet namazet. Sigurisht, të gjitha këto do t'i bëjë jo me idenë që t'i shikojë filani apo t'i dëgjojë fisteku, po vetëm për të çuar në vend urdhrin e Allahut (*xhel'le xheláluhu*) dhe për të fituar pëlqimin e Tij.

Të shfaqësh diçka ndryshe në namaz

Nëse janë të pavullnetshme, pasthirrmat “ah, vah”, rënkimet dhe nxjerrja zë gjatë namazit nuk përbëjnë ndonjë problem. Në rast se vijnë si rrjedhojë e një grade të caktuar, nëse burojnë nga një gjendje ekstaze, atyre nuk mund t'u thotë gjë askush. Domethënë, dikush do të përjetojë një gjendje të atillë, saqë do të humbasë veten dhe, në një mënyrë të pavetëdijshme, do të nxjerrë zë e do të rënkojë. Pastaj, kur t'i

⁷⁴ Bediuzamani, Fjalët, fq. 1056 (Rrezëllimat).

thonë “Bëre kështu.”, ai, aspak i vetëdijshëm për atë që ka ndodhur, do të thotë: “Vërtet? Unë nuk mbaj mend të ketë ndodhur diçka e atillë.” Nëse nuk është kështu, nuk duhen nxjerrë zëra e, në këtë mënyrë, të shfaqen gjëra që nuk kanë lidhje me namazin. Kjo vlen edhe për të qarit. Njeriu, me aq sa është e mundur, duhet të përpiqet për t’i parandaluar të qarat. Por, nëse nuk arrin t’u bëhet pengesë atyre pavarësisht gjithçkaje, nëse e qara i vjen nga brenda dhe në mënyrë të pavullnetshme, atëherë nuk ka asgjë të keqe në këtë.

Ata që tregojnë për gjendjet e Bediuzamanit në fillim të namazit dhe gjatë faljes së tij thonë se, në namaz, sytë e tij merrnin një pamje të çuditshme dhe se zëri fillonte t’i dilte në një mënyrë të çuditshme gjithashtu. Kjo është një çështje niveli. Nuk është aspak e drejtë që një person që nuk është në atë nivel ta imitojë atë e të shfaqë veprime të këtij lloji.

Në adhurimet që kryehen bashkë me njerëz të tjerë ekziston rreziku i shirkut dhe shtirjes. Kur dikush, që i bie shkurt namazit të tij teksa falet vetëm, e zgjat dhe e zbukuron faljen e tij në praninë e të tjerëve, - Zoti na ruajt - kemi të bëjmë me shirk të fshehtë. Një person që e fal goxha gjatë namazin e tij kur është vetëm, nëse e fal shkurt atë kur është bashkë me persona të tjerë, në këtë rast, mundësia që një sjellje e tillë të jetë një formë shtirjeje është e madhe; sepse edhe në këtë sjellje ka një marrje në konsideratë të ekzistencës së njerëzve përreth duke i veshur asaj një vlerë. Kështu që, njeriu, ashtu siç e kryen namazin kur është vetëm, ashtu duhet ta kryejë edhe kur është duke u falur bashkë me xhematin. As më gjatë e as më shkurt. Nuk duhet të shfaqë as edhe një ndryshim. Si namazi i bariut që falet pranë deleve të tij. Mos qofsha i gabuar në krahasimin që po bëj, a e vret mendjen bariu për faktin që po ia shohin apo jo delet se në ç’mënyrë po e fal ai namazin?

d. Vetëdija e të qenit rob i Zotit në adhurime

Shpëtimi nga ana trupore dhe presioni i trupit, ngritja në gradat më të larta të jetës së zemrës dhe shpirtit janë të mundura për të gjithë,

sipas gradës në të cilën gjenden. Përmbushja e detyrës së adhurimeve nga njeriu dhe, në të njëjtën kohë, përpjekja e tij në rrugën e lartësimit të emrit të Allahut dhe të Islamit, për të bërë të mundur valëvitjen e lavdisë së Tij madhështore në çdo vend, janë si acidi i derdhur mbi anën trupore të njeriut. Duke hyrë kështu në nivelin e jetës së shpirtit përmes një rruge më të shkurtër, në emër të përparimit të tij shpirtëror, njeriu mund të arrijë lehtësisht pëlqimin dhe kënaqësinë e Zotit të Madhëruar.

Po, detyra e të qenit rob i Zotit, adhurimet ndaj Tij duhen realizuar patjetër me shumë kujdes e seriozitet. Ashtu siç tregohet çdo lloj përkujdesjeje për të nderuar e për të pritur më së miri mysafirët në emër të parimeve të mirësjelljes dhe moralit, duke menduar çdo gjë nga pirunët tek lugët dhe nga ushqimet më të shijshme deri tek ëmbëlsirat, po ashtu duhet vepruar edhe në çështjen e adhurimeve; në rastin më të keq, po me aq kujdes e vëmendje duhen trajtuar edhe ato. Kjo është një rrugë shumë e rëndësishme e të shpëtuarit nga ana kafshërore dhe e braktisjes së nefsit, e ngjites në nivelin e jetës së zemrës dhe shpirtit. Me bindjen më të madhe, mund të them se, nëse njeriu nuk i kryen apo nuk është në gjendje t'i kryejë të gjitha llojet e adhurimeve, nga namazi tek agjërimi dhe nga agjërimi deri tek adhurimet e tjera nafile, sikur të ishte duke bërë gjërat më të këndshme të mundshme, është e pamundur që, në kuptimin personal, të thuhet se ai ka dalë nga kafshëria dhe e ka lënë anën trupore të tij. Duke i kryer këto detyra në mënyrë të pavetëdijshme, ama duke iu përmbajtur rregullave të tyre, njeriu mund të shpëtojë nga përgjegjësia, por është gjithashtu një fakt i pamohueshëm që, me adhurime të këtilla, jeta shpirtërore dhe ajo e zemrës nuk zhvillohen.

Për të arritur në nivelin e jetës së zemrës dhe shpirtit, nevojitet gjithashtu që ushqimet e konsumuara të jenë hallall, sytë të shmangen nga haramet dhe, duke vepruar në përputhje me udhëzimin “*Më siguroni që do të ruani atë që keni mes dy nofullave dhe atë që keni mes këmbëve, që t’ju siguroj për hyrjen tuaj në Xhenet.*”⁷⁵ të Profetit tonë

⁷⁵ Buhári, rikak 23; Ebú Ja’lá, el Musned 13/549.

(s.a.s.), të qëndrohet larg bisedave të papërshtatshme e të panevojshme dhe ndjenjave që e çojnë njeriun drejt sjelljeve epshore.

Si përfundim, njeriu duhet të tregohet i kujdesshëm në maksimum ndaj adhurimeve të veta dhe të zotërojë një vullnet të çeliktë e një gjendje të thellë shpirtërore, aq sa të preferojë më parë vdekjen sesa mëkatet që ia paralizojnë jetën shpirtërore. Krahas këtyre, zemrat duhet të arrijnë ndjeshmërinë dhe, nëse e kërkon nevoja, të detyrohen e të shtrëngohen për ta arritur atë. Sepse, në sajë të këmbënguljes dhe përpjekjes, edhe zemrat më të ngurta, me kalimin e kohës, mund të bëhen të ndjeshme. Për ta arritur këtë, në varësi të rrethanave dhe cilësisë së përpjekjeve, mund të duhen ditë, javë, muaj apo edhe vite. Ama në rrugën e fitimit të kënaqësisë së Allahut ia vlen të jepet gjithçka.

3. Falja e namazit në mënyrë të vetëdijshme

Ajetet në suren *Shuará* “*Dhe mbështetu në të Plotfuqishmin, Mëshirëplotin, i Cili e sheh qëndrimin tënd në këmbë (gjatë namazit) dhe lëvizjet e tua midis atyre që përulën në sexhde.*”⁷⁶, përveç përkrahimit të adhurimit të Pejgamberit tonë (s.a.s.), na shpjegon edhe se si duhet t’i kryejmë ne adhurimet. Meqenëse, ashtu siç thuhet edhe në një nga hadithet e Profetit tonë, jemi të ngarkuar me detyrën për t’u falur ashtu siç falej Ai,⁷⁷ atëherë nuk është aspak i drejtë reduktimi i kësaj detyre vetëm në formën e namazit. Kapja e shpirtit dhe kuptimit të namazit dhe paraqitja e adhurimeve tona para Allahut brenda atij përqëndrimi duhen marrë parasysht gjithmonë brenda kësaj kornize. Sigurisht që nuk është e mundur të kapim, si nga forma, po ashtu edhe nga kuptimi, namazin e falur nga një profet, apo të ndiejmë ato çfarë ka ndier ai. Por kjo situatë nuk na pengon që të jemi në atë rrugë. Çdokush, në masën e lidhjes së tij me Allahun dhe vendit që ka ndarë për Të në zemrën e vet, mund ta arrijë dhe duhet ta arrijë përsosmërinë në adhurime.

⁷⁶ Surja Shuará, ajetet 217-219.

⁷⁷ Buhári, edhán 18, edeb 27, temenní 9; Dárimí, salát 42.

Besimtari, kur shkon drejt namazit, vrapon me gëzimin e fillimit të punës më ngazëlluese. Shembujt më të qartë të këtij fakti i vërejmë në namazet e xhumasë e të Bajramit dhe në Qabe, gjatë kryerjes së adhurimit të haxhit. Njerëzit nxitojnë drejt këtyre emnesave sikur të jenë duke iu përgjigjur ftesës së një gostie të madhe dhe, nga frika se mos nuk e arrijnë në kohë adhurimin, i bëjnë hapat sa hapja maksimale e një kompasit dhe përparojnë me shpejtësi drejt destinacionit të synuar. Qëllimi i tyre është hyrja një çast e më parë brenda mesxhidit, dalja para Allahut dhe kryerja e adhurimeve. Një frymë kësisoj e thellë ndihet edhe në nxitimin e njerëzve për tek Bahçja e Pastër (*Ravzai Táhire*). S'ka se si të mos mallëngjehesh tek i sheh ata, të cilët, pasi kanë marrë abdes dhe nuk kanë gjetur kohë as për të ulur mëngët e përveshura e as për të krehur flokët dhe mjekrën, vrapojnë gjithë emocion drejt Tij me sexhadet mbi supe e pantoflat në duar, pa parë se kë kanë në të majtë e në të djathtë.

Ja pra, ngazëllimin e një vrapimi të këtille bart namazi. Kur e shikon atë, këtë kuptim mund të nxjerrësh. Dhe besimtarët janë në gjendje ta ndiejnë këtë gjë. Kurse hipokritët, ngaqë nuk mund ta ndiejnë atë kuptim, vijnë në namaz duke e menduar atë si një bela që duhet hequr qafe, e kryejnë atë si të ishte një angari sepse nuk kanë mundur që, nëpërmjet besimit, ta kapin këtë gëzim. Namazi që falet në këtë mënyrë, si për të shpëtuar nga një bela, vetëm duke gogësitur e duke u kotur mund të falet. Allahu (*xhel'le xheláluhu*) e përshkruan kështu këtë gjendje të hipokritëve: ***“Në të vërtetë, hipokritët përpiqen të mashtrojnë Allahun, por edhe Allahu u përgjigjet mashtrimeve dhe dredhive të tyre.. Kur ata ngrihen për namaz, ngrihen me përtesë, vetëm sa për t’u dukur para botës, dhe Allahun e përmendin fare pak.”***⁷⁸ Po, hipokriti është gjithmonë në një gjendje apatie dhe mpirjeje; në lejohet të bëhet një krahasim i tillë, ai ul poshtë kokën, del para Zotit duke e tundur atë sa majtas djathtas dhe thotë: “Ah, sikur të mbaroj sa më shpejt punë me namazin e të dal jashtë!” Sepse një jetë të dyfishtë ka bërë tërë kohës dhe, për rrjedhojë, zemra i ka mbetur gjithmonë e

⁷⁸ Surja Nisá, ajeti 142.

privuar nga ngazëllimi i namazit. Zoti i Madhëruar mos lejoftë që një ndjenjë e tillë, e cila do të konsiderohej një njollë e madhe në fytyrën e zemrës së besimtarit dhe që do të bëhej shkak për turpërimin e tij në botën tjetër, të zërë vend në zemrat tona!

Në një ajet tjetër të Kuranit Famëllartë, Allahu (*xhel'le xheláluhu*) thotë kështu: **“Mjerë për ata, të cilët, kur falen, janë të pakujdesshëm për namazet e tyre.”**⁷⁹ Në namaz, *sehiv* (gabim) ka kuptimin e të qenit larg Allahut edhe gjatë qëndrimit para Tij. Në një hadith të dobët, kjo situatë shpjegohet në këtë mënyrë: *“Do të vijë një kohë, kur (mijëra njerëz) do të mbushin mesxhidet dhe do të falin namazet, por në mesin e tyre nuk do të ketë besimtarë.”*⁸⁰ Kemi shpresë tek Allahu i Madhëruar se do të na ruajë nga një rënie e tillë me kokë dhe se do të na falë të gjithëve edhe për hir të njerëzve të mirë e me lutje të pranuar, me të cilët ulemi dhe ngrihemi bashkë. Sepse Ai, kur të falë një grup njerëzish që janë mbledhur për ta përmendur Atë dhe engjëjt të thonë *“O Zot! Mes tyre ndodhej edhe një person që nuk kishte si qëllim përmendjen Tënde, ai kishte ardhur aty për diçka tjetër!”*, do të thotë: *“Unë e kam falur edhe atë. Ata janë një shoqëri e atillë, saqë është e pamundur të jetë fatkeq ai që ulet e ngrihet bashkë me ta.”*⁸¹

Po, gjatë namazit, besimtari është i këndellur në maksimum dhe gjendet i rrethuar nga paqja, qetësia e të qenit i drejtuar me gjithë zemër për nga Zoti i vet. Fundja, kjo është sjellja dhe qëndrimi që i shkojnë atij për shtat. Pakujdesia dhe hutesa, në asnjë mënyrë nuk mund të futen në ambientin e tij. Ai, kur del para Zotit dhe thotë *“Allahu Ekber”* gjithë dashuri e entuziazëm, i kujton të gjitha të vërtetat e adhurimit dhe robërisë së tij ndaj Allahut. Ndërsa pranon se Zoti është i Adhuruari Absolut, ai shpreh gjithashtu edhe dobësinë dhe varfërinë e vet. Për shembull, këto janë mendimet që i kalojnë nëpër kokë kur thotë **“ijjâke na'budu”**: *“Zoti ynë! Pastruam zemrat tona dhe erdhëm para Teje. Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm prej Teje ndihmë*

⁷⁹ Surja Máún, ajetet 4-5.

⁸⁰ Ibn Ebí Shejbe, el Musannef 6/163, 7/505.

⁸¹ Buhári, de'auát 66; Muslim, dhikr 25.

kërkojmë. Lamë pas çdo gjë të kësaj bote, sytë tanë të shohin vetëm Ty. Tani kërkojmë mëshirën Tënde. Mbase i jemi futur një pune të rëndë. Për rrjedhojë, mbajtja e kësaj barre do të jetë goxha e vështirë; çështje e vërteta, të mbash zemrën të lidhur me Ty nga fillimi në fund dhe ta bësh atë të dridhet me respektin dhe dashurinë për Ty është një detyrë shumë e mundimshme! Por tani, të drejtuar për nga horizontet e botës hyjnore, zemrave tona po iu qesh buza!”

Më pas, brenda mendimeve të tilla si “Zoti ynë! Vetëm Ti mund të na ndihmosh përballë situatave të kësaj kohe, të cilat duan të na thyejnë në mes e të na bëjnë të biem në sexhde e ruku para tyre. Na mbështet dhe bëje të mundur plotësimin e kësaj pune. Na mundëso vazhdimësinë e kuptimit të namazit në të gjitha fazat e jetës sonë.”, thotë: **“Ijja ke neste’in.”**

Pastaj, pasi strehohet tek Allahu me fjalët **“ihdinas’siratal mustekím”**, **“Na udhëzo në rrugën e drejtë; na udhëzo në rrugën ku kanë ecur profetët, besnikët, dëshmorët dhe që Ti e quan rrugë e mesme (sirat mustekím)!”**, shkon në ruku para madhësisë së Tij.

Në ruku thotë **“Subhâne rabbijel adhím”**, **“O Zoti im i Lartë! Të përmend e të lavdëroj Ty duke dëshmuar për bujarinë dhe dashurinë Tënde ndaj robërve të Tu.”** dhe bën një rinovim të besës së dhënë.

Ndërsa drejtohet nga rukuja, duke nënkuptuar fjalët “Allahu im, falënderimet të takojnë Ty, që më mundësove të ngrihem sërish pasi, duke mbetur nën peshën e llogarisë, m’u thye mesi e vajta në ruku!”, thotë **“Sem’ialláhu limen hamideh”**, e cila bart kuptimin **“Allahu i dëgjon ata që e falënderojnë Atë”**. Kur drejton trupin dhe qëndron për pak çaste në këmbë si një ‘elif’, thotë “Po, vërtet falënderimi dhe mirënjohja të takojnë Ty, Allahu im!”. Ndonjëherë, kur thënia e vetëm kësaj fjalie i duket e paktë, shton edhe shprehjen **“Allahu ekberu kebírá uel hamdulil’láhi kethírá ue subhánalláhi bukreteu’ue esílá”**, **“Allahu është më i Madhi i të mëdhenjve, falënderimet tona ndaj Allahut janë të shumta, tesbihet tona të mëngjesit dhe mbrëmjes janë për Të.”**. Kur një nga sahabët i pati thënë këto fjalë në çastet e ngritjes nga rukuja, Profeti

ynë (s.a.s.) pati pyetur: “*Kush i tha këto fjalë?*” Pasi sahabi u përgjigj duke thënë “Unë i thashë, o i Dërguari i Allahut.” Ai (s.a.s.) tha kështu: “*Më pëlqyen ato fjalë. Dyert e qiellit u hapën për to.*”⁸²

Si përfundim, mund të themi se namazi është adhurimi në të cilin ndërthuren të gjitha kuptimet e jetës. Ai, nga fillimi në fund, është pohim i robërisë sonë ndaj Zotit. Për rrjedhojë, robi, gjithë entuziazëm, e ndien dhe e rrok atë që nga fillimi i këndimit të ezanit gjer në mbarimin e faljes së namazit.

a. E vërteta e namazit

Namazi, ashtu siç ka zbatimin e kushteve dhe shtyllave të tij, të cilat përbëjnë anën e tij të jashtme (atë që duket), ka po ashtu edhe aspektin e tij të brendshëm (që nuk duket). Namazi i atij që e fal atë duke respektuar kushtet, shtyllat, detyrimet (vaxhip) e namazit dhe gjërat e tjera, kryerja e të cilave është e pëlqyeshme (mustehap), konsiderohet i vlefshëm. Edhe ata që e shikojnë këtë person tek falet në këtë mënyrë arrijnë në përfundimin se ai po i fal saktë namazet e tij. Kurse bërja e një nijeti për të qenë, të qenit i sinqertë dhe falja në shoqërinë e ndjenjave të frikës dhe respektit për Krijuesin janë çështje që kanë të bëjnë me anën e brendshme të namazit. Disa dijetarë i kanë quajtur si shtylla të namazit edhe *hushú-në* e *hudú-në*, disa të tjerë i kanë numëruar në mesin e detyrimeve (vaxhip) të namazit.

Kushtet e jashtme janë si kallëpët e namazit. Pa to, është e pamundur të përmbushen kushtet e brendshme të tij. Njeriu, duke plotësuar kushtet e nevojshme të namazit, mund ta përmbushë aspektin e jashtëm të tij. Megjithatë, nuk është e mundur të thuhet një gjë e tillë edhe për aspektin e brendshëm të namazit. Në fakt, edhe pse mund të vërejmë ngjashmëri mes anës së jashtme të namazeve të njerëzve të mëdhenj si Pejgamberi ynë (s.a.s.), Ebu Bekri (r.a.) apo Bediuzamani dhe asaj të namazeve të një njeriu të zakonshëm, namazet e tyre janë shumë të ndryshëm në aspektin e brendshëm. Kallëpët e anës së jashtme të

⁸² Muslim, mesáxhid 150; Tirmidhí, de’auát 127; Nesái, iftitáh 8.

namazit janë të qartë, por në çështjen e anës së brendshme të namazit nuk mund të flitet për ndonjë kallëp. Për shembull, mund të thuhet se, nëse e lani tri herë fytyrën gjatë marrjes së abdesit, e keni kryer plotësisht këtë shtyllë. Mirëpo, kur vjen puna tek ana e brendshme e namazit, një gjë të tillë nuk mund ta thoni. Kjo situatë varet krejtësisht nga lidhja dhe marrëdhënia e robit me Zotin e tij.

Namazi i vërtetë është pasqyrimi dhe shfaqja e natyrës njerëzore. Profeti ynë (s.a.s.), në një hadith të tijin, thotë kështu: *“Çdo ditë, është e nevojshme të jepet një sadaka (lëmoshë) për çdo nyje tuajën. Çdo tesbih (subhánalláh) është një sadaka. Çdo tahmíd (elhamdulil’láh) është një sadaka, çdo tehlíl (Lá iláhe il’lallah) është një sadaka, çdo tekbír (Alláhu Ekber) është një sadaka. Emri bil maruf (urdhërimi për të mirën) është një sadaka, nehy anil munker (ndalimi i së keqes) është një sadaka. Falja e një namazi dyrekatësh në kohën mes mëngjesit dhe drekës është e barasvlershme me të gjitha këto sadaka.”*⁸³

Njeriu, duke vrapuar për të dalë gjithë përlësi para Allahut në kohën kur është më së shumti i zënë me punë dhe ndihet i freskët e energjik, e ndien thellësisht vlerën e nyjeve që i ka dhënë Allahu. Ja, pra, ky namaz, i falur në kohën mes mëngjesit dhe drekës, mund të bartë një vlerë të barabartë me falënderimin për të gjitha nyjet që na ka mundësuar Allahu në trupin tonë. Edhe namazet e falura në pesë kohët e përcaktuara të ditës mund t’i përgjigjen fillimisht këtij falënderimi.

Nëpërmjet namazit i shfaq njeriu të gjitha mirësitë që ia ka mundësuar Zoti i Madhëruar në këtë botë. Për këtë arsye, në botën tjetër, namazi do të marrë trajtën e njeriut. Në momentin kur personi të vendoset në varr, namazi do t’i shfaqet atij si një njeri me fytyrë të bukur e të këndshme dhe do t’i prijë atij. Nëse dikush dëshiron që, në botën tjetër, namazet e tij t’i shfaqen atij në trajtën e një njeriu të rregullt, duhet t’i falë namazet me kujdes e në përputhje me kushtet, veçoritë dhe thellësitë e brendshme të tyre.

Për shembull, kuptimi i lutjes *“et’Tehijjátu”* është dhënia selam Allahut Fuqplotë me gjuhën e robërisë sonë ndaj Tij dhe në përshtatje

⁸³ Muslim, salátul musáfirín 84.

me madhështinë, lavdinë dhe bukurinë e Tij, sepse Ai na ka ushqyer e na ka bekuar me tërë këto të mira. Me idenë se duhet t'i përgjigjem Zotit me adhurim e falënderime, duke menduar gjithashtu se unë jam zero, kurse Ai i pafund, dhe se nuk m'i ka borxh bekimet dhe të mirat që m'i ka dhënë e po m'i jep akoma, por jam unë ai që është borxhli përballë gjithë këtyre mirësive, duhet të pranoj se është e drejta e Tij t'i drejtohem me *"et'Tehijjátu"*. Njeriu, nëse nuk i ndien plotësisht këto ide e mendime kur është duke u falur vetëm, mund t'i përsërisë këto fjali, madje deri në dhjetë herë, në mënyrë që të arrijë ta ndiejë namazin që po fal. Kjo është detyra ime, por edhe e drejta e Allahut. Në qoftë se nuk tregoj përpjekje për ta thënë këtë kështu, do të thotë se po bëj një padrejtësi shumë të madhe dhe se po e lë pas dore kryerjen e kësaj detyre. Kjo gjë, ashtu si për lutjen *"et'Tehijjátu"*, vlen edhe për shtyllat dhe pjesët e tjera të namazit. Ustadi, gjatë namazeve që falte vetëm, çdo fjalë e përsëriste derisa ta ndiente atë thellësisht brenda vetes. Mirëpo, në rastet kur një person është duke e falur namazin si imam para një xhemati, të vepruarit në këtë mënyrë mund të shkaktojë turbullira në mendjet e të tjerëve.

Zoti i Madhëruar thotë: ***"Me të vërtetë, janë të shpëtuar besimtarët..."*** Ndërsa në vazhdim, si cilësi të parë të këtyre besimtarëve që kanë arritur shpëtimin, përmend faljen e namazeve me ndjenjën e *hushú-së*, me zemrat të dorëzuara tek Allahu, me vetëdijen e *ihsanit* dhe duke menduar faktin se Allahu i shikon ata në çdo çast. Të gjithë duhet të kontrollojnë ndërgjegjet e tyre, nëse janë apo jo në gjendje ta trajtojnë këtë mesele brenda kësaj kornize. Që të arrijë këtë nivel, njeriu fillimisht duhet të besojë se veprat e tij do të paraqiten në botën tjetër para të gjithëve. *"Punoni, se Allahu, i Dërguari i Tij dhe besimtarët do të shohin punën tuaj."*⁸⁴ Ky ajet na tregon rrugën që duhet të ndjekim në lidhje me këtë temë. Veproni në atë mënyrë, që veprat tuaja të jenë të denja për t'iu paraqitur Allahut, Profetit dhe besimtarëve që kanë besuar me të vërtetë. Siç mund të kuptohet nga ajeti i mësipërm, njeriu duhet të mundohet për t'i bërë sa më mirë të jetë e mundur veprat dhe punët e tij, qofshin ato punë e vepra të kësaj dynjaje apo nga ato që

⁸⁴ Surja Teube, ajeti 105.

kanë të bëjnë me botën tjetër. Jetesa e të Dërguarit të Allahut (s.a.s.) e vërteton më së miri këtë fakt. Sipas fjalëve të Nënës sonë, Aishes (r.a.), Ai (s.a.s.), kur kishte për të bërë ndonjë punë, e kryente atë në mënyrë të përsosur, pa lënë asnjë boshllëk.⁸⁵ Një besimtar, i cili e ka për detyrë t'i bindet e të ndjekë Profetin e tij, duhet të veprojë në një mënyrë të atillë, që veprat e tij të mos vihen në pikëpyetje dhe të mos sjellin nga pas kritika. Duke qenë se namazi është më i miri mes gjithë veprave të njeriut dhe se nuk ka diçka më të madhe se ai, do të thotë se çdo namaz që falim gabim dhe me mangësi hap tek ne nga një të çarë.

Pasi ta kemi besuar këtë në këtë mënyrë, jemi të detyruar t'i falim me kujdes e gjithë përkushtim namazet tona. Ndoshta do të hasni ca vështirësi në fillim, do ta sforconi veten. Por, me kalimin e kohës, ai do të bëhet pjesë e natyrës suaj. I Dërguari i Allahut (s.a.s.), i Cili për umetin parapëlqente gjithmonë atë që ishte më e kollajtë, - sipas fjalëve të Ibn Mesudit (r.a.) – aq shumë e zgjaste namazin, me aq përsosmëri përpiqej ta kryente atë kur falej vetëm, saqë, për njerëzit e tjerë, të vepruarit në mënyrë të tillë ishte mjaft e vështirë.⁸⁶ Por, kur falej bashkë me të tjerët dhe e drejtonte Ai (s.a.s.) namazin, nuk ua vështirësonte atyre faljen e namazit.

Po, një person që dëshiron t'i falë namazet e tij në kuptimin e tyre të vërtetë do të sforcohet ca dhe do ta ketë pak të vështirë në fillim. Ndonjëherë do të shfaqë veprime artificiale e të shtirura, ndonjëherë tjetër të sforcuara. Mirëpo, pas njëfarë kohe, ai do t'ia dalë ta kryejë namazin në përputhje me thelbin dhe të vërtetën e tij, e cila, në Kuran, përshkruhet nëpërmjet fjalës “*ikáme*”.

b. Thellimi në namaz

Njeriu, ndryshe nga engjëjt apo qeniet shpirtërore, është një krijesë që zotëron edhe anën e tij trupore. Edhe pse shpeshherë flitet për sundimin e shpirtit te njeriu, në të shumtën e kohës ai jeton nën

⁸⁵ Muslim, salátul musáfírín 141; Tirmidhí, salát 348; Ebú Dáúd, tatavvu 26; Nesái, kible 13, kijámul lejl 2, 64.

⁸⁶ Buhári, tehexhxhud 9; Muslim, salátul musáfírín 204.

trypsinë e trupit dhe anës trupore të tij. Për këtë arsye, nuk është gjithmonë në gjendje t'i ndiejë thellësisht namazin dhe adhurimet e tjera teksa i kryen ato.

Në fakt, duke iu drejtuar të Pafundmit, është e mundur që të kapet një ndjesi, një intuitë dhe një përhitje e pafund. Nuk ka kufij në gjërat që bëhen për të arritur tek Zoti, për ta ndier Atë dhe për t'u thelluar sa më shumë në këto çështje. Sepse Individualiteti i Allahut të Plotfuqishëm është i pafund dhe, po ashtu, mund të flitet për një pafundësi edhe në çështjet që kanë lidhje me Të. Ekziston mundësia që njeriu të ndiejë gjëra të ndryshme në çdo namaz që fal. Në namazet e falura në rrugën për të arritur tek Ai, nuk mund të bëhet fjalë për një ngopje, për shndërrimin e veprimeve në rutinë apo zakone, për arritjen e një fundi. Nëse ndodh diçka e këtillë, kjo na përket neve dhe nefsit tonë. Çdo pandjeshmëri, bezdisje apo mërzitje që mund të na kaplojë në lidhje me namazin vjen jo nga namazi, por si rezultat i dobësisë dhe mangësisë, të cilat i përkasin këndvështrimit tonë. Ne jemi njerëz me aftësi të kufizuara në çështjet e të parit, të ndierit dhe të të perceptuarit. Ai e shpalos veten para nesh me një pasqyrim të ndryshëm në çdo çast. Por, ngaqë nuk i mendojmë këto – çështë e vërteta, një çështje themelore e punës sonë është edhe meditimi – dhe ngaqë nuk i qasemi në këtë mënyrë kësaj meseleje, edhe gjërat më të gjalla, më tërheqëse dhe më shumëngjyrëshe, befash, në sytë tanë ngurtësohen e zbehen. Kështu, nuk arrijmë t'i ndiejmë ato çfarë duhen ndier; çdo gjë ngecte format dhe pamja e jashtme. Duket sikur jemi duke falur namazin, ulemi dhe ngrihemi, por namazi që falim nuk është namaz në kuptimin e tij të vërtetë. Kryesorja është falja e namazit duke ndier thellësinë karakteristike të çdo pjese përbërese të tij.

Robi, teksa nga njëra anë është duke marrë abdes, nga ana tjetër duhet të thellohet në mendimet e tij. Ai mendon se, bashkë me ujin që rrjedh nga gjymtyrët e tij, shpëton edhe nga papastërtitë e gjynaheve. Aq sa vepron me një ndjeshmëri maksimale që të mos stërpiket nga ky ujë, në një kuptim, i ndotur me gjynahe. Kur lan fytyrën, duhet të mendojë në këtë mënyrë: “Fytyra po më pastrohet nga ato gjëra që

mund të më nxjerrin faqezi në botën tjetër, po më zbardhet. Zoti im, në atë ditë kur një pjesë e fytyrave do të jenë jashtëzakonisht të bardha e një pjesë tjetër sterrë të zeza, më bëj edhe mua nga faqebardhët!”

Është shumë e rëndësishme që të gjitha këto të ndihen thellësisht, veçanërisht në pikën e përqendrimit në namaz. Nëse do t’i falni namazet duke u zhytur në ndjesi kaq të thella, para jush mund të hapet një derë e ndryshme çdo ditë. Në një moment, mund ta ndieni meselenë brenda një thellësie komplet ndryshe, jashtë atyre çfarë keni parë e përjetuar deri atëherë. Ndonjëherë mund t’ju hapet një derë ndërsa po qëndroni në kijam, ndonjëherë në ruku, ndonjëherë në kavme (qëndrimi në këmbë pas ngritjes nga rukuja) e ndonjëherë tjetër në sexhde. Por, që t’ju hapet ajo derë, ju duhet të jeni gjithmonë pas saj, ta kërkonti atë. Nëse nuk do ta keni dorën tek tokmaku i derës, nëse zemra juaj nuk do të jetë gjatë tërë kohës me Të, dyert nuk do të hapen. “Namazet që falim pa i ndier këto, asnjë vlerë nuk kanë?” Në qoftë se do të bëni një pyetje të tillë, mund t’ju them se, me një namaz të këtillë, ju e keni shlyer borxhin tuaj karshi Zotit dhe – në dashtë Allahu – në anën tjetër nuk do të jeni përgjegjës. Por nuk do të keni arritur tek e vërteta e namazit. Namazi na është caktuar nga Allahu, që ta falim duke e ndier atë, sikur të jemi duke pirë një gotë sherbet gllënjë pas gllënjke; namazi është një dhuratë e qiejve për banorët e tokës.

Por mundet që shpirti dhe kuptimi i namazit të mos shfaqen menjëherë. Një njeri që ka mundur të zbulojë shpirtin e namazit ka dëshirë të hidhet e të qëndrojë në namaz edhe kur është i zënë me më të ëmblën punë, sepse ai merr kënaqësi nga namazi. Edhe pse jo gjithmonë, shumë herë thotë kështu: “Ah, sikur jeta të mos mbaronte kurrë dhe unë të qëndroja kështu gjithmonë, në këmbë!” Por, që të arrihet kjo, njerëzve mund t’u duhen ndonjëherë njëzet, ndonjëherë tridhjetë e ndonjëherë tjetër dyzet vjet. Qëndron me përlulje tek ajo derë për dyzet vjet dhe vetëm atëherë arrin ta ndiesh namazin e vërtetë.

Në një ajet të Kuranit Famëlartë thuhet kështu: **“Prandaj, përmende**

emrin e Zotit tënd dhe përkushtojë krejtësisht Atij!⁸⁷ Ngaqë foljet në këtë ajet janë në formën “*tefa’ul*”, ato shprehin një detyrim. Fillimisht, ky ajet i drejtohet kështu Profetit tonë (s.a.s.). Por Profeti ynë, me kalimin e kohës, arrin në një gjendje të atillë, për të cilën shprehet kështu: “*Dëshirën që ju ndieni ndaj të ngrënit, të pirit dhe marrëdhënies seksuale, unë e ndiej ndaj namazit.*”⁸⁸ Po ashtu edhe njeriu, nëse tregohet mjaftueshëm këmbëngulës në këtë çështje, nëse bën durim dhe pret që t’i hapet edhe atij velloja e kuptimit të namazit, dhe, në fund, nëse i thonë atij “Në Xhenet, sofrat qenkan përgatitur për ty”, ai do t’ua kthejë atyre në këtë mënyrë: “Të fal njëherë namazin, vetëm atëherë mund të vij. Unë nuk mund ta sakrifikoj namazin tim.” Madje, sikur t’i vijë edhe Azraili (a.s.), për t’i marrë shpirtin, edhe atij do t’i thotë kështu: “Në qoftë se do t’më lejosh, le ta fal namazin e vaktit që ka hyrë, të mos më ikë. Mandej, bëj ç’të duash me mua.” Pra, me kalimin e kohës, te njeriu zhvillohet një gjendje e tillë shpirtërore, saqë mendon për namazin dhe përpiqet ta falë atë edhe në çastet kur ndodhet në prag të vdekjes.

Çdo pjesë e namazit është jashtëzakonisht tërheqëse dhe tepër e këndshme. Jam i mendimit se, nëse do t’i bënit një monument namazit, përballë jush do të dilte një monument i pakrahasueshëm me statujat e ndryshme kudo nëpër botë. Do t’ia ngulnit sytë atij dhe do ta shikonit përgjatë gjithë jetës. Në lidhje me këtë temë, ekziston edhe një hadith, i cili e përforcon këtë mendim timin: *Në botën e varrit, namazi do të marrë pamjen e njeriut. Në qoftë se ai është kryer pa ndonjë mangësi, në një mënyrë të patëmetë, do t’i shfaqet të zotit në trajtën më të bukur të mundshme.*⁸⁹

Sipas asaj që shpjegohet në një hadith tjetër, një ditë, në Xhaminë e Profetit vjen një beduin dhe fal namazin. Pejgamberi ynë (s.a.s.) i drejtohet atij duke thënë: “*Ti nuk fale namaz.*” Beduini ngrihet dhe e fal edhe një herë tjetër namazin, ama në të njëjtën mënyrë. Profeti (s.a.s.) i thotë përsëri: “*Ti nuk fale namaz.*” Dhe, kur beduini thotë “O, i Dërguari

⁸⁷ Surja Muzzemmil, ajeti 8.

⁸⁸ Taberání, el Mu’xhemul kebír 12/84.

⁸⁹ Taberání, el Mu’xhemul kebír 3/263.

i Allahut, unë nuk di mënyrë tjetër.” Profeti ynë, duke i shpjeguar se si duhet vepruar në kijam, në ruku dhe në sexhde, i tregon atij për mënyrën e duhur të kryerjes së namazit.⁹⁰ Sepse, nëse nuk e shfaqni namazin në përputhje me thelbin, kuptimin e tij të vërtetë, do të thotë se e keni çuar dëm atë. Në një situatë të tillë, nuk mund të jeni të sigurt në lidhje me atë që mund të ndodhë në vazhdim. Nga do e dini ju se namazi, teksa ndahet prej jush, nuk do të thotë nëpërmjet shpirtit të tij “Ashtu siç më çove ti dëm mua, ashtu vepruftë edhe Allahu me ty!”?

Një person që ka dalë imam dhe po e fal namazin bashkë me disa persona të tjerë, duke marrë parasysh faktin se mes tyre mund të ketë njerëz të dobët fizikisht apo të sëmurë, gra dhe fëmijë, mund ta mbajë namazin, ndoshta, në nivelin minimal të tij. Por me këtë nivel minimal nuk nënkuptoj atë që bëjnë sot disa, të cilët, aty ku duhet thënë “*Subhánalláh, Subhánalláh, Subhánalláh*”, thonë “*sub, sub, sub*”. Për shembull, sipas disa dijetarëve të fikhut, është kusht që në ruku të thuhet një herë “*Subháne Rabbijel Adhím*”, por duke ia dhënë hakun kësaj fjalie, duke e shqiptuar mirë e bukur secilën fjalë të saj. Ndërsa sipas disa dijetarëve të tjerë, ajo duhet thënë së paku tri herë. Për këtë arsye, këto tesbihe duhet t’i themi të paktën nga tri herë në ruku dhe sexhde, me ngadalë dhe duke i shqiptuar tamam fjalët e tyre. Leximi shpejt e shpejt i *Fatihasë* nuk është lexim Kurani. Sepse Kurani nuk ka zbritur në atë mënyrë. Rrjedhimisht, nuk është namaz as namazi që falet me një lexim të tillë të ngutshëm të *Fatihasë*. Me ajetet e Kuranit të lexuara në një frymë, madje, me telashin për ta përfunduar suren akoma pa mbaruar ajo frymë, nuk quhet se e ke përmbushur farzin e leximit të Kuranit në namaz. Fjalët janë kallëpët e kuptimeve, ama kallëpi duhet të jetë i përshtatshëm për kuptimin.

Të lexosh Kuran në namaz do të thotë të lexosh duke ia dhënë hakun fjalëve dhe duke u përpjekur t’i ndiesh kuptimet e tyre. Nëse kjo nuk realizohet, të njëjtat fjalë mund të përsëriten 3, 5, 7, 9 ose 11 herë, derisa të ndihet kuptimi. Hudhejfe (r.a.), kur shpjegon namazin e të Dërguarit të Allahut (s.a.s.), thotë kështu: “Vajti në ruku; rukuja nuk

⁹⁰ Buhári, edhán 95, 122, istidhán 18, ejmán 15; Muslim, salát 45.

zgjati më pak se kijami i Tij. (Në kijam kishte lexuar suret Bekare, Ál Imrán dhe Nisá.) U drejtua nga rukuja. Qëndrimi në këmbë nuk zgjati më pak se rukuja. U ul në sexhde, sexhdeja e Tij nuk zgjati më pak se qëndrimi në këmbë pas rukusë.⁹¹ Një përpjekje të tillë duhet të tregojë robi kur është duke u falur vetëm. Përderisa namazi është një adhurim shumë i rëndësishëm, përderisa është miraxhi i besimtarit, përderisa anija e fesë nëpërmjet tij lëviz, atëherë, ai duhet kryer duke i dhënë hakun. Sepse t'i japësh hakun kësaj pune, në të njëjtën kohë do të thotë të fitosh të drejtën e të qenit me vullnet të fortë.

c. Namazet plot respekt dhe frikë

Namazi, në varësi të mbushjes dhe pastërtisë sonë të brendshme, merr një trajtë të dëlirë e të kulluar edhe në sytë e Allahut. Kur e fal namazin i mbushur plot me frikë e respekt ndaj Allahut, kijami, rukuja, sexhdeja dhe çdo pjesë tjetër e tij, tek Allahu, shndërrohen në hapat që hidhen gjatë ngjitjes për në miraxh. Ne, kur përpiqemi të sqarojmë anën e jashtme të meselesë, përdorim fjalët “ulje-ngritje” dhe, në fakt, ajo çfarë bëjmë në namaz me këto dy fjalë mund të përmblihet. Por këto ulje-ngritje, duke u bashkuar me respektin dhe frikën e brendshme, fitojnë një vlerë të madhe tek Allahu, lartësohen në një vlerë mbi të gjitha vlerat e tjera. Sepse namazi është vepra më e vlefshme tek Allahu; nëse do të kishte diçka më me vlerë se ai, me përgjegjësinë e kryerjes së asaj gjëje pesë herë në ditë do t'i ngarkonte Allahu (*xhel'le xheláluhu*) robërit e Tij.

Zoti i Madhëruar, duke e ngarkuar secilin prej engjëjve, që i ka krijuar si robërit e Tij të nderuar të qiejve, me detyrën e kryerjes së vetëm një pjese të namazit, ka treguar edhe vlerën që i jep atij. Ka engjëj aq madhështorë, por që janë ngarkuar vetëm me detyrën e qëndrimit në kijam. Vetëm ky kijam bilé u mjafton dhe u tepron atyre për të arritur një gradë të lartë tek Allahu. Po ashtu, ka engjëj të atillë, të cilëve u është caktuar vetëm detyra e përthyerjes së mesit dhe qëndrimit në

⁹¹ Muslim, salátul musafirin 203; Ebú Dáúd, salát 155.

ruku para Prezencës Hyjnore. Dhe kjo detyrë është e një natyre të atillë, që do t'i ngrejë gradat e tyre gjer në Arshin e Madh. Ka gjithashtu edhe engjëj që bëjnë vetëm sexhde.

Me pak fjalë, çdo grup engjëjsh, duke i dalë për zot një pjese të namazit, noton dhe përparon drejt Fronit të Përsosmërisë ose drejtimit që e kënaq Zotin. Ja, pra, Zoti i Madhëruar, i Cili ua bëri engjëjve namazin shkak për të shprehur robërinë e tyre ndaj Tij, ia dha atë, me të gjitha shtyllat dhe pjesët e tij, umetit të Muhamedit. Prandaj, njeriu duhet të përmbushë dhe të kryejë siç duhet çdo pjesë të namazit, duke i bërë ato brenda një atmosfere sikur të ishte duke u kapur për shkallësh në ngjitjen e tij drejt gradave më të larta. Sepse ky adhurim, i cili i lartëson engjëjt për në Fronin e Përsosmërisë, do t'ia mundësojë edhe atij ngritjen në atë pozitë. Për rrjedhojë, namazi, që do ta ngrejë robin në një pozitë të këtillë, nuk duhet parë si diçka e përbërë nga ca formalitete, nuk duhet kryer sikur të jesh duke hedhur një barrë nga kurrizi. Përkundrazi, duke dalë para Prezencës Hyjnore brenda atmosferës së kryerjes së një meseleje shumë serioze, duke qëndruar aty gjithë respekt e përlulje që nga çasti i këndimit të ezanit dhe duke u përpjekur për të mos rënë në hutesë për aq kohë sa ndodhemi para Allahut, namazin duhet ta kryejmë në një gjendje meditimi dhe emocioni të brendshëm.

Namazi është një akt nderimi, përluljeje, respekti të brendshëm dhe mirësjelljeje. Për sa kohë të kryhet në këtë kuptim, ai do t'i sjellë një dëlirësi botës sonë të brendshme, ndërsa ideve dhe mendimeve tona, drejtimin e duhur. Namazi i falur jashtë kësaj vetëdijeje dhe botëkuptimi nuk është gjë tjetër veçse një barrë mbi shpinën e njeriut dhe një lodhje për të; në një situatë të këtillë, as që bëhet fjalë të mundësojë afrimin, ai bëhet shkak për largimin nga Allahu. Pejgamberi ynë (s.a.s.) ka thënë: *“Nëse namazi nuk e largon një person nga imoraliteti dhe e keqja, atëherë ai namaz nuk shërben për asgjë tjetër veç largimit të atij personi nga Allahu.”*⁹² Namazi në vetvete nuk e largon njeriun nga Allahu; ai bëhet shkak për largimin e personit nga Zoti ngaqë personi në fjalë

⁹² Taberání, el Mu'xhemul kebír 11/54.

nuk ka mundur të shkëputet nga injoranca, nuk ka mundur t'i shpëtojë hutesës e të kapërcejë vetveten dhe, për rrjedhojë, nuk ka mundur t'ia dorëzojë zemrën Zotit as aty ku duhet bërë diçka e tillë. Kështu që, kur kryen namazin, robi duhet të tregohet i kujdesshëm dhe ta kryejë atë sikur të jetë duke u kapur pas një litari drite; nëse i rrëshqet këmba, nëse hutohet për një moment, ai menjëherë do ta kthejë shikimin drejt botës sublime, do të zhytet në soditjen e asaj bote dhe, në këtë mënyrë, do ta përmbushë detyrën e të qenit rob i Zotit.

Halef ibn Ejubi është një nga dijetarët më të mëdhenj të fushës së hadithit dhe fikhut. Ai, kur qëndronte në namaz, nuk bënte as më të voglën lëvizje që nuk kishte lidhje me namazin, madje, as atëherë kur e pickonin bletët; në përfundim të namazit, kur i thoshnin “Të pickoi bleta, kurse ti nuk lëvize as dorën; në fytyrën tënde qëndroi një mizë, ti nuk tunde as kokën.”, ai përgjigjej kështu: “Një herë e një kohë, pata hasur në ca gjynahqarë të mjerë, të cilët po i tregonin njëri-tjetrit gjithë krenari për faktin se nuk kishin nxjerrë fare zë, madje nuk kishin bërë as “gëk” përballë fshikullimeve me kamxhik pasi padishahu kishte urdhëruar për dënimin e tyre me një mënyrë të këtillë. Po unë, që jam një rob i dobët dhe i pafuqishëm i Allahut, si mund të ndikohem nga bletët apo nga një mizë që ulet në kokën time ndërsa po kryej një miraxh si namazi!”

Aliut (r.a.) as përballë armiqve të tij në sheshin e betejës nuk i janë dridhur këmbët sa në namaz. Në luftën e Hendekut, kur Amr ibn Abdivud pati thënë “A nuk ka ndonjë që të dyluftojë me mua?”, edhe pse ishte në një moshë kur mund të quhej akoma fëmijë, i qe lutur me herë të tëra të Dërguarit të Allahut për të luftuar me të dhe, kur pati dalë përballë tij, nuk pati rënë pre e provokimeve të llojit “Ty të dërguan kundër meje? Nuk kishte të tjerë më të mëdhenj se ti? Gojës tënde i vjen era qumësht!”; nuk qe stepur as kur goditjet e kundërshtarit ia patën çarë më dysh mburojën e i patën shkaktuar një plagë në ballë; armikun e tij e pati shtrirë përtokë me Zulfikarin, atë shpatë që ia kishte dhënë i Dërguari i Allahut (s.a.s.). I tillë ishte përballë armikut Aliu (r.a.), nuk hezitonte kurrë, nuk kaplohej nga dyshimet, ishte gjithmonë

i vendosur. Kur shkante për të falur namazin ama, i ikte ngjyra, nuk e mbanin këmbët. Kur e pyesnin “O, prijësi i besimtarëve! Çështë kjo gjendje e jotja kështu?”, ai u përgjigjej me fjalët “A nuk e dini? Po shkoj të çoj në vend amanetin.”

Në Kuranin Famëlartë, Allahu (*xhel’le xheláluhu*) thotë kështu: **“Ne ua ofruam përgjegjësinë qiejve, Tokës dhe maleve, por ato nuk pranuan ta marrin përsipër dhe u frikësuan ta pranojnë atë, kurse njeriu e pranoi.”**⁹³ Kuptimi i këtij ajeti është ky: “Njeriu e mori përsipër unin, ndërgjegjen dhe aftësinë e të perceptuarit; ai e mori përsipër detyrën e nxjerrjes së kuptimeve që i përkasin Allahut nga mesi i gjërave e ngjarjeve dhe të ndërtimit të një hualli dijesh me to.” Ja, pra, ndërsa thirremi për në namaz pesë herë në ditë, vijmë para Zotit tonë për të përmbushur këtë detyrë. E, në fakt, ky ishte mendimi që e bënte Aliun (r.a.) t’i dridheshin këmbët.

Abdullah ibn Omeri (r.a.) – i mbështjellur nga ndjenja e peshës së detyrës – aq ngadalë ecte kur shkante për të falur namazin, saqë ata që e shihnin në atë gjendje thoshnin: “Nëse një milingonë do të nisej me të njëkohësisht, ajo patjetër që do t’ia kalonte.” Në të vërtetë, përballë një pune të rëndësishme që do të na bëjë të shqetësohemi seriozisht, ne kalojmë në një gjendje të atillë, saqë nuk shohim asgjë rreth e rrotull nesh, nuk njohim askënd. Ezani bën që në botën tonë shpirtërore të shpërthejë një kiamet i tillë; ngrihemi nga vendi, marrim ashtu siç duhet abdesin dhe përpiqemi të flakim tutje shkujdesjen sikur ftesa për të dalë para Zotit të jetë realizuar. Sepse disa minuta më pas do të qëndrojmë para Zotit tonë, qëndrim ky, që mbart kuptimin e dhënies së llogarisë për jetën. Sigurisht, nuk është aspak e përshtatshme të qëndrosh i hutuar dhe i shkujdesur në praninë e Zotit. Teksa qëndrojmë para Zotit, do t’i drejtohem Qabesë, do ta përfytyrojmë atë para nesh si guri-shenjë i kthimit tonë drejt Tij. Thënë ndryshe, do t’ia japim zemrën Zotit tonë, do të kthehemi nga Qabeja me zemrat dhe imagjinatën tonë dhe, mandej, do të përpiqemi të gjuajmë mëshirën dhe pëlqimin hyjnor.

⁹³ Surja Ahzáb, ajeti 72.

Po, një besimtar që vrapon drejt namazit me vetëdijen e ezanit, duke e imagjinuar Qabenë mu përballë vetes, përpiqet të kapë mëshirën dhe pëlqimin hyjnor. Sa e sa sulltanë kanë ardhur e kanë ikur përgjatë shekujve! Gjithmonë është e mundur që edhe ne të arrijmë të njëjtën gradë. Sepse gjendemi në një kohë dhe vend të atillë, ku njerëzit që thonë “Allah, Pejgamber, Kuran” janë të shumtë. Duke qenë se ndodhemi në një ambient të këtillë dhe të rrethuar nga një kësisoj atmosfere, mundësia që ne të jemi në gjendje për të ruajtur veten është e madhe. Megjithatë, kemi akoma shumë punë për të bërë. Nuk mund të thuhet se kemi arritur as një përqind të gradës që kanë arritur ata individë.

Si kryetar shteti, është shumë e vështirë të jesh një besimtar i mirë, të ngulësh shikimet në bukuritë e botës hyjnore ndërsa gjendesh i rrethuar nga shëmti të panumërta, të mos ngecësh te postet dhe rangjet e larta. Po ashtu, është shumë e vështirë që, si një padishah, të bësh komandantin e ushtrisë, të mbash nën kontroll ushtritë pushtuese, të ndërtosh shtetin dhe, në të njëjtën kohë, të kënaqësh edhe popullin. Sipas një transmetimi, Murati I (Murat Hudávendigár), kur lidhej në namaz duke marrë tekbirin fillestar, ngaqë nuk arrinte ta shihte Qabenë që në tekbirin e parë, vazhdonte me tekbiret derisa Qabeja t'i shfaqej para syve. Një ditë, i doli përballë mësuesit të tij dhe i tha: “Mësues! Mos kam bërë ndonjë mëkat, që nuk arrij ta shoh Qabenë që në tekbirin e parë? Jam në gjendje ta shoh vetëm pas tekbirit të dytë ose të tretë.” Murati I kujton se të gjithëve, duke përfshirë këtu edhe mësuesin e tij, u shfaqet përballë Qabeja sapo marrin tekbirin fillestar, që në çastin kur thonë “*Alláhu Ekber*”; ai kujton se është i vetmi person që nuk ka mundur ta arrijë këtë gradë!

Po, kjo është atmosfera e namazeve të njerëzve të lartë shpirtërisht. Ata, për të vendosur një marrëdhënie me mëshirën e Zotit, përfytyrojnë para syve të tyre si një gur-shenjë Qabenë, përfytyrojnë nën këmbët e tyre urën e Siratit, atë urë që ngrihet mbi Xhehenemin e fryrë nga flakët e shkëndijat në madhësinë e maleve dhe që mundëson kalimin për në Xhenet, dhe përballen me atë pamje të tmerrshme, përballë

së cilës edhe profetët do të thonë “Zoti ynë, na jep shpëtim!”. Duke imagjinuar në anën e tyre të djathtë Xhenetin me të gjitha bukuritë e tij marramendëse, Xhehenemin e tmerrshëm në të majtën e tyre dhe prapa tyre vdekjen, e cila ka zgjatur dorën për t’u ngulur thonjtë dhe që kushedi ku do t’i kapë, kryejnë përballë Zotit të tyre adhurimet, të mbërthyer nga një ndjenjë serioze frike, por edhe plot shpresë. Besimtari, për sa kohë të kapë e të ruajë këtë atmosferë në namaz, do të jetë në gjendje të qëndrojë larg çdolloj mëkati dhe imoraliteti. Në të kundërt, do të hajë shuplakën e fermanit “*Ka shumë nga ata që ngrihen (natën) për të falur namaz dhe që nga këto namaze në duar u mbetet vetëm privimi nga gjumi.*”⁹⁴

Si përfundim, mund të themi se namazi është një thellim i vetëdijes, një ndriçim i brendshëm dhe fitim i kënaqësisë së Zotit. Gjendja dhe sjelljet, gjatë të cilave brendësia e njeriut mbushet me frikë e shpresë, shpresë e tmerr, respekt e madhështi dhe të dridhurat pasohen nga rrëqethjet, përbëjnë *hushú*-në e brendshme të namazit. Vjen një moment dhe robit i bëhet sikur do t’i dalë zemra nga vendi, i duket sikur do të japë shpirt nga çasti në çast; në një moment tjetër kaplohet nga një shpresë e madhe dhe buzëqesh; ndonjëherë, duke e konsideruar si një paturpësi përkarshi Zotit gjendjen e tij të një momenti të caktuar, ndihet i turpëruar dhe e kap një sëkëlldi e paparë, “Unë nuk jam në gradën e të bërit naze.” thotë dhe, brenda një atmosfere të këtillë, kryen namazin e tij.

Po të vijmë tek ana e jashtme e *hushú*-së, ajo do të thotë që njeriu t’i kryejë brenda një morali serioz gjërat që do të thotë dhe do të bëjë në namaz. Për shembull, të këndohen me vetëdije ajetet që këndohen gjatë namazit, duke e ditur kuptimin e asaj që po thuhet; të kryhet rukuja ashtu siç shpjegohet në librat e fikhut; e njëjta gjë vlen edhe për sexhden dhe çdo pjesë tjetër të namazit. Namazi i besimtarit do të quhet namaz vetëm nëse do ta kryejë atë duke u tejmbushur përbrenda me këto ndjenja. Dhe, kështu, ai do të ketë mundësinë të nxjerrë në bregun e shpëtimit anijen e trupit të tij.

⁹⁴ Ibn Máxhe, sijám 21; Ahmed ibn Hanbel, el Musned 2/373.

d. Tre elementë të rëndësishëm në namaz

Pjesët e namazit si kijami, leximi i Kuranit, rukuja dhe sexhdeja shprehin vetëm aspektin e formës së tij. Por thelbësore në namaz dhe në pjesët përbërëse të tij janë përmbajtja dhe shpirti. Ashtu siç janë ngrënia dhe pirja të nevojshme për anën tonë trupore, po ashtu edhe namazi është ushqim për shpirtin tonë dhe jetën tonë shpirtërore. Namazi duhet shndërruar në një domosdoshmëri të karakterit tonë. Shpirti mund ta sigurojë ushqimin e tij vetëm nëpërmjet namazit të falur në këtë mënyrë.

Një pikë tjetër, ndaj së cilës duhet treguar kujdes në namaz, është kjo: Ashtu siç nevojitet të qëndrosh larg botës së mendimeve gjatë aktivitetit fizik për zhvillimin akoma më shumë të muskujve të trupit, me qëllimin për të mos e lodhur zemrën, po ashtu, për të zhvilluar shpirtin dhe për t'u shndërruar në një njeri krejtësisht i zemrës dhe shpirtit, është kusht që mendimet në lidhje me këtë botë të nxirren jashtë loje. Sigurisht, lidhja e ngushtë mes kryerjes së kujdesshme të formave të jashtme të namazit dhe kësaj përmbajtjeje nuk mungon.

Një pikë tjetër për t'u pasur kujdes në namaz është të vepruarit sipas sjelljeve të disave gjatë namazit. Një gjë e tillë nuk duhet bërë. Të tjerët mund të bëjnë veprime të ndryshme në namazet e tyre, mund të tundin dorën, krahun apo kokën. Kjo situatë nuk duhet t'i interesojë askujt, gjithësecili duhet të falë namazin e tij. Për më tepër, pavarësisht mënyrës së faljes së namazit nga ana e njerëzve, nuk duhet dyshuar për ta në çështjen e shlyerjes së borxhit karshi Allahut dhe nuk duhet hapur porta e mendimeve negative (*suizan*), të cilat, në fund të herës, do ta ngarkojnë njeriun me gjynahe. Pastaj, ne nuk jemi gjykues, që të mund të gjykojmë sjelljet dhe veprimet e të tjerëve.

Një çështje tjetër e rëndësishme është edhe kjo: Është e sigurt se gjendja shpirtërore brenda së cilës ndodhet robi dhe ngjarjet që zhvillohen përreth tij do të ndikojnë në namazin e tij. Por ai, duke qenë i vetëdijshëm për të gjitha këto, duhet t'i kapërcejë pengesat me vullnetin e tij dhe duhet ta drejtojë zemrën për te pika e përsosmërisë. Edhe në çastet kur është më i hapur ndaj bekimeve dhe begative, duhet

të përpiqet të mendojë vetëm për Atë. Për shembull, edhe sikur të hyjë mes tij dhe Allahut një gjendje ekstaze, e cila do ta bëjë të arrijë në Arshin e të Gjithëmëshirshmit, duhet të jetë në gjendje të thotë menjëherë “Jo, Zoti im! Unë nuk e dua këtë, më mjafton të jem si një nga këta që falin namaz.”

Një çështje e fundit është fakti se namazi i çdonjërit nga ne ndryshon sipas gradës në të cilën ndodhemi. Po t’ia shpjegoni ju namazin tuaj Imam Rabaniut, ekziston mundësia që ai të qeshë me ju. Ose, sikur Imam Rabaniu t’i tregojë Ibn Arabiut për namazin e vet, mbase edhe ai do të qeshë me të. Sepse dimensionet e çdonjërit prej tyre ndryshojnë shumë nga njëra-tjetra. Pikë e rëndësishme këtu është që, te njerëzit me mendime të cekëta në çështjen e namazit, t’u hapet rruga përfytyrimeve që kanë të bëjnë me namazin e vërtetë. Të lëshohesh në det edhe kur je vetëm sa një grimcë, të shndërrohesh nga një pikë uji në oqean... Dhe përtej kësaj, nëse na e mundëson Zoti ynë, të presim gjithashtu nga mëshira e Tij që të na bëjë të arrijmë ato grada, natyrën e të cilave ne as që e dimë në këtë moment.

e. Përqendrimi në namaz

Një besimtar që beson se bashkë me ujin e abdesit derdhen edhe mëkatet e tij, tendosjen metafizike që fiton nëpërmjet abdesit e vazhdon edhe gjatë kohës kur është duke dëgjuar ezanin; madje e shton akoma më shumë atë. Dhe, duke falur menjëherë pas ezanit namazet sunet, arrin në thellësi të ndërthurura me njëra-tjetrën. Meqenëse namazet sunet dhe nafile janë *“xhebran lin’nuksan”*, pra, plotësojnë mangësitë e namazeve farz dhe mbushin boshllëqet e krijuara mes tyre; meqenëse Zoti i Madhëruar, me fjalët *“Robi im nuk mund të më afrohet Mua me ndonjë vepër tjetër më të dashur se adhurimet që ia kam bërë obligim. Robi im, i cili i kryen farzet, vazhdon të afrohet tek Unë nëpërmjet nafileve. Aq sa Unë filloj ta dua atë. Kur Unë e dua robin tim, bëhem veshi i tij që dëgjon, syri i tij që sheh, dora e tij që kap...”*⁹⁵, u ka premtuar një afrimitet

⁹⁵ Buhári, rikak 38; Ahmed ibn Hanbel, el Musned 6/256.

ekstra atyre që kryejnë nafilet, besimtari përfundon faljen e namazit sunet duke i menduar këto dhe duke e shprehur me gjendjen e tij kërkesën për një afrimitet surprizë me Zotin. Në këtë mënyrë, ai arrin të bëjë një hap shumë të rëndësishëm drejt sigurimit të përqendrimit, të përshkojë edhe distancën e fundit në rrugën e shkrirjes e të bërit njësh me namazin dhe të kalojë në gjendjen e të qenit gati për faljen e namazit farz.

Për një rob kaq të kujdesshëm dhe të ndjeshëm, as që bëhet fjalë ta lërë në pritje namazin. Përkundrazi, ai vihet në pritje të namazit. Dhe kjo gjë është thelbësore për të. Duke marrë abdes para fillimit të namazit, madje, edhe para se të këndohet ezani, dhe duke u tendosur në shoqërinë e ndjenjave të shprehura nga fjalët “Jam plotësisht gati, Zoti im! Në momentin që Ti të kthesh shikimin tek unë, do të shohësh se shikimet e mia janë të drejtuara drejt Teje.”, pret ardhjen e komandës “Hajde, tani mund të dalësh para Meje.”. Zaten, nëse robi nuk ia ka dalë të kapë një tendosje metafizike përgjatë vargut të përgatitjeve që fillojnë që para marrjes së abdesit dhe vazhdojnë deri tek ezani dhe namazi sunet, do të thotë se në këtë punë ka diçka që nuk shkon. Por, edhe në qoftë kështu, është muezini ai që, duke thirrur ikametin para fillimit të namazit farz, lëshon goditjen përfundimtare mbi çdo gjë që e largon njeriun nga mendimet e adhurimit dhe e tërheq drejt gjërave të kësaj dynjaje. Dhe robi, që e ka plotësuar kështu përqendrimin e tij, i zhytur në mendimet dhe përfytyrimet më të thella të adhurimit, thotë “*Alláhu Ekber*” dhe lidhet në namaz.

Një anë tjetër e kësaj meseleje është kjo: Gjatë Shekullit të Lumturisë, urdhrat e Islamit, fesë sonë të lartë, zbrisnin të freskëta, sikur të ishin nga një sofër e begatë qiellore. Sahabët e nderuar njiheshin çdo ditë me adhurime nga më të ndryshmet. Fjala vjen, një ditë mësonin namazin, ditën pasardhëse dëgjonin ezanin. Dhe, kur ezani, duke kumbuar në veshët e tyre, lëshonte tek ata një rrëqethje dhe emocion krejt ndryshe, me një gjendje të atillë shpirtërore dhe gjithë entuziazëm e falnin namazin. Myslimanët e asaj periudhe kështu i shihnin gjërat që dëgjonin e mësonin: origjinale, plot zbukurime dhe goxha tërheqëse.

Lëshoheshin para forcës tërheqëse të këtyre bukurive marramendëse dhe sikur magjepseshin. Ata merrnin lajme nga përtej qiejve në çdo moment, çdo ditë përballeshin me një surprizë të re dhe jetonin në një lloj brezi surprizash që nuk kishin të ndalur. Vazhdimisht dëgjonin një sure të re apo një ajet të ri, me të laheshin, pastroheshin dhe, kështu, pajiseshin me ndjenja sublime.

Ja pra, me këto pajime qiellore e hyjnore dilnin para Allahut. Rrjedhimisht, atyre nuk u nevojitej një përpjekje apo mund shumë i madh për të arritur tendosjen metafizike, për të kapur përqendrimin e nevojshëm dhe për të qenë gati për kryerjen e adhurimit. Edhe pse nuk e kuptonin këtë gjë, për vetë faktin se vazhdimisht merrnin frymë në praninë e Profetit (s.a.s.) dhe të revelatës hyjnore, në mënyrë të pavullnetshme gjendeshin të mbushur me ndjesi shpirtërore dhe mendime për të përtejmen gjatë gjithë kohës. Dhe, në momentin kur thoshnin “Tani është çasti për të dalë para Zotit!”, ishin në gjendje t’i përqendronin të gjitha ndjenjat e tyre, edhe ato më të hollat, tek adhurimi.

Sa për ne, duke qenë se jemi shumë larg Shekullit të Lumturisë, asaj periudhe kur qielli zbrazte si rrebesh shpalljet hyjnore, nuk mund ta arrijmë atë përqendrim dhe pajim shpirtëror në mënyrë të pavullnetshme. Për rrjedhojë, jemi të detyruar ta kapërcejmë distancën midis nesh dhe atij shekulli nëpërmjet përpjekjes, vigjilencës në vullnetin tonë dhe vendosmërisë sonë. Duhet të përpiqemi për ta ndier origjinalitetin në thelbin e fesë, duke i stimuluar në mënyrë të vullnetshme mendimet dhe përfytyrimet tona. Nëse dëshirojmë ta falim namazin në shoqërinë e ndjenjave më sublime dhe të mendimeve sa më të gjera e të thella, ashtu si sahabët dhe të parët tanë të virtytshëm, jemi të detyruar t’i japim hakun vullnetit tonë edhe në këtë pikë.

Po, ne duhet të shohim se si të jemi gjithmonë plot ndjenja e mendime të pastra; edhe atëherë kur po shkojmë drejt namazit, duke filluar që para marrjes së abdesit, në drejtim të këtyre mendimeve dhe përfytyrimeve të dëlira duhet të përparojmë gjithmonë. Për shembull, fjalët tona të fundit para lidhjes në namaz duhen thurur rreth bisedës

për të Dashurin; duhet të flasim rreth një teme në lidhje me Të, për t'i bërë zemrat të ngrihen qirithi. Duhet të mendojmë për çështjet e shprehura nga miqtë e Allahut në lidhje me namazin dhe, kështu, duhet t'i mbërthejmë në mënyrë të vullnetshme ndjenjat dhe mendimet tona te namazi.

Nga ky këndvështrim, largimi ynë nga çdo gjë tjetër përpos Zotit dhe përqendrimi në namaz duke u përgatitur më së miri duket goxha i vështirë. Megjithatë, nuk duhet harruar se sa më shumë vështirësi të ketë një punë, sa më shumë e mundimshme të jetë të mësuarit me të, po aq të shumta janë edhe sevapet që përfitohen prej saj. Për këtë arsye, fjalia “Shpërblimi merret sipas vështirësisë.” është bërë një fjalë e urtë e njohur. Po, sa më shumë të merremi me punë të vështira, sa më të rrëpirta të jenë malet te të cilët ngjitemi, po aq i madh do të jetë edhe shpërblimi ynë. Kështu që, në rrugën për t'u mbushur me ndjenja të bukura dhe për t'i ndier plotësisht adhurimet, po në atë masë do të jetë edhe shpërblimi i një abdesi që do të marrim pa i lënë gjë mangët dhe duke i përballuar vështirësitë me vullnet të plotë.

f. Namazi i lamtumirës

Njeriu duhet ta falë namazin në një mënyrë të atillë, saqë namazi i tij të bëhet shembull edhe për të tjerët dhe sexhdeja t'i shndërrohet në një gëzim me të cilin nuk di të ngopet, lutjet në një ushqim që nuk i shkakton mërzi robit, rukuja në një akt të veçantë, kurse leximi i Kuranit në një harmoni fjalësh të gjalla.

“Fale namazin sikur të ishte namazi i lamtumirës!”⁹⁶ Kështu urdhëron Lajmëtari Fjalëdrejtë (s.a.s.). Sa me kujdes dhe përkushtim do ta falnit atë namaz nëse do t'iu thoshnin se iu ka mbetur aq jetë sa për të falur vetëm një namaz! E pra, kështu duhet ta falni çdo namaz. Po, namazi që falet duke sjellë në mendje fjalët “Ky mund të jetë namazi im i fundit.” është namazi i lamtumirës.

⁹⁶ Ibn Máxhe, zuhd 15; Ahmed ibn Hanbel, el Musned 5/412.

Po, namazi është gjëja më e bukur që mund të bëjë njeriu në jetën e tij dhe ashtu duhet të jetë. Kujtimet më të ëmbla të jetës në lidhje me namazin duhet të jenë. Sepse nëpërmjet namazit bëhet e mundur ngjitja në miraxh. Përmes namazit arrihet tek Allahu, para profetëve nëpërmjet namazit dilet.

g. Tre nivelet e namazit

Ne mund ta gjykojmë namazin në tre nivele të ndryshme:

1. Namazi që kryhet si obligim: Në këtë nivel përfshihen namazet, kryerja e të cilëve është kthyer disi në rutinë dhe që kufizohen vetëm me përmbushjen e urdhrit të Zotit të Madhëruar. Duke marrë parasysh faktin se ekziston mundësia që një person të mos falë fare namaz, sigurisht, edhe ky është një nivel. Megjithatë, edhe pse shpëtojnë nga përgjegjësia e braktisjes së namazit, ata që zotërojnë një namaz të këtillë nuk janë në gjendje të përfitojnë plotësisht nga bekimet, begatitë dhe dobitë që sjell namazi.

2. Namazi që të mbron nga të këqijat: Namazi i mbron njerëzit nga imoraliteti dhe gjithë ato të këqija që feja i konsideron të shëmtuara. Po, Allahu i Plotfuqishëm i ka dhënë namazit një veçori të tillë. Por përfitimi në këtë masë nga namazi është i mundur me kapjen e shpirtit të namazit. Çdo namaz i falur me vetëdije dhe ndërgjegjshmëri të lartë e rrethon të zotin e tij si një atmosferë mbrojtëse dhe, në këtë mënyrë, nuk lejon që e keqja të gjejë ndonjë shteg dhe të arrijë tek ai. Profeti ynë (s.a.s.) e shpjegon këtë veçori të namazit duke dhënë si shembull pastrimin nga papastërtitë të personit që lahet pesë herë në ditë në lumin që kalon para derës së shtëpisë së tij.⁹⁷ Zaten, kjo veçori e namazit është ajo që na ruan e na mbron nga të këqijat, të cilat vërshojnë drejt nesh pa pushim. Në të kundërt, si do të ishte e mundur që shpirti ynë t'u bënte ballë kaq shumë shëmtive!

3. Namazi në dimensionet e miraxhit: Namazi, çdo minutë e të cilit të bën të fitosh vite të tëra, është namazi me nuanca miraxhi. Kapja e

⁹⁷ Buhári, meuákítus'salát 6; Muslim, mesáxhid 283-284.

një namazi të tillë është shumë e vështirë, por jo e pamundur. Ky namaz u mundësohet vetëm shpirtrave të dalluar. Dhe, meqë qenka e mundur një gjë e tillë, të gjithë duhet të përpiqemi, të mundohemi të kapim një namaz të këtillë të paktën në ndonjë periudhë të caktuar të jetës sonë.

Këtu vlen të sjellim ndër mend edhe këtë: Namazi është, mbi të gjitha, një obligim; për rrjedhojë, edhe sikur të mos kryhet në nivelin dhe cilësinë e dëshiruar, duhet të falet patjetër. Të lësh namazin me pretekstin se nuk je në gjendje të falësh namaz cilësor e me nivel nuk është një shenjë vetëdijeje apo e të qenit i ndërgjegjshëm, përkundrazi, do të thotë të biesh në një situatë qesharake edhe për vetë djallin; besimtarët nuk duhet të lejojnë të vihen në lojë në këtë mënyrë.

Nga ana tjetër, namazi ka pjesët dhe kohët e tij të caktuara. Dhe askush nuk ka të drejtën e as autoritetin për të vepruar me to sipas dëshirave dhe tekave të veta personale. Ata që ia njohin vetes një të drejtë të tillë janë pa dyshim persona që i janë nënshtuar shejtanit, i cili u është afruar nga e djathta. Ajo që ata thonë është shenjë dhe dëshmi jo e shkencës, as e dijes, por e kësaj disfate përballë djallit.

h. Dashuruesit e namazit

Adhurimet si dhikri, duaja dhe namazi nafile duhen bërë në mënyrë të vazhdueshme dhe me këmbëngulje, që, me kalimin e kohës, të zhvillojnë te ne një natyrë të dytë. Për shembull, nëse mësoheni të falni katër rekate në vend të një namazi nafile dyrekatësh dhe vazhdoni ta falni rregullisht atë namaz, kur të vijë dita dhe të tentoni për ta lënë pa falur, do të thoni “Mos, e bëmë edhe sot një të pabërë!”. Një mendësi e tillë lind nga zhvillimi i disa aftësive që zaten ekzistojnë te njeriu (duke i përdor ato aftësi) dhe nga të qenit zotërues i shpirtit.

Interesi që tregoi Udhëzuesi i adhuruesve, Profeti ynë Famëlartë (s.a.s.) ndaj namazit ka nxitur një dëshirë të thellë ndaj “thelbit të adhurimeve” edhe te zemrat e atyre që ndjekin gjurmët e Tij. Qëndrimi gjithë ndjeshmëri mbi adhurimin e namazit nga ana e të Dërguarit të Nderuar (alejhi ekmelut’tehájá), që ka thënë “Namazi është drita e syve

të mi.”⁹⁸, që e tregon me çdo gjendje të tijën dëshirën dhe dashurinë ndaj namazit, atë dëshirë shumë më të zjarrtë se dëshirat e të tjerëve ndaj ca gjërave të tjera, që qëndronte në kijam deri kur i enjtëshin këmbët e tij të bekuara, që ndonjëherë nuk kalonte në ruku pa i lexuar disa xhuze në një rekat, që nga zemra plot frikë e të Cilit vinte zëri i dënesave të tij si zhurma e një mulliri dore apo e një tenxhereje që po zien dhe që përpëlitej nga respekti për Allahun kur bënte sexhde, bëri që edhe sahabët e nderuar të shndërroheshin në dashurues të namazit.

Aq sa, po të shprehemi nëpërmjet fjalëve të Fudajl ibn Ijadit, mëngjesi i gjente sahabët të zbehur e me fytyra të zverdhura. Sepse pjesën më të madhe të natës e kalonin në namaz. Ndonjëherë qëndronin për orë të tëra në kijam, herë të tjera zgjatnin qëndrimin në sexhde. Kur i hapnin zemrën Zotit të Madhëruar, lëkundeshin siç lëkunden pemët në një ditë me erë; nga sytë e tyre rridhnin aq shumë lot, sa për të qenë të mjaftueshëm për të lagur rrobat e tyre dhe vendin. Kënaqësia e namazit i bënte ta harronin lodhjen fizike dhe të kërkonin që ato minuta ribashkimi të mos mbaronin kurrë. Kur vinte mëngjesi, lyenin fytyrat me vaj, lyenin sytë dhe ashtu dilnin mes njerëzve, sikur ta kishin kaluar natën në gjumë dhe të ishin çlodhur mirë.

Omeri (r.a.), teksa po humbte ndjenjat për shkak të plagës së hapur në gjoks nga një goditje me thikë, kur dëgjonte dikë të thërriste “Namazi, o udhëheqësi i besimtarëve!”, “Ja, po çohem!” thoshte dhe e sforconte veten për t’u drejtuar, por, me gjakun që humbte në çdo lëvizje që bënte, binte përtokë gjithnjë e më i rraskapitur. Po në namaz ndodhte për njeriun e dashuruar pas namazit ribashkimi me dashurinë e tij. Dhe, në çastin kur vinte ballin në tokë për t’u lutur e për t’iu përgjyruar Zotit, rënkonte me plagën e hapur në gjoks.

Gjendja e Aliut (r.a.) nuk ishte dhe aq e ndryshme nga ajo e Omerit; edhe ai zverdhej e zbehej kur shkonte për të falur namazin dhe atyre që e pyesnin: “Çështë kjo gjendje kështu, o udhëheqësi i besimtarëve?”, u përgjigjej me fjalët “A nuk e dini se jam duke shkuar për të kryer amanetin?”. Edhe ai, ashtu si Omeri (r.a.), u godit me thikë teksa

⁹⁸ Nesáí, ishretun’nisá 1; Ahmed ibn Hanbel, el Musned 3/128, 199, 285.

po shkonte për të falur namazin dhe në atë rrugë ia dorëzoi shpirtin Allahut.

Sa e mahnitshme është kjo gjendje e një prej shokëve të Profetit, që e kishte përkapur kuptimin e të gjendurit para Zotit, e kishte ndier shijen e Kuranit dhe që na bën të kuptojmë dëshirën e madhe të atyre njerëzve karshi namazit:

Profeti ynë (s.a.s.), në luftën e Zátur-Riká, Amar ibn Jasirin (r.a.) dhe Abad ibn Bishrin (r.a.) i kishte caktuar për të bërë detyrën e rojës së natës në vendin ku kishin vendosur të çlodheshin e të kalonin natën. Pasi kaloi ca kohë dhe Amari (r.a.) vendosi të merrte një sy gjumë, Abad ibn Bishri (r.a.) u ngrit dhe filloi të falte namaz. Në atë moment, një mushrik, i cili i kishte vërejtur dy sahabët që po bënë rojë, filloi të gjuante drejt tyre me shigjeta. Edhe pse në trupin e tij u ngulën dy-tri shigjeta, Abadi nuk e la në mes namazin. Shokun e tij e zgjoi vetëm pasi mbaroi edhe kryerjen e rukusë dhe sexhdes. Amari, pasi u zgjua duke kërcyer nga vendi, nga njëra anë pa mushrikun që po ia mbathte me të katra, nga ana tjetër, duke treguar me dorë shigjetat e ngulura në trupin e Abad ibn Bishrit (r.a.) dhe gjakun që po i rridhte, pyeti i merakosur se përse nuk e kishte zgjuar nga gjumi që në momentin kur kishte marrë goditjen e parë. Abadi iu përgjigj me këto fjalë, të cilat mund t'i thoshte vetëm një dashurues i namazit: “Po këndoja një sure (Kehf), (aq të ëmbla e të këndshme qenë ato ajete, saqë) nuk desha ta ndërprisja namazin pa e përfunduar atë. Por, kur shigjetat filluan të vinin njëra pas tjetrës, përfundova namazin dhe të zgjova. Beto hem në Zot se, po të mos shqetësohesha për përmbushjen e urdhrit të Profetit tonë (s.a.s.), në vend të lënies përgjysmë të asaj sureje dhe të ndërprerjes së namazit, do të kisha zgjedhur vdekjen.”⁹⁹

Po, kur besimtari qëndron në namaz, harron çdo gjë rreth e rrotull tij.

*“Nuk e dija kështu veten time
Ai është unë apo unë jam Ai?”
(Gedáí)*

⁹⁹ Ebú Dáuúd, taharet 79; Hákim, el Mustedrek 1/258.

Ashtu siç shprehet edhe në këto vargje, besimtari kalon nga vetvetja dhe arrin në një gjendje të atillë, saqë nuk njeh as veten. Zaten, nuk është e mundur që një person të dalë para Zotit me qëllimin për të kryer këtë detyrë dhe të mendojë gjëra të tjera; në qoftë se mendon për gjëra të tjera, edhe sikur të ketë dalë e të ketë qëndruar para Zotit, do të thotë se nuk po ia jep hakun këtij qëndrimi. Njeriu, ose do t'ia kthejë shpinën gjithçkaje tjetër dhe do t'i drejtohet Zotit me një zemër të paqme, ose do të sorollatet me zemrën në një luginë e trupin në një luginë tjetër dhe, në këtë mënyrë, nuk do të jetë në gjendje të marrë frytet e asaj çfarë bën.

Ja, pra, brenda këtij misteri gjen kuptim të qëndruarit në namaz. Të mbesësh vetëm për vetëm me Zotin, t'i nxjerrësh nga zemra e t'i flakësh tutje dynjanë dhe çdo gjë tjetër përveç Zotit, madje, të harrosh edhe nefsin tënd e të kalosh nga vetja... Dhe të përpiqesh për të qenë i suksesshëm në faljen e një namazi të këtillë, qoftë edhe për një herë të vetme.

i. Qindra rekate namaz çdo ditë

Po, sahabët nuk ngopeshin kurrë me adhurimet, veçanërisht me namazin. Edhe trimat e të Vërtetit, të cilët merrnin mësim prej tyre, po rriteshin si heronj të namazit. Për shembull, Ata ibn Ebi Rebah (r.a.), edhe gjatë viteve të pleqërisë, atëherë kur ndihej i dobët dhe i pafuqishëm, në një rekat të namazit këndonte njëqind ajete të sures Bekare. Përqendrimi në namaz e bënte të mos e ndiente lodhjen e trupit.

Në lidhje me Shu'be ibn Haxhaxhin, i cili ishte një nga imamët e mëdhenj të pasuesve të pasuesve të sahabëve (*tebei tabiin*), Muslim ibn Ibrahim thotë kështu: "Sa herë që shkoja pranë Shu'bes, duke përjashtuar këtu rastet në kohët e kerahetit, e gjeja duke falur namaz."¹⁰⁰ Ebu Katani shton edhe diçka tjetër: "Po të ishit dëshmitarë të kohës që kalonte në ruku Shu'beja, do të thoshit 'Me shumë mundësi, harroi

¹⁰⁰ Hatib el Bagdádí, Táríhu Bagdád 9/261.

të ulet në sexhde.’; po ta shihnit atë tek ulej pas sexhdes së parë, ‘Me shumë gjasë, harroi të bëjë sexhden e dytë.’ do të thoshit këtë herë.”¹⁰¹

Ja pra, në këtë periudhë kohore, gjatë së cilës patën jetuar këta dashurues të namazit, falja e namazeve nafile njëqindrekatësh ishte një gjë pothuajse e zakonshme. Aq shumë faleshin ata, sa që mund të themi se, për pjesën më të madhe të tyre, udhëtimi drejt së përtëjmes fillonte te sexhadja. Për shembull, Ebu Ubejde el Basriu, i cili ishte nga brezi i pasuesve të sahabëve (*tabiin*), ndërroi jetë gjatë faljes së namazit, kur po qëndronte në kijam. Në atë periudhë, numri i miqve të Allahut si Uehb ibn Munebih, Tavus ibn Kejsan, Said ibn Musejeb dhe Imam Adhami, të cilët përgjatë tridhjetë-dyzet vjetëve e patën falur namazin e sabahut me abdesin që merrnin para faljes së namazit të jaxisë, nuk ishte aspak i vogël. Për tridhjetë vjet rresht, Xhunejd Bagdadiut nuk i pati ndodhur asnjëherë që të mos e kapte faljen e namazit me xhemat, madje, as në tekbirot fillestare të tyre nuk pati munguar asnjëherë. Nëse ndiente në zemër, sikur edhe fare pak, praninë e mendimeve në lidhje me dynjanë, nëse kuptonte se nuk po e ndiente në ato çaste të vërtetën e namazit, faljen e atij namazi e përsëriste edhe një herë. I ishte bërë zakon të falte katërqind rekate namaz nafile çdo ditë. Për një periudhë kohore tridhjetëvjeçare, netët i pati kaluar vetëm me adhurim, pa fjetur fare pas namazit të jaxisë. Edhe Ebu Osman Nehdiu, i cili ishte nga ata që e kishin arritur epokën e të Dërguarit të Allahut (s.a.s.), por që nuk kishin mundur ta shihnin Atë (muhadramún), mes namazit të akshamit dhe atij të jaxisë falte njëqind rekate namaz. Sulltanë të botës së zemrës si Bishr ibn Mufadali dhe Bishr ibn Mansuri ishin gjithashtu mes atyre që falnin përditë nga katërqind-pesëqind rekate namaz nafile. Transmetohet gjithashtu se edhe Harun Rashidi, një nga kalifët më të shquar të shtetit Abasi, ka falur çdo ditë nga njëqind rekate namaz deri në çastin kur ndërroi jetë, duke përfshirë këtu edhe periudhën e kalifatit të tij, gjatë së cilës i duhej të merrej njëkohësisht edhe me punë të kësaj dynjaje, edhe me punët administrative të shtetit. Dhe duhet thënë se, për sa i përket vënies në pah të dëshirës së zjartrtë

¹⁰¹ Dhehebi, Sijeru a'lâmin'nubelâ 7/207.

ndaj adhurimeve, që i mbështillte shpirtrat në ato kohë, ky përbën një shembull të rëndësishëm dhe të bukur.

Në fakt, po të marrim në shqyrtim librat biografikë, do të jetë e mundur që, në lidhje me këtë temë, të gjejmë edhe shumë shembuj të tjerë. Dhe do të shihet se, në mesin e të parëve tanë të lartë e të devotshëm, numri i atyre që falnin me qindra rekate namaz në ditë nuk është aspak i vogël.

Meqë ra fjala, më duhet të përmend edhe këtë: Nuk ka vështirësi në fe; Islami bazohet në lehtësimin. Profeti ynë i dashur (s.a.s.), edhe pse vetë vazhdonte me faljen e namazit derisa i ënjtëshin këmbët, anëtarët e umetit të Tij i këshillonte të mjaftoheshin me aq sa ishin në gjendje të bënin dhe të mos merrnin përsipër detyra apo punë që nuk do t'i përballonin dot, qofshin këto edhe lloje adhurimesh. Nga ky këndvështrim, çështja e të ndierit plotësisht namazin, ashtu si edhe ajo e faljes namaz sa më shumë, është çështje niveli dhe zemre. Kur flitet për adhurimet, të gjithë besimtarët nxiten gjithmonë drejt horizonteve sa më të largëta, si në aspektin cilësor, po ashtu edhe në atë sasior, por, në këtë drejtim, as që bëhet fjalë për detyrim.

Në fakt, edhe Shkruesi i Mesazheve të Dritës (*Risale-i Nur*), duke thënë se *një orë në ditë është e mjaftueshme për pesë faljet së bashku me marrjen e abdesit*¹⁰², ka nxjerrë në pah lehtësinë në thelbin e fesë dhe ka treguar këtë rregull objektiv. Pra, kur bëhet fjalë për një dispozitë që i përfshin të gjithë njerëzit, bazuar në parimin se duhen marrë parasysh edhe ata që ndodhen në kushte të vështira dhe të pafavorshme, jemi të detyruar të themi se ata besimtarë që gjenden në kushte aspak të përshtatshme duhet t'i falin patjetër namazet, qoftë edhe duke e kufizuar kryerjen e tyre bashkë me abdesin brenda një intervali kohor njëorësh. Për më tepër, duke thënë “As mos e ço ndër mend të thuash: ‘Çfarë janë faljet e mia në krahasim me të vërtetën e faljeve!’ Sepse fara e një hurme, ashtu si vetë pema e hurmës, përshkruan pemën e saj.”¹⁰³, Ustadi i nderuar na e ka bërë të qartë se në fletoren e

¹⁰² Bediuzamani, Fjalët, fq. 32 (Fjala e Katërt).

¹⁰³ Bediuzamani, Fjalët, fq. 393 (Fjala e Njëzet e Një, Stacioni i Parë).

veprave, edhe për një njeri të thjeshtë që falet, por që nuk e ka kuptuar thelbin e namazit dhe nuk e ndien atë në zemrën e tij, ai namaz do të regjistrohët gjithsesi si një hisë adhurimesh. Siç ka shumë grada nga fara e hurmës deri te një pemë e përsosur hurme, edhe namazet janë shkallë-shkallë, por, pavarësisht kësaj, namazi i çdo shkalle përfiton patjetër nga nuri i adhurimeve. Këto thënie të Bediuzamanit janë për të mos thyer krejtësisht shpresat e analfabetëve si puna jonë, për t'i shpëtuar njerëzit nga rënia në pesimizëm dhe për të vënë në dukje atë që është objektive. Po, Zoti i Plotfuqishëm mundëson shpërblim për namazin e gjithësecilit; por ajo mbi të cilën po fokusohemi ne këtu është e vërteta e namazit, shpirti dhe thelbi i tij.

Në këtë aspekt, një besimtar duhet t'i falë namazet, së paku namazet farz, në cilësinë e "kryerjes" së tyre. Pra, ai duhet t'i përmbushë të gjitha shtyllat dhe pjesët e tjera përbërëse të namazit në përshtatje me mënyrën e duhur të kryerjes së tyre dhe duhet të përpiqet për ta vazhduar namazin gjithmonë me entuziazmin dhe emocionet si ato të ditës së parë, pa lejuar që ai të zbehet e të çngjyroset dhe duke vepruar ashtu siç thotë Said Nursi në librin e tij "Shenjat e Mrekullisë": *"Të veprësh në përputhje me kuptimet e "kryerjes" së namazit si falja e tij me korrektësi, seriozitet, vijimësi dhe duke e ruajtur veten..."*¹⁰⁴ Të paktën pesë herë në ditë duhet të vrapojë për tek ai burim uji të ëmbël, të lahet e të pastrohet me të dhe, pasi të pastrohet nga gabimet dhe mëkatet, me një gjendje shpirtërore krejtësisht të pastër, t'i drejtohet Zotit të Lartësuar sikur të ishte duke u ngjitur në miraxh në çdo kohë të namazit.

4. Farat e namazit

Fjali të veçanta si tekbiri (*Alláhu Ekber*), tesbihi (*Subhánalláh*), tahmidi (*Elhamdulil'láh*), *Fatihaja* dhe *Tahijatu* përbëjnë farat e namazit. Kjo është arsyeja pse ne themi se kuptimet e fjalëve "*Subhánalláh*",

¹⁰⁴ Bediuzamani, *Shenjat e Mrekullisë*, fq. 77.

“*Elhamdulillah*” dhe “*Alláhu Ekber*” janë të fshehura në të gjitha lëvizjet dhe dhikret e namazit. Siç ka thënë edhe i nderuari Bediuzaman, ne, nga tekbiri fillestar (*iftitah*) deri në çastin kur japim selam, me fjalët, gjendjen dhe sjelljet tona, ose lavdërojmë Allahun e Madhëruar duke thënë “*Subhánalláh*”, ose shprehim ndjenjat tona falënderuese dhe të lavdërimit të Zotit nëpërmjet fjalës “*Elhamdulillah*”, ose e lartësojmë Atë duke thënë “*Alláhu Ekber*”.

Ashtu siç është quajtur tekbiri që thuhet në fillim të namazit “tekbiri *iftitah*”, për vetë faktin se me të fillon ky adhurim, duke qenë se nëpërmjet këtij tekbiri fillon edhe koha kur është e ndaluar kryerja e ca veprimeve të tjera (veprimet që nuk lejohen të bëhen gjatë namazit), është emërtuar gjithashtu edhe si “tekbiri tahrir” ose “tekbiri ihram” (tekbiri i ndalimit). Në fakt, ky tekbir mbart kuptimin e hedhjes së hapit brenda rrethit të haremit duke ia ndaluar vetes çdo gjë tjetër përveç Zotit, të lënies së gjithçkaje që i përket dynjasë prapa derës dhe të dhënies së fjalës për t’u drejtuar vetëm Sulltanit të Universit. Do të thotë të qëndisësh të gjitha minutat, sekondat dhe të qindtat e sekondës së namazit me shpirtin e tahmidit dhe tekbirit që nga ai moment; në një kuptim, do të thotë besëlidhje për t’u bërë njësh me namazin, për t’u shndërruar i tëri në namaz. Nëse do t’u kërkohej engjëjve të vizatonin shëmbëllimin në botën e ndërmjetme të robit që e kryen namazin duke e çuar në vend këtë fjalë të dhënë, me shumë gjasë, përpara syve do të na shfaqej piktura e namazit; ai njeri mund të paraqitet vetëm si një namaz i mishëruar.

Po, nëse dëshironi ta kryeni namazin ashtu siç duhet, me marrjen e tekbirit fillestar duhet të shkëputeni nga çdo gjë që ka të bëjë me këtë botë, duhet t’ia hapni zemrën vetëm Atij dhe duhet të vulosni me vulën e ndërgjegjes suaj çdo fjalë që rrjedh nga mesi i buzëve tuaja. Për shembull, kur thoni “*Elhamdulillah*”, duhet ta dini mirë atë çfarë shpreh kjo fjalë, duhet të mendoni thellësisht në lidhje me të dhe të ulërinë me fjalët “Të gjitha falënderimet, mirënjohja dhe të gjitha lavdërimet i përkasin vetëm Allahut (*Tebáreke ue Teálá*); shpallja e kësaj

të vërtete është detyrë e imja dhe e drejtë e Krijuesit të Universit. Në këtë mënyrë, ajo fjalë, teksa ngjitet për tek Allahu i Madhëruar, duhet të ngjitet bashkë me ato kuptime të thella që i keni ngarkuar mbi të.

Ndërsa shpallni që Ai është i Gjithëmëshirëshmi dhe Mëshirëploti, me të njëjtat ndjenja të thella duhet të mbusheni përsëri. Kur shprehni të vërtetën e “*Málikí jeumiddín*”, kuptimet që ajo përfshin duhet t’ia vini përsipër si një vulë dhe ashtu duhet t’ia dërgoni Zotit të Madhëruar. Edhe ju duhet ta shihni namazin si një miraxh dhe duhet të përpiqeni të ndieni nga horizonti juaj i të kuptuarit të vërtetat që ndjeu në Miraxh i Dërguari i Allahut (s.a.s.).

Duhet të lartësoheni hap pas hapi, duke i hurbur të gjitha kuptimet e namazit, të takoheni në katin e parë të qiejve me Ademin (a.s.), në të dytin me Jahjanë dhe Isain (a.s.), në të tretin me Jusufin (a.s.) dhe në katet e tjera me Idrisin, Musain e Ibrahimin (a.s.), të mësoni nga jeta e secilit prej tyre, të arrini dëlirësinë e të qenit pranë tyre dhe, pasi të hidhni edhe një hap tjetër, të ndiheni sikur keni hyrë në haremgjahun hyjnor. Dhe, sapo të jepni selam në fund të namazit, me frikën se mos nuk keni vepruar në përputhje me etikën e të qëndruarit para Zotit të Madhëruar, duhet të ngrini duart edhe një herë, të hidhni sërish shikimin për nga dergjahu hyjnor me fjalitë e tesbiheve, tahmideve dhe tekbireve, dhe t’i përsërisni nga tridhjetë e tri herë ato fjalë të bekuara, të cilat përforcojnë kuptimin e namazit.

Në lidhje me tesbihatin që bëhet pas namazit mund të mendohet kështu: Këto fjalë, të cilat i përmenda imtësisht gjatë namazit, po i përmend edhe një herë pas namazit, përmbledhtazi. Sado që i kam përmendur ato në namaz, akoma nuk jam ngopur me to. Le ta kujtoj Allahun edhe një herë pas namazit me këto shprehje.

E pra, nuk mund t’i biesh shkurt namazit kur ai nevojitet të kryhet me mendime e ndjenja kaq të thella; përgatitjet e nevojshme para namazit duhet t’i kryeni plotësisht, kurse namazin duhet ta falni në përshtatshmëri me kuptimin e tij.

Dimensioni i meditimit në namaz

Këto shprehje, të cilat përbëjnë thelbin e namazit, janë gjithashtu edhe bazat e adhurimit dhe të të qenit rob i Zotit, janë elementë shumë të rëndësishëm për botën e meditimit të besimtarit. Me fjalë të tjera, shprehjet e sipërpërmendura janë fjali shumë të rëndësishme që shprehin zbrazjen e besimtarit pasi është mbushur me meditim. Për më tepër, secila prej këtyre shprehjeve shpreh admirimin e besimtarit përballë të vërtetave në univers. Nëse dëshironi, tani le t'i zgjerojmë pak më shumë këto vlerësime që bëjnë përmbledhtazi:

Ekziston një thënie e bukur, sipas së cilës “*Namazi është miraxhi i besimtarit.*”¹⁰⁵ Profeti ynë (s.a.s.) u ngjit lart në qiej me trup dhe me shpirt, arriti në majat mbi çfarëdolloj grade, pa – me lejen e Allahut dhe si një mirësi e mundësuar prej Tij – atë që duhej të shihte dhe, më pas, u kthye sërish mes njerëzve. Nëse përqendrohet mirë, besimtari mund ta arrijë këtë horizont në imagjinatën, shpirtin dhe mendjen e tij dhe, në këtë mënyrë, mund të përjetojë në hijen e miraxhit të vërtetë një miraxh relativ.

Njeriu, ndërsa bën këtë miraxh mendor dhe shpirtëror, vrojton ajetet (argumentet) në lidhje me universin dhe botën e brendshme të njeriut dhe gjen lidhje mes tyre dhe ajeteve të Kuranit. Në atë moment, që është njëkohësisht edhe në tokë, i bëhet sikur koka e tij ka kapërcyer atmosferën dhe ka arritur përtej qiejve. Po, nëse ia vë pak veshin shpirtit të tij, njeriu gjithmonë mund ta kapë këtë atmosferë.

Pas kësaj, me ndihmën edhe të ajeteve të Kuranit, para jush shfaqen tablo ngjyra-ngjyra, të cilat, ashtu siç mund të dalin nga nefsi juaj, mund të jenë edhe tablo të lindura nga universi; dhe me ç’gjëra shumëngjyrëshe do të përballeni ju në secilën nga këto tablo! Në fakt, harmonia që ekziston në gjithë universin, në materie dhe në trupin e njeriut, harmonia në marrëdhëniet mes njeriut dhe universit është e atillë, saqë është e pamundur të pretendosh për më shumë se aq.

¹⁰⁵ Fahrudín Rází, Mefátihul gajb 1/214; Sujúti, Sherhu Suneni ibn Máxhe, fq. 313.

Përballë një panorame të këtitllë, ju do të thoni “Në këtë punë nuk mund të jetë përfshirë asnjë dorë tjetër. Pas këtij rregulli dhe kësaj harmonie qëndron vetëm Allahu!” dhe, duke i ndier ato në çdo grimcë tuajën, do të bërtisni me fjalët “*Subhánalláh!*”. Sapo të merrni tekbinin, duke thënë “*Subhánekaláhumme ue bihamdik*”, duke i përmendur bashkë falënderimin ndaj Allahut, lartësimin dhe përmendjen e Tij, do të thoni: “Falënderimet të takojnë Ty, që na e mundësove ta ndiejmë këtë. Ne Ty të përmendim, Ty të lartësojmë dhe dëshmojmë se Ti ekziston dhe se je i Pashoq, i Patëmetë dhe i Shenjtë!” Për aq kohë sa këto do të vazhdojnë të tingëllojnë rreth e rrotull si zëri dhe frymëmarrjet e zemrës, njeriu do ta ndiejë veten brenda një melodie ekstaze dhe kënaqësish shpirtërore.

Ndonjëherë, këto mendime të thella ndiqen nga dëgjimi i atyre ngjarjeve marramendëse në univers. Në lidhje me këtë temë, një njeri i dijes thotë kuptimisht kështu: “Aq madhështore është harmonia në këtë univers të madh, saqë, ashtu siç nuk ka mundësi të përplasen dy anije që lundrojnë në ujërat e dy deteve të ndryshëm, po ashtu nuk mund të bëhet aspak fjalë për përplasjen e sistemit tonë diellor me ndonjë sistem tjetër apo atë të dy trupave qiellorë me njëri-tjetrin.”

Po, kur shikon këtë rregull dhe rend madhështor në univers, njeriu nuk mund të rrijë pa thënë “Ç’vepër e mrekullueshme kjo, e një fuqie madhështore!”. Pastaj, për të marrë frymë thellë edhe një herë nëpërmjet meditimit, thotë “*Alláhu Ekber*” dhe përulet para Krijuesit të gjithësisë. Në varësi të situatës në të cilën ndodhet dhe të ajeteve që po reciton, ose mendon begatitë, që Allahu i Plotfuqishëm na i mundëson nga qielli dhe toka, dhe mbushet me ndjenja falënderuese dhe lavdëruese ndaj Tij, ose, duke i konsideruar gjërat e dhëna si kredenciale të atyre që do të jepen në të ardhmen, gëzohet. Kështu, përsa i përket ndjenjave dhe mendimeve të tij, ai buçet sikur të ishte gjithmonë duke përparuar drejt Tij; me fjalët që reciton ndërton lidhje mes gjërave që dëgjon dhe ndien; shpreh ndjenjat me fjalë të bukura e në përshtatje me pjesët e namazit dhe, duke u thelluar gjithnjë e më shumë, vazhdon udhëtimin e tij.

Po, fjalët e shenjta si *Subhánalláh*, *Elhamdulil'láh* dhe *Alláhu Ekber*, të cilat përmenden shumë në namaz, në një aspekt, janë zëri dhe fryma e robërisë ndaj Zotit, janë shenjat e pjesëve të ndryshme të së vërtetës së miraxhit.

Ne, teksa jemi duke kryer adhurimet tona përkarshi Zotit të Madhëruar, të gjitha ato çfarë shohim, dëgjojmë dhe ndiejmë i shprehim në formën e tesbiheve, tahmideve dhe tekbireve. Them i "*Elhamdulil'láh*" për të gjitha mirësitë e begatitë që na ka dhënë, materiale e shpirtërore; përballë faktit të të qenit i Pashoq të Allahut, themi në formë madhërimi "*Subhánalláh*"; duke thënë "*Alláhu Ekber*", për t'u dorëzuar tek Ai me vogëlsinë tonë dhe për të shpallur madhëstsinë e Tij, mundohemi të shfaqim përballë Hyjnisë Gjithëpërfshirëse një adhurim sa më të plotë.

Surja *Fatiha* është përmbledhja dhe thelbi i Kuranit. Është e mundur që të gjitha të vërtetat e Kuranit të vërehen në një formë të përmbledhur te *Fatihaja*. Për rrjedhojë, duke parë aty madhëstsinë e Allahut të Madhëruar dhe duke u tromaksur përballë saj, ndonjëherë themi "*Alláhu Ekber!*", që ka kuptimin "Zoti im, Ti je më i Madhi!", ndonjëherë tjetër na bëhet sikur jemi duke notuar brenda begatitë të Xhenetit, e ndiejmë veten brenda mundësive që do të na bëjnë t'i arrijmë ato begati dhe, duke parë ngjitjen tonë nëpër shkallët shpirtërore si një mirësi e Allahut ndaj nesh, - të njëjtat gjëra vlejné edhe për adhurimet e tjera si agjërimi, zekati dhe haxhi - themi "*Elhamdulil'láh*". Herë tjetër, duke thënë "Allahu është Ai që përgatit marrëdhënien mes kësaj bote dhe botës tjetër.", i sjellim në mendje të gjitha këto kuptime, që, në fakt, përfshihen shkurtimisht në suren *Fatiha*.

Sa i përket lutjes "*et'Tehijátu*", ajo na e kujton më qartë miraxhin. Miraxhi është adhurimi i Profetit tonë (s.a.s.) ndaj Allahut dhe - thënë ndryshe - shprehja e arritjes së gradës më të lartë të përsosmërisë, duke shkuar përtej detyrës që kërkohet prej tij, pra, atë të të qenit rob i Zotit. Po, Allahu i Madhëruar i hapi Profetit tonë (s.a.s.) një derë në emër të adhurimeve e të të qenit rob i Tij dhe i kërkoi të kalonte në përputhje me rregullat e kalimit përmes asaj dere. Dhe Profeti ynë (s.a.s.), në një mënyrë që nuk do t'i mundësohet askujt tjetër dhe me një thellësi dhe

përsosmëri të jashtëzakonshme, kaloi nga ajo derë ashtu siç tregohet në ajetet ***“Pastaj iu afrua e iu lëshua, sa largësia midis dy harqeve ose edhe më afër...”***¹⁰⁶

Miraxhi, më shumë sesa ai i të qenit Profet, është rezultat i adhurimeve të Tij ndaj Zotit, i të qenit rob i Tij. Në atë kohë kur njerëzit i kishin kthyer shpinën të Dërguarit të Allahut (s.a.s.), i Cili nuk i sakrifikoi adhurimet e tij as në situatat më të vështira, miraxhi që pasqyrimi i dritës së Njësisë Hyjnore brenda sekretit të Unitetit.

Në atë periudhë ogurzezë, kur Kurejshët thanë “Nuk do të jepni vajza për martesë tek ata e as nuk do të merrni vajza prej tyre, nuk do t’u shisni asgjë atyre nëpër çarshi e pazare dhe do t’i ndërprisni të gjitha marrëdhëniet me ta derisa i gjithë fisi Hashim të shkatërrohet në Shi’bi Ebí Talib.”, pra, në momentin kur, në pamje të parë, dukej sikur të gjitha shkaqet për shpëtim kishin heshtur, Allahu i Madhëruar, për t’ia ledhatuar zemrën dhe për t’ia riparuar nderin e thyer nëpërmjet një trajtimi të veçantë, i mundësoi Profetit tonë (s.a.s.) Miraxhin.

Kjo periudhë është gjithashtu edhe periudha kur Profeti ynë (s.a.s.), krahas gjithë atyre negativiteteve, u përball edhe me dy fatkeqësi të mëdha. Njëra prej tyre ishte vdekja e Ebu Talibit, xhaxhait të tij, ndërsa tjetra ishte humbja e Hatixhes së Madhe, bashkëshortes së tij të parë (r.a.). Për të bërë të mundur mjekimin e plagëve të Profetit tonë të dashur, Allahu i Plotfuqishëm, duke thënë “Pavarësisht të gjithëve dhe gjithçkaje, më ke Mua sa për të gjitha botët!”, e ngushëlloi dhe e kurorëzoi Atë me Miraxhin.

Të gjitha namazet, lutjet, agjërimet dhe vuajtjet e Tij u bënë shkak që Ai (s.a.s.) të ngrihej në Miraxh, t’i shpjegonte popullit domethënien e namazit, lutjes, agjërimin dhe që të gjitha këto të bëheshin shkallë të asaj ngjitjeje. Përpos Profetit tonë (s.a.s.), nuk ka një profet të dytë që t’i jetë mundësuar një nderim i tillë. Çdo profet mund të ketë dalë para Allahut në shpirtin e vet, mund të jetë nderuar me afrimitetin ndaj Tij. Por qerasja me soditjen e të gjithë qiejve dhe xheneteve me të gjitha

¹⁰⁶ Surja Nexhm, ajetet 8-9.

cilësitë e tyre, për ne të panjohura, i është mundësuar vetëm Muhamed Mustafasë (s.a.s.). Ja, pra, edhe ne, falë privilegjit të të gjendurit pas këtij Profeti Famëlartë e Madhështor, përpiqemi të ndiejmë atë miraxh në namazet tona.

5. Dimensioni i dhikrit dhe ai i pendimit në namaz

Dhikri është adhurimi që e afron besimtarin tek Allahu në mënyrën më të shpejtë të mundshme, por është edhe era më efektive në shpërndarjen dhe dëbimin e reve të hutesës dhe pakujdesisë. Dhikër do të thotë të përmendësh, të kujtosh, ta jetosh jetën duke e ndier atë. Dhikër do të thotë të marrësh një mesazh në lidhje me Allahun pothuajse nga çdo objekt që has ndërsa endesh nëpër korridoret e ekzistencës. Në këtë kuptim, mund të flitet për një lidhje të ngushtë ndërmjet dhikrit dhe namazit. Madje mund të themi se, krahasuar me dhikrin e namazit, dhikret e adhurimeve të tjera mbeten në një nivel dytësor. Zaten, nëse do të kishte një adhurim tjetër që do t'ia kujtonte njeriut Allahun në atë masë dhe që do t'i zhdukte pakujdesinë dhe hutesën nga horizonti i të parit, të menduarit, të kuptuarit dhe të vlerësuarit, në vend të namazit, Allahu do të urdhëronte e do të rekomandonte kryerjen e atij adhurimi pesë herë në ditë.

Namazi zotëron në vetvete një fuqi përkujtuuese. Kurani Famëlartë na e kujton këtë të vërtetë nëpërmjet ajetit “... **kryej faljen për të më kujtuar Mua.**”¹⁰⁷. Po, ashtu siç shprehet në këtë ajet, mes përkujtimit (dhikër) dhe namazit ka një lidhje të ngushtë. Për shkak të rëndësisë në këtë masë të namazit, Allahu (*xhel'le xheláluhu*) e ka theksuar shumë në Kuran faljen e namazit pesë herë në ditë.

Agjërimi, për shembull, është një adhurim i fshehtë. Dhe, kur dikush është duke agjëruar, të tjerët nuk mund ta dinë këtë. Në fakt, për shkak të të qenit një adhurim i fshehtë, Allahu (*xhel'le xheláluhu*) i ka dhënë një rëndësi të veçantë agjërimit dhe e ka lartësuar atë nëpërmjet një

¹⁰⁷ Surja Tâhá, ajeti 14.

hadithi të shenjtë (kudsi), i cili është si vijon: “Agjërimi më përket Mua, Unë do ta jap shpërblimin e tij.”¹⁰⁸ Nëse edhe agjërimi do të kishte një vazhdimësi të dhikrit si ajo në namaz, Allahu do të na e bënte farz të agjëruarit një herë në dy ditë, pra, agjërimitin e Davudit (a.s.). Kështu, mund të thuhet se ky ndikim përkujtues kaq i fuqishëm i namazit nuk gjendet në asnjë adhurim tjetër. Mbase mund të flitet për një ndikim të tillë të fuqishëm në adhurimet e përgjithshme si namazi i Xhumasë apo haxhi, forca e tyre përkujtuese mund të konsiderohet një dhikër i një niveli të rëndësishëm. Megjithatë, për shkak se këto adhurime nuk bëhen pesë herë në ditë si namazi, as çdo ditë, është e pamundur që ato të zënë vendin e namazit.

Namazi është si ajo pjesa e gurtë nën çezmë, që i pastron njerëzit nga gjynahet dhe papastërtitë. Ata që lahen shpirtërisht në namaz pesë herë në ditë pastrohen nga gjynahet dhe bëhen të dëlirë. Këtë të vërtetë shpreh edhe ajeti “**Fale namazin në mëngjes e mbrëmje dhe në një kohë të natës, sepse veprat e mira i shlyejnë veprat e këqija. Kjo këshillë vlen për ata që i pranojnë këshillat.**”¹⁰⁹ Ajo çfarë kuptohet nga ky ajet është se çdo namaz i falur përbën një vepër të mirë gjithëpërfshirëse, dhe kur për këtë vepër të mirë thuhet “**Kjo këshillë vlen për ata që i pranojnë këshillat.**”, vihet edhe një herë në pah forca përkujtuese e namazit.

Pas identifikimit në këtë mënyrë të lidhjes mes dhikrit dhe namazit, le të vijmë tani të lidhja mes teubes (pendimit) dhe namazit. Teube do të thotë që personi t’i drejtohet Allahut dhe t’ia hapë zemrën Atij (*xhel’le xheláluhu*). Teubeja është procesi që Allahu e ka bërë pjesë të natyrës sonë dhe që na mundëson edhe një herë ristrukturimin e ndjenjave tona të bukura, delikate e të dëlira, në rastet kur ato pësojnë deformime për shkak të mëkateve të ndryshme.

Çdo njeri që kryen një mëkat konsiderohet se ka bërë një hap drejt kufrit (mosbesimit). Po, ashtu siç thotë edhe Ustadi, “*Brenda çdo mëkati*

¹⁰⁸ Buhári, teuhíd 35; Muslim, sijam 160.

¹⁰⁹ Surja Húd, ajeti 114.

është një rrugë që të çon në mosbesim.”¹¹⁰ Prandaj, kushdo që bën një mëkat është një hap më shumë larg Zotit dhe një hap më pak më afër shejtanit. Kështu, ky njeri, duke bërë teube, kthehet sërish tek Allahu dhe, në të njëjtën kohë, një njeriu të tillë veprat e këqija i shndërrohen në vepra të mira. Me qasjen e Ustadit, teubeja, aftësitë e njeriut, të cilat janë të hapura ndaj së keqes, i kthen për tek e mira. Dhe, në këtë mënyrë, njeriu fiton potencialin për të bërë mirë.¹¹¹

E pra, e njëjta gjë vlen edhe për namazin. Sepse namazi bën të mundur që te njeriu të krijohet vetëdija e teubes në kuptimin e saj të vërtetë. Njeriu, edhe pse nuk bën teube verbalisht gjatë namazeve që kryen pesë herë në ditë, namazet e falura kalojnë si teube me vepra. Fundja, në uirdet dhe dhikret që këndohen gjatë namazit ka shumë lutje dhe ajete që mbartin kuptimin e teubes dhe istigfarit (pendesës dhe të kërkimit falje). Për shembull, besimtari e nis namazin me fjalët “*Alláhu Ekber*”. Nëpërmjet tekbirit, tokmaku i mendimit dhe i vetëdijes lëshohet mbi gjërat e kota që na rrethojnë, në mënyrë që të shkëputemi nga punët e tjera dhe t’i drejtohemi Allahut (*xhel’le xheláluhu*). Po, në namaz kemi të bëjmë me shkëputjen nga çdo gjë e kotë dhe kthimin tek i Vërteti, duke iu përgjigjur kështu ftesës së Tij. Një drejtim i tillë ndaj Zotit mund të realizohet nga çdokush, por në varësi të gradës në të cilën ndodhet.

Më pas, robi thotë “*Subháneke’lláhumme ue bi hamdik*”. “*Subháneke*” do të thotë “Në gjithë këtë krijim nuk ka asgjë që mund të të bëhet Ty shok. Ti, në Individualitetin Tënd, atributet e Tua dhe veprimtarinë Tënde je i Vetëm, i Pashoq. As veprimet e mia dhe as ngjarjet që ndodhin nëpër univers nuk mund t’i jepen askujt tjetër përpos Teje. Ja, pra, duke ia kthyer shpinën një mendimi të këtillë shirku dhe duke dëshmuar se përsosmëria të përket vetëm Ty, Ty të përkujtoj e të lartësoj.”

Kurse “*Ue bi hamdik*” ka kuptimin “Unë Ty të falënderoj e të përlëvdoj.” Në fjalën “*Subháneke*” gjendet kuptimi i shfaqjes së një

¹¹⁰ Bediuzamani, Shkreptimat, fq. 19 (Shkreptima e Dytë, Pika e Parë).

¹¹¹ Bediuzamani, Fjalët, fq. 686 (Fjala e Njëzet e Gjashtë, Çështja e Dytë, E shtata).

adhurimi të plotë karshi pasqyrimeve të pashoq të Allahut të Madhëruar dhe duke e mbajtur Atë larg çdo të mete dhe mangësie. Ndërsa me fjalët “*Ue bi hamdik*”, të cilat vijnë menjëherë pas fjalës “*Subhâneke*”, njeriu thotë “Unë nuk jam në gjendje ta perceptoj vetvetiu këtë kuptim, je Ti që ma bën atë të njohur. Sepse, nëse Ti nuk ma mundëson këtë gjë, unë nuk mund t’i dëgjoj e as t’i ndiej ato. Prandaj, ndërkohë që nga njëra anë të përmend e të përkujtoj, nga ana tjetër, Ty t’i paraqes falënderimet dhe mirënjohjen time ndaj Teje, me përlulje dhe duke të lavdëruar vetëm Ty.”

Më pas vjen pjesa “*Ue tebarekesmuk*”, e cila mbart këtë kuptim: “Emri yt është burim begatish. Mundësoju diçka nga thesari yt i pamasë edhe atyre si puna ime, robërve të tu me këmbë të prangosura e të lidhur me zinxhir nga qafa! Sepse Ti u jep shumë të mira edhe atyre që të mohojnë Ty e që bëjnë shirk. Edhe unë, duke t’u drejtuar Ty pavarësisht mëkateve dhe devijimeve të mia, strehohem tek emri yt dhe rënkoj para Teje me fjalët e imamatit të Allvarit ‘*Ji bujar, Sulltani im, mos e ndërpre bujarinë tënde ndaj të ngratëve / A i ka hije Bujarit të ndërpresë bujarinë ndaj përderësve të tij?*’”

Kurse fjalia “*Ue teála xhedduk*” ka këtë kuptim: “Ti je Famëlartë. Me të vërtetë, sulltanit i ka hije një sjellje prej sulltani, kurse lypësit, lypsaria. Unë mund të jem rrëzuar shumë herë, mund të kem gabuar shumë, por tani, i përkulur më dysh, ndodhem para derës tënde. Përveçse tek Ti, nuk kam asnjë derë tjetër ku të drejtohem. Mua nuk më ka hije mëkati, kjo është e vërtetë, por edhe falja është ajo që të ka hije Ty, ajo është lavdia jote.”

Pjesa e fundit e kësaj lutjeje, e cila është “*Ue lá iláhe gajruk*”, do të thotë: “Si mund t’i drejtohem dikujt tjetër, kur, përpos Teje, askush nuk mund të jetë i Adhuruari i denjë për t’u adhuruar dhe Qëllimi i Vërtetë?”

Po, në namaz, që nga marrja e tekbitit fillestar deri në dhënien e selamit, ekziston gjithmonë një kthim tek Allahu me një orbitë të tillë teubeje dhe ky kthim, me kalimin e kohës, mund ta çojë robin drejt shpateve të ihsanit hap pas hapi.

6. Delikatesa e zemrës dhe namazi

Delikatesa e zemrës është një shenjë besimi. Kurse lotët, të cilët janë gjuha e një zemre delikate, përbëjnë gjithashtu një proces lehtësimi për heronjtë e dashurisë me zemra të djegura e shpirtra të lënduar. I Dërguari i Allahut (s.a.s.) thotë kështu: “Nëse ndodh që nga syri i një besimtari të rrjedhë një pikë loti nga frika prej Allahut dhe të rrëshqasë nëpër faqet e tij, Allahu do t’ia bëjë haram ato faqe Xhehenemit, zjarri i Xhehenemit nuk do t’i prekë ato.”¹¹² Po, lotët janë eliksiri i vetëm në gjendje për të shuar flakët e Xhehenemit në botën tjetër dhe zjarret e ndarjes dhe mallit në këtë botë.

Edhe Kurani Famëllartë, duke vlerësuar dhe ngritur lart delikatesën e zemrës në shumë vende të tij, na thotë se besimtarët e vërtetë bien në sexhde me fytyrat përtokë kur dëgjojnë ajetet e Allahut.¹¹³ Në një vend tjetër, na paralajmëron në këtë mënyrë: “**Le të qeshin pak e të qajnë shumë.**”¹¹⁴ Edhe kjo lutje e Profetit tonë (s.a.s.) na tregon për rëndësinë e delikatesës së zemrës: “*Strehohem tek Ti, Zoti im, nga zemra që nuk dridhet!*”¹¹⁵

Një zemër delikate, një zemër që dridhet, është e hapur ndaj llogaridhënies dhe mbikëqyrjes. Ajo e merr veten në llogari herë pas here. Ashtu siç nuk ia njeh vetes sukseset e arritura, edhe gjërat që bën i shikon gjithmonë si të pakta. Dhe, kështu, shndërrohet në një hero të “*Hel min mezíd*” (A nuk ka më?), që nuk di të ngopet me kryerjen e vepreve të mira dhe punëve të hairit.

Për një njeri me zemër delikate, as në çështjen e adhurimeve nuk mund të bëhet fjalë për diçka të tillë, pra, që të ndihet i ngopur me adhurimet e kryera apo t’i shikojë ato si të mjaftueshme. Pas kryerjes së farzeve, koha që i duhet kushtuar adhurimeve nafile është një çështje për të cilin individit duhet të vendosë vetë. Një njeri, në lidhje me

¹¹² Bejhakí, Shuabul ímán 1/491.

¹¹³ Shihni ajetin 107 të sures Isrá.

¹¹⁴ Surja Teube, ajeti 82.

¹¹⁵ Muslim, dhikr 73; Ebú Dáúud, uitr 32; Tirmidhí, de’auát 68.

namazet që ka falur, mund të thotë kështu: “Nuk munda t’i fal këto namaze me zemrën plotësisht të qetë, nuk munda t’i kryej ashtu siç duhet ato. Në vend të tyre, të fal të paktën ca namaze nafile. Ose t’i bëj kaza këto namaze që kam falur shkujdesshëm.” Në këtë mënyrë, duke përcaktuar se edhe sa namaze shtesë do të falë në një vakt apo ditë, ai bën një lloj planifikimi. Dhe, ngaqë askush nuk e di se kur do t’i vijë vdekja, i ngjesh ato brenda një kohe të shkurtër, fjala vjen, përpiqet t’i plotësojë mangësitë e tij në çështjen e namazeve duke falur çdo ditë namaze kaza disaditore.

Në lidhje me adhurimet nafile përdoret shprehja “*xhebran lin’nuksan*”, që do të thotë “fashë për lidhjen e thyerjeve dhe lëndimeve”; ne synojmë që, nëpërmjet tyre, të mbyllim çarjet dhe mangësitë e adhurimeve tona farz, të lidhim me to frakturat, lëndimet. Ja, pra, kjo çështje i është lënë në dorë ndërgjegjes së individit. Për shembull, një person, përgjatë një periudhe të caktuar kohore, i ka falur namazet farz pa mundur t’i drejtohet Zotit të Madhëruar me gjithë zemër. Një ditë, ai kupton të vërtetën e nijetit dhe i qaset atij duke e përkufizuar si qëllim dhe drejtim të zemrës. Kurse drejtimin e zemrës e kupton si fshirjen nga zemra të çdo gjëje që ka të bëjë me këtë botë, të mendosh në ato çaste vetëm Allahun dhe të harrosh çdo gjë tjetër. Për dikë që e ka kuptuar kështu nijetin, nëse nuk lidhet në namaz pikërisht me këtë nijet, quhet sikur nuk e ka falur fare namazin. E megjithatë, në këtë pikë, gjithsecili duhet të veprojë sipas gradës së vet.

Në disa libra të jurisprudencës Hanefi, ndonëse nuk është e qartë se në çfarë argumentesh bazohet një gjë e tillë, shkruhet kështu: “Është më mirë që nijeti të thuhet me gojë.” Dhe, për rrjedhojë, kjo është shndërruar në një zakon tashmë. Për këtë arsye, besimtarët bëjnë nijet me zë para se të lidhen në namaz, duke thënë “*Neuejtu en usal’lije lil’láhi...*” ose përkthimin e kësaj të fundit, që është “Bëra nijet për hir të Allahut...”. Nëse është e mundur që, në këtë mënyrë, të arrihet drejtimi i zemrës për te Zoti i Madhëruar, ku ka më mirë! Ama, në rast se njeriu ngec vetëm te fjalët dhe, më keq akoma, lidhet në namaz duke thënë ca fjalë, por pa qenë aspak i vetëdijshëm për domethënien e tyre, nëse

zemra e tij nuk kthehet për në drejtimin e duhur, atëherë kjo do të thotë se ajo çfarë dëshirohet nuk është duke u përmbushur.

Pra, një njeri që e ka mësuar kështu nijetin dhe që fillon të jetojë brenda një marrëdhënieje të këtillë me adhurimet e veta, mund të thotë: “Deri më sot, i kam falur të gjitha namazet e mia, pa asnjë përjashtim. Por, a i kam kryer ato ashtu siç duhet? Për këtë nuk jam i bindur dhe as që mund ta di përgjigjen e kësaj pyetjeje. Kështu që, më duhet t’i bëj kaza, t’i fal edhe një herë namazet e mia, ose të fal namaze të tjera nafile, që t’më llogariten si *‘xhebran lin’nuksan’*.” Dhe, duke falur përditë namaze kaza njëditore – gjithmonë nëse Zoti (*xhel’le xheláluhu*) do t’ia mundësojë një jetë aq të gjatë sa për t’i kryer të gjitha namazet e ditëve të kaluara, – ai do të jetë në gjendje t’i plotësojë boshllëqet dhe mangësitë e adhurimeve të tij të shkuara.

Përveç kësaj, në medhhebin Hanefi, ashtu siç falen me shumë kujdes farzet e pesë kohëve të namazit, duhen falur edhe sunetet e tyre. Dymbëdhjetë rekate nga ato të namazeve sunet të pesë kohëve të namazit janë *‘sunnet muekkede’* (sunet i fuqishëm – veprime dhe adhurime që, në përgjithësi, Profeti ynë (s.a.s.) i kryente rregullisht), të urdhëruara me ngulm nga ana e të Dërguarit të Allahut (s.a.s.). Për shembull, për namazin sunet të kohës së ikindisë nuk ka një urdhër aq këmbëngulës sa ai i dymbëdhjetë rekateve të sipërpërmendura. Megjithatë, edhe ai pranohet si pjesë e veprave të virtytshme. E njëjta gjë vlen edhe për katër rekatet e para sunet të kohës së jacistë. As ky namaz sunet nuk gjendet në *“Kutubu sitte”* (Gjashtë librat e hadithit); por, sipas asaj që shkruhet në librin *“Fet’hu Bábil Ináje”* të Alij’julkáriu, i cili, në lidhje me namazin sunet prej katër rekatesh të jacistë, ka marrë për bazë një hadith nga vepra *“Sunen”* e Said ibn Mansurit, Profeti ynë (s.a.s.) ka falur katër rekate namaz sunet para farzit të jacistë.¹¹⁶

Edhe namazi i tehexhudit (namazi i natës) është shumë i rëndësishëm. Ata që i ndriçojnë netët e tyre me projektorët e tehexhudit, duke i shndërruar kështu në ditë ato, të ndriçuar do ta kenë edhe jetën e

¹¹⁶ Alij’julkári, Fet’hu Bábil Ináje 1/467.

berzahut (jeta e varrit). Tehexhudi është një parzmore, një armë, një pishtar kundër errësirës së berzahut. Ai është një shpat i sigurt, një vend ku mund të strehohesh për të shpëtuar nga vuajtjet dhe mundimet e berzahut. Çdo namaz ka marrë përsipër detyrën e ndriçimit të një pjese të jetës së njeriut në botën tjetër. Namazet e tehexhudit janë nozullimet, paja dhe ndriçuesit e besimtarit në jetën e varrit.

Tehexhudi përmendet në disa vende në Kuran:

“O ti i mbuluar (o Muhamed)! Çohu (të falesh) gjithë natën, përveç një pjese të saj, që është gjysma ose diçka më pak a diçka më shumë se ajo dhe lexoje Kuranin ngadalë dhe qartë, sepse Ne do të të dërgojmë vërtet një fjalë me peshë të rëndë. Natyrisht, adhurimi natën vepron më fuqishëm dhe fjala është më shprehëse, ngaqë ti ditën je vërtet shumë i zënë. Prandaj, përmende emrin e Zotit tënd dhe përkushtoju krejtësisht Atij!”¹¹⁷

“Kaloje një pjesë të natës, si falje shtesë për ty (Muhamed)! Është e vërtetë se Zoti yt do të të vendosë ty në një vend të lavdëruar.”¹¹⁸

“Ata ngrihen nga shtrati, i luten Zotit të tyre me frikë e shpresë dhe japin nga ajo që iu kemi dhënë Ne.”¹¹⁹

“Përmende emrin e Zotit tënd në mëngjes dhe në mbrëmje. Në një pjesë të natës bëji sexhde Atij dhe, natën, falju gjatë Atij.”¹²⁰

Sipas transmetimeve të Buhariut dhe Muslimit, Abdullah ibn Omeri (r.a.) shikon në ëndërr dy persona të frikshëm, të cilët i afrohen, e kapin nga krahët dhe e çojnë te gryka e një pusi të thellë e plot flakë. Kjo situatë e frikëson atë, ka frikë se mos do ta hedhin brenda pusit. Por dy personat, kur e vërejnë këtë gjë, i thonë: “Mos u frikëso, nuk ke pse shqetësohesh.” Pasi ia tregon ëndrrën Profetit tonë (s.a.s.), Ai e interpreton në këtë mënyrë ëndrrën e Abdullah ibn Omerit (r.a.): “Sa

¹¹⁷ Surja Muzzemmil, ajetet 1-8.

¹¹⁸ Surja Isrá, ajeti 79.

¹¹⁹ Surja Sexhde, ajeti 16.

¹²⁰ Surja Insán, ajetet 25-26.

njeri i mirë është Abdullah ibn Omeri; ah, sikur të falte edhe namazin e tehexhudit!”¹²¹ Allahu, duke i treguar Abdullah ibn Omerit në ëndrrën e tij atë fragment të jetës së varrit me pamje që i përkisnin Xhehenemit, i sinjalizoi atij që të merrte masa e të përgatitej.

Krahas këtyre, edhe namazet e tjerë nafile, si namazet ‘duhá’ dhe ‘eu’uábin’, do të kryejnë detyrën e fashimit të të metave dhe mangësive të mbetura të namazeve farz dhe do t’i plotësojnë ato. Allahu (xhel’le xheláluhu) do t’i mbushë boshllëqet në farzet tona nëpërmjet nafileve.

Ashtu siç shpjegohet në një hadith që e vërteton këtë, në krye të gjërave për të cilat do të na kërkohet llogari në botën tjetër qëndron namazi. Zoti i Madhëruar do të pyesë: “A janë të plota namazet e robit tim?” Kur të thonë “Po, të plota janë.”, Ai do të urdhërojë me fjalët “Atëherë le të kalojë.”. Nëse do të thuhet “Namazet e tij janë të mangëta.”, Zoti do të pyesë: “A ka falur namaze nafile?” Dhe, pasi të marrë përgjigjen “Po, ka falur edhe namaze nafile.”, Ai do të urdhërojë kështu: “Plotësojani mangësitë me namazet e tij nafile.” Në këtë mënyrë, si rezultat i pasqyimit dhe shfaqjes së mëshirës hyjnore, namazet nafile do të zënë vendin e namazeve farz të mangët.¹²² Këtë, nëse doni, mund ta interpretoni edhe kështu: “Fashimi i thyerjeve dhe lëndimeve (xhebran lin’nuksan) ndodh me vullnetin dhe dëshirën e Zotit të Plotfuqishëm, në një mënyrë të drejtpërdrejtë; pra, është Allahu (xhel’le xheláluhu) Ai që na e lidh fashën në botën tjetër.”

Me pak fjalë, një zemër delikate është burim i dëshirës, entuziazmit, forcës dhe moralit për t’u treguar të kujdesshëm ndaj namazeve farz e nafile dhe për të përmbushur detyrën tonë të të qenit robër të Zotit në këtë botë; ndërsa në botën tjetër, në atë rrugë plot peripeci, e cila fillon me vdekjen dhe zgjatet deri në Xhenet, ajo do të jetë për ne një bashkëudhëtare besnike dhe një ndërmjetësuese. Namazi do të jetë ai që do të na afrojë te Krijuesi i Lartë, litari i pashkëputshëm tek i cili do të kapemi për të qëndruar në vend, një vjegë shumë e fortë dhe

¹²¹ Buhári, tehexh’xhud 2, 21, fedáilu ashábin’nebi 19, tabir 35, 36; Muslim, fedáilus’sahabe 139, 140.

¹²² Tirmidhí, salát 188; Ebú Dáuúd, salát 144; ibn Máxhe, ikámetus’salát 202.

një dorezë ku mund të mbahemi. Le të kujtojmë gjithashtu se namazi është një burim jete të dëlirë dhe një mur rrethues që na mbron nga imoralitetet dhe le ta mbyllim këtë temë duke përmendur kuptimin e ajetit që shpreh pikërisht këtë të vërtetë:

“Lexo (o Muhamed) atë që të është zbritur ty prej Librit (Kuranit) dhe fale namazin! Vërtet që namazi të ruan nga shthurja e nga çdo vepër e shëmtuar dhe vërtet që përmendja e Allahut është më e madhe! Allahu di gjithçka që ju bëni.”¹²³

7. Namazi i Profetit tonë të dashur (s.a.s.)

Vetë Zoti i Madhëruar na e shpjegon mënyrën se si lidhej në namaz dhe si e falte atë Pejgamberi ynë (s.a.s.): ***“Dhe mbështetu në të Plotfuqishmin, Mëshirëplotin, i Cili e sheh qëndrimin tënd në këmbë (gjatë namazit) dhe lëvizjet e tua midis atyre që përulen në sexhde.”***¹²⁴ Me këto fjale, Allahu i Madhëruar na vë në dijeni për vuajtjen e të Dërguarit të Tij në kijam e sexhde, na tregon për përgjegjshmërinë e tij në kryerjen me përpikëri të pjesëve të namazit, për vështirësinë e detyrës së tij si rob i Zotit dhe për përpjekjen dhe vuajtjen e tij të brendshme, që këtë detyrë të mund ta përmbushë në mënyrën më të mirë të mundshme.

Të gjitha këto vuajtje të të Dërguarit të Allahut (s.a.s.) janë shprehje e respektit dhe nderimit që i duhet bërë Allahut të Madhëruar, kurse kjo shprehje e Allahut (*xhel’le xheláluhu*) në Kuranin Famëlartë është një lavdërim për Profetin tonë (s.a.s.). Në fakt, namazi shkruhet si namaz për sa kohë gjendesh para Zotit tënd; nëse bota e brendshme dhe ajo shpirtërore i rrinë larg Krijuesit të botëve, atëherë ai del nga të qenit namaz dhe shndërrohet në diçka të pafrytshme. Sepse Allahu i Madhëruar nuk shikon trupat, po zemrat; Ai shikon dëshirën dhe entuziazmin brenda zemrave dhe sipas tyre vendos. Aishja (r.a.) na

¹²³ Surja Ankbút, ajeti 45.

¹²⁴ Surja Shu’ará, ajetet 217-219.

transmeton se, gjatë faljes së namazit, gjoksi i Profetit tonë (s.a.s.) lëshonte një zë si zhurma e gurit të mullirit apo si ajo e zierjes së gjellës brenda një tenxhereje.¹²⁵ Po, Ai (s.a.s.), kur dilte para Allahut, vlonte si një temjanicë dhe, mandej, fillonte të lëshonte aromë madhështie. Sigurisht, kjo gjendje e Pejgamberit tonë (s.a.s.) vinte si rezultat i përpjekjes së tij për të shprehur në nivelin më të lartë të mundshëm adhurimet dhe robërinë ndaj Zotit.

Namazi ishte ajo gjë që Ai e dëshironte fuqishëm. Asgjë tjetër nuk i jepte Atij kënaqësinë që i mundësonte namazi. Prandaj një ditë do të thoshte kështu: *“Namazi është drita e syve të mi.”*¹²⁶

Kurse në një hadith tjetër, të transmetuar nga Taberaniu dhe që e përforcon kuptimin e hadithit të lartpërmendur, Profeti ynë (s.a.s.) shprehet me këto fjalë: *“Allahu i ka dhënë secilit profet një pasion, një dëshirë të fortë ndaj diçkaje. Dëshira ime, pasioni im është namazi i natës.”*¹²⁷

Adhurimet e të Dërguarit të Allahut dhe lidhja e Tij me Allahun, po ashtu edhe shpallja dhe dëshmimi i njësimiit hyjnor nga ana e Tij, aq të thella ishin, saqë, deri më sot, shumë njerëz nuk kanë qenë në gjendje ta kuptojnë këtë thellësi. Hadithi që cituam më lart është shembulli më i qartë i kësaj.

Aishja (r.a.), Nëna jonë e nderuar, tregon: “Kur u zgjova një natë, vërejta se i Dërguari i Allahut (s.a.s.) nuk ndodhej pranë meje. Mendja më vajti te mundësia se mos kishte shkuar te një nga gratë e tij të tjera. E kërkova duke prekur rreth e rrotull vetes me dorë. Dora ime preku këmbën e tij. Atëherë kuptova se i Dërguari i Allahut (s.a.s.) ishte duke u falur. Koka e tij ishte në sexhde. Mbjajta vesh. Ai, duke qarë me ngashërim, po i përgjërohej Zotit në këtë mënyrë: *‘Allahu im! Strehohem nga zemërimi Yt po te pëlqimi Yt. Strehohem nga dënimi Yt te falja Jote. Zoti im! Strehohem nga Ti te Ti, tek askush tjetër. (Strehohem*

¹²⁵ Ebú Dáúd, salát 161; Nesáí, sehu 18.

¹²⁶ Nesáí, ishretun’nisá 1; Ahmed ibn Hanbel, el Musned 3/128, 199, 285.

¹²⁷ Taberání, salát 221-222; Eú Dáúd, salát 148.

nga ashpërsia Jote te bukuria Jote, nga zemërimi Yt te mëshira Jote, nga madhështia Jote te dhembshuria Jote.) Pranoj se jam i paaftë për të të lavdëruar Ty në masën që e lavdëron Ti Vetën.”¹²⁸

Më pas, pati thënë këto fjalë:

“Të qenit afër Teje është shkak lartësimi, ai që është afër Teje është i lartësuar. E madhe është lavdia Jote. Ushtria Jote nuk mund të mposhtet. Ti nuk e thyen premtimin Tënd. Nuk ka zot tjetër përveç Teje, nuk ka as të adhuruar tjetër përpos Teje.”¹²⁹

Tregon Ebu Dherri (r.a.): “Një natë, i Dërguari i Allahut (s.a.s.) fali namaz gjer në të gdhirë, duke qarë e duke kënduar ajetin **‘Nëse Ti i dënon ata, robërit e Tu janë, e nëse i fal, me të vërtetë, vetëm Ti je i Plotfuqishmi dhe i Urti.’**”¹³⁰¹³¹

Tregon Abdullah ibn Mesud (r.a.): “Një ditë, pata vendosur të falja namaz natën bashkë me të Dërguarin e Allahut (s.a.s.). Do ta kaloja natën me Të dhe do të bëja adhurimet që do të bënte Ai. Kur Ai u lidh në namaz, u lidha edhe unë pas Tij. Por, nuk po shkonte që nuk po shkonte në ruku. Madje, në një moment, më erdhi në mendje diçka e keqe...” Ata që ndodheshin pranë tij e pyetën: “Çfarë të erdhi në mendje?” Abdullah ibn Mesudi (r.a.) u përgjigj kështu: “Aq shumë u lodha gjatë namazit, saqë, për një çast, mendova ta ndërprisja namazin tim dhe ta lija Atë (s.a.s.) vetëm në namazin e Tij.”¹³²

Aishja e nderuar (r.a.) tregon: “Në një natë kur i Dërguari i Allahut (s.a.s.) qëndroi tek unë, patëm hyrë bashkë në shtrat. Pas njëfarë kohe, më tha: *‘Aishe! Më lejo të adhuroj Zotin tim.’* ‘Betohem në Zot se dua të rrish pranë meje, por, që Ti të adhurosh Allahun, këtë e dëshiroj më shumë.’ thashë unë. Më pas, Ai u ngrit, mori abdes nga torba e ujit të varur në mur dhe u lidh në namaz. Gjatë namazit, qau derisa iu lag

¹²⁸ Muslim, salát 221-222; Ebú Dáúd, salát 148.

¹²⁹ Tirmidhí, de’áuát 90; Ebú Dáúd, edeb 97; Hejthemí, Mexhmeuz’zeuáid 10/124.

¹³⁰ Surja Máide, ajeti 118.

¹³¹ Muslim, ímán 346; Nesái, Sunenul kubrá 6/373.

¹³² Buhárí, tehexhhud 9; Muslim, salátul musáfírín 204.

e gjithë mjekra. Vazhdoi të qante edhe pasi u ul në sexhde. Vendi u lag me lotët e tij. Nuk pushoi së qari edhe pasi mbaroi namazin dhe u mbështet anash. Pranë Tij erdhi Bilali, i cili, duke i thënë ‘O, i Dërguari i Allahut! Është koha e namazit,’ e njoftoi për hyrjen e vaktit të sabahut. Por, kur e pa Atë duke qarë, Bilali iu drejtua me këto fjalë: ‘O, i Dërguari i Allahut! Përse po qan? A nuk t’i ka falur Ty Allahu të gjitha mëkatet e së shkuarës dhe së ardhmes?’ I Dërguari i Allahut (s.a.s.) iu përgjigj në këtë mënyrë: ‘O, Bilal! E si të mos qaj! Këtë natë më zbritën ajetet **‘Me të vërtetë, në krijimin e qiejve dhe të Tokës dhe në ndërrimin e natës e të ditës, ka shenja për mendarët, për ata që e përmendin Allahun duke qëndruar në këmbë, ndenjor ose shtrirë dhe që meditojnë për krijimin e qiejve dhe të Tokës (duke thënë:)** ‘O Zoti Ynë! Ti nuk i ke krijuar kot këto, lartësuar qofsh (nga çdo e metë)! Prandaj, na ruaj nga ndëshkimi i zjarrit!’¹³³ Turp për ata që i lexojnë këto ajete dhe nuk mendojnë për to!’¹³⁴

Nëna jonë Aishja (r.a.), duke thënë “Ai qëndronte në kijam në një mënyrë të atillë që, lëre, mos më pyet! Mos më pyet as për rukunë e Tij! Mos më pyet as për mënyrën se si ulej në sexhde!”¹³⁵, pra, duke u shprehur në këtë mënyrë, është përpjekur të na shpjegojë bukurinë e namazit të të Dërguarit të Allahut (s.a.s.).

Është e pamundur të tregohet ndonjë adhurim që Profeti ynë (s.a.s.) ta ketë ndërprerë pasi e ka filluar. Edhe pse i linte ndonjëherë disa nafile për t’i mundësuar edhe lehtësira umetit të vet, Ai i tejmbushte këto boshllëqe gjatë netëve, duke i kryer ato adhurime të shumëfishuara. Në këtë mënyrë, Ai e përmbushi më së miri detyrën e të qenit një pejgamber rob. Pejgamberi ynë i dashur (s.a.s.), duke e jetuar të gjithë jetën e tij brenda një vetëdijeje të plotë dhe pa çuar dëm asnjë çast të saj dhe duke rrahur pa pushim flatrat në fluturimin drejt Allahut, është përpjekur të ngrihet lart e më lart. Dhe, sigurisht, nuk kishte si të mendonte ndryshe as gjatë çasteve të fundit të jetës. Zaten, dera e

¹³³ Surja Áli Imrán, ajetet 190-191.

¹³⁴ ibn Kethír, Tefsírul Kur’án 1/442.

¹³⁵ Buhári, terauh 1; Muslim, salátul musáfirín 125.

shtëpisë së Tij të lumturisë hapej brenda mesxhidit. Sepse Ai (s.a.s.) dëshironte që njëren këmbë ta kishte gjithmonë brenda mesxhidit. Gjatë kohës së itikafit qëndronte në mesxhid. Ndonjëherë, zgjaste kokën për tek shtëpia e Tij e lumturisë dhe sikur ndahej më dysh; njëra gjysmë e Tij mbetej brenda mesxhidit të Tij të bekuar, kurse gjysma tjetër në shtëpinë e Tij. Edhe kur kishte për të shkuar diku, kalonte përmes mesxhidit, falte namazin dhe ashtu largohej; të njëjtën gjë bënte edhe kur kthehej. Namazi i ishte bërë rrugë Atij, ndërsa mesxhidi ishte një destinacion i përhershëm, një katapultë që do t'i mundësonte arrijtjen e botës mes botës së mundshme dhe asaj të domosdoshme.

8. Sëmundjet që prekin namazin

a. Hedhja e vesveseve nga ana e shejtanit

Shejtani jeton duke u qëndruar besnik fjalëve *“Ai tha: ‘Për shkak se Ti më flake tej, unë do t’u zë pritë njerëzve në rrugën Tënde të drejtë.’”*¹³⁶, të cilat i pati thënë në çastin kur ngriti krye ndaj urdhrin të Allahut, dhe, duke iu afruar besimtarëve nga para, nga mbrapa, nga e djathta dhe nga e majta, përpiqet në çdo çast t’i bëjë ata të devijojnë nga rruga e drejtë. Pra, qëllimi i tij është që ta pengojë besimtarin, ta bëjë atë të heqë dorë nga kryerja e çfarëdolloj vepre të mirë. Profeti ynë (s.a.s.), në lidhje me këtë dinakëri të shejtanit, shprehet kështu: *“Shejtani lëviz nëpër venat e birit të Ademit.”*¹³⁷

Shejtani i afrohet besimtarit më së shumti gjatë namazit. Sepse namazi është adhurimi që i përfshin edhe kuptimet e të gjitha adhurimeve të tjera. Për rrjedhojë, asnjë adhurim nuk mund të arrijë në nivelin e tij. Për shkak të kësaj veçorie të namazit, gjatë kryerjes së tij e ngacmon njeriun shejtani; i hedh vesvese zemrës së besimtarit, ndërsa kokën e tij e sulmon me shigjetat e dyshimit dhe hezitimit; orvatet t’ia prishë atij namazin duke e shpërqendruar,

¹³⁶ Surja A’ráf, ajeti 16.

¹³⁷ Buhárí, i’tikáf 11, 12, bed’ul halk 11, edeb 121, ahkám 21; Muslim, selám 23, 24.

duke e bërë të mendojë për mesele të kësaj dynjaje.

Nëpërmjet hadithit “Kur në një vend këndohet ezani, shejtani largohet që aty i xhindosur; vrapon derisa arrin në ndonjë vend nga ku nuk mund ta dëgjojë ezanin. Me mbarimin e ezanit, kthehet sërish. Kur fillon ikameti, largohet edhe një herë. Vjen prapë pasi mbaron këndimi i ikametit dhe futet mes robit dhe zemrës së tij. Me pëshpëritje të llojit ‘Kujto edhe atë gjë, mendo edhe për këtë gjë!’, i hedh vesvese për gjëra që as i ka çuar në mendje më parë. Aq sa personi (në një situatë të këtillë) të mos jetë në gjendje të dijë sa rekate ka falur.”¹³⁸, Pejgamberi ynë (s.a.s.) na bën me dije se shejtani u vihet më shumë nga pas njerëzve që, nëpërmjet namazit, arrijnë në dimensionet e miraxhit; ai nuk u afrohet atyre me zemra të shkretuara e anë shpirtërore të rrënuar.

Po, shejtani nuk merret me njerëzit që nuk kanë një jetë shpirtërore. Sepse ata janë prej atyre, në jetët e të cilëve nuk ka më vend për namazin, agjërimin, haxhin, madje as për besimin në Zot; ata janë prej atyre për të cilët shejtani thotë “Ata, me çdo gjë të tyren, i janë bashkuar ushtrisë sime.”. Për rrjedhojë, shejtani nuk ka më nevojë t’i kapë këta njerëz për jakash. Me këto gjendje të tyre, ata janë bërë shejtanë të vetvetes dhe nuk kanë punë tjetër përveç përpjekjes për të nxjerrë njëri-tjetrin nga binarët. Kjo është arsyeja pse ai kërkon gjithmonë zemrat e përshpirtshme, ato të mbushurat plot, që t’iu vardiset derisa të gjejë rastin për t’i zhvatur. Sa njeri i madh është ai që i përkushtohet adhurimit! Edhe pse i sulmuar nga shejtanët më të egër e të përbetuar në djallëzitë e tyre, është në gjendje të jetojë më ndershmërisht se të tjerët dhe të jetë i përgjegjshëm nga ana morale. Ai mendon vetëm për një gjë: ditë e natë të jetë në rrugën për në mesxhid, të mund të qëndrojë para Zotit me zemër dhe shpirt vigilent. Zaten, për ata që ia dalin të jenë kështu, shejtani thotë: **“Përveç robërve të Tu të sinqertë (të gjithë do t’i shpie në mashtrim).”**¹³⁹ Me fjalë të tjera, ai pohon se nuk do të jetë në gjendje t’i prekë e t’i bëjë të devijojnë në rrugë të

¹³⁸ Buhári, edhán 4, el amel fissalát 18, seuh 6, bed’ul halk 11; Muslim, salát 19, mesáxhid 83.

¹³⁹ Surja Hixhr, ajeti 40; surja Sád, ajeti 83.

gabuar profetët dhe ata njerëz që e kanë kapërcyer vetveten, që e kanë marrë nën këmbë dynjanë me gjithë ç'ka ajo brenda, që kanë ditur të ngrihen sërish e të vazhdojnë rrugën edhe pasi janë rrëzuar, që kanë gjetur qetësinë shpirtërore dhe paqen në zemrat e tyre nëpërmjet faljes pesë herë në ditë dhe që kanë zgjedhur të merren e të luftojnë jo me të tjerët, po me nefsën e tyre. Me këto fjalë, shejtani pranon dobësinë dhe pafuqinë e tij në këtë pikë.

Po, shejtani do t'u vihet nga pas zemrave të lulëzuara. Do t'u afrohet atyre që vendosin kokën në tokë gjatë namazit dhe që pohojnë dobësinë, varfërinë dhe vogëlsinë e tyre duke thënë "Te Ti erdha, Zoti im!"; do t'u afrohet besimtarëve gjatë faljes dhe, nëpërmjet vesveseve, do të përpiqet t'ua prishë atyre namazin. Mirëpo, një hadith, që ka të bëjë me këtë temë, shfaqet para nesh me këtë sihariq: "*Nëse biri i Ademit lexon një ajet sexhdeje dhe, pastaj, bie në sexhde, shejtani largohet që aty duke qarë dhe thotë: 'Mjerë unë! Njeriu u urdhërua për të bërë sexhde dhe ai e bëri atë. Në këmbim, i është premtuar Xheneti. Edhe mua më urdhëruan të bija në sexhde, por unë kundërshtova. Dhe për mua ka zjarr!'*"¹⁴⁰

Kur ne të biem në sexhde duke e barazuar veten me një zero të madhe, ai ndoshta do të orvatet të na e tërheqë vëmendjen te gradat, postet, profesionet, të korrat, dyqanet, mallrat apo pronat tona, të cilat nuk kanë vlerë as sa krahu i një mize. As që mund të mendohet vënia e tyre në një peshore me ato çfarë na ka premtuar Zoti i Madhëruar. Si përgjigje ndaj përpjekjeve të shejtanit, ne do të mendojmë miraxhin që jemi duke kryer dhe, të emocionuar nga shfaqja e shkallëve para syve tanë, do të kujtojmë ngarendjen tonë pa frymë drejt përballjes me mëshirën e Zotit të Gjithëmëshirshëm. Mandej, duke thënë "O, i mallkuar! Zoti ynë na premtonte Xhenetin dhe Bukurinë e Tij. Po ti, ti ç'kapital ke?" dhe duke u thelluar akoma më shumë në sexhdet tona, do të përpiqemi të shpëtojmë nga këto vesvese.

¹⁴⁰ Muslim, imán 133; ibn Máxhe, ikáme 70; Ahmed ibn Hanbel, el Musned 2/442.

b. Vjedhjet e shejtanit nga namazi

Shikimi majtas-djathtas gjatë faljes së namazit quhet vjedhje e shejtanit nga namazi. Domethënë, ai nuk mund ta vjedhë namazin të gjithin, por vetëm ndonjë pjesë të vogël të tij. Pjesët që përbëjnë shtyllat e namazit nuk mund t'i vjedhë. Rrjedhimisht, kartën e tij të fundit e përdor për të vjedhur shikimet e atij që po fal namaz. Orvatet duke thënë: “A mund ta bëj të shikojë djathtas, a mund ta bëj të hedhë shikimin majtas?”

Nuk duhet lejuar që të na vidhet diçka nga namazi. Nga namazi nuk duhet humbur asgjë. Shejtani nuk duhet të vjedhë asgjë prej tij. Ai është një amanet. Njerëzit besnikë ndaj amanetit të namazit të plotë e të përsosur duhet t'i kryejnë namazet e tyre në përputhje me thelbin e të vërtetës së namazit në botën e ndërmjetme. Për të shmangur shqetësimet atje, nuk duhet t'i shkaktojmë këtu shqetësime namazit, duhet të bëhemi pengesë ndaj duarve vjedhëse që zgjaten drejt tij. Duhet t'i drejtohem Allahut (*xhel'le xheláluhu*) me gjithë zemër, me të gjitha ndjenjat tona dhe me çdo pjesë të shpirtit; nuk duhet të na vidhet asgjë, nga asnjë pjesë e namazit. Për ata që janë në fillim të kësaj pune, është e vështirë që ta kryejnë atë duke e ndier në maksimum. Por Zoti mund ta hapë një ditë atë derë. Ju shtrëngojini dhëmbët; kohën tuaj më të rëndësishme, atë më të përshtatshmen, kushtojani namazit dhe jepini vetes një shtytje në këtë pikë. Dhe, në dashtë Allahu, do të vijë dita kur për ju do të lindë mundësia për ta kryer atë në një mënyrë sa më të bukur.

c. Dembelizmi ndaj namazit

Duke qenë se besimi vjen në krye të çdo çështjeje dhe është baza e secilës prej tyre, është e nevojshme që meselesë së dembelizmit ndaj namazeve t'i qasemi në radhë të parë nga ky këndvështrim. Parimet e renditura ndër kushtet e besimit i japin formë pikëpamjes së individit. Prandaj, besimi në Zot është baza dhe garancia e vetme e paqes dhe qetësisë shpirtërore. Zemrat që nuk janë në gjendje të përfitojnë nga

besimi në Zot, pa asnjë dyshim, nuk mund ta mbushin këtë boshllëk me asgjë tjetër. Këtë të vërtetë na kujtojnë edhe ajetet **“Thuaj: ‘Me të vërtetë, Allahu shpie në humbje ata që Ai do, ndërsa udhëzon në rrugë të drejtë ata që kthehen tek Ai, ata që besojnë dhe zemrat e të cilëve, kur përmendet Allahu, qetësohen. Vërtet, zemrat qetësohen me përmendjen e Allahut!’”**¹⁴¹

Besimi në profetët është një faktor i rëndësishëm, i cili na shpëton nga fatkeqësia e të parit të së shkuarës në errësirë, ndërsa e asaj të së ardhmes në ankth. Ne besojmë se, falë besimit në profetët dhe veçanërisht atij në Sulltanin e Profetëve, vendet më të rrezikshme të kësaj bote dhe botës së përtejme do t'i kalojmë me shpejtësinë e një rrufeje verbuese dhe se, në sajë të ndërmjetësimit të Tij të madh, do të nderohemi me mirësi e begati që i kapërcejnë horizontet e imagjinatës sonë.

Besimi në librat hyjnorë, tablotë që përshkruhen në ato libra (sidomos ato në lidhje me botën tjetër), përshkrimi i Xhenetit dhe Xhehenemit u mundësojnë besimtarëve një gjendje tendosjeje metafizike të vazhdueshme. Një person që lexon në librat hyjnorë për tmerrin e ditës së llogaridhënies, përpiqet ta shfrytëzojë më së miri çdo çast të jetës së tij.

Besimi në engjëj na bën të ndihemi me ta edhe gjatë atyre momenteve kur jemi vetëm. Falë këtij besimi, ne ndihemi sikur jemi nën kontrollin dhe mbikëqyrjen e tyre në çdo çast. Kështu, ne marrim nën kontroll sjelljen dhe veprimet tona dhe e jetojmë jetën duke e ndier atë.

Besimi në kader do të thotë të besosh se çdo gjë që ndodh, qoftë ajo një fatkeqësi apo një myzhde, është prej Allahut dhe të jesh i sigurt se e kundërta e kësaj nuk është aspak e mundur.

Besimi në botën tjetër, përveçse është një element shumë i rëndësishëm i kushteve të imanit dhe që na mundëson të marrim nën kontroll sjelljet tona, na siguron gjithashtu edhe përfitime të panumërta që kanë të bëjnë me këtë botë. Për më tepër, takimi ballë për ballë me të Dërguarin e Allahut (s.a.s.), që është ëndrra e çdo besimtari, vetëm

¹⁴¹ Surja Ra'd, ajetet 27-28.

në botën tjetër do të jetë i mundur. Të gjithë profetët e mëdhenj, të parët tanë të virtytshëm, evlijatë dhe të devotshmit e lartë janë në botën tjetër. Për rrjedhojë, besimi në botën tjetër i besimtarëve që digjen nga dëshira për t'u takuar me ta dhe ato çfarë ata fitojnë nëpërmjet këtij besimi janë një tjetër gjë.

Besimi në tërësinë e këtyre bazave do ta ulë personin aty ku duhet të ulet përsa i përket besimit (*akíde*), e do t'i mundësojë atij qetësinë shpirtërore dhe paqen e vërtetë. Pas kësaj, do të zhduken në mënyrë të vullnetshme elementët që e cenojnë këtë qetësi dhe do të kryhen adhurimet që do të bëjnë të mundur ruajtjen e vazhdimësisë së saj. Kjo do të thotë se arsyeja e dembelizmit ndaj namazeve duhet kërkuar në bazat e besimit, të cilat vijnë para adhurimeve dhe që i përmendëm shkurtimisht pak më sipër. Për ata me besim të plotë, kurrë nuk mund të flitet për ballafaqime me probleme të këtilla.

Namazi është ai adhurim që na i kujton një nga një bazat e besimit që i cekëm më lart përmbledhtazi. Namazi e ka gjithmonë potencialin e tij përkujtues dhe, krahas këtij potenciali, të mundëson edhe një kënaqësi të thellë. Ai na kujton dobësinë dhe varfërinë tonë përballë Zotit, na tregon rrugët që çojnë në zgjidhjen e problemeve, kapërcimi i të cilëve mund të na duket i pamundur. Dhe, në fakt, thelbi dhe baza e kësaj që sapo thamë është besimi në një të Plotfuqishëm Absolut, forca e të Cilit mjafton për gjithçka. Këtë çështjen e fundit mund ta shtjellojmë pak më shumë duke u ndalur në ajetet e sures Fátiha:

“El hamdu lil’láhi Rabbil álemín.” “Çdo lavdërim i përket Allahut, Zotit të botëve, që krijon, edukon, disiplinon, rrit dhe pjek çdo gjë, nga grimcat deri te sistemet.” Pasi të ketë besuar në një Zot të tillë, që e kap nga dora dhe e shpëton nga mbytja, pse të jetë i pashpresë dhe të bjerë në pesimizëm njeriu përballë mijëra ngjarjeve?

“Err’Rrahmánirr’Rrahím.” “Ai është i Gjithëmëshirshëm dhe Mëshirëplotë në këtë botë dhe në botën tjetër, ndaj besimtarëve, por edhe ndaj mosbesimtarëve.” Mëshira e Tij e tejkalon zemërimin e Tij. Atëherë, përse t'i humbasësh shpresat e të dëshpërohesh?

“Málíki jeumiddín.” “Ai është Sunduesi i Ditës së Gjykimit.” Robit do t’i paraqiten të gjitha veprat që ka bërë këtu, madje edhe ato më të voglat, dhe do t’i kërkohet llogari për çdo gjë. Por Zoti ynë, mëshira e të Cilit është shumë më e madhe se zemërimi i Tij, do të zgjatë drejt nesh dorën e ndihmesës edhe atje.

“Ijjáke na’budu ue ijjáke neste’in.” “Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë.” Shpallim dhe pranojmë para Sundimit dhe Madhësisë Tënde që ne jemi robërit e Tu. Por ç’robëri e nderuar është kjo! Ti je Sulltani ynë, Sulltan mbi sulltanë, Allahu ynë. Ne jemi të lartë e të nderuar, aq sa për të mos iu përkulur asnjë krijese. Ne jemi të gatshëm të ngremë krye ndaj çdo gjëje të papëlqyeshme për Ty dhe vetëm Ty të dëshirojmë!

“Ihdinas’sirátal mustekím. Sirátal’ledhíne en’amte alejhim gajril magdúbi alejhim ue leddál’lín.” “Udhëzona në rrugën e drejtë, në rrugën e atyre që u ke dhuruar mirësi e jo në atë të atyre që kanë shkaktuar zemërimin Tënd, as në atë të atyre që janë të humbur!”

Ngaqë njeriu nuk mund ta dijë se cila do të jetë ndihmesa më e rëndësishme për të, Allahu (*xhel’le xheláluhu*), si vepër e mëshirës së Tij, i mëson atij atë çfarë duhet të kërkojë fillimisht dhe e urdhëron të thotë **“Ihdinas’sirátal mustekím.”**

Në fakt, dalja para Allahut me një adhurim të këtyllë, që bëhet me vetëdije dhe që shfaq besimin në një Zot të vetëm nga çdo anë që ta kapësh, dhe të kërkuarit ndihmë prej Tij janë nga një pohim i paaftësisë për t’i kryer plotësisht dhe ashtu siç duhet falënderimet dhe adhurimet përkarsi mirësive dhe begatave të Allahut, janë shpalljet e strehimit dhe mbështetjes te Zoti, i Cili është i Pasuri Bujar dhe i Plotfuqishmi i Madhëruar, nga ana e njeriut që, i vetëdijshëm për dobësinë dhe varfërinë e tij, e ka kuptuar marrëdhënien Krijues-krijesë. Si mund të jetë i pashpresë një njeri që gjendet brenda një botëkuptimi të tillë dhe i rrethuar nga mendime të këtylla?

Po, për një njeri që ia del t’i falë namazet me ndjenja dhe mendime

të tilla, është e paimagjinueshme që, duke nxjerrë si pretekst punët e kësaj dynjaje, ta braktisë faljen e namazit. Prandaj, është e nevojshme që, krahas besimit, këtyre njerëzve t'u shpjegohet edhe e vërteta e namazit dhe, nëse është e mundur, të ndihmohen në mënyrë që edhe ata të mund t'i ndiejnë të gjitha këto.

Njeriu mund ta plotësojë zhvillimin e tij nëpërmjet adhurimit të namazit ashtu siç plotëson luledielli zhvillimin e saj duke parë diellin. Duke iu drejtuar Zotit pesë herë në ditë, ai mund të bëjë të mundur ringjalljen e ndërgjegjes së zbehur dhe ndjenjave të tij të vyshkura. Ai mund të fitojë edhe një herë freskinë, gjallërinë e tij dhe, kështu, mund të ripërtërijë premtimin e tij ndaj Zotit.

Në këtë këndvështrim, namazi është begatia më e madhe e Allahut ndaj nesh. Mungesa e tij është si mungesa e diellit. Ashtu siç nuk mund të ketë luledielli në mungësi të diellit, – parë nga aspekti shkak-pasojë – po ashtu nuk mund të ekzistojë as njeriu, në një farë kuptimi, nëse nuk janë adhurimet. Pra, jemi ne ata që janë me të vërtetë nevojtarë ndaj adhurimeve.

Nga ana tjetër, një njeri që fal namaz dhe mbushet shpirtërisht para Zotit të tij, tregohet i kujdesshëm dhe u shmanget, me aq sa është e mundur, edhe gjërave të dëmshme e problematike në punët e ndryshme të jetës së tij të përditshme. Namazet, sidomos namazet e drekës dhe ikindisë, mundësojnë shpërthimin e ndjenjave të mbikëqyrjes dhe vetëllogarisë të njeriu; aktivizojnë këto mekanizma dhe, në këtë mënyrë, e mbrojnë njeriun nga rënia në gabim. Ndërsa namazet e mbrëmjes, jaciesë, tehexhudit dhe sabahut janë qendrat e shfaqjes së mistereve që synohen të shpjegohen përmes vargjeve:

*“Aty ku mbetesh pa rrugëdalje
Befas të hapet një perde
Dhe gjen derman për ato derte...”
(Ibrahim Hakki)*

Për më tepër, namazi është një faktor që e detyron myslimanin të vejë rend dhe rregull në jetën e tij të përditshme. Njeriu që del para Zotit pesë herë në ditë, dashje pa dashje, e fut në shina jetën e tij. Fillon punën pas namazit të sabahut dhe, kur lodhet pas një pune intensive prej gjashtë-shtatë orësh, rigjallërohet e fiton sërish freskinë nëpërmjet namazit të drekës. Pastaj i futet përsëri punës, vazhdon të punojë deri në kohën e ikindisë. Me namazin e ikindisë, përjeton edhe një herë tjetër një çlodhje mendore dhe fizike. Njerëzit që nuk i dinë këto baza të namazit dhe që nuk janë në gjendje t'i ndiejnë ato, rrëmbëhen prej një vorbulle shqetësimesh e trazirash dhe përplasen nga një krizë shpirtërore në tjetrën.

Shkurtimisht, ata që nuk gjejnë dot kohë për namazin duke nxjerrë si pretekst punët e shumta të tyre, janë ata që qëndrojnë symbyllur ndaj të vërtetave hyjnore. Për rrjedhojë, besimi i dobët, mosbesimi në bazat e imanit në masën që duhen besuar dhe paaftësia për të kuptuar thelbin dhe të vërtetën e namazit, fatkeqësisht, mund t'i shtyjnë njerëzit tanë drejt mendimeve të këtij lloji. Rruga e shpëtimit nga këto, siç u përpoqëm ta shtjellojmë pjesërisht më sipër, është besimi i fortë, i arritur nëpërmjet njohjes dhe dijës, dhe reflektimi i tij në jetesën tonë.

d. Lodhja nga adhurimet

Për ne myslimanët, një nga problemet dhe hallet më të mëdha që kemi është zbehtësia në çehren e adhurimeve tona. Sa e dhimbshme dhe sa e trishtueshme është gjendja e xhamive dhe e njerëzve tanë të shpërndarë brenda atyre xhamive si gjethet e shpërhapura andej-këtej në stinën e vjeshtës; dikush gogësin i përgjumur, dikush është shtrirë për shtatë palë qejfe, dikush flet për punët e kësaj dynjaje edhe nga mihrabi, dikush tjetër pret me padurim mbarimin e namazit, që të fluturojë e të dalë jashtë xhamisë një çast e më parë. Nuk dua të paragjykoj të tjerët e të mendoj negativisht për ta, por pamja që pasqyrohet jashtë në përgjithësi – sepse ka edhe përjashtime – na bën të sjellim në mendje ata njerëz që nuk kanë një lidhje të mirëfilltë me

Allahun, që nuk e njohin mirë Profetin e tyre (s.a.s.), që mbajnë rrugën e mesxhudit për shkak se kanë parë dikur gjyshërit e tyre tek shkonin në xhami, që zënë vend në rreshtat brenda xhamisë thjesht për të imituar baballarët e tyre ngaqë kanë qenë dëshmitarë të namazeve që ata kanë falur, dhe që, duke e harruar thelbin dhe brendësinë e asaj që po bëjnë, kanë mbetur vetëm te forma dhe pamja e jashtme. Kjo është arsyeja pse gjendja e xhamisë dhe ajo e xhematit të saj nuk u thotë asgjë të tjerëve; adhurimet nuk po e kryejnë detyrën e thirrjes së njerëzve të tjerë në Islam nëpërmjet gjuhës së gjendjes. Nëse ne do të shfaqim një gjendje besimi të plotë, shumëkush do të pranojë Islamin. Thënë me fjalët e Udhërrëfyesit të Nderuar Bediuzaman Said Nursi: *“Në qoftë se e demonstrojmë nëpërmjet sjelljes dhe veprave tona përsosmërinë e moralit Islam dhe të të vërtetave të imanit, sigurisht që ithtarët e feve të tjera do të futen në Islam grupe-grupe. Ndoshta Islamin do ta pranojnë edhe disa kontinente dhe shtete të rruzullit tokësor.”*¹⁴² Por, për fat të keq, ne nuk po e pasqyrojmë ashtu siç duhet Islamin, me atraksionet e tij të veçanta.

Në fakt, myslimanizmi është zëri dhe fryma e së ndryshmes. Në këtë aspekt, ai që shikon rukunë e një besimtari të vërtetë duhet të shtanget para tij, atij që shikon gjendjen e tij në sexhde duhet t'i bjerë të fikët, ai që dëgjon rënkimin e tij para Zotit të Madhëruar duhet të kalojë në një gjendje ekstaze dhe të ulet në sexhde bashkë me të. E pra, kur nuk përfaqësohet në këtë mënyrë Islami, nuk ka si të reflektohet në anën përballë; askush nuk mund ta shohë shpirtin e namazit dhe hijeshinë e tij të shenjtë në uljet dhe ngritjet e mbetura vetëm te forma e jashtme.

Çështë e vërteta, ne po përjetojmë një lodhje në çështjen e adhurimeve. Jemi si ushtarë të rraskapitur, që të gjithë. Sikur jemi lodhur nga adhurimet. Ndihe mi të këputur. Myslimanizmin e shohim përciptazi, ia kemi ngushtuar shumë vendin Islamit në zemrat tona. Për shkak të ambientimit, vlerave u janë zbehur ngjyrat në sytë tanë; nuk ngjallin emocion brenda nesh. Nuk po i kryejmë dot adhurimet sikur të ishim duke pirë shërbet trëndafili. Sikur edhe vetëm dy-tre veta nga

¹⁴² Bediuzamani, *Emirdağ Lahikası* 2/142.

xhemati të kalonin në ekstazë gjatë faljes së namazit, ky përqendrim mund t'u thoshte shumë gjëra shpirttrave të njerëzve përreth.

Namazi që merr për pjesë vetëm lodhjen

I Dërguari i Allahut (s.a.s.) thotë: *“Ka shumë nga ata që agjërojnë dhe që nuk përfitojnë gjë tjetër veç urisë dhe etjes. Ka shumë nga ata që falin namaz dhe që nuk përfitojnë asgjë tjetër veç mundimit dhe lodhjes.”*¹⁴³

Kuptimi që shpreh namazi, veçanërisht kuptimi i brendisë së tij, lidhet ngushtë me thellësinë e brendshme të njeriut. Edhe në Kuran, në çdo pjesë ku përmendet dhe shpjegohet namazi, theksohet kjo thellësi e brendshme e tij. Për shembull, në suren *Mu'minún*, ndërsa përshkruhen njerëzit që kanë arritur shpëtimin, nëpërmjet ajeteve ***“Me të vërtetë, janë të shpëtuar besimtarët, të cilët janë të përlulur në namazin e tyre.”***¹⁴⁴, vihet në pah marrëdhënia mes namazit, *hushú*-së dhe *hudú*-së. Po, *hushú*-ja dhe *hudú*-ja gjejnë kuptimin e tyre të vërtetë vetëm në namaz. Për rrjedhojë, gjatë faljes së namazit, njeriu nuk duhet të shohë, të dëgjojë apo të mendojë asgjë tjetër përveç namazit.

Pra, nëpërmjet namazit, duke qëndruar duarlidhur dhe i përlulur para madhësisë së Allahut, njeriu lutet me fjalë dhe me gjendjen e tij për plotësimin e nevojave që nuk është në gjendje t'i arrijë. Namazi është ushqimi i zemrës dhe miraxhi i shpirtit. Pavarësisht problemeve dhe telasheve, ai bën të mundur qetësimin e shpirtit, i jep krahë zemrës. Pejgamberi ynë (s.a.s.), kur mërzitej me punët e kësaj dynjaje, i drejtohej Bilalit të nderuar me fjalët *“Thirr ikametin e na fresko, o Bilal!”*¹⁴⁵, që të qetësoheshin nëpërmjet faljes së namazit. Namazi nuk është nga ato gjëra që mund t'i bëjë një njeri dembel dhe i përgjumur. Namazi është një detyrë, të cilën mund ta përmbushin vetëm zemrat e zgjuara dhe vigjilente para Zotit.

¹⁴³ Ibn Máxhe, sijám 21; Ahmed ibn Hanbel, el Musned 2/373.

¹⁴⁴ Surja Mu'minún, ajetet 1-2.

¹⁴⁵ Ebú Dáúd, edeb 85.

Ai që mendon për punët e dynjasë edhe gjatë namazit, që merret me llogaritë e tyre, veç lodhjes, asnjë përfitim tjetër nuk do të ketë. Zoti im mos lëntë askënd në një gjendje të këtillë! Le të lutemi në këtë mënyrë, le të kërkojmë nga mëshira e Tij e pafund. Na i bëftë zemrat dhe ndjenjat tona vigjilente, të përlurura e të bindura ndaj Tij gjithmonë!

Nuk është e pëlqyeshme që leximi i Kuranit dhe kryerja e dhikreve apo duave të bëhen në mënyrë të pavetëdijshme, pa menduar në lidhje me kuptimet e tyre, por, edhe kur bëhen në këtë mënyrë, ato prapë ndikojnë në njëfarë mënyre te një pjesë e ndjenjave tona dhe, kështu, ne arrijmë të përfitojmë diçka. Le të shpresojmë që edhe ajo përpjekje aq e vogël, ashtu si pikat e vogla të shiut, të bëhet shkak për stimulimin e farave në gjirin e tokës. Njeriut ama, që të mund të përfitojë sa më thellësisht nga namazi, i takon të përpiqet sa më shumë. Që të mund të hapë velat drejt mendimeve dhe përfytyrimeve më të thella, njeriu duhet ta sfancojë ca veten. Është e nevojshme që, me një përpjekje për t'i thënë në mënyrë të vetëdijshme dhe për t'i kuptuar më së miri ato, çdo fjalë e shprehje të arrijë në thellësitë e zemrës. Të ndierit me vetëdije e bën njëshin një mijë.

Por edhe ta braktisësh namazin duke thënë “Nuk jam në gjendje të lexoj në mënyrë të vetëdijshme, nuk arrij të marr kënaqësi nga adhurimet e mia.” është gjithashtu gabim. Sepse një mendim i tillë është nga mashtrimet e nefsit. Pavarësisht kushteve të vështira dhe atyre më negative, e rëndësishme është të përmbushim plotësisht detyrat tona, si ato personale, edhe ato shoqërore. Ndonjëherë, një heshtje e gjatë është më domethënëse dhe shpreh më shumë se një hutbe e gjatë. Të jesh në gjendje të ruash dëshirën dhe entuziazmin ndaj adhurimeve në çfarëdo rrethanash të rënda, ndoshta mund të jetë më e vlefshme se adhurimet e shumta të kryera në të njëjtat rrethana. Për shembull, ne nuk jemi në gjendje ta dimë se cili vlen më shumë, një namaz i falur në xhami dhe që na e bën zemrën të hidhet përpjetë apo kuptimi i asgjësisë sonë pasi kemi vënë kokën në sexhde në një vend ku nuk ndodhet askush tjetër përveç nesh. Për këtë arsye, mbase e kanë gabim ata që janë gjatë gjithë kohës të qetë. Sepse është e pamundur për ne

të parashikojmë saktësisht se me cilat vepra tonat do të jetë i kënaqur Zoti i Madhëruar.

Një kujtim dhe kujdesi në namaz

Një nga njerëzit që nuk do t'i harroj kurrë është edhe i ndjeri Xhelal Efendi, babai i hoxhës së nderuar Mehmet Kërkënxhë. Xhelal Efendiu ishte një njeri me vlerë, një *muxhâuir*¹⁴⁶ në Medine. Atje ndërroi jetë dhe po atje u varros. Kur unë vajta për t'i bërë një vizitë, ai ishte shumë i moshuar. Dhe, pavarësisht moshës së thyer dhe shqetësimeve të shumta shëndetësore, nuk i linte të mangëta namazet e tij, madje edhe sunetet i falte në këmbë. Por, ngaqë e kishte të vështirë të ulej e ngrihej, namazet i falte pranë shtratis. Sepse, që të mund të ngrihej në këmbë, i duhej të mbahej te shtrati. Pas një namazi të falur në këtë mënyrë, më qe drejtuar mua: “Hoxhë, unë kështu ngrihem kur fal namaz, duke u mbajtur te shtrati. A më quhen namazet që fal në këtë mënyrë?” Këtë tablo nuk mund ta harroj kurrë. Ç’vetëdije e mahnitshme është kjo! Pavarësisht gjithçkaje, të përpiqesh për ta përmbushur ashtu siç duhet detyrën e të qenit rob i Zotit dhe, prapëseprapë, të mos mjaftohesh me aq sa ke bërë, po të kërkosh për atë që është akoma më e mirë...

Po, namazi është kapitali që do të na shpëtojë në botën tjetër. Prandaj është e nevojshme të tregohemi shumë të ndjeshëm në çështjen e namazit. Allahu (*xhel’le xheláluhu*) na bëftë të vetëdijshëm në lidhje me vlerën e tij dhe na i pranofte namazet tona me të metat dhe mangësitë e tyre!

9. Ekuilibri mes namazit dhe lartësimit të emrit të Allahut

Çdo adhurim ka vendin dhe peshën e vet. Të gjitha obligimet e besimtarit, me metodat, llojet dhe nënlojet e tyre, që nga çështjet më themelore të tyre e deri te çështjet më të hollësishme, janë në një

¹⁴⁶ Kështu quhen ata që vendosin ta kalojnë jetën e tyre në një vend të shenjtë, duke iu përkushtuar adhurimeve dhe kryerjes së shërbimeve të atij vendi.

harmoni të përsosur me njëri-tjetrin. Mes tyre nuk ekziston asnjë mospërputhje. Ashtu siç nuk mund të jetë ndikues xhihadi pa namazin dhe agjërimin, po ashtu as kryerja e një namazi në përputhje me të vërtetën e tij nuk është e mundur pa xhihadin. Po, këta qëndrojnë krah për krah me njëri-tjetrin. Ata bëjnë të mundur vazhdimësinë e ekzistencës së tyre së bashku, njësoj si gurët e një kubeje, të mbështetur te njëri-tjetri kokë më kokë.

Kështu është edhe çështja e besimit (*akíde*); ashtu siç nuk mund të ekzistojë Islami pa imanin, po ashtu nuk mund të ketë iman të plotë pa Islamin. Njeriu do të besojë fort në ato gjëra që duhet besuar, që të mund të bëhet një mysliman i mirë dhe i shëndoshë. Nëse një person i zbaton urdhrat e Islamit pa pasur një iman të fortë, pa besuar në mënyrën e duhur, do të vijë një ditë kur ai vetë – në mos ai, brezi pasardhës i tij – do të fillojë të tregojë dembelizëm në çështjen e përmbushjes së atyre urdhrave. Njeriu duhet edhe të besojë fort, edhe të veprojë duke i kryer të plota, ashtu siç duhet veprat e tij. Besimi, në qoftë se nuk mbështetet me vepra, dobësohet gradualisht dhe shkon drejt shpërbërjes. Brezi i ditëve tona është një shembull i gjallë i kësaj.

Prandaj xhihadi dhe namazi nuk duhen ndarë nga njëri-tjetri. Sahabët e nderuar falnin namazet e tyre, por bënë edhe xhihad në rrugën e Allahut. Sepse namazi, i cili bart kuptimin e ripërtëritjes së fjalës së dhënë ndaj Allahut pesë herë në ditë, duke u bashkuar me xhihadin dhe detyrat e tjera, nënkupton ecjen drejt përsosmërisë në sytë e Allahut.

Në fakt, për njeriun, edhe sikur ta ripërtërinte premtimin e tij jo pesë, po pesëqind herë në ditë, prapë me vend do ishte. Sepse vetëm në këtë mënyrë mund ta fitojë ai aftësinë për të kryer detyrën e xhihadit me entuziazëm dhe sinqeritet.

Në Kuran, *salátul hauf* (namazi i frikës) përshkruhet me të gjitha hollësitë e tij.¹⁴⁷ Nëpërmjet këtij namazi, Allahu na lë të kuptojmë se, edhe atëherë kur armiku është duke lëshuar mbi ne një shi shigjetash,

¹⁴⁷ Shihni ajetet 101-103 të sures Nisá.

edhe në çastet kur ashpërsia e luftës ka arritur kulmin, as falja e namazit me xhemat nuk duhet lënë pas dore. Po, namazi do të falet edhe nën shigjetat e armikut, madje me xhemat. Domethënë, ndërkohë që një pjesë e xhematit po qëndron përballë armikut, pjesa tjetër vjen dhe lidhet në namaz bashkë me imamin. Pas përfundimit të rekatit të parë, xhemati shkëputet nga namazi dhe kthehet në krye të detyrës në frontin e luftës; këtë herë, vijnë dhe lidhen pas imamit në rekatën e dytë ata që kishin qëndruar përballë armikut gjatë faljes së rekatit të parë. Pasi përfundon edhe rekati i dytë, të pranishmit në faljen e namazit ndërrojnë sërish vend me ata që janë në frontin e luftës. Dhe, kështu, duke ndërruar me radhë vendet, quhet se e kanë falur me xhemat namazin.

Po, namazi do të falet edhe gjatë luftimeve përballë armikut, në asnjë mënyrë nuk do të nxirret nga mendja Allahu. Njerëzit do e përmbushin këtë detyrë sepse kështu ka urdhëruar Ai. Po, namazi dhe xhihadit janë të pandashëm. Sahabët i falnin namazet e tyre edhe gjatë luftës, edhe kur ndodheshin ballë për ballë me armikun. Prandaj i përkrahte gjithmonë ata Zoti i Madhëruar. Parë nga ky këndvështrim, ata që nuk shohin përkrahje, le ta kërkojnë arsyen e mungesës së përkrahjes të marrëdhënia e tyre me Allahun (*xhel'le xheláluhu*).

Në ditët e sotme ka ca njerëz që nuk falin as edhe një namaz gjatë natës, ama, kur vjen puna të llafet, nuk ka më të gojës se ata. Por ajo për të cilën ne kemi më shumë nevojë sot nuk janë fjalët boshe, po shëndeti shpirtëror, paqja e zemrës, arritja e pastërtisë dhe dëlirësisë së brendshme. **“O besimtarë! Ju keni përgjegjësi vetëm për veten tuaj!”**¹⁴⁸ thotë Zoti në Kuran. Allahu i do njerëzit që i kryejnë adhurimet me qëllimin për të fituar pëlqimin e Zotit të tyre dhe që e respektojnë Atë. Ndërsa ata që kërkojnë t'i bien qylit, nga njëra anë thonë “Unë jam rob i Zotit, unë i bëj detyrat me të cilat më ka ngarkuar Zoti.”, ndërsa nga ana tjetër, përfshihen në një mijë lloje rebelimesh.

Sa i përket besimtarit të vërtetë, kryerjen e detyrave me të cilat e ka ngarkuar Allahu e konsideron si një çështje të rëndësishme edhe

¹⁴⁸ Surja Máide, ajeti 105.

në të qenit ndikues te të tjerët. Sepse, lidhur me këtë, duke thënë “O, Isa! Së pari këshillo neftin tënd. Nëse ai i pranon ato këshilla, atëherë këshilloji edhe njerëzit. Në të kundërt, të më druhash Mua.”¹⁴⁹, Allahu paralajmëron edhe Isanë (a.s.). Njeriu fillimisht duhet t’i kryejë vetë përgjegjësitë e tij, pastaj, kur t’i jepet mundësia, t’ua shpjegojë ato të tjerëve. Kjo është detyra kryesore e njeriut. Një person i tillë, edhe nëse do të japë shembuj nga të tjerët, do të duket sikur thotë gjithmonë ato gjë që bën. Po, për shembull, dikush që nuk fal tehexhud, duhet të dridhet nga ideja për t’ua rekomanduar atë të tjerëve ndër kohë që vetë nuk është çuar asnjëherë natën për ta kryer këtë namaz. Sepse shpjegimi i diçkaje që nuk është hedhur në jetë, që nuk është zbatuar edhe nga vetë personi që po flet, nuk do të ketë ndikim te të tjerët. Po kështu, që një njeri të jetë në gjendje të thotë “Agjëroni dy ditë në javë, të hënën dhe të enjten!”, duhet të ketë filluar njëherë vetë me agjërimin e këtyre dy ditëve. Sepse Allahu na drejtohet në këtë mënyrë: **“O besimtarë, përse thoni atë që nuk e bëni?”**¹⁵⁰. Sikur po na thotë: “A nuk ju vjen turp?”

Po, nuk mund ta ndajmë namazin nga xhihadi. Ashtu siç është xhihadi një farz i rëndësishëm, po ashtu edhe namazi është xhihadi më i rëndësishëm i njeriut ndaj neftit të tij. “Tani jeni kthyer nga xhihadi i vogël për në xhihadin e madh!” u tha një herë i Dërguari i Allahut (s.a.s.) atyre që sapo ishin kthyer nga lufta. Kur sahabët e pyetën Profetin tonë se çfarë ishte xhihadi i madh, Ai (s.a.s.) u përgjigj në këtë mënyrë: “Është xhihadi që bëhet ndaj neftit.”¹⁵¹ Pra, xhihadi i vërtetë, ai më i madhi, është përleshja me neftin, egon tonë. Një person që nuk fal namaz do të thotë se është mundur nga nefti i tij dhe i është nënshtruar atij.

Nga ana tjetër, nëse besoni se ia keni përkushtuar veten lartësimit të emrit të Allahut, duhet të mendoni për kuptimin e një detyre të këtillë dhe të përkushtimit ndaj saj, si dhe të shfaqni një qëndrim në përputhje me të. Lartësimi i emrit të Allahut është thirrje për besim në Zot; është ftesë për të pranuar Profetin tonë (s.a.s.), shtyllat e tjera të besimit dhe

¹⁴⁹ Ahmed ibn Hanbel, Zuhd 1/54; Ebú Nuajm, Hiljetul eulijá 2/382.

¹⁵⁰ Surja Saf, ajeti 2.

¹⁵¹ Bejhakí, Zuhd 1/165; Hatíb el Bagdádí, Tárihu Bagdád 13/523.

Islamin. Lartësim i emrit të Allahut do të thotë të përpiqesh shumë seriozisht për të bërë të mundur që emri i lartë i Allahut të dëgjohej kudo e të valëvitet si një flamur, që shpirti Muhamedan të hapë flatrat e të fluturojë edhe në qoshet më të errëta. Lartësim i emrit të Allahut do të thotë të ngresh akoma më lart atë që, në vetvete, është e lartë dhe sublime, pra, të vërtetën “*Lá iláhe il’lalláh Muhammedun Resúlulláh*”; ta bësh atë të dukshëm në të katër anët e botës si një ylber; ta bësh atë të dëgjohej nga të gjithë.

Pra, nëse ju po i thërrisni njerëzit të njohin Allahun, të dëgjojnë mesazhin e Tij, të lexojnë pasqyrimet hyjnore në çehren e ekzistencës dhe të adhurojnë të Adhuruarin Absolut, a nuk duhet që, si fillim, ju vetë t’ia vini veshin atij mesazhi hyjnor, t’i lexoni ato pasqyrime dhe të bëheni robër të vërtetë e të sinqertë të Tij? Nëse nuk jeni duke e kryer ashtu siç duhet një adhurim si namazi, i cili është thelbi dhe baza e adhurimeve, ndërkohë që po i ftoni të tjerët në adhurime, a nuk do t’ju quajnë gënjeshtarë? Nëse lidheni në namaz çdo herë me mendimin “Të shpëtojme njëherë nga kjo punë.”, nëse e falni namazin me ndjenjë për ta hequr qafe atë dhe mjaftoheni vetëm me kryerjen e disa lëvizjeve që për ju nuk janë gjë tjetër veçse ca formalitete, a nuk i bie që të keni përgënjeshtuar veten tuaj? A nuk është një punë e pakuptimtë të ftoni të tjerët të bëjnë diçka që ju e shihni aq të pavlerë sa për ta hequr qafe menjëherë? A nuk duhet të jetë një çështje shumë serioze në sytë tuaj një e vërtetë tek e cila i keni ftuar të gjithë? Nëse nuk qëndroni me një seriozitet të përsosur mbi ndonjë çështje çfarëdo, si do t’i bëni të tjerët të besojnë që ajo çështje është me të vërtetë e vyer?

Ndikimi varet nga marrëdhënia me Allahun

Mbyllja me sukses e përpjekjeve të bëra në rrugën e lartësimit të emrit të Allahut është e lidhur vetëm me pranimin e Allahut dhe me vlerësimin e atyre përpjekjeve nga ana e Tij. Zoti i Madhëruar nuk i bën ndikues te të tjerët ata që nuk kanë një lidhje të fortë me Të. Le të shpjegojnë çfarë të duan ata që nuk kanë një marrëdhënie të thellë me

Të, nuk do të jenë në gjendje të hyjnë në zemrën e askujt, askënd nuk do mund të sjellin në rrugë të drejtë dhe nuk do të jenë në gjendje të ngrenë as edhe një person të vetëm nga të qenit një njeri i rëndomtë në gradën e jetës së zemrës dhe shpirtit. Allahu (*xhel'le xhelaluhu*) u jep vlerë zërit dhe frymës së atyre që janë në rrugën e Tij; fjalët, sjelljet dhe veprat e tyre i bën ndikuese te të tjerët.

Nga ky këndvështrim, shërbëtorët e Kuranit duhet ta kërkojnë vlerën e tyre tek i Vërteti në marrëdhënien që kanë me Të dhe duhet të dinë se gjërat thjesht formale nuk kanë asnjë vlerë në oborrin hyjnor. Po, siç theksohet në një hadith, Allahu i Lartësuar nuk shikon format tuaja, gjendjet tuaja të jashtme apo anën e jashtme të uljeve dhe ngritjeve tuaja, Ai shikon dhe vlerëson emocionet tuaja të përzemërta, thellësitë tuaja të brendshme dhe sjelljet tuaja të singerta, të cilat burojnë nga zemrat tuaja dhe janë pasqyrime të anës tuaj të brendshme.¹⁵² Nëse nuk do të ketë një thellësi shpirtërore në sjelljet dhe veprimet tuaja, nëse ato nuk do të derdhen në sheshin e veprave vetëm pasi janë shkëputur nga zemrat tuaja, atëherë e gjithë përpjekja juaj do të jetë e kotë.

Kështu, shpirtitrat që duan t'i përkushtohen shërbimit ndaj besimit, për të mos u përballur me qortimin "**O besimtarë, përse thoni atë që nuk e bëni?**"¹⁵³ dhe me pyetjen "Pse bëheni gënjeshtarë duke mos i përfaqësuar ashtu siç duhet të vërtetat te të cilat i thërrisni njerëzit, përse ia nxini fytyrën Islamit?", duhet të tregojnë një përpjekje madhore. Dhe, meqenëse kanë lidhje me këtë temë, përveç kryerjes më së miri të namazeve farz, ata duhet të tregojnë shumë kujdes edhe ndaj pikave të mëposhtme, që të mund të bëhen heronj të vërtetë të namazit:

Tre kushte për t'u bërë 'Hero i Namazit'

1. I Dërguari i Allahut (*alejhi ekmelut'tehájá*), pasi na e bën të qartë se Xheneti ka njëqind shkallë dhe se shkalla më e lartë e tij është Firdeusi, duke na thënë "*Kur t'i kërkon Allahut të Madhëruar Xhenetin,*

¹⁵² Muslim, birr 34; ibn Máxhe, zuhd 9.

¹⁵³ Surja Saf, ajeti 2.

*kërkojini Firdeusin.*¹⁵⁴, na lë të kuptojmë se qëllimet tona duhet t'i mbajmë gjithmonë sa më të larta. Për më tepër, përtej kërkimit të Firdeusit, Ai na mëson edhe edukatën e të kërkuarit nga Zoti dhe lutje që na tregojnë se çfarë janë ato gjëra që mund të kërkojmë prej Tij. Falë lutjeve që kemi mësuar prej Pejgamberit tonë (s.a.s.), themi "Allahu ynë, mbushi zemrat tona me dëshirën për të parë Bukurinë Tënde, bëji ato të shpërthejnë me zellin për të arritur te Ti dhe na ndero në botën e përtejme me Bukurinë Tënde!" në mëngjes e mbrëmje; falë duave të Profetit tonë jemi në gjendje të shpallim dëshirat tona për të parë Bukurinë e Allahut, për të fituar kënaqësinë dhe pëlqimin hyjnor. Po, nga këto lutje, të cilat i kemi mësuar prej Profetit tonë të nderuar, kuptojmë se duhet t'i mbajmë sa më të larta synimet tona.

Për rrjedhojë, synime të larta duhet të kemi edhe në çështjen e kuptimit të të vërtetës së namazit; duhet t'i kërkojmë Zotit të Madhëruar që të na e mundësojë edhe neve dëshirën e zjarrtë të të parëve tanë ndaj adhurimeve, kujdesin e tyre në kryerjen më së miri të adhurimeve; duhet t'i kërkojmë Atij ndihmesën hyjnore, në mënyrë që të mund ta kryejmë namazin me vetëdije. Mbase secili nga ne duhet të thotë kështu: "Allahu im! Më begato edhe mua me thellësinë e namazit të Profetit Tënd të Dashur; mundësoja edhe shpëritit tim kuptimin e namazit! Zoti im, edhe unë dua të fal namaz ashtu si Pejgamberi ynë (s.a.s.), dëshiroj ta ndiej atë me të gjitha grimcat e qenies sime... Dëshiroj që, gjatë namazit, të mos mendoj për asgjë tjetër përpos Teje dhe të bëhem njësh me namazin... Të lutem, Allahu im, ma mundëso edhe mua këtë mirësi Tënden!"

Po, të duash të arrish në një horizont profetik të adhurimit nuk do të thotë që po kërkon të jesh profet. Kjo dëshirë është kërkesa për të marrë si shembull në jetën tonë të adhurimeve Tablonë e Krenarisë së Njerëzimit (s.a.s.), Atë që duhet ndjekur në çdo çështje, dhe për t'u thelluar akoma më shumë në namaz. Pa dyshim, një lutje e tillë e juaja kurrë nuk shkon dëm. Nëse do të jeni ambiciozë dhe këmbëngulës në këtë dua, Allahu nuk do t'ju privojë prej saj; në dashtë Zoti, falë

¹⁵⁴ Buhárí, xhíhád 4; Tirmidhí, xhennet 4; ibn Máxhe, zuhd 39.

kësaj, shpresoj të arrini të jeni bashkë me Të. Ju shfaqni një dëshirë kaq të vogël, kurse Sundimtari i Përjetshëm i përgjigjet asaj ashtu siç i takon Individualitetit të Tij, në masën e madhështisë dhe mëshirës së Tij të pafund. Në këtë aspekt, të qenit i etur për gjëra të larta dhe t'ua vësh syrin qëllimeve sublime janë shprehje të dëshirës për t'i mbajtur synimet sa më të larta. Edhe në çështjen e kryerjes së namazit, njeriu gjithmonë duhet të aspirojë për më lart.

2. Dëshira për të kuptuar të vërtetën e namazit është një lutje me fjalë dhe me zemër, ndërsa aspekti vepror i kësaj lutjeje konsiston kryesisht në leximin e veprave të shkruara mbi këtë temë. Për një besimtar që dëshiron ta falë namazin me vetëdije, por që nuk ka lexuar as dy-tre libra në lidhje me të, që nuk ka treguar as më të voglën përpjekje për të mësuar përsiatjet e të mëdhenjve në lidhje me këtë temë dhe që ka lënë pas dore madje edhe anën teorike të kësaj çështjeje, nuk mund të thuhet se është i sinqertë në këtë dëshirë të tijën. Kështu që, hapi i dytë i udhëtarit të namazit është mbushja e zemrës me një dëshirë të zjarrtë ndaj adhurimeve dhe leximi i artikujve e librave, të cilët, duke e shëtitur atë nëpër atmosferën e ndritshme të namazit dhe duke i përcjellur atij botëkuptimet e gjera në lidhje me namazin dhe ndjesitë e thella të të mëdhenjve të botës shpirtërore, do e mbushin përbrenda edhe me ndjenjën e frikës dhe respektit. Ustadi i nderuar, për shkak se i konsideronte të rëndësishme, disa nga veprat e tij i ka lexuar njëqind e pesëmbëdhjetë herë. A nuk duhet që edhe një besimtar t'i lexojë disa herë të paktën disa vepra në lidhje me të vërtetën e Individualitetit Hyjnor, parimet e besimit dhe dimensionin kuptimor të adhurimeve? Po, nxënësit e Kuranit duhet t'i lexojnë patjetër mendimet në lidhje me namazin të miqve të të Vërtetit, siç janë Gazaliu, Mevlana dhe Bediuzamani, por edhe artikujt e shkruar mbi namazin në ditët e sotme. Ata duhet të përfshihen gjithashtu edhe në diskutimet që zhvillohen me synimin e shtjellimit të mëtejshëm të kësaj teme.

3. Një kusht tjetër shumë i rëndësishëm në rrugën për të arritur rezultatin e dëshiruar është të qenit këmbëngulës edhe në lutjet me fjalë, edhe në ato me vepra, të qenit i vendosur dhe i qëndrueshëm

në çështjen e arritjes së synimit dhe ecja drejt qëllimit hap pas hapi, duke treguar një durim aktiv. Zemrën e atij që po e kërkon një gjë të tillë mund të mos e zërë menjëherë sevdaja për namazin; një person mund të mos e ndiejë të vërtetën e namazit për ditë, muaj, madje edhe vite të tëra. Rrjedhimisht, është goxha e rëndësishme që, në çështjen e plotësimit të shkaqeve që do të na çojnë drejt arritjes së asaj çfare kërkojmë, të tregohemi këmbëngulës.

Nëse dëshironi ta shihni veten si kandidat për hero të namazit, nuk duhet të qëndroni indiferent ndaj përdorimit të argumenteve që do t'ju çojnë në atë horizont. Duhet t'i drejtoheni jo vetëm një herë, po ndoshta njëqind herë cilitdo zë, cilësdo frymë që jua entuziazmon zemrën e ju bën të ngriheni qirithi. Mbase do t'ju duhet ta lexoni një libër dhjetëra herë, ta dëgjoni disa herë një kasetë, t'u vini veshin sa e sa herë fjalëve të një më të madhi dhe të mendoni gjatë gjithë kohës për qëllimin që ia keni vënë vetes. Nuk duhet të themi “Nuk po bëhet!”, kthimin mbrapa nuk duhet ta çojmë në mendje aspak, nuk duhet të tregohemi të nxituar. Të mos harrojmë se mund të rrjedhim si uji në këtë rrugë për vite me radhë, mund të përplasemi në shumë shkëmbinj, por çdo herë do të dalim edhe më të dëlirë dhe, në fund, do të arrijmë oqeanin. Në varësi të thellësisë së njetit dhe madhësisë së përpjekjes dhe përkushtimit tuaj, në botën tjetër do të zini vendin tuaj prapa “të parëve”, secili prej të cilëve qe një dashurues i namazit.

10. Funkzioni i mesxhideve dhe xhamive

Mesxhidet dhe xhamitë kanë një vend të veçantë në sytë e myslimanëve. Prandaj bart një rëndësi të madhe ndërtimi dhe rikonstruktimi i tyre. I Dërguari i Allahut (s.a.s.) ka dhënë sihariqin e ndërtimit të një shtëpie në Xhenet nga ana e Allahut (*xhel'le xheláluhu*) për këdo që ndërton një mesxhid në këtë botë.¹⁵⁵ Edhe Ai vetë, posa mbërriti në Medine, iu fut punës së ndërtimit të një mesxhidi, i cili

¹⁵⁵ Buhárí, salát 65; Muslim, mesáxhid 24, 25, zuhd 43-44.

do të shërbente edhe për mbledhjet që do të zhvillonin këshilltarët ushtarakë e civilë në lidhje me çështjet e ndryshme të shtetit, edhe si një vend ku të gjithë besimtarët do t'ia paraqitnin bashkarisht adhurimet e tyre Allahut. Madje iu vu punës në një mënyrë të atillë, sa që punoi bashkë me sahabët e tij sikur të ishte një punëtor krahu. Kur e kërkonte nevoja, transportonte mbi shpinë një qerpiç, merrte në duar manivelën, kazmën, lopatën dhe, duke i qëndruar larg çdo pikëpamjeje burokratike, gërmonte tokën, thyente gurë e punonte si një njeri i thjeshtë. Umeti i Tij e ka pranuar si sunet këtë sjellje të Profetit Muhamed (s.a.s.); komandantët e ushtrive islame, duke hapur fillimisht një mesxhid në secilin vis që merrnin nën kontroll, përgatisnin kështu vendin ku njerëzit do të kishin mundësinë të mblidheshin e t'i përgjëroheshin Allahut dua pas duaje, të hapnin duart drejt qiellit e t'i paraqisnin Zotit adhurimet e tyre.

Në ditët e sotme, mesxhidet e kanë humbur shumicën e funksioneve të tyre, duke u shndërruar kështu në ndërtesa ku ne vetëm mund të kryejmë adhurimet tona. Kurse i Dërguari i Allahut (s.a.s.) kryente në mesxhid edhe mbledhjet për zgjidhjen e meseleve ushtarake, juridike dhe administrative. Po ashtu edhe myslimanët e patën vazhduar zbatimin e këtij suneti për një kohë të gjatë. Në periudhat kur të gjitha punët kryeshin në mesxhide, njerëzit, brenda atmosferës së llogaridhënies para Zotit, në fillim vendosnin kokën në tokë, pastaj ngriheshin dhe kryenin punët që kishin për të kryer. Ndoshta bënin ndonjë mëkat pa dashje, por, më pas, vinte koha tjetër e namazit dhe ata pastroheshin duke iu drejtuar sërish Allahut.

Në një hadith *sahih* (të vërtetë, të saktë), i Dërguari i Allahut (s.a.s.) e shpreh këtë veçori të namazit si vijon:

“Pesë namazet, namazi i Xhumasë deri në namazin e Xhumasë pasardhëse dhe Ramazani deri në Ramazanin pasardhës janë shlyerje për mëkatet e bëra mes tyre, për sa kohë robi ruhet nga mëkatet e mëdha.”¹⁵⁶

¹⁵⁶ Muslim, taháret 10, 15, 16; Tirmidhí, salát 46; Ahmed ibn Hanbel, el Musned 2/359.

Ndërsa në një hadith tjetër, i pyet sahabët në këtë mënyrë: “Nëse një lumë rrjedh para derës së njerit prej jush dhe ai person lahet në atë lumë pesë herë në ditë, si thoni, a mund të mbesë ndonjë papastërti mbi trupin e tij?” Pasi sahabët i përgjigjen duke thënë “Asnjë papastërti nuk mbet në trupin e një personi që vepron në këtë mënyrë!”, Profeti ynë (s.a.s.) thotë: “Ja pra, ky është shembulli i pesë kohëve të namazit. Në sajë të namazeve, Allahu i fshin të gjitha gjynahet.”¹⁵⁷

Ne besojmë se, kur mesxhidet dhe xhamitë të fillojnë të përmbushin sërish funksionet e tyre të vjetra, njerëzit do të fillojnë t’i bëjnë punët e tyre me ndërgjegje të pastër dhe dinamizëm të brendshëm në një atmosferë llogaridhënieje ndaj Allahut, në përputhje me këto rrethana do t’i hedhin hapat, do t’i lënë pas gjërat e epokës së injorancës dhe do të jenë një hap më afër Islamit. Deri më tani, ndoshta janë hedhur disa hapa në këtë drejtim, janë bërë disa lëvizje; por frytet e pritura ende nuk janë marrë. Shpresohet që në vazhdim, duke u marrë disa vendime në këtë drejtim, xhamitë të mos shihen më vetëm si vende ku bëhen vetëm një pjesë e adhurimeve, po të shndërrohen në vende ku kryhen edhe disa detyra të tjera që kanë të bëjnë me shoqërinë. Sipas fjalëve të Kuranit, ata që do t’i bëjnë mesxhidet të fitojnë funksionin e tyre të vërtetë dhe që do të bëjnë të mundur restaurimin e tyre material dhe shpirtëror, janë ata që i kanë besuar me të vërtetë Allahut. Në Kuranin Famëlartë thuhet kështu:

“Faltoret e Allahut i vizitojnë dhe i mirëmbajnë vetëm ata që besojnë Allahun dhe Ditën e Fundit, që falin namazin dhe japin zekatin e që nuk i frikësohen askujt tjetër përveç Allahut. Sigurisht që këta janë në rrugë të drejtë.”¹⁵⁸

Sulltan Ahmeti i dinastisë së osmanllinjve, ai sundimtar i madh që, kur shenja e këmbës së Pejgamberit tonë (s.a.s.) qe ekspozuar në Stamboll, e pati përshëndetur atë objekt të bekuar me fjalët “Ah, sikur ta shëtisja si një kurorë mbi kokën time këmbën tënde të pastër!”, ishte nga ata njerëz që vetëdijen islame e kishin të ngulitur gjer në palcë.

¹⁵⁷ Buharí, meuákítus’salát 6; Muslim, mesáxhid 283-284.

¹⁵⁸ Surja Teube, ajeti 18.

Transmetohet se edhe ai ka punuar si një punëtor gjatë ndërtimit të xhamisë së Sulltan Ahmetit, duke transportuar rërë e zhavorr me fundin e kaftanit të tij, dhe se më pas është lutur duke thënë: “Allahu im! Pranoje këtë punë kaq të vogël të Ahmetit të varfër, robit Tënd! Bëje atë nga nozullimet e botës tjetër!”

Njeriu vdes ashtu siç jeton, dhe ringjallet ashtu siç vdes. Vite më vonë, këtë njeri të madh, që punoi në ndërtimin e xhamisë që deshi të bënte ashtu siç pati punuar në të kaluarën Profeti ynë (s.a.s.), nipi i tij e sheh në ëndërr, tek po shëtiste në Xhenet. “Gjyshi im i dashur, si je?”, e pyet ai. Kurse Sulltan Ahmeti i përgjigjet në këtë mënyrë: “Zoti i Madhëruar, duke i pranuar veprat që bëra, më fali dhe më futi në Xhenetin e Tij.”

PJESA E TRETË



PËRGATITJA PËR NAMAZ

1. Abdesi

Allahut (*xhel'le xheláluhu*) nuk i pëlqen që ne ta përdorim jetën tonë tërësisht për hesap të nefsit; Ai (*xhel'le xheláluhu*) na urdhëron që, në intervale të caktuara kohore, të dalim para Tij dhe, të përlurur, t'i paraqesim Atij adhurimet tona. Në krye të këtyre urdhrave janë pesë kohët e namazit. Për këtë arsye, pesë namazet ditore përbëjnë çështjen më të rëndësishme të besimtarit. Por, para shtjellimit të temës së namazit, do të ishte me vend të fokusoheshim së pari te pastrimi që bëhet si një parapërgatitje për të.

Pastrimi që kryhet para fillimit të namazit mund të krahasohet me çelësin e tij. Për rrjedhojë, kur një person nuk e bën këtë pastrim, edhe sikur të lidhet për të falur namazin, do të thotë se nuk është futur dot brenda tij. Ajeti “... *xhamia (mesxhidi i Kubasë) e themeluar në përkushtim (ndaj Allahut) që në ditën e parë, pa dyshim që është më e denjë për të falur namaz në të. Aty ka njerëz që duan të pastrohen. Allahu i do ata që pastrohen shpesh.*”¹⁵⁹ ka zbritur për banorët e Kubasë, të cilët i kushtonin shumë rëndësi pastrimit si parapërgatitje për namazin, për rrjedhojë, edhe abdesit.

Po, një besimtar, që bën të mundur derdhjen jashtë vetes së tij të pastërtisë dhe dëlirësisë së brendshme në trajtën e abdesit, është një njeri i dashur tek Allahu. Ai përvesh mëngët dhe merr abdes vetëm ngaqë ka besuar në Zot. Si një shprehje e përtypjes së kuptimeve që ka ndier tek shkonte drejt daljes para Zotit, te buzët i shfaqet një buzëqeshje e hidhur, një brengë; dhe, ashtu si në shembullin e Aliut (r.a.), trupin ia kaplon një dridhje, një shqetësim.

Me kryerjen e pastrimit, ndërkohë që nga njëra anë bëhet i mundur pastrimi i gjymtyrëve nga papastërtitë, nga ana tjetër, në kuptimin e të qenit e karikuar dhe e mbushur plot, zemra zhvishet nga veçoritë e moralit të keq dhe fluturon drejt lartësive. Ndërkohë, ndjenjat e fshehta

¹⁵⁹ Surja Teube, ajeti 108.

të zemrës, duke marrë trajtën e një pasqyre të ndritshme përballë dhuratave dhe bekimeve të ardhura nga Allahu i Madhëruar, vazhdojnë të ruajnë dëlirësinë e tyre. Ja, pra, me një pastrim të tillë arrihet gjysma e besimit dhe, kështu, na shfaqet e vërteta e fjalëve të të Dërguarit të Allahut (s.a.s.), i cili thotë: “*Pastërtia është gjysma e besimit.*”¹⁶⁰ Kurse gjysma e mbetur është çështja e krijimit të besimit në zemër, e cila i përket tërësisht Zotit të Madhërishëm. Besoj se, kur njeriu t’i futet një pastrimi të tillë me qëllimin për të adhuruar Krijuesin, ndryshku dhe papastërtitë brenda tij do të zhduken dhe, në këtë zemër, e cila është e gatshme tashmë për të mirëpritur imanin, Allahu i Plotfuqishëm do ta ndezë shkëndijën e besimit.

Paralajmërimi i parë në rrugën drejt namazit

Abdesi, i cili bëhet shkak për përgatitjen shpirtërore ndaj adhurimeve dhe që mundëson përfitimin maksimal prej tyre, është paralajmërimi dhe përgatitja e parë veçanërisht në rrugën drejt namazit. Abdesi është bërë farz jo për çdo vepër e adhurim, po vetëm për disa adhurime, me në krye namazin. Për faljen e namazit, kryerjen e sexhdes së tilavetit (leximit) apo prekjen me dorë të Kuranit Famëlartë, marrja e abdesit është farz; marrja e abdesit për të bërë tavaf Qabenë është vaxhib (e nevojshme, e domosdoshme); ndërsa marrja e abdesit për qëllime të tilla si këndimi i ezanit, thirrja e ikametit dhe leximi e shpjegimi i dijeve fetare është mendub, pra, një vepër që, edhe pse feja nuk e urdhëron në mënyrë të prerë, mundëson fitim sevapësh kur kryhet. Pastaj, dihet se Pejgamberi ynë, Profeti i Nderuar Muhamed (s.a.s.), është kujdesur që të ketë abdes gjithmonë dhe të mos kryejë asnjë punë të tijen pa abdes. Në këtë aspekt, është sunet që një mysliman të ketë abdes vazhdimisht.

Termi ‘abdes’ është një fjalë persisht, e përbërë nga fjalët ‘*ab*’, që do të thotë ‘ujë’, dhe ‘*dest*’, që ka kuptimin ‘dorë’. Për abdesin, në arabisht përdoret fjala ‘*vudú*’. Kjo fjalë, e cila përfshin kuptimet ‘bukuri’ dhe ‘pastërti’, shpreh gatishmërinë për të dalë para Allahut të personit

¹⁶⁰ Muslim, tahâret 1; Tirmidhî, de’auât 86.

që, duke e çliruar zemrën nga mendimet për gjërat e kësaj bote dhe duke e pajisur atë me ndjenja shpirtërore, duke i larë dhe pastruar mirë gjymtyrët dhe duke u zbukuruar kështu edhe shpirtërisht, edhe fizikisht, ka bërë nijet të kryejë adhurimin.

Siç dihet, një nga kushtet e namazit është edhe pastrimi konvencional. Pastrim konvencional do të thotë të marrësh abdes atëherë kur je pa abdes, gjendje kjo që konsiderohet papastërti konvencionale, dhe të marrësh gusl (larje trupore e plotë) në situatat ku është e nevojshme marrja e tij. Abdesi dhe gusli, edhe pse sjellin me vete shumë dobi të dukshme siç janë heqja e papastërtive materiale dhe mbrojtja e shëndetit trupor, në thelb janë *'ta'abbudî'*; pra, janë pastrime me përmbajtje fetare e adhurimore, që kryhen vetëm se i urdhëron Allahu, por që mund të kenë edhe urtësi të tjera, të cilat ne nuk mund t'i dimë.

Allahu i Madhëruar, nëpërmjet ajetit ***“O besimtarë! Kur doni të falni namaz, lani fytyrën dhe duart deri në bërryla, kurse kokën fshijeni me dorë të lagët; lani edhe këmbët deri në nyje.”***¹⁶¹, e bëri kusht marrjen e abdesit para faljes së namazit. Në vazhdimin e këtij ajeti, i cili na e bën të ditur se është farz marrja e abdesit para namazit, adhurimit që konsiderohet si shenja më e rëndësishme e robërisë sonë ndaj Allahut, Zoti i Madhëruar e urdhëron njeriun që, nëse është *xhunub*, të bëjë gusl në rastin e parë që i jepet, pra, të bëjë një larje trupore të plotë, dhe të bëjë tejemum me dhe në rastet kur nuk mund të gjejë ujë. Vetëm pasi të plotësohen këto kushte mund të lidhet në namaz njeriu.

Thellësia në mendime

Abdesi është paralajmërimi dhe përgatitja e parë në rrugën drejt namazit. Megjithatë, marrja e fryteve të dëshiruara prej tij varet nga thellësia në mendime e përfytyrime. Në fakt, njeriu, në varësi të masës së sinqeritetit në ndjenjat dhe mendimet e veta, mund të bëjë që të gjitha veprat e tij të fitojnë një thellësi të veçantë dhe mund t'i japë një natyrë krejtësisht ndryshe çdo ngjarjeje që përjeton. Për shembull, në

¹⁶¹ Surja Máide, ajeti 6.

një mënyrë apo në një tjetër, ju do të bëni durim ndaj belasë që iu ka rënë mbi kokë. Por, nëse e shihni atë si një fatkeqësi të rëndomtë, që jeni të detyruar ta duroni, i bie që jeni duke i burgosur përjetimet e hidhura dhe dhimbjen e atyre çasteve brenda ngushtësisë së perceptimit tuaj të gabuar. Nga ana tjetër, nëse ngecni në pjesën sipërfaqësore të kësaj fatkeqësie dhe nuk i mendoni disa mesele të prapaskenës së saj, do të thotë se, duke e ngjeshur atë ngjarje brenda kohës në të cilën ndodhëni, keni ngushtuar kështu jetën tuaj dhe i keni duruar kot gjithë ato vuajtje.

Por është e mundur që, që në momentin e parë të përballjes me fatkeqësinë, ta vlerësoni atë edhe si një mjet pastrimi dhe si një mundësi për të fituar sevape. Në qoftë se do të jeni në gjendje të shihni përtej belasë atë që jua ka dërguar atë, nëse do të mendoni se asnjë ngjarje që ndodh në këtë univers nuk është e rastësishme apo e pakuptimtë, atëherë brenda jush do të lindë një ndjenjë durimi në orbitën e pranimit. Do t'i drejtoheni Allahut të Plotfuqishëm dhe do të viheni në ndërlidhje me dergjahun hyjnor. Dhe, duke marrë parasysh faktin që Ai sheh gjithçka dhe që me mijëra urtësi gjenden në çdo punë të Tijën, do të thoni:

*“E këndshme është çdo gjë që prej Teje më vjen,
Qoftë ai një kaftan, qoftë një qefin;
Një trëndafil i freskët qoftë, apo edhe një gjemb,
I këndshëm është favor i Yt, i këndshëm edhe dënimi Yt.”*

Edhe sikur belaja me të cilën po përballeni të lëshohet mbi kokën tuaj si një çekan, edhe sikur t’iu thyejë mesin, duke thënë “Do të thotë se paska qenë e nevojshme t’i përjetoj këto vuajtje e probleme, që të pastrohëm nga gjynahet dhe gabimet e mia dhe të arrij një tendosje metafizike serioze; zaten, vetëm një dert i tillë mund t’i shlyente të metat e mia. Zoti im, jam i kënaqur edhe me këtë fatkeqësi që po më vjen prej Teje, mjaft që Ti t’më falësh mua!”, do të duroni me zemrën të qetësuar jo ngase jeni të detyruar të bëni durim, po ngaqë i keni besuar

faktit se ajo bela ka ardhur nga Zoti i Madhëruar. Në këtë mënyrë, do ta vlerësoni shumë mirë edhe një fatkeqësi të atillë dhe, me mendimet dhe përfytyrimet tuaja, do t'i përftoni edhe asaj një thellësi. Madje, edhe nëse nuk do t'i shfaqni dhe nuk do t'i shprehni me fjalë këto ndjesi, një sjellje e butë e juaja dhe shfaqja e durimit nëpërmjet gjendjes suaj do të mjaftojnë për lindjen e një puhize që do të përhapë qetësinë brenda jush. Kurse ajo ngjarje me fytyrë të shëmtuar, më shumë sesa në një fatkeqësi, do të shndërrohet në një shkak për të fituar faljen.

Pra, për ta ndier sa më thellësisht namazin, është e nevojshme të jemi të mbushur me të njëjtat mendime e ndjenja të përzemërta që në çastin kur vendosim të marrim abdes. Duke thënë “Allahu im, që të dal para Teje si një njeri i pastruar nga ndyrësitë e kësaj dynjaje, Ti më bërë shenjë për te çezma e abdesit; unë po marr abdes duke pasur parasysh këtë shenjë dhe urdhër Tëndin.”, abdesin duhet ta konsiderojmë si një detyrë të urdhëruar nga Zoti i Madhërishëm dhe ta vlerësojmë si një lloj kostumi adhurimesh, të përcaktuar po ashtu nga Allahu i Madhëruar. Sepse vetëm Ai e di dhe e sheh atë që nënkupton abdesi, se për ç’lloj pastërtie bëhet shkak ai, çfarë identiteti na jep në aspektin e botës së shëmbëllimeve dhe në çfarë mënyre na zbukuron. Na shohin gjithashtu, me lejen e Tij sigurisht, edhe pjesëtarët e Engjëjve më të Lartë (*Mele A’lá*) dhe engjëjt shkruar. Rrjedhimisht, është kusht i të qenit besimtar pranimit dhe zbatimi i pastrimit në atë mënyrë që ka urdhëruar i Gjithëmëshirshmi. Ne duhet të dalim para Tij ashtu siç dëshiron Ai të na shohë. Kushti i parë për të arritur ato që na premtton abdesi është, para së gjithash, vlerësimi i tij vetëm pse e ka urdhëruar Allahu dhe, duke besuar në aftësinë e tij pastruese materiale e shpirtërore, trajtimi i tij brenda kornizës së parimeve të përcaktuara nga feja.

I Dërguari i Allahut (s.a.s.), duke theksuar se abdesi është një pastrues që zhduk edhe papastërtitë dhe njollat shpirtërore, ka thënë:

“Kur një besimtar lan fytyrën tek është duke marrë abdes, mëkatet që ka bërë me sy i rrjedhin dhe ikin bashkë me ujin – ose me pikën e fundit të ujit – që pikon nga faqet e tij; kur lan duart, gjynahet e gabimeve që ka kryer me duart e tij pikojnë dhe zhduken bashkë me ujin e abdesit;

kur lan këmbët, të gjitha mëkatet, të shkaktuara nga ecja e këmbëve të tij drejt haramit, rrjedhin nga majat e gishtave të këmbëve bashkë me pikën e fundit të ujit. Kështu, një rob që merr abdes ashtu siç duhet pastrohet plotësisht nga mëkatet.”¹⁶²

Do të thotë se njeriu që pastron papastërtitë materiale që i janë ngjitur në trup, falë abdesit, pastrohet edhe nga njollat shpirtërore, merr trajtën më të përshtatshme për adhurimet dhe, kështu, është i gatshëm të dalë në dergjahun e lartë të Sunduesit Madhështor.

Çdo besimtar që vjen në xhami, duke menduar vazhdimisht për çastin kur do të dalë para Zotit, merr abdes dhe i jep mbase më shumë rëndësi jo pastërtisë së jashtme, por asaj të brendshme. Sepse, pavarësisht pastërtisë së jashtme, nëse do të ndiejë brenda vetes shfaqjen e një errësire, e cila do të prishë integritetin e anës së brendshme të tij me atë të jashtme, ai do të shqetësohet, madje, do të dyshojë se mos është edhe hipokrit. Besimtari, edhe pse i ka hequr qafe pluhurat dhe dherat duke i larë nga tri herë gjymtyrët dhe fytyrën, daljen para Allahut me ca gënjeshtër e gjëra të neveritshme përbrenda e konsideron mungesë respekti ndaj Tij. Allahu i Madhëruar, më shumë se trupin, shikon zemrën; Ai mund t'i dëbojë ata që dalin para Tij të pastruar nga jashtë, por të leckosur e të rrënuar nga brenda. Për këtë arsye, pastërtia e jashtme bart në vetvete edhe një kuptim të pastërtisë së brendshme për besimtarin.

Në një hadith tjetër, Pejgamberi ynë (s.a.s.) urdhëron kështu: *“Pasi të jeni zgjuar nga gjumi, askush nga ju të mos i zhysë duart në enën e ujit pa i larë ato tri herë. Sepse nuk mund ta dini se në ç’pjesë të trupit kanë shëtitur duart gjatë natës.”¹⁶³* Sipas asaj që thonë sot ekspertët, mikrobet gjenden në masë veçanërisht në pjesët e njomura të trupit. Ekziston gjithmonë mundësia që, gjatë natës, duart të shëtisin nëpër këto pjesë dhe, rrjedhimisht, të ndoten nga mikrobet e gjendura në ato vende. Njeriu nuk mund ta dijë se ku i ka mbajtur duart gjatë kohës kur ka qenë duke fjetur, nëse, në një mënyrë të pavetëdijshme, i kanë vajtur

¹⁶² Muslim, tahâret 32; Tirmidhî, tahâret 2; Ebú Dáúd, tahâret 51.

¹⁶³ Buhârî, vudú 25; Muslim, tahâret 87-88.

poshtë sqetullave apo në ndonjë vend tjetër të trupit. Kështu që, nuk ka rëndësi se si vendosim ta trajtojmë këtë çështje. Mund ta shikoni atë nga aspekti mjekësor, mund ta shihni si një arsye të pastrimit si parapërgatitje për namazin ose, pa i menduar fare këto të parat, në një atmosferë bindjeje ndaj dekretit të të Dërguarit të Allahut, mund të thoni “Po e bëj sepse kështu ka urdhëruar Ai (s.a.s.)”. Nuk ka rëndësi se cilën prej këtyre vendosni të zgjidhni, sepse, në fund të fundit, kjo është një çështje pastërtie. Shpëtimi nga gabimet dhe punët e gabuara është i mundur vetëm nëpërmjet faljes nga ana e Allahut. Ndërsa gabimi i dorës së ndyrë fshihet nëpërmjet një larjeje të mirë të saj. Për rrjedhojë, një njeri që merr abdes pesë herë në ditë, nuk do të gabojë ndaj Zotit sepse do të ruajë dëlirësinë e tij të brendshme, nuk do të gabojë as ndaj vetes, sepse nuk do të lejojë infektimin e trupit të tij nga mikrobet. Abdesi është shlyerje për të gjitha këto dhe, në të njëjtën kohë, është edhe një rritje në gradë për besimtarin.

Po, abdesi është si ai kostumi më i përshtatshëm, që duhet veshur për të dalë para Zotit. Një abdes që merret i plotë dhe në përputhje me rregullat e marrjes së tij do të thotë ta veshësh atë kostum në mënyrën më elegante, të jesh gati për të hyrë në sallën e pranimit të quajtur ‘namaz’. Nëse do të kishim qenë në gjendje të shihnim pasqyrimin fragment pas fragmenti të abdesit në botën e shëmbëllimeve, në varësi të thellësisë apo cekëtisë së mendimeve të njerëzve, kushedi se me ç’shumëllojshmëri veshjesh do të përballëshim përtej. Ndoshta, nga njëra anë do të vërenim shndërrimin në një kaftan të bukur të abdesit të atij që e trajton atë brenda atmosferës së hareshme të adhurimit, ndërsa nga ana tjetër, gjendjen e rreckosur të veshjes së atij që, edhe pse e merr abdesin me qëllimin për të kryer adhurimin, e shikon atë si një larje të zakonshme të duarve dhe këmbëve.

Të qëndruarit larg preokupimeve

Aq sa është e nevojshme veshja e kostumit të abdesit për personin që do të lidhet në namaz, po aq i nevojshëm është edhe çlirimi i zemrës së tij nga preokupimet që mund ta shpërqendrojnë atë dhe që, për

rrjedhojë, e largojnë nga fryma e adhurimit. Prandaj konsiderohet si një veprim i shëmtuar lidhja në namaz e atij personi që i nevojitet urgjentisht përdorimi i tualetit. Njeriu fillimisht duhet t'i hedhë ato gjëra që duhen hedhur, në turin e adhurimit duhet të hyjë vetëm me ndjenjën e adhurimit dhe duhet të lidhet në namaz pasi t'i ketë hequr qafe të gjithë ndikuesit negativë që mund ta preokupojnë. Zaten kjo mesele është diskutuar edhe në librat e fikhut dhe, duke e lidhur atë me çështjen e preokupimit të zemrës për gjëra të kësaj bote, është arritur në përfundimin se lidhja në namaz për një person që e ka urgjente përdorimin e tualetit (kryerjen e nevojave personale) konsiderohet mekruh (e papëlqyeshme, e pakëndshme). Sepse njeriu, kur e ka të zënë me diçka zemrën dhe mendjen, nuk mund të përqendrohet në një punë tjetër. Është shumë e vështirë, madje e pamundur, që një person, mendja e të cilit është e fokusuar te një nevojë e tij, të përqendrojë vëmendjen edhe në një mesele të dytë. Rrjedhimisht, nuk është e mundur që njeriu i zënë me një nevojë të tillë ta falë namazin me vetëdije, ta falë atë ashtu siç e meriton të falet dhe ta ndiejë thellësisht adhurimin e tij.

Për më tepër, qëndrimi në namaz në një gjendje të atillë është gjithashtu fyerje për namazin. Sepse ai nuk është nga ato punë të thjeshta, të cilat mund të kryhen edhe sa për të kaluar radhën. Namazi ekziston jo për t'u hequr qafe, por për të ndriçuar çastet kur kryhet dhe për të mbushur me nur të gjithë jetën. Për të gjitha këto arsye, disa dijetarë të fikhut e kanë parë të arsyeshme që nijeti për marrjen e abdesit të bëhet që në momentin kur nisësh për të kryer në tualet nevojat personale. Sepse, falë një nijeti të tillë, të gjitha parapërgatitjet, që bëhen me qëllimin për të falur namazin me një zemër të qetë, do të vlerësohen brenda kategorisë së adhurimeve; që nga përgatitjet para marrjes së abdesit e deri në çastin e lidhjes në namaz, çdo fazë i sjell sevape njeriut.

Abdesi është shumë i rëndësishëm edhe përse i përket përfshirjes në atmosferën e adhurimit dhe përqendrimit në namaz. As moti i ftohtë dhe as ai i nxehtë nuk e pengojnë besimtarin të marrë abdes ashtu siç

duhet. Sido që të jenë kushtet, ai e gjen një mënyrë dhe, si një udhëtar i gatshëm për t'u ngjitur në miraxh, i futet pastrimit material e shpirtëror. I braktis fjalët e kota të kësaj dynjaje dhe hyn në atmosferën e kryerjes së një adhurimi nën ndjenjat e frikës, respektit dhe dashurisë ndaj Zotit që në çastin kur është duke zgjatur duart nën ujë. Pastaj, me larjen e çdo gjymtyre, përparon ca më shumë, percepton një ndriçim ndryshe dhe arrin një gjallëri të pazakontë. Nëse i di dhe i thotë duatë që është e këshillueshme të thuhet gjatë marrjes së abdesit, ose mendon për kuptimet e përfshira prej tyre dhe i drejtohet Zotit të Madhëruar me ato ndjenja sublime, atëherë ai shndërrohet në një krijesë krejtësisht shpirtërore dhe përfshihet nga një tendosje metafizike komplet tjetër.

a. Pastrimi i dhëmbëve para abdesit

Para se të fillojë me marrjen e abdesit, si përgatitje për të, besimtari duhet të pastrojë njëherë dhëmbët. Këtë, ashtu siç mund ta bëjë me misvak, mund ta bëjë edhe me një furçë dhëmbësh. Nuk ka rëndësi nëse qëllimi i këtij pastrimi është heqja e mbetjeve të ushqimeve nga dhëmbët apo mbrojtja e dhëmbëve dhe mishrave të tyre nëpërmjet eliminimit të baktereve. Ne e bëjmë këtë sepse është nga sunetet e Profetit tonë (s.a.s.). Nga ana tjetër, edhe pse njeriu duket i lirë të veprojë si të dojë në kryerjen e punëve të veta, duke qenë se është rob i Allahut, ai nuk mund të ndërhyjë as në disa aspekte të vetvetes pa lejen e Tij. Po, njeriu është rob i Allahut; dhe robi lëviz vetëm brenda rrethit të lejes së zotërisë së tij.

Për shembull, ju nuk mund të thoni “Ky është gishti im, mund të bëj me të çfarë të dua.” dhe ta prisni me thikë e ta flakni tutje një pjesë të gishtit tuaj. Kjo për ju është e ndaluar dhe, në rast se bëni diçka të tillë, duhet të pendoheni e të kërkoni falje. Përsëri, nëse njeriu bëhet gabimisht shkak për vdekjen e një personi tjetër, ai duhet të paguajë për gjakun e tij. Kjo dietë është përcaktuar nga Pejgamberi ynë (s.a.s.) në vlerën e një mijë deleve ose njëqind deveve, që, po të tentojmë sot ta konvertojmë në vlerën e saj monetare, i bie një shumë goxha e madhe

parash. Kurse sipas ibn Abasit (r.a.), për dikë që vret një njeri qëllimisht dhe pa të drejtë, hyrja në Xhenet është absolutisht e pamundur.¹⁶⁴ Duke marrë parasysh faktin se sa të vlefshëm janë në Islam njeriu, jeta dhe trupi i tij, mbrojtja e dhëmbëve dhe parandalimi i shndërrimit të tyre në diçka të padobishme është një çështje që duhet marrë seriozisht. Kjo do të thotë se edhe gjërat më të vogla të trupit të njeriut e kanë një vlerë; secila prej tyre është një mirësi më vete dhe secila prej tyre ka vlerën e saj të veçantë. Edhe pse dhënia e këtyre mirësive nuk varet nga vullneti i njeriut, vazhdimësia e tyre patjetër që varet nga vullneti i tij, nga përpjekja që ai do të tregojë në këtë drejtim. Mirëpo, çfarë është kjo përpjekje?

Kjo përpjekje nënkupton larjen dhe pastrimin shumë serioz të dhëmbëve të paktën disa herë në ditë. Në një hadith, i Dërguari i Allahut (s.a.s.) thotë kështu:

*“Lajini dhëmbët tuaj. Sepse larja e dhëmbëve bëhet shkak për pastërtinë e gojës dhe fitimin e pëlqimit të Allahut. Xhibrili, në çdo ardhje të tijën, më këshillonte të përdorja misvakun. Aq sa u frikësova se mos do të na bëhej farz përdorimi i tij, për mua dhe umetin tim. Nëse nuk do të bartja shqetësimin e shkaktimit të vështirësive ndaj umetit tim, këtë do ta kisha bërë të detyrueshme për ta. Unë aq shumë e përdor misvakun, saqë, ndonjëherë, kaplohem nga frika se mos dhëmbët e përparmë do t’më biejnë me gjithë rrënjë.”*¹⁶⁵

Edhe pse ky hadith është transmetuar nga dyzet e ca sahabë, myslimanët nuk kanë qëndruar seriozisht mbi këtë temë, nuk i kanë dhënë asaj rëndësinë e duhur. Ashtu siç po tregohet sot një ndjeshmëri e lartë ndaj kësaj çështjeje në emër të mjekësisë parandaluese, po në të njëjtën mënyrë do të veprohet edhe në të ardhmen. E megjithatë, ne nuk dimë të ketë fjalë të tjera në nivelin e fjalëve të të Dërguarit të Allahut (s.a.s.), që shpjegojnë rëndësinë e kësaj çështjeje.

Në një hadith tjetër, Profeti ynë (s.a.s.) thotë kështu: *“Patjetër që*

¹⁶⁴ Tirmidhí, tefsír 5; Nesáí, tahrím 2, kasáme 48.

¹⁶⁵ ibn Máxhe, taháret 7.

*gojët tuaja janë rrugët e Kuranit, pastrojini ato me misvak.*¹⁶⁶ Po, Allahu (*xhel'le xheláluhu*) është i bukur dhe e do të bukurën; është i hijshëm dhe e do të hijshmen. Ai nuk i do gjërat e shëmtuara. Ju do ta mbani të pastër gojën, në mënyrë që Allahu të jetë i kënaqur me ju. Përndryshe, do të jepni llogari para Tij.

Në lidhje me këtë temë, dua të prek edhe një çështje të fundit: Edhe pse fjalën ‘misvak’ e përdorim për një model të vjetër të furçës së dhëmbëve, e cila përftohet nga degët e një peme të caktuar dhe është përdorur në pastrimin e dhëmbëve prej shumë kohësh, ajo çfarë nënkuptohet me fjalën ‘*siuák*’ të haditheve në lidhje me këtë temë është absolutisht pastrimi i dhëmbëve. Ky pastrim, ashtu siç mund të kryhet me furçat e bëra nga degët e asaj peme, mund të bëhet me furçat e dhëmbëve që prodhohen në ditët e sotme. Madje, mund të kryhet edhe duke i fërkuar dhëmbët me gishta, duke përdorur pe apo ndonjë gjë tjetër. Dhe, nëse ky pastrim bëhet duke menduar për fitimin e kënaqësisë dhe pëlqimit të Allahut, do të kuptohet më mirë serioziteti i urdhrave të fesë në lidhje me jetën e njeriut.

b. Kuptimet që shprehin duatë e abdesit

Këndimi i duave të abdesit, sipas disa prej dijetarëve të fikhut, është pranuar si pjesë e etikës së abdesit. Sipas terminologjisë së fikhut, etika përfshin veprat dhe veprimet që mundësojnë kryerjen e një pune në mënyrën më të mirë të mundshme, shpërblehen me sevape kur bëhen me këtë nijet, konsiderohen të bukura nga feja dhe braktisja e të cilave nuk përbën mëkat. Pra, kryerja e tyre të sjell sevape, kurse moskryerja e tyre nuk të sjell gjynahe. Në fakt, duatë e abdesit nuk janë dua të transmetuara drejtpërdrejt nga i Dërguari i Allahut (s.a.s.), por, në thelb, bazohen ose në disa ajete të Kuranit, ose në fjalët fisnike të Pejgamberit tonë. Këto janë dua që të parët tanë i kanë shprehur në mënyra të ndryshme në kohë të ndryshme, herë duke u bërë ndonjë shtesë, herë duke u bërë ndonjë shkurtim. Por është e sigurt se këto

¹⁶⁶ ibn Máxhe, taháret 7.

dua e përgjërime të përzemërta të miqve të të Vërtetit, të cilat bartin edhe thellësinë e mendimeve dhe përfytyrimeve të tyre, i tërheqin personat që i lexojnë ato drejt një atmosfere shumë të veçantë dhe ua mbushin zemrat me ndjenjat më të sinqerta dhe dashurinë e dëshirën për adhurime.

Një rob i sinqertë, kur po bëhet gati për të marrë abdes, mbështetet tek Allahu prej shejtanit të dëbuar nga dergjahu hyjnor e të privuar nga mëshira e pafund dhe, si gjithmonë, fillon marrjen e abdesit me emrin e të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit. Pastaj, teksa bie në kontakt me ujin, mendon për madhësitinë e kësaj mirësie të quajtur Islam dhe falënderon Allahun, që e bëri atë një burim drite, një mjet shpëtimi nga njollat shpirtërore, ndërsa ujin, një mjet për pastrimin e papastërtive materiale.

Në çastin e shpëlarjes së gojës (*madmadah*), duke thënë “*Allahu im! Kërkoj ndihmën Tënde në leximin e Kuranit Famëlartë. Më ndihmo që të të përkujtoj Ty me gjithë zemër, të të lavdëroj ashtu siç Ti e meriton dhe të të adhuroj në mënyrën më të mirë të mundshme.*”, “*Zoti im! Më mundëso të pi ujë deri në ngopje nga burimi i të Dërguarit Bujar (s.a.s.); të pi në një mënyrë të atillë, sa që të mos më kapë kurrë më etja.*”, mbushet me shpresën për të arritur ditën kur do të pijë me grushte nga uji i Keutherit.

Gjatë tërheqjes së ujit me hundë (*istinshak*), uron të ndiejë që në këtë botë erën e këndshme të së përtejmes dhe lutet që, në botën tjetër, të nuhasë aromën e Xhenetit dhe të përfitojë nga të mirat e tij.

Kur lan fytyrën, duke thënë “*Allahu im! Më nxirr edhe mua faqebardhë e fytyrëndritur në atë ditë kur miqve të Tu do t’ua zbardhësh faqen e do t’i bësh të shndrisin, kurse armiqtë, do të jenë me fytyra sterrë të zeza.*”, kthen edhe një herë shikimet drejt shpateve të Xhenetit.

Mandej, bashkë me larjen apo lagjen e çdo gjymtyre tjetër, shpreh edhe një dëshirë akoma më të veçantë: Kërkon lehtësimin e llogaridhënies në Ditën e Gjykimit, dhënien e fletore së veprave nga ana e djathtë, mbrojtjen e flokëve dhe të lëkurës së tij nga zjarri, strehimin nën hijen

e Arshit të Lartë në atë ditë kur nuk do të ketë asnjë hije tjetër përveç asaj të arshit të Zotit të Madhëruar, të jetë prej atyre që, gjatë gjithë jetës, dëgjojnë vetëm fjalë të dobishme dhe veprojnë në përputhje me atë më të bukurën, çlirimin nga zjarri i Xhehenemit, shpëtimin nga rrëshqitja e këmbëve në urën e Siratit në atë ditë kur rrëshqitja e këmbëve është thujse e paevitueshme dhe të mos ngecë në mes të rrugës që të çon drejt Xhenetit. Kur është duke mbaruar punë me abdesin, duke thënë “Zoti im! Shpërbleji punët dhe përpjekjet e mia me mirësitë e Tua të bollshme; falmi mëkatet, më fal mua, pranoji veprat e mia, më mundëso një tregti fitimprurëse dhe mos më bëj nga të humburit!”, uron të jetë nga robërit që bëjnë vazhdimisht teube dhe shpëtojnë nga gjynahet duke e bërë pastërtinë pjesë të pandashme të natyrës së tyre. Një njeri që u përmbahet mendimeve të këtilla në çdo fazë të marrjes së abdesit përparon hap pas hapi drejt një përqendrimi të plotë.

Marrja e abdesit në mënyrën e duhur pavarësisht vështirësive

I Dërguari i Allahut (*alejhi ekmelut'tehájá*), pasi u bën sahabëve të nderuar pyetjen “*A t’jua them gjërat që Allahu i ka bërë shkak për shlyerjen e gabimeve tuaja dhe që bëjnë të mundur lartësimin tuaj gradë pas grade?*”, numëron këto gjëra: “*Marrja e abdesit ashtu siç duhet edhe kur (kushtet janë jashtëzakonisht të rënda dhe) marrja e tij është e vështirë, të vesh e të vish mes shtëpisë dhe mesxhidit edhe nëse distanca mes tyre është shumë e madhe dhe të vihesh në pritje të namazit tjetër pasi ke falur një namaz.*” Më pas, Profeti ynë (s.a.s.) shton edhe këtë fjali: “*Ja, pra, kjo është lidhja me të Vërtetin (ribat) në gradën e kryerjes së detyrës së rojës përgjatë kufirit.*”¹⁶⁷

Në këtë hadith, i Dërguari i Allahut (s.a.s.) e shpreh marrjen e abdesit nëpërmjet fjalës ‘*isbág*’, e cila do të thotë të marrësh abdes në mënyrën e duhur, të shpëlash gojën dhe hundën me ujë të bollshëm, t’i lash mirë duart, krahët, fytyrën dhe këmbët. Një shprehje tjetër,

¹⁶⁷ Muslim, taháret 41; Tirmidhí, taháret 39.

e përdorur gjithashtu në këtë hadith, është edhe *'alel mekârih'*. Kjo bart kuptimin e vrapimit drejt ujit dhe marrjes së një abdesi të plotë pavarësisht vështirësive, pa pyetur për të ftohtin apo të nxehtin.

Çështja e marrjes së abdesit në çfarëdolloj kushtesh dhe fjala profetike që sapo cekëm më kujtojnë gjithmonë njerëzit që, në dimrin e acartë të Erzurimit, merrnin abdes me ujin e ftohtë akull të çezmave rreth e rrotull shatërvanit të ngrirë nga të gjitha anët. Gjendjet e atyre udhëtarëve të namazit, sikur të ishin krijesa tërësisht shpirtërore, ato gjendje, pra, që lënë mbresa të forta tek ai që po i vëzhgon, më vijnë para syve sikur të kishin ndodhur sot. Ende i kam të gjalla në kujtimet e mia përzierjen e zhurmës së ujit me psherëtimat e atyre robërve të sinqertë, veprimet dhe sjelljet e të cilëve të linin të kuptoje besimin e tyre të plotë të Zotit i Madhëruar, dhe ngjitjen e asaj përzierjeje tek Allahu. Sikur të kishin ardhur nga përtej, përvishnin mëngët e palët e pantallonave dhe uleshin para rubinetave. Aq ftohtë ishte në ato çaste, sa që uji që rridhte nga gishtat, derisa arrinte bërrylat, thujse ngrinte e bëhej akull. Kur ashpërsia e ujit bashkohej me të ftohtin jashtë, dridhjet e çdo qelize të trupit të fillonin që me larjen e duarve. Dhe, sidomos kur atyre dridhjeve u shtohej edhe një dridhmë e brendshme, një zë lartësohej drejt qiellit: *"Allahu im! Ma lehtëso llogaridhënien në ditën kur do të më kërkosh llogari për jetën time dhe, ashtu siç do të bësh me robërit e Tu të virtytshëm, jepma nga e djathta fletoren time të veprave!"*

Po, besimtarët janë të vetëdijshëm për sprovimin me vështirësi të këtij lloji, ashtu siç janë të vetëdijshëm edhe për sprovimin e tyre me çdo gjë tjetër. Ata besojnë fuqishëm se, nëpërmjet përpjekjes për t'u përqendruar dhe për t'iu kthyer Atij plotësisht, do t'i plotësojnë një pjesë të boshllëqeve në skadat e tyre të adhurimit. Me këtë iman dhe besim, besimtarët i japin abdesit një vlerë krejt tjetër, e vlerësojnë atë si një farë që mbin e jep fruta jo shtatë, po shtatëdhjetë herë në vit. Bëjnë që të shkruhet një abdes në fletoren e tyre të veprave, por shpresojnë të shpërblehen për shumë më shumë se aq. E, pse jo? *"Ajo është mirësia e Allahut, që Ai ia jep kujt të dojë..."*¹⁶⁸

¹⁶⁸ Surja Hadíd, ajeti 21.

Në fakt, edhe i Dërguari i Allahut (s.a.s.) ka thënë: “Për atë rob që merr abdes sipas rregullave dhe etikës së abdesit, hap duart drejt qiellit dhe thotë ‘Dëshmoj se, përveç Allahut, askush tjetër nuk mund të jetë i Dëshiruari i Vërtetë, i Dëshiruari i Denjë; Ai është Një dhe i Pashoq. Dëshmoj gjithashtu se Muhamedi i nderuar (alejhissalátu uesselám) është rob dhe pejgamber i Tij,’ hapen njëherazi tetë dyert e Xhenetit dhe ai mund të hyjë brenda nga ajo derë që dëshiron.”¹⁶⁹ Arritja e një shpërblimi kaq të madh, mbase nuk është praktikisht e mundur për këdo që merr abdes. Sepse mund të mos jetë e mundur që çdo besimtar të mbushet me të njëjtat ndjenja e mendime në rrugën e namazit dhe ta ndiejë abdesin me gjithë thellësinë e tij. Megjithatë, arritja e një shpërblimi të tillë përmes abdesit është potencialisht e mundur pothuajse për të gjithë dhe është e sigurt se këta fatlumë, për të cilët do të hapen të gjitha dyert e Xhenetit, do të përzgjidhen nga mesi i atyre që i japin hakun abdesit.

Prandaj i Dërguari i Allahut (s.a.s.) merrte abdes para çdo namazi. Madje, deri në çlirimin e Mekës, Ai thua se asnjëherë nuk ka falur dy kohë namazesh me të njëjtin abdes. Edhe sahabët besonin se rruga që të çon faqebardhë drejt ditës së kiametit, me sy të shndritshëm, duar e fytyrë të pastër dhe me ndërgjegje të kulluar si botët e brendshme të atyre në qiell, kalon nga namazi dhe veprimet që bëhen para tij. Dhe në përputhje me këtë besim jetuan deri në çastin e fundit. Për shembull, Ebu Hurajra (r.a.) e kishte bërë zakon që, gjatë marrjes së abdesit, t’i lante krahët pothuajse deri te supet, ndërsa këmbët deri te gjunjët. Atyre që e patën pyetën për arsyen e të vepruarit në këtë mënyrë, ai u qe përgjigjur kështu: “Unë kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut (s.a.s.) të thotë ‘Kur umeti im të thirret në ditën e kiametit, ata do të vijnë duke shkëlqyer si dritë për shkak të shenjave të abdesit në gjymtyrët dhe fytyrat e tyre.’ Andaj, kush të ketë mundësi për ta shtuar dritën e tij, le ta shtojë.”¹⁷⁰ Sipas një transmetimi

¹⁶⁹ Ahmed ibn Hanbel, el Musned 1/19, 4/150.

¹⁷⁰ Buhári, vudú 3; Muslim, taháret 34-37.

tjetër, Profeti ynë (s.a.s.) thotë kështu: *“Stolitë e besimtarit do të arrijnë deri aty ku arrin uji i abdesit.”*¹⁷¹

Çështja e të qenit me shenjat në gjymtyrët e abdesit dhe sexhdes shumë më para se edhe ata që janë të parët dhe ajo e të njohurit nga ana e Pejgamberit tonë (s.a.s.) në botën e përtejme shpjegohen edhe në një hadith tjetër, madje, bashkë me një sihariq të tillë:

Një ditë, i Dërguari i Allahut (s.a.s.) pati shkuar te varrezat Bakí, pati vizituar fatlumët e varrosur atje dhe pati thënë: *“Paqja qoftë mbi ju, o banorët e tokës së besimtarëve! Në dashtë Allahu, edhe ne do të bashkohemi me ju një ditë.”* Më pas, pati shtuar: *“Do doja shumë t’i shihja vëllezërit e mi.”* Kur sahabët e nderuar e patën pyetur me fjalët *“O, i Dërguari i Allahut, a nuk jemi ne vëllezërit e tu?”*, Profeti ynë Bujar (s.a.s.) qe përgjigjur kështu: *“Ju jeni shokët e mi; vëllezërit e mi nuk kanë ardhur ende; ata do të vijnë më vonë.”* Sahabët e nderuar e patën pyetur sërish: *“Si do ta njohësh në botën tjetër umetin tënd që nuk ka ardhur akoma, o, i Dërguari i Allahut?”* Ai Profet i Dhembshurisë qe përgjigjur në këtë mënyrë: *“Mendohuni pak. Nëse një burrë do të kishte kuaj me shenja të bardha te balli dhe këmbët, a nuk do të ishte ai në gjendje t’i njihnte kuajt e tij në mesin e kuajve të zinj dhe të kuqërremtë? Ja, pra, falë abdesit, vëllezërit e mi do të vijnë me fytyrat plot nur dhe duar e këmbë të shndritshme. Unë do t’i pres ata te burimi im...”*¹⁷²

Ja, pra, abdesi premtion shpërblime shumë të mëdha si në këtë botë, po ashtu edhe në botën tjetër. Por, për të arritur tek ato çfarë ai premtion, është një e përpjetë goxha e pjerrët që duhet kapërcyer. Dhe kalimi i saj varet nga vullneti i njeriut. Kjo do të thotë se detyra e robërve në këtë pikë është të treguarit e një përpjekjeje dhe mundi të vullnetshëm për të arritur përqendrimin në adhurime. Në fillim mund t’ju duket e vështirë dhe e rëndë, ndonjëherë mund të ndodhë që edhe kushtet të mos jenë të favorshme, por me kalimin e kohës, nëse do të shtrëngoni dhëmbët e do të bëni durim, do të merrni një kënaqësi të atillë nga abdesi, sa që do ta konsideroni atë dritën e syve tuaj dhe nuk do ta

¹⁷¹ Buhári, libás 90; Muslim, taháret 40.

¹⁷² Muslim, taháret 39; Nesáí, taháret 110; ibn Máxhe, zuhd 36.

ndërroni me asgjë tjetër. Pasi të niseni duke thënë ‘*bismil’láh*’, pasi ajo e përpjetë thikë të kapërcehet me durim, do të përballeni me një shije dhe një kënaqësi të atillë, saqë do të dëshironi të mos mbarojnë kurrë endjet tuaja në mëqik mes abdesit dhe namazit.

Teprimi (ifrat) në adhurime dhe lënia e tyre mangët (tefrit)

Çekuilibri në botëkuptimin tonë të adhurimeve dhe robërisë ndaj Zotit, herë me pretendimin e të qenit i pastër përbrenda, herë me pretekstin e ca angazhimeve të kësaj bote dhe herë duke u fshehur pas justifikimeve të tjera, mund të shfaqet ndonjëherë si lënie mangët e adhurimeve apo braktisje e plotë e tyre. Për shembull, disa njerëz, që nuk janë aspak seriozë në çështjet që kanë të bëjnë me fenë, duke pretenduar se pastërtia e zemrës është gjëja më thelbësore, thonë se kryerja e adhurimeve nuk është e nevojshme. Përballë këtij botëkuptimi të gabuar, ka edhe njerëz që tregojnë një ndjeshmëri deri në tepri (*ifrat*) ndaj adhurimeve. Për shembull, ca persona, me pretekstin se po marrin abdes ashtu siç duhet, e shpërdorojnë ujin në një mënyrë të jashtëzakonshme. Disa të tjerë, duke bërë disa veprime të çuditshme me mendimin se janë duke bërë *istibra*, futen në situata aspak të këndshme. Ama asnjë nga këto sjellje nuk është parë as te Profeti ynë (s.a.s.), as te të parët tanë të nderuar dhe as te dijetarët e mëdhenj.

Tregon Ebu Said el Hudri (r.a.): “Ne, bashkë me të Dërguarin e Allahut (s.a.s.), në dhjetëditëshin e dytë të Ramazanit u futëm në itikaf; në mëngjesin e ditës së njëzetë, gjërat tona i zhvendosëm (nëpër shtëpitë tona). I Dërguari i Allahut (mbajti një hutbe dhe) tha këto fjalë: *‘Ata që kanë hyrë në itikaf të kthehen në vendet e tyre të itikafit. Sepse natën e kaluar m’u tregua se kur do të jetë nata e Kadrit, por, pastaj, më bënë ta harroja. Ju kërkoheni atë gjatë dhjetëditëshit të fundit, në netët tek. Për më tepër, këtë natë e pashë veten duke bërë sexhde në ujë e baltë.’* Pasi i Dërguari i Allahut (s.a.s.) u kthye në vendin e itikafit, drejt fundit të asaj dite moti u prish, filloi të binte shi. Në atë kohë, mesxhidi ishte në trajtën e një çardaku (të ngritur mbi dhe e të

mbuluar me degë). Vëreja se i Dërguari i Allahut (s.a.s.) kishte pak baltë në hundë dhe ballë (për shkak të sexhdeve që kishte bërë mbi dhe).¹⁷³

Profeti ynë (s.a.s.) nuk mbante me vete ndonjë rrogë për namazin, sepse e gjithë sipërfaqja e tokës i ishte bërë mesxhid Atij. Përsëri sipas disa dijetarëve, tharja me diçka pas marrjes së abdesit është mekruh. Do të thotë se ata, më shumë sesa për anën e jashtme, preokupoheshin për anën e brendshme të çështjes; ngaqë i drejtoheshin Zotit me një zemër të pastër e të dëlirë, në atë masë ishin të pastra, të dëlira dhe të qarta mirësitë, begatitë që u vinin prej Tij.

Po, ata që merren me anën e jashtme të çështjes në një mënyrë të panevojshme – me shumë gjasë – nuk preokupohen dhe aq për anën e brendshme të tyre dhe as që janë të vetëdijshëm për gjendjen e zemrave të tyre tashmë të ndryshkura. Kjo gjë nuk duhet nxjerrë aspak nga mendja: Një person le të bëjë sa të dojë veprime të çuditshme me qëllimin për të bërë istibra, le t'i fërkojë sa të dojë gjymtyrët për të bërë të mundur arritjen e ujit në çdo pjesë të tyren, ama, nëse jeton pa qenë i vetëdijshëm për botën e tij të brendshme dhe përmbajtjen e gjërave që bën, këto të fundit nuk do të kenë asnjë vlerë dhe, në botën tjetër, i gjithë ky mund do t'i përplaset fytyrës.

Feja jonë është fe e lehtësisë; ata që ua vështirësojnë atë të tjerëve janë persona që nuk e kanë kuptuar kuptimin e saj të vërtetë. I Dërguari i Allahut (s.a.s.) i paralajmëron kështu ata që, duke kaluar në ekstreme, e tregojnë fenë të vështirë: *“Kjo fe është fe e lehtësisë. Askush të mos provojë ta kalojë fenë duke shkuar në ekstreme, (nuk do t’ia dalin dot, prapëseprapë, bashkë me gjërat që ata do t’i lënë të mangëta) fitorja do t’i mbesë fesë.”*¹⁷⁴

Po, feja është diçka që mund të jetohet; ajo është shumë larg mendësive ekstreme si braktisja e adhurimeve duke thënë “Zemra ime është e pastër...” (*tefrit*) dhe moskryerja e sexhdes në vendet ku nuk ka sexhade (*ifrat*). Në fakt, robëria e një njeriu ndaj Zotit të tij është

¹⁷³ Buhárí, fadlu lejletil kadr 2; Muslim, sijám 213.

¹⁷⁴ Buhárí, ímán 29; Nesáí, ímán 28.

aq sa emocionet dhe entuziazmi që ai mbart përbrenda. Ai në asnjë mënyrë nuk duhet ta ndyjë këtë entuziazëm nëpërmjet kryerjes së një sërë veprimesh artificiale. Përndryshe, do të prishë ekuilibrin. Nëse ana e tij e brendshme nuk është në përputhje me atë të jashtmen, njeriu le të merret sa të dojë me anën e jashtme të çështjes. Ai do të endet nëpër këtë luginë këmbëzbathur e kokëzbuluar, por, në fund fare, do të kthehet duarbosh. Kështu që, në asnjë mënyrë nuk duhet treguar një krenari dhe mendjemadhësi e tillë si qëndrimi dhe këmbëngulja djallëzore për të mos vënë kokën në tokë, për të mos vënë kokën atje ku edhe profetët, duke shkelur me këmbë krenaritë e tyre, janë përulur dhe kanë mbështetur kokat e tyre. Brenda një ekuilibri të përgjithshëm, bëj edhe ti sexhde duke vënë kokën në tokë, bëj sexhde dhe eja para Zotit tënd me pluhur e dhe në ballë. Atëherë Allahu (*xhel'le xheláluhu*) do të jetë Ndihmësi yt.

Profetët, ashtu si në çdo gjë tjetër, jetës shoqërore i kanë sjellë një ekuilibër të qartë edhe në çështjen e adhurimeve. Nëse do t'i ndjekim ata, nëse do t'i kryejmë adhurimet tona ashtu siç na kanë udhëzuar ata, do të jemi në rrugë të drejtë dhe larg çdo devijimi.

c. Mirësitë që plotësohen me abdesin

Në krijimin e mekanizmit të trupit të njeriut, Zoti i Plotfuqishëm ka ndjekur qëllime mahnitëse. Imam Gazaliu thotë se nuk ka diçka më të çuditshme se trupi i njeriut. Në trupin e njeriut janë vendosur ekuilibra aq delikatë dhe me vend, saqë, nëse do tentoni të ndryshoni njërin prej tyre, do t'ju shkojë munda huq. Sepse do të gaboni dhe, për rrjedhojë, do të shkaktoni prishjen e gjithë trupit. Për shembull, trupi ka zemrën dhe sistemet kardiovaskulare, që kryejnë detyrën e tyre sikur të ishin pjesët përbërëse të një pompe. Ky sistem, gjatë gjithë kohës, mban pulsion tonë dhe pompon gjak deri në pjesët më të largëta të trupit tonë. Ky sistem, i cili i jep gjallëri jetës sonë, edhe pse ne mund të mos jemi të vetëdijshëm për këtë, rreh gjatë gjithë jetës duke thënë 'Allah'. Dervishët thonë se ritmi i '*Lá iláhe il'lalláh, lá iláhe il'lalláh...*' përkon

me atë të rrahjeve të zemrës. Pasi njeriu fillon të thotë ‘*Lá iláhe il’lalláh*’, edhe zemra i përshtatet atij ritmi dhe, duke filluar të thotë edhe ajo ‘*Lá iláhe il’lalláh, lá iláhe il’lalláh...*’, pompon deri në pjesët më të largëta të trupit gjakun, i cili e mban trupin në këmbë. Detyrën e transportimit të gjakut nëpër këto pjesë të trupit e kanë kapilarët, të cilët janë si tubat e ujit; ashtu siç bllokohen me kalimin e kohës tubat e ujit nga gëlqerizimi, po ashtu, si pasojë e formimit të shtresave yndyrore, ngurtësohen edhe kapilarët. Dhe, kështu, vijnë në një gjendje pamundësie për të kryer detyrën e tyre. Nga kjo situatë, më së shumti ndikohen ato pjesë të trupit që janë më larg zemrës, fjala vjen, majat e gishtave të duarve dhe këmbëve, pika në majë të trurit etj. Në mënyrë që këto organe e gjymtyrë të jenë të shëndetshme, qarkullimi i gjakut në trup duhet të funksionojë ashtu siç duhet. Kështu, uji i abdesit, duke aktivizuar kapilarët në pikat më të largëta ndaj zemrës, ndihmon në këtë drejtim. Kjo është shumë e rëndësishme në aspektin e ruajtjes së vitalitetit të atyre gjymtyrëve, te të cilat, gjaku i ndotur biologjikisht, pasi është kthyer në zemër dhe pasi është pastruar te mushkëritë, mbërrin sërish i filtruar. Të gjitha këto janë nga një mirësi e Allahut. Në fund të ajetit që urdhëron marrjen e abdesit, Allahu (*xhel’le xheláluhu*) thotë kështu: **“Allahu nuk dëshiron t’ju krijojë vështirësi, por dëshiron t’ju pastrojë dhe t’i plotësojë dhuntitë e Tij ndaj jush, që të jeni falënderues.”**¹⁷⁵

Nëse do të thuhet “Mirë, po, çështë kjo mirësi që kërkon të plotësohet?”, nuk duhet të harrojmë se çdo gjë që Zoti i Plotfuqishëm i ka dhënë njeriut është një mirësi. Por, në njëfarë kuptimi, plotësimi i këtyre mirësive i është lënë vullnetit të vetë robit. Sepse krijimi i parë ndodh jashtë dëshirës sonë; Allahu (*xhel’le xheláluhu*) na krijon dhe na sjell në këtë botë; nuk pyet askënd për këtë. Vazhdimësia e këtyre mirësive ama, varet nga vullneti i vetë robit. Për shembull, siç thonë edhe mjekët e ditëve të sotme, një nga faktorët e rëndësishëm në ruajtjen e elasticitetit të sistemit vaskular është larja herë me ujë të nxehtë, herë me ujë të ftohtë. Uji i nxehtë ndihmon në hapjen e venave, kursi uji i ftohtë i ngushton ato. Rrjedhimisht, për sa kohë merr abdes,

¹⁷⁵ Surja Máide, ajeti 6.

njeriu bën të mundur nëpërmjet vullnetit të tij të lirë që ato të kryejnë detyrën e tyre duke u tkurrur dhe duke u rihapur vazhdimisht.

Abdesi dhe gusli, jo vetëm që kontribuojnë në mirëfunksionimin e mekanizmit të qarkullimit të gjakut në trup, por ndihmojnë edhe në stimulimin dhe aktivizimin e sistemit limfatik. Funksionimi i këtij sistemi është një faktor i rëndësishëm në shërimin e plagëve dhe mbrojtjen e organizmit nga mikrobet. Në shumicën e librave të shkruar me qëllimin për të përpiluar shkencën e mjekësisë nëpërmjet urdhrave të Islamit, thuhet se stimulimi i këtij sistemi limfatik është i mundur vetëm përmes larjes me ujë të hundës dhe qafës. Ja, pra, Allahu i Madhëruar ka bërë që të jetë abdesi ai që e kryen këtë detyrë.

Në të gjithë trupin e njeriut ekziston një ekuilibër elektrik statik. Vazhdimësia dhe ruajtja e këtij ekuilibri elektrik, në aspektin e shëndetit të trupit, është e nevojshme dhe shumë e rëndësishme. Veçanërisht sëmundjet mendore, të cilat ne sot i quajmë çrregullime psiko-somatike, në shumicën e rasteve prekin edhe trupin, ndikojnë edhe tek ai. Për shembull, sëmundjet si ulcera e stomakut janë rezultat i një ndërveprimi të tillë.

Në ditët e sotme, negativitetet që ndikojnë në strukturën mendore e shpirtërore të njeriut dhe që prishin ekuilibrin elektrik të trupit të tij janë goxha shumë. Ajri i ndotur, përdorimi në veshje dhe enë i substancave, kimikateve etj. të dëmshme për shëndetin e njeriut janë faktorë që prishin ekuilibrin elektrik të trupit dhe që e shtyjnë njeriun drejt çekuilibrit. Në krye të gjërave që, duke i eliminuar këto prishje ekulibrash, rregullojnë elektricitetin e trupit vijnë uji dhe dheu. Marrja e abdesit pesë herë në ditë dhe, kur gjetja e ujit është e pamundur, – me shprehjen e ajetit – marrja e tejemumit me dhe të pastër rregullon elektricitetin në trup dhe hedh jashtë tij elektricitetin e tepërt. Ja, pra, edhe Kurani, duke na urdhëruar që të marrim abdes kur ngrihemi për të falur namazin, të marrim gusl nëse jemi *xhunub* dhe të marrim tejemum në ato raste kur nuk mund të gjejmë ujë, tërheq vëmendjen te kjo çështje. Të gjitha këto janë për plotësimin e mirësive të Allahut të Madhëruar ndaj robërve të Tij.

Po kështu, edhe jeta është një mirësi. Vazhdimi i kësaj mirësie, me fjalë të tjera, arritja e përjetësisë, varet nga shpenzimi i saj në rrugën drejt amshimit. Allahu (*xhel'le xheláluhu*) na e ka dhënë këtë mundësi; Ai ia ka ofruar vetë vullnetit të robit mundësinë për ta shndërruar këtë jetë të fundme në një diell të përjetshëm. Në këtë kontekst, – edhe pse gradualisht – Ai i ka bërë haram gjërat që kërcënojnë shëndetin e njeriut.

Po, Islami është fe e lehtësimit. Allahu (*xhel'le xheláluhu*) kurrë nuk dëshiron ta vërë në vështirësi robin e Tij. Siç shprehet në një ajet të Kuranit, **“Ai dëshiron që t’jua lehtësojë dhe jo që t’jua vështirësojë.”**¹⁷⁶ Prandaj nuk mund të thuhet “Pse na kërkohet të marrim abdes edhe në kushte të vështira?”. Sepse Ai dëshiron t’i plotësojë mirësitë e Tij ndaj nesh. Dhe abdesi është një faktor i rëndësishëm në vazhdimin e atyre mirësive.

d. Shkallët e pastërtisë në namaz

Namazi është një adhurim madhështor që përfshin katër shkallë të pastërtisë.

Shkalla e parë: Nëpërmjet pastrimit nga papastërtitë materiale, të cilin e bëjmë në emër të përgatitjes për namaz, pastrohemi, para së gjithash, nga papastërtitë mbi rrobat dhe gjymtyrët tona.

Shkalla e dytë: Syri, i cili pastrohet nga papastërtitë materiale përmes marrjes së abdesit, nuk shikon gjëra haram; goja, nuk thotë fjalë të liga; dora, nuk bën punë të këqija; këmba, nuk hedh hapa drejt së keqes... Në këtë mënyrë, të gjitha gjymtyrët qëndrojnë larg mëkateve.

Shkalla e tretë: Në këtë shkallë të pastërtisë, zemra largohet nga ndjenjat dhe mendimet e këqija. Mandej, lidhet vetëm me pëlqimin dhe kënaqësinë e Zotit.

Po, Allahu i Madhëruar kthen shikimin te njerëzit, u drejtohet atyre

¹⁷⁶ Surja Bekare, ajeti 185.

me gjërat që Ai urdhëron dhe e bën kthimin e tyre ndaj Tij si shkak për këtë drejtim të Tijin ndaj njerëzve. Allahu thotë: *“Kthehuni tek Unë, m'u drejtoni ju Mua, që edhe Unë të kthehem nga ju.”* Me fjalë të tjera, nëse një njeri del me namaz para Zotit, qëndron i përlur, paloset më dysh para Tij, edhe Ai do ta shikojë atë, do t'i drejtohet atij. Allahu kurrë nuk drejtohet nga ai që nuk fal namaz, nuk e kthen shikimin te beli që nuk përkulet para Tij, te koka që nuk bën sexhde dhe balli i ndotur.

Rabiatul Adeuije, këtë shikim dhe drejtim të Zotit, e shpreh kështu: “Nëse Allahu nuk do të ishte kthyer nga unë, unë nuk do të kisha qenë në gjendje të merrja abdes e të falja namaz, nuk do të kisha agjëruar dot, nuk do të kisha mundur të ngrihesha e ta gjallëroja natën duke thënë ‘Sonte është nata e Miraxhit.’ Kthimi i Tij nga unë më ka sjellë në këtë gjendje.”

Këtë mund ta shpjegojmë më mirë me një krahasim të tillë: Një luledielli, a ndjek diellin ngaqë dielli e shikon atë, apo e ndjek vetvetiu, pa ndonjë arsye? Sigurisht, nëse dielli nuk do të ishte, ajo nuk do t'ia kthente fytyrën atij. Kështu që, thelbësore është ekzistenca e diellit që i drejtohet asaj. Në të njëjtën mënyrë, edhe shikimi dhe drejtimi i Diellit të Pafillim e të Pafund ndaj robit janë thelbësore për të. Nëse Ai nuk do ta shikojë atë, njeriu do të bjerë në një situatë të mjerueshme, nuk do të jetë në gjendje të dijë rrugën e xhamisë, të gjejë sexhaden dhe të njohë mihrabin, do të ngecë e do të mbesë rrugëve. E, në fakt, Allahu (*xhel'le xheláluhu*) na ka udhëzuar të gjithë ne, me të rinj e të moshuar, dhe na ka treguar rrugët që shkojnë drejt xhamisë. Pra, ne do ta shohim Atë, që edhe Ai të na shikojë ne; Ai do të na shikojë ne, edhe ne do ta shikojmë Atë. Interesimi sjell si rezultat interesimin. Zaten këtë shpreh edhe ajeti **“Prandaj, më kujtoni Mua (me adhurime), që Unë t’ju kujtoj (me shpërblim)...”**¹⁷⁷. Pra, Allahu kërkon ta kujtojmë Atë në kohët tona të rehatisë, që Ai të na kujtojë në çastet tona të vështira; le ta kujtojmë Zotin në këtë botë, që Ai të na kujtojë në jetën e varrit, në Ditën e Gjykimit, në urën e Siratit dhe atëherë kur shkëndijat e Xhehenemit do të vijnë drejt nesh.

¹⁷⁷ Surja Bekare, ajeti 152.

Po, robi duhet ta kërkojë Zotin, ta kërkojë duke u rrotulluar pa pushim si një helikë, që të mund ta gjejë Atë një ditë. Ja, pra, namazi është ai që ia siguron njeriut këtë kthim të Allahut për nga ai. Një besimtar që përgatitet për faljen e namazit, dashje pa dashje, do të ripërtërihet nëpërmjet abdesit, pastaj, do të vrapojë për të dalë para Tij dhe do t'i drejtohet Atij. Allahu i Madhëruar nuk do të qëndrojë indiferent ndaj këtij drejtimi të besimtarit, përkundrazi, do t'ia hapë atij të gjitha dyert deri në fund.

Shkalla e katërt: Ekziston edhe shkalla e fundit e pastërtisë, ajo e profetëve, e cila qëndron në izolimin e zemrës dhe shkëputjen e saj nga çdo gjë tjetër përveç Allahut, në nxjerrjen nga zemra dhe flakjen tutje edhe të gjërave që janë të lejuara pavarësisht se kanë të bëjnë me këtë botë dhe në shfaqjen e pasqyrimin e Allahut në zemrën e robit.

Kjo është pastërtia që i kërkohet Profetit tonë (s.a.s.) dhe profetëve të tjerë, kjo është pika e fundit e arritur nga ata në çështjen e pastërtisë. Për ta kapur këtë shkallë, është e nevojshme të fillohet nga shkalla e parë dhe të ndiqet radha e tyre deri tek ajo e fundit. Për shembull, nuk është e mundur të pastrohesh nga çdo gjë që ka të bëjë me këtë botë pa kaluar nga pastrimi i zemrës dhe pa e izoluar veten ndaj moralit të keq. Zemra nuk mund të ndërtojë një lidhje me Allahun pasi nuk është shkëputur nga morali i keq dhe nuk i ka ndërprerë marrëdhëniet me gjërat e kësaj dynjaje. Nuk është e mundur ndezja e dritës në zemër nëse gjymtyrët dhe organet e tjera nuk izoloohen ndaj mëkateve. Thënë ndryshe, shkëptimi i imanit do të shkëlqejë në zemrën e njeriut vetëm në sajë të largimit nga mëkatet e organeve të brendshme dhe të jashtme.

Pra, është e pamundur të arrihet në shkallën tjetër pa kaluar fillimisht shkallën paraardhëse. Ashtu siç bëhet ngjitja e shkallëve këmbëz pas këmbëze, po ashtu do të arrihet në pikën e dëshiruar, duke u ngjitur hap pas hapi. Dhe, në fund, do të fitohet pëlqimi i Zotit. Profetët janë lartësuar në atë gradë duke u treguar të kujdesshëm ndaj këtij ekuilibri. Për shembull, i Dërguari i Allahut (s.a.s.) ishte shumë i përpiktë dhe i rregullt si në çështjen e abdesit, po ashtu edhe në atë të namazit. Në

emër të pastërtisë së zemrës, kërkonte falje njëqind herë në ditë dhe këtë e pati deklaruar duke thënë: *“Unë i kërkoj falje Allahut njëqind herë në ditë.”*¹⁷⁸ Dimë gjithashtu se Ai (s.a.s.) e përsëriste disa herë çdo mëngjes e mbrëmje lutjen *“Allahu im! Ma bëj zemrën të qëndrueshme në fenë Tënde!”*¹⁷⁹.

2. Ezani

Pas abdesit, hapi i dytë në arritjen e përqendrimit në namaz është ezani. Besimtari fillon të shkëputet nga ndjenjat dhe mendimet djallëzore me marrjen e abdesit, ndërsa nëpërmjet ezanit fiton një thellësi shpirtërore akoma më të madhe, arrin qetësinë e brendshme dhe brenda tij fillojnë të fryjnë puhizat e ëmbla parajsore. I Dërguari i Allahut (s.a.s.) thotë: *“Kur fillon këndimi i ezanit, për shkak të shqetësimeve dhe stresit që përjeton në atë çast, shejtani ia mbath duke nxjerrë zëra të neveritshëm.”*¹⁸⁰

Pra, do të thotë se ezani është një thirrje shumë e bekuar, e cila bëhet shkak për zhytjen dhe fundosjen e shejtanit dhe shpirttrave djallëzorë brenda shqetësimeve dhe një situatë alarmante. Është shumë e rëndësishme që njeriu, për të qenë në gjendje të pastrohet nga djalli dhe mendimet djallëzore, ta falë në shoqërinë e lotëve të tij namazin dhe të përqendrohet totalisht tek ai, të dëgjojë një ezan të kënduar me vetëdije, me gjithë zemër. Kur vinte koha e faljes së namazit, I Dërguari i Allahut (s.a.s.) nuk i thoshte Bilalit të nderuar *“Çohu e na këndo ezanin!”*, po, në të shumtën e herëve, i drejtohej me fjalët *“O Bilal, na fresko njëherë!”*¹⁸¹ Kuptimi i kësaj shprehjeje është ky: *“Këto punët e kësaj dynjaje na mërzitën. Na i qetëso njëherë shpirttrat, që t'i heqim këto barrë që po na rëndojnë mbi supë e të rehatohemi pak. Dhe të shpëtojme nga vesveset djallëzore që i pëshpëriten nefsit të secilit prej nesh.”*

¹⁷⁸ Muslim, dhikr 41; Tirmidhí, tefsíru sùre (47) 1; ibn Máxhe, edeb 57.

¹⁷⁹ Tirmidhí, kader 7, de'auát 89, 124; ibn Máxhe, duá 2.

¹⁸⁰ Buhári, edhán 4; Muslim, salát 19.

¹⁸¹ Ebú Dáúd, edeb 78; Ahmed ibn Hanbel, el Musned 5/364, 371.

Para se të vendosej që ezani të ishte mënyra për t'i thirrur njerëzit në faljen e namazit, qenë propozuar edhe mënyra të tilla si përdorimi i borive apo këmbanave. Por i Dërguari i Allahut (s.a.s.) nuk i pati pranuar ato propozime. Sepse, përderisa do të bëhej një thirrje për faljen e namazit, kjo punë duhej bërë nëpërmjet ca fjalëve që do të ishin në gjendje të shprehnin shpirtin dhe bërthamën e namazit. Kur të dëgjohej ajo thirrje, njerëzit duhej të dridheshin dhe të kuptonin se do të dilnin para një Fuqie Sublime. Kjo thirrje nuk duhej bërë me fjalë çfarëdo, po me fjalë të bekuara, të cilat do të ishin gjithashtu një frymëzim nga ana e Allahut. Si përfundim, nëpërmjet fjalëve me të cilat frymëzoi disa nga sahabët, Allahu mundësoi që ezani të arrinte një bukuri të veçantë. Kjo është arsyeja pse dijetarët i shihnin fjalët e ezanit si të ishin shtyllat e tij. Domethënë, siç janë tekberi fillestar, kijami apo leximi i Kuranit në namaz nga një shtyllë e namazit, siç nuk mund të ketë namaz pa këto pjesë thelbësore të tij, po ashtu janë edhe fjalët e ezanit për ezanin. Nëse ndonjëra nga fjalët e tij mungon, ajo që mbetet nuk është më ezan.

Edhe shprehja e ezanit me fjalë të tjera mund të vlerësohet brenda së njëjtës dispozitë. Sepse, për shembull, me fjalët *“Allahu është më i madhi”*, ndërgjegjja e njeriut paralajmërohet për diçka. Siç dihet, fjala *‘ekber’*, në shqip ka kuptimin ‘më i madhi’. Por ajo nuk do të thotë se ka edhe të mëdhenj të tjerë dhe se Allahu (*xhel’le xheláluhu*) është më i madhi mes tyre. Ne e përkthejmë atë në këtë mënyrë për shkak të mungesës së fjalëve të duhura në gjuhën tonë. Nëse do të jepnim kuptimin e vërtetë të kësaj fjalie, do të na duhej të thoshnim kështu: “I madh është vetëm dhe vetëm Allahu. Ai është i Adhuruari i Vërtetë dhe i Dëshiruari i Denjë. Vetëm në derën e Tij zgjidhen të gjitha problemet, edhe ato të pazgjidhshmet; gjërat që duken të pakapërcyeshme, vetëm duke iu drejtuar Atij kapërcehen. Prandaj bëhen vetëm ndaj Tij adhurimet.” Ja, pra, të gjitha këto kuptime shprehen nëpërmjet fjalëve *“Alláhu Ekber”*.

Më pas, duke thënë *“Eshhedu el’lá iláhe il’lalláh”*, *“Dëshmoj se nuk ka zot tjetër përpos Allahut.”*, dëshmohet në lidhje me çështjen e mësipërme.

Mandej, me fjalët *Eshhedu enne Muhammeden Rasúlulláh*, “Dëshmoj sërish se Muhamedi i nderuar është i dërguari i Tij”, dëshmohet edhe në lidhje me profetësinë e Pejgamberit tonë (s.a.s.). Sepse Ai na e ka sjellë këtë mesazh. Pastaj bëhet thirrja “*Hajje alessaláh*”, “*Hajdeni, vraponi për në namaz (për të shpëtuar nga streset dhe të gjitha llojet e shqetësimeve)*.” Kjo thirrje përsëritet edhe një herë me fjalët “*Hajje alet feláh*”, “*Vraponi drejt shpëtimit*.”. Sepse shpëtimi gjendet në portën e Atij, përpos të Cilit nuk ka të madh tjetër. Që namazi është një mjet shpëtimi, këtë e konfirmon edhe Kurani Famëlartë, nëpërmjet ajeteve **“Me të vërtetë, janë të shpëtuar besimtarët, të cilët janë të përlulur në namazin e tyre.”**¹⁸².

Ndërsa në fund fare, pasi thërritet edhe një herë madhështia e Allahut dhe shprehja e njësimi të Zotit me fjalët “*Alláhu Ekber, Alláhu Ekber, Lá iláhe il’lalláh*”, sikur të mos jetë arritur një ngopje e caktuar në këtë thellim, bëhet një dua edhe për Muhamedin (s.a.s.), i Cili, bashkë me namazin, sollti nga Allahu edhe ezanin: “*O Zotërues i kësaj ftese të përsosur dhe i namazit të falur! Lartësoje gradën e Muhamedit të nderuar (alejhi’salátu ues’selám) në Xhenet dhe jepi vlerë Atij! Bëje Atë të arrijë në atë gradë të lartë, që Ti ia ke premtuar Atij vetë.*” I Dërguari i Allahut (s.a.s.) na jep myzhdenë duke thënë: “*Ai që e bën këtë dua pas ezanit, do të përfitojë nga ndërmjetësimi im në Ditën e Kiametit.*”¹⁸³ Robi dëshiron që kjo lutje dhe namazi që do të falë të bëhen shkak që dora e Profetit tonë të arrijë tek ai dhe që Ai (s.a.s.) të arrijë në gradën më të lartë (*Makami Mahmud*). Sepse atje ndodhet “*Flamuri i Lavdërimit*” (*Livaul hamd*) dhe umeti i Muhamedit do të jetë në gjendje të mblidhet nën atë flamur të bekuar vetëm falë arritjes së Profetit tonë (s.a.s.) në atë gradë.

Si përfundim, duhet thënë se ezani është shumë i rëndësishëm. Për këtë arsye, gjatë këndimit të ezanit, është sunet që çdo individ t’i përsërisë fjalët e tij të bekuara duke i sjellë në mendje edhe kuptimet e tyre. Madje, të parët tanë të nderuar kanë thënë se do të ishte më

¹⁸² Surja Mu’minún, ajetet 1-2.

¹⁸³ Buhári, edhán 8, tefsíru súde (17) 11; Tirmidhí, salát 157; Ebú Dáúud, salát 28.

mirë sikur të mos lëvizej shumë gjatë kryerjes së kësaj. Fjalët e ezanit të dëgjohen dhe të përsëriten në qetësi dhe me një zemër të qetë. Sepse, për t'u përqendruar në namaz, duhet të bëhemi njësh me ezanin dhe përfitimet hyjnore që vijnë bashkë me të.

I Dërguari i Allahut (s.a.s.), edhe pse ishin nga të parët dhe më kryesorët në mesin e sahabëve, personave si Ebu Bekri, Omeri dhe Osmani (r.a.) nuk u ka kërkuar të thërrasin ezanin. E në fakt, Ebu Bekri (r.a.) kishte një zë aq mallëngjyes, saqë, kur fillonte të këndonte Kuran, të bënte të ndaleshe e ta dëgjoje me ëndje. Por, përderisa ua kërkonte Ebu Mahdhures, Ibn Umme Mektumit (r.a.) dhe më së shumti – ndoshta sepse kishte një zë që ndikonte thellë në shpirtin e njeriut – Bilalit (r.a.), do të thotë se ezani kërkon një zë ndryshe, një mënyrë tjetër të kënduari. Ezani nuk duhet kaluar me ca ulërime gërvishtëse, atij i duhet veshur një rrobë në përputhje me bukurinë e tij, në mënyrë që njeriu, duke ndier njëkohësisht fuqinë, ndikimin e fjalëve të ezanit dhe bukurinë e interpretimit të tij, të jetë në gjendje të futet brenda një përqendrimi dhe përgatitjeje shumë të mirë për faljen e namazit.

3. Namazet sunet

Një tjetër gjë e rëndësishme në arritjen e përqendrimit në faljen e namazeve farz është falja e namazeve nafile (sunet). Namazet nafile përbëjnë një tjetër hap ndër hapat që hidhen drejt qëllimit të mbushjes së zemrës në namaz dhe plotësimit të veçantë të saj. Me fjalë të tjera, para se të hapen drejt pafundësisë së afrimitetit të vërtetë me faljen e namazit farz, shpirtrat, në sajë të namazeve nafile, rrethohen sërish nga flladet e mëshirës hyjnore, ndërsa përqendrimi, i thelluar deri në atë çast hap pas hapi përmes abdesit dhe përgatitjeve të tjera, kontrollohet edhe një herë. Kështu, nëpërmjet namazeve nafile, njeriu do të përparojë, do të shkojë pak më tej dhe do t'i afrohet ca më shumë Zotit.

Siç edhe dihet, adhurimet e tjera përveç atyre farz dhe vaxhib quhen adhurime nafile. Një pjesë e namazeve nafile, më konkretisht, namazi

sunet i vaktit të sabahut, namazet sunet para dhe pas namazit farz të drekës dhe sunetet e ikindisë, akshamit dhe jacisë, falen bashkë me namazet farz të pesë kohëve ditore. Këto namaze, duke shtuar këtu edhe namazet sunet të namazit të Xhumasë, quhen sunete *'reuátib'*. Ky është emri i namazeve nafile që falen bashkë me namazet farz. I Dërguari i Allahut (s.a.s.), duke folur në lidhje me këto nafile në shumë hadithe, e shpjegon gjerë e gjatë rëndësinë e tyre. Në një hadith në lidhje me sunetet *'reuátib'*, pasi thotë *"Atij që vazhdon t'i falë dymbëdhjetë rekatet e namazeve sunet, Allahu i ndërton në Xhenet një shtëpi."*, Pejgamberi ynë (s.a.s.) i numëron kështu këto dymbëdhjetë rekatet: *"Katër rekatet para namazit farz të drekës, dy rekatet pas farzit të drekës, dy rekatet pas farzit të akshamit, dy rekatet pas farzit të jacisë dhe dy rekatet para namazit farz të sabahut."*¹⁸⁴

Kurse në një hadith tjetër, të mirat dhe përfitimet e këtyre nafileve i shpjegon veç e veç. Për shembull, në lidhje me dy rekatet sunet të kohës së sabahut thotë kështu: *"Namazi nafile dyrekatësh, i cili falet para namazit farz të sabahut, është më i vlefshëm se e gjithë bota."*¹⁸⁵

Fitimi i një diçkaje të tillë është i mundur për të gjithë, por, a mund të fitojë çdokush që e fal këtë namaz, a mund të ketë edhe nga ata që nuk fitojnë, vetëm Zoti e di. Për të fituar, ky namaz duhet falur. Është kusht që, për të arritur afrimitetin me Allahun, të shfrytëzohet ai rast. Ne, nëpërmjet mënyrave që Ai na ka treguar, mund të përfitojmë nga mirësitë e Zotit të Madhëruar; duke ndjekur rrugën që sërish Ai na ka treguar, mund të nderohemi me afrimitetin ndaj Tij. Emri i kësaj udhe, që do të na mundësojë t'i arrijmë të gjitha këto mirësi, që do ta bëjë shpëtimin tonë realitet dhe që, nëpërmjet zhvillimit të zemrës dhe shpirtit tonë, do të na shndërrojë në krijesa të denja për botët e përjetshme, është *'siráti mustakím'* (rruga e drejtë). Një person që përparon në këtë rrugë pa rënë në dëshpërim përballë situatave me të cilat do të ballafaqohet përgjatë saj, herët a vonë, do t'i arrijë qëllimet e tij. Në fakt, ta përjetosh këtë rrugë me të gjitha aspektet e saj nuk

¹⁸⁴ Tirmidhí, salát 306; ibn Máxhe, ikáme 100.

¹⁸⁵ Muslim, salátul musáfirín 96; Tirmidhí, salát 307; Nesái, kijám 56.

është dhe aq e lehtë, përkundrazi, është shumë e rëndë. Zaten Allahu (*xhel'le xheláluhu*) thotë: **“Kjo është njëmend e vështirë, përveçse për të devotshmit.”**¹⁸⁶

Përsëri Profeti ynë (s.a.s.), në lidhje me nafilet e kohës së drekës, thotë kështu: *“Atë që fal katër (rekate namaz nafile) para namazit të drekës, Allahu ia bën haram zjarrit të Xhehenemit.”*¹⁸⁷ Për namazin sunet të kohës së ikindisë, është shprehur në këtë mënyrë: *“Allahu e mëshiroftë atë që fal katër rekate namaz nafile para namazit të ikindisë.”*¹⁸⁸ Dhe kur shpjegon namazin sunet të vaktit të mbrëmjes, thotë: *“Namazi dyrekatësh i atij që e fal atë menjëherë pas namazit të akshamit, pa folur asnjë fjalë mes tyre, ngjitet në ‘il’lijún’ (që është një vend i lartë).”*¹⁸⁹

Nafilet që mbeten jashtë suneteve ‘*reuátib*’ janë namazet si: namazi i tehexhudit, namazi i duhasë (paradites), namazi ‘*eu’uábín*’ (namazi i atij që pendohet dhe kërkon mbështetje tek Allahu), namazi ‘*tahijjetul mesxhid*’ (namazi i përshëndetjes së faltores), namazi i haxhetit (nevojtarisë), namazi i istihares, namazi i shiut, namazi i eklipsit të diellit, namazi i eklipsit të hënës, namazi ‘*tesbih*’ dhe namazi i teravive.

4. Ikameti

Njeriu, i cili, me faljen e namazit sunet pas marrjes së abdesit dhe dëgjimit të ezanit, ka hedhur kështu edhe hapin e tij të tretë drejt faljes së namazit farz, me ngritjen në këmbë të një myezini me zë melodik që thërret ikametin duke iu drejtuar Allahut me sinqeritet të plotë, bën përgatitjet e fundit dhe përjeton nëpërmjet tij edhe një shpërthim të fundit emocionesh. Në këtë pikë, dua të prek edhe një çështje tjetër në lidhje me ikametin. Zëri dhe mënyra e të kënduarit gjatë çasteve të thirrjes së ikametit, nëse ndihmojnë në thellimin edhe ca më shumë

¹⁸⁶ Surja Bekare, ajeti 45.

¹⁸⁷ Tirmidhí, salát 317; ibn Máxhe, ikáme 108.

¹⁸⁸ Tirmidhí, salát 318; Ebú Dáúd, salát 296.

¹⁸⁹ Abdurrezzak, el Musan’nef 3/70; ibn Ebí Shejbe, el Musannef 2/16.

të dimensionit të dridhmës te ne, janë të pranueshme; përndryshe, që personi ta lëshojë veten e të rrëmbehet nga rrjedha e melodisë, kjo është diçka që as nuk mund të dëshirohet e as të pranohet. Ky është kriteri që duhet mbajtur parasysh edhe gjatë këndimit të një ilahije apo mevludit. E rëndësishme është që zëri të zbresë poshtë fytit, që, bashkë me zërin, të rënkojë edhe ndërgjegjja dhe ana e brendshme e njeriut. Ja, pra, ikameti, i kënduar nga myezini brenda kornizës së këtyre kriterëve, do t'ju vijë në ndihmë dhe do t'ju bëjë të emocionoheni edhe një herë në çastin e lidhjes në namazin farz.

Po, nëpërmjet ikametit, myezini e përsërit edhe një herë ezanin dhe, duke shtuar pjesën “Kini kujdes, namazi po fillon!”, bën paralajmërimin e fundit para fillimit të namazit farz. Sa i përket faljes së namazit farz, ai është çasti kur robi bëhet njësh me pasqyrimet Cilësive të Larta të Zotit të Madhëruar.

PJESA E KATËRT



***PJESËT PËRBËRËSE TË NAMAZIT
DHE URTËSITË E TYRE***

Aq sa është e vlefshme një e tërë, po aq të vlefshme janë edhe pjesët përbërëse të saj. Mendoni një komunitet ose komb, individët e të cilit janë me zemra, ndjenja dhe mendje të përparuara mjaftueshëm; ja, pra, një komunitet i tillë është një komunitet i zhvilluar dhe përparimtar. Pra, përsosmëria e së tërës është e lidhur dhe varet nga përsosmëria e pjesëve që e përbëjnë atë. Edhe namazi është një e tërë e tillë aq e përsosur, saqë çdo veprim që kryejmë, nga faza e pastrimit, e cila, në thelb, është një përgatitje për të, e deri në momentin kur ndahemi prej tij duke dhënë selam, ka një vlerë të paçmuar në vendin dhe fushën e vet. Për rrjedhojë, besimtari duhet t'i bëjë me vetëdije gjërat që bën për namazin, duhet t'i mbyllë sytë e veshët ndaj gjërave që nuk janë pjesë e namazit dhe nuk duhet të lejojë që ato t'ia turbullojnë mendjen dhe mendimet. Madje të arrijë deri aty sa ta ndiejë veten një hiç, të shndërrohet me çdo gjë të tijën në një pjesë të namazit. Në përkuljen, uljen dhe ngritjen e tij, në çdo *'Subhánalláh'* që thotë, të vërehet shfaqja e pasqyrimeve Emrave dhe Atributeve të Allahut. Zaten, kjo është ajo çfarë quajmë ndjenjë e dashurisë, frikës dhe respektit ndaj Allahut në namaz. Kjo gjendje e mban njeriun larg çdo hutese, moskuptimi dhe ndyrësie; kjo gjendje e besimtarit bën të mundur që namazi i tij të arrijë të jetë namaz në kuptimin e tij të vërtetë.

Po, çdo element përbërës i namazit ka urtësinë e tij specifike. Çdo lëvizje e bërë gjatë namazit, që nga tekberi që thuhet për të filluar namazin e deri te selami që jepet për të dalë prej tij, përbën një pjesë të namazit dhe secila prej tyre ka kuptimin e saj të veçantë. Andaj, të gjitha këto duhen kryer me kujdes dhe ndjeshmëri të madhe. Le të mendojmë një palestër gjimnastike; instruktori përgjegjës i saj, duke u dhënë njerëzve të pranishëm në atë palestër komanda të llojit "Kështu

do t'i mbani këmbët, duart dhe krahët do t'i lëvizni në këtë mënyrë etj.», bën të mundur që lëvizjet të kryhen në përputhje me teknikën e gjimnastikës. Sepse, veçanërisht në lëvizjet që mund të bëhen shkak për shfaqjen e ndonjë shqetësimi, respektimi i teknikës së kryerjes së tyre është një domosdoshmëri.

Ta krahasosh namazin me gjimnastikën dhe ta shohësh atë thjesht si diçka të përbërë nga një sërë lëvizjesh fizike është shumë e gabuar. Megjithatë, janë disa kushte dhe veprime që, gjatë faljes së namazit, duhen përmbushur me një ndjeshmëri të përsosur. Dijetarët tanë, elementët e domosdoshëm të namazit i kanë renditur nën dy ndarje: kushtet e namazit (farzet e jashtme) dhe shtyllat e tij (farzet e brendshme). Shtyllat e namazit janë themelet e adhurimit të namazit; secilën nga lëvizjet dhe veprimet që duhen bërë patjetër në namaz e quajmë shtyllë të namazit. Kurse kushtet e namazit, edhe pse nuk përbëhen nga lëvizje dhe veprime pjesë të namazit në vetvete, janë disa situata që shihen si kusht që namazi të jetë namaz.

1. Kushtet e namazit

a. Taharet nga hadethi – Pastrimi konvencional (Marrja e guslit dhe abdesit)

Me pak fjalë, pastrim konvencional do të thotë pastrim nga papastërtitë që nuk mund të shihen me sy (shpirtërore). Abdesi, gusli dhe tejemumi (kur marrja e dy të parave nuk është e mundur) janë lloje të pastrimit konvencional. Kuptimi i përgjithshëm i fjalës '*hadeth*' është 'papastërti konvencionale', ndërsa *taharet* nga *hadethi* do të thotë të pastrohesh nga kjo papastërti konvencionale. Edhe pse ky pastrim sjell përfitime të tilla si heqjen e papastërtive materiale nga trupi dhe ruajtjen e shëndetit trupor, në thelb, ai është një pastrim me karakter adhurimor. Pastrim konvencional do të thotë të marrësh abdes kur nuk ke abdes dhe të marrësh gusl kur nuk ke gusl. Personat që janë *xhunub* (që konsiderohen të papastër për shkak se kanë kryer marrëdhënie

seksuale), nuk mund të falin namaz pa marrë gusl. Për ata që e kanë të pamundur gjetjen e ujit ose që nuk mund ta përdorin atë në marrjen e guslit edhe pse gjetja e tij nuk përbën ndonjë problem, ky kusht mund të përmbushet nëpërmjet tejemumit.

b. Pastrimi material (Pastrimi nga ndyrësitë materiale)

Pastrimi material shkurtimisht nënkupton pastrimin nga papastërtitë që mund të shihen me sy. Personi që do të falë namaz, duhet të pastrojë nga ndyrësitë, pra, nga gjërat që konsiderohen të pista në fenë tonë (gjaku dhe urina e njeriut, urina dhe jashtëqitja e kafshëve si kali, delja etj.), trupin, veshjen e tij dhe vendin ku do të falet.

c. Mbulimi i pjesëve intime të trupit

Njeriu është një rob i nderuar i Zotit të Madhëruar. Allahu, i Cili e ka krijuar njeriun në formën më të përsosur, ka dërguar profetë dhe libra, në mënyrë që ai të bëjë një jetë sa më të ndershme dhe të respektueshme. Ai nuk mund të jetojë si kafshët. Atyre që duan të bëjnë një jetë të këtillë u del para ajeti i Kuranit, i cili thotë: ***“Ata janë si kafshët, madje edhe më zi. Pikërisht këta janë të shkujdesurit.”***¹⁹⁰

Një nga mënyrat e ruajtjes së dinjitetit dhe nderit të njeriut është mbulimi i tij. Ndërkohë që kafshët janë të mbuluara nga veshjet e tyre natyrale, të cilat ua ka mundësuar Zoti i Plotfuqishëm, për njeriun nuk është kështu. Askujt nuk i duket e çuditshme që kafshët të mos veshin rroba, ama lëvizja e njerëzve pa rroba mbi trup, në sytë e atyre me ndërgjegje të përpishur, është diçka jashtëzakonisht e neveritshme.

Allahu i Madhëruar e ka urdhëruar njeriun të mbulohet, që të mund të jetojë njerëzisht. Mbulimi i trupit është nga ato sjellje që e bëjnë njeriun të vlefshëm dhe dinjitoz jo vetëm tek Allahu, por, me në krye njerëzit e tjerë, edhe në sytë e të gjitha krijesave. Për këtë arsye,

¹⁹⁰ Surja Arâf, ajeti 179.

ashtu siç është farz për njeriun mbulimi i pjesëve intime në praninë e të tjerëve, është gjithashtu edhe një nga kushtet e adhurimeve si namazi dhe tavafi. Sepse, me thënie të tilla si *“Nuk pranohet namazi i femrës që ka arritur moshën e pjekurisë dhe e fal atë pa u mbuluar.”*¹⁹¹, Profeti ynë (s.a.s.) i ka urdhëruar burrat dhe gratë t’i mbulojnë gjatë faljes së namazit ato pjesë të trupit, të cilat konsiderohen intime sipas fesë Islame.

Përveç mbulimit të pjesëve intime, për çdo mysliman është sunet që, me kusht që të mos e teprojë në këtë pikë, gjatë kryerjes së adhurimit të ketë veshur rrobat e tij më të bukura dhe më të pastra. Nga shumë interpretues të Kuranit Famëlartë, me në krye Abdullah ibn Abasin (r.a.), na është bërë e ditur se ajeti ***“O bijtë e Ademit, vishuni përshtatshëm kudo dhe kurdo që të faleni!”***¹⁹² ka zbritur për arabët që i bënin tavaf Qabesë me pjesët e tyre intime të zbuluara dhe se nëpërmjet këtij ajeti u urdhërua fillimisht mbulimi i pjesëve intime të trupit gjatë kryerjes së adhurimeve si tavafi e namazi.¹⁹³

d. Orientimi kah kibla

Besimtari, pasi i ka kryer të gjitha përgatitjet e nevojshme për namaz, drejtohet kah kibla. Sepse ai, duke përjashtuar këtu situatat që e pengojnë atë ta bëjë këtë, është i ngarkuar me detyrën e kthimit nga Qabeja në faljen e çdo namazi. Zoti na e ka bërë të qartë këtë urdhër nëpërmjet ajetit ***“Nga cilido vend që të dalësh, ktheje fytyrën nga Xhamia e Shenjtë. Kudo që të ndodhesh, ktheni fytyrat tuaja nga ajo anë...”***¹⁹⁴ Sepse Qabeja është një ‘*Bejti Atik*’ (shtëpi e vjetër, historike), e ndërtuar vetëm për hir të Allahut; ndërsa mesxhidet dhe xhamitë e tjera kudo nëpër botë, janë ndërtesa që për nga Qabeja drejtohen dhe atë tregojnë. Allahu i Madhëruar, duke iu referuar ndërtimit të Bejtullahut (Shtëpisë së Allahut) nga ana e Ibrahimit dhe Ismailit (a.s.), asaj shtëpie që, deri në Ditën e Kiametit, do të jetë kibla e njerëzimit

¹⁹¹ Tirmidhí, salát 277; Ebú Dáúd, salát 85; ibn Máxhe, tejemmum 132.

¹⁹² Surja Aráf, ajeti 31.

¹⁹³ Muslim, tefsir 25; Nesái, menásik 161.

¹⁹⁴ Surja Bekare, ajeti 150.

mbi sipërfaqen e tokës dhe vendi i tavafit të engjëjve, i cili zgjatet deri në *Sidretul Muntehá*, thotë: **“Kujtoni kur ne e bëmë Qabenë vend grumbullimi dhe sigurie për njerëzit, duke thënë ‘Bëjeni vendin e Ibrahimit vend faljeje!’. Ne i urdhëruam Ibrahimin dhe Ismailin: ‘Pastrojeni Shtëpinë Time (Qabenë) për ata që e vizitojnë, që rrinë aty për adhurim dhe që falen duke u përkulur dhe përlurur.’”**¹⁹⁵ Prandaj Qabeja ka një vend dhe rëndësi të veçantë në sytë e myslimanëve. Një ditë, i Dërguari i Allahut (s.a.s.) vëren një copë gëlbbaze në njërin nga muret e mesxhidit, në atë me drejtim nga kibla. I vjen shumë rëndë nga ky veprim. Ngrihet, e pastron murin dhe, pastaj, urdhëron në këtë mënyrë: **“Kur ndonjëri prej jush ngrihet për të falur namaz, i drejtohet Zotit në një mënyrë të veçantë, sikur Zoti është mes atij dhe kiblës. Kurrë mos pështyni në drejtim të kiblës. (Nëse duhet të pështyni patjetër,) pështyni (të paktën) në të majtën tuaj, ose poshtë këmbëve tuaja!”**¹⁹⁶

Besimtari, me kthimin për nga Qabeja e një shenjtërie të këtillë, sikur e shikon veten para Allahut duke i nxjerrë jashtë të gjitha të këqijat brenda tij dhe duke qarë mbi to. Mandej, duke shkuar një hap më tej në mendime, e përfytyron veten sikur po shkon në botën tjetër dhe po qëndron atje në kijam, i gatshëm për të dhënë llogari për jetën që ka bërë në këtë botë. Namazi i kryer nën ndikimin e mendimeve dhe përfytyrimeve të tilla përbën namazin e robërve të pazakontë, të veçantë të Zotit. Kjo është gjendja në të cilën sytë dhe veshët mbyllen, zemra gati sa s’ndalet dhe, brenda lëvizshmërisë së heshtur të qenies, arrihet kthimi për tek Allahu. Pra, personi ikën e zhduket, pas mbetet vetëm Ai (*xhel’le xheláluhu*). Dhe, kur thotë **“Lá iláhe il’lalláh”** (Nuk ka zot tjetër përveç Allahut), e ndien atë në zemër me gjithë intensitetin e tij. Kjo është arsyeja pse shumë njerëz të lartë, pasi çonin duart te veshët, përpëliteshin për ta fituar këtë gradë të zemrës.

Shkurtimisht, kur besimtari lidhet në namaz, imagjimon sikur ka para syve Qabenë, boshtin e shndritshëm që ngrihet nga qendra e tokës dhe arrin deri në *Sidretul Muntehá*, atë bosht rreth të cilit bëjnë

¹⁹⁵ Surja Bekare, ajeti 125.

¹⁹⁶ Buhári, salát 34-36, 38-39, meuákít 8; Muslim, mesáxhid 52, 54.

tavaf engjëjt. Pastaj, duke e imagjinuar veten para Allahut bashkë me një xhemat të bekuar, thotë: “Unë po qëndoj brenda një xhemati të atillë që, kur ia ngul sytë Qabesë, shikoj se në këtë xhemat, bashkë me krijesat që zvarriten në tokë, ka njerëz si unë, por edhe profetë të atyre njerëzve. Brenda këtij xhemati ka gjithashtu edhe engjëj, të cilët vendosin fytyrat e tyre në tokë para Zotit. Unë kthehem kah kibla dhe kryej detyrën time duke qenë pjesë e këtij xhemati madhështor.” Dhe, kështu, me të tilla ndjenja, futet në namaz.

e. Koha

Një nga kushtet e namazit është edhe koha, pra, falja e secilit namaz në kohën e vet. Namazi është një farz (obligim) që duhet përmbushur në kohë të caktuara të ditës. Kështu, koha është kusht për namazet farz. Një namaz farz, ashtu siç nuk mund të falet pa ardhur koha e faljes së tij, nuk mund të falet as pasi koha e tij ka kaluar. Jo vetëm që nuk është e drejtë që një namaz, pa patur asnjë arsye të fortë, të mos falet në kohë dhe të shtyhet për t’u falur kaza në një kohë të papërcaktuar, por është edhe gjynah (mëkat) për atë që vepron në këtë mënyrë.

f. Nijeti

Besimtari, i cili e ka përfunduar pastrimin e tij të brendshëm dhe të jashtëm para lidhjes në namaz, del para Zotit bashkë me zemrën e tij, që do të thotë se ai e di shumë mirë vendin ku ndodhet dhe mënyrën se si duhet të sillet. Kjo bart njëkohësisht edhe një kuptim të nijetit (qëllim). Sepse nijeti është kast i zemrës, jo ajo që thotë gjuha. Zemra do t’i drejtohet Zotit dhe, përveç Tij, do të flakë tutje çdo gjë tjetër. Pasi të arrihet kjo nga brenda, nuk ka rëndësi nëse gjuha e thotë apo nuk e thotë atë. Kuptimi i nijetit nuk është të thuash vetëm me gjuhë “Bëra nijet të fal namazin sunet të kohës së drekës apo ikindisë...”. Nijeti ideal është të fshish nga zemra çdo gjë tjetër përpos Allahut akoma pa filluar faljen e namazit, të mendosh se atë punë që po bën je duke e bërë para

Allahut dhe të jesh i vetëdijshëm për këto. Njeriu le ta bëjë sa të dojë nijetin me gojë; nëse zemra e tij nuk e ka arritur këtë gradë, ai nuk konsiderohet i lidhur në namaz. Në këtë rast, ajo çfarë ai bën nuk është gjë tjetër veçse një veprim i përbërë thjesht nga ca ulje e ngritje. Kjo është arsyeja pse dijetarë si Imam Rabaniu e shikojnë si problematike kryerjen e nijetit vetëm me gojë.¹⁹⁷ Por, sipas mendimit tim, nëse disa besimtarë e bëjnë nijetin e tyre gojarisht, duhet të themi se veprojnë në atë mënyrë duke u bazuar në fjalët e disa prej dijetarëve. Sepse vetëm në këtë mënyrë mund t'i qasemi kësaj meseleje pa shkaktuar ndonjë konflikt mes besimtarëve.

Nijeti i gjithësecilit është në masën e marrëdhënies së tij Me Zotin e Madhëruar. Parë nga ky aspekt, është e mundur të flitet për lloje të ndryshme nijetesh te njerëzit. Shkalla e parë e nijetit, për ata që janë akoma në fillim të kësaj pune dhe po përjetojnë atë që quhet Islam dhe iman imitues, është që personi të çojë në mendje dhe zemër faljen e namazit. Ndërsa sipas evlijave, nijet do të thotë që njeriu ta kyçë veten në punën që do të bëjë, t'u përmbahet vetëm përfytyrimeve në lidhje me të dhe të përqendrohet tek ajo me të gjitha ndjenjat dhe mendimet e tij. Një shkallë më sipër është nijeti i njerëzve që mund të quhen më të veçantët në mesin e të veçantëve. Ky nijet ka kuptimin e pastrimit të zemrës nga çdo gjë tjetër përpos Allahut dhe ruajtjen e kësaj zemre të pastër edhe gjatë faljes së namazit. Sepse, nëse Ai është i dëshiruari, nuk mund të ketë dy të dëshiruar në një qëllim. Pra, në qoftë se robi ka për qëllim Atë, në qoftë se synon të ketë si të dëshiruar të vetin vetëm dhe vetëm Atë, atëherë duhet t'i shkulë nga zemra dhe mendja e t'i flakë tutje të gjithë të dëshiruarit e tjerë, qofshin ata realë apo relativë. Nëse njerëzve të kësaj grade u vjen në mendje ndonjë përfytyrim tjetër gjatë këtyre momenteve, kthehen prapa, marrin përsëri tekbir dhe e shtrëngojnë veten deri në çastin kur zemrat e tyre të boshatisen. Një përpjekje e tillë vërehet te Bediuzamani dhe nxënësit e tij të rreshtit të parë. Por nuk duhet harruar se kjo përpjekje nuk duhet të mbesë te forma. Nëse dikush i futet kësaj çështjeje thjesht si imitues dhe për t'u

¹⁹⁷ Imam Rabbání, el Mektúbát 1/160 (Letra 186).

dukur sikur po përpiqet, asgjë nuk do të përfitojë prej saj.

Në shkallët *fenáfil'láh* (të shkrihesh në ekzistencën e Allahut) dhe *bekábil'láh* (të gjesh përjetësinë në përjetësinë e Allahut), të cilat janë gradat më të larta të nijetit, bëhet fjalë edhe për një gjendje të harrimit edhe të vetvetes. Po, nijetet e njerëzve që e kanë kapërcyer Rrethin e Emrave dhe Atributeve dhe janë shkrirë përballë dritës hyjnore, mbase janë në një mënyrë të atillë që ata të mos shohin, të mos dëgjojnë dhe të mos ndiejnë as veten. Dhe, sipas atyre që ndajnë këtë horizont, nëse e ndien veten kur je duke falur namaz, do të thotë se je akoma i zënë me gjëra të tjera. Në varësi të gradës në të cilën ndodhen, këta persona i qasen kësaj situatë me frikën se mos po bëjnë shirk.

Me pak fjalë, gjerësia e pafund e nijetit është gradë-gradë, shkallë-shkallë. Gjithsecili, kur fillon të falë namazin, lidhjen e zemrës e vendos në përputhje me horizontin e tij në çështjen e njohjes së Allahut. Në atë masë që e njeh Allahun, sipas asaj do të qëndrojë edhe në namaz.

Nijeti është shpirti i asaj që veprohet

Në Përfundimin e Letrës së Njëzet e Dytë, tek po shpjegon fjalë për fjalë nën dritën e ajetit ***“Mos vallë dëshiron ndokush prej jush të hajë mishin e vëllait të vet të vdekur? Sigurisht që ju do ta urrenit këtë!”***¹⁹⁸ se ç’veprim i shëmtuar është përgojimi, Bediuzamani thotë se ‘hemzeja’ në krye të këtij ajeti, e cila është një pjesëz që i jep atij trajtën e pyetjes, i përshkon të gjitha fjalët e ajetit si të ishte ujë. Mbase edhe si një dritë, ose shpirt.¹⁹⁹ Kështu është edhe nijeti. Besimtari, nëpërmjet nijetit të tij, përhap/duhet të përhapë në çdo pjesë të namazit drejtimin e tij për nga Allahu i Madhëruar dhe besimin se Ai është i Dëshiruari i Vërtetë, i Dashuri i Vërtetë dhe i Adhuruari i Vërtetë. Ai duhet t’i qëndrojë besnik këtij nijeti në çdo gjë që këndon e reciton gjatë namazit. Është me vend që kësaj çështjeje, e cila mund të quhet edhe mundim apo sforcim, t’i kushtohet më shumë rëndësi sidomos në namazet nafle që kryhen

¹⁹⁸ Surja Huxhurát, ajeti 12.

¹⁹⁹ Bediuzamani, Letrat, fq. 413 (Letra e Njëzet e Dytë, Përfundim).

individualisht. Në namazet që falen me xhemat ama, të vepruarit në këtë mënyrë nuk është e drejtë. Sepse kjo do të thotë ta vështirësosh fenë. Ndërsa në namazet nafile që i falim vetëm, të gjendurit brenda një kërkimi dhe përpjekjeje për arritjen e një nijeti të tillë, i cili do të bëjë të mundur faljen e namazit duke mos e nxjerrë nga mendja as për një çast të vetëm mendimin e të qenit para Zotit, nuk përbën ndonjë problem.

Namazi është miraxhi i besimtarit. Aty ku shpjegon miraxhin, Allahu i Madhëruar thotë kështu: **“Ai, me të vërtetë, dëgjon çdo gjë dhe sheh çdo gjë.”**²⁰⁰ Ka dy interpretime në lidhje me përemrin e përdorur në këtë ajet. Sipas njërit prej tyre, përemri i referohet Zotit të Plotfuqishëm; Ai që dëgjon dhe sheh gjithçka është Allahu. Kurse sipas interpretimit tjetër, atributet e përmendura në këtë ajet shprehin gjendjen e Profetit tonë (s.a.s.). Tani, përderisa Shpirti i Zotërisë së gjithë krijesave (s.a.s.) është përshkruar përmes emrave ‘*semi*’ (dëgjues) dhe ‘*basír*’ (shikues), të cilët janë dy nga emrat e bukur të Allahut, do të thotë se këtu duan të na e tërheqin vëmendjen te një e vërtetë e rëndësishme. Do të thotë se Profeti ynë (s.a.s.) i ka parë, dëgjuar dhe ndier thellësisht gjërat që iu paraqitën gjatë Miraxhit. Me fjalë të tjera, e ka shtrydhur shumë mirë Miraxhin dhe është ngopur në maksimum me të. Nuk i ka ikur kot as një sekondë e Miraxhit, as një e dhjeta e sekondit e atij udhëtimi. Sikur kanë kaluar nëpër sitën e ndërgjegjes së Tij të gjitha ato gjëra që ka parë e dëgjuar nga fillimi deri në fund.

Imami i Allvarit thotë: *“Namazi e bën të mundur lundrimin e anijes së fesë, namazi është udhëheqësi i të gjithë adhurimeve.”* Kurse Sulejman Çelebiu, këtë kuptim e shpreh nëpërmjet fjalëve *“Miraxh të umetit e kam bërë namazin.”*²⁰¹ Përderisa namazi është miraxhi i besimtarit, ai është i detyruar t’i ketë nën kontroll veshët dhe sytë gjatë faljes së namazit. Ata sy dhe veshë duhet të shohin e të dëgjojnë vetëm atë që duhet parë e dëgjuar. Në *“Fjalën e Shtatëmbëdhjetë”*, Ustadi e shpjegon këtë nëpërmjet kësaj shprehjeje të Mevlana Xhamiut:²⁰²

²⁰⁰ Surja Isrá, ajeti 1.

²⁰¹ Sulejman Çelebi, Mevlid (vesiletun nexhat) fq. 118.

²⁰² Bediuzamani, Fjalët, fq. 313-314 (STACIONI I DYTË I FJALËS SË SHTATËMBËDHJETË).

“Dëshiro vetëm Njërin, thirr vetëm Njërin, kërko vetëm Njërin, shiko vetëm Njërin, njih vetëm Njërin, fol vetëm Njërin.”²⁰³

Kështu, një besimtar duhet të shohë vetëm Njërin, duhet të njohë vetëm Njërin, duhet të dëgjojë vetëm Njërin, duhet të kërkojë vetëm Njërin, duhet të thërrasë vetëm Njërin, duhet të ndiejë vetëm Njërin, duhet të qëndrojë i mbyllur ndaj çdo gjëje tjetër përveç Tij dhe duhet të përpiqet ta kapë këtë në të gjitha pjesët përbërëse të namazit. Dhe, kur ta arrijë këtë, duhet të thotë: “Kjo nuk mund të kapet kështu. Duhet ta kisha kapur duke harruar edhe vetveten, nuk duhet ta kisha ndier veten. A ekzistoj unë apo nuk ekzistoj, edhe këtë duhet ta kisha harruar.” Kështu duhet të thotë dhe në këtë masë duhet të kalojë në ekstazë.

Një përpjekje deri në vdekje

Le të theksojmë edhe një herë se të gjitha këto janë çështje gradash. Arritja e tyre pa u ushtruar dhe pa e sforcuar nefsin është e pamundur. Pra, nëse nuk ka mundim dhe sforcim në fillim, nuk mund të ketë propozim më pas. Nëse nuk e detyron nefsin që në krye të herës, nuk mund t’i propozoni atij një gjë të tillë më vonë. Në këtë aspekt, një person që ia ka vënë syrin këtyre gradave duhet ta sforcojë veten me një përpjekje gjer në vdekje. I nderuari Xhunejd Bagdadi diku thotë diçka që, pak a shumë, ka këtë kuptim: “Unë jam sforcuar dhe e kam detyruar veten për gjashtëdhjetë vjet. Vetëm pas kaq vitesh ma mundësoi Allahu që të filloja të falja namaz.” Kështu që, ata si puna jonë, që nuk e kanë shijuar ndonjëherë namazin e vërtetë, duhet të falin namaz duke u sforcuar dhe duke e shtrënguar veten të paktën për nja pesë ose dhjetë vjet.

Meqë ra fjala te namazi i vërtetë, të mos mendohet se, duke marrë për bazë çështjet e lartpërmendura, namazet që deri më tani i kemi falur me një mijë e një mangësi nuk janë pranuar apo nuk do të pranohen nga Allahu (*xhel’le xheláluhu*). Ne shpresojmë se Zoti ynë, mëshira dhe

²⁰³ Molla Xhâmi, Jusufi dhe Zulejhaja” Heft Evreng, 2/22 (Bejtja e 59).

mirësitë e të Cilit janë të pafund, do të na i pranojë edhe namazet e këtij niveli. Madje shpresojmë që, falë këtyre namazeve, të na vendosë në Xhenetin e Tij, shpresojmë që të na e bëjë namazin mik në jetën e varrit dhe të na e bëjë atë një Burak gjatë kalimit mbi Urën e Siratit. Ku i dihet, mbase Allahu do e shndërrojë namazin tonë në një vetëtimë që do të na e ndriçojë horizontin. Në këtë këndvështrim, namazin nuk duhet ta lëmë kurrë, nuk duhet t'i nënvlerësojmë namazet tona. Por, nga ana tjetër, qëllimet dhe përpjekjet duhen mbajtur gjithmonë lart. Adhurimi që do të kryejmë karshi Zotit tonë Bujar e të Madhërishëm duhet të jetë në përpjestim të drejtë me madhësinë e Tij. Adhurimi që do të bëjmë duhet të bartë kuptimin e falënderimit dhe mirënjohjes ndaj Allahut për mirësitë dhe begatitë e Tij të panumërta ndaj nesh. Rrjedhimisht, një besimtar duhet të përpiqet gjatë gjithë jetës së tij për të arritur namazin e vërtetë.

Një tjetër çështje e rëndësishme në lidhje me nijetin është edhe të ndierit e pranisë së tij të gjallë e vigjilente në të gjitha pjesët përbërëse të adhurimit. Besimtari, nijetin që ka bërë me një përqendrim të plotë që në fillim, pra, atë qëllim absolut, drejtim absolut dhe shikim absolut, duhet t'i ndiejë në ndërgjegjen e tij gjatë gjithë namazit dhe duhet të ngrejë krye ndaj gjërave të tjera që mbeten jashtë këtyre. Po, kur është duke falur namaz, besimtari duhet të shqetësohet nga çdo lloj mendimi dhe përfytyrimi që nuk ka të bëjë me Të dhe duhet ta shfaqë këtë shqetësim në trajtën e një reagimi në botën e tij të brendshme. Për shembull, kur një njeri thotë ***“Çdo lavdërim i përket Allahut, Zotit të botëve, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit.”***²⁰⁴, nëse nuk arrin t'i ndiejë në ndërgjegjen e tij valët e pasqyrimeve të ndryshme të mëshirës së Tij të pafund, të cilat vijnë deri tek ai dhe rrethojnë gjithçka, atëherë duhet që të paktën të jetë në gjendje ta qortojë veten përbrenda.

Asnjëra nga këto nuk është e pamundur për t'u realizuar. Sepse dihet që janë përjetuar nga mijëra e miliona njerëz. Po ashtu, me mijëra e miliona janë edhe ata që e shohin veten si kandidat për t'i përjetuar ato. ***“Nëse dikush i vihet nga pas diçkaje dhe tregon seriozitet në këtë pikë, ai***

²⁰⁴ Surja Fátiha, ajetet 2-3.

patjetër që do ta gjejë atë që kërkon.” Dhe, sipas kuptimit të kundërt të kësaj shprehjeje, nëse dikush nuk e ka gjetur dot atë që kërkon, do të thotë se nuk i është vënë nga pas asaj, nuk është treguar serioz në këtë kërkim.

2. Shtyllat e namazit

a. *Tekbiri iftitah (fillestar)*

Zemra e plotësuar, kapërcimi i dimensioneve në të cilët ndodhesh, hyrja brenda një bote komplet tjetër dhe të thënit “*Alláhu Ekber*” sikur të jesh duke ia prerë fytyrë nefsit, përbëjnë fillimin e faljes së namazit.

Po t'i shohim me kujdes, do të vërejmë se veçoritë e përbashkëta të fuqive që hyjnizohen, shenjtërohen dhe që njerëzit u përulen dhe të udhëheqësve, të cilët kanë turmat e tyre që u binden qorrazi, janë ndjenjat e madhësisë, arrogancës, epërsisë dhe kryelartësisë. Prandaj, besimtari, i cili e nis namazin duke thënë “*Alláhu Ekber*”, u vjen hakut të gjithë tiranëve, arrogantëve dhe mendjemëdhenjve, i gjunjëzon ata dhe deklaron se nuk njih fuqi tjetër përpos Allahut të Plotfuqishëm. Rrjedhimisht, hedh pas krahëve çdo gjë që mund ta largojë atë nga Allahu, ngul shikimin në shtigjet e botës hyjnore dhe vihet në pritje të gjërave që do të vijnë nga atje. Ai nuk mund të hyjë në namaz me ndonjë fjalë tjetër. I Dërguari i Allahut (s.a.s.), duke thënë “*Çelësi i namazit është pastërtia. Ajo gjë që shpreh fillimin e namazit dhe na e bën haram (marrjen me gjërat që nuk kanë lidhje me namazin) është tekbiri iftitah (fillestar). Ajo gjë që na e bën hallall (marrjen me gjërat që nuk kanë lidhje me namazin) dhe e përfundon namazin është selami në fund të tij.*”²⁰⁵, tërheq vëmendjet për te kjo çështje. Kurse në një hadith tjetër, thotë kështu: “*Për sa kohë nuk merrni abdes ashtu siç duhet, namazi i asnjërit prej jush nuk do të jetë i plotë.*”²⁰⁶ Për këtë arsye, hyrja me tekbir në namaz është farz.

²⁰⁵ Tirmidhí, taháret 3, salát 176; Ebú Dáúd, taháret 30, salát 74; ibn Máxhe, taháret 3, 30, salát 75.

²⁰⁶ Ibn Máxhe, taháret 57; Dárimí, salát 78.

b. Kijami (Qëndrimi në këmbë)

Dalja para Allahut gjithë respekt e përrulje, i kujton besimtarit faktin se ai është krijesa e parë mbi gjithë sipërfaqen e tokës që dëshmon për ekzistencën e Tij. Ndërkohë që disa nga qeniet zvarriten përtokë e disa të tjera lëvizin qafëpërkulur mbi katër këmbë, Allahu i Madhëruar i ka mundësuar njeriut ecjen mbi dy këmbë dhe qëndrimin me trupin drejt si një *'elif'*. Nëse do të ishte e mundur për kafshët që ecin këmbadoras e që zvarriten me fytyrën në tokë të ecnin mbi dy këmbë, përse do të vazhdonin të zvarriteshin? Ato, ngaqë nuk i kanë të mirat e begatitë që kanë njerëzit, ecin të përkulur e të përthyer, ose hiqen zvarrë, përballë ligjeve detyruese të krijimit të Zotit të Plotëfuqishëm. Nëse njeriu do të ngrihej të numëronte mirësitë që Allahu i Madhëruar i ka dhënë atij, – siç thuhet edhe në Kuran – kjo nuk do të ishte e mundur.²⁰⁷ Për këtë arsye, sado që ta falënderojë njeriu Zotin, prapë pak është. Askush nuk mund ta falënderojë Allahun aq sa duhet. Para së gjithash, ai është krijuar si një qenie në trajtën më të përkryer (*ahseni takuím*), me anën e tij të brendshme dhe atë të jashtme. Allahu Fuqiplotë nuk e ka krijuar atë si një krijesë të pajetë, nuk e ka lënë në mesin e krijesave të pandërgjegjshme. Përkundrazi, Zoti e krijoi njeriun si një krijesë të ndërgjegjshme me vullnet e mendje. Dhe, sa i përket besimtarit, Allahu nuk e përfshiu atë në turmat e të pafeve, por, duke e pastruar kohë pas kohe, e lartësoi në gradën e të qenit njerëzor dhe, më pas, në atë të të qenit besimtar. Në këtë gjendje të tijën, sikur Allahu i ka vënë në kanistrën që po mban mbi shpinë nga një mirësi tjetër në çdo hap të tij drejt përsosmërisë. Ja, pra, gjatë kohës që është në kijam, besimtarit do t'i vijë në mendje gjithë këto mirësi të grumbulluara në shportën e tij dhe, gati për të dhënë llogari para Zotit në Ditën e Gjykimit, do ta imagjinojë veten përballë urdhrit 'Jep llogari për frymët që ke marrë e ke dhënë gjatë gjithë jetës tënde!'

²⁰⁷ Shih ajetin 34 të sures Ibrahim dhe ajetin 18 të sures Nahl.

c. Kiraeti (Leximi i ajeteve të Kuranit)

Robi, pasi pranon madhësinë e Allahut dhe e shpall atë duke thënë “*Alláhu Ekber*”, duke pasur parasysh rëndësinë e namazit që do të falë dhe të ajeteve të Kuranit që do të këndojë dhe me dëshirën që shejtani të mos ketë pjesë në to, thotë: “*Eúdhü bil’láhi minesh’shejtánirr’rрахím*”, “*Strehohem tek Allahu nga e keqja e shejtanit të dëbuar prej mëshirës hyjnore.*” Nëpërmjet këtyre fjalëve, njeriu në radhë të parë shpreh dobësinë, pafuqinë e tij. Më pas, ai këndon ‘*besmele*’-në, e cila shpreh se çdo gjë që ndodh, çdo veprim i ndërrmarë, realizohet/duhet të realizohet me emrin e Allahut. Një njeri që e shpreh dobësinë e tij në këtë mënyrë në namaz, i drejtohet Allahut me zemrën e tij të thyer dhe thotë “*El hamdu lil’láhi Rabbil álemín*”, e cila bart këtë kuptim: “Zoti im! Organet që më ke dhënë mua i ke vënë në punë si të ishin makineri; qelizat, qeniet më të vogla të gjalla, i bëre të bashkohen për të formuar trupin tim. Tani, secili nga ato organe, secila nga ato gjymtyrë të miat është si një individ më vete; të adhurojnë Ty me lëvizjet e tyre të veçanta dhe me kuptimet që shprehin nëpërmjet tyre. Kurse unë, unë vetëm po përkthej në fjalë adhurimet e tyre, robërinë e tyre ndaj Teje. Unë po të paraqes Ty mirënjohjen time dhe aq falënderime sa gjymtyrët, organet dhe qelizat e mia, të cilat i vë në lëvizje gjatë faljes së namazit.”

Pastaj thotë “*Err’Rrahmánirr’Rrahím*”, që bart këto kuptime: “Duke parë dobësinë dhe varfërinë time, Ai e shtriu këtë univers para syve të mi si të ishte një libër i madh dhe më dha mua vullnet për ta lexuar atë, më dha mua vullnet për t’i shndërruar në besim në zemrën time rrezet e dritës që do të marr nga ai libër. Përsëri nëpërmjet tij, më mundësoi kapërcimin e sekreteve të universit, afrimin për te brigjet e emrave të Allahut, shqyrtimin e attributeve të Tij dhe të menduarit për Zanafillësin e Plotfuqishëm.”

Më pas, sikur të jetë duke shpjeguar se pse është Ai i denjë për kaq shumë lavdërime, falënderime e mirënjohje, thotë “*Málikí jeumiddín*” (Sunduesi i Ditës së Gjykimit) e, në këtë mënyrë, shpreh dhe konfirmon se Zoti i Madhëruar, përveçse ka krijuar gjithë këtë

univers, i ka furnizuar krijesat e Tij me çdo lloj të mire, të jashtme e të brendshme, të kësaj bote dhe të asaj të përtejme, dhe se Ai është gjithashtu Sunduesi i vetëm i asaj dite kur të gjithë do të merren në logari e do të shpërblehen ose ndëshkohen.

Kurse për të treguar se mund të kryejë adhurime vetëm ndaj një Individualiteti që i ka të gjitha këto cilësi dhe se forcën e fuqinë për t'i përdorur gjymtyrët e tij në këtë drejtim prapë Atij do t'ia kërkojë, thotë ***“Ijjáke na’budu ue ijjáke nesté’in”, “Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë.”*** dhe, në emër të njohjes së Allahut, arrin në një gradë nga ku mund t'i drejtohet Atij me ‘Ti’. Sepse përballimi dhe përmbushja e detyrës së të qenit rob i Zotit mund të arrihet vetëm nëpërmjet një kërkesë të tillë për ndihmë. Dhe, në këtë gradë, njeriut i bëhet sikur po zbulon dhënien e një mundësie dhe, pa humbur kohë, duke thënë ***“Thdinas’sirátal mustekím. Sirátal’ledhíne en’amte alejhim gajril magdúbi alejhim ue led’dál’lín”, “Udhëzona në rrugën e drejtë! Në rrugën e atyre që u ke dhuruar mirësi e jo në atë të atyre që kanë shkaktuar zemërimin Tënd, as në atë të atyre që janë të humbur!”***, kërkon udhëzimin në rrugën e drejtë të syve e veshëve, gjuhës e buzëve, duarve e këmbëve dhe të çdo pjese tjetër të tij. Sepse ai e di se ekzistojnë shumë mundësi devijimi në rrugë të gabuar për secilën nga këto gjymtyrë e organe.

Në një hadith të transmetuar nga Ebu Hurajra (r.a.), i Dërguari i Allahut (s.a.s.) thotë kështu: ***“Pa dyshim, Allahu i Lartësuar ia ka shkruar të birit të Ademit atë që i bie për pjesë nga zinaja.”***²⁰⁸ Po, zinaja e syrit është të shikosh ato gjëra që janë të ndaluara, zinaja e veshit është të dëgjosh gjëra të pamoralshme, zinaja e gojës është të flasësh fjalë që i përkasin imoralitetit, zinaja e këmbëve është ecja drejt imoralitetit. Siç mund të vihet re, të gjitha këto janë rrugë të shtrembra. Ja, pra, mëshira hyjnore në këtë pikë i buzëqesh në fytyrë njeriut që ka shumë nevojë për mëshirë e dhembshuri; Allahu bëhet për robin syri i tij që shikon, dora e tij që kap, veshi i tij që dëgjon, gjuha e tij që flet dhe nuk e lejon atë të hedhë hapa të gabuar, të bëjë punë të gabuara, të shikojë vendet e

²⁰⁸ Buhárí, isti’dhán 12, kader 9; Muslim, kader 20-21.

gabuaara dhe të thotë fjalë të gabuaara.

Nga ana tjetër, nëpërmjet këtyre ajeteve që këndon gjatë namazit, robi sikur flet me Allahun (*xhel'le xheláluhu*). Në një hadith të shenjtë (*kudsi*), i Dërguari i Allahut (s.a.s.) e shpreh në këtë mënyrë këtë të vërtetë: *‘Allahu (xhel'le xheláluhu) tha: ‘Unë e kam ndarë kiraetin mes vetes sime dhe robit tim; gjysma e tij më përket mua, gjysma tjetër i përket atij. Robit tim i është dhënë ajo që ka kërkuar. Kur robi thotë ‘El hamdu lil’láhi Rabbil álemín’, ‘Falënderimet dhe lavdërimet i takojnë Allahut, Zotit të botëve.’, Allahu i Lartë e Madhështor thotë ‘Robi im më falënderoi.’. Kur robi thotë ‘Err’Rrahmánirr’Rrahím’, ‘Ai është i Gjithëmëshirshmi, Mëshirëploti.’, Allahu thotë ‘Robi im më lavdëroi.’. Kur robi thotë ‘Máliki jeumid’dín’, ‘Ai është Sunduesi i Ditës së Gjykimit.’, Allahu thotë ‘Robi im më lartësoi.’. Kur robi thotë ‘Ijjáke na’budu ue ijjáke neste’ín’, ‘Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë.’, Allahu thotë ‘Kjo është (një marrëveshje) mes meje dhe robit tim. Robit tim ia kam dhënë atë që kërkon. Kur robi thotë ‘Thdinas’sirátal mustekím. Sirátal’ledhíne enámte alejhim gajril magdúbi alejhim ue led’dál’lín.’, ‘Udhëzona në rrugën e drejtë! Në rrugën e atyre që u ke dhuruar mirësi e jo në atë të atyre që kanë shkaktuar zemërimin Tënd, as në atë të atyre që janë të humbur!’*, Allahu (*xhel'le xheláluhu*) thotë *‘Edhe kjo i përket robit tim; robit tim i është dhënë ajo që ka kërkuar.’*²⁰⁹

Po, surja *Fatiha* është shprehje e emocioneve të ndërgjegjes së njeriut. Me këndimin e *Fatihásë* në namaz, robi, ndërkohë që nga njëra anë, duke qenë ballë për ballë me hartën e një xhemati të gjendur në rrugën e duhur, bëhet përkthyes i ndërgjegjeve, nga ana tjetër, sikur ndien mbi shpinë dorën e fuqisë së Zotit të Plotfuqishëm. Kurse me këndimin e ajeteve të tjera të Kuranit, endet nëpër kuvende të ndryshme dhe përballet me lloj-lloj skenash. Ndonjëherë kalon në ekstazë, ndonjëherë qan e rënkon dhe ndonjëherë tjetër, duke u ndier i shqetësuar përbrenda dhe, për rrjedhojë, duke mos gjetur dot forcën për të vazhduar më tej me këndimin e Kuranit, ulet menjëherë në ruku.

²⁰⁹ Muslim, salát 38; Tirmidhí, tefsir 2; Nesái, salátul musáfírin 204.

Në të shumtën e rasteve, këndimi i Kuranit gjatë namazeve të Profetit tonë (s.a.s.) zgjaste shumë. Abdullah ibn Mesudi (r.a.) e shpjegon në këtë mënyrë një kujtim të tijin në lidhje me këtë çështje: “Një natë fala namaz bashkë me të Dërguarin e Allahut (s.a.s.). Aq shumë e zgjati namazin, saqë, për një moment, mendova të bëja diçka të keqe.” Kur e pyesin se ç’kishte qenë ajo gjë e keqe që kishte menduar të bënte, ai përgjigjet në këtë mënyrë: “Mendova të lija në mes namazin e të ulesha.”²¹⁰

Kurse një hadith tjetër, të cilin Muslimi na e ka transmetuar nga Hudhejfe (r.a.), është kështu: “Një natë fala namaz bashkë me Profetin tonë (s.a.s.). Kur filloi të këndonte suren *Bekare*, ‘Pasi t’i plotësojë njëqind ajete, do të shkojë në ruku.’ thashë unë me vete. ‘Ndoshta do ta këndojë të gjithë suren në një rekat.’ thashë pasi i kaloi njëqind ajetet e para. Por Ai (s.a.s.) vazhdoi akoma. ‘Me këtë sure do të kalojë në ruku.’ thashë unë; Ai filloi suren *Al Imran*. E këndoi edhe atë. Pastaj filloi suren *Nisa*, e këndoi edhe atë. I këndonte ngadalë ato dhe, kur vinte ndonjë ajet që përfshinte tesbihe, i bënte edhe tesbihet; kur vinte ndonjë ajet lutjeje, i lutej Allahut; kur vinte ndonjë ajet në lidhje me strehimin tek Allahu, strehohej tek Ai. Pastaj vajti në ruku dhe aty filloi të thoshte: ‘*Subhâne Rabbijel adhím*, ‘*I lartësuar qoftë Zoti im i Madhërishëm*.’ Edhe rukuja zgjati po aq sa kijami. Pastaj, duke thënë ‘*Semialláhu limen hamideh*, *Rabbená lekel hamd*, ‘*Allahu e dëgjon atë që është falënderues ndaj Tij. O Zoti ynë! Ty të takon falënderimi!*’, u ngrit nga rukuja dhe qëndroi në këmbë për një kohë pothuajse aq të gjatë sa ajo e rukusë. Mandej u ul në sexhde dhe tha: ‘*Subhâne Rabbijel a’lá*, ‘*I madhëruar qoftë Zoti im i Lartë*.’ Edhe qëndrimi në sexhde zgjati për një kohë të përafërt me atë të qëndrimit në kijam.”²¹¹

Po, i Dërguari i Allahut (s.a.s.) i lutej Allahut në çdo pamje që kapte gjatë namazit. Ne mbase nuk mund ta bëjmë një gjë të tillë në namazet farz që kryejmë me xhemat, por mund të shfrytësojmë çdo rast për të dalë para Zotit, për t’ia hapur Atij zemrën dhe për t’ia shprehur ndjenjat që kemi përbrenda gjatë namazeve tona nafile. Unë besoj se

²¹⁰ Buháirí, *tehexhjud* 9; Muslim, *salátul musáfírín* 204.

²¹¹ Muslim, *salátul musáfírín* 203; Nesáí, *tatbík* 74; Ahmed ibn Hanbel, *el Musned* 5/384.

kjo hapje e zemrës ndaj Zotit tonë dhe të kërkuarit derman për mëkatet dhe plagët tona do të na freskojnë së brendshmi dhe do të na bëjnë të ndihemi të qetë e të lehtësuar. Në fakt, ata njerëz fatkeq, që nuk arrijnë të futen brenda namazit dhe vetëm sa sorollaten në hyrjen e tij, edhe pse mendojnë se falin çdo ditë namaz, nuk e dinë se çdo të thotë të kalosh në ekstazë para Zotit dhe t'i drejtohesh Atij me gjithë zemër. Sepse ata e mendojnë namazin si diçka të përbërë thjesht nga disa formula të thata, si një barrë që duhet mbajtur mbi shpinë. Kurse besimtari i vërtetë shkon në namaz me kënaqësi dhe gëzim sikur të jetë duke shkuar në një drekë apo darkë, më tej akoma, sikur të jetë duke shkuar në Xhenet... Shkon drejt namazit në këtë mënyrë dhe përpiqet që, nëpërmjet rrugëve që do t'i hapen në namaz, të sigurojë një bashkëbisedim, një marrëdhënie me Zotin e tij. Allahu i Madhëruar na e mundësoftë të ndierit e gjithë këtyre kuptimeve. Sepse, nëse Ai nuk do të na e mundësojë një gjë të këtillë, shpëtimi nga hutesa do të jetë i pamundur, nuk do të jemi në gjendje të largojmë nga vetja dembelizmin dhe plogështinë. Madje, edhe gjatë faljes së namazit, nuk do ta dimë se sa rekate kemi falur, nuk do të jemi të vetëdijshëm për ato që themi.

d. Rukuja

Me ajetet ***“A nuk i kemi dhënë Ne atij dy sy, edhe gjuhë, edhe dy buzë, dhe ia kemi bërë të qarta të dyja rrugët? Atëherë le të ndjekë rrugën e vështirë!”***²¹², të cilët bartin kuptimet “Edhe pse të bekuam me të gjitha llojet e mirësive, edhe pse të udhëzuam në rrugën e madhe e të drejtë të hapur nga profetët, ti nuk arrite ta kapërceje hutesën, nuk e dhe atë që duhej të jepje. Për rrjedhojë, nuk ia dole të futeshe në rrugën e Zotit. Tani jep llogari për të gjitha këto!”, besimtarin, që del para Zotit të Madhëruar për të dhënë llogari për mirësitë që po mban mbi shpinë, sikur nuk e mbajnë më këmbët. Dhe, duke mos qenë më në gjendje të qëndrojnë në këmbë, përkulet e shkon në ruku. “Po, më ke dhënë

²¹² Surja Beled, ajetet 8-11.

shumëçka, Zoti im! Sepse zotërinjtë, të mëdhenjtë japin gjithmonë; kurse të vegjëlit dhe robërit shpërdorjnë. Unë i pranoj vogëlsinë dhe të metat e mia përballë madhësisë Tënde, i bindem urdhrin Tënd **‘Andaj, lavdëroje emrin e Zotit tënd të Madhërishëm!’**²¹³ dhe, duke thënë ‘*Subhâne Rabbijel adhím*’, ‘Zoti im i Madh është larg çdo të mete.’, trokas në derën Tënde me tesbihatin e engjëjve.” thotë dhe, kështu, pranon dhe shpall përsosmërinë e Zotit përballë papërsosurisë së vet.

I Dërguari i Allahut (s.a.s.), kur shkante në ruku, lutej kështu: *“Allahu im! Ty po të bëj ruku, Ty të besova dhe te Ti u dorëzova. Ti je Zoti im. Veshët e mi, sytë e mi, truri im, kockat e mia, palca e kockave të mia, nervat e mi dhe gjithçka mbajnë këmbët e mia janë përkulur para Allahut, Zotit të botëve, dhe i janë bindur Atij.”*²¹⁴

Qëndrimi në ruku është gjithashtu edhe adhurimi i krijesave që ecin të përkulura. Në ruku, besimtari sjell në mendje edhe këtë fakt dhe, me duatë që bën aty, sikur dëshiron të thotë: “Falënderimet dhe lavdërimet të takojnë vetëm Ty, o Zoti im! Mua më krijove jo si krijesat që ecin të përkulura, po trupdrejtë si shkronja ‘elif’”. Tani jam përkulur për të shprehur dhe dëshmuar madhësinë Tënde, por do të jem në gjendje të drejtohem sërish.”

e. Sexhdeja

Besimtari, pasi i ndien me zemër të gjitha këto kuptime në ruku, me një fllad shprese që i vjen nga Zoti i tij, ngre kokën dhe hedh sërish shikimin drejt mëshirës së Tij. Në librat e haditheve të sakta (*sahih*), transmetohet një hadith i tillë i Pejgamberit tonë (s.a.s.):

“Në mejdanin e Mahsherit (vendi ku do të tubohen njerëzit pas ringjalljes), një rob po jep llogari për jetën e tij; në përfundim të llogaridhënies, ngaqë mëkatet i peshojnë më shumë, lëshohet fermami ‘Çojeni atë në Xhehenem!’”. Engjëjt e kapin atë dhe nisen për ta dërguar

²¹³ Surja Uákí’a, ajetet 74 dhe 96; surja Hák’ka, ajeti 52.

²¹⁴ Nesáí, iftitah 104; Ahmed ibn Hanbel, el Musned 2/268.

drejt Xhehenemit. Në një çast, robi kthen kokën dhe shikon mbrapa. Zoti, i Cili nuk është i kufizuar nga koha dhe hapësira, edhe pse e di arsyen e atij shikimi të robit të Tij, u thotë engjëjve: ‘Pyeteni njëherë robin Tim, përse e ktheu kokën dhe pa në atë mënyrë?’ Robi jep këtë përgjigje: ‘O Zot! Unë kurrë nuk të kisha menduar Ty kështu. Unë mendoja se, edhe sikur të vija para Teje me mëkate që do të peshonin sa malet, Ti do t’më falje dhe do t’më dërgoje në Xhenetin Tënd. Mendimi im për Ty në këtë drejtim ishte. Kurse tani, Ti po më dërgon në Xhehenem...’ Pas këtyre fjalëve të robit, Allahu (xhel’le xheláluhu) urdhëron: ‘Unë e trajtoj robin Tim ashtu siç mendon ai për Mua. Nuk do ta nxjerr robin Tim gënjeshtar në këtë shpresë të tij. Dërgojeni atë në Xhenet!’²¹⁵

Ja pra, teksa ngrihet nga rukuja dhe drejtohet sërish, robi sikur ndien një qetësim të zemrës dhe thotë “Semiallâhu limen hamideh”, “Allahu i dëgjon ata që e falënderojnë Atë”. Dhe kur drejtohet plotësisht si një ‘elif’, thotë “Rabbenâ lekel hamd”, që bart kuptimin “O Zoti im! Lavdërimi dhe falënderimi të takojnë Ty. Më krijove mua si njeri. Me mëshirën Tënde më shpëtove nga tmerrri i llogaridhënies dhe më bekovë edhe me shumë mirësi e begati të tjera.”

Ndonjëherë, duke e parë këtë si të pamjaftueshme, besimtari mund të lutet si Profeti ynë (s.a.s.) dhe të thotë “Allahu im, strehohem në pëlqimin Tënd nga zemërimi Yt, në mirëqenien Tënde nga mundimi Yt, nga Ti te Ti (nga ashpërsia Jote në mirësinë Tënde). E pranoj se nuk jam në gjendje për të të lavdëruar Ty. Prapë vetëm Ti je Ai që mund ta lavdërojë Veten ashtu siç e meriton.”²¹⁶ ose “O Allahu im, o Zoti ynë, për Ty qofshin aq falënderime e lavdërime sa qiejt me çdo gjë ka në to, sa toka me çdo gjë ka në të, sa çdo gjë që ndodhet mes qiejve e tokës dhe sa çdo gjë tjetër që dëshiron Ti!”²¹⁷

Duke menduar se mëshira e Zotit është bashkë me të, shqetësimet në lidhje me vështirësinë e llogaridhënies i lehtësohen disi dhe flade shprese fillojnë të fryjnë në botën e tij shpirtërore. Dhe më pas, si

²¹⁵ el Bejhakí, Shuabul ímán 2/9.

²¹⁶ Muslim, salát 222; Tirmidhí, de’auát 76, 113; Ebú Dáúd, salát 152, 338.

²¹⁷ Muslim, salátul musáfirín 201; Tirmidhí, de’auát 32; Ebú Dáúd, salát 118.

shprehje falënderimi ndaj Zotit të Madhëruar, ulet në sexhde dhe vendos fytyrën në tokë. Dhe aty, duke thënë tri herë “*Subhâne Rabbijel a’lá*”, “*Allahu im i Lartë është larg çdo të mete.*”, lartëson Zotin dhe tregon respektin që ndien ndaj Tij.

I Dërguari i Allahut (s.a.s.) bënte sexhde duke iu bindur urdhrit të Kuranit Famëlartë “***Bëji sexhde Allahut...***”²¹⁸; herë kalonte në ekstazë duke thënë “*Allahu im! M’i fal të gjitha mëkatet, të mëdhaja e të vogla, të vjetra e të reja, të fshehta e të hapura!*”²¹⁹, herë shprehte madhështinë dhe qerasjet e Zotit të tij duke u lutur me fjalët “*Allahu im! Ty të bëra sexhde, Ty të besova, te Ti u dorëzova. Edhe fytyra ime i bën sexhde Krijuesit të saj, që e ka krijuar dhe i ka dhënë formë, që i ka vënë veshë e sy. Sa i lartë është Allahu, Ai që e ka krijuar çdo gjë në trajtën e saj më të bukur!*”²²⁰.

Shkurtimisht, – ashtu siç u lartësua Profeti Muhamed (s.a.s.) falë adhurimeve dhe robërisë ndaj Zotit të vet dhe u takua me Të në Miraxh, në sajë të kësaj sexhdeje edhe besimtari do të zërë vendin e tij pas Profetit tonë (s.a.s.), për t’u takuar dhe folur me Zotin. Ai duhet ta kryejë namazin me nijetin për ta kërkuar dhe arritur këtë gradë të lartë. Besimtari, që, për të fituar atë që Zoti i ka premtuar, përmbush urdhrin dhe propozimin që po Zoti i tij i ka bërë, do të ndiejë një kënaqësi të ëmbël dhe të pakufi në të gjitha pjesët përbërëse të namazit. Sepse pas këtij premtimi fshihet fitimi i kënaqësisë së Allahut dhe soditja e bukurisë hyjnore. Për më tepër, udhëheqësi ynë në kryerjen e kësaj detyre të madhe është Muhamedi (s.a.s.). Allahu i Madhëruar na bëftë të përkushtuar ndaj namazit dhe na i mbushtë shpirtrat me gëzimin e tij! Nëpërmjet namazeve që do të falim, na e mundësoftë gjithashtu edhe përjetimin e miraxhit!

Dijetarët kërkuar të së vërtetës e pranojnë sexhden, njëherë nga shtyllat e namazit, si majën e fundit ku mund të arrijë njeriu dhe thonë se shtyllat e tjera të namazit janë si shkallë që të çojnë për te sexhdeja. Po, në rrugëtimin drejt daljes para Allahut, që fillon me marrjen e

²¹⁸ Surja Insán, ajeti 26.

²¹⁹ Muslim, salátul musáfirín 201; Ebú Dáúd, salát 118; Tirmidhí de’auát 32.

²²⁰ Muslim, salát 216; Ebú Dáúd, salát 147.

abdesit, njeriu kalon nëpër faza të ndryshme dhe arrin në vendin që i Dërguari i Allahut e cilëson si vendi në të cilin njeriu ndodhet më afër Zotit të tij²²¹, pra, në gjendjen e sexhdes. Për njeriun që po bën sexhde, të rëndësishme janë lidhja e tij shpirtërore me Zotin dhe gjërat që ndien aty. Për shembull, një besimtar që është duke falur namaz, gjatë qëndrimit në kijam mund të mendojë kështu: “Zoti im, po të mos na e kishe treguar Ti, unë nuk do dija si të të adhuroja; pa fund lavdërime e falënderime qofshin vetëm për Ty!” Në ruku, mund të thotë “Nuk mund ta di nëse kjo gjendje e imja është apo jo e mjaftueshme për të shprehur adhurimet dhe robërinë time ndaj Teje, por, duke marrë si shembull Pejgamberin tonë, po përpiqem të bëj aq sa mundem. Zoti im, pranoji adhurimet e mia!”, ndërsa në sexhde, “Zoti im! Po të ishte e mundur, kokën do e vendosja shumë më poshtë këmbëve të mia.” Pra, me mendime të tilla duhet t’i kryejë besimtari pjesët e namazit, duke e ndier secilën prej tyre në maksimum.

Po, namazi është një udhëtim drejt së pëртеjmes, i cili bëhet nën hijen e Miraxhit; ndërsa sexhdeja është shtylla më e rëndësishme e atij udhëtimit. Për rrjedhojë, në sexhde njeriu duhet të përpiqet të ndiejë afrimin final dhe ta kapë atë në zemër.

Sexhdeja është një mundësi, një *‘shebi arús’* (nata e dasmës), – nëse do të përdornim shprehjen e Mevlanës – që i jepet njeriut për ta vlerësuar më së miri. Është një terren ku të gjithë, në varësi të horizontit të tyre të njohjes dhe gradës në të cilën kanë arritur, mund të bekojnë me të mira e begati.

Sexhdeja është vendi ku njeriu fshin çdo gjë tjetër përveç Allahut dhe thotë *“il’lalláh”*, është vendi ku ai do të gëlltisë gllënjkat e afrimit me Zotin.

Po, sexhdeja është emri i bindjes së përsosur në përshtatshmëri me madhësinë e Allahut të Madhëruar. Në këtë pikë, duhet të mendojmë se çfarë, si, në çmënyrë dhe pse duhet bërë. Për rrjedhojë, duhet vepruar duke i marrë parasysh të gjitha këto.

²²¹ Muslim, salát 215; Ebú Dáúd, salát 148; Nesái, meuákit 35, tatbík 78.

f. Teshehudi/Ulja pas çdo dy rekateve

Ulja në teshehud është shprehja e përpjekjes së robit për të përparuar në namaz dhe e shterjes si rezultat i stërmundimeve të tij në këtë drejtim. Robi, të gjithë energjinë e trupit, ndjeshmërinë e mendjes, emocionin e shpirtit dhe të gjitha ndjenjat e tij vigjilente do t'i përdorë për të përparuar drejt Zotit të tij dhe, pastaj, do të ulet në teshehud. Sepse në teshehud thuret epopeja e Miraxhit, epopeja e atij udhëtimi të bekuar të Profetit tonë Famëlartë (s.a.s.). Atëherë kur njerëzit i kthyen Atij (s.a.s.) shpinën, Allahu (*xhel'le xheláluhu*) hapi për Të dyert e qiellit dhe e ftoi duke iu drejtuar me fjalët "Urdhëro, o rob im!". Kurse banorët e qiejve e pritën Atë duke i buzëqeshur. Çdo besimtar, pasi fal namazin sipas gradës që ka dhe thellësisë së zemrës, me zigzaget e uljen ngritjeve të tij, daç ta mendojë veten të paaftë për t'u ngritur në këmbë nën peshën e llogaridhënies dhe të ulet, daç të ulet në atmosferën e arritjes së mirësive, i gëzuar, krenar dhe i çliruar nga gjithçka, thua se po rehatohet në kolltukët e Xhenetit, daç të ulet ashtu siç shpjegohet në suren *Nexhm*, sikur të jetë duke dalë para Zotit, sikur të ketë arritur në një vend diku mes ekzistencës së mundshme dhe asaj të domosdoshme, sikur të ketë fituar postin e lartë të bashkëbisedimit me Zotin e tij. Këtu, pasi ta ketë kryer namazin me të gjitha vështirësitë dhe peshën e tij materiale, në varësi të thellësisë së zemrës dhe kthjelltësisë së ndjenjave të tij, do të lexojë epopenë e miraxhit.

Po, teshehudi shpjegon miraxhin. Dalja vetëm para Allahut është shumë e vështirë për ne; pa kaluar nga Muhamedi (s.a.s.), që erdhi e shkoi para nesh, la gjurmë dhe hapi një rrugë të gjerë për të gjithë ne, pa e përshëndetur Atë dhe pa e siguruar ndërmjetësimin e Tij, arritja para Allahut të Madhëruar është e pamundur. Kjo është arsyeja pse ne e përshëndesim Profetin tonë Bujar (s.a.s.) menjëherë pasi kemi kënduar ndaj Zotit tonë "*ettehijjátu...*", pra, pasi kemi shprehur se vetëm për Të i bëjmë të gjitha adhurimet tona trupore dhe materiale. Dhe themi "*esselámu alejke ejuhen'nebijju*". Kuptimi i kësaj në përfytyrimet tona është rreshtimi ynë pas Muhamedit Famëlartë (s.a.s.) kur po shkojmë për të dalë para Allahut të Madhëruar dhe përpjekja për të mbajtur

vesh ndaj gjërave që fliten në këtë bashkëbisedim të ëmbël, përpjekja për t'i kuptuar ato.

Aty, Profeti ynë (s.a.s.) fillimisht thotë “Përshëndetjet, fjalët e mira dhe duatë janë për Allahun!”, pra, “Të gjitha adhurimet që bëjmë me të gjitha grimcat e trupit tonë dhe gjërat që kemi harxhuar nga pasuria që kemi fituar dhe mbledhur janë për Ty, për fitimin e pëlqimit Tënd, o Allahu im! Unë po vij para Teje për të shprehur besën dhe besnikërinë time dhe për të të përshëndetur me këto fjalë.” dhe, pastaj, i jep selam Allahut (*xhel'le xheláluhu*). Zoti i Madhëruar, duke iu përgjigjet të Dashurit të Tij me fjalët “O, i Dërguar! Paqja, mëshira dhe begatitë e Allahut qofshin mbi ty!”, sikur po i thotë “O, i Dërguari i lavdishëm! Përkundrejt selamit tënd, selam edhe për ty!”

Ndërkohë që ky bashkëbisedim po zhvillohet në një pozitë të paimagjinueshme për ne (mendja jonë e ka të pamundur të kuptojë nëse ekziston apo nuk ekziston vendi aty), engjëjt thonë “Paqja qoftë mbi ne dhe mbi robërit e virtytshëm të Allahut!” Në fund, me fjalët “Dëshmoj se nuk ka zot tjetër përveç Allahut dhe se Muhamedi është rob dhe i dërguar i Tij.” dhe duke i bërë edhe qiejt e tokën të kumbojnë nëpërmjet tyre, Xhibrili (a.s.) i shton kësaj sinfonie një atmosferë dhe harmoni të ëmbël, ua bën të ditur të gjithë banorëve të tokës dhe qiejve se Allahu është i Adhuruari Absolut dhe i Dëshiruari i Denjë dhe se Muhamedi (s.a.s.) është i Dërguari i Tij i lavdishëm.

Pra, teshehudi konsiston në konceptimin dhe përfytyrimin e kësaj ngjarjeje të përjetuar në Miraxh dhe në shndërrimin e saj në një epike të lartësimit të robit drejt Allahut falë adhurimeve dhe robërisë së tij ndaj Tij. I Dërguari i Allahut (s.a.s.) e përfundonte namazin e tij pasi bënte këtë dua: “Allahu im, falmi të gjitha mëkatet që kam kryer, mëkatet e kohës së shkuar dhe ato të së ardhmes, ato që i kam kryer haptas dhe ato që i kam kryer fshehtas, mëkatet që kam kryer duke e kaluar cakun dhe, përtej këtyre, ato mëkate të miat që Ti i di shumë më mirë se unë! Ti je Ai që të çon përpara, Ti je Ai që të lë pas. Nuk ka zot tjetër përveç Teje!”²²²

²²² Muslim, salátul musáfirín 201, dhikr 70; Tirmidhí, de'auát 32; Ebú Dáúd, salát 121, fedáil 358.

Allahu (*xhel'le xheláluhu*) na bëftë prej atyre që arrijnë ta përfytyrojnë këtë moment gjatë teshehudeve të namazeve të tyre!

3. Elementë plotësues të namazit

a. *Ta'díli erkán*

Ta'díli erkán do të thotë të kryesh ashtu siç duhet shtyllat dhe pjesët e tjera përbërëse të namazit; të zgjasësh çdo shtyllë dhe pjesë të namazit të paktën derisa gjymtyrët dhe organet e trupit të relaksohen e të gjejnë qetësi. Kjo është gjendja që duhet të arrijë trupi i njeriut në aspektin fizik gjatë faljes së namazit. Namazi nuk do të jetë i plotë nëse nuk respektohet kjo gjë.

Tregon Ebu Hurajra (r.a.): “Kur i Dërguari i Allahut (s.a.s.) po rrinte ulur në mesxhid, aty erdhi një burrë, i cili, pasi fali namazin në një qoshe, erdhi pranë Pejgamberit tonë dhe e përshëndeti. Edhe Profeti ynë (s.a.s.) e mori përshëndetjen e tij. Tamam atëherë kur burri po bëhej gati për t'u ulur, i Dërguari i Allahut (s.a.s.) tha: *'Shko e përsërite edhe një herë namazin, nuk e fale ashtu siç duhet.'* Burri iku, fali sërish namazin, erdhi, dha selam, selami i tij u mor, por u përball përsëri me të njëjtat fjalë: *'Shko e përsërite edhe një herë namazin, nuk e fale ashtu siç duhet.'* Në herën e dytë ose në atë të tretën, burri tha: 'O, i Dërguari i Allahut! Kaq është ajo që di unë, sikur të ma tregonit se ku po gaboj!' Atëherë, Profeti ynë (s.a.s.) urdhëroi kështu: *'Kur të ngrihesh për të falur namazin, filloje atë duke marrë tekbir. Pastaj këndo pak Kuran. Pastaj shko në ruku dhe qëndro aty derisa gjymtyrët e tua të zënë vend e të gjejnë qetësi (sipas një transmetimi tjetër, 'derisa nyjet e tua të lirohen e të tendosen'). Pastaj ngrihu nga rukuja dhe mos shko në sexhde pa e drejtuar plotësisht trupin. Pastaj shko në sexhde dhe qëndro aty derisa gjymtyrët e tua të zënë vend. Pastaj ngrije kokën nga sexhdeja dhe qëndro ulur derisa trupi yt të gjejë qetësi në atë pozicion. Pastaj shko prapë në sexhde dhe mos u ço derisa gjymtyrët e tua të gjejnë qetësi... dhe kështu fali të gjitha namazet.'*”²²³

²²³ Buhári, edhán 95, 122, istidhán 18, ejmán 15; Muslim, salát 45.

Bazuar në këtë hadith dhe në dëshmi të ngjashme me të, shumë dijetarë të jurisprudencës islame, në mesin e të cilëve bën pjesë edhe Imam Ebu Jusufi i medhhebit Hanefi, e kanë pranuar si farz faljen e namazit me *ta'dili erkán*. Ndërsa sipas pikëpamjes në të cilën bazohet fetvaja e medhhebit Hanefi në lidhje me këtë temë, falja e namazit me *ta'dili erkán* është vaxhib. Rrjedhimisht, rregullat e faljes së namazit me *ta'dili erkán* duhen respektuar patjetër. Sipas meje, marrja për bazë e mendimit të atyre që e konsiderojnë farz këtë është më e përshtatshme për ata që dëshirojnë të tregohen të matur e të kujdesshëm në adhurimet e tyre. Përderisa imamët muxhtehidë, të cilët e kanë thënë këtë gjë, kanë qenë plotësisht të përkushtuar ndaj Kuranit, përderisa kanë qenë njerëz të mëdhenj që kanë pasur si qëllim të jetës së tyre kuptimin e Kuranit dhe Sunetit, mënyra më e mirë e të vepruarit, pra, në çështjet për të cilat ata kanë pasur mospajtime me njëri-tjetrin, është të vepruarit me kujdes dhe duke i marrë të gjitha masat e nevojshme.

Kjo do të thotë t'i kryesh ashtu siç duhet të gjitha shtyllat dhe pjesët e tjera përbërëse të namazit, të përpiqesh ta vazhdosh atë me emocionet e ditës së parë, pa lejuar që ai të zbehet e të humbasë gjallërinë. Për këtë, çështje të tilla si zgjatja e kijamit nëpërmjet këndimit të Kuranit për një kohë më të gjatë dhe qëndrimi i zgjatur në ruku e sexhde janë gjithashtu shumë të rëndësishme. Në një kuptim, thelbësore është kryerja e të gjitha pjesëve të namazit në mënyrën e duhur dhe përballimi i vështirësive të tyre. Sepse të vepruarit në këtë mënyrë do t'i mundësojë njeriut arritjen e dimensioneve të ndryshme në çdo namaz. Kjo është arsyeja pse njeriu duhet t'i interpretojë edhe një herë namazet që ka falur dhe duhet të përpiqet t'i ndiejë thellësisht, me gjithë qenien e tij, rikutë dhe sexhdet.

Nuk ka dyshim se falja e namazit pa i lënë asgjë mangët, duke treguar kujdes ndaj shtyllave, kushteve, suneteve, mustehabeve (gjë e pëlqyeshme), madje edhe ndaj adabeve (edukatë) të tij, është një çështje shumë e rëndësishme, askush nuk mund ta nënvlerësojë e ta shohë atë si diçka të thjeshtë. Kryesore në marrëdhënien e njeriut me Zotin e tij janë kuptimi, thelbi, shpirti. Por, nga ana tjetër, janë fjalët, format

dhe shabllonet ato që i bartin këto të fundit. Prandaj duhet treguar patjetër kujdes edhe ndaj atyre fjalëve e shablloneve. Ato duhet të jenë në gjendje ta mbajnë atë kuptim thelbësor. Për rrjedhojë, nuk mund të thuhet se shabllonet dhe format nuk kanë asnjë vlerë. Mbi to ndërtohen dispozitat e dukshme. Por, siç e thamë edhe më sipër, thelbësor është shpirti i punës. Dhe kjo arrihet nëpërmjet faljes së namazit me *hushú*.

Ndonëse nuk ka një shprehje të atillë për to në librat e fikhut, mund të themi se *hushú*-ja dhe *hudú*-ja janë *taḍīli erkán*-i i brendshëm i namazit. *Hushú* dhe *hudú* do të thotë ta çosh deri në fund këtë çështje pa iu ndarë kuptimit të namazit.

Në një hadith të Pejgamberit tonë (s.a.s.), teksa shpjegohet koncepti '*ihsan*', përkufizimi i tij jepet në këtë mënyrë: "Ta adhurosh Allahun sikur je duke e parë Atë. Por, edhe sikur ti të mos e shohësh dot Atë, Ai po të shikon ty!"²²⁴ Me një vetëdije kaq të thellë duhet kryer namazi. Pavarësisht çdo gjëje, ai duhet falur me kujdes dhe *hushú*. Çdo namaz duhet falur në një atmosferë dhe dimension ndryshe nga ato të namazit paraardhës.

Përmbajtja e namazit është aq e gjerë, sa për t'i bërë njerëzit të mendojnë shumë thellësisht. Ka një gamë të gjerë mënyrash për të ndier namazin gjatë faljes së tij nga të qenit i vetëdijshëm për daljen para Allahut thellësisht i entuziazmuar e deri tek ndjesia e faljes së namazit si një individ i xhematit prapa Profetit tonë (s.a.s.); nga të parit e vetes mes rreshtave të engjëjve e deri te ajo ndjesi që e kapërcen horizontin tonë me një lëvizje të vetme, pra, ndjesia e kryerjes së namazit sikur po e vë kokën në mbulesën e Arshit.

Kushti i parë, që njeriu të ketë sukses në këtë, është ta dijë namazin si një miraxh ose si një hije të miraxhit. Sepse ai nuk është një përmbledhje lëvizjesh që konsistojnë vetëm në ulje dhe ngritje. Për besimtarin, çdo namaz është një mjet që e lartëson atë si në miraxh. Kështu që, qoftë edhe në dimensione të ndryshme, ai duhet ta përmbushë miraxhin e tij në çdo namaz.

²²⁴ Buhári, ímán 37; tefsíru súde (31) 2; Muslim, ímán 5, 7.

Qëllimi i namazit

Në të gjitha adhurimet që i bëhen Zotit të Madhëruar ka patjetër një begati dhe bereqet. Nuk mund të mendohet që një person t'i drejtohet derës së mëshirës së Tij dhe të mbesë i privuar nga ajo mëshirë. Megjithatë, njeriu nuk duhet t'i lidhë adhurimet e tij me begatitë, ose më saktë, me kënaqësinë. Ndonjëherë mund të ndodhë që të falni namaz në një gjendje shtrëngese, pra, kur ju është ngushtuar zemra dhe ndiheni të mërzitur. Dhe, nëse do të nxitoni t'i gjykoni këto namaze duke u bazuar thjesht në anën e tyre të jashtme, mund të mendoni me pesimizëm për to. Por, në të vërtetë, ato janë nga namazet më të pranuar. Sepse ju, edhe atëherë kur jeni të zhveshur nga ndjesitë në lidhje me begatitë materiale e shpirtërore, nuk i keni harruar adhurimet tuaja dhe keni dalë para Allahut të Madhëruar. Në këtë rast, juve nuk ju jepet ndonjë paradhënie, por, në të njëjtën kohë, kjo situatë as nuk jua pakëson besnikërinë tuaj... Dhe, ja, këto janë adhurimet e kryera me sinqeritet.

Të thuash “Meqenëse Zoti i Madhëruar, duke thënë ***Lutmuni Mua, se do t’ju përgjigjem!***²²⁵, na e ka bërë të ditur që do t’u përgjigjet të gjitha duave që do të derdhen jashtë buzëve tona, atëherë unë duhet të vazhdoj të pres te pragu i derës së Tij.” dhe të mos largohesh që aty është një shprehje përkushtimi dhe besnikërie. Nëse një person i kryen adhurimet në këtë mënyrë gjatë gjithë jetës së tij, pra, pa marrë asnjë kënaqësi prej tyre, do të thotë se të gjithë jetën e ka kaluar në një robëri të dëlirë ndaj Allahut dhe në çiltëri e sinqeritet.

Nga ana tjetër, as arritja e gradave shpirtërore nuk duhet parë si qëllim i adhurimit. Kjo është arsyeja pse personi që kryen adhurimet e tij me një dëshirë të zjarrtë për Xhenetin është quajtur rob i Xhenetit (*Abdul Xhenneh*). Xheneti nuk mund të jetë pikësynimi kryesor i veprave dhe adhurimeve të kryera. Adhurimi bëhet për shkak se i Vërteti e urdhëron atë dhe me qëllimin për të fituar pëlqimin e Tij.

Po, arsyeja e vërtetë e adhurimit është urdhri i Allahut. Pra, ne i

²²⁵ Surja Gáfir, ajeti 60.

kryejmë adhurimet ngaqë Allahu na urdhëron për një gjë të tillë. Ai që ngrihet të falë namaz duke u dridhur nga frika prej Xhehenemit dhe që qëndron duarlidhur e i përlur para Allahut po për të njëjtën arsye, është quajtur rob i Xhehenemit (*Abdun'nár*).

Si i bëhet, atëherë, për t'u bërë "*Abdulláh*" (rob i Allahut)? Njeriu duhet t'i kryejë adhurimet e tij jo për shkak të dashurisë ndaj Xhenetit, as për shkak të ndjenjës së frikës prej Xhehenemit, po ngaqë Allahu e ka urdhëruar një gjë të tillë dhe për shkak të të qenit vetëm rob i Allahut.

Njeriu duhet t'i falë patjetër namazet e tij, edhe në ato çaste shtrëngese, edhe kur është i privuar nga të ndierit e përfitimeve materiale dhe shpirtërore. Madje, ashtu siç mund të bëhen shkak i begatisë dhe bereqetit, e qara dhe rënkimi i tij mund të jenë edhe një tundim e sprovë. Edhe të qarat dhe rënkimet e një personi që nuk arrin ta mbajë zemrën e tij nën dorën e mendjes dhe të vetëkontrollit mund të jenë një rrezik serioz për të. Sepse një person i tillë, nuk është gjithmonë në gjendje t'i dijë e t'i ruajë thellësitë e zemrës së tij. Edhe sikur të jenë këto gjendje dhurata e mirësi që i jepen plotësisht namazit, nëse njeriu, pikërisht për këtë arsye, do të vrapojë pas tyre gjatë faljes së namazit, do të thotë se i ka humbur disa pika shumë të rëndësishme në lidhje me sinqeritetin. Është shumë e rëndësishme që të dilet para Allahut si një sënduk i mbyllur, i zënë dhe i ngopur vetëm me ndjenjën dhe mendimin e fitimit të pëlqimit të Tij.

I lutemi Zotit tonë që të na mundësojë të arrijmë majat në çështjet e sinqeritetit, të lidhjes me Të dhe të çiltërisë! Përkundrejt kësaj, nuk prish punë nëse gjendja jonë duket e rrënuar dhe e shkretë në sytë e të tjerëve. Një pamje e jashtme e tillë nuk ka dhe aq rëndësi. E rëndësishme është të jesh i madh në sytë e Zotit. Në këtë pikë, të gjithë duhet të shqetësohemi dhe, gjithë përlulje, t'i lutemi Zotit: "*Allahu im, më bëj mua të vogël në sytë e mi dhe sa më të madh te shikimet e Tua hyjnore!*"²²⁶

Një çështje tjetër është edhe kjo: Allahu i Plotfuqishëm mund t'i

²²⁶ el Bezzár, el Musned 10/315; ed'Dejlemí, el Musned 1/473.

begatojë ata që kryejnë adhurime edhe me disa kënaqësi shpirtërore. Ka disa njerëz të mëdhenj, të cilët, duke qenë se e kanë fshirë nga zemrat e tyre atë që quhet ‘*uxhb*’ (pëlqim i vetes) dhe kanë arritur teuhidin, të gjitha mirësitë dhe bukuritë që u janë mundësuar i dinë nga Individualiteti që ua ka hedhur mbi shpinë si të ishin një rrobë. Për këtë arsye, ata e konsiderojnë si ‘*tahdisi nimet*’ (përmendja e mirësive të Zotit duke falënderuar për to) shprehjen me zë të lartë të kësaj të vërtete. Për shembull, i Dërguari i Allahut (s.a.s.) thotë kështu: “*Në ditën kur do të ringjallen të gjithë, unë do të ringjallem si i zoti i Flamurit të Lavdërimit (Livaul Hamd).*”²²⁷ Ndërsa në një hadith tjetër, shprehet në këtë mënyrë: “*Allahu më ka dhënë pesë gjëra që nuk ua ka dhënë profetëve të tjerë.*”²²⁸

Këto janë fjalë të thëna në gradën e ‘*tahdisi nimet*’-it. Dikush më ka veshur një rrobë të bukur dhe unë, në çdo vend që shkoj, shpreh këtë dhuratë, këtë mirësi të atij personi ndaj meje. Duke bërëtitur me sa zë kam, them kështu: “Kjo rrobë në trupin tim është e bukur, madje ma shton edhe mua bukurinë, i jep një tjetër dimension bukurisë së krijimit të Zotit tim. Por kjo bukuria nuk buron nga unë, po nga Ai që ma ka veshur këtë rrobë dhe nga rroba me të cilën Ai më ka veshur.” Në këtë kuptim, nuk ka ndonjë të keqe në përmendjen e qerasjeve të Zotit tonë ndaj nesh; madje, shumë herë, fshehja e tyre do të ishte një shenjë mosmirënjohjeje ndaj Tij.

Ja edhe një tjetër hadith i Pejgamberit tonë (s.a.s.), i thënë në të njëjtin kontekst: “*Allahu, çdo profeti i ka dhënë një dëshirë të fortë ndaj diçkaje. Ajo që dëshiroj unë është ibadeti i natës.*”²²⁹ Mirëpo, Profeti ynë kurrë nuk i ka falur namazet për kënaqësinë shpirtërore që merrte prej tyre. Nëpërmjet këtyre fjalëve, njerëzve që janë të hapur ndaj gjërave të tilla u jepet një mesazh. Qëllimi do të mbahet sa më lart dhe të punuarit e përpjekjet do të vazhdojnë derisa namazi të arrijë në atë gradë.

²²⁷ Tirmidhí, menákib 1; Ibn Máxhe, zuhd 37.

²²⁸ Buhárí, tejemmum 1, salát 56; Muslim, mesáxhid 3, 5.

²²⁹ et’Taberání, el Mu’xhemul kebír 12/84.

b. Falja e namazit me xhemat

Falja e namazit me xhemat është një sunet shumë i rëndësishëm që nuk duhet neglizhuar asnjëherë. Pikëpamja e imam Ahmed ibn Hanbelit në çështjen e xhematit është për t'u marrë në konsideratë. Ai e numëron faljen e namazit me xhemat mes farzeve të namazit. Tabiunët ishin jashtëzakonisht të kujdesshëm e rigorozë në çështjen e faljes së namazit me xhemat. Për shembull, i madhi imam A'meshi (Sulejman ibn Mihran) – sipas dëshmisë së Ueki ibn Xherrahut, njërit prej imamëve të pasuesve të tabiunëve (*tebei tabiún*) – për shtatëdhjetë vjet me radhë nuk i ka ikur asnjë tekbir fillestar i namazeve me xhemat. Gjatë gjithë këtyre viteve, nuk është parë të bëjë kaza as edhe një rekat të vetëm. Një tjetër, gjatë gjithë jetës së vet, nuk ka parë kurrë qafë njeriu në namazet me xhemat, sepse është falur gjithmonë në rresht të parë.

Profeti ynë (s.a.s.) i kushtonte një rëndësi të madhe faljes së namazit me xhemat dhe, sa herë që i jepej rasti, i nxiste besimtarët në këtë pikë. *“Betohem në Allahun që ka në dorë neftin tim se më shkon në mendje të caktot dikë imam kur këndohet ezani dhe, pasi të marr edhe ca dru me vete, të shkoj e t'ua djeg shtëpitë atyre që nuk vijnë në namaz.”*²³⁰ Ky hadith tregon gjithashtu rëndësinë që i jepte Ai (s.a.s.) xhematit. Duke u bazuar në këtë hadith, shumë dijetarë kanë dhënë gjykimet e tyre në lidhje me faljen e namazit me xhemat. Disa e kanë konsideruar atë farz, disa vaxhib dhe disa të tjerë sunet të fortë (*sunnet muekkede*). I nderuari Ahmed ibn Hanbel, duke u bazuar në ajete të tilla si ***“Faleni namazin, jepeni zekatin dhe përkuluni në ruku bashkë me ata që përkulen (në namaz).”***²³¹, në hadithin e mësipërm dhe në shumë hadithe të tjera të ngjashme me të, ka arritur në përfundimin se falja e namazit me xhemat është *‘farz ajn’* (detyrim individual, për çdo mysliman). Ndërkohë që një pjesë e dijetarëve të medhhebit Shafi e kanë pranuar faljen e namazit me xhemat si *‘farz kifáje’* (detyrim kolektiv), ata të medhhebeve Hanefi dhe Maliki janë pajtuar në gjykimin se namazi me xhemat është *‘sunnet muekkede’*.

²³⁰ Buhári, edhán 29, 34, ahkám 52; Muslim, mesáxhid 251-254.

²³¹ Surja Bekare, ajeti 43.

Tabloja e Krenarisë së Njerëzimit (s.a.s.) ka thënë: “*Namazi që falet me xhemat është njëzet e shtatë herë më sipëror se namazi i falur vetëm.*”²³² Në këtë rast, duke qenë se sevapet janë për të gjithë xhematin, nuk mund të bëhet fjalë për privimin e të tjerëve nga sevapet që i jepen një individ. Ato sevape kalojnë në fletoren e veprave të gjithsecilit.

Në të njëjtën kohë, këto hadithe na mësojnë të vërtetën se sukseset individuale në adhurimet dhe udhëtimin shpirtëror në rrugën e Allahut absolutisht që do të shpërblehen, porse, në fund të fundit, do të mbeten prapëseprapë në planin individual dhe nuk do ta arrijnë kurrë cilësinë e kryerjes së tyre me xhemat. Kjo çështje, ashtu siç vlen për namazin, agjërimin, haxhin dhe adhurimet e tjera, vlen edhe për përpjekjet që bëhen në rrugën e besimit dhe Kuranit.

Po, duhet ditur se arritja nga një individ i vetëm tek ato gjëra që ka premtuar Allahu nuk është e garantuar. Edhe sikur të bëjë gjëra të mrekullueshme në emër të besimit dhe Kuranit, një njeriu të vetëm, këto i mbesin gjithmonë në planin individual. Mirëpo, nëse një punë bëhet nga një grup njerëzish, të cilët ndajnë me njëri-tjetrin të njëjtat vlera në ndjenja dhe mendime, bazuar në parimin e të qenit ortakë në kryerjen e veprave që kanë të bëjnë me botën tjetër, secili nga ata njerëz do të ketë pjesën e tij në sevapin e fituar nga ajo vepër. Duke vepruar me këtë vetëdije mund të mbahen mbi supe barrët e rënda sa malet, sidomos në shekullin në të cilin po jetojmë, cili konsiderohet si shekulli i ndërjegjes kolektive.

²³² Buhári, edhán 30; Muslim, mesáxhid 249.

PJESA E PESTË



KOHËT E NAMAZIT

Jeta duhet programuar sipas namazit dhe namazi, si një kalendar, duhet t'i rrethojë të gjitha pikat e jetës. Bllokada e kalendarit të vërtetë të jetës duhet ngritur mbi namazin. Kohët e namazit duhet të jenë gurë themeli dhe sipas tyre duhen programuar punët e tjera. Të vjetrit, kur merreshin vesh për ndonjë punë, thoshnin: “Takohemi para namazit të sabahut... E fillojmë pas namazit të drekës...” Kjo mënyrë e të shprehurit në lidhje me kohën vërehet edhe në Kuran, në shumë vende të të cilit hasim shprehje të tilla si “Pas faljes së namazit...”, “Para aksh namazi...” etj. Rrjedhimisht, besimtari, për të marrë ato gjëra që do t'i jepen nga horizonti i mëshirës, do të përshkojë rrugën drejt mesxhidit, do të kontrollojë zemrën dhe do të vëzhgojë Zotin e tij nga vendvrojtimi i mesxhidit. Sahabët, kur shpjegonin ndjenjat e madhështisë dhe të frikës, të cilat i përjetonin në çastet e daljes para Allahut në namaz, thoshnin kështu: “Ne uleshim dhe bisedonim me Profetin tonë (s.a.s.), por kur lidheshim në namaz, nuk shikonim majtas apo djathtas. Në namaz, nuk e njihnim njëri-tjetrin. Vështrimi dhe vëmendja jonë fiksoheshin te një botë tjetër, të cilën nuk e kishim ditur më parë.” Sepse i Dërguari i Allahut (s.a.s.) u pati thënë atyre kështu: *“Allahu e shikon robin e tij që fal namaz, drejtohet për nga ai. Kur robi largon prej Tij fytyrën duke parë majtas e djathtas, Ai gjithashtu e shkëput shikimin e Tij prej robot.”*²³³

Po, një person që nuk e ndjen këtë pjekuri në shpirt edhe gjatë çasteve kur është duke iu drejtuar Zotit, nuk do t'u shpëtojë dot dëshirave të tij trupore, nuk do të jetë në gjendje të fluturojë në botën e zemrës, nuk do të jetë në gjendje t'u japë drejtimin e duhur uljeve dhe ngritjeve të

²³³ Ebú Dáúd, salát 164; Nesáí, sehv 10.

tij, gjendjen e tij të mjerueshme në shtëpi e rrugë do ta vazhdojë edhe në xhami; do të falë namaz, por do të kthehet pas e do të largohet pa i korrur frytet e tij. Disa dijetarë shumë të kujdesshëm dhe të përpiktë në këtë çështje, kanë thënë se i prishet namazi atij që shpërqendrohet gjatë faljes së tij aq sa të fillojë të mendojë se kë person ka në krah apo se kush është personi që po vjen për t'u lidhur në namaz në krah të tij dhe e kanë përdorur këtë si një masë në çështjen e hutimit gjatë namazit. I Dërguari i Allahut (s.a.s.) thotë: *“Lutjuni Allahut me besimin se Ai do t’ju përgjigjet. Dijeni se Allahu (xhel’le xheláluhu) nuk e pranon duanë e një zemre që hutohet duke u marrë me gjëra të tjera.”*²³⁴

Kështu, besimtari, ashtu siç ruan kuletën nga hajdutët apo fajdexhinjtë, po ashtu duhet të ruajë e të kontrollojë zemrën kur kalon nëpër rrugët ku mbizotërojnë shturja, imoraliteti dhe gjynahet. Të njëjtën gjë duhet të bëjë edhe pasi të arrijë në mesxhid. Duhet të kontrollojë sërish zemrën dhe të flakë jashtë saj çdo gjë të kësaj dynjaje që mund të bëhet shkas për largimin e tij nga Zoti i Madhëruar. Duhet të tregojë një përpjekje të madhe për të arritur kthimin tek Allahu dhe drejtimin për tek Ai ashtu siç duhet. Në të kundërt, i bie që zemrës së tij, në emër të ndërtimit të një marrëdhënieje me Zotin e tij dhe të daljes para Zotit, të mos i ketë kushtuar rëndësi as sa kuleta e tij. Për rrjedhojë, po kaq do të jetë edhe vlera e tij tek Allahu. Në namaz, besimtari duhet të dijë vetëm Zotin e tij, duhet t’i drejtohet Atij me gjithë zemër. Me faljen e namazit pesë herë në ditë, sikur të jetë duke e goditur atë me tokmak pas qafe, do ta shpërbëjë, do ta heqë qafe hutesën shkaktare të largimit të tij nga Zoti. Dhe, kështu, do ta bëjë robërinë e tij ndaj Zotit mbizotërues të të gjithë kohës. Koha, e cila pranohet në trajtën e një vije nocionore, në sajë të kësaj robërie dhe të adhurimeve të kryera do të fitojë vlerë dhe do të vërshojë drejt botës së pafund si një lumë i rrëmbyeshëm; nata do të ndjekë ditën, dita do të ndjekë natën dhe, në fund, do të vijnë frutat e Xhenetit, të cilat do t’i buzëqeshin robit në Xhenet.

Po, çdo gjë që do t’i dalë robit përpara atje, do të jetë një shprehje e marrëdhënies së tij me Zotin këtu. Nëse ka ndier një gëzim të veçantë

²³⁴ Tirmidhí, de’auát, 65; el Hákim, el Mustedrek 1/670.

sa herë ka falur namaz këtu, nëse i është drejtuar Zotit me rrezatime e kuptime krejtësisht të reja në çdo rast, atëherë Zoti do t'ia kthejë atij të gjitha këto atje, një nga një.

1. Caktimi i namazit pesë herë në ditë

Fakti që kohët e namazit në një ditë janë pesë, mund të kuptohet si nga ajetet e Kuranit Famëlartë, po ashtu edhe nga Suneti i Profetit tonë (s.a.s.). Fillimisht do të përmendim ato shenja të ajeteve të Kuranit që na e bëjnë të ditur këtë, kurse hadithet në lidhje me këtë temë, do t'i shqyrtojmë më pas.

a. Pesë kohët e namazit në Kuranin Famëlartë

Duke qenë se jemi njerëz, ne i harrojmë shumë shpejt dhe vështirë se i sjellim më në mendje mirësitë e mundësuar nga i Madhi Zot. Allahu, që na njeh më mirë seç e njohim ne veten, ngaqë e di shumë mirë këtë shkujdesje dhe hutesë tonën, i ka ndarë njëzet e katër orët e ditës në intervale kohore të caktuara dhe na ka kërkuar që, gjatë pjesëve të caktuara të këtyre intervaleve kohore, brenda një atmosfere pothuajse llogaridhënieje dhe për të kujtuar edhe një herë të mirat e begatitë që zotërojmë falë Tij, të dalim para Tij me përulje dhe gjithë respekt. Sepse mahnitja dhe admirimi i robit vazhdojnë për aq kohë sa ai ndodhet afër mjedisit hyjnor; e kundërta ndodh kur ai qëndron larg Zotit, ndjenjat shtazore e kapin për jake dhe nuk ia lëshojnë atë. Ja, pra, që ne të mund t'i shpëtojmë kësaj hutese, Allahu i Madhëruar, duke thënë **“Namazi është detyrë për besimtarët në kohë të caktuara.”**²³⁵, na fton në xhami për të falur namaz në kohë të caktuara.

Kurani i Shenjtë flet për kohët e namazit në shumë ajete të tij. Disa prej tyre janë si vijojnë:

²³⁵ Surja Nisá, ajeti 103.

“Fale namazin në mëngjes e mbrëmje dhe në një kohë të natës, sepse veprat e mira i shlyejnë veprat e këqija. Kjo këshillë vlen për ata që i pranojnë këshillat.”²³⁶

“Kryeje namazin prej kthimit të Diellit (nga gjysma e qiellit) deri në errësirën e natës dhe këndo Kuran në agim; me të vërtetë, falja e mëngjesit është e dëshmuar (nga engjëjt).”²³⁷

“Prandaj duroje (o Muhamed) atë që thonë ata dhe lavdëroje me falënderim Zotin tënd para lindjes së Diellit dhe para perëndimit të tij! Lavdëroje Atë edhe në orët e natës, edhe në skajet e ditës, që të arrish pëlqimin e Zotit.”²³⁸

Në një vend tjetër, duke thënë ***“Prandaj lavdërojeni Allahun, kur bie muzgu dhe kur gdhin drita! Për Atë është falënderimi në qiej dhe në Tokë, në mbrëmje dhe në mesditë.”***²³⁹, na bën me dije se kohët e namazit në një ditë janë pesë.

Kështu, në kohët e akshamit, jacisë dhe sabahut, kur engjëjt në qiej dhe adhuruesit në tokë i drejtohen Atij me lavdërime e falënderime, dhe në kohët e drekës dhe ikindisë, kur e gjithë bota shndërrohet në një gjuhë që përmend, lavdëron dhe lartëson Allahun, edhe robi, me fjalë që shprehin madhështinë e Zotit, do t'i bashkohet kësaj simfonie të gjerë dhe nuk do ta prishë këtë harmoni. Nafi ibn Ezrak është një nga ata që e kanë dëgjuar prej Abdullah ibn Abasit (r.a.) botëkuptimin e Profetit tonë (s.a.s.) në çështjen e tefsirit. Kur e pati pyetur ai Abdullah ibn Abasin (r.a.) me fjalët “A shpjegohen pesë kohët e namazit në Kuranin Famëlartë?”, Abdullah ibn Abasi i pati kënduar këtë ajet.²⁴⁰ Po, ky ajet tregon se namazet ditore janë pesë dhe se duhen falur në kohët e tyre përkatëse. Jo vetëm Abdullah ibn Abasi (r.a.), po edhe shumë sahabë të tjerë kanë nxjerrë të njëjtin kuptim nga ky ajet.

²³⁶ Surja Húd, ajeti 114.

²³⁷ Surja Isrá, ajeti 78.

²³⁸ Surja Táhá, ajeti 130.

²³⁹ Surja Rúm, ajetet 17-18.

²⁴⁰ Abdurrezzak, el Musannef 1/454; et’Taberání, el Mu’xhemul kebír 10/247; el Hákim, el Mustedrek 2/445.

Duke thënë se në ajet përmenden vetëm katër kohë, mund të na lindë ndonjë dyshim në lidhje me këtë çështje. Por ky numër shprehet në një mënyrë më të qartë në ajetin **“Falini rregullisht namazet dhe namazin e mesëm, dhe qëndroni me devotshmëri para Allahut, duke iu lutur Atij.”**²⁴¹ Në arabisht, gjërat që janë më pak se tre nuk shprehen në shumës. Rrjedhimisht, me fjalën “namazet” shprehen minimumi tre namaze. Në ajet flitet edhe për namazin e mesëm. Që do të thotë se në këtë ajet bëhet fjalë për katër namaze. Por, që një namaz të quhet namaz i mesëm, nevojitet që në dy anët e tij të ketë një numër të barabartë namazesh. Rrjedhimisht, kohët e namazeve nuk mund të jenë katër. Atëherë i bie që kohët e namazit duhet të jenë të paktën pesë. Pavarësisht mosmarrëveshjeve në këtë pikë, mbizotëron mendimi se namazi i mesëm është namazi i ikindisë. Nëse do duhej të jepnim si shembull një nga transmetimet që e mbështesin këtë mendim, mund të përmendnim fjalët e Profetit tonë (alejhis’salátu ues’selám) në një çast të luftës së Hendekut. Një ditë, për shkak të intensitetit të luftës, Ai (s.a.s.) dhe besimtarët e tjerë nuk kishin mundur ta falnin në kohë namazin e ikindisë. Në këtë situatë, Ai i qe drejtuar Zotit me këto fjalë: *“O Allahu im! Mbushua me zjarr shtëpitë dhe varret atyre që na penguan në faljen e namazit të mesëm, namazit të ikindisë.”*²⁴²

Po, aq i rëndësishëm është namazi, sa për ta bërë të Dërguarin e Allahut (s.a.s.) të mërzitej jashtëzakonisht shumë për namazet që, për shkak të ashpërsisë së luftës, nuk i falte dot. Ai ishte lutur gjithmonë për të mirën dhe shpëtimin e gjithë njerëzimit, por, këtë herë, ngriti duart lart dhe i mallkoi ata që i ishin bërë pengesë në faljen e namazeve. Përse pati vepruar kështu Profeti i Mëshirës? Sepse namazi kishte një vlerë të veçantë në sytë e Tij. Atë ditë, namazi i mesëm kishte ikur pa u falur. Për rrjedhojë, dita qe copëtuar, drejtimi për nga Zoti në kohën e ikindisë nuk qe realizuar dhe një pjesë e miraxhit qe braktisur.

Kështu që, kohët e namazit në një ditë duhet të jenë pesë dhe, në mënyrë që të fitojë shpejtësi në ngjitjen drejt përsosmërisë, robi duhet

²⁴¹ Surja Bekare, ajeti 238.

²⁴² Buhárí, xhíhád 98, megází 29, de’auát 58; Muslim, mesáxhid 202-206.

të jetë në gjendje të dalë para Allahut pesë herë në ditë. Ai duhet të jetë në gjendje të japë llogari për jetën e tij pesë herë në ditë, që t'i shpëtojë hutesës dhe të mund të ndërtojë një marrëdhënie me Zotin e tij. Ai duhet të dijë të ulet me *edep* para Allahut, që zemra e tij të jetë e përgatitur për misteret e më të shenjtës begati, ndjenjat e tij të mësohen me këtë punë, në shpirtin e tij të lindë një butësi dhe xhentilesë dhe, në këtë mënyrë, të flakë tutje veçoritë kafshërore e të mos mbajë mbi shpinë një barrë të panevojshme.

Një tjetër çështje që na tërheq vëmendjen në këtë ajet është të shprehurit e namazit nëpërmjet fjalës '*tesbih*'. E, në fakt, një nga kuptimet e namazit është edhe ky. Sepse namazi është mënyra më e përsosur e përmendjes së Allahut. Ne rrimë e kërkojmë fjalët më të përshtatshme për të shprehur madhësinë e Zotit të Madhëruar dhe vogëlsinë tonë, gjatë gjithë kohës orvatemi të gjejmë mënyrat më të përshtatshme për të shprehur me fjalë, me vepra dhe me gjendjen tonë madhësinë e Tij. Por shprehjet më lartësuese dhe që e shprehin më së miri madhësinë e Allahut, – këto janë '*Subhánalláh*', '*Elhamduli'láh*' dhe '*Alláhu Ekber*' – të gjitha janë të shpërndara nëpër pjesët përbërëse të namazit. Akoma pa filluar me kiraetin, "*Allahu im, Ti je larg çdo të mete, madhështia absolute të përket vetëm Ty dhe lavdërimet e falënderimet e mia për Ty janë!*" themi në duanë '*Subháneke*'; këndimin e *Fatijasë* e fillojmë me ajetin "***Çdo lavdërim i përket Allahut, Zotit të botëve.***", ndërsa kur ngrihemi nga rukuja, themi "*O Zoti im! Të gjitha lavdërimet janë për Ty.*". Pra, gjatë namazit, me të gjitha këto shprehje lavdërojmë dhe falënderojmë Allahun. Në të njëjtën mënyrë, ne shprehim në namaz përballë veprimtarisë marramendëse të Allahut habinë dhe admirimin tonë me fjalët '*Alláhu Ekber*'; ulemi e ngrihemi, kalojmë nga njëra pjesë e namazit në tjetrën duke thënë '*Alláhu Ekber*'. Nëpërmjet fjalës '*Subhánalláh*', shprehim faktin se nuk duhet zgatur dorë për te madhështia e Tij dhe se në asnjë mënyrë nuk i dilet kundër Atij; ndonjëherë sjellim njëra pranë tjetrës ashpërsinë dhe butësinë e Tij dhe themi: "*Allahu im! Të përmend Ty me lavdërimet e Tua; Allahu im i Lartë, deklaroj se Ti je larg çdo të mete!*" I Dërguari i Allahut (s.a.s.), në një fjalë të tijën që, për ne, përbën një lajm të mirë, ka thënë

kështu: “*Ekzistojnë dy fjalë, të cilat janë të lehta për gjuhën, të rënda në peshore dhe shumë të dashura tek i Gjithëmëshirshmi: ‘Subhánalláhi ue bihamdihi, subhánalláhil adhím.’*”²⁴³

Shkurtimisht, namazi është formuluar i gjithi nga Allahu i Madhëruar. Pesë namazet ditore, të stolitura me këto fjalë të shenjta e që duhet të kryhen çdo ditë, do të na lartësojnë me përmendjet dhe lavdërimet që i bëjmë Zotit gjatë faljes së tyre dhe, duke qenë adhurime në dimensionet e miraxhit, do të na çojnë shpirtërisht para Allahut brenda një çasti.

b. Pesë kohët e namazit në hadithe

Caktimi i namazit në pesë kohë nuk ka mbetur i përmbledhur vetëm me ato që thuhet në ajetet e Kuranit. Allahu i Madhëruar ia mësoi Profetit tonë (s.a.s.) kohët e namazit nëpërmjet engjëllit. Në një hadith të transmetuar nga Abdullah ibn Abasi (r.a.), i Dërguari i Allahut (s.a.s.) tregon për këtë të vërtetë si vijon: “*Xhibrili më priu në faljen e namazit pranë Bejtullahut (Shtëpisë së Zotit) përgjatë dy ditëve. Në ditën e parë, namazin e drekës e falëm kur hija ishte sa lidhësja e këpucëve (pra, në mes të ditës, në kohën kur objektet kanë hijen më të shkurtër të mundshme). Pastaj, kur hija e çdo objekti arriti në madhësinë e vetë objektit, falëm namazin e ikindisë. Namazin e akshamit e falëm kur perëndoi dielli, në kohën kur agjëruesi çel agjërimin e tij; namazin e jacistë e falëm pasi drita në horizont u zhduk, kurse namazin e sabahut e falëm kur errësira e natës filloi t’ia linte vendin dritës, në kohën kur agjëruesit i ndalohet ngrënia dhe pirja. Ditën e dytë, namazin e drekës e falëm në kohën kur, gjatë ditës së parë, kishim falur namazin e ikindisë, pra, atëherë kur çdo gjë e ka hijen po aq sa është edhe ajo vetë. Namazin e ikindisë e falëm kur hija e çdo gjëje arriti në madhësinë sa dyfishi i madhësisë së secilës gjë. Namazin e akshamit e falëm në të njëjtën kohë me atë të ditës paraardhëse; namazin e jacistë, pasi kishte kaluar një e treta e natës; kurse namazin e sabahut e falëm pasi qielli ishte ndriçuar*

²⁴³ Buhári, ejmán 19, teuhíd 58; Muslim, dhikr 31.

ca. *Pastaj, Xhibrili u kthye nga unë dhe më tha: 'O, Muhamed! Këto janë kohët e namazeve të profetëve të ardhur para teje. Kohët tuaja të namazeve janë kohët e mbetura mes këtyre dy kohëve!'*²⁴⁴

Po, ne i shohim qartë pesë kohët e namazit në sunetin e Pejgamberit tonë (s.a.s.). Librat e haditheve autentikë të Buhariut dhe Muslimit raportojnë se, kur qe kthyer nga Miraxhi, Profeti ynë pati njoftuar se pesë kohët e namazit, të cilët vlenin sa pesëdhjetë kohët farz të popujve të tjerë, do të ishin farz për umetin e tij. Enesi (r.a.) na e përcjell kështu këtë hadith: “Natën kur i Dërguari i Allahut (s.a.s.) u ngjit në miraxh, iu bënë farz pesëdhjetë kohë namaz. Por, më pas, këto u reduktuan në pesë kohë. Pastaj Allahu iu drejtua kështu: ‘O, Muhamed! Tek Unë, (vendimi është marrë) tashmë, kjo fjalë nuk ndryshohet. Këto pesë kohë, për Ty dhe për umetin tënd, (si një mirësi e Zotit tënd, do të pranohen dhjetëfish dhe) do të llogariten si pesëdhjetë kohë.’”²⁴⁵

Në një hadith tjetër autentik, i Dërguari i Allahut (s.a.s.) i pyet sahabët: “Nëse një lumë rrjedh para derës së njërit prej jush dhe ai person lahet në atë lumë pesë herë në ditë, si thoni, a mund të mbesë ndonjë papastërti mbi trupin e tij?” Sahabët i përgjigjen me fjalët “Në trupin e një personi në këtë gjendje, asnjë papastërti nuk mbetet!”. Pas këtyre fjalëve të sahabëve, Profeti ynë (s.a.s.) thotë “Ja pra, ky është shembulli i pesë kohëve të namazit. Në sajë të namazeve, Allahu i fshin të gjitha gjynahet.”²⁴⁶ dhe shpreh qartë pesë kohët e namazit.

Një ngjarje tjetër, që shpjegohet në librat e haditheve në lidhje me kohët e namazit dhe që tregon për pesë kohët e namazit, transmetohet nga Ebu Musa el Esh'ariu (r.a.) në këtë mënyrë: “Erdhi një person tek i Dërguari i Allahut (s.a.s.) dhe e pyeti për kohët e namazit. Pejgamberi ynë nuk i dha asnjë përgjigje atij. (Në një transmetim tjetër thuhet se i kërkoi atij të falte me ta namaz përgjatë dy ditëve.) (Në kohën e sabahut,) në ag, kur ishte akoma aq errësirë sa askush të mos ishte në gjendje të dallonte askënd përreth, urdhëroi Bilalin. Bilali këndoi

²⁴⁴ Tirmidhí, salát 1; Ebu Dáúd, salát 2.

²⁴⁵ Buharí, salát 1; Muslim, ímán 263.

²⁴⁶ Buharí, bed'ul halk 6, menákibul ensár 42; Muslim, ímán 259.

ikametin e namazit të sabahut (dhe u lidhën në namaz). Pastaj, kur dielli kishte arritur majën dhe sapo kishte filluar të kthehej drejt perëndimit, e urdhëroi sërish Bilalin. Bilali këndoi ikametin e namazit të drekës. Dikush – dikush që e dinte këtë më mirë se të tjerët – pati thënë se kjo kohë ishte mesi i ditës. Mandej, kur dielli ndodhej ende lart dhe ishte akoma i shndritshëm, e urdhëroi Bilalin që të thërriste ikametin e namazit të ikindisë. Me perëndimin e diellit, e urdhëroi Bilalin për ikametin e namazit të akshamit, ndërsa kur u zhduk drita, e urdhëroi për ikametin e namazit të jacistë dhe, pas çdo ikameti, u falën edhe namazet. Të nesërmen, Profeti ynë (s.a.s.) e vonoi namazin e sabahut. Aq sa, pasi mbaruam me faljen, pyetëm njëri-tjetrin: ‘A lindi dielli?’ Namazin e drekës e falëm në (një kohë të afërt me) kohën kur kishim falur namazin e ikindisë së ditës paraardhëse. Namazin e ikindisë e falëm pasi dielli e kishte humbur shkëlqimin e tij dhe që zverdhur, kurse namazin e akshamit, pak para se drita në horizont të zhdukej. Namazin e jacistë e shtymë derisa kaloi një e treta e parë e natës. Ditën tjetër, i Dërguari i Allahut (s.a.s.) e thirri në mëngjes personin që kishte bërë pyetjen dhe i tha: ‘*Ja pra, kohët e namazeve janë mes këtyre dy kohëve.*’²⁴⁷

Shkurtimisht, ashtu siç ka vazhduar deri më sot falja e pesë namazeve ditore në atë mënyrë që na e ka mësuar Profeti ynë (s.a.s.), po ashtu kanë vazhduar edhe pesë kohët e namazit. Prandaj, siç janë të rëndësishme për ne pesë namazet ditore, e rëndësishme është edhe falja e tyre në kohë. Thënë ndryshe, siç është farz falja e namazit, farz është edhe falja e tij në kohë; ashtu siç është haram braktisja e namazit, haram është edhe lënia e faljes së namazit për në një kohë tjetër të papërcaktuar. Për rrjedhojë, të gjitha namazet duhen falur brenda kohëve të përcaktuara nga Pejgamberi ynë (s.a.s.). Kur sahabët e pyesin Atë në lidhje me veprat më të virtytshme, si një nga tri gjërat që u numëron atyre Profeti ynë është falja e namazit në kohën e vet.²⁴⁸ Pra, do të thotë se koha, nëpërmjet namazit, ndriçohet dhe merr vlerë. Si

²⁴⁷ Muslim, mesáxhid 178; Ebu Dáúd, salát 2; Nesái, meuákít 15.

²⁴⁸ Buhárí, meuákít 5, xhihad 1, edeb 1, teuhíd 48; Muslim, ímán 138-140.

vepër të dytë të virtytshme, Profeti (s.a.s.) përmend të qenit i sjellshëm dhe bujar ndaj prindërve. Ndërsa vepra e tretë më e virtytshme është xhahadi në rrugën e Allahut. Domethënë, këto vepra janë të barabarta me njëra-tjetrën.

2. Urtësitë e caktimit të namazit në pesë kohë të ditës

Ne vërejmë se në pesë namazet, që Allahu i Madhëruar i ka ndarë në pesë kohë të caktuara të ditës, Kurani, gjithësia, njeriu dhe adhurimet e tij janë të ndërthurura me njëra-tjetrën. Libri i universit, njeriu, që është bërthama dhe një shembull në miniaturë i universit, dhe Kurani, i cili është përkthyesi i universit dhe njeriut, ndërthuren në namaz dhe janë si tri fytyra të një gjëje të vetme. Robi, që është një përmbledhje dhe një model i vogël i gjithë universit, del i përlur para Zotit me Kuranin, që është përkthimi i librit të gjithësisë, dhe me *Fatihane*, e cila është një përmbledhje e Kuranit, dhe kryen namazin, që është një përmbledhje e të gjitha adhurimeve dhe robërisë së tij ndaj Zotit.

Për ta shtjelluar pak më shumë këtë temë, mund të themi se njeriu është një indeks i universit, i krijuar në emër të Emrave dhe Atributeve Hyjnore. Të gjitha botët janë të fshehura tek ai, i gjithë universi brenda tij është ngjeshur. Pra, gjithësia, rresht pas rreshti, tek ai është shkruar; ashtu siç është shkruar i gjithë Kurani në fjalëzën '*já sín*'. Një sy i kujdesshëm dhe i vëmendshëm mund ta lexojë të gjithë universin te njeriu, mund t'i vërejë tek ai të gjitha kuptimet e tij. Sërish, përmbledhja e të gjithë librave është Kurani; të gjithë librat e tjerë të shenjtë, si Teurati, Zeburi, Inxhili (Ungjilli), janë të përmbledhur në librin e Kuranit; të gjithë libërthat dhe fletët që u janë zbritur profetëve të mëparshëm, emocionet e zemrave të tyre dhe frymëzimet që u ka mundësuar Allahu janë të përfshira në Kuran. Kurse Kurani, i gjithi është i përmbledhur te surja *Fatiha*. Për këtë arsye, shumë komentues të Kuranit kanë vënë theksin te kuptimet që përfshin *Fatihaja* dhe te mësimet që ajo jep dhe, deri më sot, kanë paraqitur vëllime të tëra veprash në këtë drejtim. Dhe, në këtë mënyrë,

na e kanë bërë të qartë se *Fatihaja* është në çdo aspekt një përmbledhje e Kuranit Famëlartë.

Për rrjedhojë, *Fatihaja* e kënduar në namaz merr trajtën e një gjuhe që shpreh të gjithë përmbajtjen e Kuranit. Me të i shprehim ne të gjitha përmendjet, lavdërimet, falënderimet, lartësimin dhe tekbirot që i bëjmë Allahut, nëpërmjet saj përpiqemi t'ia paraqesim Atij adhurimet dhe robërinë tonë ndaj Tij. Pastaj sigurisht, për të mos dalë gënjeshtarë në të gjitha këto, duke thënë “Zoti im! Ne nuk jemi hipokritë që nuk e bëjnë atë që thonë; për t'i vulosur ato çfarë kemi shprehur me gjuhë, do të shkojmë në mesxhid dhe do të vëmë kokën në sexhde. Do t'i vëmë vulën gojës sonë nëpërmjet agjërimit, gjatë netëve do të braktisim shtretërit e ngrohtë dhe do t'i bindemi ajetit *'Ata ngrihen nga shtrati, i luten Zotit të tyre me frikë e shpresë dhe japin nga ajo që iu kemi dhënë Ne.'*²⁴⁹”, do t'i tregojmë e vërtetojmë me gjendjen dhe veprat tona. Sepse gjuha është përkthyesja e zemrës, ndërsa veprat, dëshmia e gjuhës. Nëse ka dëlirësi në zemër, ajo do të gjejë ekuivalentin e saj edhe te gjuha; nëse ajo që thuhet me gjuhë është e drejtë, do të pasqyrohet edhe në vepra. Është e pamundur që këto tri gjëra të ndahen nga njëra-tjetra.

Po, robi, që është përmbledhja e universit, vjen para Allahut nëpërmjet miraxhit të namazit, që është një përmbledhje e të gjitha adhurimeve, dhe me *Fatihane*, e cila është përmbledhja e të gjithë Kuranit. Kështu, universi pasqyrohet tek ai si një libër i mbështjellë dhe i bërë rul. Këtë mund ta shprehim edhe në këtë mënyrë, me një gjuhë më të kuptueshme: Ashtu siç ekzistojnë orët me akrepat që numërojnë sekondat, minutat dhe orët, imagjinoni sikur të ekzistonte një orë e atillë, akrepat e së cilës do të tregonin vitet, jetët e njerëzve dhe jetëgjatësinë e universit. Secili akrep i saj do të bënte ‘tiktak’ sa herë të plotësohej koha e përfaqësuar prej tyre. Kur të lëvizte njëri nga akrepat, do të lëviznin edhe akrepat e tjerë. Ja, pra, një orë e tillë e Allahut është gjithësia; ndërsa gjërat dhe ngjarjet rrjedhin në kohë siç vërshon uji gjatë një përmbytjeje, akrepat e një ore të këtillë vazhdojnë

²⁴⁹ Surja Sexhde, ajeti 16.

të lëvizin, duke bërë kështu që ora të mirëfunksionojë. Ajo ka akrepa që tregojnë ditët, javët, muajt dhe vitet; tiktaket e tyre dëgjoen sa herë mbushet koha që përfaqësojnë ato. Ne, kur shikojmë në atë orë të madhe akrepin që tregon vitet, besojmë se ekziston edhe një akrep që tregon jetëgjatësinë e njeriut, brenda nesh krijohet përshtypja se edhe ai është duke lëvizur. Do të vijë një ditë kur sekreti i ajeteve **“Çdo gjë që është në Tokë do të zhduket, do të mbetet vetëm Fytyra (Qenia) e Zotit Tënd, plot Madhëri dhe Nderim.”**²⁵⁰ do të shfaqet; të gjitha orët do të ndalen, tiktaket e çdo gjëje që punon do të pushojnë së rrahuri. Atë ditë, vetëm Allahu do të mbesë, vetëm Ai do të flasë, vetëm Ai do të dëgjojë, Ai do të sundojë. Kështu që, njeriu do të jetë në gjendje të vazhdojë të ekzistojë në një trajtë të panjohur tani për tani, por që do të varet nga lidhja dhe raporti i tij me Allahun. Sepse prej Allahut erdhi dhe tek Ai do të kthehet.

Në Hutben e Lamtumirës, i Dërguari i Allahut (s.a.s.) thotë: *“Koha, duke u rrotulluar vazhdimisht, gjeti sërish rendin që kishte në ditën kur Allahu krijoi tokën dhe qiejt. Viti ka dymbëdhjetë muaj.”*²⁵¹ Në fakt, edhe pse merrnin për bazë kalendarin hënor, për shkak të një praktike të quajtur ‘nesi’, të cilën e kryenin me qëllimin që stinët e tregtisë të përputheshin me muajt haram, mushrikët e periudhës së injorancës e patën bërë lëmsh radhën e muajve, për rrjedhojë, edhe kalendarin. Kështu, kjo situatë u bë shkak edhe për ngatërrimin e haremeve dhe hallalleve, që Zoti i Madhëruar kishte përcaktuar në lidhje me kohën. Sepse, ashtu siç kishte një kohë në botën normale, edhe makrobota e kishte një rend dhe orën e saj funksionale. Ja, pra, në shoqërinë nga ku kishte dalë i Dërguari i Allahut (s.a.s.), këto dy kohë nuk ishin në përputhje me njëra-tjetrën. Me përmbushjen e jetës së tij profetike në Hutben e Lamtumirës, duke u thënë besimtarëve se koha kishte hyrë në shinat e duhura, Profeti ynë (s.a.s.) i informoi ata edhe në lidhje me këtë temë. Pra, përkarshi kohës së botës së madhe, edhe koha e botës së vogël kishte filluar të funksiononte si një zemër që rreh në

²⁵⁰ Surja Rahman, ajetet 26-27.

²⁵¹ Buhári, fiten 8; Muslim, haxh 147.

harmoni; koha e shprehur në orë, minuta dhe sekonda në botën e vogël korrespondonte me vitet, javët dhe ditët e botës së madhe. Brenda këtij sekreti të përpiktë duhet parë edhe sekreti që bartin pesë kohët e namazit.

Po, një kohë po rrjedh në makrobotë, një kohë që, si një shigjetë që po i hollohet maja gjithnjë e më shumë, vjen deri te ne dhe, pastaj, shndërrohet në orë, minuta e sekonda. Madje kjo vijë bëhet aq e hollë në mikrobotë, aty ku shqisat tona dalin jashtë loje, saqë detyrohemi ta shprehim atë me të dhjetat apo të qindtat e sekondës. Për shembull, është e pamundur të matet me orë dore shpejtësia e lëvizjes së elektroneve rreth e rrotull bërthamës. Në të njëjtën mënyrë, ora e dorës mbetet shumë e vogël përballë matjes së kohës së nevojitur në rrotullimet e hënës, diellit apo planeteve. Prapëseprapë, të qindtat e sekondës na japin myzhdenë e sekondave, minutave dhe orëve; këto të fundit, atë të ditëve dhe javëve; ditët dhe javët, atë të muajve dhe viteve; ndërsa muajt dhe vitet, atë të jetëgjatësisë së njerëzve dhe universit. Kështu, kur të shikoni lëvizjen e akrepit të sekondave në orën tuaj të dorës, do të shihni rrotullimin e Diellit brenda Rrugës së Qumështit, do të ndieni orbitën tek i afrohet çarkut tuaj të exhelit dhe do të vëreni se si po i fut duart në jetëgjatësinë e shtresës njerëzore. Dhe, mes gjithë këtyre ndjesive, do të sillni në mendje ditën kur do të ndalet edhe zemra e gjithësisë, kur do të marrë fund gjithçka. Ja, pra, nëpërmjet një botëkuptimi të këtillë, do ta kemi më të lehtë ta kuptojmë atë që na tregon koha e namazit të sabahut, atë që na tregon koha e namazit të drekës, atë që thotë koha e ikindisë, atë që na shpjegojnë kohët e namazeve të akshamit dhe jacisë.

a. Kuptimi i kohës së namazit të sabahut

Me zbardhjen e ditës, ne hyjmë në kohën e sabahut të gëzuar e gjithë harë për vetë faktin e arritjes së një dite të re e të shndritshme dhe themi se edhe ne patëm lindur dikur njësoj siç po lind kjo ditë. Kjo ditë e re na njofton edhe për ditën e ngjizjes sonë në barkun e

nënës, edhe për ditën e parë të krijimit të gjithësisë në gjashtë ditë. Ne ngjitemi nëpër një shirit të caktuar drejt orës së madhe, pra, nga agu i një dite që po lind mbi kokat tona, në çastin e ngjizjes sonë në barkun e nënës, nga aty, kalojmë në ditën e parë të krijimit të gjithësisë dhe kujtojmë krijimin e këtyre ditëve nga ana e Allahut për të na e mbushur prehrin me mirësitë e Tij të pafund. Pastaj, pavarësisht largësisë sonë ndaj Tij, duke dëshiruar që Ai të jetë pranë nesh me afërsinë e Tij, dalim para Allahut për ta përmendur, lartësuar dhe lavdëruar Atë. Ja, pra, ç'adhurim me vend është namazi i sabahut i kryer brenda një botëkuptimi të këtillë!

Bediuzaman Said Nursi, në lidhje me namazin e falur në një kohë të tillë, shprehet kështu: *“Për nga natyra, njeriu është shumë i dobët. E megjithatë, të shumta janë gjërat që e prekin atë, e dëshpërojnë dhe e pikëllojnë. Ai është shumë i brishtë gjithashtu. Por, pavarësisht kësaj, belatë dhe armiqtë e tij janë po aq të shumtë. Ai është shumë i varfër. Ama edhe nevojat e tij janë me të vërtetë të shumta. Ai është gjithashtu dembel dhe i pafuqishëm. Por, nga ana tjetër, përgjegjësitë e jetës janë goxha të rënda. Të qenit njeri e ka bërë atë të jetë i lidhur me të gjithë universin. Mirëpo, ndarja nga gjërat që do dhe me të cilat është mësuar e ka krijuar miqësi dhe zhdukja e tyre e lëndojnë vazhdimisht. Mendja i tregon atij qëllime të larta dhe fruta të përhershme. Por, çë do, duart i ka të shkurtra, jetën të shkurtër, fuqinë të pamjaftueshme dhe durimin të pakët. Kështu, mund të kuptohet qartë se sa shumë e nevojshme është për shpirtin që, në kohën e mëngjesit të hershëm (fexhr), të trokasë me dua dhe namaz në derën e të Plotfuqishmit Madhështor, të lutet e të përgjërohet në derën e Mëshirëplotit Hirplotë, t'i paraqesë Atij gjendjen në të cilën ndodhet dhe të kërkojë prej Tij ndihmë e sukses; mund të kuptohet qartë se ç'pikëmbështetje e nevojshme është kjo për të, që të jetë në gjendje t'i durojë ato që do t'i ndodhin gjatë ditës në vazhdim dhe punët, detyrat që do t'i ngarkohen mbi shpinë.”*²⁵²

²⁵² Bediuzamani, Fjalët, fq 63-64 (Fjala e Nëntë, Pika e Pestë).

b. Kuptimi i kohës së namazit të drekës

Koha e drekës është çasti kur dita arrin pjekurinë e saj. Për rrjedhojë, në drekë dita ka ardhur në pikën kur pema jep frutat e saj. Koha e drekës ngjan gjithashtu me çastin kur akrepi i jetës së një njeriu tregon vitet e tij të rinisë. Në çastet e krijimit të gjithësisë, ajo tregon krijimin e babait tonë Adem (a.s.), profetit të parë, fillimin e periudhës gjatë së cilës do të kuptohet kuptimi i krijesave dhe fillimin e kohës në të cilën vullneti do të kuptojë kuptimin e gjërave dhe ngjarjeve. Pra, nëse do t'i ndiqnim në rresht kuptimet e kohës së namazit të drekës, do të kalonim nga rinia jonë në pjekurinë e ditës, nga pjekuria e ditës në pjekurinë e ditëve të gjithësisë dhe nga kjo e fundit në lartësimin e Adem (a.s.) për të mirësia e të qenit një bashkëbisedues i Allahut. Të dalësh në kohën e drekës para Allahut për ta falënderuar për të gjitha këto, të qëndrosh para Tij duarlidhur dhe i përlur, të thuash “O Ti, që na i ke mbushur pëqinjte me xhevahire mirësish që nga krijimi i Adem (a.s.) e deri në vaktin e drekës së kësaj dite! O Allahu im! Kam ardhur të fal namazin e drekës, që të të falënderoj Ty dhe të shpreh veprimtarinë Tënde madhështore!” dhe t'i shprehësh këto me fjalët ‘*Subhánalláh*’, ‘*Elhamdulil’láh*’ dhe ‘*Alláhu Ekber*’... Të gjitha këto nuk përbëjnë gjë tjetër veçse një adhurim plot urtësi e përfitime.

Po, koha e drekës na kujton çastin kur punët e përditshme fillojnë të rëndohen dhe mirësitë e Allahut arrijnë kulmin. Në këtë kohë, njeriut i bëhet sikur është duke u mbytur nga shqetësimet e punëve të asaj dite. Kështu që, për t'i lënë mënjanë këto shqetësime dhe për të shpëtuar prej tyre nga njëra anë, nga ana tjetër, që ta falënderojë Zotin për mirësitë e panumërta, të mundësuar deri në atë orë të ditës, vrapon drejt mesxhidit dhe, duke u shkëputur përkohësisht nga punët e kësaj bote, gjen rastin për të marrë frymë lirshëm. Duke thënë “O Allahu im! Ti je i Madhi, kurse i vogli jam unë!”, shpreh edhe një herë dobësinë dhe varfërinë e tij. Pastaj kalon në ruku, e cila nënkupton fjalët “Të gjitha gjymtyrët e mia përkulen para madhësisë Tënde.”, dhe, në fund, ulet në sexhde. Të gjitha këto janë një pushim dhe një frymëmarrje e atillë për shpirtin, saqë, po të ishte njeriu në gjendje të

dëgjonte me të vërtetë shpirtin dhe të mbante vesh rrahjet e zemrës së tij, do të ndiente në namaz çlirimin e nxënësit që ka dalë në pushim pas një ore të mërzitshme mësimi.

Vrapimi drejt mesxhidit në kohën e drekës, atëherë kur nxehtësia e madhe e saj, për të cilën Profeti ynë (s.a.s.) ka thënë “*I nxehti i madh është një fryrje e Xhehenemit.*”²⁵³, të godet në kokë, bart freskinë e mbështetjes tek Allahu dhe të strehimit në hijen e Tij në atë ditë kur nuk do të ketë asnjë hije tjetër; vrapimi drejt mesxhidit në kohën e drekës bart freskinë e hyrjes nën flamurin e Profetit tonë Famëlartë e Bujar (s.a.s.).

Po, ardhja në këtë kuptim për në namazin e drekës do të thotë të braktisësh përkohësisht anën trupore dhe t’ia vësh veshin britmës së zemrës, të dëgjosh terminologjinë e shpirtit. Dhe kjo është vetë paqja, lumturia.

c. Kuptimi i kohës së namazit të ikindisë

Koha e ikindisë është koha kur dielli fillon të tregojë një anim drejt perëndimit. Për rrjedhojë, kjo kohë na kujton çastin e plakjes së njerëzimit dhe, bashkë me lindjen e profetit të fundit, Krenarisë së Gjithësisë (s.a.s.), perëndimin e tij. Kur po kryejmë namazin e ikindisë, ne kuptojmë se çdo gjë është gati në të përnduar dhe se, brenda disa orësh, gjithçka gjendet mbi sipërfaqen e tokës do të zhduket. Kuptojmë gjithashtu se edhe ne, me dhimbjet e belit, sëmbimet te këmbët dhe thinjat në kokë, jemi të përkohshëm këtu dhe se po i afrohemi dalëngadalë fundit. Pikërisht në këtë kohë, kur jemi thuajse duke rënë në dëshpërim e në një gjendje të pashpresë, dëgjojmë thirrjen e ezanit dhe, duke u gëzuar për faktin se e gjetëm më në fund mënyrën për ta shndërruar në të përhershme këtë jetë të përkohshme, vrapojmë drejt faljes së namazit gjithë harë.

Kjo kohë na tregon gjithashtu edhe për shekullin e Pejgamberit tonë

²⁵³ Buhári, meuákít 9-10, bed’ul halk 10; Muslim, mesáxhid 180-184, 186.

të dashur. I Dërguari i Allahut (s.a.s.) thotë se Ai vetë është dielli i ikindisë dhe, për të bërë një krahasim mes umetit të Tij dhe popujve të mëparshëm, shprehet në këtë mënyrë: *“Në krahasim me popujt që kanë jetuar para jush, vazhdimësia juaj është si koha mes ikindisë dhe perëndimit të diellit. Njerëzve të Teuratit iu dha Teurati, ata vepruan sipas tij deri në mes të ditës. Nuk mundën të vazhdonin më tej. Ata e morën shpërblimin e tyre me karatë. Pastaj, iu dha Inxhili njerëzve të Inxhilit. Edhe ata vepruan sipas tij deri në kohën e namazit të ikindisë. Por as ata nuk patën fuqi për të vazhduar edhe më tej. Edhe ata u shpërblyen me karatë. Ne u shpërblyem me nga dy karatë. Ndjekësit e dy librave të parë thanë: ‘O Zoti ynë! Ti u dhe këtyre nga dy karatë. Kurse neve na pate dhënë nga një karat. Mirëpo, ne jemi më lart se ata në vepra!’ Allahu (xhel’le xheláluhu) tha: ‘A ju kam bërë ndonjë padrejtësi në shpërblimin tuaj?’ ‘Jo!’ thanë ata. Allahu tha: ‘Atëherë, kjo mirësi është e Imja, ia jap atë kujt të dua.’”²⁵⁴*

Pra, Shekulli i Lumturisë është lajmëtar i rrugëtimit të njerëzimit drejt fundit të tij. Duke qenë se Profeti ynë Bujar (s.a.s.) është profeti i fundit, është e qartë se jetëgjatësisë së njerëzimit nuk i ka mbetur dhe shumë kohë; ashtu siç kujtojmë me diellin e ikindisë pleqërinë tonë, po ashtu këtë gjë na sjell në mendje edhe Shekulli i Lumturisë. Ja, pra, në këtë kohë të ditës, të mërztur e të trishtuar përballë këtyre ngjarjeve të njëpasnjëshme që na vijnë në mendje apo të gëzuar për vetë faktin se do të kalojmë në botën tjetër dhe se do të jemi në gjendje të përfitojmë nga begatitë e Xhenetit, pak rëndësi ka kjo, dalim para Allahut dhe kryejmë namazin e ikindisë. Në Kuran, në suren *Asr*, Allahu betohet për këtë kohë. Ne, duke vrapuar për të dalë para Zotit në një kohë të tillë, mbi të cilën edhe vetë Zoti është betuar, sikur po kërkojmë një mënyrë për t’i bërë të përjetshme gjërat që rrjedha përmbytëse e vdekjes dhe asgjësimit është duke i marrë para. Fjalët *‘Alláhu Ekber’*, të cilat lartësohen nga minaret e xhamive, na japin frymë e na rigjallërojnë.

²⁵⁴ Buhárí, meuákítus’salát 17; enbijá 50; fedáílul Kur’án 17; teuhíd 31, 47; Tirmidhí, edeb 82; Ahmed ibn Hanbel, el Musned 2/121, 124, 129.

d. Kuptimi i kohës së namazit të akshamit.

Koha e akshamit është një moment perëndimi; dita mbaron, perëndon dielli dhe, kështu, ne futemi në një pjesëz të veçantë kohe. Kjo gjendje, bashkë me mbarimin e një dite njëzetekatërorëshe, na njofton edhe për vdekjen tonë. Sepse do të vijë një ditë dhe ne do të vdesim, do të mbështillemi me një qefin dhe do të futemi në varr me duar, këmbë dhe nofulla të lidhura. Pasi të ngulin një çift gurësh te kokat tona dhe të largohen që aty familjarët, të afërmit dhe miqtë tanë, do të mbesim aty vetëm.

Nga ana tjetër, kjo kohë na tërheq vëmendjen edhe për te përpëlitjet dhe rënkimet e tokës në agoninë e saj. Perëndimi i diellit na kujton faktin se, një ditë, çdo gjë që lind do të perëndojë, do të perëndojnë të gjitha sistemet. Po ashtu, na sjell në mendje edhe ajetet e Kuranit Famëllartë: ***“Kur Dielli të mblidhet e të humbë shkëlqimin, kur yjet të rrëzohen dhe malet të lëvizin tutje...”***²⁵⁵ Për të ngushëlluar zemrat tona të trishtuara përballë këtij tmerri dhe për të bërë të mundur qetësimin edhe një herë të shpirtrave tanë, vrapojmë drejt namazit të akshamit.

Po, koha e akshamit është ose shprehje e dëshpërimit dhe të qarave te koka e një perëndimi, ose shprehje e përjetimit të entuziazmit për ta bërë të begatë gjendjen tonë në botën tjetër. Ezanet që dëgjohen edhe në këtë kohë, në kohën kur çdo gjë është duke i thënë ‘lamtumirë’ njëra-tjetrës, duke kënduar këngë ndarjeje dhe duke dëshiruar të shprehet në lidhje me zemrën e saj të thyer, na japin lajmin e një agimi të ri brenda këtij perëndimi; me vdekjen, ne përjetojmë në shpirtrat tanë një ringjallje dhe ekzistencë të re e plot gjallëri. Me fjalë të tjera, ezani që këndohet në këtë kohë është si zëri që do të dëgjohet në ditën e kiametit, kur Israfil i fryjë Surit; ky ezan sikur thotë “Ka ringjallje dhe dalje para Allahut!”.

Do të thotë gjithashtu që t’i drejtohesh Allahut të Përjetshëm, të Pafillim e të Pafund, me fjalët “Unë nuk mund të jem i kënaqur me ata që perëndojnë e ikin, me ata që, edhe pse i kam shokë e miq, nuk janë

²⁵⁵ Surja Tekuúr, ajetet 1-3.

me mua gjatë gjithë kohës.”, ashtu siç pati thënë edhe Ibrahim (a.s.): **“Nuk i dua ata që perëndojnë.”**²⁵⁶ Sepse Allahu (*xhel’le xheláluhu*) është *Ehad* dhe *Samed*, është Ai që ndez shkëndijën e ekzistencës në mosekzistencë; Ai i bën të perëndojnë ata që janë të perëndueshëm, Ai i zhduk ata që janë të dënuar me zhdukje. Allahu është përsëri Ai që, me forcën e Tij të pafund, do ta kthejë mosekzistencën në ekzistencë, do t’i kthejë në jetë zemrat e vdekura dhe do t’iu mundësojë sërish dashurinë dhe emocionet edhe pasi të kenë vdekur dashuria dhe entuziazmi i tyre, edhe pasi të jetë fshirë çdo gjë nga mendjet, edhe pasi të jetë shkatërruar gjithçka.

e. Kuptimi i kohës së namazit të jacistë

Koha e jacistë është koha kur muzgu i mbrëmjes zhduket dhe qielli errësohet plotësisht. Është koha kur nga dielli nuk mbetet më asnjë shenjë. Në këtë kohë nuk ka asgjë që mund të na japë ndonjë ide në lidhje me ekzistencën e një dite të lënë pas. Sepse dita, pasi qe larguar, ia pati lënë gjurmët të kuqerremtës së qiellit në kohën e akshamit dhe i pati kërkuar që ta kujtonte edhe për pak kohë. Me ikjen e kohës së akshamit ikën dhe mbaron edhe çdo gjë tjetër.

Koha e jacistë, bashkë me mbarimin e gjithçkaje, i kujton njeriut edhe mbarimin e jetës dhe zhdukjen e tij. Vdekja është diçka tjetër; kur njeriu vdes, lë pas dikë që qan për vdekjen e tij, dikë që i priten gjunjët gjatë faljes së namazit të xhenazes dhe dikë tjetër që e humb fare toruan. Por, pasi kalon një periudhë e caktuar kohore, nga mendjet e njerëzve fillojnë të fshihen edhe kujtimet në lidhje me atë person. Ndërsa shpirtrat, për sa i përket kuptimit të personit të vdekur, fillojnë të ndihen të zbrazët. Dhe, ashtu siç thuhet edhe në një ajet të Kuranit Famëllartë, personi që vdes ikën e harrohet krejt.²⁵⁷ Ka shumë njerëz që prindërit apo të afërmit e tyre të vdekur i kujtojnë vetëm në të shtatat,

²⁵⁶ Surja En’ám, ajeti 76.

²⁵⁷ Surja Merjem, ajeti 23.

të dyzetat ose pesëdhjetë e dy ditë pas vdekjes. Qajnë për ta, ose bëjnë ndonjë vepër të mirë në emër të tyre. Do të thotë se, me kalimin e viteve, një njeri i vdekur duket sikur nuk ka jetuar kurrë.

Ja, pra, koha e jacisë i kujton njeriut çastin kur do të mbarojë gjithçka, çastin kur do të mbesë në varr i privuar nga çfarëdolloj drite. E vetmja gjë që mund të bëjë një rob i rrënuar emocionalisht, me ndjenjat të kthyera përmbys dhe me zemrën të thyer në këtë mënyrë, është të vrapojë drejt Zotit të tij në kohën e namazit të jacisë e t'i lutet Atij për ngushëllim që në atë minutë, në mënyrë që ajo qetësi shpirtërore t'ia ndriçojë natën, dimrit të tij t'i japë një atmosferë pranvere, yjet e rëna e të shpërndara andej-këtej t'ia gozhdojë edhe një herë në qiellin e tij dhe jetën, që në ato momente anon drejt shuarjes, t'ia bëjë fillim të një jete të re. Kjo është e vetmja gjë që duhet të bëjë robi në ato çaste, të thotë “U rraskapitëm dhe morëm fund këtu, por ky përëndim bart sihariqin e një lindjeje. Kështu siç po vdesim, kështu edhe do të ringjallemi.” dhe, me këto ndjenja, të lejojë që sexhadja e tij ta puthë atë në ballë.

Lartësimi i emrit të lartë të Allahut nga minaret e xhamive në një kohë të tillë, do të lëshojë dritë edhe në jetën e varrit të atij njeriu, i cili pret që t'i këndojnë një *Fatiha*, që ta përmendin e ta kujtojnë me lutje dhe që t'i kumtohet lajmi i mirë i faljes, madje, do t'i ndriçojë atij edhe botën tjetër. Kështu, ai do të shikojë se nuk është i vetëm brenda egërsisë së varrit. Do të shikojë se veprat e tij të mira e kanë ndjekur deri aty dhe adhurimet që ka bërë, veçanërisht namazi, do t'i shfaqen në të djathtë, në të majtë, para dhe mbrapa, do të shfaqen aty për të dhe do t'i bëjnë shoqëri. Por, përtej këtyre, në ato çaste kur errësira do ta rrethojë nga të gjitha anët, kur varri do ta shtrëngojë derisa kockat t'i ngjeshen pranë e pranë njëra-tjetrës dhe kur do të mbesë i pagjuhë përballë pyetjeve të Munkerit dhe Nekirit, ai do të shohë se Zoti i tij, të Cilin e ka më pranë vetes se të gjithë miqtë e tij, do të jetë duke e pritur me mëshirën e Tij të pafund, si të ishte i vetmi Mik i vërtetë për të.

f. Errësira e natës dhe tehexhudi

Errësira e natës, përveçse të kujton çastin e humbjes së shpresave, të mbetjes pa frymë dhe me duar e këmbë të lidhura përballë tmerrit të varrit, të kujton edhe kohën kur do të shkatërrohet i gjithë ky univers. Përballë këtij tmerrit të varrit, njeriut i bëhet sikur të ketë rënë brenda një makthi; dëshiron të flasë, por nuk flet dot. Nuk i lëviz dot as duart, as këmbët. Bërtet, por askush nuk ia dëgjon të bërtiturën... Dhe, në atë gjendje, nuk i mbetet gjë tjetër për të bërë përveçse vënies në pritje të kaderit të tij.

Ç’veprim i shndritshëm, frytdhënës dhe i bereqetshëm është ngritja për të falur namaz pikërisht në këtë kohë, për të lënë një ‘Ah!’ në errësitat e natës, për të ndriçuar natën e errët, për të ndriçuar të gjithë jetën... Vetëm ai që është njeri mund ta kuptojë këtë.

Kurani qëndron me këmbëngulje në çështjen e adhurimeve të natës dhe i drejtohet Profetit tonë (s.a.s.) me fjalët **“O ti i mbuluar (O Muhamed)! Çohu (të falesh) gjithë natën, përveç një pjese të saj, që është gjysma ose diçka më pak a diçka më shumë se ajo, dhe lexoje Kurandin ngadalë dhe qartë.”**²⁵⁸ Dhe, duke thënë **“Natyrisht, adhurimi natën vepron më fuqishëm dhe fjala është më shprehëse, ngaqë ti je vërtet shumë i zënë ditën.”**²⁵⁹ menjëherë pas këtyre ajeteve, sikur po ia përcakton Pejgamberit tonë (s.a.s.) kohën kur duhet t’i drejtohet Allahut të Madhëruar.

Kurse në një ajet tjetër, Zoti urdhëron kështu: **“Kaloje një pjesë të natës si falje shtesë për ty (o Muhamed)! Është e vërtetë se Zoti yt do të të vendosë ty në një vend të lavdëruar.”**²⁶⁰

Shtjellimi i këtij ajeti do të ishte kështu: “Kjo gradë (*Mekâmi Mahmúd*) nuk arrihet me hutesë, duke qenë i shkujdesur, duke u marrë me gjëra të tjera, duke u rrotulluar brenda shtratit të ngrohtë; ajo mund të arrihet vetëm nëpërmjet kokës që puth sexhaden dhe pikave të lotit

²⁵⁸ Surja Muzzemmil, ajetet 1-4.

²⁵⁹ Surja Muzzemmil, ajetet 6-7.

²⁶⁰ Surja Isrá, ajeti 79.

që do të derdhësh mbi të.” Kurse Profeti ynë (s.a.s.), duke u përlur para këtyre urdhrave e porosive të Zotit me një ndjeshmëri të lartë e serioze, duke ia kthyer shpinën ndjenjave dhe dëshirave trupore edhe në çastet më të këndshme të jetës, u lartësua në gradat më të larta të zemrës dhe shpirtit. Nëpërmjet një hadithi të transmetuar nga Aishja (r.a.), na bëhet e ditur se Ai (s.a.s.) qëndronte në këmbë dhe kryente adhurime gjatë natës derisa i ënjtëshin këmbët. Kur i patën thënë “Allahu t’i ka falur Ty gjynahet e kaluara dhe ato të së ardhmes (përse e torturon veten në këtë mënyrë?)”, Ai që përgjigjur kështu: “A të mos jem unë një rob falënderues?”²⁶¹ Poeti Busiri, kur e shpjegon këtë situatë në Odet e Lavdërimit (*Kasídei Burde*) me fjalët “Unë kam vepruar në kundërshtim me sunetin e atij Profeti Famëlartë (s.a.s.), i Cili nuk binte të flinte pa iu ënjtur këmbët, pa i dhënë nur errësirës së natës.”²⁶², fajëson veten sikur të ishte duke thënë “Ndërsa unë, unë fle duke u rrotulluar në shtrat sa në një anë në tjetrën dhe duke e shijuar në maksimum gjumin...”

Po, nëpërmjet namazit të natës, njeriu ndërton një marrëdhënie me Allahun, bashkëbisedon me Të dhe fiton pozitën e të qenit mik i Tij. Namazi i natës është një nder për besimtarin; besimtari përmes tij arrin të përfitojë nga mirësitë dhe begatitë e Zotit. Kur ngrihet për të dalë para Zotit të tij me qëllimin për të bashkëbiseduar me Të, për më tepër, në një kohë kur të gjithë janë pranë të dashurve të tyre, njeriu nderohet në një mënyrë të atillë, saqë asnjë nderim tjetër nuk mund të matet me të. Sot, jemi të detyruar t’i rifitojmë sërish ato gjëra që janë një domosdoshmëri e humanizmit tonë, por që, për fat të keq, i kemi humbur. Është kusht që, për ta ndier këtë si një detyrë madhore fillimisht dhe, më pas, për ta përmbushur atë, të mbështetemi tek Allahu, të strehohemi te mëshira e Tij. Ashtu si ushtarët, të cilët, duke u mbështetur te forca dhe fuqia e Sulltanit, marrin peng edhe shahët e mbretërit, edhe ne do t’i zgjidhim të gjitha problemet tona nëpërmjet lidhjes sonë me Të. Sepse vetëm në sajë të mbështetjes tek Ai mund të lëvizim nga vendi edhe malet, duke iu mbështetur Atij mund të hiqim

²⁶¹ Buhárí, *tehexh Hud* 6; Muslim, *sifátul munáfikín* 79-81.

²⁶² el Búsírí, *Díuánul Búsírí* fq. 239.

qafe ortekët e borës dhe vetëm falë forcës dhe fuqisë së Tij mund të përftohen ujëvarat që rrjedhin duke gurgulluar.

Po, pa iu mbështetur Atij, asgjë nuk mund të bëhet. Sot, e ardhmja dhe suksezi i botës Islame varen tërësisht nga kthimi për te Kurani; Allahu i Madhëruar do të na lartësojë e do të na bëjë prej njerëzve të nderuar vetëm nëse do ta përmbushim detyrën e të qenit robër të Tij nën drejtimin e Kuranit dhe duke zënë vend pas Muhamedit Famëlartë (s.a.s.). Përndryshe, dyert ku kemi trokitur do të na përplasen fytyrës, po ashtu edhe kërkesat tona. Dhe poshtëtimeve tona disashekullore do t'u shtohen në zinxhir poshtëtime të reja... Për pasojë, ne, edhe pse kemi qenë dhe vazhdojmë të jemi mes popujve të lavdishëm të Islamit, të cilët e përfaqësuan Atë për nëntë shekuj, nuk do të jemi në gjendje t'i shpëtojmë lypësisë. Sepse Allahu (*xhel'le xheláluhu*) e ka lidhur këtë përparim dhe lumturi tonën me kthimin tek Ai dhe te vetja jonë. Ne do t'i drejtohemi Atij me lutjet tona ditë e natë dhe, me zemrat tona të përvuajtura, do të përpiqemi të sigurojmë vënien në lëvizje të mëshirës së Tij.

Sepse ne, për nga natyra e krijimit tonë, jemi shumë të dobët e të varfër. Por, nga ana tjetër, rrethi i nevojave tona është aq i gjerë sa të përfshijë brenda vetes tokë e qiej. Nëse do të mbështetemi tek Allahu i Plotfuqishëm, do të gjejmë forcën për të plotësuar nevojat tona dhe do të jemi të sigurt nga armiqtë. Fitimin e kësaj force namazi na e mundëson. Një njeri i gjendur brenda një rrethi kaq të frikshëm armiqsh, duke braktisur gjumin, duke dalë i përulur para Zotit dhe duke i hapur duart për t'iu lutur Atij në orët e fundit të natës, çlirohet nga kjo peshë, të cilën e ndien si një plagë në gjoksin e tij. Në të njëjtën kohë, kjo është një situatë aq e begatë, sa për t'u bërë shkak që shpirti të marrë frymë e të relaksohet. Kënaqësinë dhe gëzimin që të mundësojnë adhurimet e natës, njeriu mund t'i ndiejë vetëm nëpërmjet anës së tij engjëllore.

PJESA E PESTË



FRYTET E NAMAZIT

1. Frytet e namazit në aspektin individual

a. Të qetëson zemrën dhe të mundëson një paqe shpirtërore

Namaz do të thotë që njeriu të lajë e të shpëlajë zemrën dhe shpirtin pasi është pastruar nga papastërtitë e jashtme dhe të jetë gati për të dalë para Madhësisë së Allahut. Parë nga ky aspekt, ai është një adhurim i jashtëzakonshëm dhe i veçantë, i cili i mundëson njeriut arritjen e një qetësie shpirtërore. Falë namazit, robi ndihet i sigurt dhe gjen paqe në zemrën dhe shpirtin e tij, por edhe fiton kënaqësinë dhe pëlqimin e Zotit. Një person që nuk është në gjendje të gjejë paqe dhe qetësi në namaz, nuk mund t'i gjejë ato askund. Ai që nuk mund të arrijë në horizontin e paqes së vërtetë përmes rrugës së mesxhidit apo xhamisë, nuk mund të arrijë atje as nëpërmjet ndonjë rruge tjetër. Ne besojmë se njerëzimi do të gjejë paqen dhe qetësinë e vërtetë kur të gjithë njerëzit t'i kthehen plotësisht namazit. Për zemrat që digjen me dëshirën e zjarrtë për të përparuar sa më shumë shpirtërisht, falja e namazit pesë herë në ditë kryen detyrën e shkallëve që të mundësojnë ngjitjen në miraxh pesë herë në ditë dhe arritjen tek Allahu. Për këtë arsye, Profeti ynë (s.a.s.) e ka quajtur namazin 'dritë e syve'.²⁶³ Bashkë me këto fjalë, Ai ka thënë edhe se namazi është ajo gjë që të jep qetësi, të freskon shpirtin dhe, ashtu si një mesazh që të vjen nga larg, ngjall te ti besim e të bën të ndihesh i sigurt.

Në Miraxh, në momentin kur u lartësua për të dalë para madhësisë së Allahut dhe kur po priste me padurim ardhjen e një lajmi të rëndësishëm, namazi i doli para Pejgamberit tonë (s.a.s.) si një surprizë dhe, kështu, u bë farz për umetin e Tij. I Dërguari i Allahut (s.a.s.), pasi hyri në botën e gjallesave duke ndjekur rrugët trupore, u lartësua

²⁶³ Nesáí, ishretun'nísá 1; Ahmed ibn Hanbel, el Musned 3/128, 199, 285.

në fronin e përsosmërisë nëpërmjet rrugës engjëjlore të të qenit rob i Allahut dhe kërkoi prej Tij një mjet shpëtimi për njerëzit e umetit, të cilët po bënin një jetë të kotë në tokë. Kështu, Allahu i Madhëruar i dha atij pesë namazet ditore. Në fillim, urdhri që për pesëdhjetë namaze në ditë, por, me mendimin se kjo do të ishte e papërballeshme për umetin, numri i kohëve të namazit në një ditë u ul në pesë. Allahu ia bëri të ditur të Dërguarit të Tij se, nëse këto pesë namaze do të kryhen me besnikëri, shpërblimi i tyre do të jetë sa për pesëdhjetë.

Ja, pra, pesë namazet ditore të kësaj cilësie u bënë dritë për sytë e Profetit tonë (s.a.s.) dhe ata të pjesëtarëve të umetit të Tij. Ashtu siç u shndritin sytë përballë një lajmi që do t'i lehtësojë përbrenda prindërit që, të mbetur larg fëmijës së tyre, po digjen nga malli për të, po ashtu edhe namazi i lehtëson dhe i qetëson përbrenda besimtarët, i bën ata të ndihen të sigurt.

Po, namazi është një dhuratë që i është dhënë Pejgamberit tonë (s.a.s.) në Miraxh, në kuptimin “U bëftë dritë për sytë e tu!”. Prandaj besimtari, kur lidhet në namaz, përfshihet apo nuk përfshihet ndërgjegjja e tij, i ndien erërat e lëhtësimit që fillojnë të fryjnë brenda tij. Sado të hutuar të jemi, në të shumtën e rasteve, kënaqësinë që ndiejmë gjatë faljes së namazit nuk e ndiejmë në asgjë tjetër. Por, për fat të keq, kjo kënaqësi nuk vazhdon pandërprerë. Që të mos e harxhojmë që në këtë botë shpërblimin e adhurimeve të kryera ndaj Tij, Allahu Mëshirëplotë shumë herë nuk na e mundëson atë kënaqësi. Kur ta ndiejmë ama, dynjanë dhe çdo gjë tjetër përveç Allahut do ta përbuzim sikur të jemi duke e shtyrë me majën e këmbës dhe, ashtu si Junusi, do të themi “Të dua vetëm Ty!”.

Njëren anë të Islamit e përbëjnë urdhrat, ndërsa anën tjetër të tij, ndalimet. Si besimtarë, ne e organizojmë jetën tonë brenda kornizës së këtyre urdhrave dhe ndalimeve dhe përpiqemi ta ruajmë këtë vijë të drejtë nëpërmjet namazeve tona. Në vetvete, namazi është shprehje e gërshetimit me njëri-tjetrin të Emrave dhe Atributeve të Zotit të Madhërishëm dhe, në këtë aspekt, përbën një adhurim gjithëpërfshirës. Ai ka një natyrë urdhëruese, por edhe ndaluese. Mes gjërave për të

cilat jemi urdhëruar t'i kryejmë, namazi është më i rëndi. Në të njëjtën kohë ama, nëse marrim parasysh lidhjen që mundëson mes Allahut dhe robit, mund të themi se namazi ka edhe një anë të ëmbël. Ata, të cilëve u qesh buza me harenë e botës hyjnore, në namaz ndiejnë gjëra që nuk mund t'i ndiejnë në adhurimet e tjera. Prandaj, kur dëgjohet thirrja për në namaz, vrapojnë për tek ai gjithë kënaqësi e entuziazëm. Për besimtarët, kjo situatë është si një proces shpëtimi pesë herë në ditë nga atmosfera mbytëse dhe dëshpëruese e jetës shoqërore, është si një proces shpëtimi që e lejon të marrë frymë lirshëm. Mesxhidet dhe xhamitë shndërrohen në vendet ku bëhen këto frymëmarrje e ku besimtarët lehtësohen, ndërsa tekbiret, tehlilet dhe tahmidet, të cilat lartësohen që aty drejt qiejve, bëhen shkak për tërheqjen e mëshirës dhe faljes së Allahut. Për këtë arsye, shikimet e besimtarit në namaz janë gjithmonë lart. Ai e fillon këtë rrugëtim duke thënë *'Alláhu Ekber'* dhe duke iu drejtuar Zotit Bujar, të Cilin e di dhe e ndien në zemër si një Thesar të Fshehtë.

Një njeri që vjen para Allahut me këto kuptime, hapet ndaj botës së të fshehtave në çdo ajet që këndon. Perdet e syve të tij zhduken një nga një dhe, kështu, fillon t'i vëzhgojë të gjitha veçoritë e Xhenetit dhe Xhehenemit. Po të ngrihen lart perdet e syve të një njeriu, po t'i shfaqen atij flakët e zjarrit brambullues në njërën anë dhe, në anën tjetër, bahçet e Xhenetit, nëse ai njeri i ka dy pare mend në kokë, sigurisht që do ta braktisë rrugën e Xhehenemit dhe do të zgjedhë atë të Xhenetit. Edhe namazi, me kuptimin dhe natyrën e tij, i ngre lart perdet e syve tanë pesë herë në ditë dhe na bën t'i kthejmë shikimet për te bota e kuptimeve.

Ja, pra, ngaqë namazi shpreh të gjitha këto kuptime, zemra gjen qetësi dhe ndihet e sigurt në namaz. Prandaj, në kohën kur i nxehti i drekës fillonte ta humbte intensitetin e tij pak nga pak, Profeti ynë (s.a.s.) i drejtohej Bilalit (r.a.) jo me fjalët "Këndoje ezanin!", po duke i thënë "*Na fresko pak, o Bilal!*"²⁶⁴ Bilali e kuptonte shumë mirë atë që po i kërkohet. Menjëherë pas këtij urdhri, ngjitej në tarracën e mesxhidit

²⁶⁴ Ebú Dáúd, edeb 78; Ahmed ibn Hanbel, el Musned 5/364, 371.

dhe, me thirrjet “*Alláhu Ekber, Alláhu Ekber*”, të cilat do të vazhdojnë kështu deri në përjetësi, e çonte në këmbë Medinen e Shndritshme. Njerëzit vraponin drejt mesxhidit për t’u freskuar, për t’u ndriçuar nga brenda, që zemrat e tyre të gjenin qetësi, për t’u lartësuar drejt qiejve duke fluturuar me botët e tyre të ndjenjave dhe shpirtit. Qëllimi i ardhjes së tyre në mesxhid nuk ishte heqja e një barre nga shpina apo shpëtimi nga një përgjegjësi; ata kishin si qëllim marrjen e ushqimit të shpirtit dhe zemrës, pra, fluturimin lart e më lart nëpërmjet namazit. Edhe ne, në këtë mënyrë do ta shohim thirrjen e muezinit, brenda një atmosfere të këtille do të vrapojmë drejt mesxhidit. Të vetëdijshëm për qetësinë e vërtetë shpirtërore që të mundëson qëndrimi me përulje para Allahut të Madhëruar, do të përpiqemi të kryejmë nëpërmjet namazit miraxhin, të cilin Profeti ynë (s.a.s.) e pati kryer në kuptimin e tij të vërtetë. Dhe kjo, pra, kryerja e namazit duke e ndier atë në këtë mënyrë, është gjëja kryesore. Omeri (r.a.), ngaqë i ndiente në këtë mënyrë namazet, sëmurej e bëhej për shtrat. Kështu ishte edhe Aliu (r.a.). Sipas një transmetimi, që të mund t’ia nxirrnin Aliut shigjetën që i ishte ngulur në trup, qe lidhur në namaz. Sepse, në ato çaste, kuptimet që ndiente në namaz e rrethonin nga të gjitha anët dhe, kështu, nuk e lejonin të ndiente gjë tjetër.

Po, kjo duhet të jetë përmendja e Zotit në përputhje me madhësinë e Tij. Zaten, edhe besimi këtë kërkon. Besimtari, duke jetuar brenda këtij botëkuptimi të thellë, do ta bëjë emrin e Zotit pjesë të çdo çasti të jetës së tij dhe do të jetojë një jetë si ajo e engjëjve. I Dërguari i Allahut (s.a.s.) thotë: “*Xheneti është i rrethuar me gjëra që nuk i pëlqejnë nefsit, kurse Xhehenemi, me gjëra tërheqëse, që nefs i dëshiron.*”²⁶⁵ Rrjedhimisht, duhen përballuar disa vështirësi për të hyrë në Xhenet dhe duhet bërë durim ndaj disa gjërave epshore për të shpëtuar nga Xhehenemi.

Po, përmendja e Allahut, përkujtimi i Tij në çdo moment është një cilësi shumë e lartë. Në çdo namaz të xhumasë, imami na e rikujton këtë duke kënduar ajetin “***Vërtet që namazi të ruan nga shthurja dhe***

²⁶⁵ Buhári, rikák 28; Muslim, xhennet 1.

nga çdo vepër e shëmtuar dhe vërtet që përmendja e Allahut është më e madhja (e adhurimeve)!²⁶⁶ teksa zbret nga minberi. Për një besimtar të vërtetë, harrimi i Allahut është diçka e padurueshme.

Për të siguruar paqen e zemrës

Kryerja e namazit me vetëdije do t'i sjellë regull jetës së çrregullt të besimtarit, zemrës së tij të rrëmujujshme do t'i sjellë një ekuilibër dhe koherencë, do t'ia rigjallërojë ndjenjat e tij të mjera dhe do të hedhë dritë mbi anët e tij të turbullta. Dhe kështu, falë kësaj, besimtari do të gjejë mundësinë për të parë drejt, për të menduar drejt dhe për të folur drejt. Me lejen e Zotit, dalja para Tij dhe falja e namazit me vetëdije pesë herë në ditë do të bëjnë të mundur që njeriu t'i fitojë të gjitha këto.

Po, namaz i vërtetë është ai që kryhet nga besimtari me ndjenjën e *hushú-së*. Por, për të siguruar *hushú-në*, janë disa kushte që duhen plotësuar. Para së gjithash, nevojitet paqja e zemrës; pastaj, të kuptuarit e çështjes, mbështetja tek Allahu me besim e shpresë dhe, më pas, dalja para Tij gjithë turp e drojë.

Paqja e zemrës mund të arrihet nëse nuk dilet jashtë kuptimeve që shprehen nëpërmjet lëvizjeve që kryhen në namaz. Për shembull, pas qëndrimit në këmbë para Allahut për ca kohë, kalohet në ruku. Pse? Sepse nuk kemi më forcë të qëndrojmë në këmbë, prandaj. Pas rukusë, duke pranuar vogëlsinë tonë përballë madhësisë së Zotit dhe për ta shprehur atë para Tij, ulemi në sexhde. Ne themi “*Çdo lavdërim i përket Allahut, Zotit të botëve.*” që në fillim të namazit. Sepse Ai na ka mëshiruar duke na dhënë gjuhë, gojë e buzë, me të cilat mund të flasim e mund të shprehim dëshirat, kërkesat dhe shqetësimet tona. Ai gjithashtu na ka vendosur nyje në pjesë të ndryshme të trupit tonë, që ne të mund të ulemi, të ngrihem e të lëvizim lehtësisht. Vlera e vërtetë e këtyre mirësive mund të mësohet vetëm kur të pyeten ata, të cilëve, pasi kanë qëndruar të shtrirë për ditë të tëra dhe kanë rënkuar me mijëra herë për shkak të dhimbjeve të belit

²⁶⁶ Surja Ankebut, ajeti 45.

dhe këmbëve, u është mundësuar sërish ngritja në këmbë, lëvizja e këmbëve dhe drejtimi i belit.

Në namaz mendojmë gjithashtu edhe për çastet kur, pasi të na ketë goditur putra e exhelit, do të jemi duke ecur në Urën e Siratit, nën të cilën lartësohen flakët e Xhehenemit. Mendojmë për njerëzit që, të tmerruar nga përballja me një situatë të këtillë, do të bien në sexhde dhe themi: “Zoti im! Vetëm fjala Jote vlen në këtë botë e në botën tjetër, Ti je Sunduesi i Ditës së Gjykimit! Përse të bëhem rob i të tjerëve atëherë, përse të adhuroj tjetërkënd? Unë vetëm Ty të adhuroj dhe ndihmën për të shpëtuar nga tmerret e kësaj bote dhe të botës tjetër vetëm prej Teje e kërkoj. Mos më bëj prej atyre që, duke devijuar nga rruga e të qenit rob i Yti, biejnë në herezi dhe, për rrjedhojë, turpërohen e bëhen rezil në të dyja botët!”

Po, paqja e zemrës është mosdalja jashtë këtyre kuptimeve që thuhet e shprehen në namaz. Sipas kuptimit të saj në arabisht, ‘*huzur*’ (paqe, qetësi shpirtërore) do të thotë ‘të jesh gati, të gjendesh i gatshëm’. Po të shprehemi në një mënyrë popullore, do të thotë të marrësh me vete në namaz zemrën, ashtu siç merr me vete kuletën kur shkon në çarshi apo pazar. Sepse nëse ka një akçe që vlen tek Allahu, ajo është zemra. Ju do t’ia jepni Atij zemrën tuaj dhe në këmbim do të merrni mëshirën dhe pëlqimin e Tij. Kur vjen puna te paqja dhe qetësia shpirtërore ama, ju nuk mund ta realizoni këtë allishverish nëse nuk e keni zemrën me vete. Me fjalë të tjera, zemra që, ndërkohë që po falet namazi, është duke bredhur nëpër pazar apo ka mbetur në shtëpi mes zërave të hareshëm të fëmijëve nuk është një akçe e vlefshme në këtë tregti. Në çastin që e ke përgatitur zemrën për namaz, do t’i bësh sytë katër dhe do të shtypesh nën madhëstini e gjërave që do të shohësh. Ndërsa këndon ajetet e Kuranit, do të kuptosh se, në emër të dijes dhe njohjes, je duke shëtitur nëpër brigje të pafund. Ato ajete do të të kapin nga dora dhe do të të udhëheqin drejt dijes dhe pasurisë së brendshme, do të të shëtisin nëpër brigje të panjohura për ty... Do të të shëtisin dhe, papritmas, do të të bëhet sikur gjëra në lidhje me njohjen e Allahut, që nuk i ke ditur më parë, po lindin e po vijnë nga një botë e ndryshme.

Dhe, kështu, ti do të endesh nëpër qiej e tokë, por, ndonjëherë, edhe në botën tënde të brendshme. Do të shohësh se si i gjithë rruzulli tokësor do të shndërrohet në një zemër të madhe dhe do të bëhesh i tëri veshë për të dëgjuar rrahjet e asaj zemre dhe zhurmat që nxjerr, të cilat nuk janë gjë tjetër veçse përmendje të emrit të Allahut. Që aty do të kalosh te dielli dhe do të shohësh se edhe ai, si një zemër që tkurret e lëshohet duke thënë “*Alláh*”, orvatet të bëjë rrugën e tij brenda galaktikës së Rrugës së Qumështit.

Thënë më shkurt, bashkë me tiktaket e zemrës tënde, do të dëgjosh edhe të gjitha sistemet tek thonë “*Alláh, Alláh*” me pamjet e tyre mahnitëse; ndërsa shkon e vjen si një mëqik që udhëton mes këtyre sistemeve, do të formohet gjithashtu edhe një huall dijesh dhe, në këtë mënyrë, brenda teje do të lindin ndjenjat e respektit dhe nderimit. Mandej, do ta lëvdosh dhe do ta lartësosh Administruesin e këtij universi madhështor me fjalët “*Alláhu Ekber*”; do të thuash “*Alláhu Ekber*” dhe do të kalosh në ruku; do të thuash “*Alláhu Ekber*” e do të ulesh në sexhde; do të thuash “*Alláhu Ekber*” dhe do të ngrihesh nga sexhdeja...

Po, Allahu (*xhel’le xheláluhu*) është shumë i madh... Përmes këtyre fjalëve në namaz, robi dëshmon madhësinë e Tij, bëhet kundruar i kësaj madhësie. Madje, ndonjëherë, kjo madhësi e Tij e tmerron robin, e bën të përhumbet deri në atë pikë, sa të mos dijë çfarë të bëjë. Por, kur vjen në vete, qoftë edhe për një çast të vetëm, kupton se Zoti i Madhëruar, të Cilin e përshkruan si të Gjithëmëshirshëm dhe Mëshirëplotë që në fillim të namazit, e ka mbështjellë atë me mëshirën dhe dhembshurinë e Tij, ashtu siç ka mbështjellë me to edhe çdo gjë tjetër të këtij universi. Madje i bëhet sikur Zoti është duke parë vetëm atë; “Vetëm mua po më shikon, mua po më dëgjon... Është përkthyes i emocioneve dhe ndjesive të mia në zërin dhe frymën time...” thotë. Përballja e tij me një shpresë të tillë në kohën kur bie në një frikë dhe ankth të kësaj derexheje është mëshirë për të. Kur t’i ndiejë këto kuptime, robi do të thotë “Shkela në këtë gosti dhe fitova miqësinë e Zotit tim; tashmë jam i magjepsur dhe i dehur me gjërat që më vijnë

prej Tij.”, por, duke qenë se ai vetë nuk është në gradën e përkëdhelisë, do të kujdeset që të mos tregohet i paturpshëm. Sepse Ai është Krijuesi, kurse robi, i krijuari dhe ai që ia ndien nevojën mëshirës së Tij.

Shkurtimisht, besimtari duhet të ushqejë gjithmonë shpresën e arritjes së namazit të vërtetë. Për sa kohë vepron në këtë mënyrë, shpresohet që, nga mëshira e pafund e Zotit të Plotfuqishëm, atij t’i jepet sevapi i faljes së namazit të vërtetë. Ndoshta të gjithë ne mundohemi herë pas here dhe tregojmë përpjekje që në namazet që falim të arrijmë namazin e vërtetë. Edhe kur bëjmë një sexhde të vetme, duke thënë “Ah, sikur të kisha sukses në kryerjen e kësaj sexhdeje ashtu siç duhet!”, e vlerësojmë atë si një vrapim drejt të Dashurit. Por gjëja më e rëndësishme është të ndiejmë madhështinë e Allahut, me gjithë shkëlqimin e saj, në ndërgjegjen tonë në çdo moment; të ndiejmë vogëlsinë tonë në shpirtin tonë dhe, të kapluar nga këto ndjesi, të jemi në gjendje t’ia paraqesim Zotit kijamin, rukunë, sexhden dhe çdo pjesë tjetër të namazit tonë. Mendoj se vetëm një namaz i kryer në këtë mënyrë mund t’i bëjë shpirtin dhe zemrën të gjejnë drejtimin e duhur.

I Dërguari i Allahut (s.a.s.) thotë: *“Ka persona, të cilëve, pasi mbarojnë faljen e namazit, u shkruhet vetëm një e dhjeta e sevapit të namazit. Ka edhe persona të tjerë, të cilëve u shkruhet vetëm një e nënta, një e teta, një e shtata, një e gjashta, një e pesta, një e katërta, një e treta, gjysma.”*²⁶⁷ Mirëpo, namaz quhet ai që i mundëson besimtarit sevapin e plotë. Dhe këtë e mundëson namazi që kryhet para Zotit me mendje dhe vetëdije. Allahu (*xhel’le xheláluhu*) na faltë e na mëshiroftë, na i shtoftë ndjenjat e përluljes, respektit dhe nderimit përkarshi Tij dhe i bëftë ato mbizotëruese të të gjithë qenies sonë! Na ardhtë në ndihmë me hapjen e dymëve të shpresës dhe me mundësimin e forcës për të kaluar nëpër to në çastet tona të dëshpërimit dhe të rënies në batakun e pesimizmit! Dhe mos na privoftë nga edukata dhe mirësjellja për asnjë çast, në mënyrë që të mos tregohemi të vrazhdë e të paedukatë para Tij!

²⁶⁷ Ebú Dáúd, salát 127; Nesáí, es’Sunenul kubrá 1/211-212; el Bejhakí, es’Sunenul kubrá 2/281.

b. Bën që ndjenjat e njeriut të marrin drejtimin e duhur

Njeriu tregohet ambicioz ndaj përfitimeve që mund të arrihen brenda një kohe shumë të shkurtër, kurse ndaj gjërave shumë më të mira se ato përfitime, por që kërkojnë më shumë kohë për t'u fituar, në të shumtën e rasteve tregohet indiferent. Kurani Famëlartë e shpreh këtë të vërtetë nëpërmjet ajetit **“Vërtet që njeriu është i ngutur.”**²⁶⁸. Ndërsa në një ajet tjetër, thotë kështu: **“Vërtet që njeriu është krijuar i paqëndrueshëm.”**²⁶⁹ Kurse ajeti pasardhës i këtij të fundit është si vijon: **“Kur e godet e keqja, ai ligështohet fort.”**²⁷⁰. Pra, kur i ndodh ndonjë fatkeqësi, fillon të ulërasë, të ankohet e të revoltohet, fatkeqësinë e tij e kthen në legjendë ngado që shkon dhe dëshiron t'i bëjë edhe të tjerët të qajnë me hallin e tij. Mirëpo, ngaqë tregohet i nxituar, nuk e di se ajo fatkeqësi mund të jetë në të mirën e tij. Nuk është në dijeni as të faktit se Allahu i Gjithëfuqishëm, që vëzhgon, kontrollon dhe drejton gjithçka, ia lëshon fatkeqësitë si shi mbi kokë, në mënyrë që ai të pastrohet nga gjynahet e të shëtisë serbes nëpër sipërfaqen e tokës. Por, duke qenë se është i varur ndaj marrjes së gjithçkaje paradhënie, as që bëhet fjalë për t'u treguar durimtar ndaj fatkeqësive. **“Kur i bie e mira, ai bëhet koprrac.”**²⁷¹ Nuk lejon t'i ikë nga duart as edhe një qindarkë. Njëshin dëshiron ta bëjë një mijë.

Po, këto dhe ndjenja të ngjashme me këto, të vendosura në natyrën e njeriut, marrin drejtimin e duhur dhe, rrjedhimisht, përdoren ashtu siç duhen përdorur vetëm nëpërmjet namazit. Në fakt, qëllimi i tyre është ngritja e njeriut në gradën më të lartë të mundshme të përsosmërisë (*a'láji il'lijíni kemálát*). Por njeriu, kur nuk arrin të ndërtojë një marrëdhënie mes vetes dhe Zotit, nuk është në gjendje të dijë se ku t'i përdorë ato. Kështu, për shkak të keqpërdorimit në këtë mënyrë të këtyre aftësive, njeriu, në vend që të ngjitet në gradën më të lartë të përsosmërisë, bie në gradën më të ulët (*esfeli sáfílin*).

²⁶⁸ Surja Isrá', ajeti 11.

²⁶⁹ Surja Meárixh, ajeti 19.

²⁷⁰ Surja Meárixh, ajeti 20.

²⁷¹ Surja Meárixh, ajeti 21.

Ndjenja e inatit për shembull, duke iu drejtuar Zotit të Madhëruar dhe duke qenë në rezonancë me mëshirën, mund ta ngrejë njeriun në gradën më të lartë (*a'láji il'lijín*). Sepse kjo ndjenjë mundëson që njeriu të ngulmojë tek e drejta dhe e vërteta. Ai shtrëngon dhëmbët përballë dallgëve të mosbesimit që vijnë e përplasen me të dhe vepron në përputhje me urdhrin hyjnor: **“Dhe adhuroje Zotin tënd derisa të të vijë vdekja!”**²⁷² Kështu, inati kthehet në një virtyt të lartë dhe bëhet shkak për lartësimin e njeriut në pikën më të lartë të pjekurisë dhe përsosmërisë.

E njëjta gjë vlen edhe për pangopësinë. Njeriu mund t'i fitojë bukuritë shpirtërore vetëm në sajë të pangopësisë. Në fakt, kjo ndjenjë është bërë pjesë e natyrës së njeriut në mënyrë që ai të jetë në gjendje të fitojë cilësitë e njerëzve të lartë e të virtytshëm, të thellohet sa më shumë të jetë e mundur në adhurimin e Zotit të tij, madje, të mos dijë të ngopet në këtë pikë, të thotë “Zoti im! Sa i ëmbël është adhurimi Yt! Më mundëso të arrij lart e më lart!” dhe, si përfundim, të shtojë gradat e tij në Xhenet. Nëse një person jeton i shkëputur nga Allahu, këtë herë, pangopësia e tij do të kanalizohet për te dynjaja dhe bukuritë e saj tërheqëse, të cilat e largojnë njeriun nga Zoti i tij, dhe kjo nuk është gjë tjetër veçse një keqpërdorim i kësaj ndjenje. Po të zhytet një herë njeriu brenda këtij bataku, vështirë të dalë më që aty.

Përdorimi i këtyre aftësive për dynjanë, që nuk ka vlerë as krahu i një mize, apo për kënaqësitë e saj të vogla është një zhgënjim dhe një humbje në kuptimin e plotë të saj. Përkarrshi kësaj gjendjeje të sëmure e të tmerrshme, Kurani Famëlartë, duke thënë **“Përjashtim bëjnë ata që falen e që janë të vazhdueshëm në faljet e tyre.”**²⁷³, na tregon udhën që duhet ndjekur dhe, kështu, na njofton se vetëm ata që falin namaz nuk do të bien në një situatë kaq të rrezikshme e, në të njëjtën kohë, të frikshme. Pra, do të thotë se ata që dalin para Zotit pesë herë në ditë, veçoritë e keqija të njeriut, ku mund të përmendim pangopësinë, inatin, urrejtjen dhe epshin, nuk do t'i përdorin për hesap të dynjasë, po, mbase, për hesap të botës tjetër.

²⁷² Surja Hixhr, ajeti 99.

²⁷³ Surja Me'arixh, ajetet 22-23.

c. Është një përgjigje ndaj ftesës hyjnore

Namazi, përveçse është një shkak për arritjen e qetësisë shpirtërore dhe ndjenjën e sigurisë, bart edhe kuptimin e një përgjigjeje ndaj ftesës së Zotit. Nëpërmjet ezanit, që lartësohet nga minaret e xhamive pesë herë në ditë, për të gjithë njerëzit lëshohet nga një ftesë. “Allahu është i madh, kurse ju, ju jeni ata që janë të vegjël. Për t’i përfutuar ato gjëra për të cilat keni nevojë, dilni para Allahut, vraponi drejt mesxhideve ku do të shpërndahen shpërblimet, që të begatoheni e të gjeni shpëtim.” sikur u thotë atyre ezani.

Besimtari i përgjigjet kësaj ftese. Sepse kjo ftesë është ftesa e kauzës së tij. Me këtë gjendje, ai sikur dëshiron të thotë “Allahu im! Më ftove për në xhami pesë herë në ditë; më ftove dhe, ja, unë po i përgjigjem ftesës Tënde. Jo vetëm pesë herë, po, sikur edhe pesëdhjetë herë të më kishe thirrur, unë prapë do të vija.” Kundrejt këtij nijeti të tij, Allahu i Madhëruar, duke thënë “Robi Im! E di nijetin tënd. Kështu që, edhe unë po të shpërblej me sevape sikur të kesh ardhur në xhami pesëdhjetë herë në ditë.”, shkruan për pesë namazet ditore të besimtarit sevapet e pesëdhjetë namazeve.

Sa i përket atij që nuk është besimtar, ngaqë nuk ia vë veshin ezanit që këndohet pesë herë në ditë dhe nuk i bashkohet faljes së pesë namazeve ditore, jeta i shkon kot dhe, për rrjedhojë, në fletoren e tij nuk shënohet asgjë në emër të punëve të mira dhe sevapeve. Besimtari zotëron një jetë të begatë dhe plot bereqet; ai mbjell një farë në arën e kësaj bote, por ajo që korr në botën tjetër është dhjetëfishi, njëqindfishi, shtatëqindfishi i asaj që mbjell. Sepse nijeti i tij është më i madh se veprat e tij. Do të thotë se, për aq kohë sa është i vetëdijshëm në çështjen e adhurimeve dhe të të qenit rob i Zotit, çdo fazë e jetës së tij, çdo pjesë e saj, dhe çdo vepër e kryer nga ana e tij kalon në llogari të adhurimeve.

Le të vijmë tani tek aspekti i kësaj ftese të shenjtë, që shikon nga Zoti i Madhëruar. Allahu (*xhel’le xheláluhu*), nëpërmjet namazit, na fton për te mëshira e Tij. Ashtu si ftuesi, i cili i pret te dera të ftuarit, pastaj i qeras me gjithë të mirat dhe, në fund, nuk i lejon të largohen duarbosh,

po ashtu edhe Allahu, i Cili i fton në xhami njerëzit nëpërmjet zërit më të bukur – në Kuranin Famëlartë, aty ku shpjegohet ezani, thuhet **“E kush flet më bukur se ai që i fton njerëzit drejt Allahut?”**²⁷⁴ – dhe që lartësohet nga majat e minareve pesë herë në ditë, nuk do t’i kthejë duarbosh ata që vijnë aty; do t’iu mundësojë shpirtrave dhe zemrave të robërve të Tij ushqim nga mirësitë, bujaria dhe mëshira e Tij e pafund, do t’ua ngrejë atyre perdet e syve dhe, duke u mundësuar pamje dhe pasqyrime të botës hyjnore, do t’i nderojë ata me privilegjin e kryerjes së miraxhit, qofshin apo jo të vetëdijshëm për këtë robërit e Tij. Kur t’i përgjigjet kësaj ftese dhe të dalë para Zotit, robi do të dëshmojë se namazi i tij është shndërruar në një shkallë që e lartëson atë lart e më lart. Aq sa, nga pika më e lartë e tyre, do të jetë në gjendje të vëzhgojë Zotin e tij.

Përderisa i Dërguari i Allahut (s.a.s.) ka mundur të shohë Zotin e Tij në Miraxh, të njëjtën të vërtetë do ta përfjetojë në namaz edhe robi. Sepse Lajmdhënësi Fjalëdrejtë (s.a.s.) na ka urdhëruar kështu: *“Kur të vijë te ju fisniku (i pari) i një fisi, respektojeni dhe qeraseni atë.”*²⁷⁵ Shpirtrat dhe zemrat që i kanë besuar Allahut janë krijesat më fisnike të rruzullit tokësor. Sepse nuk i kanë bërë shirk Allahut, nuk i kanë bërë sexhde askujt tjetër dhe i janë përgjigjur ftesës së dërguar me këndimin e ezanit. Shpresojmë me gjithë zemër që Allahu, i Cili e bëri të Dashurin e Tij të Virtytshëm (s.a.s.) të flasë në këtë mënyrë, të mos i privojë nga kjo mirësi ata që dalin para Tij duke iu përgjigjur kësaj ftese të dërguar nga Ai vetë.

d. Është bashkëbisedim me Zotin

Namazi është dorëzimi ndaj një Qenieje, fuqia dhe forca e të Cilit është e pakufi, është mbështetja tek Ai dhe pritja e zgjidhjes së meseleve prej Tij. Kur kishte ndonjë problem serioz që e dëshpëronte, i shkaktonte shqetësime dhe që e linte në mëdyshje, Profeti ynë (s.a.s.)

²⁷⁴ Surja Fus’silet, ajeti 33.

²⁷⁵ Ibn Máxhe, edeb 19; Ibn Ebí Shejbe, el Musannef 5/234.

ngrihej për të falur namaz, qëndronte me përulje para Zotit dhe, kësisoj, zemra e tij paqësohej e gjente qetësi. Sepse ishte Allahu i Madhëruar Ai që e kërkonte këtë gjë. Ajeti **“O besimtarë! Kërkoni ndihmë për veten nëpërmjet durimit dhe namazit! Në të vërtetë, Allahu është me të duruarit.”**²⁷⁶ e urdhëron këtë. Domethënë, “O ju, që thoni se i keni besuar Allahut! Kur të përballeni me ndonjë vështirësi, kur problemet tuaja në lidhje me këtë botë të jenë bërë grumbull dhe të jenë në pritje të zgjidhjeve të tyre, që të shpëtoni nga shqetësimet që ju kanë mbërthyer dhe që të ndiheni sërish të çliruar e të lehtësuar, ejani para Allahut, lidhuni në namaz dhe lutjuni Atij. Sepse namazi, për njeriun që përpëlitet brenda dobësisë dhe varfërisë së tij, do të thotë shprehje e kësaj dobësie dhe varfërie duke qëndruar gjithë respekt dhe me përulje përballë Atij që zotëron forcën dhe fuqinë e pafund.”

Ja pra, në këtë kuptim, namazi është një pozitë e lartë, nga ku njeriu mund të bashkëbisedojë me Zotin e Madhëruar. Falë veprimeve që bën në namaz dhe ajeteve e lutjeve që këndon gjatë faljes, kalon në një marrëdhënie zemre me Allahun dhe bisedon me Të; herë gjendet në pozicionin e atij që flet, herë në atë të dëgjuesit. Në një hadith të shenjtë (*kudsi*), që e kemi përmendur edhe më parë, kjo e vërtetë shprehet kështu:

Allahu (xhel’le xheláluhu) thotë: “Unë e kam ndarë kiraetin në dy pjesë mes vetes sime dhe robit tim; gjysma më përket mua, gjysma tjetër i përket atij. Robit tim i është dhënë ajo që ka kërkuar. Kur robi thotë ‘Falënderimet dhe lavdërimet qofshin për Allahun, Zotin e botëve.’, Allahu i Madhëruar thotë ‘Robi im më falënderoi.’. Kur robi thotë ‘Ai është i Gjithëmëshirshmi, Mëshirëploti.’, Allahu thotë ‘Robi im më lavdëroi.’. Kur robi thotë ‘Ai është Sunduesi i Ditës së Gjykimit...’, Allahu thotë ‘Robi im më lartësoi e më madhëroi.’. kur robi thotë ‘Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë.’, Allahu thotë ‘Kjo është (një marrëveshje) mes meje dhe robit tim. Robit tim ia dhashë atë që dëshiroi.’. Kur robi thotë ‘Udhëzoni në rrugën e drejtë! Në rrugën e atyre që u ke dhuruar mirësi e jo në atë të atyre që kanë shkaktuar

²⁷⁶ Surja Bekare, ajeti 153.

zemërimin Tënd, as në atë të atyre që janë të humbur!, Allahu (*xhel'le xheláluhu*) thotë *'Edhe kjo i përket robit tim; robit tim i është dhënë ajo që dëshiron.'*²⁷⁷

Me pak fjalë, në namaz, robi do të vijë ballë për ballë me Zotin dhe, në varësi të thellësisë së zemrës, sinqeritetit të fjalëve dhe forcës bindëse të veprimeve të tij, do të marrë shpërblimin që meriton. Këtë gjë na e ka premtuar vetë i Plotfuqishmi Allah.

e. E mban njeriun larg imoraliteteve

Namazi është dalje para Allahut të Madhërishëm pesë herë në ditë, për të dhënë llogari për jetën. Me fjalë të tjera, namaz do të thotë të ndiesh në çdo çast frymën e Azrailit (a.s.) pas vetes tënde, kurse nga para, të ndiesh gjykimin e Zotit në lidhje me ty. Të dalësh para Allahut i përlulur dhe me duart të lidhura para vetes, të mendosh sikur po strehohesh në dergjahun e Zotit për t'i shpëtuar kurtheve të shejtanit në të majtën tënde, sikur po kalon nën mbrojtjen e engjëjve në të djathtë tënde. Ja, pra, namazi i kryer në këtë kuptim është ai që e mban njeriun larg të keqes dhe imoraliteteve. Sepse një namaz i kryer në këtë kuptim do të thotë të shpëtosh nga gjynahet dhe të meritosh daljen para Allahut pesë herë në ditë. Në këtë pikë, është e pamundur të gjesh arsye apo ndonjë justifikim të logjikshëm për të hyrë në mëkat e për t'u përlyer me papastërtitë dhe ndryshkun e dynjasë.

Në Kuranin Famëlartë, Allahu (*xhel'le xheláluhu*) thotë kështu: ***"Vërtet që namazi të ruan nga shthurja dhe nga çdo vepër e shëmtuar."***²⁷⁸ Shthurja, veprat e shëmtuara dhe imoralitetet janë pesha të rënda, të cilat, me anët e tyre të liga e ogurzeza, i bëhen pengesë besimtarit në kryerjen e asaj që është themelore për të, pra, në kryerjen e miraxhit dhe daljen para Zotit, dhe, rrjedhimisht, janë mëkate që Allahu nuk i do. *"Në çdo mëkat gjendet një rrugë që të çon drejt*

²⁷⁷ Muslim, salát 38; Tirmidhí, tefsir 2; Nesái, iftitah 23.

²⁷⁸ Surja Ankebut, ajeti 45.

*mosbesimit.*²⁷⁹ Sipas kësaj, një njeri që e lëshon veten në batakun e mëkateve, i largohet Allahut dhe i afrohet shejtanit në masën e kësaj zhytjeje të tij. Me fjalë të tjera, do të thotë të humbasësh nëpërmjet mëkateve afrimitetin me Zotin, të cilin e ke fituar përmes namazit; do të thotë që, për gjëra të kota e të pakuptimta, të biesh, madje me kokë, nga maja e shkallëve që ke ngjitur hap pas hapi. Pra, besimtari, i cili ka si ideal fitimin e afrimitetit me Allahun dhe që vrapon pas këtij ideali, duhet t'u rrijë larg shthurjes dhe imoraliteteve, të cilat nuk shërbejnë për gjë tjetër veçse për ta larguar njeriun nga Zoti, dhe t'u frikësohet zhytjes në to – nëse do të përdornim shprehjen e përdorur në një hadith autentik – ashtu siç i frikësohet hedhjes në zjarr.

I Dërguari i Allahut (s.a.s.) thotë: *“Kush i ka këto tri cilësi, e ka ndier shijen e imanit. Një: Ta duash Allahun dhe të Dërguarin e Tij më shumë se çdokush dhe çdo gjë tjetër. Dy: T'i duash të dashurit e tu vetëm për hir të Allahut. Tre: Pasi të është mundësuar nga ana e Allahut shpëtimi prej mosbesimit dhe nderimi me pranimin e fesë së Islamit, t'i frikësohesh kthimit në mosbesim siç i frikësohesh hedhjes në zjarr.*²⁸⁰ Atëherë, do të thotë se ata që e kanë ndier shijen e imanit, kur të ekspozohen ndaj kufrit dhe gjërave që të çojnë drejt tij, do të ndihen sikur po futen në zjarr. Dhe, për të shmangur kthimin edhe një herë në të, do të bëjnë gjithçka që është e mundur të bëhet. Ja, pra, kryerja e namazit me këtë frymë dhe vetëdije do të thotë të qëndrosh i përlurur përballë Zotit dhe të ripërtërisht fjalën e dhënë, do të thotë të forcosh lidhjet me Allahun. Kjo, në vetvete, është shumë e lehtë. Por, për ata që nuk arrijnë ta kapin thelbin e kësaj çështjeje, është më se e vështirë. Ashtu siç bëhet shkak falja e namazit për arritjen e një afrimiteti me Allahun, edhe braktisja e faljes së namazit është një shkak për rënien në shirk dhe mosbesim. Profeti ynë (s.a.s.) thotë: *“Mes robit dhe shirkut e kufrit është vetëm braktisja e namazit.*²⁸¹ Kurse në një hadith tjetër, na urdhëron kështu: *“Kushdo që e fal namazin tonë, që kthehet nga kibra jonë dhe ha*

²⁷⁹ Bediuzamani, Shkreptimat, fq. 19 (Shkreptima e Dytë, Pika e Parë).

²⁸⁰ Buhári, ímán 9, 14, íkráh 1; Muslim, ímán 67.

²⁸¹ Muslim, ímán 134; Tirmidhí, ímán 9; Ebú Dáúd, sun'net 15.

nga ajo që hamë ne, është mysliman dhe është nën mbrojtjen e Allahut dhe të të Dërguarit të Tij. Mos e nënvlerësoni mbrojtjen e Allahut.”²⁸²

Ashtu si jomyslimanët, të cilët, duke pranuar pagesën e xhizjes ndaj një administrate islame, hynin nën mbrojtjen e asaj administrate dhe përfitonin nga të gjitha të drejtat që gëzonin edhe shtetasit myslimanë të saj, edhe myslimani, duke iu kthyer kibles dhe duke kryer namazin, hyn nën mbrojtjen e Allahut dhe të të Dërguarit të Tij. Askush nuk mund ta prekë më atë. Keqtrajtimi dhe mizoritë e bëra ndaj personit që është marrë nën mbrojtjen e dikujt konsiderohen të kryera drejtpërdrejt ndaj këtij të fundit!

Pra, për njeriun që e ka pranuar mbrojtjen e Allahut, do të thotë se, duke tërhequr një perde mes vetes dhe dyshes mosbesim-shirk në sajë të simboleve të Islamit, ka hyrë nën një mbrojtje shumë të madhe.

f. Të kujton kushtet e besimit

Namazi është një poemë e kushteve të besimit. Para së gjithash, ai vendos një marrëdhënie mes robit dhe Allahut. Kur lidhet në namaz duke thënë *‘Alláhu Ekber’*, robi hedh prapa krahëve çdo gjë që mund ta largojë atë nga Zoti dhe, duke ia ngulur sytë shtigjeve të botëve shpirtërore, fokusohet te gjërat që do t’i vijnë prej andej. Ai gjithashtu e di me siguri se çdo gjë që del nga goja e tij gjatë faljes së namazit, çdo gjë që përjeton brenda tij në trajtën e ndjenjave dhe emocioneve ka aftësinë për t’u ngjitur tek Allahu si një fjalë e mirë, e bukur dhe e këndshme. Ajeti *“Vallë, a nuk e sheh se si Allahu e përqsas fjalën e mirë me pemën e mirë, e cila rrënjën e ka të fortë në tokë, kurse degët nga qielli?”*²⁸³ këtë të vërtetë shpreh. Në një ajet tjetër, Allahu i Madhëruar thotë kështu: *“Tek Ai ngjiten fjalët e bukura, ndërsa veprën e mirë Ai e ngre Vetë (Punët e mira dhe të pranuar ia shtojnë vlerën fjalëve të mira).”*²⁸⁴

²⁸² Buhárí, salát 28, edáhí 14; Tirmidhí, ímán 2; Nesáí, ímán 9.

²⁸³ Surja Ibráhím, ajeti 24.

²⁸⁴ Surja Fátir, ajeti 10.

Duke i mbyllur sytë ndaj gjërave të kësaj dynjaje, robi shndërrohet në një kundrues të vetëm asaj bote dhe e kryen namazin me kënaqësi... E kryen ashtu namazin sepse ka një kënaqësi të veçantë në dridhjet e robit me ndjenjën e *hushú*-së kur kupton vogëlsinë dhe varfërinë e tij përballë madhësisë së Zotit të Madhëruar.

Edhe kur thotë **“Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë.”**, përveçse e pranon Allahun si të Adhuruarin Absolut, shpreh edhe paaftësinë e tij për ta adhuruar Atë ashtu siç e meriton. I vetëdijshëm për dobësinë dhe varfërinë e tij, strehohet tek Ai dhe thotë: “Zoti im! Ty po të adhuroj. Në qafë kam zinxhirin që të përket Ty, ndërsa në veshë po mbaj vathët e dobësisë dhe varfërisë, të cilët, po ashtu, të përkasin Ty. Unë jam një rob, ama kjo është një robëri e nderuar për mua, sepse jam robi Yt!”

Po, Allahu (*xhel'le xheláluhu*) është Sulltani i Sulltanëve, kurse ne jemi shërbëtorët e asaj dere dhe këtë e shprehim – bashkë me namazet sunet – dyzet herë në ditë, kur ulemi në teshehud. Duke thënë “Dëshmoj se nuk ka zot tjetër përveç Allahut.”, pranojmë dhe deklarojmë se Allahu është i Adhuruari dhe i Dëshiruari i Vërtetë, se Ai është Sunduesi i Plotfuqishëm dhe i Pashoq dhe se në duart e Tij janë frerët e gjithçkaje.

Në namaz bëhet gjithashtu edhe deklarimi i besimit në profetët. Kur themi shehadetin, duke thënë *“Ue eshhedu enne Muhammeden abduhu ue rasúluhu”*, duke përmendur emrin e atij Profeti Famëlartë dhe duke dëshmuar për profetësinë e Tij, dëshmojmë po ashtu edhe për profetësinë e të gjithë profetëve që kanë ardhur e ikur që nga koha e Ademit (a.s.) deri në atë të Profetit tonë (s.a.s.). Këto fjalë, ndonjëherë na çojnë në anijen e Nuhut (a.s.), një herë tjetër na çojnë në malin Tur, pranë Musait (a.s.), ndonjëherë na çojnë pranë Mesihut (a.s.), i cili na shfaqet në trajtën e një misteri qiellor dhe ndonjëherë tjetër na çojnë pranë Muhamedit (s.a.s.), tek i Cili, në një aspekt, mund të vërehen të gjitha veçoritë e profetëve të mëparshëm. Po, këto fjalë na çojnë te secili prej tyre dhe na sjellin përsëri aty ku jemi fizikisht. Dhe, sikur të kishim dalë para Tij e të ishim ulur gju më gju me Të, themi: *“O profet, që nuk kam mundur të të kuptoj siç duhet e që na e ke bërë veten të*

njohur si ‘Muhammedun Rasúlulláh’, sepse ashtu të pati mësuar Allahu! Po të paraqes përshëndetjet e mia, të cilat janë sa numri i grimcave të trupit tim. Të lutem, pranoji ato!’. Po, themi kështu dhe i japim selam.

Në dashtë Zoti, falë besimit në profetët, ne nuk do ta shohim më të kaluarën si një botë errësirash, kurse në të ardhmen, duke i kaluar me shpejtësinë e rrufesë edhe fazat më të vështira të saj, do të arrijmë në vende ku mbizotëron paqja.

Në të njëjtën mënyrë, ne kujtojmë gjatë faljes së namazit edhe besimin në engjëjt. Në sajë të besimit në ekzistencën e tyre, ne nuk ndihemi kurrë vetëm. Gjithmonë mendojmë se, kudo që të jemi e ngado që të shkojmë, do t’i kemi pranë si miq besnikë e mirënjohës, se na tregojnë rrugët që të çojnë për tek e drejta dhe se na i bllokojnë rrugët e shtrembra. Ky besim i yni tek ata do të na mundësojë këtu qetësinë shpirtërore dhe paqen e zemrës, kurse në lidhje me botën tjetër, do të mbjellë te ne përfytyrimet e hyrjes në Xhenet ashtu siç u ka hije mbretërve, duke kaluar nën harqe triumfi dhe mes kordonëve të engjëjve në pritje të ardhjes sonë.

Kur themi **“Ai është Sunduesi i Ditës së Gjykimit.”**, kujtojmë ditën kur do të japim llogari para Allahut, i Cili është Zoti dhe Sunduesi ynë në këtë botë dhe që do të jetë Zoti dhe Sunduesi ynë edhe pas vdekjes sonë. Në atë ditë, askush nuk do të jetë në gjendje ta quajë të keq atë që Ai do ta quajë të mirë dhe askush nuk do të jetë në gjendje ta quajë të mirë atë që Ai do ta quajë të keq. Kur themi **“Udhëzona në rrugën e drejtë!”**, kujtojmë Islamin, këtë fe të pastër e të qartë, bashkë me dispozitat dhe përmbajtjen e Kuranit, si dhe kërkesat e tyre ndaj nesh.

Po, të gjitha këto na kujtohen gjatë faljes së namazit, kësaj poeme të kushteve të besimit. Mundet që edhe të mos e dimë atë që duhet sjellë në mendje dhe duhet ndier në ruku, sexhde apo teshehud, mundet që edhe të ulemi e të ngrihemi si të hutuar. Porse Allahu, nëpërmjet fermanit të Tij hyjnor, e ka formuluar në trajtën e një sistemi ndjenjën e adhurimit që fryhet brenda nesh dhe, duke e futur atë në forma e kallëpe të caktuara, na thotë: “Ju do të fitoni kënaqësinë Time vetëm nëse do të veproni në këtë mënyrë.”

g. Është shlyerje për mëkatet

Namazi, nëse kryhet ashtu siç duhet dhe në përputhje me kuptimin që ai bart, – siç thuhet edhe në shumë hadithe – ia fshin mëkatet robit dhe e pastron atë. Sepse në namaz, pendimi bëhet pjesë e ndërjegjes. Pra, edhe pse pendimi i bërë nëpërmjet namazit nuk është i qëllimshëm dhe i vullnetshëm, njësimi i tij me një namaz të falur sipas mënyrës që na kërkohet dhe dalja para Allahut me këtë njësim krijojnë te njeriu një vetëdije në emër të pendimit.

Nga ana tjetër, namaz do të thotë pendesë e plotë. Aq shumë ka depërtuar pendesa në shtyllat dhe pjesët e tjera përbërëse të namazit, saqë është pothuajse e pamundur që namazi dhe pendesa të merren në konsideratë veç e veç. Jo çdo pendesë është namaz, sigurisht; ama çdo namaz i falur në mënyrë të vetëdijshme është njëkohësisht edhe një pendesë. Mirëpo, që namazi të japë një efekt të këtillë, fillimisht duhet që ai të kryhet ashtu siç na është kërkuar ta kryejmë.

Këtu dëshiroj t’ju tërheq vëmendjen në një pikë, e cila mund të kuptohet fare lehtë nga hadithet në lidhje me temën në fjalë: Po të dojë, Allahu i Madhëruar mund t’i falë mëkatet në çdo namaz. Ama, që kjo gjë të shndërrohet në një ftesë serioze për faljen e mëkateve, vuajtjen e mëkatit të tij robi duhet ta ndiejë në zemër përgjatë njëzet e katër orëve të ditës. Përkarshi mëkatit të kryer në atë ditë, e gjithë dita duhet të kalojë me teube. Dhe robi duhet ta kërkojë dhe të përpiqet ta gjejë pranimin e kësaj pëndese në të gjitha namazet e asaj dite. Për ata që e kalojnë çdo ditë të tyre në këtë mënyrë, kryerja e namazit me një vetëdije të këtillë është një mirësi më vete. Ashtu siç nuk dihen me saktësi nata e Kadrit brenda muajit të Ramazanit dhe koha e lutjeve të pranuar brenda ditës së Xhuma, urtësia e të cilave qëndron në vlerësimin maksimal të të gjithë muajit të Ramazanit dhe të të gjithë ditës së Xhuma, po ashtu na është fshehur edhe namazi që do të bëhet shlyerje për mëkatet, që njeriu ta kërkojë këtë në çdo namaz, që t’i kryejë të gjitha namazet me këto ndjenja dhe, në fund, të mbledhë frutat e shlyerjes së mëkateve në cilindo namaz të tijin.

h. Të afron tek Allahu

Namazi është shkaku më i madh i afrimit me Zotin. As që bëhet fjalë që robi t'i afrohet Zotit të tij me diçka më të këndshme se sexhdeja. Pejgamberi ynë (s.a.s.) e shpreh këtë me fjalët *“Robi është më afër Zotit të tij kur ndodhet në sexhde. Kështu që, bëni shumë dua (në sexhde).”*²⁸⁵. Besimtari, nëpërmjet një sexhdeje gjatë së cilës zemrën mund t'ia shohë vetëm Allahu, aq shumë i afrohet Zotit të tij, saqë shejtani, pasi përballet me këtë tablo të besimtarit, fillon të largohet me vrap e duke ulëritur. I Dërguari i Allahut (s.a.s.), këtë gjendje të shejtanit e shpreh kështu: *“Nëse i biri i Ademit bën sexhde kur lexon një ajet sexhdeje, shejtani largohet duke qarë e duke thënë ‘Sa keq për mua! Njeriu u urdhërua për të bërë sexhde dhe e bëri atë. Në këmbim, do të ketë Xhenetin. Edhe unë u urdhërova për të bërë sexhde, por nuk e bëra atë. Për mua do të ketë zjarr.”*²⁸⁶

Kështu, besimtari në asnjë mënyrë nuk duhet t'i rrijë larg namazit, këtij adhurimi që e largon kaq shumë shejtanin prej tij dhe që e afron atë kaq shumë me Zotin. Veçanërisht ai duhet t'i kushtojë rëndësi sexhdes. Duhet të shfrytëzojë çdo rast që i jepet për të vënë kokën në tokë para Zotit e për t'i shprehur Atij hallet e veta. Duhet t'ia hapë Atij zemrën duke thënë *“Zoti im, askush nuk m'i dëgjoi britmat e zemrës, askush nuk mundi të bëhej derman i derteve të mia... Prandaj po dal para Teje e po t'i qaj Ty hallet e mia!”*. Zaten, me fjalët *“Subhâne Rabbijel Alá”, “I madhëruar (dhe larg çdo të mete) është Zoti im i Lartë.”*, të cilat i thotë në sexhde, sikur dëshiron të shprehë këto kuptime: *“Zoti im! Unë i kam bërë keq vetes sime! Pavarësisht vogëlsisë sime dhe vendit të vogël që zë në gjithë këtë univers, krimet që kam kryer, mëkatet që kam bërë janë të mëdha. Por, në këtë moment, tani që ndodhem përballë madhësisë Tënde, po e thyej krenarinë time, po strehohem te Ti dhe po e vë kokën në tokë. Më fal! Sepse nuk ka kush të më falë tjetër përveç Teje. Ti je mbikëqyrës, Ti je dëshmitar i gjithçkaje. Edhe pse jam mëkatar, nuk kam trokitur në derën e askujt tjetër, nuk kam bërë ruku*

²⁸⁵ Muslim, salát 215; Ebú Dáúid, salát 148; Nesái, meuákít, 35, tatbík 78.

²⁸⁶ Muslim, ímán 133; Ibn Máxhe, ikáme 70; Ahmed ibn Hanbel, el Musned, 2/442.

e nuk kam rënë në sexhde para këmbëve të të tjerëve. Ndoshta më janë përzier në çdo gjë timen, ama unë nuk kam përzier askënd në sexhden time. Atëherë kur shejtani iku duke ulëritur, unë iu binda urdhrin Tënd **'Andaj, ikni (prej dënimit) drejt (shpërblimit të) Allahut!**²⁸⁷, po arratisem drejt Teje. Te Ti strehohem, te Ti mbështetem!"

Po, namazi që na afron me Zotin, është adhurimi më i madh dhe – ashtu siç dëshmojnë edhe engjëjt – adhurimi që mund të bëhet shkak për faljen tonë. Engjëjt e nderuar, ndërrimin e detyrave mes shoqishoqit e bëjnë në kohët e namazit pikërisht për shkak të kësaj vlere të namazit. Në një hadith autentik, i Dërguari i Allahut (s.a.s.) ka thënë kështu: *"Ditën dhe natën, një pjesë e engjëjve gjenden mes jush me radhë. Këta mbliidhen në kohët e namazit të sabahut dhe të ikindisë. Pastaj, engjëjt që ju ndjekin gjatë natës, ngjiten lart (për të dhënë llogari para Allahut në lidhje me ju). Allahu, i Cili e di shumë mirë gjendjen tuaj, i pyet këta engjëj: 'Si i latë robërit e mi?' Engjëjt përgjigjen në këtë mënyrë: 'Ne i lamë ata kur po falnin namazin. Zaten, edhe kur patëm shkuar pranë tyre, duke falur namaz i patëm gjetur.'"*²⁸⁸

Ja, pra, ky është namazi, kuptimi dhe përmbajtja e të cilit është me kaq shumë peshë, pjesët e të cilit kryhen si adhurime më vete nga bashkësi engjëjsh në qiej, detyra që iu dha të Dërguarit në mënyrë të drejtpërdrejtë, pa asnjë ndërmjetës. Të gjitha adhurimet e tjera, Profetit tonë (s.a.s.) i janë përcjellë nëpërmjet Xhibrilit; për namazin ama, nuk mund të thuhet e njëjta gjë. Namazi është dhurata që Allahu i Madhëruar ia paraqiti Pejgamberit tonë (s.a.s.) në Miraxh pa ndërmjetësimin e askujt. Prandaj, kur kryhet me besnikëri, – siç ka thënë edhe Profeti ynë (s.a.s.) – namazi i mundëson njeriut sevapin e pesëdhjetë kohëve.²⁸⁹

Pavarësisht vogëlsisë, mangësive dhe prirjes së njeriut për të rënë në *esfeli sáfilín*, namazi e sjell atë në çast para Allahut (*xhel'le xheláluhu*) dhe e bën bashkëbisedues të Tij. Nëse lejohet të bëhet një krahasim i tillë, robi në namaz i futet një pazarllëku me Allahun; ndonjëherë

²⁸⁷ Surja Dháriját, ajeti 50.

²⁸⁸ Buhári, meuákítus'salát 16, bed'ul halk 6, teuhíd 23, 33; Muslim, mesáxhid 210.

²⁸⁹ Buhári, bed'ul halk 6, menákibul ensár 42; Muslim, ímán 259.

flet ai, ndonjëherë flet Zoti dhe ndonjëherë atyre u bashkohen edhe engjëjt. Kur vjen në namaz, robi sikur thotë: “O Krijuesi im! O Zoti im, që më pranon, më jep mundësinë për t’u drejtuar Ty dhe më nderon nëpërmjet bashkëbisedimit Tënd pavarësisht vogëlsisë sime! I mbushur me respekt përkarshi Teje, dua të bëj diçka. Si mund ta shpreh mirënjohjen time për të gjitha mirësitë dhe begatitë që më ke dhënë, me çfarë mund të të paguaj për to? Nuk po mundem të gjej asgjë brenda meje, që të jetë në gjendje të bëhet përkthyes i gjithë këtyre mirësive. Më jep një gjuhë, më mundëso një frymë, që të jem në gjendje të të lavdëroj dhe të shpreh mirënjohjen time, falënderimet e mia ndaj Teje! Ashtu siç e lavdëron Ti Vetën Tënde.”

Kësaj dëshire të robit, Allahu i Madhëruar i përgjigjet në këtë mënyrë: “Me dorën e Muhamedit, të kam dhënë namazin, si një gjuhë që zgjatet nga Miraxhi; me gjuhën e namazit do t’me flasësh, respektin që ke ndaj meje nëpërmjet tij do e shprehësh. Çdo pjesë e tij do të marrë trajtën e një gjuhe dhe, me to, do të përmbushësh detyrën e falënderimit për mirësitë që të kam dhënë.” Pas kësaj bisede, robi, herë duke qëndruar në këmbë, herë duke u përkulur në ruku dhe herë duke rënë në sexhde, do të shprehë mirënjohjen dhe falënderimet ndaj Zotit. Dhe, në fund, thotë: “Zoti im! Duke më vënë në trup me qindra nje dhe duke ma bërë atë si një makineri, më dhe mundësinë për të të treguar Ty ndjenjat e mia të respektit dhe *hushú*-së në namaz. Për këtë arsye, ndiej një respekt akoma më të madh ndaj Teje, si dhe dua të të nderoj, lartësoj e lavdëroj. Pranoje edhe këtë si një qëllim timin!”

Shkurtimisht, mund të themi se namazi, me të gjitha pjesët e tij, bëhet përkthyes i shqetësimeve të brendshme të robit, i derteve që ai nuk është në gjendje t’i shprehë. Zoti i Madhëruar i dëgjon zërat që vijnë nga ato gjuhë dhe thotë: “Robi im më bëri sexhde, robi im u përkul para Meje, robi im e përmbushi detyrën e robërisë së tij ndaj Meje.” E, në fakt, arritja e kësaj gjendjeje është një qëllim i epërm për njeriun. Le të shpresojmë që Zoti i Plotfuqishëm t’ua mundësojë të gjitha ndërgjegjeve të pastra e të dëlira një miraxh të tillë në namaz; kurse njerëzve që janë bërë si të huaj ndaj adhurimeve, që e falin namazin si

të ishte një barrë e rëndë që duhet hequr qafe dhe që e shohin kryerjen e tij thjesht një formalitet, këtyre u mundësoftë ndierjen e kuptimit të vërtetë të namazit!

2. Frytet e namazit në aspektin shoqëror

Islami është një fe gjithëpërfshirëse. Për këtë arsye, ndërkohë që nga njëra anë u bën thirrje të gjithë popujve për t'u bashkuar para Allahut, nga ana tjetër, kërkon që myslimanët të kenë një unitet mes tyre dhe të kenë me njëri-tjetrin një afrimitet vëllazëror. Ajeti "***Në të vërtetë, besimtarët janë vëllazër...***"²⁹⁰ këtë të vërtetë shpreh. Namazi, i cili është nga bazat më të rëndësishme të Islamit, jo vetëm që siguron marrëdhënien dhe komunikimin mes robit dhe Zotit, por mundëson gjithashtu edhe dialogun midis njerëzve, madje, në mënyrën më të mirë të mundshme. Në këtë aspekt, pra, mund të themi se namazi ka edhe një frymë shoqërore. Xhamia, ku besimtari takohet me vëllazërit e tij të fesë pesë herë në ditë, nuk është vetëm një vend adhurimesh; Profeti ynë (s.a.s.), sapo e nderoi Medinen e Ndritur me praninë e Tij, iu përvesh punës për ndërtimin e një mesxhidi, i cili do të shërbente edhe si një vend ku do të mund t'i kryenin kolektivisht adhurimet ndaj Allahut, edhe si një vend ku do të zhvilloheshin mbledhjet e këshilltarëve ushtarakë e civilë për të shqyrtuar çështjet e ndryshme të shtetit, edhe si një vend ku pjesëtarët e umetit, të ulur në hallka njëra pas tjetrës, do të lëvronin dijen. Kjo praktikë, pas Pejgamberit tonë (s.a.s.), është pranuar si një sunet. Dhe, me të vërtetë, po të shohim periudhat e hershme të Perandorisë Osmane, do të vërejmë se situata nuk është dhe aq e ndryshme nga kjo që sapo përmendëm. Po të ishte e mundur gjetja e një rruge që do të na çonte pas në kohë dhe të shkonim në Bursa, do të shihnim atje Mehmet Çelebiun, Muratin I (Murat Hudavendigâr) dhe shumë sulltanë të tjerë të mblidhnin këshillin ushtarak në njërën anë të mesxhidit dhe këshillin civil në anën tjetër të tij për të zgjidhur problemet e ndryshme e për të përcaktuar strategjitë

²⁹⁰ Surja Huxhurât, ajeti 10.

e shtetit nën zhurmën e ëmbël të ujit që rrjedh nga shatërvanët. Kur këndohej ezani, ata vraponin drejt shatërvanit, merrnin abdes, falnin namazin dhe, pasi mbaronte falja, uleshin për të diskutuar në lidhje me çështjet që prisnin një zgjidhje. Në të njëjtën kohë, me daljen para Allahut pesë herë në ditë duke thënë “Allahu është i madh.”, bënin një parapërgatitje për punët që do duhej t’i bënin me një zemër të pastër e të dëlirë. Duke marrë parasysh faktin që të gjitha këto çështje diskutoheshin me vetëdijen e llogaridhënies para Allahut, kuptojmë se sa të pastra, të sigurta, qetësuese dhe të orientuara drejt synimeve kanë qenë vendimet e marra dhe përfundimet e arritura në ato diskutime.

a. Mundëson barazinë mes njerëzve

Adhurimet i minimizojnë në maksimum diferencimet brenda shoqërisë dhe japin kontributin e tyre në arritjen e barazisë, të cilën njerëzimi e ka ëndërruar prej kohësh. Namazi, agjërimi, haxhi dhe zekati një funksion të tillë kryejnë.

Një nga qëllimet e sistemit islam të adhurimeve është mbrojtja e njerëzve nga sëmundjet shpirtërore, mendore dhe fizike duke i mbajtur ata të shëndetshëm shpirtërisht, mendërisht dhe fizikisht. Krenaria, arroganca dhe mendjemadhësia janë boshllëqe dhe sëmundje shpirtërore të njerëzve të vegjël që nuk kanë arritur të gjejnë veten. Rënia e njeriut në dobësi të këtij lloji është gjithmonë e mundur. Për rrjedhojë, lufta ndaj këtyre dobësive duhet të vazhdojë deri në çastin e fundit të jetës. Nga ana tjetër, sinqeriteti, thjeshtësia dhe modestia janë dimensione të virtyteve që duhet të mbushin këto boshllëqe të personalitetit të njeriut. Dhe adhurimi më gjithëpërfshirës, që i bart mbi vete të gjitha këto kuptime, është namazi.

Po, namazi i eliminon ndjenjat e këqija të njeriut; ai i zhduk edhe ato gjëra që bëhen pengesë në integrimin e njeriut me njerëzit e tjerë dhe vendos mes tyre barazinë e vërtetë. Përveçse në namaz, njerëzit askund tjetër nuk mund të vijnë sup më sup me të pasur e të varfër, eprorë e nëpunës, të vegjël e të mëdhenj... Edhe krerët e shtetit, të cilët,

kur dalin në rrugë, lëvizin me truprojat e tyre që nuk lejojnë të afrohet askënd, detyrohen të ndajnë të njëjtin rresht me qytetarët e thjeshtë kur vjen puna te falja e namazit në xhami. Sepse para Allahut, ashtu siç nuk ka asnjë ndryshim mes një skllavi dhe zotërisë së tij, nuk ka asnjë ndryshim as mes atij që është veshur me kostum dhe atij që ka veshur një triko të vjetër. E vetmja gjë që mund t'i dallojë ata nga njëri-tjetri është devotshmëria.

Islami, me këtë botëkuptim të shoqërisë, vjen dhe u mundëson njerëzve një barazi të tillë. Aq shumë familjarizohemi me këtë botëkuptim në namaz, saqë, pa kaluar shumë, bëhet pjesë e çdo faze të jetës dhe mbizotërues i tyre. Kështu, njerëzit nuk e shikojnë më njëri-tjetrin nga lart e me përbuzje, nuk ikin nga njëri-tjetri. Përkundrazi, ashtu si në namaz, formojnë një strukturë të fortë e sakllame edhe në fushat e ndryshme shoqërore.

b. Disiplinon njeriun dhe shoqërinë

Namazi e disiplinon jetën e besimtarit, i mundëson atij frymën e bindjes. Besimtari, duke u lidhur në namaz pesë herë në ditë, i ndan njëzet e katër orët e tij në pesë pjesë fikse. Rrjedhimisht, – pasi të ketë vënë në ekuilibër jetën e t'u ketë dhënë drejtimin e duhur mendimeve duke dalë para Allahut – të gjitha punët i kryen sipas këtyre kohëve.

Në të njëjtën kohë, kur e kryen namazin duke u lidhur pas një imami, besimtari ia lë imamit bashkëbisedimin me Zotin; kiraeti i imamit bëhet kiraeti i tij dhe vetëm u thotë 'amin' fjalëve të imamit, u bën temena. Sepse Profeti ynë (s.a.s.), në një hadith të transmetuar nga Xhabiri (r.a.), thotë kështu: *“Për atë që lidhet pas një imami, kiraeti i imamit është edhe kiraeti i tij.”*²⁹¹ Kur imami përkulet e kalon në ruku, edhe ai bën të njëjtën gjë; kur ulet në sexhde, ulet edhe ai... Dhe kjo vazhdon në këtë mënyrë deri kur imami jep selam. Në këtë aspekt, kuptimi i imamllekut në Islam është shumë i madh. Pejgamberi ynë (s.a.s.) ka qenë gjithmonë imam i shokëve të tij; dhe, sa qe në jetë, nuk

²⁹¹ Ibn Máxhe, ikáme 13; Abdurrezzak, el Musannef 2/136.

u lidh kurrë pas dikujt tjetër në namaz. Vetëm drejt fundit të jetës së tij, kur u sëmur dhe e pati të vështirë ardhjen në mesxhid, Ebu Bekri (r.a.) qe ai që doli në mihrab dhe i priu në namaz besimtarët. Por, kur pa Profetin tonë (s.a.s.) të ndihej pak më mirë e të vinte në mesxhid, Ebu Bekri (r.a.) u tërhoq nga posti i imamit, nuk desh ta falte namazin para Tij. Sepse Ai (s.a.s.) ishte jo vetëm profet, por edhe kryetar shteti dhe imam; për rrjedhojë nuk mund të dilje si prijës i këtij imami në namaz.

Nga ana tjetër, bindje ndaj imamit nuk do të thotë t'i bindesh atij qorrazi; nëse ai bën një gabim ose harron diçka, duhet udhëzuar në atë që është e drejtë. Një herë, kur po i printe sahabët në namaz, Profetin Famëlartë (s.a.s.) e pati mërzitur një skenë që i qe shfaqur nga bota e shëmbëllimeve. Ebu Hurajra (r.a.) e përshkruan kështu këtë gjendje të të Dërguarit të Allahut: “Vetullat i qenë vrenjtur, fytyra i pati marrë një pamje ndryshe nga ajo e zakonshmja.” Për këtë arsye, gabimisht pati dhënë selam në fund të rekatit të dytë të atij namazi 4-rekatësh. Në mbarim të namazit, Dhuljedejni (r.a.) hidhet e thotë: “O i Dërguari i Allahut! A u shkurtua namazi apo harruat ju? A erdhi ndonjë urdhër nga Allahu që e falëm si 2-rekatësh namazin që herë të tjera e kemi falur me katër rekate?” I Dërguari i Allahut (s.a.s.) kthehet nga sahabët dhe i pyet: “Çfarë po thotë Dhuljedejni?” “Po thotë të vërtetën, o i Dërguari i Allahut! Falëm vetëm dy rekate.” u përgjigjën sahabët.²⁹² Pas këtyre fjalëve, Profeti ynë thotë: “Nëse ndodh ndonjë ndryshim në lidhje me namazin, unë sigurisht që do t’ju informoj për këtë. Por edhe unë jam një njeri si ju. Ashtu siç harroni ju, mund të harroj edhe unë; kur të harroj, ma kujtoni ju atë që kam harruar.”²⁹³ Ishte sikur Allahu (xhel’le xhelaluhu), duke e bërë Pejgamberin tonë (s.a.s.) të harronte rekatet e namazit, donte të fuste tek umeti frymën e paralajmërimit në rastet kur gabon imami, sikur po i frymëzonte ata për atë që duhej bërë në këtë pikë.

Me pak fjalë, imami del para xhematit dhe i prin ata në namaz. Nëse ai bën një gabim me ose pa vetëdije, ju e paralajmëroni atë. Në këtë aspekt, namazi është elementi më i rëndësishëm në disiplinimin

²⁹² Buhári, salát 88, edhán 69, shehu 3,4,5, edeb 45, ahbár 1; Muslim, mesáxhid 97, 99.

²⁹³ Buhári, salát 89; Muslim, mesáxhid 89.

e një xhemati të lartë. Ai është marrja trajtë e idesë së një bindjeje dhe nënshtrimi të shëndetshëm.

c. E bën njeriun bujar

Kur shikojmë shoqëritë e emancipuara të botës, vërejmë se ato kanë disa veçori që i bëjnë të dallohen nga shoqëritë e tjera. Shoqëria më ideale është ajo shoqëri, individët e së cilës, me të vegjël e të mëdhenj, janë modestë e të përlulur, veprojnë me ndjenjën e bindjes dhe të dorëzimit, janë të respektueshëm ndaj njëri-tjetrit dhe, gjithë bujari, u japin nga ajo që zotërojnë edhe njerëzve nevojtarë. Ja, pra, namazi është ai adhurim sublim që i bart në vetvete të gjitha këto veçori. Namazi është një formulim i modestisë dhe një thirrje e shenjtë që i bën njerëzit të fitojnë ndjenjën e bujarisë.

Po, në namaz, njeriu praktikon bujarinë; para së gjithash, ai sakrifikon nga koha e tij; çdo kohë vjen e shkon, por koha e tij në namaz arrin pafundësinë. Në sajë të namazit, koha fiton vlerë dhe merr trajtën e një vije të shndritshme mes ekszitencës së domosdoshme dhe asaj të mundshme. Për ta paraqitur këtë me një shembull, mund të themi kështu: Njeriu, për hir të Allahut, jep zekatin nga pasuria e tij, të cilën e fiton duke ia kushtuar afërsisht një të tretën e kohës së tij dynjasë. Ai e jep këtë zekat jo nga kapitali, jo nga koha e tij, por nga produkti apo pasuria që fiton nëpërmjet atij kapitali. Mirëpo, në çështjen e namazit nuk ndodh kështu; ai i jepet Zotit tërësisht nga kapitali. Besimtari që falet pesë herë në ditë, po të përfshijmë këtu edhe kohën që kalon gjatë marrjes së abdesit dhe rrugës për në mesxhid, një pjesë të konsiderueshme dhe të rëndësishme të kapitalit të tij ditor 24-orësh e ndan për Zotin e tij. Kjo do të thotë se, në këtë mënyrë, ai investon drejtpërdrejtë në kohë. Kjo situatë është pak a shumë si të japësh si zekat vetë pemën në vend që ta japësh zekatin nga frutat e saj.

Po, njerëzit që vijnë në xhami pesë herë në ditë kanë një ndjenjë të atillë bujarie, sa që janë të gatshëm të japin për Allahun edhe kapitalin e tyre. Sepse ata, në lidhje me mundësitë e tyre për ta bërë këtë pesë

herë në ditë, kanë dhënë fjalën. Shyqyr Zotit, ne jemi sot dëshmitarë të shumë fytirave të pasura dhe zemrave të përulura që bëjnë sexhde, ose më saktë, jemi dëshmitarë të mijëra individëve që, me të pasur e të varfër, të rinj e të moshuar, po përpiqen, po derdhin mund në rrugën për të ngritur një shoqëri shumë të dashur tek Allahu.

PJESA E SHTATË

NAMAZI I XHUMASË
..***..

1. Rëndësia e namazit të xhumasë

Namazi i xhumasë, si namaz, nuk ndryshon nga namazet e tjerë; domethënë, edhe ai përbëhet nga kijami, kiraeti, rukuja, sexhdeja dhe çdo pjesë tjetër e namazeve të përditshëm. Thënë ndryshe, namazi i xhumasë konsiston në rrahjen e flatrave të njeriut për t'u ngjitur te Zoti i tij, në realizimin e miraxhit, në vajtjen mendërisht dhe duke përdorur imagjinatën pranë Udhërrëfyesit të Përsosur (s.a.s.), i cili jetoi katërmëdhjetë shekuj më parë, dhe në zënien vend pas Tij. Ne, ashtu siç i ndajmë njëzet e katër orët e ditës në pesë pjesë dhe i ndriçojmë ato nëpërmjet pesë kohëve të namazit, edhe javën e ndajmë nëpërmjet xhumasë, i japim formë dhe e spërkasim me pikla drite. Orën tonë javore e kurdisim sipas xhumasë dhe, kur vjen çasti i saj, i drejtohem Zotit me të gjitha shqisat, ndjenjat dhe zemrat tona. Sepse xhumaja (e premtja), ndër ditët e krijuara prej Allahut, është më e çmuara. I Dërguari i Allahut (s.a.s.), veçoritë e kësaj dite i rëndit kështu: *“Xhumaja është më e nderuara e ditëve (të tjera të javës). Dhe, tek Allahu, është më e rëndësishmja. Për Allahun, ajo është më e rëndësishme edhe se ditët e Bajrameve të Kurbanit dhe Ramazanit. Kjo ditë ka pesë veçori: Allahu (xhel'le xheláluhu) e ka krijuar Ademin (a.s.) në këtë ditë, në këtë ditë e zbriti atë në tokë dhe po në këtë ditë ia mori shpirtin atij. Për më tepër, në këtë ditë gjendet edhe një kohë e atillë, gjatë së cilës, për sa kohë nuk kërkon prej Allahut diçka të ndaluar, robit i jepet patjetër ajo që dëshiron. Në këtë ditë do të ndodhë edhe kiameti. Të gjithë engjëjt e afërt me Allahun, qielli, toka, era, mali, deti... tërhiqen para madhështisë dhe vlerës së kësaj dite.”*²⁹⁴

²⁹⁴ Ibn Máxhe, ikáme 79; Ahmed ibn Hanbel, el Musned 3/430.

Ndërkohë që ato që ne i quajmë ditë po e plotësojnë ciklin e tyre në këtë botë, edhe në makrobotë ka një cikël. Në këtë botë, sipas fjalëve të Pejgamberit tonë (s.a.s.), xhumaja është dita e shfaqjes së njeriut në tokë. Për rrjedhojë, kur të premtet, të shtunat, të dielat... e kësaj bote përkohë dhe janë në përputhje me ditët e makrobotës, kyçi hapet sikur të kesh futur kodin e saktë dhe vetëm atëherë njeriu gjen rastin për të plotësuar kurbën e zemrës së tij. Në të kundërt, atëherë kur mes këtyre ditëve ka një mospërputhje, njerëzit nuk mund të përfitojnë nga begatitë hyjnore. Për shembull, hebrenjtë dhe të krishterët, duke thënë e shtuna dhe e diela, nuk kanë mundur të përfitojnë nga këto sekrete. Kurse umeti i Muhamedit (s.a.s.), duke pasur parasysh rëndësinë e xhumasë, i ka dalë zot kësaj dite dhe është përpjekur e po përpiqet ta vlerësojë dhe përjetojë atë me entuziazëm çdo javë. Dhe, në dashtë Zoti, kështu do të vazhdojë deri në ditën e kiametit. I Dërguari i Allahut (s.a.s.) e shpreh këtë të vërtetë në këtë mënyrë: *“Allahu i Lartë, ata para nesh i bëri të hutohen në çështjen e gjetjes së xhumasë. Për këtë arsye, e shtuna u bë dita e hebrenjve, kurse e diela, ajo e të krishterëve. Allahu (xhel’le xheláluhu) na krijoi dhe na udhëzoi në çështjen e gjetjes së ditës së xhuma: na e mundësoi edhe xhumanë, edhe të shtunën, edhe të dielën (si ditë adhurimesh). Ata do të na vijnë nga pas edhe në ditën e kiametit. Ne jemi të fundit në mesin e popujve të kësaj bote, por do të jemi të parët në ditën e kiametit, do të jemi ata që do të mbarojnë punë me llogaridhënien para të gjitha krijesave të tjera.”*²⁹⁵

Nuk mund të vihesh në rrugë me një mjet difektoz, nuk mund të përparosh nëpërmjet një sistemi të prishur, arritja e synimeve në këtë mënyrë është e pamundur. Ne erdhëm në këtë botë më vonë se ata, por i parakaluam dhe e fituam garën. Prandaj namazi i xhumasë është më domethënësi dhe më gjithëpërfshirësi i namazeve. Kështu që, besimtari do t’ia dijë vlerën atij, do ta çmojë dhe do të përpiqet ta kryejë atë me çdo kusht.

Po, namazi i xhumasë plotëson javën dhe i ngre njerëzit në një vend nga ku mund t’i afrohen Allahut. Kurse ata, në sajë të xhumasë,

²⁹⁵ Muslim, xhumu’á 22; Nesáí, xhumu’á 1; Ibn Máxhe, ikáme 78.

mendojnë për mënyrat e të përfiturit nga mëshira e Zotit. Me fjalë të tjera, pasi kanë falur namazet përgjatë gjashtë ditëve, në një ditë të caktuar ngjiten në një pikë të caktuar për të marrë shpërblimin. Në atë ditë, prehri i atij që është i ndërgjegjshëm dhe që e ka lidhur zemrën e tij me të Vërtetin (xhel'le xheláluhu) do të mbushet përplot me xhevahire. Pra, dita e xhuma është shprehja e arritjes në një majë të caktuar për të marrë në fund të udhëtimit njëjavor gjërat e përcaktuara nga Zoti. Këtë të vërtetë, Profeti ynë (s.a.s.) e ka shprehur nëpërmjet hadithit në vijim: *“Pesë namazet ditore dhe namazet e xhumasë nga njëra ditë e xhuma në xhumanë tjetër janë shlyerje; për sa kohë nuk bëhet ndonjë mëkat i madh, namazet bëhen shkak për faljen e mëkateve që kryhen mes tyre.”*²⁹⁶

Siç vërehet, Pejgamberi ynë (s.a.s.) e ndan ditën, javën dhe vitin në pjesë të caktuara dhe na bën me dije se namazet që kryhen gjatë atyre pjesëve i ndriçojnë edhe pjesët kohore që kalojnë pa namaz.

Në Kuranin Famëlartë, Zoti ynë, me fjalët **“O besimtarë! Kur të thirreni për (të falur) namazin (e xhumasë) në ditën e premte, pezulloni tregtinë dhe vraponi për ta përmendur Allahun! Kjo, që ta dini, është më e mirë për ju!”**²⁹⁷, sikur po na thotë: “Ai që po ju fton është i Adhuruari Absolut, i Dëshiruari i Merituar. Duke ju ftuar për në namazin e xhumasë, dëshiron t’ju lartësojë e t’ju marrë pranë Vetes. Dhe, ashtu siç i nënshkruajnë të zotët e dasmës ftesat e saj, edhe Ai e ka nënshkruar këtë ftesë me fjalët *“Allahu Ekber, Allahu Ekber...”*”.

Në ajetin e mësipërm, fjala ‘nida’ i referohet ezanit. Zaten, përkthesa e myslimanëve, që ngrihet në fluturim nga minaretë pesë herë në ditë dhe rreh flatrat drejt qiejve, ezani është. Kurse me fjalën ‘dhikr’ nënkuptohet namazi që fillon me hutben. Në kohën e Profetit sonë (s.a.s.), ky ezan këndohej kur imami gjendej në minber. Mandej thirrej ikameti dhe fillonte namazi. Ky zbatim pati vazhduar edhe në kohët e udhëheqjes së Ebu Bekrit dhe Omerit (radijalláhu anhumá). Por, me shtimin e numrit të myslimanëve dhe zgjerimin e qyteteve ditë pas dite, arritja e zërit në të gjitha anët dhe dëgjimi i tij u bë i pamundur.

²⁹⁶ Muslim, taháret 10, 15, 16; Tirmidhí, salát 46; Ahmed ibn Hanbel, el Musned 2/359.

²⁹⁷ Surja Xhumu’a, ajeti 9.

Për këtë arsye, në mënyrë që ezani të dëgjohej nga i gjithë populli, Osmani (r.a.) nisi edhe këndimin e ezanit të jashtëm, si një ezan shtesë për ezanin që këndohej kur imami ndodhej në minber. Kjo metodë u aprovua edhe me konsensusin (*ixhmá*) e dijetarëve myslimanë. Edhe ezani që këndohej gjatë hutbes, duke qenë se ishte nga sunetet e Profetit Muhamed (s.a.s.), u vazhdua në të njëjtën mënyrë.

Sipas sahabëve, shprehja në ajet **“Vraponi për ta përmendur Allahun.”** bart kuptimin “Shkoni menjëherë.” Abdullah ibn Mesudi (r.a.) thotë: *“Nëse ajo do të nënkuptonte me të vërtetë të vrapuarit që dimë ne, kur të këndohej ezani, do të kisha vrapuar në një mënyrë të atillë, saqë edhe xhybeja do t’më kishte rënë nga supet.”*²⁹⁸ Sahabët e patën kuptuar këtë shprehje si ecje plot entuziazëm drejt mesxhidit. E, në fakt, vajtja me seriozitet dhe qetësi për të falur namazin është diçka thelbësore. Ndoshta do t’ju lindë përbrenda dëshira për të vrapuar, por, me dinjitetin dhe seriozitetin që i shkon për shtat vetëm besimtarit, ju do ta frenoni këtë shpërthim të brendshëm tuajin dhe do të shkoni drejt mesxhidit dalëngadalë. Do të shkoni dhe do të falni aq pjesë sa keni arritur të kapni nga namazi, kurse pjesët e tjera, duke vepruar në përputhje me dekretin *“Kur të këndohet ikameti për faljen e namazit, mos hajdeni në namaz duke vrapuar, ejani duke ecur, mos hiqni dorë nga serioziteti, falni aq sa arrini të kapni nga namazi, atë që nuk e keni arritur plotësojeni pastaj.”*²⁹⁹ të Pejgamberit tonë (s.a.s.), do t’i plotësoni në fund.

Sahabët e nderuar, sa herë që thirreshin për në namaz, shkonin me dëshirë e plot entuziazëm. Ezani u freskonte atyre shpirtin dhe bëhej shkak që, qoftë edhe për fare pak, të shpëtonin nga gajlet mbytëse të kësaj dynjaje e të ndiheshin të lehtësuar. Në të njëjtën kohë, kjo gjendje është edhe një shenjë e të qenit besimtar; besimtari, kur merr një ftesë nga Allahu, i përgjigjet ftesës pa humbur kohë. Pra, nëpërmjet ajetit të mësipërm, Kurani bëhet përkthyes i kësaj gjendjeje shpirtërore të besimtarit.

Një çështje tjetër në këtë ajet, që mund të na bëjë përshtypje të gjithëve, është shprehja **“pezulloni tregtinë”**. Në këtë botë, gjëja më

²⁹⁸ Ibn Ebí Shejbe, el Musannef 1/482; Abdurrezzak, el Musannef 3/207.

²⁹⁹ Buhári, xhumu’a 18; Muslim, mesáxhid 151.

tërheqëse për njeriun është të vrapuarit pas fitimit dhe të fituarit e katër-pesë qindarkave më shumë në çdo tregti që bën. Për rrjedhojë, tregtari do të pezullojë tregtinë kaq tërheqëse për të dhe do të vijë në xhami; nëpunësi civil do të ngrihet nga tavolina e tij e punës dhe do të vrapojë për në xhami; punëtori do të mbyllë tezgjahun e tij, do të dëgjojë ezanin dhe do të niset drejt xhamisë...

Kurse fjalia **“Kjo, që ta dini, është më e mirë për ju!”** në fund të ajetit, na thotë këtë: Në emër të fitimit të kënaqësisë dhe pëlqimit të Zotit dhe të sigurimit të lumturisë suaj në botën tjetër, është më e vlefshme për ju t’i lini të gjitha punët dhe të shkoni për në namazin e xhumasë, i cili është nga mirësitë më të larta hyjnore në sofrën e zifafetit të sjellë nga Muhamedi (s.a.s.). E thënë ndryshe, nëse e ndieni në ndërgjegjet tuaja domethënien e urdhrave të Kuranit me gjithë peshën e tyre, nëse e ndieni brenda vetes kënaqësinë që të jep namazi, atëherë nuk është e nevojshme t’ju flas për të mirat dhe virtytshmërinë e namazit të xhumasë, ju i dini më mirë ato. Kështu, i bie që, kur t’ju vijë në vesh thirrja, do të braktisni tregtinë dhe, me seriozitetin që i shkon për shtat besimtarit, do të vraponi drejt mesxhidit.

Kurse në ajetin pasardhës, thuhet kështu: **“Dhe, kur të përfundojë namazi, shpërndahuni nëpër tokë, kërkoni nga mirësitë e Allahut dhe përmendeni shumë Atë, në mënyrë që të shpëtoni.”**³⁰⁰ Në çështjen se çfarë janë këto mirësi të Allahut, Abdullah ibn Abasi (r.a.) bën një vlerësim të këtillë: *“Me këtë ajet, besimtarët nuk janë urdhëruar të vrapojnë pas gjërave të kësaj bote. Këtu, mirësitë e Allahut nënkuptojnë gjëra të tilla si vizitat e të sëmurëve, marrjet pjesë në varrime dhe vizitat e vëllezërve të fesë vetëm për hir të Allahut.”*³⁰¹ Megjithatë, po ta marrim këtë çështje e ta shqyrtojmë në një mënyrë më gjithëpërfshirëse, mund të themi kështu: Falni namazin, që të pastroheni përbrenda e të bëheni të dëlirë, dhe, pastaj, shpërndahuni nëpër tokë, me ndjenjën e përgjegjësisë për të përfitur nga të gjitha mirësitë e Allahut, edhe nga mirësitë e kësaj bote, edhe nga ato të botës tjetër. Jetoni një jetë

³⁰⁰ Surja Xhumu’a, ajeti 10.

³⁰¹ El Begauí, Meálimut’tenzil 4/345; es Sujúti, ed Durrul mensúr 8/165.

të ndritshme e të begatë, që jeta juaj të hyjë në binarë. Vetëm në këtë mënyrë mund të arrini shpëtimin.

Ndërsa nëpërmjet ajetit të fundit të sures, i cili thotë **“Mirëpo, sa herë që ata shohin ndonjë tregti ose lojë, shkojnë tek ajo e të lënë ty në këmbë. Thuaj: ‘Ajo që është tek Allahu, është më e mirë se argëtimi e tregtia.’ Allahu është Dhuruesi më Bujar.”**³⁰², tërhiqet vëmendja te një ngjarje që ka ndodhur në kohën e Profetit tonë (s.a.s.):

Një ditë, i Dërguari i Allahut po mbante hutben në minber. Ishte një kohë kur në Medine sundonte uria dhe shtrenjtimi i çmimeve. Befas u dëgjua zëri i një kasneci ose zhurma e një daulleje, që lajmëronte kthimin nga Damasku të një karvani tregtie. Ata që ndodheshin në mesxhid e lanë dëgjimin e hutbes dhe vrapuan në drejtim të karvanit. Sigurisht, patën vepruar në këtë mënyrë ngaqë, atëherë, nuk ishin ende të vetëdijshëm për obligimin për të dëgjuar Profetin tonë në minber dhe ngaqë nuk dinin mjaftueshëm në lidhje me rregullat e hutbes dhe të namazit të xhumasë. Sahabët si Selman Farisiu, Abdullah ibn Mesudi dhe Bilal Habeshiu, të cilët e transmetojnë këtë ngjarje, na bëjnë me dije se aty kishin mbetur vetëm dymbëdhjetë burra dhe një grua. I Dërguari i Allahut (s.a.s.), pasi mërzhitet shumë nga kjo situatë thotë: *“Betohem tek Allahu, i Cili ka në dorë shpirtin e Muhamedit, se, nëse do të kishit ikur të gjithë, një vërshim zjarri do ta kishte mbushur luginën dhe do t’ju merrte edhe ju me vete.”* Kurse sipas një transmetimi tjetër, ka thënë kështu: *“Po të mos kishin qenë ata që qëndruan, mbi ju do të kishin rënë gurë nga qielli.”*³⁰³

Po, largimi ndërkohë që Profeti po mbante hutben ishte diçka e frikshme; kjo është edhe arsyeja pse qortimi i sahabëve është po ashtu i frikshëm. Megjithatë, ata fatlumë të paktë në numër e kishin kuptuar thelbin dhe rëndësinë e kësaj çështjeje dhe, duke mos e lënë vetëm të Dërguarin e Allahut, e parandaluan ardhjen e asaj fatkeqësie të madhe. Transmetohet se, pas kësaj ngjarjeje, sahabët e dëgjuan Profetin tonë

³⁰² Surja Xhumu’a, ajeti 11.

³⁰³ Ebú Ja’lá, el Musned 3/468; eth Tha’lebi, el Keshf uel beján 9/317; el Begauí, Meálimut’tenzíl 4/345.

(s.a.s.) sikur të ishin të lidhur me pranga nga këmbët. Me aq edukatë uleshin tashmë kur dëgjonin hutben, saqë uljet e tyre sikur merrnin trajtën e namazit. Sipas asaj që thotë Said ibn Xhubejr (r.a.), dëgjimi i hutbes gjatë periudhës së profetësisë së Muhamedit (s.a.s.) konsiderohej i barabartë me një namaz dyrekatësh.³⁰⁴

Me pak fjalë, duke qenë se është më e nderuara e ditëve, dita e xhuma qëndron në vendin e vet pa lëvizur dhe ruan gjendjen e saj të veçantë. Kurse ditët e tjera të javës marrin pozicionet e tyre dhe mbajnë qëndrim në varësi të ditës së xhuma. Bajrami, Arefeja dhe ditët e ngjashme me to ndryshojnë gjithmonë dhe bien në kohë të ndryshme. Për këtë arsye, besimtarët i kushtojnë më shumë vëmendje jo Bajrameve, po ditës së xhuma. Kurse ata, të cilëve u duket e rëndë ardhja për në namazin e xhumasë një herë në javë, për të ngushëlluar veten, vijnë në xhami dhe i bashkohen xhematit nga Bajrami në Bajram. Mirëpo, si mund të krahasohen namazet e Bajrameve me namazin e xhumasë! Sahabët i kushtonin namazit të xhumasë ndoshta njëqindfishin e rëndësisë që i kushtonin Bajramit. Sepse i Dërguari i Allahut (s.a.s.) pati thënë: *“Allahu ia vulos zemrën atij që, duke mos i dhënë rëndësi kësaj gjëje (sipas një transmetimi tjetër, pa arsye), e braktis tri herë rresht namazin e xhumasë.”*³⁰⁵ Me fjalë të tjera, tek ai njeri vdes dashuria ndaj adhurimeve, fillon të privohet jo vetëm nga kënaqësia e namazit të xhumasë, por edhe nga ajo e pesë namazeve ditore dhe, më pas, bie në një derexhe të atillë sa të mos jetë më në gjendje për ta dashur Allahun, për ta vlerësuar Udhëzuesin e Përsosur dhe për të zënë vend pas Tij. Një njeri i tillë vjen para Allahut sikur të ketë një litar në qafë e të jetë duke u tërhequr me zor nga dikush.

Kurse në një hadith tjetër, me natyrë kërcënuese, disiplinuese dhe riedukuese, thuhet kështu: *“Disa njerëz, ose do të heqin dorë nga braktisja e namazit të xhumasë, ose do të vuajnë vulosjen e zemrave të tyre nga ana e Allahut. Dhe, kështu, do të futen në grupin e të hutuarve dhe do të*

³⁰⁴ El Kurtubí, el Xhámí’ li ahkámil Kur’án, 18/114.

³⁰⁵ Ebú Dáúd, salát 209; Nesáí, xhumu’a 2.

*shndërrohen në individë të padëgjueshëm e të pandjeshëm.*³⁰⁶

Po, kaq e madhe është xhumaja dhe kaq shumë peshë ka. Të gjitha këto hadithe shprehin ndjeshmërinë e Pejgamberit tonë, Krenarisë së Gjithësisë (s.a.s.) në çështjen e rëndësisë së xhumasë, ose më saktë, shprehin peshën e mësimëve dhe udhëzimeve të Allahut të Madhëruar ndaj Tij në këtë pikë.

2. Namazi i xhumasë është një adhurim gjithëpërfshirës

Arabët, kur emërtojnë shtatë ditët e javës, thonë: “Dita e parë, dita e dytë, dita e tretë...”; kurse ditën e premte e quajnë dita ‘*xhumua*’ (dita e bashkimit, grumbullimit), që bart kuptimin e ditës së përfitimit nga ato gjëra që na vijnë prej Zotit të Madhëruar nëpërmjet përqendrimit të ndërgjegjes kolektive në një pikë të caktuar. Në periudhën e injorancës, këtë ditë e quanin ‘*arúba*’. Pavarësisht emrit që përdoret, xhumaja është një ditë mbledhjeje, pra, është dita e të qenit gati për parakalimin në praninë e Allahut, dita e të qenit të gatshëm për t’u inspektuar. Me fjalë të tjera, është dita e daljes para Allahut për të dhënë llogari të gjithë bashkë dhe për të treguar gatishmërinë tonë ndaj urdhrave të Tij pasi kemi lënë pas përgjegjësinë e pesë kohëve ditore të namazit.

Kur i braktisim ato gjëra që ne i konsiderojmë fitimprurëse në këtë botë dhe vrapojmë drejt kësaj ftese, sigurisht që shkojmë duke menduar për majën ku do të arrijmë. Sepse xhematit që fal namazin e xhumasë në tokë i bashkohen edhe engjëjt. Për rrjedhojë, bashkë me lutjet e xhematit, për tek Allahu ngrihen edhe lutjet e engjëjve; sado e dobët të jetë lutja e robërve të pafuqishëm si puna jonë, shpresohet që, duke u gjendur në mesin e lutjeve të atyre krijesave të pastra e të pafajshme, edhe ato të jenë të denja për t’u pranuar.

Po, namazi i xhumasë nuk është një adhurim individual; ai është drejtimi i ndërgjegjes kolektive për tek Allahu i Lartësuar. Robi, i paafte për t’i shprehur i vetëm mirënjohjen dhe falënderimet ndaj Allahut

³⁰⁶ Muslim, *xhumu’á* 40; Nesáí, *xhumu’á* 2.

për begatitë e panumërta të Tij, sikur thotë: “Zoti im! Unë nuk kam si t’u përgjigjem me gjendjen time personale mirësive dhe begative të Tua, për të cilat Ti shprehesh në Kuran me fjalët ‘*Nëse do t’i numëronit mirësitë e Allahut, nuk do të mund t’i llogarisnit ato.*’³⁰⁷, ndërgjegjja ime është e pamjaftueshme për këtë. Prandaj jemi mbledhur bashkë, që t’i paraqesim para Teje si xhemat mirënjohjen, falënderimet, adhurimet dhe robërinë tonë ndaj Teje. Zoti im, mos i kushto vëmendje zërit tim të dobët! Dëgjo zërin e plotë dhe buçitës të xhematit tek thotë ‘*Allahu Ekber!*’ Shiko se si thonë ‘*Allahu Ekber!*’ dhe qëndrojnë në kijam, thonë ‘*Allahu Ekber!*’ dhe kalojnë në ruku, thonë ‘*Allahu Ekber!*’ dhe bien në sexhde! Shiko se si të përmendin Ty aty duke thënë ‘*Subhánalláh!*’ Edhe unë, si pjesë e këtij zëri buçitës të xhematit, dua të shpreh mirënjohjen dhe falënderimet e mia ndaj mirësive të Tua të pafund.”

Nga ana tjetër, xhumaja është një pikë pasqyrimi e emrave të Allahut. Kështu, ajo konsiston në indeksimin në një pikë të caktuar të çdo gjëje të krijuar në univers si rezultat i veprimtarisë hyjnore. Kuptimi i kësaj është të koncentrosh diçka dhe, duke e holluar atë kur e kërkon nevoja, të bësh të mundur që ajo gjë të kryejë një detyrë shumë herë më të madhe se detyra e saj e mëparshme. Në këtë aspekt, xhumaja bart kuptimin e bashkimit në një të të gjitha ditëve të krijimit. Xhumaja, e cila ndan javën, ndan njëkohësisht edhe muajt e vitet dhe, në këtë mënyrë, spërkat me copëza drite të tërë vitin, të gjithë jetën e njeriut. Në të njëjtën kohë, në namazin e xhumasë ndiejmë edhe gëzimin dhe kënaqësinë e engjëjve që rrinë në ruku, bëjnë sexhde, qëndrojnë në kijam përgjatë gjithë jetës së tyre.

3. Disa pika që duhen pasur kujdes në namazin e xhumasë

Për shkak të rëndësisë së namazit të xhumasë, janë përcaktuar disa kushte për të dhe na është bërë e ditur se, pa plotësimin e tyre, namazi i xhumasë nuk do të pranohet. Para së gjithash, siç e thamë edhe më lart, individit duhet ta kryejë namazin e xhumasë jo vetëm, por me një

³⁰⁷ Surja Nahl, ajeti 18.

xhemat. Namazi i xhumasë quhet i kryer kur ai falet me xhemat dhe kur hutbeja e tij dëgjohet nga xhemati.

Po, xhumaja është namaz i xhematit; prandaj, kur të shkojmë për ta kryer atë, do të veshim rrobat tona më të bukura, do të hedhim aromat më të këndshme dhe do të përpiqemi ta përfaqësojmë atë brenda një atmosfere të këtyllë. Dita e xhuma është dita e fundit e gjashtë ditëve të krijimit të gjithësisë. Në makrobotë, këto ditë kanë kuptimin e epokave. Pra, janë epokat që kanë kaluar nga çasti i krijimit të qiejve dhe tokës deri në çastin kur rruzulli tokësor u bë i përshtatshëm për vazhdimin e jetës. Tek Allahu, ato kanë vlerën e gjashtë ditëve: **“Në të vërtetë, Zoti juaj është Allahu, që krijoi qiejt dhe Tokën për gjashtë ditë...”**³⁰⁸

Ebu Hurajra (radijalláhu anh) transmeton: “I Dërguari i Allahut (s.a.s.) më kapi dorën një ditë dhe tha: *Allahu e krijoi dheun ditën e shtunë. Malet i krijoi të dielën; pemët i krijoi ditën e hënë. Gjërat e nevojshme për jetën i krijoi të martën. Dritën e krijoi ditën e mërkurë, kurse kafshët i përhapit të enjten. Ademin (a.s.) e krijoi pas kohës së ikindisë së ditës së xhuma, e krijoi atë si krijesën e fundit në orën e fundit të ditës, mes ikindisë dhe natës.*”³⁰⁹

Hebrenjtë e patën kuptuar gabim këtë çështje. Duke thënë “Kjo punë mbaroi ditën e xhuma, të shtunën Allahu bëri pushim.”, i veshën Allahut lodhjen. Por myslimanët, në sajë të udhëzimit të Profetit tonë Bujar, nuk ranë në një situatë kaq të rrezikshme e të frikshme.

Koha e xhumasë është koha e mesditës; pra, është koha kur njeriu arrin pjekurinë. Profeti ynë (s.a.s.), duke qenë se kështu qe urdhëruar nga Allahu, caktoi kohën e mesditës si kohën e faljes së këtij namazi, që do të bëhej shkak për shikimin e Allahut të Madhëruar. Kthimi për tek Allahu në atë kohë është një shkak për ta parë Atë. I Dërguari i Allahut (s.a.s.) e shpjegon këtë nëpërmjet një krahasimi duke thënë: *“Do ta shikoni Zotin tuaj ashtu siç mund të shihni fare qartë diellin në kohën e drekës.”*³¹⁰

³⁰⁸ Surja A'ráf, ajeti 54.

³⁰⁹ Muslim, sifátul munáfikín 27; Ahmed ibn Hanbel, el Musned 2/327.

³¹⁰ Buhári, edhán 129, rikák 52, teuhíd 24; Muslim, zuhd 16.

Një kusht tjetër për namazin e xhumasë është përcaktimi i vendit ku do të kryhet falja. Për namazet e tjerë, Profeti ynë (s.a.s.) thotë kështu: *“Toka më është bërë e pastër, e dëlirë dhe mesxhid. Kushdo që arrin kohën e namazit, e fal atë kudo që të jetë.”*³¹¹ Ama, për namazin e xhumasë nuk është kështu; ju nuk mund ta falni namazin e xhumasë në majë të malit duke vënë si sutre shkopin tuaj. Ai kryhet në vende të urbanizuara e të qytetëruara, banorët e të cilëve e kanë kuptuar domethënien e ndërgjegjjes kolektive dhe janë në gjendje të veprojnë në grup.

Përveç këtyre, i Dërguari i Allahut (s.a.s.) vë theksin edhe në ca pika të tjera, të nevojshme për namazin e xhumasë. Për shembull, kur po mbante një herë hutben në minber, mesxhidin e pati pushtuar një erë shqetësuese djerse, si rezultat i djersitjes së shumtë të xhematit për shkak të punëve të rënda që bënin dhe të veshjes me rroba leshi edhe gjatë ditëve të nxehta. Për rrjedhojë, i Dërguari i Allahut (s.a.s.) i pati këshilluar sahabët të laheshin para se të vinin në xhami, të lyheshin me aromat më të këndshme dhe të kishin një veshje të veçantë për namazin e xhumasë. Hadithi që i shpreh këto është si vijon: *“Gusli i xhumasë është vaxhib për të gjithë ata që kanë arritur moshën e pjekurisë, po ashtu edhe përdorimi i misvakut dhe, nëse është në gjendje ta gjejë atë, lyerja me aromë të mirë.”*³¹² Dijetarët e fikhut e kanë diskutuar gjerë e gjatë këtë çështje dhe, si përfundim, disa prej tyre e kanë pranuar ashtu siç është fjalën ‘vaxhib’ të Pejgamberit tonë (s.a.s.) dhe kanë vendosur që marrja e guslit para namazit të xhumasë të jetë vaxhib, kurse disa të tjerë, duke thënë se kjo gjë nuk shpreh një detyrim, kanë vendosur që gusli para namazit të xhumasë të njihet si sunet.

Sipas transmetimeve të Buhariut dhe Muslimit, i njëjti diskutim është zhvilluar edhe mes Omerit (r.a.) dhe njërit prej sahabëve më të shquar. Omeri (r.a.), kur po mbante hutben në minber një ditë të xhuma, sahabi futet brenda nga dera e mesxhidit. Papritmas, Omeri (r.a.) e lë në gjysmë hutben dhe i drejtohet atij me fjalët: *“Ku ishe deri në këtë kohë? A nuk duhej të vije në xhami menjëherë pas këndimit të ezanit*

³¹¹ Buharí, tejemmum 1, salát 56; Muslim, mesáxhid 3, 4, 5.

³¹² Buharí, xhumu’a 2-5, 12, 26; Muslim, xhumu’a 1-12.

të namazit të xhumasë?” Sahabi i përgjigjet në këtë mënyrë: “O kalif i Profetit të Allahut (s.a.s.)! Sapo dëgjova ezanin, nxitova për të ardhur këtu. Përveçse mora abdes, asgjë tjetër nuk bëra.” Bashkë me pranimin e gabimit, justifikimi është legjitim; kishte nxituar të bëhej gati kur kishte dëgjuar ezanin dhe aq kishte mundur të kapte nga namazi i xhumasë. Omeri ama, nuk e lë me kaq: “Kur dëgjove ezanin, more abdes dhe nxitove të vije në mesxhid. Por edhe e mjaftuara jote vetëm me marrjen e abdesit është një mangësi. I Dërguari i Allahut (s.a.s.) na ka urdhëruar që edhe të lahem!”³¹³

Sahabi e dinte shumë mirë që gusli i ditës së xhuma nuk ishte as farz dhe as një nga kushtet e namazit të xhumasë. Ai, ngaqë e dinte se kjo fjalë e Profetit tonë (s.a.s.) nuk shprehte një domosdoshmëri, e pati perceptuar atë vetëm si një virtyt. Prandaj kishte marrë vetëm abdes para se të shkonte në faljen e namazit të xhumasë. E, megjithatë, sahabët e qortonin vëllanë e tyre dhe i kërkonin llogari njëri-tjetrit edhe për çështjet më të vogla. Sepse ata silleshin natyrshëm me njëri-tjetrin dhe, në të njëjtën kohë, ishin të gatshëm për të duruar çdo gjë që mund t’u vinte nga vëllezërit e fesë. Nuk i mbanin mëri njëri-tjetrit, nuk u mbetej hatri. Kështu që, mund ta qortonin njëri-tjetrin pa problem dhe mund t’ia thoshnin në fytyrë fare lehtë njëri-tjetrit mangësitë. Kjo situatë kërkon që të jesh i natyrshëm dhe t’i qëndrosh larg shtirjes dhe dëshirës për t’u dukur. Kjo gjendje nuk është nga ato gjëra që mund të përballohen prej shoqërisë së ditëve të sotme. Sot është thuajse e pamundur t’i thuash dikujt mangësitë që ka; sepse të gjithë e shohin veten të patëmetë. Kjo është arsyeja pse përballemi me kryeneçësinë dhe reagimet e ashpra të tjetrit edhe kur ajo gjë që po i thoni është diçka e papërfillshme. Ndoshta edhe ne vetë jemi në të njëjtën situatë; edhe pse shpeshherë shprehemi duke u treguar të gatshëm për t’i pranuar mangësitë që mund të na i numërojnë dikush në fytyrë, prapë reagojmë ashpër ndonjëherë dhe nuk i avitemi që nuk i avitemi pranimit të atyre mangësive.

Ky shekull është shekulli i egos dhe arrogancës. Është pothuajse e pamundur t’ua thuash njerëzve mangësitë në fytyrë. Kam frikë se, edhe

³¹³ Buhárí, xhumu’á 2; Muslim, xhumu’á 3-4.

sikur të dilte në minber sot Krenaria e Gjithësisë, Profeti ynë (s.a.s.), për t'u shpjeguar diçka njerëzve të ditëve të sotme, kur nga goja e Tij të dilnin fjalë që prekin plagët tona, ne do ta kishim mërztur edhe Atë. Kjo mesele është shumë e vështirë. Ah, sikur të kishim ndonjë shok, të cilit mund t'ia jepnim pa problem autoritetin për të na i thënë në fytyrë dhe pa më të voglin hezitim mangësitë dhe gabimet tona! Ai të na i thoshte në fytyrë mangësitë tona, ne t'i thoshnim atij mangësitë e tij dhe, në këtë mënyrë, të ishim në gjendje të kontrollonim veten, por, ç'e do! Ku ta gjesh sot një person të atillë! Sahabët ama, që të gjithë i bënë kontrollin vetes dhe të tjerëve; ndonjëherë ishte kalifi ai që i thoshte sahabit "Po thua se ke marrë abdes dhe ke ardhur në xhami. Po gusli, ç'u bë?" dhe i bënte pyetje, ndonjëherë ishte sahabi ai që çohej dhe i thoshte kalifit "Nga e more këmishën që ke mbi trup? Sepse unë nuk qeshë në gjendje të nxirrja një këmishë nga pëlhura që më ra për pjesë!" dhe i kërkonte llogari. Dhe askush nuk shqetësohej, as nuk bezdisej, nga kjo kërkesë e llogarisë. Kalifi, ndoshta duke u shpjeguar në një mënyrë të pranueshme në lidhje me çështjen e këmishës, bëhej shkak që dyshimet në zemrën e besimtarit të zhdukeshin; po ashtu edhe sahabi, bashkë me pranimin e gabimit apo të mangësive të tij, shpjegohej duke dhënë arsyet e tij të përligjshme.

4. Namazi i parë i xhumasë

Të mblidhesh me njerëzit, të përzihesh me ta, të shqetësohesh për hallet e të tjerëve dhe të gëzohesh edhe ti me gëzimet e tyre është një domosdoshmëri e të qenit i qytetëruar. Prandaj ensarët, që para se të vinin në Medinë muhaxhirët, patën folur kështu mes tyre: "Hebrenjtë dhe të krishterët mblidhen çdo shtatë ditë. Ejani të caktojmë edhe ne një ditë dhe le të mblidhemi rregullisht. Të përmendim Allahun, ta adhurojmë dhe ta falënderojmë Atë." Dhe, më pas, në ditën që caktuan, u mblodhën në shtëpinë e Esad ibn Zurares (r.a.) dhe falën namaz. Esadi (r.a.) i priu ata në faljen e namazit. Kab ibn Malik (r.a.), gjuha e të cilit ishte po aq e mprehtë dhe ndikuese sa shpata e tij, në kohët kur do

të humbte shikimin, atëherë kur nipi i tij do ta kapte për dore dhe do ta shoqëronte sa herë të kishte dëshirë për të shkuar në mesxhid, do të kujtonte këtë moment në çastet e këndimit të ezanit të xhumasë dhe do të thoshte: “Allahu (xhel’le xheláluhu) e mëshiroftë Esad ibn Zuraren (r.a.). Pasi Musabi (r.a.) u bë shkak që ne të bëheshim myslimanë në Medine – nuk e di nëse kishte ardhur ndonjë lajm nga i Dërguari i Allahut – ai përveshi mëngët dhe, duke lëvizur nëpër sokakët e Medines, mblodhi pas vetes dyzet (sipas një transmetimi tjetër, dymbëdhjetë) veta. Pastaj na priu në faljen e namazit të xhumasë. Mandej theri një cjap dhe shtroi për ne një gosti. Kështu, Esad ibn Zurare (r.a.) që ai që na përgëzoi për herë të parë me namazin e xhumasë. Allahu e mëshiroftë atë deri në fund të jetës së tij.”³¹⁴ Më vonë, pasi i erdhi urdhri me shkrim i Profetit tonë (s.a.s.), Musab ibn Umejri (r.a.) filloi të printe faljen e namazeve të xhumasë.

Nga të gjitha këto, ne kuptojmë këtë: Të mbledhurit së bashku qoftë edhe vetëm një herë në javë, adhurimet e përbashkëta, bashkëbisedimet me ndërgjegje të pastra dhe ndarja e halleve me njëri-tjetrin përbëjnë një nevojë dhe një çështje të rëndësishme shoqërore. Edhe në një kohë kur Islami sapo kishte hapur flatrat për t’u ngritur në fluturim, besimtarët e ndërgjegjshëm e patën kuptuar nevojën e diçkaje të këtillë, i patën besuar domosdoshmërisë së xhumasë dhe, edhe pse nuk kishte ardhur ende ndonjë urdhër nga Profeti ynë (s.a.s.) në lidhje me këtë çështje, patën falur namazin e xhumasë.

Sipas asaj që thotë Ibn Haxheri, Profetit tonë (s.a.s.), obligimi i namazit të xhumasë i ka ardhur që kur ishte në Mekë.³¹⁵ Ky imam i madh sigurisht që është bazuar diku në lidhje me këtë që thotë; mirëpo, është e pamundur të kuptohet kuptimi i propozimit të Allahut të Madhëruar për faljen e namazit të xhumasë në një vend ku kushtet për kryerjen e saj nuk ishin plotësuar akoma. Pra, ishte e sigurt që Pejgamberi ynë (s.a.s.) nuk do të ishte në gjendje ta falte namazin e xhumasë gjatë asaj periudhe, sepse kushtet nuk ishin të përshtatshme. E, në fakt, ajo që ne

³¹⁴ Ebú Dáúd, salát 209; Ibn Máxhe, ikametus’salát 78.

³¹⁵ Ibn Haxher, el Hejtemí, Tuhfetul muhtáxh 2/405.

dimë në lidhje me këtë çështje është se Profeti ynë (s.a.s.) nuk ka falur as edhe një namaz xhumaje në Mekë. Namazi i xhumasë është namaz xhemati; ai kërkon një imam përpara, të përkushtuar ndaj së drejtës dhe që merret edhe me punët e popullit, dhe, pas tij, një xhemat, që i bindet atij imami dhe ia vë veshin të drejtës e të vërtetës. Ngaqë këto kushte nuk ishin plotësuar të gjitha, do të thotë se Profeti ynë (s.a.s.) nuk ishte obliguar me faljen e namazit të xhumasë që kur ndodhej në Mekë. Vetëm pasi u urdhërua për të bërë hixhret, pra, pasi iu hap rruga për në Medine, vajti në Kuba fillimisht; pastaj, brenda katër-pesë ditëve që qëndroi atje, ndërtoi mesxhidin e Kubas. Xhibrili i solli lajmin e faljes së xhumasë pasi që larguar nga Kuba, kur kishte ardhur në luginën e djemve të Salim ibn Aufit. Kështu që, aty u fal namazi i parë i xhumasë. Sepse i Dërguari i Allahut (s.a.s.) e kishte gjetur një popull tashmë dhe mund ta shpallte haptazi faljen e namazit të xhumasë, që është një nga simbolet e Islamit. Për më tepër, Ai kishte hyrë brenda kufijve të qytet-shtetit që do të themelonte së shpejti. Për rrjedhojë, Ai do ta kishte në dorë vulën tanimë, Ai do të ishte imami, dhe xhemati Atë do të dëgjonte.

Pasi u futën në Medine, të gëzuar e të lumtur për shkak të pranisë së Pejgamberit tonë në mesin e tyre dhe të myzhdesë në lidhje me namazin e xhumasë, gjëja e parë që bënë besimtarët që marrja e një gërmadhe dhe ndërtimi i një mesxhidi në vendin e saj. Më vonë, aty filluan të faleshin namazet e xhumasë. Sido që ta quajmë ne sot atë vend, *Mesxhid Nebeuí* (Mesxhidi i Profetit) apo *Rauza Táhire* (Bahçja e Pastër), nuk do të jemi kurrë në gjendje ta shprehim me fjalë natyrën e tij të vërtetë. Sepse dheu i vendit ku shtrihet trupi i të Dërguarit të Allahut nuk mund të krahasohet me asnjë dhe tjetër të botës. A ka ardhur nga Xheneti, apo është krijuar në një mënyrë të veçantë nga nuri hyjnor, këtë nuk mund ta dimë. Por dimë se Profeti ynë (s.a.s.) ka thënë kështu: “*Tre janë mesxhidet që duhen vizituar pavarësisht largësisë së madhe: Mesxhidi Haram, Mesxhidi Aksá dhe mesxhidi im.*”³¹⁶ Sepse *Mesxhidi Nebeuí* është ndërtuar nga mësuesi i njerëzimit, Muhamedi

³¹⁶ Buhári, fedáilus’salát 6, haxh 26, saum 67; Muslim, haxh 288.

Famëlartë (s.a.s.). Bashkë me sahabët si Bilali dhe Amari, edhe Ai pati përzier llaçin me duar, pati mbajtur mbi shpinë qerpiçë, pati thyer gurë me qysqi... Dhe, në këtë mënyrë, qe bërë e mundur hedhja mbi hair e themeleve të këtij mesxhidi. Kjo është arsyeja pse një rekat namaz i falur në atë vend konsiderohet sa qindra rekate namaz të falura në vende të tjera.

5. Kërkimi i kohës së lutjeve të pranuar në ditën e xhuma

Namazi është direku i anijes së fesë, ai është si një busull që i tregon besimtarit drejtimin që duhet të mbajë. Me fjalë të tjera, namazi është litari i fortë që do t'i mundësojë besimtarit ngjitjen në miraxh. Njëri skaj i këtij litari është në dorën e tij, kurse skaji tjetër është në atë të Allahut. Ndërsa thelbi i namazit me të gjitha këto cilësi, ai që është edhe shprehja e emocioneve dhe entuziazmit të ndërgjegjes kolektive, është namazi i xhumasë. Për rrjedhojë, ai duhet kryer me një zemër dhe shpirt vigjilent. Profeti ynë (s.a.s.) thotë: *“Në ditën e xhuma ndodhet një kohë e atillë, që, kur myslimani e kap atë duke falur namaz, çfarëdo qoftë ajo gjë që i ka kërkuar Allahut në ato çaste, Allahu ia jep patjetër.”*³¹⁷ Në lidhje me këtë kohë të ditës së xhuma, sahabët, pasuesit e sahabëve dhe dijetarë të mëdhenj të mëvonshëm kanë parashtruar mendime të ndryshme. Unë kam përshtypjen se, ashtu siç shëtit nata e Kadrit brenda muajit të Ramazanit, në të njëjtën mënyrë shëtit e lëviz edhe kjo kohë brenda ditës së xhuma. Rrjedhimisht, përjetimi i atij çasti varet nga përjetimi ashtu siç duhet i gjithë ditës së xhuma dhe nga kthimi tek Allahu me besim të plotë.

Kjo është arsyeja pse i Dërguari i Allahut (s.a.s.) dhe shokët e Tij e kalonin me vetëdije të plotë këtë ditë, sikur të ishin një trup i vetëm dhe sikur të ishin duke u ngjitur në miraxh. Shpresojmë nga mëshira hyjnore që, për sa kohë ta vlerësojmë ditën e xhuma brenda një atmosfere të tillë dhe me një frymë të tillë, Allahu i Madhëruar të

³¹⁷ Buhári, xhumu'a 37, talák 24, de'auát 61; Muslim, xhumu'a 13-15.

na e mundësojë kapjen e asaj kohe të pranimit të lutjeve dhe t'i pranojë lutjet tona. Profeti i Profetëve (s.a.s.) dhe personat me lutje të pranuar e kanë kapur shumë herë atë çast, i janë lutur Allahut dhe Allahu (xhel'le xheláluhu) i ka pranuar lutjet e tyre.

Këtu kemi një shembull nga këto lutje të pranuar të Pejgamberit tonë (s.a.s.). Tregon Enesi (r.a.): “Njerëzit po përballeshin me urinë. Një ditë të xhuma, kur i Dërguari i Allahut (s.a.s.) po mbante hutben, ngrihet në këmbë një beduin dhe thotë: ‘O Profet i Zotit! Pasuritë tona u shkatërruan, familjet tona kanë mbetur të uritura, lutju Allahut për ne!’ Profeti ynë (s.a.s.) ngriti duart. Në qiell nuk kishte as edhe një re. Beto hem tek Ai që ka në dorë shpirtin tim se, akoma pa i ulur duart poshtë, në qiell u shfaqën re të mëdha si male. Dhe, akoma pa zbritur nga minberi, nga mjekra e Tij filluan të pikonin pikat e shiut. Shiu vazhdoi të binte atë ditë, vazhdoi të binte edhe gjatë ditës së nesërme, edhe gjatë ditëve në vazhdim. Shiu vazhdoi të binte edhe gjatë xhumasë pasardhëse, aq sa ai beduin, ose dikush tjetër, u ngrit e tha: ‘O, i Dërguari i Allahut! Ndërtesat tona po shemben, pasurinë tonë po e merr uji i shiut, lutju Allahut për ne (që shiu të ndalojë tashmë)!’ Profeti ynë (s.a.s.) ngriti duart lart dhe filloi të lutej: *Allahu im! Lëshoje shiun përreth nesh, jo mbi ne! (Kurse në një transmetim tjetër thuhet kështu:) Allahu im! (Shiu) le të bjerë përreth nesh, jo mbi ne! Allahu im, bëje të bjerë mbi male e kodra, nëpër lugina e vende ku rriten pemë!* Pastaj tregoi me dorë retë. Retë që tregonte Ai me dorë shpërbëheshin në çast. Në qiell nuk mbeti asnjë re. Dhe ne dolëm e ecëm në diell.”³¹⁸

Po, i Dërguari i Allahut (s.a.s.) ngrinte lart duart në atë kohë të ditës së xhuma dhe Allahu i përgjigjej kërkesës së Tij. Kështu që, edhe duave tona, kur ta kapim atë çast dhe të lutemi, Allahu (*xhel'le xheláluhu*) do t'u përgjigjet.

³¹⁸ Buhári, istiská 7; Muslim, istiská 1.

PJESA E TETË



NAMAZET NAFILE

1. Të mirat e namazeve nafile

a. Plotësojnë farzet

Namazet nafile janë vendosur ‘*xhebran lin’nuksan*’. Kuptimi i kësaj fjalie është ky: Namazet nafile kryhen për të kompensuar mangësitë në namazet farz. Për rrjedhojë, falja e namazeve sunet, të përcaktuar për secilën kohë të pesë farzeve ditore, do t’i shërojë plagët e ndryshme të jetës sonë shpirtërore, do të bëhet shlyerje për mëkatet tona dhe, duke u llogaritur në vend të namazeve farz të mangët, do të bëhen shkak për hyrjen tonë në Xhenet. Një hadith të të Dërguarit të Allahut (s.a.s.) në lidhje me këtë të vërtetë, Hurejth ibn Kabisa (r.a.) na e transmeton kështu: “Erdha në Medine dhe u luta në këtë mënyrë: ‘O Zoti im! Më mundëso mua një shok të virtytshëm!’ Mandej u ula pranë Ebu Hurajras (r.a.). ‘U luta Allahut që të më mundësojë një shok të virtytshëm. Më thuaj ndonjë hadith që ke dëgjuar nga i Dërguari i Allahut! Mbase Allahu më mundëson të përfitoj diçka nga ai hadith!’ i thashë atij. Pas këtyre fjalëve të mia, ai tha: ‘Unë e kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut (s.a.s.) të thotë: *‘Në ditën e kiametit, ndër gjithë veprat e tij, njeriu do të japë së pari llogari për namazin. Nëse kjo llogaridhënie kalon mirë, do të thotë se ka shpëtuar. Nëse kjo llogaridhënie shkon keq, do të thotë se ka rënë në humbje. Nëse dalin mangësi në namazet farz të robit, Zoti i Madhëruar do të urdhërojë: ‘Shikoni, a ka robi im nafile (të shkruara në fletoren e tij)?’ Kështu, mangësitë në farze do të plotësohen me (namazet) nafile. Pastaj, në të njëjtën mënyrë do të jepet llogari edhe për veprat e tjera.*’³¹⁹

³¹⁹ Tirmidhí, salát 305; Nesáí, salát 9; Ibn Máxhe, ikáme 202.

b. Na afrojnë akoma më shumë me Allahun

Një tjetër kuptim i namazeve nafile është të qenit shkak i afrimit me Allahun. T'i afroresh Zotit të Madhëruar do të thotë të futesh në rrethin e Tij të dashurisë. Në një hadith, i Dërguari i Allahut (s.a.s.) e shpreh këtë të vërtetë në këtë mënyrë: *“Allahu i Madhëruar thotë: ‘Atij që armiqësohet me robin tim, edhe unë i shpall luftë. Mes gjërave që e afrojnë robin tim me mua, më së shumti më pëlqen kryerja nga ana e tij e gjërave që ia kam bërë farz. Robi im vazhdon të më afrohet edhe nëpërmjet adhurimeve nafile dhe, në fund, nderohet me dashurinë time. Filloj ta dua atë. Kur unë e dua robin tim, bëhem veshi i tij që dëgjon, syri i tij që sheh, dora e tij që kap; e bëj atë të ecë gjithmonë drejt gjërave të hairit. Kur kërkon diçka nga unë, ia jap. Nëse kërkon nga unë strehim, e marr nën mbrojtjen time dhe e mbroj.’”*³²⁰

Po, njeriu i afrohet akoma më shumë Allahut dhe përfiton nga dashuria e Tij nëpërmjet adhurimeve nafile. Kur Allahu (xhel’le xheláluhu) e do një njeri, Ai e bën atë të dashur edhe tek të tjerët. Në një hadith të transmetuar nga Ebu Hurajra (r.a.), i Dërguari i Allahut (s.a.s.) thotë kështu: *“Po e deshi Allahu një rob, i thërret Xhibrilit të nderuar: ‘Allahu e do filanin, duahe edhe ti!’ Kështu, atë fillon ta dojë edhe Xhibrili. Pastaj, Xhibrili (a.s.) u drejtohet banorëve të qiellit: ‘Allahu e do filanin, duahe edhe ju!’ Dhe, kështu, atë person fillojnë ta duan edhe banorët e qiellit. Më pas, ai pranohet dhe mirëpritet edhe (mes njerëzve) në tokë. Kur Allahu (xhel’le xheláluhu) e urren një rob, i thërret Xhibrilit: ‘Unë e urrej filanin, urrehe edhe ti!’ Kështu, edhe Xhibrili fillon ta urrejë atë. Xhibrili u drejtohet pastaj banorëve të qiellit: ‘Allahu (xhel’le xheláluhu) e urren filanin, urrejehet edhe ju!’ Më pas, edhe në tokë përhapet një urretje për të.”*³²¹

Pra, nëse bota Islame, me një popullsi që sot ka arritur në disa miliardë, nuk po merr ndonjë kompliment, ndihmesë apo përkujdesje nga Allahu, do të thotë se ajo nuk e ka arritur ende pozitën e të qenit

³²⁰ Buhári, rikak 38; Ahmed ibn Hanbel, el Musned 6/256.

³²¹ Buhári, bed’ul halk 6, edeb 41, teuhíd 33; Muslim, birra 157.

e dashura e Allahut. Ne dëshirojmë që Allahu i Madhëruar t'i nderojë me afrimin tek Ai të gjithë grupet që shkojnë në xhami dhe bien në sexhde para Tij. Por, për fat të keq, shumë herë ndodh që njeriu që shkon në xhami të gjendet në një luginë, kurse mëshira e Allahut në një luginë tjetër. Nuk ka mundur të takohet me Kuranin në të njëjtën luginë dhe, për rrjedhojë, kur vjen në xhami, vjen duke mos qenë i vetëdijshëm për kuptimin e tij. Një gjendje e tillë, kurrë nuk mund të konsiderohet e përshtatshme për xhaminë. Atje shkohet vetëm me një zemër vigjilente; atje, zemra dridhet nga ndjesia e të qenit para Zotit, syri përletot. Asgjë, asnjë qëllim tjetër nuk mund të përzihet me kohën e caktuar për Allahun e Madhëruar dhe me adhurimet që do të bëhen për Të. Një çast i vetëm i një kohe të shfrytëzuar në këtë mënyrë është më i parapëlqyer se një jetë e padritë mijëravjeçare.

c. Të lartësojnë në gradë

Adhurimet nafile, duke qenë se bëhen shlyerje për disa nga mëkatet e robit, i mundësojnë atij fitimin e gradave të ndryshme. Prandaj thuhet se çdo adhurim nafile ka një vlerë të veçantë. Lajmdhënësi Fjalëdrejtë (s.a.s.), në lidhje me namazin e paradites për shembull, ka thënë kështu: *“Çdo ditë nevojitet një sadaka për çdo nyje tuajën. Çdo tesbih (subhánallah) është një sadaka. Çdo tahmid (elhamdulil’lah) është një sadaka, çdo tehlil (lá iláhe il’lallah) është një sadaka. Urdhërimi për mirë është një sadaka. Ndalimi i së keqes është sadaka. Falja e një namazi dyrekatësh në kohën mes mëngjesit dhe drekës është e barasvlershme me të gjitha këto sadaka.”*³²²

Po, në trupin e njeriut ka me qindra nyje. Funkzionimi i tyre në një mënyrë të rregullt dhe lëvizjet lehtësisht të njeriut falë tyre janë mirësi më vete. Dihet se sa të vështira janë uljet dhe ngritjet për një njeri që vuan nga hernia diskale. E njëjta gjë vlen edhe për ata që vuajnë nga reumatizmi apo që kanë probleme me nervin shiatik dhe, rrjedhimisht, përpëliten nën dhimbjet e padurueshme të belit dhe këmbëve. Besoj se

³²² Muslim, salátul musafirin 84.

nuk është e nevojshme të them se çfarë mirësie, ç'bekim i madh është për këta njerëz aftësia për t'u ulur dhe për t'u ngritur në këmbë lehtësisht dhe pa ndier dhimbje. Ç'do të ndodhte nëse gishtat e duarve tona do të përbëheshin nga një strukturë kockore pa nyje, të palëvizshme? Trupi ynë ka shumë nyje të tilla.

Po, ne jemi të rrethuar me mirësi nga të gjitha anët, nga koka te këmbët, dhe asnjërin prej tyre nuk e kemi fituar vetë e as nuk na janë dhënë sipas meritave tona. Kështu që, të gjitha këto mirësi kërkojnë falënderim. Edhe sikur të përpiqeshim të falënderonim përgjatë gjithë jetës sonë qoftë edhe vetëm për aftësinë për të hapur e mbyllur sytë tanë, nuk do të kishte qenë e mjaftueshme për kryerjen ashtu siç duhet të këtij falënderimi. Dridhem përbrenda sa herë më vjen në mendje gjendja e një shoku që më pati bërë një vizitë dikur. Edhe pse patëm kaluar disa orë bashkë, nuk pati mundur t'i lëvizte qepallat as edhe një herë të vetme. Sepse i ishin paralizuar nervat e syve. Çdo herë që e mendoj gjendjen e tij, kujtoj se ç'mirësi e madhe është qoftë edhe vetëm të qenit në gjendje për t'i hapur e mbyllur sytë. Ai shok më pati thënë fiks kështu: “Hoxhë, nuk jam në gjendje t'i mbyll sytë as kur dua të fle. Më mbyllen vetëm nëse i ul poshtë qepallat me dorë.”

Po organet e tjera të trupit! Sytë janë një mirësi më vete, veshët po ashtu, po ashtu edhe hunda... Për të treguar forcën dhe fuqinë e Tij, Allahu i Plotfuqishëm na i ka vendosur aty ku duhet këto organe të përbërë prej mishi e kockash dhe i ka pajisur ato me urtësi të mëdha. Për rrjedhojë, ne duhet të falënderojmë në çdo çast për këto mirësi të vazhdueshme të Tij. Madje, nëse do të shpreheshim me fjalët e Sadiut, në çdo frymëmarrje tonën duhet ta falënderojmë dy herë Atë.³²³ Sepse frymëmarrja jonë përbën jetën tonë; ne marrim oksigjenin përmes frymëmarrjes dhe, në këtë mënyrë, bëjmë të mundur pastrimin e mushkërive tona; nga ana tjetër, kur japim frymë, nxjerrim jashtë gazin e dioksidit të karbonit dhe, kështu, trupi ynë pastrohet nga gazrat helmues. Nëse nuk do të ishim në gjendje të nxirrnim jashtë gazrat e dëmshëm të trupit tonë, trupi ynë do të helmohej dhe ne do të vdisnim.

³²³ Sádí Shirází, Gjylistani dhe Bostani, fq. 309.

E njëjta gjë mund të thuhet edhe në rastin e marrjes frymë; nëse nuk do të ishim në gjendje të merrnim frymë, nëse mushkëritë tona nuk do të pastroheshin nëpërmjet oksigjenit, ne do të vdisnim.

Kjo do të thotë se, në çdo frymëmarrje tonën, Allahu (xhel'le xheláluhu) na e fal jetën dy herë. Atëherë, a nuk duhet ta falënderojmë ne Allahun, i Cili na e fal jetën në çdo çast? Ja, pra, namazi, i formuluar dhe i vënë në një formë të caktuar nga vetë Allahu, na jep mundësinë e kryerjes së këtij falënderimi ndaj Tij.

Në një hadith tjetër, që tregon po ashtu për rëndësinë e namazit të natës, i Dërguari i Allahut (s.a.s.) thotë: *“Çdo natë, kur futet një e treta e fundit e natës, Zoti ynë zbret në qiellin e tokës dhe thotë: ‘A ka ndonjë që po më lutet mua, që unë t’i përgjigjem lutjes së tij? A ka ndonjë që kërkon diçka nga unë, që unë t’ia jap atë që kërkon? A ka ndonjë që kërkon falje nga unë, që unë ta fal atë?’”*³²⁴ Pra, Zoti ynë i Gjithëmëshirshëm zbret në botën tonë dhe, ndërkohë që ne e ndiejmë Atë në zemrat tona si një Thesar të Fshehtë të çdo zemre, Ai pasqyrohet aty, na shikon në fytyrë, na përkëdhel zemrat edhe pse nuk e meritojmë një gjë të tillë, u përgjigjet lutjeve të atyre që luten, u jep atë që kërkojnë atyre që kërkojnë diçka prej Tij dhe u mundëson faljen atyre që kërkojnë prej Tij falje.

I Dërguari i Allahut (s.a.s.) gjithmonë ka qëndruar pas fjalëve që ka thënë përgjatë gjithë jetës së Tij. Ai është ngritur netëve dhe i është drejtuar Allahut duke falur namaze të gjata. Nëna jonë Aishja (r.a.), një përvojë të sajën në lidhje me këtë temë e shpjegon kështu: *“Kur i Dërguari i Allahut (s.a.s.) po flinte pranë meje një natë, në një çast vëreja se ai nuk ndodhej më aty. Në shtëpi nuk kishte asnjë dritë. Kur fillova të kërkoja me dorë rreth e rrotull, dora ime preku këmbën e tij. Kishte vënë kokën në sexhde. Pastaj, për të dëgjuar se çfarë po thoshte, mbajta vesh. Po i përgjerohej Zotit me këto fjalë: ‘Allahu im! Duke bërë ndërmjetësues pëlqimin Tënd, strehohem tek Ti nga zemërimi Yt. Duke bërë ndërmjetësues faljen Tënde, strehohem tek Ti nga dënimi Yt.*

³²⁴ Buhári, tehexhxhud 14, de’auát 14, teuhíd 35; Muslim, salátul musafirín 168-170.

*Strehothem nga Ti po tek Ti. Unë nuk mund të të lavdëroj ashtu siç e meriton. Ti je ashtu siç e cilëson dhe e lavdëron Ti veten.*³²⁵

Po, sipas vëzhgimeve dhe fjalëve të Aishes (r.a.), Pejgamberi ynë (s.a.s.) vinte kokën përtokë, i bënte sexhde Allahut dhe e adhuronte Atë deri në sabah. Atëherë edhe ti, ditën do të jesh mysafir i botës, kurse natën, mysafir i Zotit tënd; vetëm Atë do të dëgjosh, vetëm Atë do të mendosh, dhe do të magjepsesh me artin e Tij të pashoq. Do të kuptosh se sa shumë ndikohesh e mjerohesh qoftë edhe nga pickimi i një akrepi apo insekti, do të kuptosh se në ç'loj mungese vullneti gjendet trupi yt i pafuqishëm, i cili bart mbi shpinë edhe frikën e një rrufeje që bie në qiell. Do të arrish në përfundimin se, nëpërmjet forcës dhe pushtetit tënd personal, nuk je në gjendje të sigurosh as një të mijtën e gjërave për të cilat ke nevojë, të cilat fillojnë me grimcat e ajrit që, duke na mundësuar frymëmarrjen, plotësojnë një nevojë madhore tonën dhe mbarojnë me frutat e shumëllojshme, të cilat Allahu na i servir përmes duarve të pemëve. Mandej, plotësimin e gjithë këtyre nevojave do t'ia lësh Atij. Sepse rrethi i nevojave është pafundësisht i gjerë, ndërsa ai i fuqisë është tejet i ngushtë. Pafuqia dhe varfëria jote janë të pafundme, ama, nga ana tjetër, edhe hasmët dhe armiqtë e tu janë goxha shumë. Si një qenie me barrë kaq të mëdha mbi shpinë, do t'i bindesh fermanit hyjnor ***“Ata (robërit e të Gjithëmëshirshmit) e kalojnë natën duke iu falur Zotit të tyre në sexhde dhe në këmbë...”***³²⁶, do të kërcesh nga shtrati sikur të kesh dalë nga vetvetja dhe do të qëndrosh para Zotit tënd me përulje e gjithë respekt. Do të pranosh vogëlsinë tënde përballë madhësisë së Tij dhe do të thuash: “Po s'më dhe Ti, unë asgjë nuk mund të marr. Nëse nuk më dhuron gjë Ti, unë asgjë nuk mund të zotëroj. Nëse nuk ma mundëson Ti, unë nuk mund ta sundoj këtë univers të gjerë, nuk mund ta bëj askënd të dëgjojë fjalën time... Të gjitha këto i kam prej Teje. Prona është e gjitha e Jotja. Kështu që, mirënjohja dhe falënderimet janë vetëm për Ty, Allahu im!”

³²⁵ Muslim, salát 222; Tirmidhí, de'auát 76, 113; Ebú Dáúd, salát 340.

³²⁶ Surja Furkán, ajeti 64.

Kur t'i drejtohesh në këtë mënyrë Atij në derën e të Cilit po troket, Ai do të të mirëpresë si një mysafir të rëndësishëm dhe do të të qerasë me të mira të panumërta. I Dërguari i Allahut (s.a.s.), këtë myzhde na e jep nëpërmjet hadithit në vijim: *“Kur të ndodhë kiameti, njerëzit do të ringjallen dhe nga qiejt do të vijë një thirrje e tillë: ‘Ku janë ata që, duke shpresuar mëshirën e Zotit të tyre dhe duke iu frikësuar dënimit të Tij, ngrihen nga shtretërit e tyre natën (ata që braktisin rehatinë për të adhuruar Zotin e tyre, që ngrihen për të falur namazin e sabahut edhe gjatë netëve të shkurtra dhe që vrapojnë për në mesxhid)?”* Në vazhdim, Krenaria e Gjithësisë thotë kështu: *“Një numër i vogël njerëzish mblidhen para Zotit. Allahu urdhëron që ata të futen në Xhenet pa iu bërë asnjë pyetje. Pastaj thirren të tjerët, për të dhënë llogari.”*³²⁷

Kështu që, në një kohë kur të gjithë zhyten në hutesë ose bien të flenë pranë të dashurve të tyre, besimtari duhet të vijë para Allahut dhe, duke thënë *“Zoti im! Kam vrapuar gjatë gjithë ditës pas gjërave të tjera, ndërsa tani, tani kam ardhur të trokas në derën Tënde; të gjithë kërkuan me sy dikë tjetër, të gjithë shkuan pas diçkaje tjetër, ama unë po të kërkoj Ty, po përpiqem për të arritur tek Ti.”*, të trokasë në derën e Tij. Në errësirën e natës, besimtari duhet të kthehet nga Zoti dhe, ashtu siç bënte Profeti ynë (s.a.s.) kur ngrihej natën, duhet t'i drejtohet Allahut me këtë lutje: *“Allahu im, Zoti ynë! Çdo lavdërim dhe të gjitha falënderimet janë për Ty. Allahu im, Ti je Ai që i mban në këmbë tokën, qiejt dhe çdo gjë tjetër mes tyre, falënderimet janë vetëm për Ty! Allahu im, Ti je Zotëruesi i qiejve, tokës dhe çdo gjëje që ekziston mes tyre, falënderimet të takojnë vetëm Ty. Ti je drita e qiejve, tokës dhe çdo gjëje tjetër që ekziston në to e mes tyre. Çdo lavdërim, çdo falënderim është vetëm për Ty! Ti je Sunduesi i qiejve, tokës dhe çdo i gjëje që ekziston në to e mes tyre, çdo lavd të përket vetëm Ty! Ti je i Vërteti, i Drejti, premtimi Yt është i vërtetë! Bashkimi me Ty në botën tjetër është i vërtetë. Fjala Jote është e vërtetë. Xheneti është i vërtetë, Xhehenemi është i vërtetë. Profetët janë të vërtetë, Muhamedi (s.a.s.) është i vërtetë, kiameti është i vërtetë. Allahu im! Ty t'u dorëzova, Ty të besova, tek Ti u mbështeta,*

³²⁷ Bejhakí, Shuabul ímán 3/169.

*Ty t'u drejtova! Luftova kundër armiqve të Tu duke u mbështetur tek Ti, vetëm gjykimit Tënd iu drejtova. Allahu im, falmi mëkatet e së kaluarës e të së ardhmes, ato që i kam bërë haptazi dhe ato që i kam bërë fshehurazi! Ti je Nismëtari, Përparësidhënësi (Ai që të lartëson, të çon përpara); Ti je Prapësuesi (Ai që të ul poshtë, të lë prapa). Nuk ka zot tjetër veç Teje!*³²⁸ Sepse nderimi i Tij fshihet në ngritjen natën dhe daljen me përulje para Zotit, për t'ia shprehur vetëm Atij të gjitha hallet.

2. Disa namaze nafile

a. Namazi i tehexhudit

Tehexhud do të thotë rigjallërimi i natës përmes namazit. Nata është ajo pjesë kohe gjatë së cilës dyert e botës së padukshme hapen pakëz. Gjatë natës, me hapjen e disa shtigjeve qiellorë, mund të soditësh diçka nga bota e përtejme. Ashtu siç thotë edhe Bediuzamani, rigjallërimi i natës nëpërmjet namazit të tehexhudit është si një projektor që ndriçon botën e varrit.³²⁹ Në njëfarë mase, adhurimet e natës përfshijnë edhe kuptimet e largimit nga çdo gjë tjetër përveç Allahut dhe përkushtimit ndaj Tij. Kurani, duke e theksuar këtë çështje të rëndësishme nëpërmjet ajetit **“Ue tebet’el ilejhi tebtıla”, “Prandaj, përmende emrin e Zotit tënd dhe përkushtoju krejtësisht Atij!”**³³⁰, sikur na thotë: “Duke i prerë në njëfarë kuptimi marrëdhëniet me çdo gjë tjetër përveç Allahut, përkushtoj plotësisht Atij! Dhe ulu e ngrihu vetëm me njohjen e Tij, dashurinë e Tij, kënaqësitë shpirtërore në lidhje me Të dhe me pasqyrimet e Tij.” Kjo mund të realizohet vetëm nëse njeriu e përgatit veten për këtë gjë, duke i braktisur në një mënyrë të vullnetshme gjumin dhe shtratin e tij të ngrohtë.

Edhe para se t'i vinte profetësia, Pejgamberi ynë (s.a.s.), duke u veçuar në njëfarë mase nga njerëzit, gjithmonë kërkonte për mënyra

³²⁸ Buhári, tehexhud 1, de'auát 10, teuhíd 8, 24, 35; Muslim, salátul musáfirín 199.

³²⁹ Bediuzaman, Fjalët, fq. 63 (Fjala e Nëntë, Pika e Katërt).

³³⁰ Surja Muzzemmil, ajeti 8.

dhe rrugë që do ta afronin me Zotin e Tij. I bënte pjesë të këtij kërkimi botën e Tij të brendshme, ndjenjat zaten të pastra dhe zemrën, të cilën e kishte gjithmonë të hapur ndaj Allahut, dhe shëtiste nëpër horizontet e vëzhgimit. Përveç zhytjes në thellësitë e botës së ndërmjetme përmes ëndrrave, përveç qëndrimit vetëm për vetëm me mendimet në lidhje me sekretet hyjnore, duke hapur sadopak dyert e jetës së përtejme, Ai përpiqej gjithashtu të vlerësonte gjithçka që mund t'ia përshpejtonte afrimin me Allahun e që do t'i mundësonte rënien mbi Të si shi të begative të shenjta dhe, në këtë mënyrë, skiconte një hartë të ndryshme mendimi.

Në suren *Muzzemmil*, ku kalon edhe ajeti që përmendëm më sipër, ceken dy çështje të rëndësishme: Çështja e parë është drejtimi i Tablosë së Krenarisë së Njerëzimit (s.a.s.) për tek një largim i përkohshëm nga njerëzit (*inziuá*), sigurisht, përmes një shtyse hyjnore nga ana e Allahut; ndërsa çështja e dytë, të gjendurit brenda një përgatitjeje shpirtërore, e cila, në të ardhmen, do t'i shërbejë në përmbushjen e një misioni të rëndësishëm në emër të kauzës së profetësisë.

Nëse do të na duhej t'i shtjellonim ca më shumë këto, do të thoshnim kështu: Pothuajse të gjithë njerëzit e mëdhenj, dhe në veçanti Profeti ynë Famëlartë (s.a.s.), janë orientuar nëpërmjet shtysës hyjnore të Allahut (xhel'le xheláluhu). Kjo situatë, ashtu siç vlen për të gjithë profetët dhe të dërguarit e Zotit, vlen edhe për asfijatë (robërit e sinqertë e më shpirt të dëlirë të Allahut, ata që ia kanë përkushtuar jetën fitimit të kënaqësisë dhe pëlqimit të Allahut). Për shembull, Imam Gazaliu, në një periudhë të caktuar, u qe përkushtuar shkencave të larta Islame. Jetën e pati kaluar nëpër teqe e medrese dhe, në një pikë të saj, i pati vënë vulën qëllimit të jetës së vet me një burim të bereqetshëm dijesh si "*Ihjáu ulúmu'dín*" (Ringjallja e dijeve të fesë). Po ashtu edhe Imam Rabaniu, udhëtoi e shëtiti nëpër vende të ndryshme të Indisë për vite me radhë, lexoi, mendoi e reflektoi, jetoi si asket, hapi velat drejt së përtejmes, u mor me veprimtari serioze për të mundësuar vendosjen e besimit të myslimanëve mbi baza solide dhe themeloi një sistem krejt të ri të mendimit.

Edhe jeta e Bediuzamanit nuk ndryshon shumë nga jetët e tyre. Siç tregon edhe ai vetë në veprat e tij të titulluara Shtojcat (*Lahika*)

– duke i përmendur ato si mirësi të mundësuar nga Allahu dhe me qëllimin për të falënderuar dhe shprehur mirënjohjen – vitet e para të jetës i pati kaluar nëpër teqe e medrese; me atë mendje dhe inteligjencë sipërore të tijën që endur mes teksteve që mësoheshin nëpër ato vende; që marrë si me fushat e fesë, po ashtu edhe me ato të shkencës; që rritur me frymën e teqeve dhe, një ditë, e pati gjetur veten në terrenin e shërbimit ndaj besimit në linjën retorikë-argumentim-njohuri. Pra, duke i përpunuar mirë njohuritë e asaj kohe, të cilat, në pamje të parë, dukeshin sikur nuk kishin lidhje me njëra-tjetrën, duke i ushqyer me meditim, i pati kthyer ato në një burim safi, të pastër dijesh. Ndërkohë, për shkak të rrethanave gjatë një periudhe të caktuar, pati vrapuar edhe për të mbrojtur vendin, pati luftuar në vijën e parë të frontit dhe, pavarësisht luftës, nuk e pati lënë pas dore zhvillimin e mësimëve me nxënësit e tij. Edhe pse pjesën e mbetur të jetës e pati shpenzuar nëpër burgje, gjykata, biruca e internime, vullnetin e tij të lartë nuk e pati humbur kurrë.

Ja pra, gjatë kësaj periudhe përgatitjeje, edhe i Dërguari i Allahut (s.a.s.) që përpjekur vazhdimisht për të mësuar gjuhën e botës shpirtërore, pati kaluar në një komunikim me botën e ndërmjetme, pati kërkuar përmes vetëkontrollit të brendshëm, vëzhgimeve të brendshme dhe një lloji të vetëveçimit për shtigjet që do t'i mundësonin depërtimin në prapaskenën e gjërave dhe, pas kësaj përgatitjeje të gjatë, që nderuar me detyrën e profetësisë.

Tani, duhet të jetë e papajtueshme që dikush, që është caktuar në një detyrë kaq serioze dhe jashtëzakonisht të rëndësishme, të flejë gjatë gjithë natës. Për rrjedhojë, personi i ngarkuar me këtë detyrë duhet të ngrihet natën dhe ta adhurojë Zotin e tij. Madje ta adhurojë Atë në një mënyrë të atillë, sa që të mos shihet asnjë mospërputhje mes sjelljes e veprimeve të tij përballë Krijuesit dhe detyrës e misionit që bart mbi supe.

Si një tregues përmbledhës i të gjitha këtyre, Kurani thotë: ***“O ti i mbuluar (o Muhamed)! Çohu (të falesh) gjithë natën, përveç një pjese***

të saj, që është gjysma, ose diçka më pak a diçka më shumë se ajo, dhe lexoje Kuranin ngadalë dhe qartë!³³¹

Përse? Sepse një mision i tillë kërkon një jashtëzakonshmëri që i kapërcen normat njerëzore dhe jeta e njerëzve të këtillë brenda kësi jashtëzakonshmërisht duhet të vazhdojë gjithmonë. Mirëpo, nëse do duhej t'u thuhej diçka në lidhje me këtë temë njerëzve të thjeshtë si ne, ajo do të ishte si vijon: Pas faljes së namazit të jacisë, – duke përfshirë këtu edhe namazin e vitrit – shkoni të flini me nijetin për t'u ngritur edhe për namazin e sabahut. Atëherë edhe frymëmarrja juaj gjatë gjumit do të quhet adhurim. Ndërsa Profetit (s.a.s.), Allahu i drejtohet me fjalët ***“Çohu (të falesh) gjithë natën, përveç një pjese të saj, që është gjysma, ose diçka më pak a diçka më shumë se ajo, dhe lexoje Kuranin ngadalë dhe qartë!”***; sepse kështu e kërkon misioni me të cilin Ai është ngarkuar.

Fjala ***“nisfehu”***, që kalon në njërin nga ajetet e sipërpërmendur, do të thotë gjysma e natës. Kurse në vazhdim të ajetit, zë vend urdhri i Allahut për ta zvogëluar ose rritur pak këtë. Nata llogaritet kështu: Për shembull, nëse dielli lind në gjashtë të mëngjesit dhe perëndon në gjashtë të pasdites, i bie që e gjithë nata të jetë dymbëdhjetë orë. Rrjedhimisht, do të thotë se, në këtë rast, gjysma e natës është gjashtë orë. Diçka më pak se gjysma i bie të jetë rreth 4-5 orë, kurse diçka më shumë se gjysma mund të llogaritet si 6,5-7 orë. Duke filluar që nga dita kur iu kthye pafundësisë me spektrat e parë të shpalljes hyjnore, i Dërguari i Allahut (s.a.s.) e vazhdoi jetën e Tij të adhurimeve po në këtë masë deri në periudhën e pleqërisë së Tij, madje, deri në çastet e fundit të jetës së Tij të lartë. Gjatë natës, Ai falte namaz derisa i ënjtëshin këmbët; nëse ndodhte që, për ndonjë arsye, t'i ikte namazi i natës, këtë herë e falte atë kaza gjatë ditës, madje duke e falur atë shumë herë më gjatë se namazi që falte natën.³³²

³³¹ Surja Muzzemmil, ajetet 1-4.

³³² Muslim, salátul musáfirín 141; Tirmidhí, salát 348; Ebú Dáúd, tatavvu 26; Nesáí, kible 13, kijámul lejl 2, 64.

Po të vijmë tek ajo që Kurani e quan ‘*tertil*’ dhe që ne e shprehëm me fjalët “*Lexoje Kurantin ngadalë dhe qartë!*”, do të thotë lexim ashtu siç duhet i shkronjave të Kuranit, duke iu dhënë hakun dhe duke i ndier në horizontet e zemrës dhe shpirtit. Ashtu siç thotë edhe Bediuzamani në Mesnevinë e tij, leximi dhe kuptimi i Kuranit sikur po e dëgjon atë nga Allahu, sikur po e dëgjon nga Xhibrili ose sikur po e merr nga i Dërguari i Allahut (s.a.s.) janë tre dimensione të veçanta që, në emër të kiraetit, përbëjnë një përgjegjësi tonën.³³³ Me fjalë të tjera, ‘*tertil*’ do të thotë që njeriu ta lexojë Kurantin duke e dëgjuar atë në ndërgjegjen e tij mbi mekanizmat e mendimit, përfytyrimit dhe imagjinatës, duke shëtitur nëpër shpatet e botës shpirtërore dhe duke e ndier atë thellësisht. Aq sa, kur të shqiptojë secilën fjalë të ajetit që po lexon, të ndiejë atë që ndien një i etur kur është duke çuar në fyt gllënjkat e ujit. Gjithsesi, kjo është një çështje niveli dhe, si e tillë, mund të mos i mundësohet të gjithëve.

Mënyra se si lexojnë sot Kuran shumica e njerëzve nuk është ‘*tertil*’. Është e pamundur të thuhet se ky lexim shkakton drithërima në ndërgjegjen e njeriut. Nuk është e mundur që, me një lexim të tillë, ajetet e Kuranit ta frymëzojnë njeriun e ta bëjnë atë të zbulojë gjëra të reja; nuk është e mundur që ajetet e Kuranit të na ripërtërijnë në ndjenja, mendime, vepra e veprime. Kështu që, për t’i dhënë hakun Kuranit, edhe ne – duke e mbajtur veten jashtë aspektit që ka të bëjë me profetësinë – duhet ta lexojmë atë sikur të ishte duke na u shpallur neve.

Një ngjarje dhe një hadith, të transmetuara nga Abdullah ibn Omeri (r.a.), hedhin dritë mbi këtë çështje tonën. I nderuari Abdullah ibn Omer thotë: “Njerëzit shihnin ëndrra dhe vinin për t’ia treguar të Dërguarit të Allahut (s.a.s.). Edhe unë thosha me vete: ‘Ah, sikur të më hapeshin edhe mua dyert e botës së ndërmjetme, të shihja edhe unë ca gjëra dhe të vija e t’ia tregoja ato Tablosë së Krenarisë së Njerëzimit (s.a.s.), dhe Ai t’i interpretonte ato!’ Kështu, një ditë pashë në ëndërr dy persona që, pasi më kapën nga krahët, më çuan buzë një pusi të thellë e plot flakë. Flakët, duke u rrotulluar pa pushim si një uragan brenda

³³³ Bediuzaman, Letrat, fq. 612 (Letra e Njëzet e Nëntë, Pika e Gjashtë)

atij pusi të thellë, vinin deri lart. Unë e kuptova, aty ishte Xhehenemi. U tremba shumë, kisha frikë se mos do të më hidhnin brenda pusit. Iu mbështeta Allahut dhe fillova t'i përgjërroheshja Atij me fjalët 'O Zot...!'. Njëri nga ata të dy më tha: 'Mos ki frikë! Nuk ka asgjë për t'u shqetësuar. Ti nuk do të futesh aty.' Pastaj më doli gjumi. Ëndrën ia tregova Hafsës, motrës sime, dhe i kërkova që ta pyeste të Dërguarin e Allahut (s.a.s.) për kuptimin e saj. Kur ime motër e pyeti të Dërguarin e Allahut, Ai tha kështu: '*Sa njeri i mirë është Abdullahu. Ah, sikur t'u jepte gjallëri edhe netëve të veta!*'³³⁴

Është më se e qartë, këtu tregohet haptazi rruga që duhet ndjekur për t'i shpëtuar tmerrit të botës së ndërmjetme. Dhe kjo rrugë është gjallërimi i netëve në kuptimin adhurimor. Po, në një aspekt, gjallëria e zemrave varet nga gjallëria e netëve.

Të qenit i vetëdijshëm për anën shpirtërore të gjërave është i lidhur ngushtë me udhëzimin e njerëzimit. Në fakt, kjo mund të vlerësohet edhe nga këndvështrimi i këtij hadithi të shenjtë: "*Nëse robi im më afrohet Mua një pëllëmbë, Unë i afrohem atij një pashë. Nëse ai vjen drejt Meje duke ecur, Unë shkoj drejt tij duke vrapuar.*"³³⁵

Po, Zotëria i Profetëve (s.a.s.), i Cili erdhi me mesazhin e shpëtimit të njerëzimit, u tregua i vendosur në çështjen e arritjes së afrimitetit me Allahun nëpërmjet vullnetit të vet; nga ana tjetër, edhe Allahu iu afrua Atij në masën e madhështisë dhe mëshirës së Tij. Këtu ama, duhet theksuar diçka. I Dërguari i Allahut, i Cili kërkonte gjithmonë shpëtimit të njerëzimit, hapej drejt së përtejmes dhe e kërkonte këtë shpëtim në arritjen e zotërimit të anës shpirtërore të gjërave e të ndërgjegjësimit të njerëzve në lidhje me të. Kështu, përmes një rrugëkalimi të ndryshëm nate për çdo natë, Ai ecte drejt Allahut (xhel'le xheláluhu). Ashtu si në çdo punë tjetër të Tijën, Ai bënte atë që duhej bërë edhe në këtë pikë. Po, duke qenë se pesha mbi supet e Tij ishte më e rëndë se ajo e kujtdo tjetër, Ai duhej të përjetonte një '*isrâ'*

³³⁴ Buhárí, tehexhxhud 2, 21, fedáilu as'hábin'nebi 19, tabir 35, 36; Muslim, fedáilus'sahabe 139, 140.

³³⁵ Buhárí, teuhíd 15, 50; Muslim, teube 1, dhikr 1, 20-22.

(udhëtim natën) çdo natë, duhej ta lexonte Kuranin sa më shumë dhe duke e ndier thellësisht.

Barra e Tij ishte shumë e rëndë; Kurani i thoshte Atij vazhdimisht ***“Ne do të të ngarkojmë ty me një fjalë me peshë shumë të rëndë.”***³³⁶ Dhe, pa dyshim, ajo çfarë nënkuptohet në këtë ajet është misioni i profetësisë. E kuptonin, nuk e kuptonin apo nuk donin ta kuptonin njerëzit të cilëve u drejtohej, Allahu i kërkonte Atij t’ua shpjegonte të vërtetën të gjithëve, gjithmonë. Të qenit efektiv në një shërbim të tillë varet gjithmonë nga të pasurit një lidhje të fortë me Zotin.

Në lidhje me urtësinë e ngritjes natën, Kurani bën një vlerësim të tillë: ***“Natyrisht, adhurimi natën vepron më fuqishëm, dhe fjala është më shprehëse. Ngaqë ti ditën je vërtet shumë i zënë.”***³³⁷ Po, në emër të hedhjes së hapave të sigurt nga ana e njeriut, të të dëgjuarit të asaj që thotë dhe të të ndierit të asaj që përjeton, netët, me ato thellësitë e tyre të magjishme, janë një atmosferë e rëndësishme. Ato janë si gjire të veçara nga ku zemrat mund të hapen drejt Allahut (xhel’le xheláluhu)... Dhe duhen shfrytëzuar patjetër. Gjatë ditës, njeriu merret me punë të ndryshme, endet nëpër botën e ndjenjave të tij të jashtme dhe jeton nën ndikimin e tyre. Për Tablonë e Krenarisë së Njerëzimit (s.a.s.), as që mund të bëhet fjalë për diçka të këtillë. Për ne ama, njerëzit e zakonshëm, kjo gjë vlen gjithmonë. Kështu që, kam përshtypjen se do të ishte me vend që ajeti të interpretohej në këtë mënyrë: Allahu, përmes personalitetit të të Dërguarit të Tij, sikur na drejtohet neve me fjalët “Ju, duke u marrë me këtë e atë gjatë ditës, po jetoni si të hutuar; nuk jeni në gjendje t’u drejtoheni thellësive tuaja të brendshme, nuk po lidheni dot me botën e përtejme; dhe as që bëhet fjalë të lidheni. Sepse netët janë thelbësore në këtë çështje. Pra, netët janë periudha kohore e bereqetshme gjatë së cilës njeriu, me zemrën të përvëlur nga malli, do t’i drejtohet Allahut, do të vendosë kokën në sexhde dhe do të derdhë lot. Do të veproni kështu në një kohë dhe vend ku nuk ndodhet askush tjetër dhe vetëm Atij do t’ia hapni zemrën. Vetëm Ai do ta dijë gjendjen

³³⁶ Surja Muzzemmil, ajeti 5.

³³⁷ Surja Muzzemmil, ajetet 6-7.

tuaj dhe ju, duke qenë të vetëdijshëm për faktin se Ai di dhe shikon gjithçka, sipas kësaj do të veproni.”

Jeta e natës e trashëgimtarëve të kauzës së profetësisë

Profetësia mbaroi me Muhamedin (s.a.s.). Ama, kauza e Tij do të vazhdojë përjetësisht. Po me kë? Me trashëgimtarët e kauzës së profetësisë. Për të qenë në gjendje për të kryer misionin e kryer prej profetëve, duhet kaluar nga ura që kanë kaluar ata. Kjo është një detyrë dhe domosdoshmëri.

Për rrjedhojë, netët duhen gjallëruar, duhen hapur dyert e botëve të fshehta, në mënyrë që kjo barrë e rëndë, e cila vërtitet rreth asaj fjale të lartë, të mund të bartet ashtu siç e meriton, në mënyrë që edhe ata që janë mbi një terren të rrëshqitshëm gjatë gjithë kohës dhe që janë nën ndikimin e lakmive, babëzive, tekave dhe inateve njerëzore të mund të shpëtojnë nga këto vese negative dhe të jenë në gjendje për t'u bërë ballë sprovave të fushave të ndryshme. Dhe, kështu, të mos bëhen nga ata që, edhe pse janë mes atyre që i kanë të gjitha mundësitë për të fituar, humbasin!

Po, Allahu ka bërë që kjo kauzë dhe ky shërbim i shenjtë, dikur i përfaqësuar nga profetët, të përfaqësohet gjithmonë nga njerëz të rinj e të freskët dhe jo nga shpirtra të vdekur apo të vyshkur. Pra, nuk ka lejuar që kjo kauzë të përfaqësohet nga ata njerëz që duken sikur janë në krye të një pune, por që, në të vërtetë, nuk ia dalin të jenë. Mes të qenit me të vërtetë dhe të dukurit sikur je ka ndryshime aq sa ka mes qiellit dhe tokës. Allahu nuk e ka përfaqësuar këtë kauzë as me ata që, edhe pse reagojnë ndaj disa gjërave, nuk kanë mundur të bëhen njerëz të aksionit dhe veprimt. Ai ka bërë që kjo kauzë të përfaqësohet vetëm nga heronjtë e vërtetë të zemrës dhe shpirtit. Përkundrazi, kur kjo kauzë u mbetet atyre që janë të pazemër e të pashpirt, Allahu (xhel'le xheláluhu), ashtu siç shprehet edhe në ajetet ***“Nëse ndokush prej jush braktis besimin e vet, djeni se Allahu do të sjellë njerëz, që i do dhe***

*që e duan.*³³⁸ dhe “*Nëse do, Ai ju zhduk dhe sjell krijesa të reja.*”³³⁹, i merr e i largon ata dhe sjell breza krejt të rinj, që, me ditët dhe netët e tyre, e kanë bërë këtë punë qëllim të jetës së tyre dhe mendojnë për udhëzimin e njerëzimit sa herë që hapin e mbyllin sytë. Ka me mijëra njerëz të tillë sot e, në dashtë Zoti, në të ardhmen do të jenë me miliona.

Prandaj, trashëgimtarët e kauzës së profetësisë do t’i kryejnë adhurimet e natës ashtu siç i kryente Muhamedi (s.a.s.), Ai Shembull i Pashoq dhe Udhëzues i Përsosur. Dhe, nëse do të ndodhë që ndonjë natë t’iu ikë pa e shfrytëzuar, atë njëzetekatërorësh duhet ta numërojnë mes ditëve të humbura e të çuara dëm; do të mendojnë në këtë mënyrë dhe, ashtu siç pati vepruar Ademi (a.s.) që nga çasti kur pati menduar se kishte bërë një faj, do të ulin kokën dhe do të shikojnë gjithmonë poshtë... Do të mblidhen kruspull si macja që ka derdhur qumështin dhe do të thonë: “Nuk u ngrita dot këtë natë, ajo më iku pa e gjallëruar. Tani kam mbi shpinë edhe një natë tjetër të vdekur.” Dhe, po i kaloi edhe disa net të tjera kështu, duhet të mendojë në këtë mënyrë: “Më duket se edhe unë do të vdes, edhe unë do të bëhem një i vdekur në mesin e të vdekurve.” Edhe pse është pak rrënqethëse, nëse unë ua them edhe shërbëtorëve të Kuranit këto fjalë, të cilat Allahu (xhel’le xheláluhu) ia ka thënë robit të Tij më të dashur, nuk duhet parë si e tepërt.

Nuk i harroj kurrë fjalët e asaj gruaje të moshuar në Barlla. Kur patëm shkuar për të vizituar shtëpinë e Ustadit, ajo na pati thënë fiks këto fjalë: “Ah, hoxhë efendi! Ah, hoxhë efendi! (E ka fjalën për Ustadin) Gumëzhinte si bletë tek ai rrap deri në mëngjes. Gjatë natës, nuk e shihnim kurrë të flinte.”

Dhe një çështje e fundit: Është vërtetuar përmes një mijë e një përvojash se ata që i gjallërojnë netët e tyre me adhurime, edhe gjatë ditëve vrapojnë porsì kuaj. Deri më sot, unë kam njohur një botë të tërë njerëzish që i kanë këto cilësi e që nuk kanë bërë as më të voglin devijim përgjatë jetës së tyre. Kanë vite të tëra që, me kokat e tyre në

³³⁸ Surja Máide, ajeti 54.

³³⁹ Surja Fátir, ajeti 16.

këtë prag, nuk po lejojnë që netët t'iu shkojnë dëm dhe, sigurisht, nuk mbeten prapa as në çështjen e shërbimit ndaj popullit.

Kurse ata që bëjnë zigzage në jetët e tyre të natës, kanë bërë zigzage edhe gjatë ditëve, në jetët e tyre të Shërbimit. Të këtillët, edhe pse ndonjëherë duken sikur po vrapojnë para të gjithëve në Shërbim, kur janë përballur me vështirësi e probleme, menjëherë kanë kaluar mbrapa. Po, këta nuk kanë qenë në gjendje të durojnë e të përballojnë as më të voglin presion, as më të voglën vështirësi, as më të voglin problem. Sa për të tjerët, që nga dita kur i kam njohur, me gjendjet e tyre shpirtërore gjithmonë të thella, kanë vërshuar si lumenj gjatë netëve, kurse gjatë ditëve, kanë vrapuar si kuaj deri në plasje.

b. Namazi/duaaja i/e nevojtarisë (haxhet)

Namazi i haxhetit dhe duaaja e haxhetit – ashtu si namazi i xhenazes, namazi i shiut apo namazi i eklipseve të hënës dhe diellit – janë nga adhurimet e legjitimuara nëpërmjet sunetit të pastër e të patëmetë të Profetit tonë (s.a.s.). Kur njeriu ka nevojë për diçka, fal një namaz dyrekatësh dhe, pasi këndon edhe disa lutje që na i ka mësuar Pejgamberi ynë (s.a.s.), ia shpreh nevojën Zotit të botëve. Ekzistojnë dy transmetime të ndryshme në lidhje me duanë e haxhetit. Duke qenë se që të dyja i përkasin të Dërguarit të Allahut dhe për të mos u privuar nga begatitë e asnjërës prej tyre, ne, në përgjithësi, i përmendim bashkë të dyja.

Në një hadith të transmetuar nga Tirmidhiu, Profeti ynë (s.a.s.) thotë kështu: *“Kushdo që ka nevojë për diçka nga Allahu apo nga njerëzit, le të marrë mirë abdes, të falë dy rekate namaz dhe, pasi të lavdërojë Allahun e t'i dërgojë salavate të Dërguarit të Tij, të thotë kështu: ‘Nuk ka zot tjetër përveç Allahut. Ai është Përdëllimtari, Bujari. I madhëruar qoftë Allahu, Zoti i Arshit të Madh! Çdo lavdërim i takon Allahut, Zotit të botëve. Zoti im! Kërkoj prej Teje gjërat që do të tërheqin mëshirën Tënde, faljen Tënde absolute, fitimin e çdo të mire dhe shpëtimin prej çdo lloj mëkati! O më Mëshiruesi i mëshiruesve, mos lër tek unë asnjë mëkat të pafalur, asnjë*

qeder të paqetësueshëm dhe, për sa kohë nuk bie ndesh me pëlqimin Tënd, asnjë nevojë të paplotësuar!”³⁴⁰

Sipas një hadithi të transmetuar nga shumë libra hadithesh, përsëri me në krye Tirmidhiun, një person që kishte probleme me shikimin vajti pranë Tablosë së Krenarisë së Njerëzimit (s.a.s.) dhe tha: “O, i Dërguari i Allahut! Sikur t’i ishit lutur Zotit për mua, që të më kthejë sërish shëndetin...” I Dërguari i Allahut (s.a.s.) ia ktheu me këto fjalë: “*Dëshiron që unë të lutem për ty apo të durosh dhe, kështu, të marrësh shpërblimin e durimit? Kjo e dyta është më e hairit për ty.*” “O, i Dërguari i Allahut, lutuni për mua!” tha i gjori burrë. Pas këtyre fjalëve të tij, Profeti ynë (s.a.s.) e këshilloi atë të merrte abdes, të falte dy rekate namaz dhe, pastaj, të lutej e të përgjërohej në këtë mënyrë: “*Allahu im! Prej Teje kërkoj dhe, duke bërë ndërmjetës të Dërguarin Tënd, Profetin e Mëshirës, Muhamedin e nderuar, Ty po të drejtohem e të përgjërohem! O Muhamed, që të më plotësohet kjo nevojë, po i drejtohem Zotit tim duke të bërë ty ndërmjetës! Allahu im, bëje Atë ndërmjetës për mua!*”³⁴¹

Në varësi të horizontit të tij dhe vlerës që ka, çështjet që një njeri mund t’i shohë si nevoja mund të ndryshojnë shumë nga njëra-tjetra. Sidoqoftë, nuk ka dallime në çështjen e gjërave që duhen kërkuar nëpërmjet namazit të haxhetit, nuk është vendosur ndonjë kusht. Për shembull, një njeri mund të thotë “Kjo është nevoja ime.” dhe të falë namazin e haxhetit me dëshirën që të korrat e tij të jenë më të bereqetshme. Për të mirën e të gjithëve, përveçse të bëjë lutjen e shiut, mund të falë edhe namazin e haxhetit e të lutet që të bjerë shi. Ose mund të falë namazin e haxhetit për të bijtë, që të jenë fëmijë të mbarë e të hairit, dhe t’i përgjërohet Allahut të Madhëruar me fjalët “Allahu im! Jepu këtyre mend e urtësi, dhe mos lejo që të bien në rrugë të keqe!”. Këto kërkesa janë në përpjestim të drejtë me përpjekjet dhe qëllimet e individëve dhe ne nuk mund të nënvlerësojmë asnjërën prej tyre.

Që besimtari/besimtarja të kërkojë një bashkëshorte/bashkëshort të mirë, një fëmijë të mbarë, një të ardhme të mirë për fëmijët e vet, –

³⁴⁰ Tirmidhí, uitr 348; Ibn Máxhe, ikáme 189.

³⁴¹ Tirmidhí, de’auát 119; Ibn Máxhe, ikámetus’salát 189.

sipas një përpjekjeje dhe qëllimi të caktuar – është një gjë e mirë. Dhe njeriu duhet t'ia kërkojë këto gjëra Allahut. Sipas logjikës së një sahabi, po të humbasim lidhësen e këpucës, edhe atë Allahut ia kërkojmë. Pra, ne çdo gjë prej Allahut e kërkojmë, qoftë ajo e vogël apo e madhe.

Por, nga ana tjetër, përpjekjet dhe qëllimet e profetëve janë shumë të larta. Për shembull, kur ngrenë duart lart, ata lutën kështu: “Allahu im! Të lutem, zbuti zemrat e njerëzve ndaj imanit!” Edhe pse jo tamam të njëjtat fjalë, mes lutjeve të transmetuara nga Profeti ynë (s.a.s.) gjenden shprehje të ngjashme me këtë, por më të thella.

Çështjet që paraqiten si nevoja nga ana e njerëzve janë sipas nivelit të përpjekjes dhe qëllimeve të gjithsecilit. Për shembull, disa besimtarë ia kanë kushtuar jetën e tyre tërësisht përhapjes së fesë mbi të gjithë sipërfaqen e tokës. Ata mbase hanë dhe pinë aq sa për të mos vdekur urie, mbase gjenden brenda një marrëdhënieje të caktuar me familjet dhe fëmijët e tyre; ama sytë i kanë gjithmonë të kthyer për tek Allahu.

Pra, mund të themi se dikush fal namazin e nevojtarisë për një kërkesë të vogël të tijën, për më tepër, që ka të bëjë me këtë dynja. Dikush tjetër i drejtohet Zotit të Madhëruar, fal namazin e nevojtarisë dhe bën dua për gjëra që kanë të bëjnë me myslimanët në përgjithësi apo me gjithë njerëzimin. Dikush tjetër i lutet Zotit të Plotfuqishëm për përhapjen e fesë kudo nëpër tokë dhe për zbutjen e zemrave të qafirëve dhe gjynahqarëve, në mënyrë që edhe zemrat më inatçore të qetësohen e të bëhen të ndjeshme ndaj imanit. Njerëzit që e njohin sadopak Individualitetin Hyjnor, ata që i njohin Profetin tonë (s.a.s.) dhe Kuranin Famëlartë, qoftë edhe në njëfarë mase, nuk duhet të aspirojnë për gjëra të vogla e të thjeshta. Ata duhet t'i mbajnë sa më lart përpjekjet dhe qëllimet e tyre, duhet të aspirojnë për gjëra sa më sublime. Sepse, në një kuptim, është zhgënjyese të shkosh e të kërkosh hekur dhe bakër në një vend ku mund të kërkohet ari e argjendi.

Krahas këtyre, mund të falet namaz haxheti dhe të bëhet dua edhe për të kërkuar forcimin e imanit dhe mosrreshqitjen e zemrës. Sepse këto, në emër të të ndierit të gjërave të tjera sublime, janë baza shumë

të rëndësishme. Nëse nuk ke një iman të fortë e sakllam, nëse zemra jote bën vazhdimisht zigzage, si mund të pretendosh atëherë për bartjen e ndjenjave sublime në emër të të gjithë njerëzimit? Njeriut i nevojitet të ketë një horizont shumë serioz dijesh, një dashuri dhe dëshirë hyjnore të madhe, frikë dhe respekt. Njeriu duhet të falë namaz haxheti edhe për të gjitha këto, duhet t'i lutet e t'i përgjërohet Allahut duke i rreshtuar duatë njëra pas tjetrës.

Si falet namazi i nevojtarisë?

Në hadithe, namazi i nevojtarisë përshkruhet si një namaz që përbëhet prej dy ose katër rekatesh.³⁴² Edhe pse nuk ka një pohim të qartë në lidhje me suret që duhen kënduar në këtë namaz, disa dijetarë janë shprehur duke thënë se, ashtu si në namazin për forcimin e kujtesës, edhe në namazin e nevojtarisë mund të këndohen sure të tilla si suret Sexhde, Dehr dhe Jasin. Mirëpo, as kjo pikëpamje nuk është dhe aq e besueshme. Mund të japim si shembuj këto ajete:

“Ata (engjëj) që e mbajnë Fronin dhe ata që janë rreth tij, e madhërojnë Zotin e tyre me falënderim dhe i besojnë Atij. Ata lypin falje për besimtarët duke thënë: ‘O Zoti ynë, Ti përfshin çdo gjë me mëshirën dhe dijeninë Tënde, prandaj fali ata që janë penduar e që ndjekin rrugën Tënde dhe ruaji ata prej dënimit të Zjarrit flakërues!’”³⁴³

“Tashmë ju ka ardhur një i Dërguar nga gjiri juaj. Atij i vjen rëndë për gjynahet që bëni ju, jua dëshiron të mirën me gjithë zemër, që ju të shkoni rrugës së drejtë, dhe është i butë e i mëshirshëm me besimtarët. Nëse ata largohen (nga e vërteta), thuaj: ‘Më mjafton Allahu, s’ka zot tjetër përveç Tij. Unë mbështetem tek Ai që është Zot i Fronit të Madh!’”³⁴⁴

³⁴² Ahmed ibn Hanbel, el Musned 6/450.

³⁴³ Surja Mu'min, ajeti 7.

³⁴⁴ Surja Teube, ajetet 128-129.

“Allahu nuk e ngarkon askënd përtej fuqisë që ka: në dobi të tij është e mira që bën, kurse në dëm të tij është e keqja që punon. Zoti ynë, mos na ndëshko për atë që harrojmë ose veprojmë pa qëllim! Zoti ynë, mos na ngarko barrë të rëndë, ashtu si i ngarkove ata para nesh! Zoti ynë, mos na ngarko me diçka që nuk mund ta bartim! Na i shlyej gjynahet tona, na i fal ato dhe na mëshiro! Ti je Zoti ynë! Prandaj na jep fitore kundër atyre që nuk besojnë!”³⁴⁵

Këto ajete, ndërkohë që nga njëra anë të bëjnë të mendosh për mëshirën e pafund të Zotit të Madhërishëm, nga ana tjetër, bëjnë që zemra e robit të zbutet e të fitojë përqendrimin e duhur.

Pas faljes së namazit, së pari duhet lartësuar, madhëruar dhe lavdëruar Allahu i Madhërishëm me këto fjalë: *“Allahu është më i Madhi. Atij i takojnë të gjitha llojet e falënderimeve dhe lavdërimeve. Vetëm Ai e meriton të përmendet në çdo kohë. Nuk ka zot tjetër përveç Allahut, të Vetmit! Allahu është Ai që e ndihmon robin e Tij, që e bën ushtrinë e Tij të lavdishme dhe që, i Vetëm, i çon në humbje ushtritë armike. Ai nuk ka shok. Allahu im! Askush nuk mund të ma mohojë atë që më jep Ti, askush nuk mund të ma japë atë që ma mohon Ti! Askush nuk mund ta kthejë mbrapsht, askush nuk mund ta ndryshojë caktimin Tënd në lidhje me atë që Ti dëshiron të ndodhë! Përkarshi Teje, pasuria, fama, nderi dhe fuqia nuk u sjellin asnjë dobi të zotëve të tyre!”*

Njeriu duhet t'i thotë këto për ta nderuar dhe lartësuar Allahun e Madhëruar. Megjithatë, Pejgamberi ynë (s.a.s.) nuk ka caktuar diçka të prerë në këtë pikë. Për shembull, mund të këndonin edhe tre ajetet e para të sures *Fatiha*, nëse doni. Pra, e rëndësishme është që, në fillim, Allahu të përmendet, të madhërohet e të lavdërohet ashtu siç i takon Atij. Pastaj, me një *hushú* të plotë e të përsosur, i dërgohet një përshëndetje gjithëpërfshirëse Profetit tonë (s.a.s.). Më pas, mund të përmenden një nga një emrat e atyre që do të përfshihen në atë përshëndetje. Pas përmendjes së Kalifëve të Drejtë në një kategori të veçantë, kalohet në përmendjen e *Ehli Bejtit* (pjesëtarët e familjes fisnike të Profetit

³⁴⁵ Surja Bekare, ajeti 286.

Muhamed (s.a.s.). Më pas, përmenden me radhë emrat e profetëve të mëdhenj. Pastaj përmenden emrat e engjëjve më të afërt me Zotin. Në fund të kësaj përshëndetjeje gjithëpërfshirëse, duke përmendur edhe emrat e më të mëdhenjve nga mesi i miqve të Allahut të kohëve të kaluara, mund t'i bëjmë edhe ata pjesë të lutjes sonë.

Bëhet një përshëndetje e tillë gjithëpërfshirëse dhe, për ta përfunduar atë, thuhet *“Aq sa grimcat e universit dhe gjërat që formohen prej tyre!”* ose *“Aq sa janë gjërat që mbushin qiejt e tokën (aq sa atomet, elektronet, molekulat, jonet e qiejve dhe tokës) dhe aq sa dëshiron Ti, o Zot!”*. Në fakt, të gjitha këto janë gjëra të kufizuara, pra, që mund të numërohen. Kështu që, në emër të të shprehurit të pafundësisë përmes asaj që është me të vërtetë e pafundme, mund të thuhet edhe kështu: *“Allahu im! Dërgo mbi ta paqe e mëshirë aq sa dija dhe njohuritë e Tua të pafund!”*

Pasi kryhen këto, bëhen dua për umetin e Muhamedit (s.a.s.). Gjatë këtyre lutjeve mund të thuhet edhe këto fjalë: *“O Zoti ynë! Më fal mua, fali prindërit e mi dhe të gjithë besimtarët! Na fal ne në atë ditë kur do të bëhet gjykimi i çdokujt!”* Një dua tjetër është edhe ajo që bëhet në mëngjes e mbrëmje nga të ashtuquajturit *‘ebdáll*³⁴⁶: *“Allahu im! Mëshiroje umetin e Muhamedit! Allahu im! Fale umetin e Muhamedit!”*

Këto janë gjërat që duhen bërë si parathënie e duasë para se të kalohet tek ajo. Pasi kryen këto, këndohet duaja e haxhetit:

“Nuk ka zot tjetër përveç Allahut. Ai është Përdëllimtari, Bujari. I madhëruar qoftë Allahu, Zoti i Arshit të Madh! Çdo lavdërim i takon Allahut, Zotit të botëve. Zoti im! Kërkoj prej Teje gjërat që do të tërheqin mëshirën Tënde, faljen Tënde absolute, fitimin e çdo të mire dhe shpëtimin prej çdo lloj mëkati! O më Mëshiruesi i mëshiruesve, mos lër tek unë asnjë mëkat të pafalur, asnjë qeder të paqetësueshëm dhe, për sa kohë nuk bie ndesh me pëlqimin Tënd, asnjë nevojë të paplotësuar! Allahu im! Ti je Ai

³⁴⁶ *Ebdáll* është shumësi i fjalës *bedil*, e cila bart kuptimin e njeriut të pastër, të çiltër e zemërmirë. Ky term përdoret për ata njerëz të lartë shpirtërisht e të dashur tek Allahu, që u lejohet të mbikëqyrin punët e popullit dhe që janë rojtarë dhe duartrokitës të veprimtarisë hyjnore. (M. F. Gylen, *Miqhtë e Allahut*, Majat e Smeralda të Zemrës 3/75)

që vendos në gjërat për të cilat robërit e Tu bien në kundërshtim me njëri-tjetrin! Nuk ka zot tjetër veç Allahut, të Lartit, Madhështorit! Nuk ka zot tjetër veç Allahut, Përdëllimtarit, Bujarit! I madhëruar është Zoti i shtatë qiejve dhe Zoti i Arshit të Madh! Çdo lavdërim i përket Allahut, Zotit të botëve! O Allahu im, Ti që i lehtëson hallet, heq shqetësimet, i përgjigjesh lutjes së të pashpresëve kur të luten, o Mëshiruesi dhe Shpërblyesi i kësaj bote dhe i botës tjetër, mëshiromë mua me plotësimin e kësaj nevoje, në mënyrë që të mos mbetem nën mëshirën e të tjerëve!”

Pas kësaj, robi duhet të thotë dëshirën apo kërkesën që dëshiron t’ia paraqesë Allahut. Për shembull, një njeri me qëllime të larta, në emër të nevojës së tij, mund të thotë këto: *“Allahu im! Lartësoje kudo emrin Tënd të Lartë, të drejtën, të vërtetën dhe fenë Islame! Hapi zemrat tona dhe ato të të gjithë robërve të Tu ndaj imanit, Islamit, vetëdijes së ihsanit, Kuranit dhe shërbimeve të Kuranit!”*

Në një hadith thuhet se, kur Allahu i Madhëruar e do një rob, ai rob pritet mirë nga të gjithë në qiej e në tokë.³⁴⁷

Duke u bazuar në këtë hadith, mund të bëhet edhe një dua e këtillë: *“Allahu im! Vendos dashuri për ne në zemrat e robërve të Tu në qiej dhe në tokë!”* Nëpërmjet këtyre fjalëve, kërkojmë që edhe ne të prano kemi kudo nga të gjithë, të gjitha zemrat të hapen për ne dhe, në këtë mënyrë, të kemi mundësinë për t’i shërbyer me sinqeritet fesë.

Një pikë tjetër e rëndësishme në çështjen e duasë është edhe kjo: Nëse e përmend edhe umetin e Muhamedit (s.a.s.) atëherë kur do të lutesh për veten tënde, kjo situatë do të bëjë që mëshira e Allahut të Madhëruar të shkundet mbi ty. Sepse, në këtë mënyrë, Allahu do të të shikojë si robin e Tij që mendon edhe për robërit e tjerë të Tij. Dhe kjo gjë është shumë e rëndësishme.

³⁴⁷ Buhárí, bed’ul halk 6, edeb 41, teuhíd 33; Muslim, birr 157.

PJESA E NËNTË



*DUATË QË MUND TË THUHEN
NË NAMAZ*

Një pjesë e duave, që na janë përcjellë nga i Dërguari i Allahut (s.a.s.) dhe që mund të thuhën në pjesë të ndryshme të namazit, janë si më poshtë:

1. Duatë që mund të thuhën në ruku

“O Zot, Ti je larg çdo të mete, atributet më të përsosura vetëm Ti i ke! Të përmend Ty, o i Patëmetë! Ti nuk ke nevojë për ortakë e ndihmës, o i Pashoqi i Lartë!”³⁴⁸

“E përmend dhe madhëroj Zotin e Lartë e Madhështor, Zotin e botëve të dukshme e të padukshme!”³⁴⁹

“Të përmend e të madhëroj Ty, Allahu im! Ti je larg çdo të mete! Zoti ynë, Ty të takon falënderimi! Falmë mua, Allahu im!”³⁵⁰

“Ti je i Pastër, Ti je larg të metave dhe mangësive! Ti je i Shenjtë! Ti je Zoti i engjëjve dhe i Shpirtit!”³⁵¹

³⁴⁸ Muslim, salátul musáfirín 203; Tirmidhí, salát 194; Nesáí, iftitáh 77, 78, tatbík 9, 26, 77, 86; Ibn Máxhe, ikáme 20, 179.

³⁴⁹ Ebú Dáúd, salát 147; Nesáí, tatbík 12.

³⁵⁰ Buhárí, edhán 123, 139, megázi 51; tefsíru síure (110) 1; Muslim, salát 217.

³⁵¹ Muslim, salát 223; Ebú Dáúd, salát 147; Nesáí, tatbík 11.

“Allahu im, para Teje u përkula, Ty të besova dhe Ty t’u nënshtrova! Ti je Zoti im. Veshët e mi, sytë e mi, truri im, kockat e mia, nervat e mia dhe çdo gjë që bartin këmbët e mia i janë nënshtruar Allahut, Zotit të botëve, dhe i janë bindur Atij.”³⁵²

2. Duatë që mund të thuhën kur ngrihemi nga rukuja

“O Zoti ynë, lavdia dhe falënderimi janë për Ty!”³⁵³

“O Zoti ynë, falënderimi të takon Ty! Falënderime e lavdërime të shumta, të dëlira dhe të bekuara qofshin për Ty!”³⁵⁴

“Zoti ynë, lavdi Ty sa qiejt, toka dhe ç’ka mes tyre; lavdi Ty sa të gjitha gjërat që dëshiron Ti!”³⁵⁵

“O Zoti ynë, Ti që e meriton çdo lavdërim! Fjala më e denjë që mund të thonë robërit e Tu – të gjithë ne jemi robërit e Tu – është: ‘Allahu im, askush nuk mund të bëhet pengesë për atë që e mundëson Ti dhe askush nuk mund ta mundësojë atë që e pengon Ti. Përkarshi Teje, nuk ka famë e nder që t’i sjellë dobi të zotit të tyre.’”³⁵⁶

“Allahu im! Pastromë mua me ujë të ftohtë, dëborë dhe breshër! Allahu im, pastromë mua prej mëkateve dhe gabimeve siç pastrohet një rrobë e bardhë nga papastërtitë!”³⁵⁷

³⁵² Nesáí, iftitah 104; Ahmed ibn Hanbel, el Musned 2/268.

³⁵³ Buhárí, edhán 51; Muslim, salát 28.

³⁵⁴ Buhárí, edhán 126; Muslim, mesáxhid 149.

³⁵⁵ Muslim, salátul musáfirin 201; Tirmidhí, de’auát 32; Ebú Dáúd, salát 118.

³⁵⁶ Muslim, salát 205; Ebú Dáúd, taháret 143.

³⁵⁷ Buhárí, de’auát 44; Muslim, mesáxhid 129.

3. Duatë që mund të thuhet në sexhde

“I madhëruar qoftë Zoti im i Lartë!”³⁵⁸

“O Allah, o Zoti ynë! Të përmend e të lavdëroj me një lavdërim të denjë për Ty! Falmë mua, o Allahu im!”³⁵⁹

“Allahu im! Strehohem nga zemërimi Yt po te pëlqimi Yt! Strehohem nga dënimi Yt te falja Jote! Zoti im! Strehohem nga Ti te Ti (nga ashpërsia Jote te bukuria Jote, nga zemërimi Yt te mëshira Jote)! Pranoj se jam i paaftë për të të lavdëruar Ty në masën që e lavdëron Ti Vetën.”³⁶⁰

“Allahu im! Ty të bëra sexhde, Ty të besova, tek Ti u dorëzova. Edhe fytyra ime i bën sexhde Krijuesit të saj, që e ka krijuar dhe i ka dhënë formë, që i ka vënë veshë e sy. Sa i lartë je Ti, o Allah! Ti je Ai që e ka krijuar çdo gjë në trajtën e saj më të bukur! Veshët, sytë, gjaku, mishi, kockat, nervat e mia dhe çdo gjë tjetër që bartin mbi vete këmbët e mia i janë nënshtruar Allahut, Zotit të botëve, dhe i janë bindur Atij!”³⁶¹

“Ti je i Pastër, Ti je larg të metave dhe mangësive! Ti je i Shenjtë! Ti je Zoti i engjëjve dhe i Shpirtit!”³⁶²

“Allahu im! M'i fal të gjitha mëkatet, të vegjël e të mëdhenj, të vjetër e të rinj, të fshehtë e të hapur! E përmend dhe madhëroj Zotin e Lartë e Madhështor, Zotin e botëve të dukshme e të padukshme!”³⁶³

³⁵⁸ Muslim, salátul musáfirín 203; Tirmidhí salát 79; Ebú Dáúid, salát 150, 153.

³⁵⁹ Buhárí, edhán 123, 139, tefsíru súde (1) 2; Muslim, salát 217.

³⁶⁰ Muslim, salát 222; Tirmidhí, de'auát 76, 113; Ebú Dáúid, salát 340.

³⁶¹ Muslim, salát 216; Ebú Dáúid, salát 147.

³⁶² Muslim, salát 223; Ebú Dáúid, salát 147; Nesáí, tatbík 11.

³⁶³ Muslim, salátul musáfirín 201; Ebú Dáúid, salát 118; Tirmidhí, de'auát 32.

4. Duatë që mund të thuhet mes dy sexhdeve

“Allahu im! Falmë mua, mëshiromë, më jep shëndet, më udhëzo në rrugë të drejtë, më ushqe, m’i plotëso mangësitë që kam dhe lartësomë!”³⁶⁴

“Zoti im, më mundëso mua jo një zemër të pafat dhe mosmirënjohëse, po një zemër të pastruar prej shirkut, të dëlirë dhe të mbushur me ndjenjën e devotshmërisë!”³⁶⁵

“Zoti im, më fal, më mëshiro, mos m’i vë re gabimet dhe mëkatet, falmi ato! Pa dyshim, Ti je i Gjithëpushtetshmi, i Nderuari dhe Bujari!”³⁶⁶

5. Duatë që mund të thuhet në teshehud

“Allahu im! Unë i kam bërë shumë padrejtësi vetes sime; askush tjetër përveç Teje nuk mund t’i falë mëkatet. Falmë mua me një falje prej Lartësisë Tënde dhe mëshiromë! Pa dyshim, Ti je Falësi, Mëshiruesi!”³⁶⁷

“Allahu im! Falmi të gjitha mëkatet që kam kryer, mëkatet e kohës së shkuar dhe ato të së ardhmes, ato që i kam kryer haptas dhe ato që i kam kryer tinëz, falmi edhe ato mëkate të miat që Ti i di shumë më mirë se unë! Ti je Ai që të çon para, Ti je Ai që të lë pas. Nuk ka zot tjetër përveç Teje!”³⁶⁸

“Allahu im! Strehohem tek Ti nga vuajtja e varrit! Allahu im! Strehohem tek Ti nga fitneja e Dexhalit! Allahu im! Strehohem tek Ti nga fitneja e jetës dhe vdekjes!”³⁶⁹

³⁶⁴ Tirmidhí, salát 211; Ibn Máxhe, ikáme 23.

³⁶⁵ Bejhakí, Fedáilul eukát fq. 27.

³⁶⁶ Ibn Ebí Shejbe, el Musan’nef 3/420.

³⁶⁷ Buharí, edhán 149, teuhíd 9, de’auát 16; Muslim, dhikr 47, 48.

³⁶⁸ Muslim, salátul musáfirin 201, dhikr 70; Tirmidhí, de’auát 32; Ebú Dáúd, salát 121, fedáil 358.

³⁶⁹ Buharí, xhenáiz 86; Muslim, mesáxhid 129.

“Allahu im! Strehohem tek Ti nga vuajtja e Xhehenemit, vuajtja e varrit, fitneja e Dexhalit dhe nga fitneja e jetës dhe vdekjes! Allahu im! Strehohem tek Ti nga borxhi dhe mëkati!”³⁷⁰

6. Ajetet që mund të thuhën si dua në çdo pjesë të namazit

Duaja e Ademit (a.s.): *“O Zoti ynë! Ne e kemi futur veten në gjynah, prandaj, nëse Ti nuk na fal dhe nuk na mëshiron, ne vërtet që do të jemi nga të humburit.”³⁷¹*

Duaja e Junusit (a.s.): *“S’ka zot tjetër përveç Teje! Qofsh i lavdëruar! Me të vërtetë, unë kam gabuar!”³⁷²*

Duaja e Ejubit (a.s.): *“Mua më ka goditur fatkeqësia e Ti je më mëshiruesi i mëshiruesve!”³⁷³*

Duaja e Musait (a.s.): *“O Zoti im! Njëmend, unë i kam bërë keq vetes, andaj më fal!”³⁷⁴*

Duaja e atyre që luftojnë në rrugën e Allahut: *“O Zoti ynë! Na i fal gjynahet tona dhe teprimin në punën tonë, na i forco këmbët (në istikam) dhe na ndihmo kundër popullit jobesimtar!”³⁷⁵*

³⁷⁰ Buhárí, edhán 149; Muslim, mesáxhid 129, 134.

³⁷¹ Surja Aráf, ajeti 23.

³⁷² Surja Enbijá, ajeti 87.

³⁷³ Surja Enbijá, ajeti 83.

³⁷⁴ Surja Kasas, ajeti 16.

³⁷⁵ Surja Ál Imrán, ajeti 147.

Duaja e të devotshmëve: “Zoti ynë! Me të vërtetë kemi besuar, andaj na i fal gjynahet tona dhe na ruaj nga dënimi i zjarrit!”³⁷⁶

Duaja e shokëve të shpellës (As’hábi Kehf) : “O Zoti ynë, na jep mëshirë nga ana Jote dhe përgatitna për sjellje të drejtë!”³⁷⁷

Duaja për ruajtjen e drejtimit të zemrës: “O Zoti ynë! Mos lejo që zemrat tona të shmangen (nga e vërteta) pasi na ke udhëzuar në rrugën e drejtë, dhe jepna mëshirë prej Teje; vërtet, Ti je Dhuruesi i Madh!”³⁷⁸

7. Nga duatë e tjera të Profetit tonë (s.a.s.)

“O i Gjallë, i Përjetshëm dhe Mbajtës i gjithçkaje! Duke i besuar gjerësisë së mëshirës Tënde, kërkuj të më mëshirosh! M’i përmirëso të gjitha gjendjet e mia dhe mos më lër vetëm për vetëm me nefsin tim as sa hap e mbyll sytë!”³⁷⁹

“Allahu im! Na e bëj të dashur imanin dhe na i zbukuro zemrat me të! Na i bëj të shëmtuar kufrin, mëkatet dhe rebelimin ndaj Teje! Na bëj ne nga robërit e Tu të drejtë!”³⁸⁰

“Allahu im! Na mundëso arritjen e një përfundimi të bukur në të gjitha punët! Na ruaj nga poshtërsitë e dynjasë dhe vuajtjet e botës tjetër!”³⁸¹

“O Zoti im, nuk ka zot tjetër përveç Teje, Ti je larg çdo të mete! Allahu

³⁷⁶ Surja Ál Imrán, ajeti 16.

³⁷⁷ Surja Kehf, ajeti 10.

³⁷⁸ Surja Ál Imrán, ajeti 8.

³⁷⁹ Nesáí, es’Sunenul kubrá 6/147; Bezzár, el Musned 13/49.

³⁸⁰ Ahmed ibn Hanbel, el Musned 3/424; Nesáí, es’Sunenul kubrá 6/156.

³⁸¹ Ahmed ibn Hanbel, el Musned 4/181; Taberání, el Mu’xhemul kebír 2/33.

im! Kërkoj të më falësh mëkatin, kërkoj mëshirën Tënde. Allahu im! Shtoma dijen dhe mos lejo që, pasi të më kesh udhëzuar në rrugën e drejtë, zemra ime të rrëshqasë përsëri; më mëshiro me mëshirën Tënde; pa dyshim Ti je Dhuruesi shumë mirëbërës.”³⁸²

³⁸² Ebú Dáúd, edeb 99; Nesáí, es’Sunenul kubrá 6/216; el Hákim, el Mustedrek 1/724.

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Gylen, M. Fethullah

Namazi adhurimi në dimensionet e miraxhit / M. Fethullah

Gylen ; përkth. Alfons Pupli. - Tiranë : Zambaku, 2024.

... f. ; ... cm. - (Kolana Prizmi).

Tit. origj.: Namaz, mirac engilikli ibadet.

ISBN 9789928476517

1.Feja islame 2.Rite dhe ceremoni

28 -53 -543.2